

ENVER HOXHA

VEPRA

50

PROLETARE TË TË GJITHA VENDEVE, BASHKOHUNII

ENVER HOXHA

VEPRA

BOTOHET ME VENDIM TË KOMITETIT
QENDROR TË PARTISE SË PUNËS TË
SHQIPËRISE



ENVER HOXHA

INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE-LENINISTE
PRANË KQ TE PPSH

ENVER HOXHA

VELLIMI

50

JANAR 1973 – PRILL 1973

SHTËPIA BOTUESE «3 NENTORI»
TIRANË, 1986

PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 50-TË

Vëllimi i 50-të i Veprave të shokut Enver Hoxha përmban materiale të periudhës janar-prill 1973, pjesa më e madhe e të cilave botohen për herë të parë.

Edhe në shkrimet e këtij vëllimi duket qartë se Partia dhe shoku Enver Hoxha kanë analizuar me kujdes rezultatet e arritura dhe kanë shtruar për zgjidhje probleme e detyra të kohës e të perspektivës për zhvillimin tërësor e harmonik të gjithë jetës së vendit, për vazhdimin e ndërtimit të plotë të shoqërisë sociale.

Në fjalën e mbylljes në Plenumin e 3-të të KQ të Partisë më 6 shkurt 1973 tërhoqet vëmendja se plotësimi me sukses i detyrave të planit në çdo zë, në kohë, në sasi dhe në cilësi arrihet kur njerëzit punojnë me mobilizim e me frymë të lartë revolucionare në çdo sektor e degë të ekonomisë. «Ekonomia jonë socialiste, — thekson shoku Enver Hoxha, — është një unitet i lidhur organikisht dhe i bashkërenduar në bazë të një plani të shqyrtaur dhe të aprovuar në të gjitha hallkat dhe instancat përkatëse». Kuptimi i drejtë i këtyre lidhjeve të brendshme të proceseve ekonomike nga punonjësit dhe komunistët mbetet kërkesë e kohës dhe bazë për realizimin e detyrave në të gjithë sektorët. Duke vënë në dukje se ekonomia jonë e centralizuar nuk ka asgjë

të ngjashme me anarkinë e me dukuri të tjera të ekonomisë së vendeve borgjeze e revizioniste, në disa shkrime të këtij vëllimi nënvízohet se çdo mungesë apo mosrealizim në një hallkë do të rrezatonte negativisht dhe në degët e tjera të ekonomisë. Prandaj për organet e Partisë e të pushtetit në qendër e në bazë merr rëndësi të veçantë kuptimi i thellë i politikës ekonomike të Partisë dhe kontrolli sistematik e rigoroz për plotësimin e detyrave të planit të prodhimit, për qarkullimin e mallrave, për përmirësimin e furnizimit të popullsisë, duke shiuar veçanërisht prodhimin bujqësor.

Me rëndësi të madhe në këtë vëllim janë disa shkrime që trajtojnë probleme e detyra të punës së Partisë në frontin ideologjik e kulturor. Me guxim të rrallë politik e ideologjik shoku Enver Hoxha theksion nevojën e një lufte të papajtueshme, në të dy krahët, si kundër liberalizmit, ashtu edhe kundër konservatorizmit, duke dënuar qëndrimet armiqësore të Fadil Paçramit e Todi Lubonjës dhe duke kritikuar shfaqjet e huaja liberale e moderniste që u dukën në kulturë, në letërsi dhe arte, në radiotelevizion etj. Ai ndalet gjërësisht në kuptimin e rrezikut të rrethimit imperialisto-revizonist, të presionit e të ndikimit të tij në njerëzit tanë. Në diskutimin e datës 9 janar në mbledhjen e Presidiumit të Kuvendit Popullor, në fjalën e 15 marsit në mbledhjen e përgjithshme të komunistëve të aparatit të KQ të PPSH, si dhe në dokumente të tjera, shoku Enver Hoxha trajton në dritën e mësimeve marksiste-leniniste probleme teorike e ideologjike, tregon shkaqet dhe pasojat e dukurive negative dhe u bën thirrje gjithë komunistëve e masave për vigjilencë të

lartë e luftë klasore frontale. Papajtueshmëria e Partisë ndaj shfaqjeve të huaja dhe qëndrimeve liberale, si dhe kapja e problemit në kohë ngritën në këmbë komunistët, masat punonjëse e gjithë forcat krijuarë dhe bënë të dështojnë planet e armiqve.

Ndër çështjet e rëndësishme që gjejnë pasqyrim në materialet e kësaj periudhe është edhe edukimi revolucionar i rinisë. Në bisedën e 27 janarit, në diskutimet në mbledhjen e Sekretariatit të KQ më 23 shkurt e një problem jo vetëm i parë me përparësi, por edhe që kërkon kujdes të përhershëm, pasi, siç theksohet në to, rinia përbën një nga pikësynimet e luftës së armique të brendshëm e të jashtëm, të presionit dhe të ndikimit të shumëlojshëm borgjezo-revizonist. Në vëllim nënvi-zohet se në luftë kundër koncepteve e shfaqjeve të huaja liberale në sjellje, në mënyrën e paraqitjes e të veshjes, në mënyrën e jetesës etj., kërkohet që të ve-projnë energjikisht, në radhë të parë, komunistët dhe organizatat-bazë të Partisë, organizata e BRPSH, shkolla, familja dhe mbarë shoqëria.

Për të përballuar me sukses rrëthimin imperialisto-revizonist dhe presionin e tij ndaj vendit tonë, shoku Enver Hoxha thekson se krahas brumosjes ideopolitike të komunistëve, të rinisë e të gjitha masave punonjëse, rëmendje e veçantë i duhet kushtuar forcimit të pandërrerë të ekonomisë, forcimit të situatës së brendshme dhe rritjes së fuqisë mbrojtëse të vendit. Lidhur me këtë, në disa materiale trajtohen një sërë probleme të rëndësishme që u dalin Partisë, organizatave-bazë, gjithë komunistëve në terren e në ushtri, për për-

gatitjen ushtarake, ideologjike, morale, fizike dhe teknike të forcave të armatosura dhe të të gjithë popullit ushtar, për zhvillimin me cilësi të stërvitjeve ushtarake, në luftë me formalizmin, shablonizmin e rutinën. Duke zërthyer tezën «gjithë populli ushtar», shoku Enver Hoxha shtron detyra të rëndësishme para organizatave të Partisë në terren dhe në ushtri, si dhe kritikon e hedh poshtë konceptet borgjezo-revisioniste për ushtrinë e kazermës, që, siç do të vërtetohej më vonë, i përhapnin dhe i kultivonin armiqëtë puçistë në ushtri.

Çështjet e ndryshme të politikës ndërkombëtare janë një tjetër drejtim ku shoku Enver Hoxha, edhe nëpërmjet materialeve të kësaj periudhe, shpreh qëndrimin parimor, marksist-leninist të Partisë sonë, rikonfirmion marksizëm-leninizmin si të vetmen busull për t'u orientuar në vlerësimin drejt të situatave. Në takimet e bisedat me miq të huaj Ai edhe një herë thekson qëndrimin e vendosur të Partisë sonë në vlerësimin e situatave botërore, qëndrimin internacionalist ndaj gjithë forcave revolucionare e liridashiёse në botë, domosdoshmérinë e përkrahjes së revolucionit dhe të luftës çlirimtare të popujve nga pozitat e marksizëm-leninizmit, si dhe kundërshtimin e politikës hegjemoniste, agresive e luftënxitëse të superfuqive. Në këto materiale u bëhet një analizë e gjithanshme proceseve të zhvillimit botëror, natyrës imperialiste dhe agresive të superfuqive, si dhe formave e metodave që përdorin borgjezia dhe revizionizmi për të shtrirë sundimin e tyre jo vetëm nëpërmjet agresioneve ushtarake, por edhe nëpërmjet diversionit ideologjik e kulturor, në-

përmjet liberalizmit e degjenerimit të njerëzve. Përballë kësaj vale diversioniste të presionit imperialisto-revisionist, kërkohen intensifikimi dhe mbajtja vazhdimisht ndezur c luftës së papajtueshme klasore në të gjitha fushat e jetës.

Edhe në materialet e këtij vëllimi, si në gjithë Venprën e pavdekshme të shokut Enver Hoxha, komunistët dhe mbarë populli ynë do të gjejnë zgjidhje, orientime, këshilla dhe frymëzim në rrugën e pandalshme të revolucionit.

Vëllimi është i pajisur me tregues.

ZHVILLIMI I LETËRSISË DHE I ARTEVE TË BËHET NË LUFTË KUNDËR ÇDO NDIKIMI TË HUAJ IDEOLOGJIK

*Diskutim në mbledhjen e Presidiumit
të Kuvendit Popullor të RPSH¹*

9 janar 1973

Meqenëse u bë një pyetje këtu nga shoku Kahreman Ylli për çështjet e arsimit dhe të kulturës, dua të flas pikërisht për këto dy probleme, sidon që duket sikur ato janë jashtë temës që po diskutojmë sot në këtë mbledhje. Megjithatë mendoj se jam brenda temës, sepse organet e pushtetit duhet të merren me të gjitha çështjet e zhvillimit të vendit tonë, aq më tepër për kulturën e artin që janë probleme shumë të rëndësishme e të ndërlikuara. Unë desha të flas për kujdesin dhe ndihmën që duhet të jepin komitetet ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve dhe Partia atje për këto probleme, për ndihmën që këto organe duhet të jepin për kulturën dhe artin.

Kultura dhe arti, si dy fusha shumë të rëndësishme

1. Në këtë mbledhje u shqyrtua raporti i paraqitur nga Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Rrethit të Tepelenës.

të jetës së vendit tonë, janë mjete të fuqishme për realizimin e një edukate të domosdoshme politike dhe ideologjike. Ata shërbejnë për zgjerimin e horizontit të masave punonjëse, për zbulimin e ndjenjave dhe të jetës së popullit tonë. Prandaj këto probleme kaq të rëndësishme në asnjë mënyrë nuk duhet të nënveftësohen përballë problemeve shumë të mëdha ekonomike që kemi përpara. Nuk duhet të thjeshtësojmë rolin edhe kuptimin e tyre, domethënë nuk duhet t'i kuptojmë ata vetëm si mjete dëfrimi. Sigurisht, ata e kanë edhe këtë qëllim, por në asnjë mënyrë nuk kufizohen vetëm në të, bile ai nuk është kryesori. Kultura dhe arti luajnë një rol të madh shoqëror edukativ.

Zhvillimin e kulturës dhe të artit ne duhet ta bëjmë në bazë të principeve të vijës së Partisë sonë, në bazë të ideologjisë sonë marksiste-leniniste, në luftë kundër çdo ndikimi të huaj ideologjik, të vjetër ose të ri. Dhe duhet ta themi e ta theksojmë me forcë këtë, sepse ekzistojnë ndikime të huaja ideologjike, sepse duhet të ruheni nga depërtimi i ideologjisë së huaj në jetën shpirtërore të shoqërisë sonë në ndërgjegjen e njerëzve tanë. Ideologja borgjeze, e krahas saj edhe ndikime të ndryshme revizioniste hyjnë te ne nëpërmjet kanaleve të shumta të komunikimit e të informacionit social, nëpërmjet artit e kulturës borgjeze e revizioniste. Ky nuk është vetëm një rrezik potencial, që nuk ka shfaqje konkrete, siç minimizohet gabimisht ndonjëherë. Ai shfaqet në jetën shpirtërore të shoqërisë sonë, në kulturën tonë, në letërsi e në arte, sidomos në disa fusha ku ne kemi më pak traditë, siç janë muzika e kultivuar, artet figurative etj.

Edhe ju në rrethe duhet të ruheni nga këto ndikime, në çfarëdo formash të maskuara e të sheqerosura që ato të paraqiten, nëpërmjet çfarëdo teorizimesh «estetike» që mund të mbrohen. Përndryshe, në qoftë se këto ndikime nuk lustohen me forcë e nuk bëhen në kohë korrigjimet e pastrimet e nevojshme, atëherë ato mund të na çojnë në rrugë jo të drejtë, mund të dëmtojnë interesat e ndërtimit të socializmit në vendin tonë, mund të pengojnë zhvillimin e socializmit, të pengojnë sidomos zhvillimin e artit dhe të kulturës në rrugën revolucionare socialiste, sepse krijojnë konfuzione, çojnë në çoroditjen e shijeve, të mendimeve dhe të ndjenjave të masave të popullit, sidomos të rinisë.

Masat e popullit, që të edukohen, kërkojnë nga njerëzit e artit dhe të kulturës vepra e krijime të bukuria jo vetëm nga forma, por edhe nga përbajtja. Por, qoftë forma, qoftë përbajtja duhet të jenë të harmonizuara me vijën e Partisë, me interesat e popullit, si dhe duhet të frymëzohen nga idetë e Partisë sonë në bazë të mësimeve të marksizmi-leninizmit. Çdo shkëputje nga ky parim, qoftë në formë, qoftë në përbajtje, shkakton turbullira dhe këto turbullira kanë konsekvenca jo të mira.

Socializmi kërkon zhvillimin me ritme të shpejta, kërkon që ai të jetë një zhvillim i gjithanshëm i masave punonjëse — politik, ekonomik, shoqëror, kulturor artistik. Por, për t'ia arritur këtij qëllimi, kultura jonë socialiste nuk duhet të shartohet me ato forma dhe aq më tepër me atë brendi që janë karakteristike për kulturën, artin, muzikën, teatrin etj. të vendeve kapitaliste e revisioniste. Ne nuk duhet të lejojmë që ideve

dhe ndjenjave tona socialiste, që shprehen nga njerëzit e artit dhe të kulturës sonë, t'u veshim rrobën e huaj të një shoqërie dekadente, kapitaliste ose revisioniste qoftë. Ne duhet të mos kopojmë zhvillimin e kulturës e të artit të këtyre vendeve dhe të mos imitojmë format e paraqitjes së tyre.

Arti dhe kultura jonë duhet të ruhen nga pamja e gënjeshtërt, nga efektet formaliste dhe plot nuanca të të tillë formave të kulturës borgjeze, për të mos folur për brendinë e tyre, e cila është në çdo pikëpamje e dëmshme dhe e dënueshme. Pra, të mos tërhiqemi nga pamja e gënjeshtërt, të mos lejojmë që ajo të ndikojë në jetën e shëndoshë të shoqërisë sonë, në ndërgjegjen e masave tona punonjëse, që janë bartëset e zhvillimit të kulturës, të artit dhe të muzikës sonë socialiste. Ne jemi vendosmërisht kundër këtyre ndikimeve. Ne duam një kulturë dhe art që të zhvillojnë botën shpirtërore të popullit tonë në formë dhe përbajtje të lartë marksiste-leniniste.

Të marrim rrëthin e Tepelenës ose ndonjë rrëth tjetër si ky. Mund të ketë mendime se Tepelena është një nga rrëthet më të humbura në zhvillimin e kulturës dhe të artit. Por këto mendime nuk janë të drejta, nuk janë reale, sepse populli i Tepelenës tërë jetën e tij ka kënduar e ka vallëzuar në mënyra të ndryshme; në mënyra të ndryshme këngët e vallet e tij kanë shprehur ndjenjat e popullit. Nëpërmjet këtyre valleve e këngëve u këndohej njerëzve, virtyteve të tyre të larta, trimërisë, dashurisë për atdheun e për popullin; këndohej nëpër dasma e në ngjarje të tjera të jetës ku pasqyrohej edhe humori i hollë i popullit. Pra, në të

gjitha këto këngë e valle të popullit, ka një pasuri të madhe kulture e arti, që kanë mbajtur gjallë, gjatë shekujve, traditat luftarake e kulturore të masave popullore.

Ka nga ata njerëz, të cilët nxjerrin teori dhe thonë se kjo muzikë vlen vetëm si folklor që pasqyron jetën e kaluar, po nuk vlen më për të përbushur nevojat e sotme shpirtërore të popullit. Për këta njerëz muzika labe, muzika popullore nuk ka më sot ndonjë vlerë të veçantë dhe shpesh janë po këta njerëz që përkrahin ato krijime dhe ato shfaqje artistike, që nuk kanë ndonjë brendi apo karakteristikë të muzikës sonë shqiptare.

Sigurisht, ne nuk mbetemi e nuk kemi mbetur vetëm te folklori. Edhe këtë ne e shohim në zhvillim. Mbi bazën e folklorit lindin edhe drejtimet e reja të zhvillimit muzikor e artistik; për më tepër, muzika e arti i kultivuar zhvillohen në rrugë të reja më të ndërlikuara e më të përsosura. Ata duhet të mbështeten gjithmonë në shpirtin e popullit, në jetën e veprën e tij, ata duhet të kenë gjithmonë një formë të qartë kombëtare të bazuar fort në artin dhe në muzikën e popullit tonë dhe të përshkohen tejembanë nga ideologjia marksiste-leininiste.

Ne duhet t'u japim kulturës, artit, muzikës sonë fizionominë dhe karakterin shqiptar. Kjo që them nuk është nacionalizëm. Çdo vend i botës ka dashur t'i japë gjithmonë muzikës së tij karakterin dhe fizionominë kombëtare. Le të marrim Italinë, në emisionet televizive të së cilës dalin disa artistë, me paraqitje të shëmtuar, të këtij vendi, megjithatë, edhe në Itali, ka pasur e ka njerëz që luftojnë për t'i dhënë muzikës së vendit

intonacionin dhe ngjyrën e muzikës italiane. Kjo luftë në shkallë të ndryshme e me intensitet të ndryshëm bëhet jo vetëm në Itali, por edhe në vende të tjera.

Kurse këtu te ne ka muzikantë shumë të mirë, të cilët kanë bërë kompozime të bucura e origjinale, me frymë me të vërtetë revolucionare e kombëtare, krijime këto që mund të krahasohen me shumë krijime muzikore nga më të mirat që kanë bërë të huajt, në vendet e tyrc. Këto krijime muzikore të kompozitorëve tanë janë aq të mira e të bucura sa, kur i dëgjon, të entuziazmojnë. Dhe këto krijime muzikore, që janë shumë të mira, nuk janë pak. Në to u këndohet shumë bukur atdheut, popullit, Partisë, fushës, detit, punës, jetës e ndjenjave të njerëzve, pra një larmi e tërë krijimesh në të cilat i këndohet jetës sonë socialiste. Duke folur për boshllëqet e të metat e krijimtarisë muzikore artistike, është e domosdoshme t'i njohim e t'i theksojmë këto suksese të muzikës sonë (për të cilat këtu nuk është rasti të zgjerohem), ashtu si dhe të gjithë letërsisë e artit, pasi ato janë edhe një mbështetje e domosdoshme për të ecur përpara, për të krijuar vepra akoma më të shëndosha e të bucura.

Por disa nga këta artistë e shkrimtarë, të cilët kanë krijuar të tilla vepra të bucura, kanë nxjerrë edhe disa gjëra pa vlerë, si nga përbajtja, ashtu dhe nga forma. Dhe më e keqe është se me këto krijime pa vlerë, siç e shikojmë, këta gjejnë mbështetje nga disa drejtues të fushës së kulturës, duke dhënë mendimin se këto i pëlqen rinia, se këto janë krijime «novatore», që u përshtaten kohës sonë, ritmeve tona të zhvillimit, dinamizmit të jetës etj., etj. Jo vetëm këq, por, për t'u mbyllur

shtegun vërejtjeve, këta sulen me egërsi kundër kritikuesve të kësaj muzike dhe u vënë gjithfarë epitetesh si «konservatorë», «njërzë që kanë imbetur prapa, se nuk i kuptojnë kërkesat e kohës e të rinisë», se «kanë shije të vjetruara». Dhe këto krijime jepen në televizor e në radio, të shoqëruara me reklamën që u bëjnë disa tifozë të tyre.

Sot që po zgjerohet televizioni, këto probleme marrin një mprehtësi të veçantë, sidomos në fazën e parë të përhapjes së tij. Televizioni ndikon fuqishëm në formimin e shijeve të njerëzve, veçanërisht të rinisë. Në këtë vështrim televizioni ynë duhet të bëjë një punë shumë të kualifikuar, me frymë të shëndoshë kombëtare e revolucionare, në luftë me ndikimet e këqija të programeve të huaja televizive. Sigurisht, televizioni te ne është i ri. Ai është në hapat e parë. Duhet akoma kohë që ai të rregullohet edhe nga ana teknike. Megjithëkëtë tani për tani nuk duhet të pretendojmë shumë në këtë drejtim, por Partia të ketë kujdes më shumë që ai të ruhet nga ideologjia e huaj, nga kultura dhe arti dekadent. Ndaj shfaqjeve të huaja Partia duhet të marrë masa dhe për to të jetë e vendosur e konsekutive, sepse nga kjo nuk humbet, por vetëm fiton.

Kultura, arti dhe muzika jonë duhet të përsitojnë edhe nga përvoja e kulturës, e muzikës dhe e arlit të huaj. Unë e kam theksuar edhe herë të tjera se ne nuk jemi ksenofobë. Por ne mbajmë qëndrim kritik revolucionar ndaj kulturës së huaj, përpinqemi të përsitojmë vetëm nga ajo kulturë që përmban vlera për kohën tonë, që u përgjigjet kërkesave kulturore të masave punonjëse. Prandaj luftojmë me vendosmëri kundër çdo ndikimi

çoroditës, sidomos kundër atij arti që në televizionet e vendeve kapitaliste propagandohet për qëllime tregtare dhe vihet në shërbim të një shijeje e mode kalimtare si mjet zbavitjeje boshe e trullojseje të masave.

Atë muzikë që vuan nga ndikime të tillë ka raste që disa nga organizatorët e programave muzikore dhe spikerët e paraqesin si një muzikë që e pëlqen rinia. Bile ata s'mungojnë të thonë se këto këngë i kërkojnë të rintjtë, punëtorët, studentët etj., se nga ana e këtyre kanë marrë shumë letra, nga të cilat rezulton se këto këngë rinia i pëlqen shumë.

Sigurisht, letra shkruhen shumië, po disa prej tyre i shkruajnë edhe tifozë të një muzike me ndikime të huaja, të cilët ose janë snobë, ose janë të rinj akoma të paformuar. E këqja është se disa organizatorë programesh muzikore ose spikerë janë në dijeni vetëm të këtyre letrave ose, ca më keq, reklamojnë vetëm ato, me qëllim që të formojnë opiniione të njëanshme e të padëshirueshme.

Në të vërtetë shumica e të rinjve shkruajnë edhe për këto çështje letra, në të cilat mbahen qëndrime të drejta. Edhe mua më kanë shkruar nga këto letra. Më kanë shkruar punëtorë nga Lushnja¹ dhe jo një e dy, por dhjetëra, të cilët në letra bëjnë kritika të drejta për këto këngë. Edhe mësuese shkolle më kanë shkruar dhe më thonë se si është e mundur të lejohen te ne të rinj

1. Në letrën e tyre, që u botua në gazeten «Zeri i rinisë» të datës 13 janar 1973, të rintjtë lushnjarë, ashtu si tërë rinia e vendit tonë, shprehën reagimin e tyre të drejtë dhe kritikuan shfaqjet e huaja liberale e moderniste që u vunë re në Festivalin e 11-të të Këngës në Radiotelevizion.

me veshje kaubojsh, me leshra mbas qafe e mbi vesh, me favorite të atilla të gjata, siç shohim shpesh disa studentë, bile edhe disa të rinj punëtorë. Ndaj këtyre shfaqjeve nuk është aspak e drejtë të qëndrojmë pasivë dhe indiferentë.

Një mësuese shkolle më shkruan se kur u thotë nxënësve se si duhet ta kenë paraqitjen e si të sillen, këta i përgjigjen: Ju shoqja mësuese na thoni të jemi të sjellshëm, me paraqitje të rregullt, por ne po shikojmë se në televizor dalin njerëz me veshje, me flokët dhe me pamje që ju na i keni kritikuar. Mirëpo ato që shfaqen në televizor janë zyrtare.

Jo, shokë, këto gjëra nuk janë zyrtare, por kontrabandë¹. Partia do gjëra të bucura, të thjeshta, të kuptueshme, natyrisht me nivel të lartë artistik dhe kurdoherë të harmonizuara me vijën e saj. Shfaqjet e huaja ne i luftojmë. Ne duhet të luftojmë me vendosmëri, hapur dhe pa lëshime edhe ato elemente të ideologjisë së huaj që depërtojnë te ne nëpërmjet muzikës e artit.

Por dëshiroj të theksoj edhe një herë se, me këto që them, nuk duhet të kuptojmë se jemi kundër kërkimeve në art, kundër novatorizmit e freskisë, kundër përpjekjeve për zhvillimin e muzikës e të arteve tonalë atë mënyrë që ato të pasqyrojnë me të vërtetë zhvillimin e vrullshëm, dinamik të shoqërisë sonë, të të

1. Kjo punë kontrabandë në televizion, bëhej në mënyrë të organizuar dhe me qëllime të caktuara nga elementi i degjeneruar dhe antiparti, armiku i Partisë Todi Lubonja, i cili bënte pjesë në komplotin e madh e shumë të rrezikshëm që kryesonte poliagjenti Mehmet Shehu.

gjithë jetës sonë socialiste dhe t'u përgjigjen nivelist arsimor, kulturor dhe kërkesave e shijeve estetike gjithnjë në rritje të masave punonjëse e sidomos të rinisë sonë.

Ndikime të huaja vërehen edhe në letërsi, në gjinjtë e ndryshme të saj. Në revistën «Nëntori», në numrin e fundit të vitit, lexova një vjershë të Xhevahir Spahiut. Unë nuk e njoh atë, po i kam lexuar disa shkrime të tij. Përshtypja ime është se ky letrar është... disi fantazist. Unë i lexoj krijimet e të rinjve, sepse dua të shikoj zhvillimin e tyre politik, mendor, ndjenjat dhe fryshtëzimet e tyre. Nga këto krijime të të rinjve ka pjesë që më pëlqejnë, ka nga ato që nuk më pëlqejnë, ka edhe shkrime të errëta ose tepër ekstreme, ka dhe nga ato që nuk vlejnë fare. Mirëpo të gjitha këto botahen. Kjo nuk është politike, nuk është një kriter i drejtë. Revista «Nëntori» dhe gazeta «Drita», si organe të shtypit letrar, janë të interesuara jo për të botuar lakra që nuk vlejnë, por për të botuar pjesë të bukura, që të fryshtëzojnë masat pér qëllime të larta, pér ndërtimin e socializmit. Po pse ndodh kjo? Kjo ndodh sepse ka redaktorë që nuk udhëhiqen në mënyrë konsekuente nga idetë e mëdha të socializmit, që nuk zbatojnë me konsekuencë vijën e drejtë e posositë e vazhdueshme të Partisë. Në redaksitë e këtyre organeve ka subjektivizëm, ka hatëre, ka prirje të një-anshme, pa përvjetorit pér të botuar shkrimet e disave dhe pér të kritikuar të disa të tjera, bile, në mënyrë denigruese, edhe pér t'i fyeni. Sigurisht edhe kritikë do të ketë e duhet të ketë, por jo fyeni. Nuk është aspak në vijën e Partisë që njerëzve, të cilët

kritikojnë me të drejtë disa krijime jo të mira, t'u thuhet «ju jeni konservatorë», «nuk e kuptioni të renë», «nuk i përkrahni forcat e reja» etj. Jo, nuk është e drejtë të veprohet kështu, ashtu siç nuk duhet lejuar të mbahet qöndrim mospërsillës ndaj të rinxve, ndaj vlerave të reja që köta mund të sjellin në krijimtari.

Por të vijmë të vjersha që përmenda. Ajo është konfuzë. Me të, siç duket, ai ka dashur ta tregojë veten se di shumë, por kur e lexon, shikon se në këtë vjershë kanë hyrë koncepte filozofike të Sartrit. Gjithë filozofia e këtij është pak a shumi kjo që thuhet në vjershë: «Unë jam ai që nuk kam qenë, unë do të jem ai që nuk jam». Ky autor i ri ka marrë këtë pikëpamje të Sartrit, e ka kopjuar, e ka bërë të tijën, ndoshta duke menduar se të tjerët nuk dinë çfarë është Sartri dhe filozofia e tij. Sigurisht, të gjesh thelbin e filozofisë së Sartrit, është shumë e vështirë, sepse duhet të lexosh më parë disa botime të tij, të njohësh filozofinë e tij. Sartri është krijues i rrymës së ekzistencializmit. Pra, duhet të dish shumë gjëra për të, që të kuptosh filozofinë e tij antimarksiste, megjithëse Sartri pretendon se ajo nuk është e tillë. Filozofia e Sartrit, pavarësisht se ç'ihotë ai vetë, është antimarksiste, e huaj, e papravueshme për ne.

Po kthehem edhe një herë tek ajo që kam theksuar që ne të shfrytëzojmë me kujdes fondin e madh të kulturës dhe të artit tonë kombëtar, të zhvillojmë muzikën dhe vallet tona popullore të të gjitha krahinave të atdheut. Ne nuk duhet të harrojmë të kaluarën e popullit. Populli ynë ka krijuar këngë, po këto i ka kënduar në periudhat dhe në rrëthanat historike të

kohës që ka jetuar. Por ne, kur vlerësojmë të kaluarën dhe zhvillimin tonë të tanishëm në bazë të mësimeve të marksizëm-leninizmit, jemi më në gjendje të shpjegojmë vlerën dhe përbajtjen e tyre në vartësi me periudhën kur këto janë krijuar. Këto këngë e kanë fryshtëzimin në historinë e lavdishme të popullit tonë. Ne ato edhe mund t'i përpunojmë e t'i stilizojmë, por gjatë kësaj pune nuk duhet t'u ndryshojmë thelbin dhe karakterin e tyre popullor; të ruajmë në to karakteristikat themelore nga brendia dhe nga forma. Konkretisht, kur këndohet, për shembull, sot kënga e Çelo Picarit, jemi në gjendje të analizojmë rrëthanat historike në të cilat është krijuar e është kënduar ajo, prandaj, po të vijë çështja për përpunimin e saj, duhet bërë kujdes që të mos humbasë karakteri i saj popullor.

Me këto që shpjegova nuk dua të them aspak se ne jemi konservatorë, as nuk jemi për atë që të mbetemi vetëm te këngët popullore. Ne nuk jemi të prapabetur, prandaj kemi hapur gjithë këto shkolla, me qëllim që t'i japim një zhvillim edhe më të madh muzikës sonë të re socialistë. Nuk është e domosdoshme të vëmë kurdoherë vetëm këngë popullore në emisionet tona, prandaj të bëhen edhe më shumë krijime të reja, të cilat të kenë ngjyrën dhe intonacionin muzikor të popullit e të atdheut dhe të jenë me të vërtetë të bukurë.

Këtu fola më shumë për luftën kundër ndikimeve të sotme çoroditëse të ideologjisë e të kulturës borgjeze, por ne nuk kemi lënë pa luftuar, bile vazhdojmë të luftojmë me forcë edhe kundër ndikimeve të vjetra ideologjike, kundër çdo lloj konservatorizmi, në të gjithë

tha fushat e jetës, pra edhe në fushën e kulturës. Ne e kemi goditur me forcë konservatorizmin edhe në traditat e zakonet e ndryshme të jetës. Por ai i ka rrënjet akoma të forta dhe peshon akoma rëndë, sidomos në jetën e grave e të rinisë. Konservatorizmi nuk mund të mos shfaqet, gjithashtu, në fushën e gjerë të letërsisë e të arteve, përgjithësisht të kulturës, aq më shumë kur ushqehet nga rutina të vjetruara e anakronike dhe nga kuptime të ndryshme dogmatike e skematike. Prandaj, siç e kam thënë edhe herë të tjera, në këtë fushë ne luftojmë kundër çdo lloj ndikimi të huaj ideologjik, ngado që të vijë, luftojmë, si të themi, në të dy krahët, edhe kundër traditave të vjetruara konservatore e reaksionare, edhe kundër ndikimeve të sotme çoroditëse, borgjezo-revizoniste. Por, duke bërë një luftë aktive kundër shfaqjeve të ndryshme të konserverorizmit, nuk duhet të biem në liberalizëm, të humbasim vigjilencën kundër ndikimeve çoroditëse të sotme të ideologjisë e të kulturës borgjeze. Këto ndikime nuk duhet t'i minimizojmë, as të qëndrojmë pasivë ndaj tyre, por të luftojmë me vendosmëri e me pasionin e domosdoshëm revolucionar.

E theksoj edhe një herë se traditat e përvojat pozitive ne do t'i ruajmë e do t'i zhvillojmë. Ky është një proces i domosdoshëm zhvillimi që ka ndodhur e ndodh edhe në vende të tjera. Po të ndjekim literaturën botërore, për shembull, atë franceze, shkojmë se ka krijime të ndryshme, ka autorë, shkrimitarë dhe poetë që kanë qenë të famshëm në kohën e tyre, por që tani janë shuar fare e nuk përmenden. Shumë-shumë emrat e tyre përmenden kur bëhet ndonjë studim dhe kjo

shkurtazi. Megjithatë ka shkrimtarë dhe autorë, të cilët, edhe pse kanë krijuar e kanë kompozuar përpara 200-300 vjetësh, kanë mbetur të pavdekshëm. Këta kanë jetuar e kanë krijuar në një periudhë tjeter, por veprat e tyre të bucura janë fryshtuar nga mendime dhe aspirata të mira, përparimtare, prandaj u kanë rezistuar kohëve, të këqijave dhe kanë arritur të gjalla e të bucura deri në ditët tona.

Këtu unë zhvillova disa çështje që kanë lidhje me pyetjen e shokut Kahreman. Prandaj lidhur me problemet e kulturës dhe të artit është e nevojshme të ndihmojni organet e Partisë dhe të pushtetit në rreth, me qëllim që të zgjerojmë gjithnjë më shumë horizontin kulturor të popullit tonë.

Për këtë duhet të ndihmojë patjetër Partia, e cila duhet të marrë masa që të korrigjojë të metat që shfaqen. Ky korrigjim të bëhet me kritikë, por, kur kritikohen të metat që vërchen në fushën e kulturës, ka njerëz që, duke mos e duruar kritikën, e quajnë këtë «censurë». Po pse, do të lejojnë Partia, udhëheqja e saj dhe populli që të mbijnë gjithfarë lakraш? Jo, në asnjë mënyrë. Po pse, mos do të lejonte Partia disa hajdutë, agallarë, bejlerë e bajraktarë të livadhisnin akoma për hir të njëfarë humanizmi borgjez? Po kur erdhi koha për krijimin e kooperativave bujqësore, lejoi Partia që të pengohej krijimi i tyre pse nuk deshën kulakët? Jo, shokë, nc nuk do të lejojmë orvatje të tillë. Shteti ynë është shtet i diktaturës së proletariatit dhc kjo ka një kuptim të gjerë. Diktatura e proletariatit, udhëheqja e klasës punëtore, e Partisë, shtrihet edhe në fushën e kulturës, sigurisht duke vepruar me me-

toda e mjete specifike, duke marrë parasysh natyrën e solme të kontradiktave që dalin në këtë fushë. Prandaj, atyre që na trembin me «censurën», ne u themi: Në qoftë se bëhen përpjekje për të cenuar diktaturën e proletariatit, atëherë kjo e fundit i godet ata.

Nuk duhet të nënvleftësohen këto çështje, shokë. Këto probleme të mos i ndani nga problemet e mëdha ekonomike, si dhe nga problemet e tjera që kemi përpara për të zgjidhur. Çështja e zhvillimit të kulturës dhe të artit ka rëndësi të jashtëzakonshme.

Botuar për herë të parë në librin: Enver Hoxha, «Mbi letërsinë dhe artin», f. 325

Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

DISA PROBLEME TË AKADEMISË SË SHKENCAVE QE KËRKOJNË STUDIM E DISKUTIM

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

10 janar 1973

Lidhur me çështjen se kush mund të jetë anëtar i Akademisë së Shkencave, dalin disa probleme, që kërkojnë studim e diskutim, pastaj të vendosim nëse duhet të jetë kusht që anëtarët e akademisë të jenë vetëm profesorë, siç na propozohet. Një shkencëtar të naftës që ka dhënë rezultate të mira në prodhimi dhe shumë prova zotësie edhe në fushën teorike, a do t'i jepet titulli «Profesor» dhe nëse jo a duhet të bëhet kjo pengesë për të qenë ai anëtar i akademisë? A do të quhen profesorë edhe punonjës të shquar jashtë institucioneve mësimore ose studimore? Përgjithësisht, ata që janin mësim dhc shquhen në sferën e shkencës së tyre, mendoj se është me vend t'u jepet titulli «Profesor», po një inxhinieri apo një piktori të madh, fjala vjen, a

1. Në këtë mbledhje u diskutua për disa çështje që lidhen me krijimin e Akademisë së Shkencave.

duhet t'u jepet ky titull, a mund të bëhen profesorë? Po një shkrimtar i dëgjuar me merita të veçanta në fushën e krijimtarisë letrare, por që sot nuk jep mësim, do të quhet «Profesor»? Te ne, edhe një njeri pa shkollë të lartë, po të jepte mësim në shkollën e mesme, në të kaluarën quhej profesor. Sot kjo nuk është e drejtë. Mjekët, për shembull, nuk janë «Doktorë», siç i quajmë ne, titulli «Doktor» pasqyron një gradë shkencore. Ja, këto janë çështje që duhen rrahur e diskutuar.

Krahas titullit «Profesor» duhet menduar edhe për tituj të tjerë e për grada shkencore si «Kandidat i shkencave», «Doktor i shkencave»¹ etj. Deri tani ne jemi prirë nga ata që japid mësim në shkollat e larta. Kjo ka bërë që të ketë një lloj titujsh për të gjithë. Mirëpo kjo tani na pengon, se nuk mund t'u japid titullin «Profesor» të gjithë punonjësve që shquhen në fusha të ndryshme, prandaj, po të ketë edhe tituj të tjerë e grada shkencore, që s'janë të një shkalle e të një lloji me titullin «Profesor», këto do t'u jepeshin një rrathi më të gjerë shkencëtarësh.

Ne nuk mund t'i bëjmë të tërë punonjësit e shkenccës profesorë. Prandaj këto që themi të studiohen, pse

1. Në mbledhjen e datës 25 prill 1973 Byroja Politike e KQ të PPSH dha porosi për kriteret dhe për sistemin e kualifikimit shkencor të kuadrove. (Shih: «PPSH Dokumente Kryesore», vël. VI, Tiranë 1978, f. 339.) Pas kësaj Këshilli i Ministrave, më datë 23 dhjetor 1973 mori vendimin që krahas titujve shkencorë «Docent», «Bashkëpunëtor i vjetër shkencor» dhe «Profesor», që kishin filluar të jepeshin qysh nga viti 1955, të jepen edhe gradat shkencore «Kandidat i shkencave» dhe «Doktor i shkencave».

në të ardhmen problemi do të ndërlikohet akoma më shumë, pasi numri i njerëzve në fusha të ndryshme të shkencës, të prodhimit e të mësimdhënies, do të rritet dhe për këtë arsyё duhet të kemi edhe tituj të tjerë dhe grada shkencore. Pse të mos mbrohen edhe gradat shkencore «Kandidat i shkencave» e «Doktor i shkencave», po të kufizohemi vetëm me dhënien e titujve? Apo se këtë e kemi vendosur më parë dhe kështu duhet të vazhdojmë? Tani situata ka ndryshuar, njerëzit e shkencës janë më të shumtë dhe akoma më shumë do të jenë në të ardhmen. Mungesa e titujve të tjerë dhe e gradave shkencore na pengon të bëjmë një zgjedhje më të mirë të njerëzve që e meritojnë titullin «Profesor».

Tani për tani ne kemi Akademinë e Shkencave, nuk kemi një akademi të veçantë edhe për artet e bukuria, mirëpo për punonjësit e shquar në fushën e letërsisë dhe të arteve, çfarë duhet të bëjmë? Sot nuk e kemi një institucion të tillë për artet, por mund të vijë një kohë që të krijojmë edhe akademinë e arteve, atëherë mbi ç'kritere do të caktohen anëtarët e këtij institucionit? Do të ndjekim po ato kritere për të qenë anëtar i Akademisë së Shkencave? Ç'tituj do t'u jepen artistëve, shkrirtarëve e gazetarëve¹?

SHOKU HYSNI KAPO: Është e domosdoshme ta vëmë kushtin që, për të qenë anëtar i Akademisë së

1. Për artistët, si: këngëtarë, kompozitorë, dirigjentë, instrumentistë, regjisore, aktorë të teatrit, të operës, të kinemasë, të estradës etj. si dhe për piktorë e skulptorë jepen titujt e ndërit «Artist i Popullit», «Piktor i Popullit», «Skulptor i Popullit», «Artist i Merituar», «Piktor i Merituar» dhe «Skulptor i Merituar».

Shkencave, kandidati duhet të ketë titullin «Profesor»?

SHOKU ENVER HOXHA: Mirë thotë Hysniu, përsë ta vëmë këtë kusht? Nga ata që sot kanë titullin «Profesor» tani ne mund të zgjedhim disa, po në të ardhmen të mos vëmë kushtin që anëtarët e akademisë të kenë vetëm titullin «Profesor». Më vonë kur akademia të bëjë pranime të reja, ta orientojmë atë që brenda një periudhe të shkurtër t'i shtojë radhët dhe të bëjë për këtë qëllim propozimet përkatëse, vetëm se shtesat duhet të bëhen me kritere të tjera nga këto që ekzistojnë sot.

Kandidaturat e paraqitura, për të cilat diskutuan, t'i pranojmë, mendoj unë, por pa u vonuar të punohet për të përgatitur rregulloren e akademisë, në të cilën të thuhet kush do të hyjë në akademi, me ç'cilësi e me ç'tituj etj., pra të përcaktohen kritaret për pranimet e reja. Kur të bëhet kjo, atëherë kuadrot që zumë në gojë të nxiten për të bërë përcapjet e nevojshme për të marrë titujt dhe gradat e caktuara e të pranohen kështu mië vonë edhe këta anëtarë të saj.

Kështu, mendoj unë, të orientohemi për pranimet në akademi dhe për dhënen e titujve.

Për të shpallur kryetarin, nënkyetarët dhe sekretarin shkencor të Akademisë së Shkencave mendoj se është më mirë të mblidhet asambleja¹. Kjo do të bëjë zgjedhjet e organeve të akademisë pasi Këshilli i Mi-

1. Më 25 janar 1973 zhvilloi punimet mbledhja e parë e Asamblesë së Akademisë së Shkencave, në të cilën në emër të Komitetit Qendror të Partisë dhe të Këshillit të Ministrave përshëndeti shoku Hysni Kapo. Kryetar i akademisë u zgjodh profesor Aleks Buda.

nistrave të ketë aprovuar listën e anëtarëve e kandidatëve të saj në bazë të opinionit shkencor. Në mbledhjen e parë të flasë një nga shkencëtarët më të vjetër, që do të jetë edhe anëtar i akademisë. Me këtë rast bëhen edhe zgjedhjet, në formën më demokratike për presidiumin dhe kryesinë, domethënë, kryetarin, nën-kryetarët dhe sekretarin shkencor.

Tani që po ngremë këtë institucion të lartë, të gjitha botimet shkencore që do të dalin këtej e tutje, duke përfshirë edhe ato të Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe¹, mendoj tū botohen në emër të Akademisë së Shkencave të Republikës Popullore të Shqipërisë. Prandaj të studiohen mirë këto çështje.

*Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbal i mbledhjes së Sekretariatit të KQ të PPSH,
që gjendet në AQP*

1. Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe zhvilloi punimet në Tiranë nga 20 deri më 25 nëntor 1972.

VLERA E MATERIALEVE QË NA PARAQITEN VARET NGA BRENDIA E TYRE

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

10 janar 1973

Për këtë projektplan unë kam disa vërejtje. Këmbëva disa mendime me shokët lidhur me studimin që mendohet të paraqitet në Plenumin e Komitetit Qendror për një plan perspektiv me afat të gjatë të zhvillimit të ekonomisë dhe të kulturës në vendin tonë. Kësaj pune ne mund t'i futemi, por, që ta marrim në shqyrtim këtë vit në mbledhjen e Plenomit të Komitetit Qendror, nuk më duket e arsyeshme sepse studimi është i rëndësishëm dhe, sipas mendimit tim, në Plenum duhet të vemi të përgatitur mirë për këtë çështje të madhe.

Një plan orientativ me afat të gjatë duhet të përfshijë, të paktën dhjetë vjet, domethënë dy pesëvjeçarë. Kjo kërkon një studim jo të nxituar, por që do kohë, pra, puna përgatitore nuk është e lehtë. Prandaj, s'ka

1. Në këtë mbledhje u diskutua projektplani për problemet që do të merreshin në shqyrtim në mbledhjet e Byrosë Politike e të Sekretariatit të KQ të PPSH gjatë viti 1973.

pse të nxitohemi, por t'i futemi seriozisht punës me qëllim që të nxjerrim një studim me nivel. Fjalën e kam te koha shumë e shkurtër që mbelet, për këtë arsyç mendoj të mos i hyjmë kësaj pune për këtë vit. Në qoftë se Komisioni i Planit të Shtetit na sjell të dhëna për disa orientime të pjesshme, fjala vjen, në ç'drejtime mund të zhvillohet industria, ose çfarë duhet bërë dhe ç'masa janë parashikuar të merren për të ndërtuar Portin e Vlorës, për zhvillimin e minierave etj., të tilla studime mund t'i marrim në shqyrtim në vija të trasha. Kurse çështja e përgatitjes së një plani afatgjatë nuk është aq e thjeshtë dhe e lehtë që të bëhet brenda 5-6 muajve, sepse orientimet që mendohet të jepen, duhet të jenë të bazuara. Kjo kërkon kohë për ata që do t'i studiojnë këto probleme.

Pastaj, përsë ta marrim në Plenumin e Komitetit Qendror në shqyrtim kaq shpejt sa propozohet këtë çështje kaq serioze? Këtu nuk është çështja vetëm e orientimeve, po edhe e vendimeve që do të merren, se Plenumi është forumi i Partisë që përcakton politikën ekonomike, kulturore etj., në bazë të vendimeve të Kongresit. Prandaj mendoj të fillohet nga përpunimi i planit pesëvjeçar të ardhshëm. Gjatë kësaj pune mund të mendojmë edhe kur do t'i paraqitet Plenumin të Komitetit Qendror. Pastaj në bazë të këtij plani, Plenumin të Komitetit Qendror mund t'i paraqesim propozimin që të rishikojë se ku duhet të arrijmë në pesëvjeçarin tjetër në këtë ose në atë degë të ekonomisë, fjala vjen, në naftë ose në degët e tjera më të rëndësishme. Që ta hartojmë mirë dhe të marrim një vendim të bazuar për një plan 10 deri 15-vjeçar, Plenumin të Komitetit Qe-

ndror mund t'iia paraqesim studimin kur të mblidhet Kongresi i 7-të i Partisë. Brenda këtij afati 2-3-vjeçar, plani mund të përgatitet më i studiuar.

Sidoqoftë, kryesorja për ne është hartimi i planit të ardhshëm pesëvjeçar, gjatë përgatitjeve të të cilit mund të përcaktojmë në vija kryesore perspektivën e një ose dy pesëvjeçarëve të tjera të ardhshëm.

Çështja e dytë që propozohet të paraqitet për shqyrtimi në Plenumin e Komitetit Qendror është «Të rrënjosim më thellë ideologjinë tonë socialiste në ndërgjegjen e masave në luftë kundër ndikimeve të huaja». Probleni qëndron, por i formuluar në këtë mënyrë nuk del mirë e qartë, përsë është sfala. Unë propozoj që theksin ta vëmë te lufta kundër shfaqjeve të huaja në të gjitha fushat e jetës¹, pra edhe në atë të arteve dhe të letërsisë, por jo në mënyrë të përgjithshme. Komitetit Qendror nuk mund t'i dalim me një raport të mbushur me fraza të përgjithshme, me çështje të njohura, pa u futur edhe në disa probleme konkrete. Prandaj, mendoj të mos vihen në mënyrë të përgjithshme këto çështje, se ka mundësi që hartuesit e raportit të na mbushin me fraza. I tillë është edhe formulimi «Mbi plotësimin e planit të import-eksportit për vitin 1972 dhe marrëveshjet e arritura në fushën e tregtisë së jashtme për vitin 1973», që parashikohet në projekt

1. Kjo çështje u shqyrtua në Plenumin e 4-t të Komitetit Qendror të PPSH që i zhvilloi punimet në datën 26-28 qershor 1973 me temë: «Të thelojë më luftën ideologjike kundër shfaqjeve të huaja e qëndrimeve liberale ndaj tyre». Raportin e mbajti shoku Enver Hoxha. (Shih: Enver Hoxha, «Raporte e sfjalime 1972-1973», f. 297.)

si raport. Për këtë mund të paraqitet një informacion, sa për t'u vënë në dijeni. Ndërsa çështjen e prodhimit të industrisë mekanike mund ta marrë në shqyrtim Qeveria. Po kështu edhe problemin e assortimenteve.

Problemi i rolit të organizatave-bazë të Partisë të Universitetit Shtetëror¹ për rininë studentore mendoj të na paraqitet këtu në Sekretariat². Gjithashtu edhe materiali për rolin e edukimit të rinisë, po veç të kihet shumë kujdes në përbajtjen e materialit³. Të gjitha temat e kësaj natyre janë të mira t'i marrim në shqyrtim, po kujdes në përgatitjen e tyre nga ana e përbajtjes.

Në projekt ka edhe çështje që duhen bashkuar. Vërejtja ime kryesore është që materialet, të cilat do të na paraqiten, të mos janë kashtë nga përbajtja dhe me gjëra të përgjithshme. Çështja e përbajtjes së materialeve për ne ka rëndësi të madhe.

Në përgjithësi unë jam dakord me çështjet që

1. Me vendim të Plenomit të 11-të të KQ të PPSH, të mbajtur në datën 13 prill 1985. për të përjetësuar jetën dhe Veprën e udhëheqësit të lavdishëm e të paharruar të Partisë e të popullit, shokut Enver Hoxha, Universitetit të Tiranës iu dha emri «Universiteti i Tiranës Enver Hoxha».

2. Ky problem u shqyrtua në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH të datës 23 shkurt 1973. (Shih në këtë vëllim, f. 255.)

3. Me gjithë këtë preokupim dhe porosi të shokut Enver Hoxha, materiali për problemet e rinisë, që iu paraqit Sekretariatit të KQ të PPSH nga Komiteti Qendror i BRPSH, vuanë nga parashitimi jo drejt i problemeve. Në diskutimin e tij për këtë çështje shoku Enver Hoxha bëri vërejtje esenciale rrëth këtij materiali. (Shih në këtë vëllim, f. 216.)

janë parashikuar në projektplanin e mbledhjeve të Byrosë Politike dhe të Sekretariatit të Komitetit Qendror, tani rëndësi ka fakti se çfarë problemesh do të ngrihen në to; vlera e materialeve që do të na paraqitet, varet shumë nga brendia e tyre, prandaj çështjet që do të trajtohen në to duhet të jenë me të vërtetë aktuale.

*Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbali i mbledhjes së Sekretariatit të KQ të PPSH,
që gjendet në AQP*

TË TREGOJMË KUJDES PËR SHËNDETIN E SHOKËVE TË UDHËHEQJES

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

10 janar 1973

Meqenëse jemi mbledhur, doja të sësja pak për kujdesin që duhet treguar për ruajtjen e shëndetit të shokëve të udhëheqjes, në mënyrë të veçantë të shëndetit tuaj, shokë të Sekretariatit. Nuk dua të futeni në çështjet që u përkasin mjekëve, këshillat e të cilëve duhet t'i zbatojë çdonjëri prej nesh. Të gjithë e kuptojmë rëndësinë e tyre. Por lidhur me shëndetin unë e kam fjalën për organizimin e punës këtu, në Sekretariatin e Komitetit Qendror.

Mendoj se ju, të tre shokë sekretarë dhe në mënyrë të veçantë Hysniu me Hakiun, jeni shumë të ngarkuar me punë. Për këtë, të gjithë e kemi për detyrë të shqetësohem. Lidhur me ngarkesën e shokut Ramiz mendoj se gjendja nuk është shqetësuese, për arsy se është ca më i ri se ne të tjerët dhe me shëndet të mirë.

Natyrisht, asnjë nga ne nuk i shmanget punës, për-

1. Në këtë mbledhje u diskutua për kujdesin që duhet treguar ndaj shëndetit të shokëve të udhëheqjes.

kundrazi ne bëjmë të gjitha përpjekjet e mundshme pér të kryer detyrat plotësisht, po vihet re se shpesh kalohet mbi rregullat që duhet të zbatojmë në punë lidhur me shëndetin. Fakt është se pikërisht pér këto arsyen duken disa shqetësimë shëndetësore si te Hakiu, edhe te Hysniu, edhe tek unë. Prandaj tanë është koha tē marrim disa masa pér ta vënë më në rregull ngarkesën tonë me punë, kryesisht të përmirësojmë metodën e stilin e punës këtu, në aparatin e Komitetit Qendror.

Në radhë tē parë, mendoj tē lehtësohem ca, nga punët e shumta tē përditshme. Në radhë tē dytë, tē lehtësohem duke vendosur një rregull, stil e metodë pune më tē mirë nga ai i gjertanishmi. Se pér çfarë stili e metode është sfala, ne kemi folur edhe herë tē tjera, megjithatë gjer tanë ngarkesa e secilit nga ne është e tillë që juve, sidomos, ju serviren çdo ditë materiale tē shumta, bëni takime tē shumta, që ju shkaktojnë lodhje tē madhe fizike e mendore. Kjo sjell pastaj pa-sojat e veta në organizmin tonë, që shprehen me shqetësimë tē zemrës, dhimbje koke etj. Prandaj, propozoj që shokët sekretarë tē Komitetit Qendror tē lehtësohen ca nga punët e shumta, sidomos Hysniu dhe Hakiu. Po si mund tē bëhet ky lehtësim konkretisht? Pér këtë mendoj se ka dy rrugë:

E para është që shokët, tē cilët punojnë me ju, tē marrin përgjegjësi tē plota pér sektorët ku janë ngarkuar. Kur shihni se ata ju servirin orë e çast çështje tē vogla pér tē zgjidhur, në asnjë mënyrë nuk duhet t'i pranon. Ju nuk duhet as tē lejoni t'ju sjellin materiale tē papërpundera, t'ju pasojnë tē lexoni me qindra faqe materiale në ditë, pér tē cilat kërkohet t'u jepni

mendimin. Ata duhet të mësohen të punojnë në mënyrë të tillë që nga një material i gjatë, ta zëmë, prej 50 faqesh t'ju paraqesin esencën, vetëm pesë faqe, kurse përzgjidhjen e problemeve të tjera që ngrihen aty, të mendojnë vetë. T'i tretin mirë, pastaj të marrin masa dhe përgjegjësi e të vijnë t'ju raportojnë juve thelbin e çështjes.

Përveç këtyre që thashë, të cilat duhet të zbatohen absolutisht këlej e tutje, mendoj se në Sekretariatin e Komitetit Qendror kemi nevojë edhe për një sekretar tjetër. Me se do të merret sekretari i ri i Komitetit Qendror? Me ata sektorë që mendojmë t'ia heqim Hysniut dhe Hakiut për t'i lehtesar. Se cilët sektorë do t'u heqim Hysniut dhe Hakiut nuk e vendosim dot sot, këtë mendojeni ju vetë, diskutojeni me njëri-tjetrin, pastaj e shohim bashkërisht.

Haku, mendoj të shkarkohet akoma më shumë se Hysniu, jo se sëmundja e tij është diçka serioze, po natyra e sëmundjes së tij e kërkon këtë lehtësim. Ai e njeh vetë sëmundjen që ka dhe një gjë e tillë është absolutisht e nevojshme. Çështja e veseve të zemrës është delikate, prandaj të sëmurit nuk mund t'i fshihet, ashtu sikurse nuk mund të më fshihet mua diabeti që kam, ndryshe do t'u futesha të ngrënave pa kusizim dhe do të dëmtohesha. Kjo do të thotë se mjekët duhet të na i thonë neve medocemos sëmundjet që kemi, të na bëjnë të qartë situatën, që të dimë si të mbrohemi dhe çfarë regjimi të mbajmë.

Këto çështje i diskutoni më parë me njëri-tjetrin dhe, kur të keni arritur në përfundim, bisedojmë përsëri si do të veprojmë e t'i bëjmë propozimet përkatëse

Plenumit të ardhshëm të Komitetit Qendror. Më parë ne duhet t'ia paraqesim realisht situatën Byrosë Politike, e cila besoj se do ta pranojë shtimin e një sekretari tjetër të Komitetit Qendror¹.

Duhet të kuptojmë mirë se shëndeti ka lidhje me jetën, po edhe me punën e Partisë. Qëllimi i Partisë është që njerëzit e udhëheqjes, sidomos, të jepin për Partinë sa më shumë e sa më gjatë gjersa të kenë forea. Është e natyrshme që vijnë momente biologjike, kur duhet frenuar veprimitaria e shokëve. Kjo është në interesin e dyshtë, të Partisë dhe të shokëve kryesorë, të cilët duhet t'i ruajmë, ndërsa të tjerëve, më të rinxje, t'u japim përgjegjësi. Sot ne marrim një masë të tillë, në një kuadër të ngushtë, në krahasim me atë që mund të marrim nesër, kur ndonjëri nga ne mund të lehtësohet akoma më tepër. Kështu si po sillojmë të veprojmë ne, edhe shokët më poshtë mësohen të marrin më shumë përgjegjësi dhe të kryejnë me guxim detyrat, të kenë edhe satisfaksion më tepër në punë. Prandaj t'i racionalizojmë sa më mirë energjitet, këto të shpenzohen atje ku nevojiten më tepër. Këtë e lypin interesat e Partisë.

*Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbal i mbledhjes së Sekretariatit të KQ të PPSH,
që gjendet në AQP*

1. Plenumi i 3-të i Komitetit Qendror të Partisë që zhvilloi punimet në datat 5 e 6 shkurt 1973, vendosi të shtohej edhe një sekretar në Sekretariatin e Komitetit Qendror. Sekretar i Komitetit Qendror të PPSH u zgjodh shoku Petro Dode.

PUNA IDEOPOLITIKE E KULTURORE NË USHTRI T'I SIIERBEJË MBROJTJES SË ATDHEUT

*Fjala në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

19 janar 1973

Problemet ideopolitike të ushtrisë i kemi ngritur edhe herë të tjera, prandaj mendimet që do të shpreh dhe vërejtjet që do të bëj për to, nuk janë të reja. Porositë dhe vërejtjet e Partisë përmirësimin e punës ideopolitike dhe ushtarake në ushtri kanë lënë gjurmë dhe kanë ndihmuar shumë. Puna politike dhe ushtarake, duke qenë të lidhura ngushtë, të puqura e të shkrira në një të tërë, kanë dhënë rezultatin e kërkuar, që ushtria jonë e edukuar dhe e drejtuar nga Partia, të ruajë kurdoherë karakterin e saj popullor, të jetë e fortë, të ngrejë vazhdimisht nivelin e saj ushtarak e politik, e stërvitur dhe e gatshme të mbrojë atdheun në çdo kohë e nga qdo rrezik që ta kërcënojë.

Si kudo, strumbullari i gjithë jetës dhe i veprim-

1. Në këtë mbledhje u diskutua për disa probleme të punës ideopolitike dhe kulturore në ushtri.

tarisë së ushtrisë üshtë Partia, e cila përbën shtyllën kurriore të saj. Pa udhëheqjen e Partisë nuk mund të kishim një Ushtri Popullorë të fortë, të edukuar me kujdes dhe të stërvitur mirë, për të qenë në gjendje të përballojë me sukses çdo agresion dhe për të mbrojtur fitoret e socializmit.

Në ushtri që të gjithë, nga ushtari i thjeshtë dho deri tek oficeri më me përgjegjësi, duhet të jenë, në radhë të parë, njerëz politikë. Partia ka theksuar që, si kudo, edhe në ushtri politika dhe ideologjia marksiste-leniniste të jenë vazhdimishit në krye. Çdo punë, çdo praktikë dhe çdo veprim në forcat tona të armatosura duhen parë e duhen zbatuar pikërisht në dritën e kësaj politike dhe ideologjie, të lidhura ngushtë dhe të përshtatura mirë me situatat që kalon në çdo etapë vendi ynë dhe me detyrat e shumta e serioze që lindin prej tyre.

Për këto arsyec Partia ka theksuar kurdoherë që në ushtri s'duhet të ketë asnjë komandant që të mos jetë edhe komisar, ashtu sikurse s'duhet të ketë edhe komisar pa dijeni të mjaftueshme ushtarake. Të mos ndodhë në asnjë rast që i pari të mos dijë mirë problemet e mëdha politike, bazat e teorisë marksiste-leniniste që metodologjinë e edukimit ideopolitik të efektivit, ndërsa i dyti të mos njohtë artin ushtarak, problemet e metodën e edukimit dhe të përgatitjes luftarake e teknike të ushtarit dhe të kuadrit. Pa këto cilësi dhe shprehi reciproke, as njëri, as tjetri nuk mund t'i kryej në si duhet detyrat e tyre. Të gjithë shokët që punojnë në ushtri e dinë këtë dhe, kush më shumë e kush më pak, ecin e punojnë në këtë rrugë. Por, në nivelin e

secilit, natyrisht, ka ndryshime, që rrjedhin nga veçoritë e punës së sektorit e të detyrës që kryejnë.

Unë jo pa qëllim pyeta nëse është punuar nga Drejtoria Politike¹ për zbërthimin e direktivave të Këshillit të Mbrojtjes në aspektin politik. Nuk doja të m'i thoshin të gjitha një për një, por të shpjegonin se si është kuptuar përbajtja e tyre politike, e cila duhet të kihet kurdoherë parasysh në punën që zhvillohet për edukimin ideopolitik të efektivit në ushtri. E thashë këtë se këto direktiva kanë vite që janë dhënë. Pra, unë kërkoja të dija se sa është vënë në jetë zbërthimi i anës politike të problemit.

Puna politike në ushtri nuk është bërë në bazë të Tezave të Këshillit të Mbrojtjes², por sipas rutinës së

1. Me vendim të Plenumin të 6-të të KQ të PPSH, që i zhvilloi punimet më 16-17 dhjetor 1974, Drejtoria Politike e Ushtrisë në Ministrinë e Mbrojtjes u suprimua dhe drejtimi i punës së Partisë në ushtri bëhet drejtpërsëdrejti nga Komiteti Qendror nëpërmjet aparatit të tij. «Kjo masë, — theksoi shoku Enver Hoxha në këtë Plenum, — nuk ka të bëjë me një ndryshim të thjeshtë organizativ, por, në radhë të parë, me një ndërrim koncepti ideologjik, me një ndryshim rrënjosor në punën e Partisë në ushtri. Drejtoria Politike ishte kthyer në një bisht të ish-ministrat dhe ish-shefit të shtabit, se ajo gjoja përsaqësonte Partinë në ushtri, por në realitet ajo përsaqësonte atje puçistët...» (Enver Hoxha, «Për Ushtrinë Popullore (Përbledhje veprash)», vell. II, Tiranë, 1984, f. 248).

2. Siç u vërtetua më vonë, këto Teza jo vetëm që nuk po viheshin në zbatim, po u sabotuan nga grupi armiqësor e puçist i Beqir Ballukut, Petrit Dumes e Hito Çakos. Kjo, siç vë në dukje shoku Enver Hoxha, nuk ishte diçka e rastit, por pjesë përbërëse e komplotit të tyre të madh. Nën mbulesën e Tezave të Këshillit të Mbrojtjes ata u përpinqën të zbatonin antitezat

vjetër duke menduar: «Hajde të flasim për disiplinën, hajde të flasim për këtë, për atë» etj. Në Tezat e Këshillit të Mbrojtjes për punën politike janë vënë detyra konkrete, duke i caktuar me numër, një, dy, tre, katër, pesë e kështu me radhë, prandaj në ushtri duhet t'i kushtohet vëmendje e madhe, në radhë të parë, edukimit politik. Kur trajtohen këto Teza, po nuk u zbërthye ana politike, puna që bëhet s'ka asnijë vlerë. Në qoftë se ushtari nuk e kupton politikisht dhe ideologjikisht brendinë e Tezave të Këshillit të Mbrojtjes, skemi gjë në vijë. Prandaj këto duhen pasur parasysh dhe jo të ecim në tym, pa një punë të organizuar mirë, ndryshe e njëjta punë rutinë do të bëhet sot dhe mot. Kur jepet mësim për problemet ushtarake, ky të mos shkëputet nga ana politike, po të jetë i lidhur organikisht me të. Më duket se nuk veprohet kështu. Nuk është e nijaftueshme praktika sipas së cilës puna politike të bëhet kur fillon stërvitja, prandaj kjo të thuhet këtu dhe jo të na thuhen hollësi.

Hito Çakoja¹, me frazeologji e fjalë të përgjithshme, u përpoq të justifikohej për mangësitë që po i viheshin në dukje dhe të spostonte problemin për të cilin ai përgjigjej e po i kërkohet llogari.

Me këto që thoni nuk po na sqaroni. Kjo është një punë jo e shëndoshë, rutinë. Sa herë që ushtari merr shërbimin e rojës, tri orë me radhë i fliten atij po ato gjëra, gjatë dy vjetëve? Domethënë i thuhen vazhdimë përgatiti Beqir Balluku dhe për të cilat ishin në dijeni më kohë edhe Petrit Dume e Hito Çako.

1. Në atë kohë drejtor i Drejtorisë Politike në Ministrinë e Mbrojtjes, i ftuar në këtë mbledhje.

misht gjëra të njohura e bajate. Përse duhet t'i përsëriten ushtarit qindra herë të njëjtat gjëra të rregulllores sikur me to është duke u bërë zërthimi i atomit? Dy vjet të tërë ushtarit i thuhet: „Do të qëndrosh këtu, do të kërkosh parrullën, kur të vijë ky e kur të vijë ai“ etj., etj.

Unë, pa qenë ndonjëherë i pranishëm në raste të tillë, po e përsëris se këto që thuhen janë jashtëzakonisht banale. Bëhet punë politike, silitet se do të veprohet kështu e ashtu siç thoni ju dhe, megjithatë, shkohet në stërvitjen luftarake me një mijë e një mungesa, pa kryer veprimet e domosdoshme që kërkon ajo! Atëherë, çfarë pune politike është kjo që bëhet? Ajo nuk është gjë hiç. Prandaj thashë se këto që thuhen këtu janë llafe. Kësaj i thonë të harxhosh kohën kot pa dobi. Koha kur duhet edukuar ushtari politikisht nuk është momenti para shërbimit, se ato llafe që i thuhen në këtë kohë mund të përmblidhen edhe me dy fjalë.

Këto probleme të mëdha nuk zgjidhen, ashtu si thua ti, Hito, se «ka të meta», apo «s'ka të meta». Të metat ekzistojnë për shumë shkaqe dhe këtyre duhet t'u gjejmë rrënjet. Kryesore është se disa nga njerëzit tanë nuk janë të ndërgjegjshëm, të edukuar dhe të ngritur sa duhet politikisht. Ata duhet të edukohen në mënyrë sistematike dhe, krahas kësaj, të organizohet edhe kontrolli i kësaj pune. Pra, një punë e tillë edukative duhet të zhvillohet jo vetëm për zërthimin e mbërthimin e pushkës, por edhe për ngritjen ideopolitike etj. Në qoftë se ne i vëmë këto çështje në rrugë të drejtë, atëherë do të kemi përmirësimë. A do të kemi

të meta? Sigurisht që do të kemi, por, po të mos punojmë politikisht për t'i ndrequr këto të meta, ato do të trashen.

Këto çështje të shikohen mirë. Unë jam i mendimit se në ushtri nuk zbatohen me rreptësi në të tëra gjërat parimet e drejta. Po të mendojmë se gjithçka e kemi vënë në rregull, atëherë do të gabohemi, nuk do ta njohim gjendjen ashtu siç është.

Komisari nuk duhet të harrojë për asnjë moment se puna e tij politike lidhet ngushtë me punën dhe me problemet ushtarake, me stërvitjen dhe me edukimin ushtarak. me gatishmërinë e përhershme luistarake të reparteve dhe të çdo ushtaraku. Kjo do të thotë që edukimin ideopolitik të efektivit ai duhet ta bëjë në lidhje të ngushtë e në funksion të asaj detyre të madhe që ka caktuar Komiteti Qendror i Partisë për ta mësuar, për ta përgatitur dhe për ta bërë të aftë ushtrinë që të mbrojë atdheun. Për ta kryer mirë këtë detyrë komisari duhet të punojë që të mësojë shumë edhe nga ana ushtarake, ndryshe puna e tij politike, jo e përshtatur dhe jo e lidhur me atë ushtaraken, nuk ka vlerë, nuk lë gjurmë dhe nuk mund të përballojë problemet e shumta që dalin në fushën e edukimit, të përgatitjes dhe të gatishmërisë luistarake të efektivit. Puna dhe fjala e një komisari nuk mund të kenë vlerë në qoftë se ai u flet ushtarëve me termë të përgjithshëm dhe për probleme që nuk kanë lidhje me detyrat ushtarake, ashtu si nuk mund të ketë vlerë fjala e një sekretari partie rrëthi, kur vejet nö një kooperativë bujqësore dhe u flet kooperativistëve për «diellin» dhe përhënën», por nuk u thotë gjë për problemet e bujqësisë.

Një sekretar partie që do t'u fliste kooperativistëve për vijën e Partisë, për ngritjen moralo-politike dhe për mobilizimin e tyre në punë, pa i lidhur ngushtë këto çështje me kryerjen e detyrave në bujqësi, nuk do ta bënte mirë punën dhe nuk do të kishte për t'ia arri-tur qëllimit.

E njëjtë gjë duhet thënë edhe për komandantin, i cili, bashkë me mësimin mbi tema të ndryshme të edukimit ushtarak e teknik që zhvillon me ushtarët, për t'i pajisur këta me njohuritë taktyke të luftimit dhe me të dhënat taktko-teknike të pushkës, të topit dhe të çdo armë e teknike tjeterë dhe për t'u formuar atyre shprehitë e luftimit, duhet të ketë parsysh se ai nuk është vetëm një instruktor i thjeshtë ushtarak apo një specialist, por, në të njëjtën kohë, është edhe një edukator politik. Edhe komandanti duhet të punojë për edukimin politik të vartësve, natyrisht, jo në formë klisheje, po në mënyrë të thelluar e me përgjegjësi. Komandanti kurrrë nuk duhet ta kufizojë mësimin dhe instruktimin e tij ushtarak vetëm me shpjegimin, fjala vjen, për topin dhe për karakteristikat e topit kundër-ajror, për parametrat e tij dhe me kaq detyrën ta quajë të mbaruar. Jo, kjo është vetëm gjysma e punës së tij. Komandanti, gjatë mësimit ushtarak, stërvitjes dhe përgatitjes teknike, duhet t'i shpjegojë mirë ushtarit se arma kundërajrore dhe gjithë të tjerat që disponojmë, nuk janë gjithçka, armët dhe teknika janë një faktor, një element, njëra anë e çështjes, kurse ana tjetër, dhe më e rëndësishmja, është kalitja e ndërgjegjes dhe e vetëdijes politike të njeriut, është të kuptuarit thellë dhe të vlerësuarit drejt nga ana e ushtarit të forcës

dhe të mjeteve që i vihen në dispozicion për të përballuar armikun, forcën, mjetet dhe astësinë e të cilat nuk duhet t'i nënveftësojë asnjëherë. Ushtari ynë nuk duhet të shkojë me paragjykimet e vjetra dhe të mendojë se me armën që ka në dorë mund t'u bëjë ballë lehtësisht sulmeve të armikut. Nënveftësimi i forcës dhe i armëve të armikut është i dënueshëm.

Me shfaqjet e nënveftësimit ndaj armëve mund të shpjegohen dobësitë e konstatuara në disa nënreparte. Shfaqjet e kësaj natyre vërtetojnë se disa komanda dhe organizata partie nuk kanë mendime të qarta përkëto armë. Ato nuk kanë bërë sqarime për qëllimin e organizimit dhe të pajisjes së nënreparteve me këto armë, nuk kuptojnë rolin, mundësitë dhe detyrat përkohë lufte të këtyre formacioneve dhe të armëve të tyre. Këto që përmenda përbëjnë një problem të rëndësishëm, që Partia në ushtri lypset ta sqarojë politikisht, sepse konceptet taktike e të ndërtimit ushtarak janë, para të gjithash, koncepte politike, të cilat, po nuk u kuptuan mirë, nuk mund të vihen në jetë.

Përveç sa thashë lidhur me nënveftësimin e armëve, një aspekt tjeter është edhe nënveftësimi i armikut, mosnjohja e pikëpamjeve dhe e mundësive të tij përluftën, përamët e për-teknikën që ai ka në dispozicion. Nuk është me vend të mendohet, që, në rast lufte, armiku nuk do të përdorë avionët e luftimit taktik, por do të kufizohet vetëm me përdorimin e avionëve strategjikë, kundër të cilëve mund të luftohet vetëm me artileri dhe me raketa.

Teza se njeriu qëndron mbi armën, është e drejtë, por kjo nuk do të thosë aspak që të nënveftësohen

armët. Duke i shikuar armët dhe teknikën në unitet me njeriun dhe në shërbim e në vartësi të tij, ato duhet t'i vlerësojmë për aq sa janë, të llogaritim mirë efektin e tyre kundër armikut, por të mos harrojmë as efektin që bëjnë armët dhe teknika e armikut në drejtimin tonë. Nga kjo ne duhet të nxjerrim detyrën se si të mbrohem i prej tyre.

Ushtria jonë është e armatosur dhe e pajisur më së miri me armë e me teknikë të fuqishme moderne, Partia mendon vazhdimisht t'i pajisë ushtrinë dhe popullin me armë të tjera. Megjithatë të törë ta kemi të qartë se në disa lloje armësh e teknikë armiqëtanë kanë epërsi, prandaj komandanti duhet ta sqarojë mirë ushtarit pér çka është e aftë arma që ka në duar dhe cilat janë efektet e saj mbi armikun dhe mbi teknikën që disponon ai. Ushtari duhet të dijë se pushka, mitrallozi dhe topi i tij, me largësi dhe me lartësi qitjeje të kufizuara, nuk mund t'i dëmtojnë avionët armiq. që fluturojnë në lartësi të mëdha. Këta avionë nuk rrëzojnë dot as me top, pa lëre me pushkë, kundër tyre duhen përdorur mjete të tjera më të efektshme. Në qoftë se ushtarit këto nuk i mësohen, ai nuk do të dijë që armiku jo rrallë mund t'i neutralizojë radiolokacionet tona, prandaj i duhet të punojë me zell pér të rritur mjeshterinë e tij tekniko-lustarake pér strehimin dhe pér maskimin e tyre. Po të mendojë ushtari ynë se arma që ka është gjithçka, se ai si trim që është nuk do t'ua dijë bombardimeve masive nga ana e aviacionit armik, do të thotë se me të nuk është punuar mirë politikisht, se ai nuk është bërë i ndërgjegjshëm që arma e tij nuk është e efektshme pér avionët strate-

gjikë, prandaj, edhe përfytyrimet e tij për luftën, për armikun që do të ketë përballë dhe për teknikën e armatimet e tij, do t'i ketë të errëta. Kështu ai nuk do t'i ketë të qarta detyrat luftarake në situata të ndryshme dhe nuk do të jetë në gjendje të veprojë me iniciativë e me guxim, nuk do të përpinqet për të gjetur forma e mënyra të përshtatshme lustimi për ta mbrojtur atdheun me sa më pak humbje.

Është, pra, e domosdoshme që ushtria jonë të mësohet dhe të edukohet me një taktkë e strategji të re dhe në këtë rrugë të ecet përpara; duke luftuar konceptet e vjetra mbi këto çështje të punohet një-kohësisht për të krijuar koncepte të reja që t'u përshtaten lustës dhe përgatitjes së armikut të kohës së tanishme.

Kötej del se, në procesin e punës për edukimin ideopolitik dhe ushtarët të efektivit të ushtrisë, puna e komisarëve dhe e komandantëve nuk mund të kufizohet vetëm me anën teknike, por të vihet medoemos theksi edhe në përmbytjen politike të çdo problemi. Duke e trajtuar kështu çështjen, do të bëhet e qartë që si komandanti, ashtu edhe komisari nuk janë të shkëputur nga puna e njëri-tjetrit. Qysh tani në kohë paqeje ata duhet të mësohen ta kryejnë mirë punën e njëri-tjetrit dhe në këtë drejtim duhet të luftojmë vazhdumisht. Tu shpjegojmë qartë njerëzve tanë se një lustë eventuale kundër vendit tonë do të jetë totale, prandaj, po të mos marrim të gjitha masat dhe po të mos përgatitemi në të gjitha drejtimet, do të kemi humbje të mëdha. Është e qartë se dasmë pa mish nuk bëhet, edhe lustë pa gjak nuk ka, puna është

që, në rast se armiqjtë ia imponojnë luftën vendit tonë, ne ta përballojmë atë me sa më pak humbje. Pikërisht për këtë arsyе kuadrot tanë politikë dhe ushtarakë duhet të përgatiten për të qenë në gjendje të zëvëndësojnë njëri-tjetrin në çdo kohë e në çdo rrëthanë.

Ne duhet të përfitojmë sa më shumë nga kjo periudhë paqeje relative që gjithë populli të organizohet e të përgatitet mirë ushtarakisht, në mënyrë që të shëmangë sa më shumë fenomenet që krijon një gjendje emergjence. Kjo arrihet duke intensifikuar përgatitjen ushtarako-teknike të ushtrisë dhe të mbarë popullit, duke pajisur terrenin me punime mbrojtëse dhe duke forcuar pareshtur vigjilencën e gatishmérinë luftarake. Prandaj, sot që kemi një unitet kaq të çeliktë moralo-politik e luftarak të popullit, është koha të marrim masa të ngutshme e të gjithanshme për mbrojtje. Tash ne nuk i kemi ato vështirësi të mëdha që kishim në kohën e Luftës Nacionallirimi, pse jemi në gjendje shumë më të mirë se atëherë. Ne sot jemi në pushtet, të pajisur me shkencën ushtarake dhe me teknikë e me armatime moderne.

Në radhë të parë, ne duhet ta përgatilim Partinë, e cila që tani t'i njoħe mirë problemet ushtarake, që nesër në luftë të udhiheqë si një trup i vetëm, me vullnet të hekurt, me njoħuri të thella e me ndjenjën e lartë të përgjegjësisë për detyrën e lartë të mbrojtjes së atdheut e të socializmit.

Drejtoria Politike dhe gjithë Partia në ushtri duhet jo vetëm t'i shpjegojnë në parim këto gjëra, të cilat oficerët i dinë, por duke pasur gjithmonë para-sysh veçoritë e punës politike dhe ushtarake, ata duhet

të punojnë për të ndërtuar me kujdes dhe mbi baza të drejta studimore programet. Pavarësisht nëse krijojmë ose jo kurse të veçanta me kursantë për kuadro politikë në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve ose në fakultetet politike të Akademisë Ushtarake, gjë që duhet ta studiojmë me kujdes, të mos lejojmë në asnje mënyrë që kuadri të dalë nga këto kurse politike i njëanshëm, pa marrë edhe njohuri të plota ushtarake. Në rast se krijojmë, pra, kurse të veçanta, programet e tyre të ndërtohen në një prizëm të gjerë. Lëndët që do t'u jepen punëtorëve politikë të jenë të plota dhe në përpjesëtime të atilla që, në të gjitha rastet, të sigurojnë me të vërtetë atë përgatitje që kërkon Partia për ushtrinë, domethënë një shkrirje të njohurive ushtarake me edukimin ideopolitik.

Rishikimi dhe ndërtimi i programeve kanë rëndësi të madhe, si për kurset që mund të krijojmë, ashtu edhe për ato që bëjmë sot për profilizimin e kuadrit oficer si punëtorë politikë që në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve. Kurset për kualifikimin e kuadrit politik, sipas kërkesave, mund të zgjaten nga 6 në 12 muaj ose edhe më gjatë po qe nevoja, por kjo duhet parë me kujdes, me qëllim që pjesëmarrësit në to të marrin njohuritë themelore të marksizëm-leninizmit, mësimet kryesore të klasikëve, të zbërthyera e të lidhura mirë me problemet tona aktuale e veçanërisht në lëmin ushtarak, si dhe të njihen me vendimet, me dokumentet dhe me mësimet e Partisë sonë. Këto të gjitha do t'u vlejnë kuadrove si orientim i përgjithshëm teorik, si vija të trasha që, kur të shkojnë në reparte si komisarë, të kenë mundësi që mësimin politik ta gërshe-

tojnë me bazat e njohurive ushtarake. Në reparte këta kuadro do të rrihen me vaj e me uthull me problemet e Partisë dhe me praktikën e punës së saj. Në të njëjtën mënyrë duhet të punohet edhe me përgatitjen e atyre që ndjekin Akademinë Ushtarake, por, natyrisht, në një shkallë më të lartë.

Veç kurseve pranë Shkollës së Bashkuar të Oficerëve ose fakulteteve pranë akademisë, ne kemi edhe Shkollën e Partisë «V. I. Lenin», ku të kujdesemi që të dërgojmë më shumë kuadro politikë nga ushtria. Programet e Shkollës së Partisë ne mund t'i rishikojmë e t'i plotësojmë, duke futur në to disa orientime më të gjera, specifike, të lidhura me çështjet ushtarako-teknike dhe politiko-ideologjike të ushtrisë. Pra, përveç lëndëve të përgjithshme, në Shkollën e Partisë diçka e veçantë mund të bëhet lidhur me punën e Partisë në ushtri. Këto lëndë do të janë të dobishme jo vetëm për kuadrin politik të ushtrisë, por dhe për dëgjuesit e tjerë të kësaj shkolle, të cilët përfshihen edhe ata në organikat e ushtrisë si oficerë rezervistë.

Mund të studiohet gjithashu, çështja që kurset e Shkollës së Bashkuar dhe fakultetet e Akademisë Ushtarake të kufizohen në përgatitjen e kuadrit oficer vetëm për anën ushtarake dhe më vonë, pasi këta të kenë bërë një stazh të caktuar pune në reparte, të dërgohen në Shkollën e Partisë për t'u aftesar e për t'u përgatitur si punëtorë politikë.

Për përgatitjen e punëtorëve politikë nga ana ideotorike në Shkollën e Bashkuar ose në Akademinë Ushtarake, nuk duhet të ndiqen ajo sasi orësh dhe ajo metodë që përdoret në fakultetet e ndryshme të uni-

versitetit. Programet e shkollave ushtarake kanë veçoritë e tyre, kurse universiteti, gjithashtu, ka veçoritë e veta, prandaj kuadrove politikë të ushtrisë marksi-zëm-leninizmin ua mësojmë jo vetëm në kurse e në shkolla, por edhe në forma të tjera.

Lëndët ideopolitike që vihen në këto programe duhen rishikuar mirë dhe të mos mendohet se kjo punë mund të bëhet brenda një dite, as në dy ose në pesë muaj. Ato duhen shikuar me një sy kritik e metodik të atillë, që të sigurojnë, në radhë të parë, edukimin e përgjithshëm ideoteorik të të gjithë oficerëve dhe ushtarëve. Së dyti, të përbajnë edukimin moralo-politik dhe metodikën e punës politike të lidhur ngushtë me praktikën e punës ushtarake dhe me detyrat që dalin në fushën e përgatitjes dhe të shërbimit ushtarak. Dhe, së fundi, ato të përfshijnë njojuritë mbi edukimin dhe mbi përgatitjen ushtarake.

Edukimin ushtarak të efektivit, në përgjithësi, ne duhet ta kuptojmë në tërë kompleksitetin e tij, në gërshtim me përgatitjen ideoteorike, moralo-politike dhe ushtarake, të cilat, të gjitha së bashku, të shkrira mirë me njëra-tjetrën dhe të zhvilluara në përputhje me detyrat e popullit dhe të vendit përmes mbrojtje, do të konkretizohen me përgatitjen e ushtarit të popullit si një qytetar i vërtetë, të qytetarit-ushtar, mbrojtës i zjarrtë i atdheut socialist. Kjo punë duhet të arrijë që të përgatitë qytetarë të ndershëm, energjikë, të shkathët e të disiplinuar, të gatshëm në çdo kohë të hidhen në zjarr përmes interesat e lartë të atdheut. Ky është qëllimi i lartë që duhet të arrijmë, prandaj në këtë drejtim të vihet theksi.

Rishikimi metodik i programeve duhet të shoqërohet me rishikimin e teksteve e të kohës që nevojitet për zhvillimin e mësimit, duke pasur parasysh një balancim, harmonizim e lidhje organike sa më të plotë të tyre dhe jo duke bashkuar gjëra të shkëputura. Me gjithë të mirat që mund të kemi në këtë drejtim, me gjithë përparimet që kemi arritur dhe përvojën e situar, duhet njojur se këto gjëra akoma nuk janë të balancuara mirë. Çështje të tilla nuk ekzistojnë vetëm në ushtri, pse këto janë procese në zhvillim, gjatë të cilit lindin gjëra të reja dhe, si të tilla, kanë nevojë përkorrigejime të vazhdueshme. Prandaj, del detyra që të përcaktohet mirë koha që do t'i jepet në program çdo lloj edukimi, për të krijuar kështu një unitet plotësues të njërit lloj edukimi me tjetrin.

Ka mundësi që kjo punë, po të bëhet mirë e me kujdes, do të shërbejë si stimul i madh për instruktorët, për komisarët, për komandantët e për pedagogët, e sidomos për ushtarët dhe për nxënësit, të cilët me këtë organizim të mësimit do të vihen në pozita më luftarakë, do të punojnë më shumë e më me iniciativë për të plotësuar dijenitë e tyre personale. Në qoftë se, me gjithë përpjekjet, koha nuk do të jetë e mjaftë për t'u dhënë atyre njojuri e sqarime të plota për ndonjë lëndë të posaçme, atëherë për komisarët dhe për komandantët mund të organizohen disa seminare të vëçanta, por pa i ngarkuar shumë. Koha që do të nevojitet për këto seminare duhet të dalë, natyrisht, nga lufta që do të bëhet kundër shablonizmave, rutinës, punës e orëve pa kontroll e pa llogari, që harxhohen në shumë raste gjatë zhvillimit të punës politike me

metoda e me norma standarde. Ky kursim kohe është i domosdoshëm të bëhet sepse, siç u tha këtu, vctëm për përgatitjen politike të ushtarit që ngarkohet të marrë shërbimin e rojës e shërbime të tjera të kësaj natyre harxhohen deri tri orë, punë kjo që, me një kujdes më të madh, mund të kryhet brenda një ore, duke kursyer në këtë mënyrë dy orë të vlefshme për ushtarin dhe për oficerin.

Shablonizmi dhe rutina ekzistojnë më shumë, se edhe ushtria ka kaluar në disa etapa zhvillimi. E kaluara, natyrisht, nuk mund të kapërcehet menjëherë e pa një luftë të vazhdueshme. Rutina te shokët e ushtrisë (dhe jo vetëm te këta, por tek të gjithë), lind pa dashje, në çdo kohë, për shkak të metodave të punës e të koncepteve që ekzistojnë. Ushtria jonë, siç thashë, ka kaluar në disa etapa, të cilat nuk mbahen parasysh sa duhet. Në dolëm nga Lufta Nacionalçlirimtare me një ushtri me veçori partizane, të krijuar dhe të udhëhequr nga Partia, e cila luftoi në ato kushte të vështira që dihen dhe çlroi atdheun. Pas Çlirimt, në kushte të reja, Ushtria Popullore stërvitej e mbahej në gatishmëri në kazerma. Këtë ushtri ne e kemi dhe po e mbajmë edhe sot e do ta ruajmë në të ardhmen për arsyet që njihen, por në një limit të caktuar, për aq sa na lejojnë kushtet dhe mundësitë, sepse ekonominë nuk mund ta rëndojni shumë me mbajtjen e një ushtrie të madhe kazerme. Prandaj kemi bërë një organizim të tillë ushtarë, i cili përgatit kontingjentet që i nënshtrohen shërbimit ushtarë, garanton mobilizimin dhe hapjen e Ushtrisë së madhe Popullore në të gjitha strukturat,

siguron stërvitjen masive të popullit dhe mbulon drejtimet më të mundshme të agresionit armik.

Gjatë Luftës Nacionaleçirimitare ne luftuam dhe çliruam vendin nga pushtuesit e huaj dhe tradhtarët e vendit, ndërsa në eventualitetin e një lufte të ardhshme do të luftojmë për mbrojtjen e atdheut dhe të fitoreve të socializmit nga armiqtë, që do të na sulmojnë, si dhe për çlirimin e ndonjë pjese të territorit që përkohësisht mund të pushtohet nga armiku. Këtë detyrë nuk e zgjidh dot vetëm ushtria e kazermës, atë mund ta zgjidhë më mirë Ushtria e madhe Popullore, «gjithë populli ushtar». Prandaj po kalojmë tani nga një ushtri kazermë, në Ushtrinë e madhe Popullore, në shkollën e lirë. Ky është një term që e kam cituar unë nga Lenini, por nuk e di se si është zbërthyer e zbatuar kjo ide¹.

Konceptin «gjithë populli ushtar» duhet ta kuptojë mirë Partia në terren e në ushtri, ta kuptojnë mirë gjithë kuadrot e Ushtrisë sonë Popullore, rezervistë dhe

1. Më 5 mars 1970 shoku Enver Hoxha shkroi materialin «Teza për Shkollën e Lirë Ushtarake» dbe menjëherë i dha për zberthim e për zbatim. Por ish-ministri i Mbrojtjes Popullore, Beqir Balluku, si armik i kamufluar që ishte, duke parë se ato pengonin realizimin e synimeve të padronëve të tij, i mbylli në kasafortë, nën pretekstin se «janë tepër sekret», kurse qëllimi i tij ishte të sabotonte vijën ushtarake të Partisë për zbatimin e mësimit leninist lidhur me armatosjen dhe përgatitjen ushtarake të popullit ushtar.

Pas zbulimit dhe demaskimit të veprimtarisë komplotiste e puçiste të armiqve B. Balluku, P. Dume e H. Çako, më 22 nëntor 1974 shoku Enver Hoxha dha porosi për shumëzimin e këtyre lezave, të cilat u botuan menjëherë për përdorim të brendshëm në Parti dhe në ushtri.

aktivë. Ne nuk mund të konsiderojnë ushtri popullore vetëm ushtrinë aktive, prandaj na dalin probleme që, natyrisht, nuk zgjidhen dot menjëherë, por ne duhet t'u dalim përpara me kohë e të marrim masa për t'i zgjidhur me sukses. Kështu, për shembull, në drejtim të ndërtimit organizativ ushtarak, janë arritur suksese të njohura. Është bërë rajonizimi, në qendrat e prodhitit janë organizuar reparte e nënreparte, bëhet punë për edukimin ushtarak të rinisë shkolllore e studenteske, forcat vullnetare të vetëmbrojtjes popullore janë organizuar në formacione ushtarake, i gjithë populli është përfshirë në përgatitjen e organizuar ushtarake duke vënë në dispozicion të tij armë të të gjitha llojeve.

Mobilizimi i forcave rezerviste e vullnetare është i kënaqshëm dhe slërvitjet me trupa që janë bërë herë pas here e kanë vërtetuar këtë konkluzion. Megjithatë ka akoma probleme që nuk venë mirë si duhet. Disa herë, gjatë mbledhjeve mësimore, mungojnë disiplina dhe serioziteti i duhur, interesimi dhe përfitimi nga to nuk janë në lartësinë që kërkohet, bëhen lëshime dhe vërehen shmangje nga lufta për të kapërcyer vështirësitë në stërvitje. Ka dhe probleme të tjera si këto, që lindin kryesisht nga të meta e dobësi në punën edukative bindëse ideopolitike, e cila, po të kryhet me cilësi, do t'i ngrejë njerëzit në nivelin e kërkesave dhe të detyrave, do t'i sqarojë, do t'i mobilizojë e do të forcojë tek ata këmbënguljen dhe srymën luftarake. Këto çështje mund të vihen në rrugë në bashkëpunim të ngushtë me rrethet, që kanë nën drejtimin e tyre të gjitha forcat e shunita të ushtrisë, nga ushtari e gjer te kuadrot politikë dhe ushtarakë.

Me ushtarakët rezervistë është e nevojshme të organizohet e të zhvillohet një punë poitike e gjerë, e cila do të mënjanjojë shfaqjet dhe qëndrimet e papëlqyera të disa ushtarëve e kuadrove, do të luftojë konceptet e ngushta mbi domosdoshmërinë e përgatitjes luftarake dhe do ta mobilizojë popullin ushtar për të punuar me seriozitet në stërvitje e për të përsituar sa më shumë prej tyre. Por, në drejtim të përgatitjes luftarake, të zhvillimit të stërvitjes dhe të formimit të shprehive të nevojshme ushtarake e teknike, përgjegjësinë e ka ushtria. Kjo duhet të merret seriozisht me përgatitjen e popullit për luftë e, për të bërë këtë, ajo duhet t'i thyejë kornizat që pengojnë të dalë nga format shabllone të punës dhe të mos kufizohet vetëm me mbledhjet mësimore.

Rajonizimi i bërë me sukses, që është duke u thelluar e duke u përsosur, i ka afruar plotësisht punonjësit dhe kuadrot, ushtarët e oficerët me armët dhe me nënrepartin, me batalionin dhe me kompaninë. Veç këtyre në terren, në lagje, në kooperativë dhe në qendrat e punës kemi edhe mjast oficerë të tjera, që kanë dalë në pension për arsyen apo shëndetësore. Këta kuadro, që pjesërisht janë edhe në marrëdhënie pune, kanë njohuri, astësi dhe përvojë të madhe për të ndihmuar në përgatitjen ushtarake të popullit. Vetëm ushtarakët aktivë nuk e kryejnë dot detyrën e përgatitjes luftarake të njësisë ushtarake ku punojnë. Këtë punë, të ndihmuar nga kuadrot ushtarakët në pension dhe nga ata aktivë, mund ta kryejnë me sukses, në radhë të parë, kuadrot rezervistë, që përojnë masën e kuadrit oficer të ushtrisë. Pikërisht sepse nuk shikohet e nuk

zgjidhet tamam kështu problemi, në procesin e përgatitjes luftarake dhe në stërvitjet me trupa vilen re akoma mungesa, për të cilat u fol në këtë mbledhje.

Në qoftë se Ministria e Mbrojtjes Popullore dhe Drejtoria Politike nuk do të bëjnë scaricabarile¹ mbi rrëthet, por do të mendojnë më gjerë për këtë çështje, duke organizuar punën së bashku me rrëthet që përgatitja luftarake e ushtrisë të mos kufizohet vetëm me mbledhjet mësimore dhe të mos lihet vetëm në duart e kuadrit oficer aktiv, në qoftë se ato do të marrin masa konkrete që të aktivizojnë kuadrin rezervist dhe atë në pension, shumë probleme të disiplinës, të kilitjes fizike, të stërvitjes taktike, të mësimit të armëve etj., nuk do të janë shqetësuese. Për të bërë punën ushtarake plotësuese, në radhë të parë për çështjet që nuk janë përvetësuar mirë nga ushtarët, kuadri rezervist dhe ai në pension të mos aktivizohen me ditë të tëra, por disa orë në javë, jashtë kohës së punës. Në këtë drejtim ka disa herë mosmarrëveshje në mes shokëve të ushtrisë dhe atyre të terrenit. Të parët ankohen se shokët e terrenit nuk i ndihmojnë sa duhet, kurse këta të fundit thonë se shokët e ushtrisë kanë të meta në punën e tyre me rezervistët, pengojnë prodhimin, nuk bashkëpunojnë në shkallën e duhur etj. Këto mosmarrëveshje ndodhin se nuk punohet, siç thamë më lart, se Partia dhe kuadrot e saj në ushtri akoma nuk kanë kuptuar si duhet qëllimin e edukimit ushtarët të Ushtrisë së madhe Popullore, të popullit ushtar, prandaj bëjnë një dallim të madh në mes ushtarëve

1. Italisht — sinkarkim i veles për t'u ngarkuar të tjerëve.

dhe oficerëve aktivë, nga njëra anë, dhe oficerëve e ushtarëve rezervistë, nga ana tjetër.

Koncepte, te kuadrot e ushtrisë, shprehen në konsideratën jo të drejtë që ekziston për rezervistët, të cilët konsiderohen si ushtarakë me më pak vlerë. Rezervistët nuk shikohen si masa dhe forca kryesore e ushtrisë dhe e fuqisë sonë mbrojtëse, po si një shtojcë, si forcë ndihmëse e ushtrisë aktive, ndërsa kjo e fundit, sipas këtij mendimi, përbën fuqinë kryesore goditëse të ushtrisë dhe mburojën e vërtetë të vendit. Ky është një mendim krejtësisht i gabuar, që e ka burimin në moskuptimin e drejtë e të plotë të konceptit mbi Ushtrinë e madhe Popullore, ku bën pjesë gjithë populli ushtar dhe mbrojtës i atdheut.

Rezervistët te ne nuk mund të konceptohen si në ushtritë e vjetra borgjeze. Konsiderata jonë për rezervistin nuk mund të jetë si për rezervistët e ushtrisë borgjeze. Rezervistët tanë janë të organizuar në reparte luftarake, stërviten në mënyrë të vazhdueshme, kanë në duar gjithë armatimin dhe teknikën e nevojshme, janë të organizuar e të dislokuar në drejtimet më të rëndësishme luftarake dhe qëndrojnë të gatshëm e vigjilentë për të thyer çdo orvatje të armiqve.

Nga pikëpamja e aftësisë dhe e përgatitjes luftarake, oficerët dhe ushtarët rezervistë qëndrojnë më lart se ushtarët aktivë. Kjo është e vërtetë për arsy se, ndërsa ushtarët aktivë s'kanë përvetësuar akoma si duhet programin e përgatitjes ushtarake dhe të edukimit, rezervistët me kohë e me sukses e kanë mbaruar shërbimin ushtarak, shkollën e ushtrisë, duke fituar njohuri, shprehi dhe aftësi të plota. Për

vite me radhë nëpër mbledhje të rregullta e mësimore, nëpër stërvitje me trupa dhe në forma të tjera, ata freskojnë njohuritë e situara, pasurojnë përvojën e tyre dhe kaliten. Ata janë më të pjekur e më seriozë në vlerësimin e gjendjes dhe të detyrave, prandaj nënveftësimi i rezervistëve, që përbëjnë shumicën dërrmuese të ushtrisë dhe pikëpamja se ushtria jonë është vetëm ajo e kazermës, janë të gabuara. Partia në ushtri e në terren, duhet t'i luftojë këto pikëpamje që të kuplohet drejt se nuk janë të organizuar, të përgatitur dhe të zotë vetëm ushtarët e kazermës, nuk janë vetëm ata shpëtimi i vendit.

Ushtarët, oficerët dhe repartet aktive, përbëjnë një pjesë të vogël të Ushtrisë sonë të madhe Popullore, të cilët kryejnë shërbimin ushtarak dhe qëndrojnë në gatishmëri, që në rast agresioni të thyejnë goditjet e para të armikut dhe të mbulojnë e të sigurojnë hapjen dhe mobilizimin e Ushtrisë së madhe Popullore. Për të gjitha këto arsyë ne duhet t'i vëmË rëndësi dhe t'i kushtojmë kujdes, para së gjithash, përgatitjes së kuadrit oficer dhe shtabeve të kësaj ushtrie të madhe rezerviste. Për këtë qëllim duhen përgatitur programe të përshtatshme ose afërsisht të përshtatshme me ato që thamë më lart. Të ngulim këmbë që këto programe të ndihmojnë e të zbatohen prej nënoficerëve, komandave dhe komisarëve të ushtrisë rezerviste. Përgatitja plotësuese e tyre të bëhet jashtë kohës së stërvitjes ushtarake, domethënë në vendet ku punojnë ata, sepse vetëm në kohën e caktuar me ligj për përgatitjen e oficerëve rezervistë, megjithëse kjo kohë nuk është e paktë, nuk mund të mësohen mirë të gjitha çështjet.

Por më shumë se afati i caktuar me ligj nuk mund të bëhet thirrja në stërvitje, kështu që, për të plotësuar ndonjë boshllék dhe për të ndrequr disa të meta, duhet të ndihmohen dhe të përgatiten ushtarët edhe jashtë kësaj kohe. Në këto programe nuk duhet të përsëriten gjërat që janë zhvilluar më parë e që janë të njohura për ta. Prandaj në përgatitjen e tyre të mos nisemi nga mendimi se ata nuk dinë gjë, duke harruar që ata kanë mbaruar ushtrinë, kanë bërë kurse e stërvitje dhe kanë një përvjohje shumë të gjatë pune.

Në qoftë se Partia në terren do ta kuptojë drejt rëndësinë e përgatitjes ushtarake, do të krijojë koncepte më të drejta për të dhe do të ketë të qartë ç'shtë Ushtria Popullore, atëherë do të zhduken gjithë ato fërkime, kontradikta, mosmarrëveshje e çorganizime që ekzistojnë në mes ushtrisë dhe terrenit. Kështu, pasi të bëhen hapa përpara në këtë drejtim, do të ketë një interesim reciprok dhe shqetësim të përbashkët për problemet e mbrojtjes, të përgatitjes ushtarake, do të bashkohen forcat dhe përpjekjet për të gjetur forma të përshtatshme pune për ta vënë theksin kryesisht mbi efektivin rezervist.

Siq thashë më lart, organizimi ynë ushtarak, armatimi dhe teknika u janë afruar masave të popullit, ato janë atje ku jeton dhe ku punon populli. Punonjësit dhe kuadrot e qendrave të punës janë edhe ushtarët e oficerët e repartit. Megjithatë punët nuk na venë aq mirë dhe kemi mjaft të meta. Kjo ndodh sepse organizata e Partisë e drejtoria e qendrës së punës, që janë në të njëjtën kohë edhe organizata e Partisë, kuadri dhe ushtarët e repartit përkatës, akoma nuk e ngrenë proble-

min e mbrojtjes dhe nuk kujdesen për të si për problemet e tjera të prodhimit, ata nuk kujdesen si duhet për mirëmbajtjen e teknikës dhe për pjesëmarrjen në stërvitje, ashtu si për mjetet e punës dhe për pjesëmarrjen në punë, nuk luftojnë si duhet kundër boshllëqeve në stërvitje, siç luftojnë për eliminimin e tyre në prodhim. Oficerët dhe komunistët e qendrave të punës duhet të kujdesen për armët, për teknikën, për përgatitjen e rezervistëve të repartit të tyre, duhet, pra, të dinë gjendjen dhe gatishmërinë luftarake të efektivit dhe të armatimit që t'i kenë në dorë në çdo kohë situatën dhe repartin. Bashkë me punët e tjera, shokët e qendrave të punës oshtë e domosdoshme të ushtrojnë kontroll të vazhdueshëm mbi armën e mbi teknikën, mbi pjesëmarrjen e ushtarëve në mbledhjet mësimore dhe në mësimin ushtarak, të njohin boshllëqet e krijuara në programin e përgatitjes dhe të edukimit ushtarak, të dinë prirjet dhe mungesat e çdo ushtari rezervist dhe të ngrenë probleme para Partisë dhe para kolektivit të tyre, duke kërkuar dhe duke ndihmuar që të mënjanohen dobësitë sa më shpejt që të jetë e mundur.

Kur tanku dhe arma nuk janë në gjendje gatishmërie, oficeri rezervist i kërkon ushtarit, që i ka në ngarkim, t'i vërë ato menjëherë në gatishmëri të plotë. Kur ushtari nuk e kryen këtë detyrë, oficeri t'i drejtohet atëherë sekretarit të organizatës që çështja e tij të shqyrtohet në Parti. Kështu vepron komandanti edhe me kuadrot politikë dhe ushtarakë të kompanisë, kur ata nuk e bëjnë mirë punën politike dhe nuk i edukojnë si duhet ushtarët që kanë në varësi, të cilët nuk punojnë për të arritur shokët, nuk studiojnë literaturën ushta-

rake, nuk janë të disiplinuar, nuk marrin pjesë rregullisht në mbledhjet mësimore etj. Duke vepruar kështu, forcohet bashkëpunimi i ushtrisë me terrenin për një problem kaq të madh politik, siç është ai i mbrojtjes, që arrihet në luftë me format shabllone të punës, me studime e me vendime të përpikta. Studimet dhe vendimet e përpikta nuk kanë kuptimin e futjes në shumë detaje, sa të mos i lëmë njerëzit të mendojnë e të punojnë me iniciativë, por kanë kuptimin e zërthimit me saktësi të parimeve të vendosura. Atje ku ka përcaktimë të qarta, nuk ka ujë, nuk ka akademizma, shabllonizma, ndrydhje initiative e ngathtësi. Përpikëria në punë zhvillon vetëveprimin dhe iniciativën, jep mundësi për të bërë korrigjime në përshtatje me situatën dhe ndihmon për të gjetur forma të reja pune.

Të metat që përmenda më lart u konstatuan në stërvitjet komplekse që janë zhvilluar me trupa. Të meta të tillë, siç janë: mosplotësimi i dokumenteve me kohë, mbetja e shumë forcave të lira partie e kuadroshtë papërgatitur, që nuk dinë ku të venë, mosbërja në rregull e bronjimeve, vetëkënaqësia, paqartësia në përsytyrimin e punës së Partisë në kushte ilegaliteti, evakuimi etj, duhet të mënjanohen. Të gjitha këto janë probleme politike, për të cilat Partia duhet të ketë vëmendjen për të bërë një punë të organizuar politike, për të ngritur ndërgjegjen dhe aftësitë ushtarake, në radhë të parë të komunistëve dhe të kuadrove, për t'i bërë ata punëtorë, këmbëngulës dhe për t'u ngjallur më shumë dëshirën për punët ushtarake jo vetëm në mbledhjet mësimore dhe në stërvitjet me trupa, por edhe

gjatë gjithë vitit, duke gjetur e duke përdorur forma pune të përshtatshme.

Organizatat e Partisë në terren duhet të kujdesen se ku do të shkojnë komunistët në rast mobilizimi, sa prej tyre janë në ushtri, sa në forcat vullnetare, sa do të evakuohen, kush do të bronjohet etj. Për ata që mbeten jashtë këtyre formacioneve, të merren masa që të mos mbeten pa u organizuar dhe pa u përgatitur. Orientimi i Partisë üshtë ky: masa e madhe e komunistëve të vejë në ushtri, që të mësojë e të përgatitet për lufë dhe ashtu, si kudo, të jetë në pararojë.

Komititetet dhe organizatat e Partisë të vetëveprojnë me iniciativë, të mos merren me gjëra pa rëndësi, por me problemet kryesore. Udhëzimet e dhëna t'i zbatojnë në mënyrë krijuese e sipas situatave luftarake, pa i ndërlikuar ato, pasi lufsta nuk duron ndërlikime. Disa rregulla, norma e orientime do të caktohen nga lart, por ato duhet të zbërthehen më tej dhe të zbatohen me iniciativë nga baza. Punën edukative specifike, të lidhur me problemet ushtarake dhe me përgatitjen luftarake të popullit, me gjithë ndihmën që do të jepin organizatat dhe komitetet e Partisë në terren, nuk mund ta bëjnë vetëm. Këtë punë politike specifike duhet ta bëjë kuadri oficer politik rezervist i qendrës së punës, me ndihmën e organeve të Partisë në ushtri dhe nën kontrollin e nën drejtimin e komiteteve të Partisë të rretheve. Prandaj, Drejtoria Politike duhet të ndihmojë me metodikë dhe me materiale të zbërthyera e të përgatitura me kujdes, të balancuara e të përshtatura me kohën, me detyrat dhe me kushtet e punës së rezervistëve. Drejtoria Politike, gjithashtu, duhet të kërkojë

ndihmën e komiteteve të Partisë të rretheve për të përgatitur materialet e nevojshme politike e ideologjike, me qëllim që të përballohen dobësitë që dalin nga përgatitja dhe nga gatishmëria e rezervistëve, për të caktuar njerëzit që do të zhvillojnë këtë punë edukative, të cilët mund të janë punonjës të komitetit të Partisë, shokë të ushtrisë dhe oficerë politikë e ushtarakë rezervistë të ndërmarrjes. Me këtë organizim të punës edukohen ushtarët, mësojnë e përgatiten edhe vetë oficerët rezervistë. Në këtë punë duhet të jemi kërkuar e të kujdeshëm lidhur me kohën, e cila duhet të shfrytëzohet mirë. Rezervistët janë punëtorë, prandaj nuk mund të mbahen në mbledhje me orë të tëra, për të dëgjuar leksione pa fund. Në kuadrin e përgjithshëm të edukimit të zhvillohen edhe tema për mbrojtjen ku të gërshetohet puna politike me punën ushtarake.

Kontrolli punëtor duhet të gjejë një zgjidhje dhe zbatim konkret e të drejtë edhe në ushtri, prandaj të organizohet ai në përshtatje me kushtet, me veçoritë dhe me problemet e ushtrisë, që të vërë në lëvizje masat dhe të zgjidhë problemet e shumta që dalin. Kontrolli punëtor brendapërbrenda repartit duhet të ushtrohet nga vetë ushtarët. Por, a e keni zbërthyer ju¹ nga ana politiko-moralo-ushtarake çështjen e kontrollit punëtor në ushtri? Cilat janë orientimet kryesore në këtë drejtim? A ju kanë ardhur ushtarët juve deri në Shtabin e Përgjithshëm për t'ju kërkuar llogari?

Kështu si e shpjegoni ju, gjendja paraqitet shesh me lule. Atëherë, nga e kanë nxjerrë shokët e aparatit

1. I drejtohet Hito Çakos.

të Komitetit Qendror konkluzionin që ushtarët dhe organizata e rinisë në ushtri nuk pyeten dhe nuk kontrollojnë? Kontrolli punëtor nuk është vetëm fletërrufjeja. Këtu u tha se kjo detyrë nuk është organizuar dhe nuk zbatohet mirë dhe se gjer tanj kjo punë me rëndësi ka qenë e rastit. Kjo ka ndodhur se kontrolli punëtor në ushtri nuk është zbërthyer mirë, njerëzit atje nuk janë plotësisht të qartë për të, prandaj tek ata nuk është krijuar ndjenja organizative e lidhur me aksionin konkret.

Sikurse u tha me të drejtë këtu, për të lehtësuar më shumë punën dhe për të ndihmuar kuadrin oficer në vendosjen e rregullit dhe të disiplinës ushtarake, një rol i madh u takon të luajnë vetë ushtarët, sepse ata pësojnë në kurrizin e tyre të metat dhe gabimet e eprorëve. Kontrolli punëtor dhe vija e masave që zbatohen në ushtri kanë për qëllim ta forcojnë ushtrinë, të kompaktësojnë efektivin, të rritin frymën e tij luftarake, të luftojnë shfaqjet e burokratizmit dhe të rutinës, të forcojnë disiplinën, rregullin, përgatitjen dhe gatishmërinë luftarake, të mbrojnë dhe të sigurojnë zbatimin e përpiktë të ligjeve, të udhëzimeve dhe të normave të vendosura në ushtri. Kur ushtarët të shkojnë për të kontrolluar, ta zëmë, sektorin e prapavijës ose një sektor tjetër, shefat e këtyre sektorëve të janë të gatshëm t'u shpjegojnë çështjet për të cilat ata kërkojnë sqarime, t'i dëgjojnë, t'i informojnë për të marrë vesh se ç'bëhet në sektorin e tyre dhe si zbatohen direktivat e Partisë, ligjet e shtetit dhe rregulloret e ushtrisë. Ushtarët kanë të drejtë të pyesin: Si punoni ju, shokë të prapavijës, për të kryer detyrat, kush ju pengon dhe

ç'ndihmë kërkoni nga ne, ushtarët? Po të veprohet kështu, në ndonjë repart mund të dalë që prapavija dhe administrata nuk e bëjnë mirë punën e tyre, nuk i furnizojnë ushtarët në mënyrë të rregullt e në bazë të normave që u takojnë, se ka pakujdesi për sigurimin e kushteve të jetesës së tyre etj., por në të njëjtën kohë do të dalë, gjithashtu, se edhe nga ushtarët ka një keqtrajtim të materialeve që kanë në përdorim, se uniforma mbahet keq e jo sipas rregullores etj. Kështu pra, krahas nxjerrjes së përgjegjësive, do të përcaktohen edhe detyrat reciproke të ushtarëve dhe të oficerëve, do të shkallmohen prirjet e vjetra të disiplinës formale, të autoritarizmit pa vend, të arrogancës dhe të fodullëkut të disa oficerëve që u thonë ushtarëve: Ti je ushtar, kurse unë jam oficer, prandaj s'ke të drejtë të më kontrollosh e të më kërkosh llogari!

Por ky kontroll duhet bërë në rrugë të drejtë, në rrugë partie, duhet organizuar dhe duhet orientuar mëri, me qëllime konstruktive për të ndrequr gabimet, për të shëndoshur punën, për të ndihmuar e për të ndrequr kuadrot dhe jo në mënyrë spontane, me vend e pa vend. Atje ku s'ka asgjë për të parë e për të ndihmuar dhe atje ku zbulohet sekreti ushtarak, të veprohet me mend në kokë, duke pasur parasysh veçoritë e sektorit që kontrollohet. Kontrolli i masës së ushtarëve nuk duhet të ulë kërkeshën e llogarisë, nuk duhet të thyejë disiplinën dhe të cenojë përgatitjen e gatishmërisë luftarake.

Një kuptim dhe zbatim i tillë i kontrollit punëtor (ushtar) është një ndihmë e madhe për mbarëvajtjen e punës, për mobilizimin dhe për rritjen e frysës lufta-

rake të efektivit, për forcimin e lidhjeve të kuadrit oficer me ushtarët, për Partinë dhe për komandën e repartit, si dhe për Drejtorinë Politike e për Ministrinë e Mbrojtjes Popullore. Prandaj Drejtoria Politike dhe organet e Partisë në njësi duhet të studiojnë mësimet e Partisë mbi kontrollin punëtor, t'i zberthejnë e t'i kuptojnë mirë ato dhe të gjejnë forma të përshtatshme pune e organizimi për t'i zbatuar në mënyrë të vazhdueshme.

Në kushtet e sotme të hapjes së ushtrisë, të shtrirjes së saj dhe të pjesëmarrjes së gjerë e të gjithanshme të imbarë popullit në strukturat ushtarake dhe në edukimin ushtarak, një zbatim më të gjerë e më të rregullt duhet të marrë kontrolli drejtpërdrejt i klasës punëtore në ushtri. Sot në përgatitjen ushtarake e teknike të reparteve dhe të nënreparteve të përbëra nga punonjës të ndërmarrjeve ka suksese të shumta e të njohura, por në të njëjtën kohë, siç u tha më lart, ka edhe probleme, vështirësi e mungesa kryesisht të karakterit subjektiv, që lindin si nga puna e pamjaftueshme e qendrave të punës dhe të vetë punonjësve, ashtu edhe nga puna jo në nivelin e duhur e komandave. Uzina «Traktori» për shembull, dërgon çdo vit në mbledhjet mësimore pranë reparteve ushtarake me qindra punëtorë e kuadro, të cilët qëndrojnë atje për aq kohë sa është parashikuar me ligj. Këto sakrifica të mëdha janë të kuptueshme e të pranueshme nga masat, pse bëhen për t'u dhënë atyre njohuritë e nevojshme ushtarake dhe për t'i bërë të asta për mbrojtjen e atdheut socialist. A duhet të dijë klasa punëtore, fjala vjen kolektivi dhe organizata e Partisë e uzinës «Traktori», si luftojnë e si punojnë shokët e tyre në repartin ushtarak, si sillen. si

i kryejnë detyrat dhe sa përfitojnë ata? Jo vetëm kaq, po kolektivi punonjës i uzinës duhet të dijë ç'probleme ka dhe si punohet me punonjësit e tij nga komandat, nga kuadrot dhe nga Partia në repartin ushtarak që të jetë në gjendje të kontrollojë, të mendojë dhe të kërkojë llogari.

Prandaj, gjatë mbledhjeve mësimore dhe në raste të tjera, qendrat e punës e të prodhimit, të udhëhequra nga Partia në terren dhe në bashkëpunim e në koordinim me Partinë e me komandën e reparteve ushtarake ku janë inkuadruar punonjësit e tyre, kanë të drejtë të dërgojnë kontrollin punëtor në repartin ushtarak për të parë punën e punonjësve të tyre dhe të komandave, përparimet dhe mungesat, për të diskutuar me të dyja palët për problemet që i preokupojnë dhe nga ky diskutim të nxirren pastaj konkluzione dhe detyra për të dyja palët.

Një kontroll i tillë punëtor do të ndihmojë shumë jo vetëm për forcimin e punës së ushtarëve dhe të komandave në procesin e stërvitjes, por edhe në kapërcimin e pengesave, në forcimin e lidhjeve të repartit ushtarak me uzinën, të ushtrisë me terrenin. Ky kontroll do të bashkërendojë më mirë forcat dhe punën edukative politike dhe ushtarake që bëhet me rezervistët në ushtri me atë që bëhet në terren, do të sigurojë lidhjen dhe vazhdimësinë e tyre.

Për organizimin e mirë të këtij kontrolli të klasës punëtore në ushtri, nën drejtimin e Partisë, duhet të merren masa të plota e të gjithanshme. Grupet e kontrollit të përbëhen nga punëtorë të zgjedhur, të caktohet mirë objektivi i kontrollit dhe të ruhet konspira-

cioni më i lartë që të mos dëmtohet sekreti ushtarak. Në këto grupe kontrolli për të ndihmuar mund të aktivizohen edhe oficerë specialistë. Kontrollin punëtor mund ta kërkojë për ndihmë edhe vetë reparti ushtarak, i cili mund ta ndiejë shumë nevojën e ndihmës së punëtorëve për të zgjidhur disa probleme që e preokupojnë atë në procesin e përgatitjes politike, ushtarake dhe teknike të efektivit rezervist dhe aktiv.

Këto kontolle të klasës punëtore komanda dhe Partia në repart duhet t'i presin mirë dhe t'i ndihmojnë që ta kryejnë plotësisht detyrën. Komandat t'u dalin përpara shokëve punëtorë dhe t'i informojnë hapur e drejt për problemet që kanë, t'i dëgjojnë me respekt e me kujdes vërejtjet e punëtorëve pas kontrollit për të marrë masa dhe për të zbatuar porositë e drejta të tyre.

Në thellimin e procesit të demokratizimit të mëtejshëm në ushtri, organizatat dhe organet e Partisë dhe Drejtoria Politike duhet të punojnë akoma. Pjesëmarrja aktive e ushtarëve në punën dhe në jetën e reparteve ushtarake duhet të ndihmojë për forcimin e disiplinës, të rregullit, të kompaktësisë, të frysës dhe të gatishmërisë luftarake, për forcimin e lidhjeve të masës së ushtarëve me kuadrin oficer, të ushtrisë me popullin, përgritjen më lart të ndërgjegjes dhe të shkallës së shqetësimit të ushtarëve për kryerjen e shërbimit dhe të detyrave luftarake.

Por demokracia duhet të kuptohet drejt, ndryshe nuk mund të zbatohet drejt.

S'ka dyshim që në ushtri vërehen suksese në drejtimit të punës për edukimin e për kalitjen e njeriut të ri me dashurinë dhe me besnikërinë për popullin, për

Partinë e për atdheun dhe meurrejtjen për armiqtë. Megjithatë ka akoma të meta e boshllëqe në këtë drejtim. Në ushtri ka akoma raste arbitraritetesh, ka edhe lëshime në mbajtjen keq të uniformës nga ushtarët, në mbajtjen e flokëve të gjatë, pa u qethur, në largimin e disa ushtarëve pa leje nga kazermat etj. Ushtaraku mund të largohet nga reparti vetëm me leje në bazë të rregulloreve dhe jo kur t'i dojë qejfi. Veprime të kësaj natyre janë në kundërshtim me rregulloret e ushtrisë dhe tregojnë se ato nuk janë kuptuar si të detyrueshme, si pjesë përbërëse dhe elementë të rëndësishëm për ruajtjen e gjendjes së shëndoshë moralo-politike të trupës, për forcimin e disiplinës dhe të përgatitjes e gatishmërisë luftarake të saj. Të bësh lëshime, do të thotë të dobësosh kompaktësinë e ushtrisë, shërbimin ushtarak dhe gatishmërinë luftarake. Rregulloret duhet të shpjegohen mirë, të kuptohen drejt dhe të kërkohet zbatimi i tyre me rreptësi e me përpikëri. Lëshime në ligjet, në rregullat dhe në normat e vendosura nuk duhen bërë. Askush nuk ka të drejtë të vërë dorë mbi uniformën, të braktisë shërbimin, ose të shëmtohet me flokë të gjatë e të tjera shfaqje të këtij lloji, që janë të huaja për rininë tonë, ca më tepër për atë që kryen shërbimin ushtarak. As komandanti, as kuadri, as ushtarët nuk kanë të drejtë të bëjnë lëshime e të shkelin rregulloret, ose t'i keqinterpretojnë e t'i shpërdorojnë ato. Jeta dhe shërbimet në ushtri bazohen në rregullore e në urdhra të prerë. Qytetarët që vijnë për të kryer shërbimin ushtarak, si dhe të gjithë oficerët duhet t'i mësojnë e t'i zbatojnë mirë rregullat për të mos i shkelur në asnjë situatë e kudo që të jenë.

Organizatat dhe organet e Partisë, organizatat e rinisë, kuadri oficer dhe puna politike duhet t'i bëjnë të qartë e të kuptueshme efektivit se bukuria e ushtarit nuk qëndron në ekstravagancat e paraqitjes së jashtme, por në kuptimin drejt nga ana e tij të rëndësisë së madhe politike e patriotike të shërbimit ushtarak dhe të detyrave ushtarake. Luftha dhe përpjekjet e ushtarit për t'i kryer sa më mirë detyrat, për të bërë të pamundurën të mundur, përbën bukurinë shpirtërore për të cilën kanë nevojë atdheu dhe Partia. Ushtarin dhe oficerin, në radhë të parë të rinjtë, duhet t'i karakterizojnë kudo e në çdo gjë puna e palodhshme krijuese, shërbimi i rregullt e intensiv, luftha këmbëngulëse dhe guximi për kapëreimin e vështirësive, bindja e thellë në drejtësinë e vijës së Partisë. Të gjitha këto veti të marra në unitet formojnë dhe zbulurojnë figurën morale dhe personalitetin e ushtarit tonë, që nuk duhet të ketë asgjë të jashtme të tepërt për ta dalluar nga të tjerët. Krahas rritjes së ndërgjegjes të masës së kuadrove dhe të ushtarëve, për edukimin e tyre më të mirë në të gjitha këto drejtime, duhet kërkuar dhe zbatimi pa lëshime i rregulloreve e i normave ushtarake.

Problemet që po diskutojmë duhet të preokupojnë edhe organizatën e rinisë, e cila është një levë e rëndësishme e Partisë, ajo është organizata më e madhe e masave në ushtri, sepse përfshin në gjirin e saj shumicën dërrmuese të ushtarëve të shërbimit aktiv, kurse në kuadrin e ushtrisë nuk përbën shumicën, se dihet që në radhët e ushtarëve rezervistë ka më pak të rinj dhe më shumë të rritur.

Roli i organizatës së rinisë në ushtri është shumë

i madh. Ajo bën një punë shumë të mirë për edukimin ushtarak dhe ideopolitik e moral të ushtarëve, prandaj Partia t'i kushtojë asaj kujdes të veçantë. Duke gjykuar për sa thashë, del detyra që komunistët të vennë më dendur në mbledhjet e rinisë, të merren më shumë me problemet e saj, sepse, me gjithë sukseset e shënuara, punës me rinninë nuk i është kushtuar vëmendja e duhur. Të mos harrojmë për asnjë çast se është Partia ajo që udhëheq jetën e ushtrisë dhe të rinisë, e cila duhet të gjallërohet gjithnjë e më shumë. Gjallërimi i organizatës së rinisë të mos kuptohet ngushtë, sikur konsiston vetëm në zhvillimin e mbledhjeve të rregullta, në diskutimet që bëhen dhe në vendimet që merren. Në radhë të parë, aktivizimi i rinisë duhet parë në masat konkrete që merren dhe në punën që bëhet për të vënë në jetë ato që vendosen në këto mbledhje.

Edukimi ushtarak i rinisë shkollore është pjesë e edukimit të saj të përgjithshëm. Këtë çështje Partia e ka studiuar dhe e ka trajtuar në gjithë gjerësinë e saj dhe e ka vënë në vendin që i përket e në përpjesëtime të drejta. Dhe kështu punohet. Nxënësit dhë rinia jonë studentore, pedagogët, repartet e kuadrot ushtarakë, me punën e tyre kanë arritur suksesë të njoitura, janë bërë përparime dhe rinia këtë detyrë e kupton si një problem të madh patriotik. Por sukseset do të ishin më të mëdha, në qoftë se edukimit të saj ushtarak do t'i kushtohej vëmendje më e madhe, në qoftë se ky problem do t'u shpjegohej të rinjve më mirë nga ana politike dhe procesi i müsimit do të organizohej më mirë nga komandat e reparteve. nga kuadri ushtarak dhe peda-

gog që është ngarkuar me këtë punë kaq të rëndësishme.

Moskryerja mirë e këtyre detyrave shpjegohet me prapambetjen, me boshllëqet dhe me mungesat që vihen re në organizimin dhe në drejtimin e punës, me përgatitjen e pamjaftueshme pedagogjike dhe praktike të kuadrit oficer e pedagog, me qëndrimin herë-herë indiferent e pasiv të komandave ushtarake dhe të drejtoreve të shkollave, me mungesat në bazën materiale e të tjera. Këto dëshmojnë se organizatat e Partisë në ushtri e në terren nuk e kanë trajtuar drejt dhe gjerë problemin, nuk e kanë bërë atë sa duhet çështje të vetë rinisë dhe të Partisë në organet përkatëse të arsimit e të komandave. Nënvleftësimi i këtij problemi nga mësuesit dhe nga pedagogët, ushtarakë e civilë, shfaqjet e mosbesimit ndaj rinisë e ndaj kuadrit pedagog rezervist, kanë bërë që edukimi ushtarak në shkolla të mos zërë vendin që i takon ndërmjet aktiviteteve dhe mësimeve të tjera. Ky qëndrim, që vihet re sidomos në shkollat e ulëta profesionale dhe 8-vjeçare, është në kundërshtim me ligjin mbi sistemin e ri arsimor që përshkohet tërësisht nga boshti ideologjik marksist-leninist dhe zhvillohet mbi bazën e lidhjeve organike të mësimit me punën prodhuese dhe me edukimin fizik e ushtarak.

Një rëndësi të posaçme duhet të tregojë Drejtoria Politike për zbërthimin ideopolitik të Tezave të Këshillit të Mbrojtjes, të dokumenteve dhe të mësimeve të Partisë, të cilat përbëjnë bazën e mendimit dhe të praktikës sonë të punës ushtarake e politike. Kjo punë ka nevojë të theullohet më shumë, në mënyrë më të organizuar dhe me objektiva të qartë. Bindjet mbi do-

mosdoshmërinë e përgatitjes dhe të edukimit ushtarak të mbarë popullit si dhe përfytyrimi real i luftës të kuptohen si e vëmja rrugë për të përballuar me sukses armiqtë dhe për të sigruar mbrojtjen e atdheut. Të metat që vërtetohen në zbatimin e Tezave të Këshillit të Mbrojtjes dhe të dokumenteve e të mësimeve të Partisë, lidhur me përgatitjen luftarake dhe me edukimin ideopolitik e moral të efektivit, qëndrimet dhe marrëdhëniet e ushtrisë me terrenin, qëndrimi ndaj rezervistëve dhe përgatitjes së tyre ushtarake, si dhe shumë anë të tjera që i zura në gojë gjer tanë, tregojnë se këto dokumente kanë nevojë të thellohen më tej për t'u zbërthyer, për t'u shpjeguar e për t'u zbatuar më mirë nga ushtria aktive e rezerviste, nga forcat vullnetare të vetëmbrojtjes popullore, nga studentët dhe nga nxënësit, nga organet e Partisë, të pushtetit dhe nga mbarë populli ynë. Kështu do të kuptohen e do të përvetësohen më mirë strukturat ushtarake që kemi ndërtuar, mendimet tonë taktilke, operative e strategjike për luftën popullore, vendi dhe roli i cilitdo në luftë, lidhjet dhe bashkëpunimi i terrenit me ushtrinë, marrëdhëniet kuadër-masë, kontrolli punëtor dhe vija e masave, faktorët që vendosin satin e luftës e të tjera. Mbi këtë bazë do të formohen koncepte të drejta, do të lindin e do të zhvillohen mendimi ynë ushtarak, ndjenja e organizimit dhe iniciativat dhe do të përsoset akoma më tej metoda e punës.

Prandaj, në përputhje me këto kërkesa të ndërtohen edhe programet e përgatitjes marksiste-leniniste të komunistëve e të kuadrove, që atyre t'u zgjerohet horizonti. Kjo është e domosdoshme, sepse, pa qenë të pa-

jisur me botëkuptimin dhe me metodologjinë marksiste-leniniste, nuk mund të kuptohet metodologja e teorisë dhe e praktikës ushtarake, nuk mund të arrihen zbërthimi, trajtimi dhe kuptimi i plotë i strukturave dhe i detyrave ushtarake, nuk mund të zbatohen problemet politike, ideologjike, organizative, strukturore, ekonomike dhe ushtarake etj.

Partia në ushtri duhet të studiojë e të zbërthejë në mënyrë të rregullt e serioze jo vetëm dokumentet e mësimet që kanë lidhje të drejtpërdrejta me ushtrinë, por të gjitha dokumentet, vendimet dhe mësimet e Partisë për bujqësinë, për industrinë, për ndërtimin, për shkencën, për kulturën, për shëndetësinë etj., pa bërë fjalë këtu për problemet organizative, ideologjike e politike. Kjo gjë është e domosdoshme të kihet parasysh se ushtria nuk jeton e shkëputur nga problemet e mëdha që preokupojnë vendin. Mbi bazën e këtij studimi dhe zbirthimi të thellë të këtyre dokumenteve, të nxirren detyra ushtarake, politike e organizative. Në qoftë se Partia në ushtri nuk e bën mirë këtë punë, ajo s'ka bërë gjë tjetër veçse ka vepruar në mënyrë të përciptë. Nuk do të ishte e drejtë t'i thuhej bazës: lexoni vetë këtë ose atë dokument të Partisë. Drejtoria Politike, komitetet e Partisë dhe aparatet e tyre në njësi nuk duhet ta përfundojnë kështu këtë çështje dhe t'i lajnë duart me kaq. Shokët e bazës, të cilëve u thuhet ta lexojnë vetë dokumentin e Partisë, mund të mos jenë të tërë në gjendje të thellohen mbi të, ta shtrijnë e ta konkretizojnë atë në lidhje me zbatimin e detyrave të tyre ushtarake. Në batalione e poshtë, me gjithë dëshirën e tyre, ata nuk e kanë aq lehtë ta bëjnë këtë punë.

Drejtoria Politike duhet ta drejtojë vetë këtë çështje të rëndësishme e parimore, të punojë që të vërë në lëvizje komisarët dhe aparatet e njësive që t'i zbërthejnë mirë direktivat e Komitetit Qendror dhe të Qeverisë. Për këtë qëllim Drejtoria Politike duhet të ushtrojë kontroll, të dijë se çfarë detyrash kanë nxjerrë ata për repartin e tyre, si e kanë organizuar punën e ç'masa kanë marrë për të vënë në jetë detyrat. Vetëm kështu do të dalin ato materiale që duam ne për të puthitur idetë teoriko-politike me detyrat ushtarake.

Një ndihmë më të madhe duhet të japë Drejtoria Politike për botimin dhe për vënien në dispozicion të kuadrove politikë e ushtarakë të pjesëve të plota nga veprat e Marksit, Engelsit, Leninit, Stalinit, nga vendimet dhe nga mësimet e Partisë sonë për ushtrinë dhe për problemet ushtarake, të cilat do t'i ndihmojnë ata të zgjerojnë dijet gjatë studimit individual dhe gjatë punës për zërthimin e vendimeve të Partisë për ushtrinë dhe për të kuptuar e për të argumentuar mirë anën ideopolitike të parimeve të luftës popullore dhe detyrat që shtrohen përpara popullit dhe ushtrisë. Prandaj puna nuk duhet të mjaftohet e të kufizohet me atë që është bërë.

Problemet e mëdha të ndërtimit dhe të zhvillimit ushtarak, që shtrohen sot përpara popullit dhe ushtrisë, kanë nevojë për një shpjegim e zërthim të vazhdueshëm e të gjithanshëm ideoteorik dhe për një kuptim të qartë ideopolitik, në mënyrë që masat e, në radhë të parë, kuadrot, të vlerësojnë situatën e vendit tonë dhe të njojin mirë zhvillimin e gjithanshëm politik, ekonomik e kulturor të tij. Ky zërthim dhe gjithë ma-

teriali që botohet, qofshin dhe leksione, do të janë një ndihmë konkrete dhe e vlefshme, që do të shërbejnë si orientime me karakter teoriko-praktik e organizativ për zgjidhjen e detyrave që qëndrojnë përpara popullit, ushtrisë dhe kuadrove. Si kudo edhe në ushtri të mos kufizohemi vetëm në shpjegimin e principeve të përgjithshme dhe të përsëritim ato që janë thënë e që dihen.

Jam në dijeni për të gjitha materialct që bëjnë fjalë për përgatitjen luftarake e politike të ushtrisë, të forcave vullnetare, të organeve të Partisë e të pushitetit, si dhe me përfundimet e stërvitjeve të zhvilluara këta dy vjetët e fundit. Me gjithë atë punë të madhe që po bëhet për përgatitjen e vendit për mbrojtje, prapësepraprë kanë lindur disa probleme shqetësuese për ushtrinë, që nxjerrin në pah si punën e dobët të kuadrove ushtarakë, ashtu dhe atë të kuadrove politikë. Nuk tregohet kurdoherë kujdesi i duhur për ta rritur më tej zotësinë e kuadrove që t'u përgjigjet kërkjesave të kohës, nuk studiohen thellë problemet dhe detyrat që qëndrojnë përpara tyre, siç e kërkojnë dinamika e luftës, paramet e luftës popullore, situatat luftarake, ndërtimi strukturor i Ushtrisë sonë Popullore dhe terreni e armatimi ynë, që do t'u kundërvihen takтикës dhe strategjisë së armikut. Këto të meta duken veçanërisht qartë në situatat luftarake, kur zhvillohen stërvitje komplekse me trupa, gjatë të cilave, megjithëse bëhen përgatitje të gjata dhe parashikohet çdo gjë e mundshme, ato vërtetohen përsëri.

Me këtë s'dua të them se në të ardhmen nuk do të kemi fare nga këto të meta, por theksoj se është e do-

mosdoshme të marrin fund dobësitë që janë përsëritje e atyre që janë dukur në stërvitjet e mëparshme dhe që janë kritikuar një herë, sikurse janë organizimi dhe zhvillimi i marshimit me temp të ulët dhe jokompakt, që dëshmojnë për mosnjohjen dhe mosvlerësimin e marshimit si mjeti kryesor për të kryer manovrën në kushtet tona, për t'iu shmangur goditjeve ajrore të armikut dhc për të zënë me shpejtësi rajonet e mbrojtjes.

Edhe drejtimi i trupave dhe kompaktësimi i tyre nxori në dukje mjaft të meta. Puna politike gjatë stërvitjes nuk ishte dinamike, e gjallë, elastike dhe e konkretizuar me problemet reale që nxirrte stërvitja në fazat e saj të ndryshme e të tjera.

Këto të meta, që nuk duhej të vërtctoheshin, e kanë burimin te përgatitjet jo të mjaftueshme luftarake e politike të efektivit, që kryhen gjatë vitit. Programi dhe metodika e kësaj përgatitjeje, siç duket, nuk ndërtohen drejt që të kombinojnë mirë stërvitjen taktike e të zjarrit me marshimet relativisht të gjata, me ngarkesë dhe me temp të lartë, por kufizohen kryesisht në përpunimin e dokumenteve të luftimit dhe të mësimit të armatimit e të teknikës në poligon. Këto dobësi reflektohen pastaj në stërvitjet komplekse me trupa, në të cilat disa herë bëhen më shumë përpjekje për t'u paraqitur mirë nga ana formale, duke u vënë më shumë rëndësi letrave, varianteve e situatave në harta, dokumenteve e planeve, sesa anës thelbësore të stërvitjes.

Ndodh që kuadrot gjatë stërvitjes nuk shohin perspektivën dhe nuk parashikojnë për t'u dalë problemeve përpara, por mundohen t'u qëndrojnë besnikë atyre që kanë parashikuar qysh më parë në letra. Ata

nuk luftojnë për të përpunuar dhe për të adaptuar dokumentacionin, planet dhe parashikimet e tyre sipas situatave që krijohen, sipas problemeve që nxjerrin jeta, efektivi, trupa, terreni etj., dhe pastaj mbi këtë bazë t'i korrigjojnë, t'i plotësojnë dhe t'i pasurojnë me përvojë të re, por përpinqen më shumë që jetën, trupën dhe dinamikën e stërvitjes t'i futin e t'i inkluadrojnë në imajjinatat, në parashikimet dhe në planet e tyre skematake, të përgatitura qysh më parë në zyrë. Një metodë punë e tillë sjell çoroditje, konflikte e mospërputhje. Kjo është metoda Partisë, në shërbimin e prapavijës etj. Me një punë rutinë si kjo njerëzit nuk mund të merren me përpunimin dhe me zgjidhjen e problemeve kyç të rëndësishme e reale, por me çështje anësore e të dorës së dytë, që nuk lejojnë të mbahet situata në dorë e të drejtohet me energji.

Këtu nuk është puna që të prishen rrënjesisht planet, variantet dhe metodikat e stërvitjes, as nuk shtrohet problemi që komandat, organet e Partisë, kuadrot dhe efektivi të venë në stërvitje pa u parapërgatitur, pa parashikime dhe pa organizim, por të kuptohet mirë se stërvitjet me trupa, në të cilat marrin pjesë me dhjetëra mijë njerëz, nuk durojnë skema e plane shabllone. Stërvitja me trupa nxjerr probleme të shumta e të ndërlikuara, që duhen trajtuar, duhen përvetësuar dhe duhen zgjidhur menjëherë jo mekanikisht, po me punë këmbëngulëse, në bashkëpunim e në koordinim me të gjitha armët e me shërbimet, jo duke u têrhequr nga prirjet e individualizmit e të egoizmit, as duke e lënë

punën e përbashkët në dorën e tjetrit. Këto nuk janë dobësi vetëm të punës e të përgatitjes ushtarake, por, në radhë të parë, të përgatitjes politike të të gjithë kësaj mase të madhe njerëzish.

E njëjta gjë duhet thënë edhe për organizimin e bashkëveprimit, të bashkëpunimit dhe të koordinimit në mes armëve dhe shërbimeve, që është problem, i cili nuk zgjidhet drejt, qoftë gjatë stërvitjeve komplekse me trupa, qoftë gjatë punës së përditshme. Në këtë çështje tërheqin vëmendjen shikimi, gjykimi dhe zgjdhja e problemeve në prizmin e ngushtë sektorial, në mënyrë të veçuar dhe të palidhur me sektorët e tjera. Në ushtri ka shokë që nuk i preokupon kjo gjë dhe përpiken të kryejnë vetëm detyrën e tyre të ngushtë, pa e lidhur e pa e bashkërenduar atë me të tjera. Shokët që vuajnë nga këto dobësi, që nuk e kuptojnë rëndësinë e madhe të bashkëpunimit dhe të bashkëveprimit në ushtri e në luftë, që nuk shqetësohen dhe nuk reagojnë për një problem kaq parimor, por i lënë armët dhe shërbimet e tyre të punojnë e të veprojnë brenda sektorit të ngushtë të armës dhe jo të lidhur fort e në interes të armëve dhe të shërbimeve të tjera, thyejnë një princip të rëndësishëm të luftës, dobësojnë përgatitjen e popullit dhe të vendit për mbrojtje. Prandaj, kur bëhen analiza për këto çështje, organizatat e Partisë e shtabet të thellohen për ta parë çështjen jo vetëm nga ana tekniko-ushtarake, por për të gjetur edhe arsyet që i shtyjnë këta njerëz me aftesi e me njohuri ushtarake të mos ngrihen në nivelin që u kërkon detyra, të nxirren dobësitë e tyre dhe të përcaktohen masat e puna politike që duhen bërë me këtë ose atë shok dhe

të mos vazhdohet të bëhet me ta një punë politike që ishte e vendosur, bie fjala, gjashtë muaj më parë.

Gjatë stërvitjeve me trupa, krahas punës së parashikuar dhe të vendosur që më parë, duhet domosdo të bëhet një punë e dendur politike për të drejtuar e për të zgjidhur problemet konkrete që nxjerr situata. Është shumë e rëndësishme të kuptohet mirë se puna politike, e ndërtuar sipas situatës konkrete, nuk e errëson aspak punën e ndërtuar shumë kohë më parë, përkundrazi, ajo është zërthim, konkretizim dhe vazhdim i së parës në kushtet e reja, që vazhdimi shkaktohen në luftë. Stërvitjet e zhvilluara kanë treguar se kjo lloj pune e zhdërvjellët akoma nuk ka hyrë në mendjen dhe në zemrën e njerëzve.

Me gjithë sukseset e pamohueshme, është fakt se ushtria i ka akoma problem stërvitjen dhe përgatitjen taktike të efektivit të saj. Ka akoma probleme të shumta e të rëndësishme që duhet të zgjidhen me një metodë dhe praktikë pune më të shkathët e më të organizuar. Metoda dhe praktika e punës duhet të jenë të tilla që të sigurojnë një mobilizim të vazhdueshëm të efektivit, një lidhje organike e reciproke të mësimit dhe të lëndëve ushtarake, një drejtim e ndihmë konkrete nga ana e Partisë, komandave e shtabeve, në përshtatje të plotë me kushtet reale të terrenit, sipas kërkjesave të luftës. Përvoja e nxjerrë nga stërvitjet dyanëshe, me batalion, stërvitjet taktike me qitjet luftarake me kompani, kalimet nga një lloj luftimi në tjetrin e të tjera, që ndihmojnë në zbatimin e Tezave të Këshillit të Mbrojtjes dhe në përvetësimin e parimeve të luftës popullore, duhet të jenë objekt studimi e zhvillimi të mëtejshëm

për Partinë në ushtri, për komandat dhe për shtabet.

Lëshimet dhe mungesa e këmbënguljes për t'i bërë stërvitjet në terren në kushte të vështira dhe për ta kthyer fushën e stërvitjes të ngjashme si një fushë lufte, mungesa e një bashkëveprimi të plotë të armëve dhe të shërbimeve, moskuptimi dhe mosvlerësimi i stërvitjes taktyke si kombinim konkret i përgatitjes luftarake etj. janë dobësi që rrjedhin nga një kuptim i ngshtë i përbajtjes politike të parimeve të artit tonë ushtarak, janë dobësi të punës ideopolitike, e cila duhet të sqarojë e të udhëheqë kuadrot dhe ushtarët për një punë këmbëngulëse drejt objektivash të qartë.

Në qitjet me armët e artilerisë dhe të këmbësorisë janë arritur rezultate të mira. Për përgatitjen e efektivit për këtë lloj stërvitjeje ushtarët dhe oficerët, vullnetarët dhe studentët e kuptojnë drejt çështjen dhe, të edukuar e të udhëhequr nga Partia në ushtri e në terren kanë punuar me ndërgjegje dhe me ndjenjë të lartë përgjegjësie, duke arritur të plotësojnë detyrën me ato mundësi të kufizuara, duke qitur në mënyrë të shkëlqyer. Në të ardhmen do të kemi edhe më tepër mundësi, por edhe me kaq sa kemi sot, ushtria duhet të punojë që të qitë gjithnjë e më mirë, sepse qitjet kanë një kuptim të madh politik, në luftë nëpërmjet qitjes asgjësohen armiqtë, që kërkojnë të skllavërojnë popullin. Prandaj qitja të mos konsiderohet si qëllim në vetvete, si problem me karakter thjesht teknik që praktikohet sa për të zënë një vend nderi në poligon. Lufta kërkon qitës të mirë, të përgatitur e të shkathët, të cilët të arrijnë ta asgjësojnë armikun me qitjen e parë. Në të njëjtën kohë, lufta kërkon që ushtari, qitësi

ynë, të shohë më larg e më gjerë se gryka e pushkës që mban, ta lidhë qitjen me situatën, me formacionin dhe me detyrën luftarake, me armët dhe me gjithë teknikën tjetër, me armikun që ka përballë etj. Pra duhet patjetër përpikëri në qitjet, por duhet dhe bashkërenditje e lidhje me format e luftimit, me taktikën e sulmit, me mbrojtjen, me tërheqjen, me luftimin në rrëthim etj.

Teknika dhe armatimi janë pa diskutim mjetet kryesore që do të asgjësojnë kundërshtarin në fushën e luftës, prandaj ata duhet të njihen, të mësohen që të përdoren në mënyrë të përsosur, por duhet pasur para-sysh se nuk janë vetëm këta gjithçka që duhet të dijë ushtari. Ky duhet të dijë mirë dhe të kuptojë si duhet qitjen në lëvizje, që ta zbatojë atë në momentet e du-hura, sipas situatës, pozicionit dhe formacionit të luftimit, sipas shfaqjes dhe veprimit të armikut, sipas vepri-meve e detyrave luftarake që do të zgjidhë nënreparti i tij dhe në bashkërendim me armët e tjera.

Të gjitha këto kërkesa kanë lidhje edhe me përgatitjen e oficerëve të ardhshëm në shkollat ushtarake. Disa kursantë nuk përvetësojnë mirë lëndët që zhvillohen me ta, sidomos teorinë dhe përdorimin praktik të armëve, përdorimin e instrumenteve për shënjim, përgatitjen e armëve dhe të munitioneve për qitje, pran-daj ata i bëjnë me vështirësi argumentimet për qitje. Me këto mungesa oficeri e ka vështirë ta përgatitë mirë ushtarin, t'i japë atij njohuri e shprehi të plota, ta edukojë e ta bëjë të ndërgjegjshëm për detyrën, t'i forcojë besimin tek arma e ta bëjë mjeshtër të saj. Për ta kryer mirë këtë detyrë, ushtarit nuk i njaftojnë vetëm shprehitë që do t'i formohen nga komandanti në procesin e

përgatitjes luftarake, por, në radhë të parë, atij duhet t'i krijohen mendime të qarta, t'i nxiten intelekti, interes, vëtëveprimi e iniciativa, t'i zgjerohen horizontet dhe të përfytyrojë mirë fushën e luftës, kompleksitetin e saj. Pastaj ai do të jetë në gjendje të përcaktojë vendin dhe rolin e tij në këtë kuadër.

Këto çështje, dhe të tjera si këto, që janë sa të nevojshme aq edhe delikate, duhet t'i zgjidhë puna edukative ideopolitike e kulturore, e cila në ushtri, e sidomos në hallkën batalion-kompani, togë e skuadër. duhet të zhvillohet me shumë kujdes.

Zhvillimin dhe trajtimin politikisht drejt të këtyre çështjeve unë e lidh me gjendjen dhe me nivelin e komisarëve të batalioneve dhe të kompanive. Është mirë që ata të kompletohen, të aftësohen dhe të forcohen akoma më shumë. Të punohet që në kompani e në batalion të kemi komisarë të aftë, sepse ata janë kuadri që komunikon drejtpërdrejt e vazhdimisht me ushtarë. Sqarimi politik, bindja e ndërgjegjshme dhe uniteti i mendimit të ushtarëve dhe të oficerëve në nënreparte, sjellin unitetin e veprimit në stërvitje dhe në fushën e luftës, prandaj forcimi i punës së komisarëve të batalioneve dhe të kompanive ka rëndësi tepër të madhe.

Të njëjtin kujdes duhet t'u kushtojmë edhe përgatitjes e aftësimit të kuadrit komendant e komisar të forcave vullnetare të vetëmbrojtjes popullore, të kësaj force të madhe të Ushtrisë sonë Popullore. Dobüsitetë dhe lëshimet në këtë punë, pakujdesitë që tregojnë repartet ushtarake, komandat e këtyre forcave dhe komitetet e Partisë të rretheve për kuadrin e këtyre forcave, flasin për atë se puna e Partisë për edukimin e tyre politiko-

-ideologjik nuk është akoma në lartësinë e duhur. Ata janë vullnetarë, por kanë detyra të caktuara në strukturat e Ushtrisë sonë të madhe Popullore dhe në kohë luftë do të luajnë një rol të madh, prandaj koha gjatë stërvitjes së tyre nuk duhet të kalojë kot, pa u dhënë atyre atë çka është e nevojshme. Mësimi, qoftë ushtarët osce politik, me forcat vullnetare duhet të organizohet mirë, të zhvillohet i rregullt dhe në nivelin e detyrave, duke e bashkërenduar mirë e vazhdimisht me stërvitjen dhe me detyrat që kryejnë repartet ushtarake. Partia në ushtri dhe në terren duhet të luftojë me forcë të madhe pikëpamjet dhe shfaqjet e nënvlefësimit ndaj këtyre forcave. Edhe programet e përgatitjes së tyre ushtarake dhe politike të rishikohen dhe të përsosen vazhdimisht. Natyrisht, mësimet e tyre nuk duhet të jenë të njëllojta me ato që bën ushtria, atyre të mos u vihen detyra që nuk u përkasin, por për ato që duhet dhe mund t'i kryejnë, të mos kursohen.

Përveç punës me komisarët në kompani e batalion, ku është efektivi, ku konkretizohen dhe materializohen stërvitja ushtarake dhe edukimi ideopolitik, Drejtoria Politike dhe komitetet e Partisë të njësive duhet të punojnë me më shumë kujdes dhe vazhdimisht që atje të kemi edhe komunistë të mirë dhe organizata të forta partice.

Masat favorizuese që propozohen të merren për kuadrin oficer, që shërben larg familjes, siç janë dhënia e lejeve, sigurimi i tyre me banim dhe me transport për të lëvizur në pikat e hapjes, janë çështje që duhet të shikohen me kujdes, por në asnjë mënyrë të mos bëhen shtesa në paga osce në shpërblime materiale.

Këto ishin disa mendime dhe vërejtje që kisha, përkëtë problem kaq të rëndësishëm për interesat e lartë të atdheut, të Partisë dhe të popullit.

*Botuar për herë të parë, me
ndonjë shkurtim, në librin:
Enver Hoxha, «Për Ushtri-
në Popullore (Përmbledhje
veprash)», vëll. I, Tiranë
1983, f. 577*

*Botohet i plotë sipas tekstit
të nxjerrë nga procesverbali
i mbledhjes së Sekretariatit
të KQ të PPSH, që gjendet
në AQP*

DEMOKRACINË TA ZHVILLOJMË KURDOHERË NË INTERES TË FORCIMIT TË PARTISE

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

19 janar 1973

Jam dakord me materialin e paraqitur për demokratizimin e mëtejshëm të procedurës së zgjedhjeve në Parti, si dhe me mendimet e shprehura nga shokët rreth këtij problemi.

Të mbështetur në vijën e Partisë, nc do të thellojmë akoma më shumë procesin e demokratizimit të zgjedhjeve në Parti. Këtë duhet ta bëjmë doemos, se tani nuk jemi më si në periudhën e ilegalitetit, kur, për shkak të rrethanave që dihen, ishim të detyruar të përdornim forma të kufizuara zgjedhjesh, për arsy se me gjithë dëshirën, demokratizimi i plotë i zgjedhjeve ishte vështirë të realizohej. Tani është tjetër kohë, megjithatë, duke u bazuar kurdoherë në Statutin e Partisë, demokracinë në Parti ta zhvillojmë kurdoherë në interes të forcimit të vazhdueshëm të saj.

1. Në këtë mbledhje u diskutua mbi përsosjen dhe demokratizimin e mëtejshëm të procedurës së zgjedhjeve në Parti.

Jam i një mendimi me shokët Hysni [Kapo] dhe Ramiz [Alia], të cilët parashtruan drejt arsyet përse komitetet e Partisë duhet, nga ana e tyre, t'i bëjnë medemos parashikimet për kandidaturat e plenumeve të Partisë të rretheve. Përveç arsyeve që përmendën ata, unë dëshiroj të shtoj edhe një arsyet tjeter: kandidaturat duhet t'i parashikojë komiteti i Partisë për të pasur mundësi që të ruhen proporcionet e kandidatëve në të gjitha drejtimet, si për sa u përket klasës, shtresës, seksit, moshës, zonave dhe një sërë kërkesash të tjera, që vëlëm komiteti i Partisë është në gjendje t'i zgjidhë drejt. sepse ka eksperience të madhe dhe një vështrim më të gjerë të problemit në shkallë rrethi. Në rast se komiteti i Partisë nuk do të merrej me këtë punë, atëherë do të na vërtetoheshin shpërpjesëtime në kandidaturat, do të krijohej një terren i përshtatshëm për subjektivizëm. Kështu do të vihej re që «kërraba» e scilit në propozimet do të tërhoqte nga zona ose reparti i tij etj. Rreziku i njëanshmërisë në propozimin e kandidaturave nga ana e komitetit të Partisë është më i paktë, për arsy se ai ka mundësi t'i shikojë këto çështje nga shumë anë, megjithëse nuk përjashtohet që, edhe nga ana e tij, të ketë ndonjë shfaqje subjektivizmi. Sidoqoftë kjo nuk e bën aspak të panevojshme ndihmën e tij, ndryshtë në mbledhjen e përfaqësisë do të përplashten shumë kandidatura.

Delegatët e një zone, të një ndërmarrjeje të madhe, apo të një kooperative të bashkuar bujqësore, vërtet njohin shumë mirë shokët e zonës së tyre me të cilët punojnë e jetojnë, por ata nuk mund të njohin sa duhet kandidatët e zonave të tjera. Ata mund të jepin kara-

kteristikën e drejtë të një ose dy kandidatëve të tyre, po nuk mund të dinë kërkesat dhe përpjesëtimet që duhen ruajtur në përbërjen e organeve udhëheqëse të Partisë për të gjithë rrethin, sepse nuk i njohin. Ka mundësi që delegatët e një zone të propozojnë më tepër kandidatë sësia duhen nga zona e tyre, sepse këta njohin më tepër. Ata mund të propozojnë kandidatë edhe nga zona të tjera, po është e natyrshme që për këta shkalla e njohjes nuk do të jetë e sigurt, prandaj në këtë rast nuk mund të evitohet subjektivizmi. Çfarë propozimesh mund të bëheshin nga zonat e tjera? Për ata anëtarë të komitetit të Partisë, të cilët komunistët i kanë njohur konkretisht në punë dhe në drejtim, kur u kanë vajtur në organizatat-bazë, anëtarët e Partisë janë në gjendje të gjykojnë dhe t'u bëjnë vlerësimin edhe pse s'janë të një zone, prandaj mund të propozojnë që ky ose ai shok të jetë përsëri në listën e kandidatëve për plenumin e ri që do të zgjedhë konferenca.

Kandidaturat që përgatit komiteti i Partisë, ia paraqet mbledhjes së përfaqësisë të konferencës. Në mbledhjen e përfaqësisë do të marrin pjesë jo vetëm ata delegatë që janë zgjedhur në përfaqësi, por edhe ata shokë të komitetit të Partisë që kanë punuar për të përpiluar listën e kandidaturave, duke pasur me vte gjithë dokumentacionin përkatës, me qëllim që të jenë në gjendje të japid shpjegime, si për propozimet që ka menduar komiteti i Partisë, ashtu dhe për propozimet e tjera që mund të bëhen nga delegatët në përfaqësi. Lista e kandidaturave për plenumin e ri që do t'i paraqitet përfaqësisë, do të shqyrtohet e aprovohet në konferencën e Partisë të rrethit. Lista që paraqitet

është projekt. Konferenca, si organi më i lartë i Partisë në rreth, është kompetente të aprovojë plenumin e ri.

Jam i mendimit që, për sa i përket numrit të kandidatëve të propozuar, t'i përbahemi rregullit që kemi, domethënë të mos propozohen më shumë nga sa është numri që vendoset të jetë forumi i zgjedhur i Partisë. Procedura që kemi caktuar është plotësisht demokratike. Në bazë të kësaj procedure ne i shoshitim mirë kuadrot e Partisë që mendohet të dalin në udhëheqje, i krahasojmë dhe caktojmë të vihen në listë për t'ia paraqitur konferencës më të mirët midis tyre. Çështja këtu është që, duke u bazuar në këtë procedurë zgjedhjesh, Partia të dalë në unitet, problem ky që nuk është një çështje formale. Në qoftë se ne vetëm për formalizëm lejojmë që numri i kandidatëve t'i paraqitet konferencës më shumë ose sa dyfishi i atij që caktohet, votat në këtë rast do të na ndaheshin. Ndonjëri mund të thotë se kjo procedurë nuk është thellësisht demokratike, por një gjykim i tillë nuk është i drejtë, sepse askujt nuk i ndalohet në konferencë të flasë, përkundrazi delegatët nxiten të bëjnë vërejtje, kritika etj. me qëllim që kandidatët e propozuar të shoshiten mirë, që atyre t'u kërkohet llogari, cilido mund të ngrihet për të diskutuar rreth tyre, mund të thuhet për shembull që ky ose ai shok duhet të hiqet nga lista, se nuk ka këto apo ato cilësi që është e domosdoshme t'i ketë udhëheqësi i Partisë në rreth dhe në vendin e tij të vihet në listë një tjetër që është më i mirë, më i zoti etj.

Këtë të drejtë të gjithë delegatëve të konferencës ua jep Statuti i Partisë, prandaj ata duhet ta praktikojn-

në sa më gjerë. Pastaj, përfaqësia, për të zëvendësuar kandidaturat që eventualisht mund të bien, parashikon në listë shokë të tjerë pér t'i pasur rezervë. Për këto arsyе mendoj se nuk është e domosdoshme të vihen në listë më shumë kandidatë nga sa duhen.

Tani po bëjmë mbledhjet pér dhënie llogari e zgjedhje në Parti. Gjatë kësaj fushate me rëndësi të madhe komunistët bëjnë analizën e punës, kritikojnë të metat dhe dobësitë e vërtetuara të secilit, u tërheqin vëmendjen shokëve drejtues që s'kanë treguar kujdesin e duhur në realizimin e detyrave, vënë në dukje veprimtarinë e punën e shokëve që kanë punuar më mirë etj., etj. Me këtë rast çdo organizatë-bazë partie ka plotësisht të drejtë t'i porositë delegatët që do të zgjedhë pér në konferencën e Partisë të çojnë mendimet dhe vërejtjet e saj pér këtë ose atë shok të organizatës së vet, që njëkohësisht mund të ketë qenë anëtar i komitetit të Partisë të rrëthit etj. Kur ky anëtar partie i kësaj organizate që ka qenë edhe anëtar i komitetit të Partisë të rrëthit gjatë analizës del se nuk e ka kryer si duhet detyrën, dhe sipas pikëpamjes së ndonjërit del se kandidatura e tij nuk është e përshtatshme, mund të dalë me këtë rast një tjetër dhe të shprehë të kundërtën. Komunisti që nuk është dakord me vërejtjet e shokut të tij të mëparshëm pér punën e anëtarit të organizatës që kritikohet, i cili është njëkohësisht anëtar i komitetit të Partisë të rrëthit, e kundërshton kritikuesin dhe këtë e argumenton. Fillon kështu në organizatë një debat me të vërtetë parimor rrëth vërejtjeve që bëhen dhe së fundi ajo arrin në përfundim si pér punën e shokëve që ishin zgjedhur në forumin e mëparshëm, ashtu dhe

për të tjerët që mund të zgjidhen në konferencën e Partisë të rrethit, që janë shumë të mirë, të aftë, besnikë të Partisë dhe të ndershëm. Organizata-bazë e Partisë është në gjendje ta bëjë shumë mirë dhe drejt këtë punë.

Kur kërkohet llogari në mbledhje, do të thotë që atje të bëhet kritikë dhe autokritikë e punës dhe e njerezve, duke përfshirë edhe ata që drejtojnë organizatën-bazë, vlerësohet në të njëjtën kohë edhe puna e shokëve të udhëheqjes së Partisë në rreth. Organizata-bazë ka të drejtë të japë mendim dhe të vlerësojë si e kanë bërë punën drejtuesit e rrethit kur kanë shkuar në mbledhjet e saj, të gjykojë qëndrimet, aftësitë e partishmërinë e tyre, të kritikojë ata që prej një kohe të gjatë nuk kanë shkuar ndonjëherë për ta ndihmuar e kontrolluar etj. Të gjitha këto delegatët e organizatës i mbajnë shënim dhe, kur venë në konferencë, mund t'iа thonë vërejtjet që ka bërë për ta organizata e tyre në rast se do të jetë e nevojshme.

E gjithë metoda e punës së Partisë është e tillë që në shqyrtimin e problemeve ajo ruan format dhe i vë kujdes sidomos përbajtjes demokratike të veprimtarisë për të shoshtur mirë problemet, duke përfshirë edhe personalitetin e shokëve që do të zgjidhen. Kjo do të thotë se ka garanci të plotë për të mos zgjedhur ata komunistë që nuk i kanë cilësitet dhe të zgjidhen shokët që meritojnë me të vërtetë. Kjo arrihet kur zbatohen drejt parimet dhe normat organizative të Partisë. Delegatët që kanë me vete porosi të qarta nga ana e organizatës, në bazë të mandatit që u është dhënë, kanë të drejtë të vendosin vetë në konferencën e rrethit, pa

qenë nevoja t'i kthejnë kandidaturat për t'i parë edhe një herë në organizatën-bazë. Duke vepruar në këtë mënyrë dhe duke u parë çështjet me kujdes në të gjitha këto hallka, Partia është e sigurt se në krye të saj do të zgjidhen njerëzit më të mirë.

Botuar për herë të parë në librin: Enver Hoxha, «Për Partinë (Përmbledhje vepresh)», vëll. 3, f. 89

*Botohet sipas librit:
Enver Hoxha, «Për Partinë (Përmbledhje vepresh)»,
vëll. 3, f. 89*

BUJQESIA ÇOHET PËRPARA ME NJEREZ TË KUALIFIKUAR

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

19 janar 1973

Edhe unë kam disa probleme për të ngritur. Ne këtu duam të na thuhen gjëra konkrete, se numërim të problemeve kemi dëgjuar shumë herë. Mund të na thoni, për shembull, nëse në shkollat e mesme apo të larta bujqësore kemi degë të posaçme për ujitjen, për qarkullimin bujqësor, për përmirësimin e tokave etj., që janë probleme kapitale për bujqësinë? Si paraqitemi në këtë drejtim? Këtu u tha se në disa rrethe shkollat e ulëta një dhe dyvjeçare, të cilat janë të vlefshme për përgatitjen e punëtorëve të kualifikuar dhe të mjeshturve të prodhimit, kanë filluar të mbyllen. Po pse kanë filluar të mbyllen? Në bazë të cilave kritere u hapën këto shkolla? Çfarë mësohet në to? Duhet të mendojmë pak më thellë për çdo problem. A e dini ju,

1. Në këtë mbledhje u diskutua edhe për punën e organizatave të Partisë për edukimin masiv agrozooteknik të kooperativistëve.

shokë të Ministrisë së Bujqësisë, pse nuk funksionojnë më këto shkolla, përse numri i tyre nga 200 ka arritur në 80? Ato u mbyllën se u ngritën në mënyrë spontane, se brendia e tyre nuk u përshtatej kërkesave të kohës. Mësimet që zhvilloheshin në to ishin për disa çështje praktike, të lehta, pa kritere shkencore, për të cilat jeta ka treguar se mund të merreshin edhe në brigadë. Punojnësit e panë që atje humbitnin kohën pa shumë dobi, prandaj e braktisën shkollën.

Kjo çështje nuk mund të vazhdojë kështu si është vepruar deri tani se është kohë e humbur dhe «koha është flori». T'i kesh apo të mos i kesh për tre vjet tokat të sistemuara, është një problem i madhi ekonomik përvendin tonë. Por, që të bëhet kjo, duhen njerëz të kualifikuar, të përgatitur. Në një kooperativë bujqësore, për shembull, duhen posë veta që të marrin vesh mirë si bëhen qarkullimi bujqësor, ujitja, përmirësimi i tokave etj. Ndaj edhe pycta nëse ka shkolla apo kurse përtë përgatitur specialistë të tillë? Por, siç thatë ju, me gjithëse üshtë problem i madh, ju s'keni shkolla apo kurse përkëto. Unë mendoj se duhet të ketë një shkollë apo kurs ku të venë kooperativistë nga gjithë Shqipëria, ku gjatë 8 muajve, ta zëmë, pjesëmarrësit të mësojnë si duhet të fillojnë ose të vazhdojnë përmirësimin e tokave mbi baza shkencore, agroteknike etj. Pra, në qoftë se sistemimi i tokave konsiderohet nga ministria si një nga problemet kyç të bujqësisë, atëherë si përgatitjen kuadrot përtë ta vënë në jetë këtë?

Në programet e Institutit të Lartë Bujqësor kjo çështje sigurisht që përfshihet, se është pjesë përbërëse e shkencës agroteknike. Por këta që do të mësojnë për

të realizuar sistemimin e tokave, duhet të jenë një ekip shumë i madh, ndoshta prej disa mijë vëtash. Atëherë vihet pyetja: Ku përgatiten këta? Mund të pritni ju sa të dalin pesë veta, të cilët do të kenë diplomë nga instituti? Edhe këta nuk janë të specializuar veçanërisht për këtë çështje; mirëpo këto punë duan specialistë të veçantë. Nuk mendoni ju për këtë problem?

Në qoftë se nuk e organizoni mirë, seriozisht dhe sistematikisht këtë punë, së bashku me studimin e hartave pedologjike dhe kimike, nuk mund të nxjerrim gjë në dritë. Ju, shokë, mos kërkon që gjithë kooperativistët e Shqipërisë të na dalin me yll në ballë dhe të na bëhen specialistë të hartave pedologjike e kimike. Ne dëshirojmë të përgatitim në çdo kooperativë bujqësore, ta zëmë nga 15 veta, jo më shumë. Në qoftë se këta do të jenë të rinj me arsim të mesëm dhe përgatiten si teknikë të kualifikuar vetëm për studimin e tokave, pedologjisë dhe kimisë, atëherë do të ndihmojnë për ta çuar përpala bujqësinë. Në të kundërtën, po u mjaf-tuam vetëm me krijimin e këtyre shkollave, kështu si thoni ju, mendoj se nuk mund t'i arrijmë qëllimit. Këta pesë ose dhjetë veta që përmenda unë (mund të jenë edhe më shumë ose më pak) duhet t'i kemi të specializuar që secili prej tyre, në një brigadë, mund të marrë nën kujdestari 10 kooperativistë, me të cilët të zbatojë praktikisht atë teori që ka mësuar. Të mos kënaqemi me një punë të sipërsaqshme.

Ata njerëz që thashë, të jenë të përgatitur, se vetëm kështu do të mund të ngrenë masën e kooperativistëve në nivelin që kërkohet, ndryshe puna që bëhet, nuk do të jetë efikase.

Mua më duket se nuk është rentabël që vetëm një pjesë e vogël e kooperativistëve të dinë të ujtin. Në rast se hapim një kurs ose një shkollë njëvjeçare apo tetëmuajore, atje vërtet mund të përgatitim vetëm tre, katër, pesë, shtatë ose dhjetë kooperativistë prej një kooperative, po ata do t'ua mësojnë artin e ujitjes edhe shokëve të tyre kooperativistë. Por, që të jenë në gjendje për ta bërë këtë punë, në radhë të parë, ata vetë duhet të dinë të ujtin mirë. Për ujitjen kemi folur shpesh c me gjithëkëtë kjo nuk bëhet si duhet dhe po na kalbet prodhimi.

Kemi bërë mirë që i kemi vënë rëndësi detyrës së brigadierit, por ai s'mund të jetë i gjithanshëm. Komandanti pa ushtarë, s'ka si të mbetet komandant. Në brigadë brigadieri duhet të ketë edhe specialistët e ujitjes, të sistemimit të tokave, të përdorimit të plehrave dhe të njohjes së hartave pedologjike e kimike. Ne nuk kemi menduar dhe nuk mendojmë seriozisht që brigadieri të ketë «krahë» për të drejtuar, por gjithçka e kërkojmë prej tij. Aktualisht ai ndan vetëm punën, komandon pjesëtarët e brigadës dhe, pastaj, gjithsecili vepron sipas mënyrës së tij osc sipas traditës, të cilën akoma nuk e di mirë kooperativisti i ri. Tradita e ujitjes mund t'i kërkohet plakut dibran se ai e di, por i riu nuk e njeh, prandaj atij duhet t'i mësohet.

Bujqësia është një kompleksitet i madh dhe në këtë drejtim, më duket mua, Ministria e Bujqësisë, duhet të mendojë më mirë se si dhe me kë do t'i zgjidhë këto probleme. Mendoj se ministria duhet t'i zgjidhë këto probleme me rrethet, që edhe ato ta kuptojnë mirë këtë nevojë të domosdoshme. Besoj se shokët e rrëtheve

i kuptojnë këto gjëra, ndryshe puna nuk ka si ecën. Edhe ata luftojnë në këtë drejtim por, në rast se Ministria e Bujqësisë nuk mendon thollë për këto probleme kyç dhe për një kohë të gjatë merret me gjëra të vogla, që s'janë për ministrinë, po për rrëthet dhe për kooperativat, atëherë punët do të çalojnë. Për ç'arsye ju i pyesni tërë ditën në telefon rrëthet nëse mbollën apo jo, e morën apo jo këtë ose atë mjet, u erdhi apo jo ky traktor etj., etj.? Në qoftë se merreni me këto vogëlima, nuk do t'ju dalë kohë të merreni me problemet e mëdha. Konkretilisht përse bëjmë fjalë vetëm teorikisht për sistemimin e tokave? Çdo ditë ju po i thoni këto gjëra, por, që të sistemohen tokat, duhet të merren masa organizative të rëndësishme. Kush do t'i marrë këto masa, shokë? Ministria duhet të bëjë planin e mësimeve se çfarë shtabesh duhen krijuar. Ç'fonde duhen, ç'mekanizma duhen, ku do t'i gjejmë dhe për sa kohë.

Ne, shokë, duhet të ecim përpara dhe ta dimë. për shembull, se kur do t'i realizojmë këto, për pesë ose për dhjetë vjet etj. E keni këtë plan ju, apo nuk e keni? Në qoftë se nuk e keni, del pyetja kush do të na e bëjë këtë plan, mos vallë shokët e rrëtheve? Jo, këta do të na ndihmojnë në qoftë se ne e kemi një plan të tillë. Ata duhet t'i sqaroni për ndihmën që do t'u japë ministria dhe t'i mësoni se si ta organizojnë punën. Ata duhet të dinë se do të sistemohen ato toka që janë për t'u sistemuar, pastaj Partia do t'u kërkojë llogari atyre. Por ju, shokë nuk e keni bërë këtë punë. Si këto ka disa probleme të rëndësishme kyç në bujqësi. Prandaj nga ju kërkohet një punë e menduar mirë dhe e themeluar. Kur filluam bonifikimet, nuk vepruam në erë,

megjithëse atëherë nuk ishim të organizuar dhe nuk kishim këtë përvojë të gjatë që kemi sot. Në qoftë se puna me to na ka vazhduar 20 vjet, punët për mirëmbajtje duhet t'i mbarojmë në një kohë më të shkurtër, sepse atëherë numëroheshin me gisht agronomët, koooperativistët nuk i kishim në këtë nivel kaq të lartë, nuk kishim harta pedologjike, nuk njihnim tokat dhe rrjedhjen e ujërave, s'kishim mekanizma etj. Kurse tashti të gjitha këto mungesa të dikurshme i kemi plotësuar.

Mund të ecim kështu more shokë kur, siç lhonë spezialistët, me sistemimin e tokave do të thotë të kemi 10 kuinalë drithëra më tepër për hektar? Kështu do të vazhdojmë ne, që, për të bërë kanalizime nëpër tokat e grurit, të punojnë me dhjetëra mijë kooperativistë? Duhet të harxhojmë ne me mijëra hektarë në këtë mënyrë siç po bëjmë apo ta kursejmë tokën? Jo, nuk duhet të vazhdojmë kështu. Po çfarë të bëjmë? Atë që kanë bërë edhe të tjerët. Mund të më thotë dikush se duhen tuba hekuri për këtë qëllim. Po pse duhen tuba hekuri? Po në mos tuba hekuri, tuba çimentoje do të thotë ai. Po përse tuba çimentoje kur ne mund t'i bëjmë me tuba gresi, siç i kanë bërë kanalizimet romakët e vjetër në kohën e antikitetit? Baltë kemi, atëherë të ngremë furrë dhe të prodhojmë tuba për kullimin e tokave. Kush do t'i mendojë këto çështje dhe kush do t'i bëjë? Këto që them unë nga ju i kam dëgjuar, po ama të mos dëgjojmë ngahera të njëjtat gjëra. Ato që themi një herë, t'i vëmë në zbatim. Në Lushnjë po hapin kanalet mijëra kooperativistë. Po pse të mos ngrenë edhe një furre të madhe dhe të pjekin tubat gres? Kështu kjo punë zgjidhet njëherë e mirë.

Shkollat duhet të hapen sipas nevojave dhe sipas funksioneve për t'i shërbyer ekonomisë e jo pa kriterë thellësisht të studiuara. Nuk është e drejtë të numërojmë sa shkolla u ngritën dhe sa u mbyllën, pa parë mirë përsë u ngritën dhe çfarë kërkojmë prej tyre.

Në bujqësi ne kemi ecur, po sigurisht, kemi dhe gjëra të reja që duhen përvetësuar dhe përhapur.

*Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbal i mbledhjes së Sekretariatit të KQ të PPSH,
që gjendet në AQP*

ZBATIMI I DIREKTIVËS KËRKON KONTROLL
TË FORTË NGA ORGANET E PARTISË
DHE TË SİHTETIT

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

22 janar 1973

Kam një vërejtje. Në raportin e paraqitur nuk ka kritika dhe ato që janë bërë ndaj të metave, janë të tëra të përgjithshme. Këto që thuhen kötu, mund të thuhen edhe në një vend tjetër, prandaj kritikat të jenë të adresuara. Ato mund të plotësohen edhe me diskutime, por përsëri mendoj që diçka duhet thënë. Me këtë nuk e kam fjalën ta ndryshojmë raportin.

Në këtë raport janë ngritur disa probleme me të vërtetë të veçanta, që prekin një mori çështjesh të cilat hapin horizont për shumë gjëra.

Siq thashë, raportin nuk ka pse ta ndryshojni, por do të ishte mirë sikur në hartimin e tij të ishim nisur

1. Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit: «Mbi plotësimin e planit të vitit 1972, detyrat kryesore për vitin 1973 dhe disa probleme për përsosjen e mëtejshme të drejtit të ekonomisë», që do t'i paraqitej Plenumit të 3-të të KQ të PPSH.

nga çështjet që na pengojnë e na zënë këmbët në realizimin e planeve. Unë do të thosha se në këtë drejtim ka dobësi të mëdha në assortimente dhe në cilësi. Këtë çështje ne duhej ta trajtonim për të zbuluar mirë se cilat janë të metat objektive dhe subjektive, në cilët sektorë paraqiten veçanërisht ato, dhe, pastaj, të shtrohej detyra imperative që këto të meta të ndreqen dhe të mos përsëriten më.

Çështja tjetër që është shtjelluar në raport është sigurimi i lëndëve të para dhe i materialeve ndihmëse. Mendoj se këtu mund të futeshin edhe një sërë problemesh të tjera.

Është ngritur disa herë dhe është një plagë e vjetër mosrealizimi i kontrataave dhe dobësitë në transport, prandaj këto meritojnë vëmendje të veçantë në trajtimin e tyre për të gjetur hallkat e dobëta dhe masat që duhen marrë për t'i ndrequr ato. Këto të meta i ka shqyrtuar edhe Qeveria.

Në raport është trajtuar edhe çështja e normave. Por mendoj se para Plenumit nuk është e mjaftueshme të thuhet vetëm që Byroja Politike e ka marrë në studim këtë problem, sepse Plenumi kërkon të dijë edhe çfarë ka vendosur Byroja Politike për të. Kjo në raport thuhet me disa fraza, bille problemi shikohet më tepër nga ana parimore dhe politike, se ç'duhet të bëjë Partia. Mirëpo kjo çështje lypset të dalë qartë dhe të shpjegohet mënyra, metoda si, qysh e tek i ka dhënë orientimet Byroja Politike. Këto duhet t'i dinë shokët e Plenumit që të mund të ecin, sepse të thuhet vetëm që Byroja Politike ka marrë një vendim për çështjen e normave, pa përmendur se çfarë thuhet në këtë vendim,

nuk është e mjaftueshme. Këtu nuk është çështja pse nuk përmenden këto probleme, por mendoj të theksohen, të shtjellohen mië mirë dhe ashtu siç duhet.

Siç diskutova pak edhe në mbledhjen e Sekretariatit të Komitetit Qendror për bujqësinë¹, mendoj se duhet t'i kërkojmë llogari Ministrisë së Bujqësisë, edhe për zbatimin e eksperiencave të mira, edhe për të metat. Në këtë sektor me rëndësi të ekonomisë ka disa probleme për të cilat mendoj se duhet të flasim në këtë raport.

Cilat janë këto?

Së pari, është problemi i sistenimit të tokave të republikës në tërësi, që duhet të ngrihet në një shkallë të atillë organizimi siç u veprua me bonifikimet. Në qoftë se shkojmë nga parimi që po të sistemojmë tokat, domethënë të zgjidhim ujitjen, kullimin etj.. do të na ngrihet prodhimi jo më shumë, por, të themi, 4-5 ose 6 kuintalë për hektar, kemi fituar kështu një betejë të madhe në bujqësi. Por, në qoftë se këlë çështje nuk e ngremë si një aksion me të vërtetë të madh, siç bëmë për bonifikimet, punët nuk do të na shkojnë mirë. Kjo çështje lidhet me një sërë problemesh, deri në kualifikimin e specializuar të traktoristëve sepse mund të arrijmë që t'i sistemojmë tokat, por traktori mund të na e prishë tërë punën përnjëherësh, në qoftë se traktoristi nuk di të çmojë punën e bërë. Këto probleme nuk zgjidhen vetëm me propagandë, por duhet edhe organizim.

Disa vjet më parë ne kemi konstatuar që kanalet e

1. Shih në këtë vëllim, f. 86.

mëdha, primare e sekondare, të bonifikimeve na janë mbushur, prandaj kemi vendosur të jepen një pjesë mjetesh për t'i mirëmbajtur këto kanale. Ky është një problem me rëndësi të madhe. Kanalet janë bërë 20 vjet më parë. Përveç spastrimeve, siç thonë specialistët, në këto kanale mundet dhe duhet të bëhen rektifikime. Por këto nuk mund të bëhen në këmbë, si me thënë: «Shko atje dhe bëje këtë punë shpejt e shpejt!.. Mua më duket se këtë punë duhet ta bëjmë me inxhinierë, me mjetet dhe me shtabe të bujqësisë, duke caktuar edhe afate. Kushtet optimale, sidomos në përmirësimin e këtyre tokave, t'i krijojmë me të vërtetë në mënyrë të organizuar.

Në raport s'bëhet fjalë fare për përvojën, për provat dhe për eksperimentet që janë bërë në bujqësinë tonë, sidomos nga specialistët. Komiteti Qendror mendoi të hedhë si një orientim përvojen e kooperativës së Plasës. Zhvillimin e bujqësisë duhet ta përcaktojmë me etapa, për të ditur se nga duhet të fillojmë tani që të përmirësohet puna e ta kthejmë atë në një bujqësi moderne.

Përvoja e Plasës ka mbetur akoma në karta. Megjithëse nuk jam specialist, ma merr mendja që këto probleme duhet të reflektohen në raport. Ministria e Bujqësisë duhcj ta diskutonte këtë përvojë dhe të arrinte në një konkluzion se çka duhet përgjithësuar e çka jo, sepse më duket se, në përgjithësi, studimi që është bërë në Plasë nuk është për të hedhur poshtë¹.

1. Në përhapjen e përvojës së përparuar të Kooperativës Bujqësore të Plasës, një rol negativ e të rrezikshëm ka luajtur

Për sa i përket sasisë së drithit që u lihet kooperativave për gatimin e bukës dhe për zahire, më duket se direktiva është e drejtë. Gati në shumicën e kooperativave bujqësore, janë ngritur furrat e bukës në të cilat duhet të vendoset një kontroll i rreptë, për sasinë e drithit që kemi caktuar, pra, të zbatohet patjetër ajo që kemi vendosur. Për zbatimin e direktivave të dhëna, duhet kontroll i fortë nga organet e Partisë dhe të shtetit. Ndryshe, edhe sikur të jepej një direktivë tjetër, prapë nuk do të respektohej dhe, pastaj, do të na duhej të procedonim me urdhra, gjë që nuk është e drejtë. Kur jepet një direktivë nga Qeveria, ajo duhet të zbatohet, se s'ka si ecet ndryshe. Këto janë të rëndësishme, prandaj të pasqyrohen në raportin që do t'i paraqitet Plenumin.

Mendoj se plani i grurit, nuk duhet ngatërruar me atë të misrit. Kur gruri realizohet, shlyhen detyrimet dhe mbahet ajo sasi që i takon kooperativës. E keqja është se në rrethe dhe në bazë shkohet me mendimin që, po nuk u realizua gruri, deficiti plotësohet me misër. Në të vërtetë, në të tëra rastet, mosrealizimi i grurit nuk plotësohet me misër. Prandaj, kjo çështje të mos ngatërrohet: gruri është grurë dhe misri është misër. Kooperativa ose rrathi, po të mundë, le të tejkalojë prodhimin e grurit në favorin e vet dhe të shtetit, por detyra tjetër është plotësimi i planit të prodhimit të misrit. Kështu duhet të bëhen illogaritë për grurin

armiku Mehmet Shehu, për të penguar modernizimin e intensifikimin e bujqësisë në vendin tonë. (Shih: Enver Hoxha, «Raporte e fjalime 1982-1983», f. 173-178.)

dhe për misrin, pa u mjaftuar vetëm me plotësimin e njërit. Pse të lejojmë ne një frymë të tillë, që i hap rrugën liberalizmit për vitin e ardhshëm?

Derisa plani në bujqësi nuk po realizohet dhe ne po importojmë drithë, deficiti të mos rëndoje vetëm në një drejtim. Të kemi kujdes që as bagëtinë të mos e lëmë pa ushqime, se kemi shumë nevojë për mish, për qumësht etj. Prandaj, të marrim disa masa të atilla, që, në vend të një sasie të misrit, që ishte planifikuar për ushqimin e bagëtive, të grumbullojmë dhe të përdorim kashtën. Mua më duket se ky vendim duhet marrë, pa qenë nevoja të shtrohet në Plenumin e Komitetit Qendror. Atje të bëhet kritikë që të mos përsëriter më këto raste.

Unë them që këto çështje të bujqësisë duhej të figuronin në raport, se sistemimi i tokave, bonifikimet, organizimi dhe drejtimi i prodhimit në një shkallë më të avancuar janë probleme me rëndësi. Ministrisë së Bujqësisë ia kemi dhënë porositë ngahera në mbledhjet e Qeverisë e të Byrosë Politike; ato ia japim edhe sot, por, në vija të përgjithshme. Ndërsa, për periudha të veçanta, ne duhet t'i theksojmë e t'i përcaktojmë mirë këto gjëra, prandaj të shikojmë se ç'mund të bëjmë në këtë drejtim.

Edhe një vërejtje të vogël kisha për raportin. Në faqen 35 të tij është përdorur termi «riprovim i punëtorëve». Mua më duket se ky term nuk është i përshtatshëm, se do të krijonte te punëtorët shqetësime, duke menduar sikur do të vihen në diskutim të tëra njohuritë që ata kanë fituar. Në fakt, punëtorët nuk do të riprovohen. Në qoftë se marrim disa vendime për

shkallëzime të tjera, për t'i ngritur ose për t'i ulur këto kategori që janë, kjo do të bëhet për ata që kërkojnë të atestohen etj.! Për këtë arsyе termi «riprosim» i të gjithë punëtorëve, më duket nuk është i përshtatshëm.

*Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbal i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH.
që gjendet në AQP*

-
1. Duke filluar që nga data 1 prill 1976, u kalua nga sistemi i kategorizimit të punëtorëve në sistemin e vlerësimit të kualifikimit me anën e atestimit kulturor e profesional.

NË PUNËN PRODHUESE NXËNËSIT E STUDENTËT KALITEN, POR EDHE MËSOJNË NJË PROFESION

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

22 janar 1973

Më duket se jemi të një mendimi përfundimin e kësaj çështjeje. Ne nuk duhet të humbasim kurajën nga vështirësitet që na dalin, sepse jemi akoma në fazat fillestare të vënies në jetë të sistemit të ri arsimor. Është e natyrshme që do të ndeshen pengesa për sigurimin e vendeve të punës etj. Të gjitha këto vështirësi ekzistojnë, por jemi të bindur se do të rregullohen çdo vit e më mirë.

Puna praktike i shërben edukimit të nxënësve e të studentëve, por kjo është e lidhur më drejtpërdrejt me mësimin. Për shembull, studenti që studion në Fakultetin e Matematikës ose të Kimisë, do të shkojë për të bërë punën praktike si ndihmës i mësuesit të mate-

1. Në këtë mbledhje u diskutua edhe rreth raportit për disa probleme që dilnin lidhur me zbatimin e vendimeve të Plenumit të 8-të të KQ të PPSH, të mbajtur më 26-28 qershor 1969, për organizimin e punës prodhuese të nxënësve dhë të studentëve.

matikës ose të kimisë atje ku caktohet, për aq kohë sa parashikohet në program dhe jo sipas qejfit.

Jam dakord me shkurtimin e kohës së punës në prodhim. Puna prodhuese synon t'u mësojë nxenësve dhc studentëve ndonjë profesion, si dhe t'i kalitë fizi-kisht. Pra, nëpërmjet saj ka dobi edhc prodhimi, edhe njeriu. Këto dy qëllime të drejta duhet t'i puqim. Por, kur nuk i puqim dot të dy për arsyet se nuk kemi arritur t'i inkluadrojmë si duhet, atëherë puna prodhuese tò ketë më tepër karakter kalitjeje, megjithëse prapëseprapë, edhe në këtë rast, nuk mbetet pa qenë punë prodhuese. Në përgjithësi kjo punë ndihmon që nxenësit e studentët të vijnë direkt në kontakt me klasën punëtorë dhe me fshatarësinë kooperativiste.

Normat e punës, sidomos për nxenësit e shkollave të mesme, nuk duhet të jenë të larta, se ata janë filiza të rinj dhc, po të ngarkohen me norma të rënda, do t'u dëmtohet shëndeti. Prandaj, atje ku ka mundësi, të vihen norma për nxenësit, por, kur nuk ka mundësi, të mos vihen norma kaq strikte dhe të rënda sa janë caktuar. Gjithashtu nuk duhet kurrsesi që djali ose vajza e shkollës së mesme, në moshë gjer në 16 vjeç, siç konstatojmë, të vejë e të punojë në turnin e natës. Unë s'jam dakord të veprohet kështu me ta. Këtu nuk e kam fjalën për studentët e universitetit. Ata, duke qenë të rritur, mund dhc duhet të punojnë edhe në turnin e natës. Këto gështje t'i kemi mirë parasysh. Ndryshe është për punëtorët. Këta venë, se paguhen për punën që bëjnë dhe janë në moshë më të madhe. Puna prodhuese, siç thashë, ka synime të dyfishta, që njeriu të kalitet dhe, mundësisht, tò fitojë një zanat,

por kjo gjë, shumë herë, është e parcalizueshme. Në qoftë se, bie fjala, kandidati për mësues, që e kreu praktikën mësimore do të vejë ta bëjë punën prodhuese, por nuk ka front pune që t'i përgjigjet profesionit të tij, të shkojë në një ndërmarrje tjetër.

Për çështjen e kontingjenteve të shkollave, që u diskutua, në përgjithësi unë jam dakord të veprohet siç kemi vendosur.

Për sa i përket stazhit në prodhim, atë duhet ta bëjnë edhe nxënësit, edhe studentët, pas mbarimit të shkollës, për aq kohë sa është caktuar¹. Që të shkojnë të punojnë në ndërmarrje, kjo është një gjë e mirë, por, çështja është që, kur të venë, të mos rrinë duarlidhur pranë tornos. Puna atje ka vështirësi dhe është më ndryshe se në bujqësi e në ndërtim, prandaj të organizohet që të kenë mundësi të gjithë nxënësit të merren me punë të dobishme. Nga ana tjetër, mendoj se ka një problem lidhur me studentët, pasi japin provimet e vitit të fundit, shkojnë për të bërë stazhin e prodhimit, dhe, pastaj, kthehen përsëri në universitet për të dhënë provimet e diplomës. Nuk më duket me vend që pas një shkëputjeje prej një viti ata të kthehen përsëri për të dhënë provimet e fundit. Kjo procedurë jo vetëm që paraqet vështirësi për studentët, por edhe për pedagogët e universitetit.

1. Me vendim të Byrosë Politike të KQ të PPSH, «Për ngrijtjen e mëtejshme të cilësisë së punës mësimore edukative të shkollës», të datës 25.6.1982, stazhi njëvjeçar në punë, pas mbarimit të shkollës së mesme dhe të universitetit, u hoq. Koha për përgatitjen e diplomës dhe të provimeve të formimit në shkollat e larta u përfshi brenda periudhës së studimeve.

Për kriteret e degëve, të mbahet ajo që kemi: të rinjtë, kur bëjnë kërkesën për në shkollat e larta, të shfaqin dëshirën për tri degë dhe ne të përpigemi t'u japim njëren prej tyrc.

*Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbal i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH,
që gjendet në AQP*

KALIMI I KOOPERATIVAVE NË NDËRMARRJE BUJQËSORE TË BËHET I MATUR DHE NË MËNYRE TË STUDIUAR

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

22 janar 1973

Dekreti i vitit 1960 për rregullimin e pasurive të kooperativave bujqësore që kalojnë në ndërmarrje shtetërore, parimisht është i drejtë dhe përputhet si me Kushtetutën, ashtu edhe me Kodin Civil e Statutin e Kooperativave. Kurse vendimi i Qeverisë i marrë më vonë, me rastin e kalimit të disa kooperativave në ndërmarrje bujqësore, në disa pikë, bie në kundërshtim me dekretin, dhe kjo është bërë vetëm që të mos rëndohej shteti.

Nuk duhet shpejtuar, duke u shprehur në mënyrë aq kategorike sa të thuhet se „kooperativistët i kanë kuptuar drejt veprimet, kur janë bërë sipas këtij vendimi të Qeverisë“. Ca më pak nuk duhet shprehur, si në rastin e Lakanosit², se „donin t'i merrnin shtetit ndo-

1. Në këtë mbledhje u diskutua për rregullimin e marrëdhënieve pasurore që lindin nga kalimi i kooperativave bujqësore në ndërmarrje bujqësore.

2. Fshat në rrethin e Tiranës.

një lek më tepër.. Duhet thënë jo shtetit, por nga pronë e tyre e grupit, që kalonte në pronë të të gjithë popullit.

Përcaktimi i kalimit të pronës së grupit në pronë të të gjithë popullit është vetëm shtruarja e problemit. Por, se si do të bëhet ky kalim, kjo nuk është aq e thjeshtë dhe duhet studuar thellë, prandaj nuk na lejohet të nxitohemi. E them këtë se si shumë shpejt po afirmohet se „disa parime ose mendime për këtë problem janë të drejta“, disa „nuk qëndrojnë në këmbë“ në lidhje me mënyrat e kalimit të kësaj prone.

Është gabim të nisemi vetëm nga veprimet faktike se kooperativistëve, „meqë nuk mund t'i përdorin mjetet kryesore drejtpërdrejt për plotësimin e nevojave vetjake, u duket se këto nuk janë të tyret, por të grupit“. Atëherë, këto «u kanë rënë nga qiejt» dhe dikush tjetër mund t'i përdorë pa i pyetur. Jo, këto mjete janë pronë e grupit, janë krijuar nga grapi, duke bërë edhe sakrifica, dhe këto sakrifica e kursime duken në disnivelin që ekziston sot në mes punëtorëve e qytetarëve, nga njëra anë, dhe kooperativistëve, nga ana tjetër, në lidhje me standardin e jetesës. Ato pra janë të tyret, ata vetë i kanë vendosur me statut e me rregullore se si të përdoren ato dhe, në rast se nuk do të përdoreshin ashtu, s'mund të kishte zhvillim, s'mund të kishte ngritje të nivelit të jetesës, të ditë-punës etj. Kjo është abécëja e zhvillimit të ekonomisë, të çfarëdo ekonomie. Kështu duhet shtruar problemi, pa harruar të kaluarën, pa harruar momentet politike para, gjatë dhe pas kollektivizimit, pa harruar Kushtetutën, ligjet, kodet dhe statutet që na kanë orientuar dhe na orientojnë në këto

çështje. Nuk duhet të vendosim me një të rënë të penës, për të anuluar statute e dekrete, por të thellohem i përtë gjetur rrugën e drejtë të kalimit të pasurive.

Që ka interes ekonomik dhe i pëlqen kooperativistit kalimi në gjendjen e një punëtori ndërmarrjeje, kjo nuk ka dyshim se është e vërtetë, sepse ai do që të ketë një të ardhur më të mirë nga puna e tij. Por, që ai, si grup dhe si individ, ia fal me «gëzim dhe entuziazëm» ndërmarrjes gjithë pasurinë e grüpuit që e ka vënë me djersë, kjo nuk është e vërtetë. Ne do të gënjejemi po ta afirmojmë dhe ta besojmë me sy mbyllur këtë gjë, siç thonë shokët dhe, si rrjedhim, do të gabojmë edhe teorikisht, edhe politikisht në mendime, sepse realiteti nuk mund të jetë plotësisht ashtu.

Duhet të përpinqemi të gjejmë rrugën që është edhe parimisht e drejtë, e pranueshme nga kooperativat dhe nga shteti. Jashtë kësaj rruge nuk është aq i saktë afirmimi kategorik i shokëve se «ky veprim nuk mund të quhet kurrsesi shtetëzim i pronës kooperativiste». Pse të mos quhet?

Merreni me mend sa e rrezikshme bëhet për zhvillimin e bujqësisë sonë, ndonëse mund të mos thuhet me plot gojën, në rast se në ndërgjegjen e kooperativistëve formohet mendimi se «ky veprim i bërë nga shteti i proletarëve është shtetëzim», gjë që prek një klasë të tërë aleate e besnike. Ne mund të themi se do ta shpjegojmë, por kooperativisti, me gjithë përparimet e mëdha, ka akoma në ndërgjegjen e vat doza të mentalitetit fshatar, që e bëjnë t'i peshojë mirë fjalët me faktet konkrete për të gjitha ato çka ndodhin rreth tij dhe çka i thuhet.

Kjo çështje e rëndësishme politike dhe ideologjike nuk shtrohet vetëm për ata që integrohen tash në ndërmarrje bujqësore. Problemi më i madh është me masën e gjërë të kooperativave dhe të kooperativistëve që s'hyjnë në ndërmarrje dhe që vazhdojnë e do të vazhdojnë edhe për një kohë të gjatë të jetojnë e të punojnë në kooperativa.

C'do të na ngjasë në rast se marrim një vendim të shpejtuar? Mund të na dobësohet ritmi i zhvillimit të kooperativave, ritmi i investimeve, duke u shtyrë nga mentaliteti se «sot ose nesër do të na thithë ndërmarrja bujqësore, do të na i marrë ajo të ardhurat dhe neve s'do të na paguhet gjë». Krijohen kështu në kokën e kooperativistëve pakënaqësi dhe paqartësi politike. Këtë irrezik të mos e harrojmë, shokë, po ta mënjanojmë se ka rëndësi të madhe politike dhe ekonomike për çështjen e socializmit, për forcimin e unitetit dhe të alcancës së klasës punëtore me fshatarësinë, si dhe për kompaktësinë përpara armikut të brendshëm dhe të jaشتëm.

Partia jonë për zgjidhjen e problemeve kyç nuk ka shkuar në asnjë moment sipas motos: «Hë mo, se nuk na ngjet gjë», por i ka shoshitur të mirat dhe irriqiqt, që të mirat të zhdunin irriqiqt.

A duhet ne të komprometojmë parimet, ligjet dhe Statutin e Kooperativave, idenë e madhe të zhvillimit të tyre, si dhe idenë tjetër të madhe të perspektivës, të kthimit të pronës së grüpit në pronë të të gjithë popullit, për arsyen se duhet t'u paguajmë këtyre kooperativave aktuale që përfshihen në ndërmarrje bujqësore disa shuma të hollash? Unë jam i mendimit se nuk

duhet ta bëjmë këtë gabim. Në çështjen e fshatarësisë të ecim me kujdes dhe gradualisht. Kjo lidhet me zhvillimin politik dhe ekonomik të të gjithë vendit, për të gjetur format më të përshtatshme pér kalimin nga njëra shkallë në tjetrën më të përparuar.

Para kolektivizimit, të mos harrojmë se bëmë Reformën Agrare, u ndamë tokat fshatarëve. Do të ishte gabim i madh të hidheshim në kolektivizimin e bujqësisë pa kaluar më parë nëpër këtë stad. pse kjo do ta komprometonte ndërtimin e socializmit në fshatin tonë. U desh një periudhë e gjatë kohe dhe një punë e kujdeshshme e Partisë pér të hyrë në rrugën e kolektivizimit, nëpër të cilën ne ecëm me kujdes. Krahas kolektivizimit, krijuam edhe ndërmarrjet bujqësore, punë kjo që u bë pa ua prekur tokat fshatarëve.

Socializmi në fshatin tonë erdhi vazhdimishit duke u zhvilluar në ngjitje. Nuk ka shumë kohë kur Partia hodhi parullën pér krijimin e kooperativave të tipit të lartë, gjë që tregon pér një ecje më përpara të zhvillimit të socializmit në fshatin tonë. Por, në vendimet që kemi marrë pér këtë çështje, vendime që janë të drejta, nuk kemi thënë që të shpejtohem, duke mbuluar gjithë Shqipërinë me kooperativa të tipit të lartë. Përkundrazi, këtë punë e kemi kufizuar hëpërhcë në zona të veçanta me karakteristikat që dimë.

Gjëja e re në këtë stad të ngritjes së kooperativave të tipit të lartë është pjesëmarrja e drejtëpërdrejtë e shtetit në to. Kjo u arrit pas një pune përgatitore politike. Por, në bazë, gjatë kohës së krijimit të kooperativave të tipit të lartë, u vërtetuan edhe gabime ndaj kooperativistëve, gabime këto që rrodhën nga shpejtimi

dhe moskuptimi, por që u ndreqën përnjëherësh. Pjesa dërrmuese e kooperativistëve e pranuan se krijimi i këtyre kooperativave ishte i drejtë, ishte në interesin e tyre, si edhe në interes të ndërtimit të socializmit në vendin tonë. Kjo kishte rëndësi të madhe.

Karakteristika tjeterë është se ne, edhe në këtë nivel më të lartë të zhvillimit të kolektivizimit, ruajtëm akoma Statutin e Kooperativave, domethënë të drejtat e kooperativistëve mbi pronën e grupit. Kjo do të thotë se ne nuk i kthyem përnjëherësh në ndërmarrje bujqësore, gjë që edhe mund ta bënim me një dekret, por që do të ishte e papjekur.

Në këtë stad të ri luftohet në dy drejtime: në përsosjen me shpejtësi më të madhe të organizimit e të drejtimit të prodhimit dhe në afrimin nga ana ekonomike e politiko-ideologjike të këtyre kooperativave dhe kooperativistëve me ndërmarrjet bujqësore dhe me klassën punëtore. Shkohet pra, gradualisht, drejt pronës së përbashkët të popullit. Po ne, akoma nuk kemi shkuar plotësisht në këtë formë prone. Sa kohë do të vazhdojë kjo periudhë, nuk mund ta përcaktojmë dot me afate; as me dekret kjo punë nuk bëhet, por do të arrihet me zhvillimin e saj në rrugë të drejtë marksiste-leniniste. Kur shfaqa idenë e krijimit të kooperativave të tipit të lartë pata parasysh që brenda kësaj periudhe të papëraktuar, nga përparimet që do të arrijnë këto do të krijojen mundësi fondesh të përbashkëta, shtet-kooperativa të tipit të lartë, të cilat duhet të përdoren në një mënyrë të atillë si ajo që ekziston në mes anëtarëve të kooperativave të tipit të lartë dhe punëtorëve të ndërmarrjeve bujqësore. Pastaj, krahas dhe njëkohë-

sisht me rritjen e nivelit ideologjik, politik, moral dhe ekonomik të tyre, ne duhet t'i përdorim këto fonde në një mënyrë të atillë të drejtë që, kur të piqen kushtet plotësisht për kalimin e tyre në ndërmarrje bujqësore, fondet e krijuara për t'u shpërndarë kooperativistëve që kthehen në punëtorë të këtyre ndërmarrjeve, të jenë shuma të pakonsiderueshme.

Gjatë kësaj kohe përgatitore do të na vihet problemi: këto fonde të tepërtë që krijojnë kooperativat e tipit të lartë çfarë do të bëhen? Do t'i përdorë koooperativa, apo do t'i ndajë për ditë-punë më tepër se ç'duhet, ndërsa shteti të disponojë kuotën që i përket dhe vetëm ky të investojë në kooperativat e tjera? Unë mendoj se, kur të arrihet kjo situatë dhe të jetë ngritur akoma më lart ndërgjegjja e këtyre kooperativistëve, këto teprica fondesh e mijetesh të përbashkëta mund të gjendet rruga që të investohen bashkërisht nga shteti dhe nga kooperativat e tipit të lartë në kooperativat e tjera malore, gjysmiëmalore dhe krejtësisht malore, ose do të tërhiqen në formën e rentës për t'i rishpërndarë, për t'i ngritur edhe këto të fundit në një nivel më të lartë ekonomik, politik e në çdo drejtim tjetër.

Si do të bëhet ky investim? Sigurisht me pëlqimin e të dyja palëve dhe me modalitetet që natyrisht duhen studiuar. Ky pëlqim nga të dyja palët do të sanksionohet me ligje që do të rrjedhin prej Kushtetutës së Republikës. Kjo është njëra çështje.

Çështja tjetër është ajo e momentit që do të vijë, kur prona e grupit do të ngrihet në pronë të të gjithë popullit. Atëherë do ta kemi përsëri pikërisht këtë problem që po shtrohet sot këtu, por shumë, shumë më

të zbutur edhe nga ana politike e materiale. Sot këtu shtrohet çështja e një numri të vogël kooperativash që thithen nga ndërmarrjet bujqësore, por, më vonë, gradualisht kjo do të shtrohet edhe për kooperativat e tipit të lartë dhe, më në fund, edhe për kooperativat e zonave malore, gjysmëmalore e krejtësisht malore.

Por, a do të mund dot shteti ynë të paguajë gjithë fshatarësinë, qoftë edhe në afatet e përpjesëtimet që propozojmë më poshtë? Kjo përsëri është e vështirë, për të mos thënë e pamundur. Por edhe në fazën të mëvonshme do të shtrohet çështja që edhe këtë pasuri të pjesëshme, që ka për të qenë e reduktuar, në parim duhet t'ua paguajmë kooperativistëve. Kohët që do të vijnë, nuk do të jenë të njëllojta me ato që ekzistojnë sot (mendoni ndihmën vëllazërore të kooperativave të fushës për kooperativat malore, me bagëti falas) pse deri atëherë do të jetë bërë një ndryshim rrënjosor në mentalitetin e fshatarësisë, në nivelin e jetesës, në mekanizimin e bujqësisë (ku mjetet janë kurdoherë në duart e shtetit), në investimet. Në të gjitha këto kontributi shtetëror do të marrë përpjesëtime më të mëdha; do të evoluojnë e tërë struktura materiale e kooperativave dhe psikologjia e kooperativistëve; kooperativat e tipit të lartë do të ndodhen kështu gati në gjendjen e një ndërmarrjeje shtetërore.

Pse do të ndodhë kjo? Për arsyec se problem kryesor mbetet çështja e tokës. Kjo tash nuk është sanksionuar me ligj si e nacionalizuar, po kështu si e kemi, në fakt, është e nacionalizuar. Në çështjen e pemëtarisë dhe të investimeve në stalla etj. domethënë në investime të paluajtshme, kurdoherë, në bazë të ligjeve dhe

me pëlqimin e të dyja palëve, mund të procedojmë, siç propozoj unë këtu më poshtë: tokat me pasurinë e paluajtshme t'ia kalojmë pronës së përbashkët të popullit.

Për sa u përket fondeve që ekzistojnë si të ardhura të akumuluara nga kooperativistët, më vonë ato do të jenë shumë të balancuara me investime në objekte të paluajtshme, në shpenzime të ndryshme dhe në kontributin që këto kooperativa mund dhe duhet t'u japin kooperativave të tjera në rrugët që thashë më lart.

Të gjitha këto veprime të së ardhmes del nevoja t'i studiojmë më thellë, t'i eksperimentojmë dhe pastaj t'i sanksionojmë me ligje, të cilat duhet të kenë aprovimin e plotë të kooperativistëve. Mendoj se në Kushtetutën e re të Republikës do të ketë përsëri një nen për pronën personale, si dhe një nen për pronën e përbashkët të grupit, e cila mund të përcaktohet edhe kështu, për shembull: «Prona socialiste e grupit kontribuon në ngritjen e nivelit të jetesës të kooperativistëve, në ndërtimin e plotë të socializmit në shat dhe në të gjithë vendin». Do të ketë, gjithashtu, edhe një nen për pronën e gjithë popullit. Këto tri përkufizime pronash nuk mund t'i përngjasin atij që ekziston në Kushtetutën aktuale. Këto duhet të përcaktohen jo vetëm duke u nisur nga rrethanat që janë krijuar sot, por duke parë edhe perspektivën. Për sa i përket pronës së përbashkët të grupit, në Kushtetutë duhet të mendohet veçanërisht një përcaktim i atillë që në parim të sanksionojë këtë rrugë dhe këtë ide, pasi Partia t'i gjykojë se janë të përshtatshme. Po të formulojmë si duhet (dhe këtë është e domosdoshme ta bëjmë pikërisht kështu),

atëherë, në bazë të Kushtetutës së re, kur të piqen kushtet, merren edhe ligjet përkatëse.

Aktualisht çdo gjë duhet ta vendosim tok me kooperativat në fjalë, domethënë çfarë do t'u paguhet dhe çfarë nuk do t'u paguhet kooperativistëve. Në radhë të parë, atyre duhet t'u paguhet prona e oborrit personal, pra kryesisht kafshët. Për këto, s'ka asnje diskutim se është e drejtë, ndryshe do t'i therin ose do t'i shesin.

E dyta, përveç atyre që na thotë neni 2 i projekt-dekretit, kooperativave që na paraqiten në këtë raport nga Ministria e Bujqësisë, duhet t'u paguhet çka përmban neni 5, me përjashtim të inventarit të materialeve, të mjeteve kulturore, kulturave drusfrutore jashtë truallit të oborrit të shtëpive të anëtarëve, të investimeve të paluajtshme të pronës kooperativiste dhe të sendeve të tjera me karakter të tillë. (Këtu nuk hyjnë kafshët e kooperativës të cilat u paguhën.)

Kuptohet se përveç çështjes së oborrit, nga llogaritë plus-minus duhet të zbriten të gjitha detyrimet që ka kooperativa ndaj shtetit, ndaj bankës, ndaj anëtarëve etj., që numërohen dhe zhvillohen në këtë projekt-vendim.

Por, ato që do t'u paguajë shteti kooperativave janë shuma mjaft të mira dhe me to mund të rëndohej ekonomia, po të paguhen menjëherë. Megjithatë, edhe kësaj duhet t'i gjendet zgjidhja e drejtë. Dihet se kooperativa këto mjete pune, që shteti si me thënë, ia blen, nuk i ka vënë në një vit, as në pesë vjet. Veç kësaj edhe shteti e ka ndihmuar atë t'i vërë këto pasuri. Prandaj, që t'i paguajë ato, edhe shtetit do t'i duhen

vite. Për këtë duhen caktuar afate, me qëllim që jo vetëm ekonomia shtetërore e republikës të mos rëndohet, por edhe kooperativistët, që do të kthchen në punëtorë ndërmarrjesh, gjendja ekonomike e të cilëve do të përmirësohet, duhet të bëhen të ndërgjegjshëm që ta ndihmojnë shtetin, duke pranuar afatet e caktuara të pagimit, në mënyrë që ta dinë se të ardhurat e tyre do të përmirësohen, por jo për të fryrë xhepin dhe buxhetin e familjarëve në dëm të interesit të përgjithshëm.

Unë e kam çështjen që në parim të jemi në përputhje me Kushtctutën, si për pronën e grupit, ashtu edhe me anët e tjera, sepse mendimi: «Dekreti që propozohet nuk quhet kurrsesi shtetëzim», nuk qëndron. Në këtë drejtim duhet vepruar me bindjen e kooperativistëve.

Për sa u përket shpërblimeve që do t'u japim kooperativistëve, këto do t'u jepen me asafe të gjata, domethënë do të jenë një përqindje e akumulimeve që merr shteti nga e gjithë ekonomia dhe nga rendimentet më të mëdha që do të marrë. Tash që po organizojmë kooperativat e tipit të lartë, kurdoherë duhet të ngulim këmbë në investimet pér përmirësimin e tokave prodhuese, me qëllim që kur të vijë momenti pér të kaluar në ndërmarrje, edhe nga kjo anë të mos kemi shumë pér të paguar, por të jemi të balancuar në këto gjëra.

Për vendimet që marrim, nganjëherë nuk mendohemi thellë sa ç'duhet. Për shembull, kuota pér pensionet e fshatarësisë derdh në buxhetin e sigurimeve shoqërore edhe kooperativa, edhe shteti. Tashti, pér sa

u përket kooperativave të tipit të lartë ku shteti investon, kjo kuotë mund të kalojë si investim shtetëror.

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbali i mbledhjes së Byrosë

*Politike të KQ të PPSH,
që gjendet në AQP*

TË GJITHA FORCAT E POPULLIT USHTAR TË JENË KURDOHERE NË GATISHMËRI TË PLOTE

*Diskutim në mbledhjen e organizatës-bazë
të Partisë ku bën pjesë*

23 janar 1973

Përgatitja ushtarake përbën një problem shumë të rëndësishëm pér Partinë dhe pér vendin tonë, prandaj organizata jonë vepron drejt që po e merr në analizë këtë çështje. Kjo analizë është pozitive edhe pér faktin se nuk kufizohet vetëm në përvojën e punës së Partisë gjatë organizimit të një stërvitjeje me trupa, por ndalet edhe në përpjekjet pér zbatimin e udhëzimeve të dhëna, në kohën e sotme, pér forcimin gjithnjë e më shumë të mbrojtjes së atdheut.

Ky është një problem i gjerë, por ajo që Partia kërkon sot çshicë, në radhë të parë, kuptimi politiko-ideologjik i përgatitjes ushtarake. Kjo ka rëndësi të madhe, veçanërisht pér momente emergjence, kur atdheu vihet në rrezik dhe nga të gjithë kërkohet të përballohet çfarëdo agresioni eventual. Partia jonë, që është në udhëheqje të masave punonjëse, s'ka pse të presë momentin e fundit pa të mendojë pér këtë problem, ajo përgatitet me kohë pér të përballuar me sukses

çdo të papritur. Prandaj në këtë drejtim kudo po bëhen përpjekje dhe, në fakt, në përgatitjen politike, organizative, ushtarake e në bazën materialo-lustarake etj. ka përmirësime.

Duke përfituar nga koha relativisht paqësore, Partia e ka për detyrë të përpinqet që kurdoherë të përsosë organizimin e punës për mbrojtjen e atdheut, duke synuar që gjithë populli të përgatitet ushtarakisht. Një organizim i shëndoshë dhe kuptimi i lartë ideologjik e politik i çështjes së mbrojtjes e kufizon në një shkallë të madhe rrezikun e një situate kërcënuese.

Gjatë këtyre gati tri dekadave të pasçlirimit Partia ka fituar një përvojë të madhe në punën e saj drejtuese e organizuese. Ajo ka, gjithashtu, edhe përvojën e madhe të organizimit e të drejimit të kohës së Luftës Nacionalçlirimtare. Të dy këta faktorë na shërbejnë që paskëtaj të përgatitemi sa më mirë edhe për mbrojtjen. Sigurisht, që në eventualitetin e një lufte të re, nuk do të jenë të njëjtat kushte të luftës që ne zhvilluam para tridhjetë vjetëve për çlirimin tonë kombëtar e shoqëror. Në Luftën Nacionalçlirimtare ne rrëmbyem armët për të çliruar vendin nga pushtuesit e huaj dhe reaksionarët e brendshëm, ndërsa në një luftë të mundshme në të ardhmen armët tona do të drejtohen kundër armiqve që do të na sulmojnë, si dhe për çlirimin e ndonjë pjese të territorit që eventualisht mund të shkellet përkohësisht nga armiku. Pra, lufta e ardhshme që mund të na imponohet do të jetë totale, prandaj është detyrë që të gjithë njerëzit tanë të përgatiten sa më mirë për ta përballuar atë me sukses dhe me sa më pak humbje.

Eshtë fakt se sot ne jemi në një situatë që ndryshon shumë nga ajo e Lustës Nacionalçirimitare, si nga ana politike dhe ekonomike, ashtu edhe materialo-teknike e ushtarake, sepse jemi më të armatosur, më të përgatitur. Ne kemi sot një shkencë ushtarake tonën në gjendje të përballojë me sukses shkencën ushtarake të armiqve eventualë. Megjithatë, do të ishte gabim të pretendojmë që shkencën dhe artin e luftës te ne i zoterojnë mirë të gjithë, të mëdhenj e të vegjël.

Në radhë të parë, është e nevojshme që për mbrojtje të përgatitet mirë ushtarakisht Partia, anëtarët e së cilës t'i kenë të qarta si duhet situatat që kalojnë, të jenë të bashkuar si një trup i vetëm e me radhë të shtrënguara midis tyre, me logjikë të fortë e mendje të kthjellët, të jenë gjithnjë në lartësinë e duhur të detyrës së madhe patriotike, siç është mbrojtja e atdheut. Tok me Partinë ne duhet të kemi të çeliktë ushtrinë, e cila ndryshon nga ushtria e dikurshme partizane, sepse sot te ne ushtar është gjithë populli, kurse gjatë Lustës Nacionalçirimitare kishte edhe nga ata që, nën ndikimin e forcave të ndryshme reaksionare, qëndronin dhe vepronin kundër Partisë. Me kohë e gradualisht, me punë të vazhdueshme politike e plot durim me masat, populli ynë, pjesë-pesë, po përherë e më tepër e më fort lidhej me Frontin Nacionalçirimitar të udhëhequr nga Partia, derisa u arrit që ai të lidhej, si sot, i téri kaq ngushtë e si një trup i vetëm rrëth Partisë sonë të lavdishme. I them këto që më të rinjtë, që lexojnë edhe në libra ose dëgjojnë të flitet për historinë e luftës sonë, t'i kuqtojnë drejt çështjet. Partia ka bërë një luftë të madhe për të krijuar këtë situatë

të shëndoshë që ekziston sot në Shqipëri. Për ta arritur këtë unitet, ne kemi ecur përpara duke bërë sakrifika të mëdha, duke derdhur gjak dhe për këtë qëllim na është dashur të shkatërrojmë jo vetëm okupatorët, por edhe forcat e organizatës së Ballit Kombëtar, të Legalitetit, të bajraktarëve. Tashmë është zhdukur ajo mjetgull që ekzistonte dikur në kokën e shumië njerëzve, mendja e tyre është qartësuar, prandaj uniteti i popullit sot është më i fortë se kurrë, gatishmëria e çdo njeriu për mbrojtjen e fitoreve të arritura është rritur më tepër se kurrë.

Koncepti i drejtë «gjithë populli ushtar» ka një përmbajtje të thellë ideologjike dhe një kuptim të lartë politik e patriotik. Është e domosdoshme që ky koncept të rrënjoset mirë në mendjen dhe në ndërgjegjen e gjithë komunistëve, sidomos të kuadrove të Partisë në ushtri e në terren, se vetëm atëherë do të gjejnë zgjedhje edhe ato detyra, që janë dukur aq të vështira e të ndërlikuara gjatë përgatitjes dhe zhvillimit të disa stërvitjeve të mëdha me trupa. Kjo ngjet, përveç të tjerave, edhe për shkak se ka komunistë dhe kuadro në terren dhe në ushtri që nuk e kanë kuptuar si duhet rëndësinë dhe nevojën e organizimit dhe të edukimit të Ushtrisë së madhe Popullore, të popullit ushtar. Kur them kështu kam parasysh se duhen bërë më shumë përpjekje për një kuptim më të thellë dhe për një veprim revolucionar në zbatim të kësaj ideje të madhe të Partisë.

Ushtria jonë ka dalë nga gjiri i Luftës Nacional-çlirimtare, nga ushtria e saj partizane. Partia krijoi më vonë Ushtrinë Popullore. Por kjo ushtri, numerikisht, është një pjesë e vogël e popullit, aq sa na e lejojnë

kushtet dhe mundësitë tona. Ekonomia jonë nuk mund të mbajë më shumë ushtri në kazermë sesa kjo që kemi sot. Prandaj na vihet detyrë të krijojmë ushtrinë e gjithë popullit, të organizojmë shkollat e lira, sipas tezës së Leninit. Kjo kërkon që të organizojmë ushtarakisht gjithë njerëzit që kanë kryer shërbimin e detyrueshëm në ushtrinë tonë e që s'janë më në shërbim aktiv, pse këta përbëjnë pjesën dërrmuese të popullit ushtar. Ata që kanë kryer shërbimin ushtarak te ne, nuk janë rezervistë, si në ushtritë borgjeze, që përgatiten të vriten për interesat e kapitalistëve. Ndryshe qëndron puna me rezervistët tanë. Këta, të edukuar nga Partia, janë ushtarë të vërtctë dhe, si anëtarë të shoqërisë së re socialistë, kanë detyrë kryesore të mbrojnë atdheun. Ky qëllim i lartë i bën rezervistët tanë të jenë të qartë, të përgatiten mirë ushtarakisht e pa u lodhur, të jenë vigjilentë ditë e natë dhe të gatshëm në çdo moment për mbrojtjen e vendit. Kjo realizohet me ta në mënyrë të organizuar në reparte ushtarake, nëpërmjet stërvitjeve të vazhdueshme.

Në qoftë se nisemi nga konceptet e vjetra, sipas të cilave, ushtrinë tonë e përbëjnë vetëm të rinjtë që përgatiten në kazermë, kjo do të conte në nënvleftësimin e forcave të shumta të popullit, të grumbulluara në njësi të organizuara, që stërviten vazhdimiisht për mbrojtjen e vendit, pa të cilat, në rast rreziku, do të kishim pasoja të rënda. Veç kësaj, mendoj të bëhet e qartë për të gjithë se ushtarët e kazermës nuk janë më të mësuar e më të zotë nga ata që kanë kryer shërbimin ushtarak, që me kohë kanë mësuar dhe dinë t'i përdorin mirë armët.

Ushtaria jonë është një shkollë e vërtetë, mësimet e së cilës vazhdojnë të thellohen vazhdimisht, edhe pasi ushtari e kryen shërbimin ushtarak. Në vendin tonë edhe pas kësaj çdo i ri duhet ta ndiejë veten përsëri ushtar. Për këtë arsy, për të freskuar njohuritë e njerrëzve dhe për t'i pajisur ata vazhdimisht me njohuri të reja ushtarake, Partia ka organizuar stërvitjet ushtarake. Prandaj është e domosdoshme që çdo qytetar kurdoherë ta ndiejë, ta vlerësojë drejt dhe ta shikojë me përparësi çështjen e mbrojtjes së atdheut. Këto koncepte revolucionare duhen rrënjosur më mirë e më parë se te kushdo të shokët e Partisë, të terrenit dhe të ushtrisë.

Te disa shokë drejtues të ushtrisë është me vend të luftohen konceplet e vjetra që kanë të bëjnë me strategjinë dhe taktikën klasike të luftës dhe të mbrojtjes, duke krijuar në vend të tyre koncepte të reja, që t'i bëjnë ballë strategjisë dhe taktikës së armikut në kohën e sotme. Populli ynë ka luftuar gjithnjë me trimëri. Natyrisht, përpara ai nuk ka pasur armë të tilla të fuqishme si këto që kemi sot, megjithatë luftën e ka zhvilluar me sukses e trimëri, bile edhe në këmbë. Por, të luftosh sot në këmbë, ashtu siç luftonte dikur shqiptari, kjo do të thotë të dëmtosh mbrojtjen e atdheut, pse tani nuk mund të luftohet më si përpara kur kundër një aeroplani mund të hapej zjarr edhe me pushkë. Që të nxjerrësh jashtë luftimit një aeroplan armik, për shembull të tipit B-52 që i hedh bombat nga lartësi të mëdha prej 8 000 e më shumë metrash, duhet të kesh patjetër raketa, pse armët e tjera nuk bëjnë asnje efekt kundër tij. Po kështu armiku ka sot mjete të tilla

kundër radarëve që i bllokon köta, duke i bërë të paefektshëm. Prandaj për të gjithë del nevoja e domosdoshme për t'i mësuar e përvetësuar armët moderne, për të njohur mirë strategjinë dhe taktkën aktuale të armikut, forcat dhe mjetet që ai ka në dispozicion etj. Në rastet kur i kemi ato armë që ka armiku, është e kuptueshme që mund t'u kundërvihemi më lehtë armëve dhe mjeteve të tij, po për ato që nuk i kemi është e domosdoshme të mendojmë e të marrim masa të tjera me qëllim që t'i bëjmë ballë fuqisë së armëve të armikut. Kjo duhet bërë medocmos, që mjetet luftarakë të tij të mos kenë mundësi të na dëmtojnë. Qëllimi është që nc ta mbrojmë atdheun kurdoherë me sa më pak humbje, ta dëmtojmë sa më rëndë armikun dhe të arrijmë fitoren mbi të.

Në fushën e përgatitjes së ushtrisë me një strategji dhe taktkë të re ne kemi ecur e po ecim përpëra. Por Partia duhet të jetë e vëmendshme që çdo reminishencë¹, çdo koncept të vjetër që i mundon disa, si dhe vetëkënaqësinë, mburrjen e të meta të tjera të tillë, t'i luftojë, t'i spastrojë, t'i zhdukë. Këto kanë rëndësi të madhe dhicë kanë lidhje të ngushtë me mbrojtjen e atdheut. Po të mendohet e të veprohet në këtë mënyrë, atëherë do të kemi me siguri një organizim të mirë të punës për përgatitjen ushtarake të popullsisë dhe tani ne jemi në plotësimin e këtij organizimi.

Çdo ndërmarrje duhet të veprojë njëkchësisht si një repart ushtarak. Organizatal-bazë të Partisë në to që tanë duhet ta dinë se çfarë do të bëjnë në kohë lufte.

1. Nga frëagjishtja — mbeturinë.

Në këtë mënyrë detyrat përmbrojtjen bëhen sa më të qarta e më konkrete përkolektivat punonjës. Pra, është e domosdoshme të japim udhëzime të qarta, duke i bërë këto çështje sa më të kuptueshme përmasat. Sigurisht, disa norma e rregulla duhen caktuar që sot në kohë paqeje, por kjo nuk do të thotë që çdo gjë të përcaktohet me hollësi nga lart. Siç dihet, në rast lufte, disa njerëz do të qëndrojnë në qendra pune, të tjerët do të shkojnë ushtarë, disa caktohen e përgatiten si komandantë e komisarë dhe venë në reparte të caktuara, ku i presin detyrat që duhen kryer në një situatë të vështirë lufte. Pra, organizimi në formacione të menduara me kohë i përshtatet shumë mirë organizimit të popullit ushtar. Këto çështje përcaktohen që në kohë paqeje nga Partia, e cila vë dorë në problemet më kardinale, kurse në detaje shumë gjëra duhet t'i vendosë vetë baza me iniciativë, se është vështirë të mendohet me hollësi që sot për ato që mund të ngajnjë në një situatë lufte. Për shembull që tanë duhet të ngrihen në përgjegjësi njerëz të rinj, të cilët të mësojnë në punë e sipër detyrat e kuadrove drejtues të kohës së luftës. Kjo është detyrë partie.

Partia duhet të punojë me këmbëngulje, dhe këtu duhet të rrahë çekani, që gjithë komunistët të mësojnë e të përgatiten qysh sot se si të luftojnë nesër, në rast se atdheu sulmohet nga armiqjtë. Kjo kërkon një organizim konkret të punës, disa duhet të bëjnë pjesë dhe të stërviten në repartet ushtarake, të tjerët në forcat vullnetare të vëtëmbrojtjes popullore apo në strukturat e tjera të forcave të armatosura. Do të bëjë përjashtim vetëm ndonjë i moshuar, megjithëse edhe për

këta duhet të jenë të përcaktuara vendet se ku do të shkojnë në rast lufte. Dihet se ndjenjat e patriotizmit i shtyjnë gjithë njerëzit tanë të mos pyesin për moshën, por të veprojnë kudo ku janë e me të gjitha mundësitet për të dëmtuar sa më shumë armikun, pra të luftojnë për mbrojtjen e atdheut. Çështja kryesore qëndron tek organizimi i masës së madhe të komunistëve dhe të popullit, te stërvitja e tyre sistematike sot, për të qenë të zotë të luftojnë nesër, në rast se do të na imponohet një lufte nga armiqtë.

Eshtë e domosdoshme që të gjithë njerëzit tanë të përgatiten ushtarakisht, që nga nxënësit e shkollave 8-vjeçare, të mesme e studentët e universitetit e të shkollave të tjera të larta dhe deri te punonjësit e qytetit e të fshatit. Gjithë kjo masë e madhe njerëzish duhet të jetë e organizuar në formacione luftarake, ku secili të përgatitet vazhdimesht si ushtar. Në këto formacione gjithsecili duhet të mësojë si të veprojë në momente lufte, në një situatë të dhënë.

I kuptojnë si duhet organizatat e Partisë këto detyra kaq të rëndësishme që kanë të bëjnë me organizimin dhe me stërvitjen e njerëzve në repara të caktuara ushtarake? Duhet të bëhen përpjekje e të punohet që jo vetëm të kuptohen, po ajo që ka më shumë rëndësi üshtë që këto detyra të zbatohen, me qëllim që në kohë rrreziku çdo situatë të përballohet me sukses. Për t'u vlerësuar drejt situata e një lufte eventuale, kërkohet nga secili që qysh tani detyra e madhe për mbrojtjen të kuptohet politikisht dhe stërvitja të zhvillohet efektivisht, sistematikisht, në mënyrë që njerëzit të jenë të vëmendshëm dhe të disiplinuar për të përvetësuar ato

që u shpjegojnë kuadrot ushtarakë, duke jetuar e vepruar seriozisht gjatë stërvitjes, pikërisht si në kushtet e luftës së vërtetë.

Këto janë çështje të rëndësishme politike, që Partia, në radhë të parë, në terren e në ushtri, duhet t'i kuptojë thellë. Po nuk bëri Partia një punë politike dhe organizative të nivelit të lartë për mbrojtjen, atëherë dobësitet do të jenë të mëdha, gjë që është e rrezikshme, sepse armiku këtë dëshiron, të na gjejë të papërgatitur, të dobët organizativisht dhe të na godasë në besasi. Prandaj të punojmë për të edukuar te njerëzit tanë një ndërgjegje të lartë politike, me qëllim që secili të mësojë e të përgatitet si duhet edhe nga pikëpamja ushtarake.

Kur bisedon me kuadrot e ushtrisë shpeshherë dëgjon prej tyre ankesa se «komiteti i Partisë i rrethit nuk merret sa duhet me përgatitjen ushtarake të popullatës», se «ka shumë që mungojnë në stërvitje» etj. Ndërsa shokët e terrenit bëjnë autokritikë dhe thonë «kemi edhe ne përgjegjësi, por edhe kuadrot e ushtrisë kanë të meta». S'ka dyshim se të dyja palët punojnë për përgatitjen ushtarake të njerëzve, por njëkohësisht të dyja palët e kanë për detyrë të kujdesen vazhdimisht që të korrigojnë përkatësisht të metat. Komitetet e Partisë të reparteve dhe komandat kanë përgjegjësi të madhe pér organizimin dhe edukimin ushtarak të njerëzve në kuptimin e gjerë të fjalës. Derisa janë caktuar shtabe e komanda, këto duhet ta kryejnë mirë detyrën që repartet ta zhvillojnë mirë stërvitjen ushtarake. Nattyrisht, më parë është e nevojshme të stërviten vetë kuadrot drejtues të njësive që përfshijnë punonjësit

e terrenit. Kjo përgatitje të jetë ushtarake dhe politike. Komandanti, në radhë të parë, duhet të stërvitet vetë, ndryshe nuk mund të drejtojë me efektivitet stërvitjen e reparteve. Çdo njeri ka nevojë të freskojë njojuritë që ka marrë gjatë kohës së shërbimit ushtarak dhe të ndihmojë për tu pajisur vazhdimi i njohuri të reja, sidomos gjatë kohës së stërvitjes ushtarake.

Çdo komunist e ka për detyrë të punojë për ngrijtjen e cilësisë së punës ushtarake në një nivel më të lartë. Në radhë të parë, të shfrytëzohet mirë stërvitja në ditët e caktuara. Po puna nuk mbaron me kaq. Ka edhe drejtime të tjera ku duhet të shprehet kujdesi i Partisë për përgalitjen ushtarake të njerëzve tanë. Të marrim një çështje të tillë: Efktivi i një uzine zhvillon stërvitjen në reparte të caktuara. Atëherë një mëngjes mund të shkohet në këto reparte dhë të shikohet, për shembull, si mbahet armatimi, në ç'gjendje është, a mbahet pastër etj. Në rast se konstatohet që nuk është mbajtur mirë, atëherë oficeri shkon takon punëtorin e uzinës që e ka në ngarkim këtë armë dhë kërkon prej tij ta mirëmbajë. Pas këtij kontrolli, merret takim me sekretarin e organizatës-bazë të Partisë të uzinës, të cilin i thuhen konstatimet, i ngrihen problemet që dalin, si mungesa e kujdesit, nevoja e rritjes së punës politike etj., me qëllim që ai t'i shtrojë këto çështje në mbledhjen e organizatës-bazë të Partisë. Shokët e ushtrisë mund të kenë edhe të dhëna të tjera, siç janë, për shembull, mungesat në stërvitjen ushtarake, ose rastet kur disa shokë, megjithëse kanë njëfarë kulturë ushtarake dhe politike, nuk bëjnë përpjekje për të ngritur më lart nivelin e tyre politiko-ushtarak etj.; të

gjitha këto i transmetohen sekretarit të organizatës së Partisë në uzinë, i cili vepron sipas rasteve. Mund të autorizohet që të shkojë në mbledhjen e organizatës-bazë të Partisë edhe vetë oficeri, por, kur kjo nuk realizohet dot, atëherë është e mjaftueshme që këtë punë ta bëjë vetë sekretari i organizatës-bazë të Partisë të uzinës. Kështu forcohet bashkëpunimi i ushtrisë me terrenin për tò zgjidhur sa më mirë problemin e madh politiko-ideologjik dhe përgatitjen ushtarake të punonjësve tanë.

Rëndësi ka çështja që oficerët aktivë të ndiejnë përgjegjësi të plotë dhe të kenë besim te rezervistët, që e njohin artin ushtarak, se kanë mësuar që kur kanë qenë ushtarë dhe pa mësuar nuk kanë qëndruar edhe pasi kanë kryer detyrën ushtarake. E them këtë, sepse ka disa oficerë që i mundon akoma koncepti i vjetër mbi ushtrinë e kazermës, së cilës me të drejtë i kushtojnë kujdes, por këtë kujdes nuk e tregojnë për rezervistët. Mbi bazën e këtij mentaliteti ka dhe një koncept tjeter. Disa mendojnë se «ushtari në kazermë qëndron dy vjet, prandaj kemi kohë ta përgatitim». Duke u nisur nga ky koncept i gabuar, ata e marrin punën shtruar, sepse, sipas tyre, «paska kohë!». Ky mendim, që na pengon në rrugën e përgatitjes me sukses të forcave të armatosura, duhet luftuar me këmbëngulje. Prandaj të krijohet mendimi i ri për një përgatitje dhe edukim revolucionar e sistematik ushtarak. Po kush do ta bëjë këtë? S'ka dyshim se një punë të tillë duhet ta bëjë Partia, ajo e ka për detyrë të kalitë vazhdimi i shtruar e masës së ushtarëve, të ngrejë kurdoherë aftësitë e tyre ushtarako-politike, të rritë

gjithmonë nivelin e kuadrove e të shtabeve. Të gjitha forcat e popullit ushtar të jenë kurdoherë në eficiencë të plotë, në gatishmëri absolute. Kjo nuk do të thotë që njerëzit t'i mbajmë në stërvitje gjatë gjithë viti, as të bëhen lëshime, por të përdoren forma nga më të ndryshmet për edukimin politiko-ushtarak, t'i bëjmë njerëzit punëtorë të dalluar dhe këmbëngulës në zbatimin e detyrave kudo ku janë, t'u ngjallim dëshirën për t'u stërvitur vazhdimi shqiptarët dhe për të njohur e vë- në në jetë artin tonë ushtarak.

Te ne zhvillohen herë pas here stërvitje me trupa, por ka prej tyre që nuk organizohen si duhet. Në organizimin e këtyre stërvitjeve ka shfaqje pozitive, por ka edhe të atilla që nuk ecin mirë, për shkak se puna politike dhe ushtarake nuk kryhet në lartësinë e duhur. Që një lojë ushtarake të zhvillohet mirë, nuk ka vlerë që njerëzit të stërviten posaçërisht për të një apo dy muaj më parë. Kjo arrihet, kur të gjitha stërvitjet e ushtrisë bëhen në rregull, në kushte reale si ato të luf- tës. Një gjë e tillë e bën ushtarin që t'i futen në gjak kërkesat e situatës së një luste të vërtetë, kështu në një marshim ai do të arrijë të ecë 10 kilometra në orë pa ndier lodhje. Në qoftë se stërvitja gjatë viti zhvillohet dobët, atëherë ai ka për të ngelur në mes të rrugës.

Veç këtyre ka edhe disa çështje të tjera që duhen mbajtur parasysh. Gjatë zhvillimit të lojës ushtarake ndodh që nuk böhët si duhet bashkëveprimi i armëve nga ana e reparteve ushtarake, nuk bashkërendohen mirë puna politike me atë ushtarake, veprimitaria e ushtrisë me terrenin etj. Në qoftë se nuk arrihet një bashkërendim i mirë i veprimeve luftarake të këmbë-

sorisë me atë të tankeve, për shembull, armiku mund të depërtojë. Po kështu, në qoftë se veprimet luftarake të tankut nuk lidhen ngushtë me veprimtarinë e artilerisë dhe kjo e fundit me aviacionin, armiku gjen të çara dhe përparon në drejtimin e forcave tona. Po pse s'bëhen si duhet këto gjëra? Sepse, nga njëra anë, në shumë raste secili punon më vete, dhe, nga ana tjeter, ka disa koncepte të gabuara, që tregojnë se puna politike s'është në lartësinë e duhur, puna ushtarake ka të meta, taktika e vogël nuk zbatohet mirë, që të plotësojë manovrën e madhe të kohës së luftës, ka vetëkënaqësi etj. Është i gabuar koncepti se «punët i organizojmë e i kombinojmë, kur të zhvillohet loja e madhe me trupa dhe është formale të veprojmë gjatë ditëve të stërvitjes». Jo, shokë, po u lanë këto punë të kryhen vetëm gjatë një loje ushtarake, atëherë do të kemi pasoja të rënda. Po nuk u zhvillua përgatitja gjithnjë e në mënyrë të vazhdueshme, armiku të përvlon. Duhen bërë mirë stërvitjet e herëpashershme, që edhe loja ushtarake të dalë me sukses, edhe të jemi të përgatitur në rast lufte. Këto dobësi janë si për terrenin, ashtu edhe për ushtrinë.

Një komandant mund të dijë t'i hedhë mirë situatat në hartë, por ç'na duhen këto, kur një pjesë e efektivit të repartit që ai drejton vjen me voncesë në rast alarmi. Alarmi, errësimi e maskimi gjatë kohës së stërvitjes nuk bëhen kurdoherë njëloj si në kohë lufte. Kjo nuk duhet të ngjasë. Njerëzit tanë duhet të mësohen me to e të jenë të përgatitur. Prandaj të mos kapemi pas gjërrave të vogla. Të sqarohen mirë orientimet e dhëna, që njerëzit të ndihmohen në mënyrë efektive si të veprojnë në situatat që mund të krijohen.

Ne kemi në terren e në ushtri organizata partie të shëndosha dhe shumië të forta, kemi kuadro me përvojë të madhe, të ngritur politikisht, besnikë deri në fund dhe të gatshëm për mbrojtjen e atdheut. Të metat që rrjedhin për shkaqe subjektive, janë të mëta të zhvillimit, të rritjes, të ecjes përpara. Ne kemi armatime për një ushtri të madhe. Natyrisht köto armë janë jo vetëm për ushtrinë, por edhe për popullin, i cili duhet t'i marrë në dorë, të stërvitet e t'i përdorë mirë, të mësojë të qitë me përpikëri me to. Pra, faktorët objektivë ekzistojnë, na mbetet tani të forcojmë faktorin subjektiv, rolin e Partisë, punën e kuadrove të saj në ushtri e në terren.

*Etohet për herë të parë sipas shënimere të nxjerra nga protokolli i mbledhjes së organizatës-bazë të Partisë,
që gjendet në AQP*

AKADEMIA E SHKENCAVE DO TI JAPË NJË HOV TË MADH ZHVILLIMIT TË SHKENCËS SONË

*Nga biseda me anëtarët e Akademisë së Shkencave
të RPSH¹*

25 janar 1973

Më lejoni, të dashur shokë, t'ju them edhe unë vetëm pak fjalë, për arsyet se më gjatë në emër të Komitetit Qendror të Partisë dhe të të gjithë popullit ju foli shoku Hysni Kapo.

Për Partinë dhe për gjithë popullin tonë krijimi i Akademisë së Shkencave është një ngjarje historike, që do t'i japë me siguri një hov shumë më të madh se deri tash zhvillimit të shkencës sonë moderne. Them me siguri, për arsyet se ajo udhëhiqet nga marksizëm-lininizmi dhe për arsyen tjetër se në përbërjen e akademisë bëjnë pjesë shokë me vullnet të çeliktë, njerëz të qartë politikisht dhe ideologjikisht, të cilët kanë në

1. Kjo bisedë me anëtarët dhe anëtarët korrespondentë të Akademisë së Shkencave u zhvillua në njërin nga pushimet e mbledhjes së parë të Akademisë së Shkencave, në të cilën morën pjesë edhe shoku Enver Hoxha dhe udhëheqës të tjerë të Partisë e të shtetit.

zemër një dashuri të flaktë për Partinë dhe për popullin, për mbarëvajtjen dhe për përparimin e tij dhe që kanë për objekt ndërtimin e socializmit e të komunizmit në vendin tonë.

Kjo siguri qëndron në faktin se Partia, në një periudhë të shkurtër historike, duke përkrahur dhe duke afruar njerëzit përparimtarë të vendit tonë, të cilët kishin si objekt kryesor të jetës së tyre çështjen e popullit, diti që tok me ta të bënte hapat e parë në të gjithë sektorët, i vuri rëndësi punës së gjithë sektorëve dhe siguroi koordinimin e punëve midis tyre, ndryshtës nuk mund të kalohej nga një periudhë në tjetrën dhe të arrihet qëndrimi suksese. Për këtë qëllim u hapën shkolla, pa të cilat nuk mund të ecej, por edhe pa rindërtuar vendin nuk mund të kishte jetë të lulëzuar, pa bërë Reformën Agrare, pa u dhënë fshatarëve tokën, pa i ndihmuar ata me mjete pune e prodhimi, nuk mund të kishte mirëqenie në fshat, pa mëkëmbur më parë atë industri të vogël që ekzistonte, nuk mund të hidheshin bazat për një perspektivë akoma më të madhe e më të ndritur për zhvillimin industrial të vendit.

Në të gjitha këto drejtime Partia mobilizoi të tëra forcat e shëndosha të kombit dhe, me një politikë të pjetur e të urtë, ju dha edhe juve, shkencëtarëve, të gjitha mundësitë, ju mori për krahu, ju krijoj kushtet e mundshme dhe nuk gaboi në këtë politikë. Gjithë njerëzit tanë, duke përfshirë edhe inteligjencien e punonjësit shkencorë, panë te Partia Komuniste e Shqipërisë atë udhëheqëse të dashur që po u realizonte ëndrrat, që po ua materializonë ato dhe po u krijonte mundësi për të ecur me hapa të sigurt përpara, për t'i dhënë një hov

të madh zhvillimit të jetës së popullit dhe përparimit të vendit.

Për këtë qëllim Partia jonë krijoi inteligjencien e re, karakteristikë e së cilës është se ajo ka dalë nga gjiri i popullit, përfaqëson dëshirat e tij dhe lufton për t'i realizuar ato në jetë. Kjo Parti e bën inteligjencien tonë popullore të mos njohë pengesa, të kapërcëjë vështirësitë, të korrë suksese, të marrë pjesë bashkë me klasën punëtore dhe gjithë punonjësit e tjerë në ndërtimin e socializmit, të mësojë vetë, të mësojë edhe të tjerët në fryshtë e mësimeve të Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit.

Ju, të dashur shokë, që u zgjodhët në mbledhjen e parë të akademisë, jeni nga njerëzit më të shquar dhe më të respektuar të inteligjencies shqiptare. Ky respekt, që kanë për ju Partia dhe masat e popullit, është i madh, pse keni dhënë prova gjithë jetën, si me zemër, ashtu edhe me intelekt, se jeni njerëz të krijimit, të zhvillimit, që dini të zbatoni drejt vijën e Partisë, vijën e socializmit për të mirën e popullit, për sigurimin e lirisë dhe të pavarësisë së atdheut.

Shumë detyra e plane të mëdha na vihen tanë përpara, siç janë plani aktual dhe plane të tjera në perspektivë. Për këtë qëllim Komiteti Qendror i Partisë ka ngarkuar shumë nga shkencëtarët tanë, që në mënyrë të organizuar të studiojnë, dhe ata po studiojnë të gjitha burimet e vendit, me qëllim që këto t'i vënë në shfrytëzim me një veprimitari krijuese shumë më të gjerë se deri tash, për mirëqenien e popullit, për ta bërë jetën e tij gjithnjë e më të lumtur. Neve na duhet, më shumë e më mirë se gjer tanë, të punojmë e të studiojmë në këtë

rrugë. Për t'i realizuar këto detyra, Partia dhe klasa na mësojnë të kemi besim te njerëzit tanë të shkencës, t'i mbështetim ata në punën e tyre të organizuar, t'u krijojmë kushte më të përshtatshme që të jasin maksimalen në punën e tyre. Partia kërkon nga ju jo vetëm të jeni në ballë të përpjekjeve për kryerjen e këtyre detyrave dhe studimeve, po edhe për zbatimin e tyre. Përveç kësaj, ajo kërkon nga ju që të gjitha ato ç'keni përvetësuar e krijuar gjatë tërë jetës suaj për shkencën, ta keni për nder dhe si objektiv që t'ua lini trashëgim, në mënyrë sa më të qartë e sa më të rrjedhshme, edhe brezave të ardhshëm, rinisë sonë, të cilën duhet ta edukojmë me dashuri të zjarrtë për atdheun, trime, heroike, të sakrificës, po edhe të zgjuar e të mësuar. Partia si kurdoherë ka besim të madh se ju do ta kryeni me nder edhe këtë detyrë.

Partia këshillon që çdonjëri prej jush, përveç detyrave të përgjithshme, përveç nxënësve e studentëve që mësoni e që janë me qindra e mijëra nëpër klasa, nëpër institute, nëpër kantiere, të grumbullojë rreth vetes elementë të rinj nga më të shquarit, me perspektivë, të talentuar e me prirje, të cilët, brenda një kohe relativisht të shkurtër, të përvetësojnë, me ndihmën e nën drejtimin tuaj, atë dituri që një shkencëtarë të afirmuar jo vetëm në Shqipëri, por edhe jashtë, i është dashur me dhjetëra vjet për ta fituar. Në këto forma dhe në forma të tjera pune, që ju do të përdorni për këtë qëllim, të rejat e të rinxjtë tanë, që kanë përgatitje tjetër në krahasim me ne kur ishim të rinj, do të bëjnë që të arrijmë rezultatet që presim. Dhe kjo do të ndodhë me siguri, pse njerëzit e brezit të tanishëm, me kushtet që

u ka krijuar Partia, janë më të zotë, më të zgjuar e më të përgatitur. Në forma të përshtatshme, ata janë në gjendje dhe mund ta përvetësojnë shkencën ose eksperiencën e një shkencëtarit të shquar më shpejt dhe më mirë. Të kemi parasysh që kjo shkencë të mos jetë stoli, të mos jetë vetëm për ata kalër-pesë veta, që çdonjëri nga shkencëtarët tanë mund të mbajë pranë vetes, por ajo të vlefjë si një bërthamë për të rritur e për të përmirësuar cilësinë e edukimit të përgjithshëm të mbarë rinisë sonë. Mund të gjenden shumë forma pune për këtë qëllim, që vetë ju i dini më mirë nga unë. Unë kam qenë një profesor i thjeshtë, kurse ju jeni profesorë jo vetëm me titull, por edhe me vepra, me një eksperiencë jashtëzakonisht të madhe pune, prandaj jeni plotësisht në gjendje të bëni atë që kërkon Partia. Këtë rini të mrekullueshme ta armatosim sa më shpejt me shkencë e dituri, se punë të mëdha na presin përparrë.

Siq e theksoi shoku Aleks Buda, kryetari i akademisë, në fjalimin e tij të shkëlqyer, që do të mbetet edhe ai historik, siç do të mbetet historike dhe sfala e hapjes e profesorit tonë të shquar dhe të dëgjuar në botë. shokut Eqrem Çabej, akademisë do t'i vihen detyra të mëdha nga populli, Partia dhe shteti. Për bashkërendimin, organizimin dhe thellimin në këto probleme kardinale, në krye të zgjidhjes së të cilave duhet të jeni ju, Partia e Qeveria do të krijojnë një situatë të atillë, që marrëdhëni tuaja dhe të instituteve që janë nën drejtimin tuaj të drejtpërdrejtë, të krijojnë mundësi për të vendosur lidhje të atilla organike, materiale e shkencore që studimet tuaja të gjejnë vend aplikimi dhe vërtetimi në jetë, që ato të korrigohen vazhdimisht e të përmirëso-

hen. Në këtë drejtim ju do të keni tërë ndihmën e Partisë dhe të shtetit dhe ne jemi të bindur se këtë detyrë të madhe që ju ngarkohet, do ta kryeni me nder.

Më lejoni ta ngre këtë dolli për Partinë tonë të lavdishme të Punës, që na mësoi, na mëson e do të na mësojë kurdoherë si të lusojmë për popullin, për të mirën e tij, për socializmin. E ngre këtë dolli për ju, shokë të shqar akademikë të parë të vendit tonë, shkencëtarë nga më të shqarit e vendit tonë. Ju uroj jetë të gjatë dhe suksese në punë për të mirën e popullit, për të mirën dhe përparimin e shkencës sonë, e cila, siç e tha shoku Aleks Buda, jo vetëm të afirmohet në vend, por edhe jashtë, sidomos në disa drejtime, në të cilat jemi jo vetëm sot në gjendje t'i zgjidhim, por shpejt do të bëhem i më specialistë e më kompetentë edhe në drejtime të tjera. Ju uroj punë të mbarë dhe shëndet, të dashur shokë! Të na rrojë Partia bashkë me gjithë popullin!

Botuar për herë të parë në librin: Enver Hoxha, „Për shkencën (Përmbledhje veprash)“, vëll. I, f. 503

*Botohet sipas librit:
Enver Hoxha, „Për shkencën
(Përmbledhje veprash)“.
vëll. I, f. 508*

VETËM ME LUFTE POPUJT MUND TË FITOJNE LIRINE

*Nga biseda me ambasadorin e RD të Vietnamit
dhe me ambasadorin e Republikës së Vietnamit
të Jugut*

26 janar 1973

Pas përshëndetjeve, ambasadori i RD të Vietnamit e informoi shokun Enver Hoxha për marrëveshjen mbi mbarimin e luftës dhe rivendosjen e paqes në Vietnam¹. Pasi e falënderoi për këtë informacion, shoku Enver Hoxha tha:

Lufta heroike e popullit të Vietnamit ka tërhequr vëmendjen e të gjithë popujve. Kjo luftë ka rëndësi jo vetëm për popullin vietnamez, që ka bërë sakrifica të pashembullta, por për të gjithë popujt e botës që lutojnë për liri, pavarësi dhe sovranitet kombëtar.

Ne, shqiptarët, që kemi qenë vazhdimisht, për vite me radhë, me zemër e me shpirt pranë popullit të Viet-

1. Kjo marrëveshje u nënshkrua në Paris më 27 janar 1973 nga përsaqësuesit e qeverive të RD të Vietnamit, të Republikës së Vietnamit të Jugut, të SHBA-së dhe të klikës kukull të Sajgonit.

namit, ju sigurojmö se do të vazhdojmë të jemi me zemër e me shpirt me popullin tuaj.

Sikurse gjithë marksistë-leninistët, ne jemi nxënës të Leninit, i cili ka luftuar kurdoherë për të vërtetën. Lenini nuk kishte frikë kurrë nga e vërteta dhe, si revolucionar i madh që ishte, mendimin e thoshtë haptas dhe qartë para të gjithëve. Pohimi i së vërtetës ishte një nga karakteristikat e tij revolucionare. Edhe ne, si nxënës modestë të Leninit, përpinqemi ta ndjekim, të ecim në shembullin dhe sipas mësimeve të tij.

Cila është e vërteta mbi vlerën dhe rëndësinë e luftës heroike të popullit tuaj? E vërteta është se populli vietnamez ka bërë një luftë të lavdishme, për të cilën do të flasë kurdoherë historia dhe do ta kujtojnë me respekt brezat e ardhshëm të mbarë njerëzimit. Të gjithë popujt kanë luftuar e luftojnë me heroizëm për liri, pavarësi dhe sovranitet, por sipas mendimit të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe timit personal, lufta e popullit vietnamez, që u zhvillua me një rreptësi të madhe për dekada me radhë, qëndron në ballë të luftërave më të ashpra të popujve. Ajo tregon vendosmërinë e madhe të një populli trim që, ndonëse relativisht i vogël, përballoi me durim të jashtëzakonshëm vuajtjet dhe mundimet që iu imponuan nga armiqjtë. Gjithë këtë heroizëm, vendosmëri dhe sakrificë populli vietnamez i gjeti te pjekuria e mençuria, te qartësia politike që e karakterizon e te qëllimet e larta që ai vetë synonte të arrinte. Mbi Vietnamin kaluan shumë hordhi të egra. nga më barbaret, të cilat, me përjashtim të bombës atomike, përdorën të gjitha llojet e armëve moderne që kishin. Këta barbarë e dogjen, e gjakosën, por nuk e

përkulën dot popullin e Vietnamit, i cili, sa herë goditej, ngríhej pérherë e më i fuqishëm para armiqve, duke qëndruar i papërkulur si Anteu i pamposhtur i mitologjisë greke. Në luftën e tij, populli vietnamez arriti fitore të pamohueshme. Ai korri fitore të plotë kundër kolonizatorëve francezë, që ishin, gjithashtu, okupatorë të egër, por që u mposhtën në Dien Bien Fu dhe, si rrjedhim, u shporrën plotësisht nga Vietnamit. Kështu u krijua Republika Demokratike e Vietnamit, që filloi punën për ndërtimin e socializmit, por njëkohësisht u bënë përpjekje të mëdha të çlrohej edhe Jugu i Vietnamit e, më së fundi, të bashkohej i gjithë vendi.

Mirëpo, pas fitores mbi francezët, Konferanca e Gjenevës e vitit 1954 bëri një rregullim të tillë të çesh-tjes vietnameze që nuk mund të kishte rezultate, sikundër që nuk pati. Situata që u krijua atëherë ishte jo pör fajin e Vietnamit të Veriut, as të vendeve socialiste të asaj kohe, por pör faj të imperializmit botëror, me imperializmin amerikan në krye, të borgjezisë reaksionare dhc të të gjithë armiqve të tjerë. Nuk dua të zgjatem pör të treguar se si u vendos në Vietnamin e Jugut regjimi proamerikan i klikës kukull terroriste të Ngo Din Diemit dhe më pas deri tek i asaj të Thieut, sepse këtë ju e dini fare mirë. Pikërisht pör ato që i ndodhën vendit të tij, populli heroik i Vietnamit të Jugut u ngrit në këmbë dhe filloi luftën kundër armiqve. Kjo u bë në bazë të një vije politike plotësisht të drejtë, rrugë që duhet të ndjekin të gjithë popujt e shtypur të botës, të cilët duan të rrojnë të lirë, të pavarur e sovranë.

Në kushtet e krijuara, populli i Vietnamit të Veriut nuk mund të rronte i shkujdesur në një kohë kur vëlle-

zërit e tij në Vietnamin e Jugut jetonin në robëri. Prandaj mbarë populli vietnamez, në Veri dhe në Jug, bashkoi forcat për shpëtimin e atdheut. Në Vietnamin u solidarizuan të gjitha forcat marksiste-leniniste e përparrimitare të botës. Lufta e popullit vietnamez u bë kështu flamur për të gjithë, u bë flamur i tezës leniniste, sipas së cilës, imperializmi, satelitetët e tij dhe reaksiioni i brendshëm nuk ua dhurojnë kurrë popujve lirinë, pavarësinë e sovranitetin. Për t'i situar këto, popujt duhet të luftojnë vetë me armë në dorë, duke i thyer armiqëtë në fushat e betejës.

Flamurin e luftës kundër imperializmit pas Luftës së Dytë Botërore, e mbajtët ju, vietnamezët, jo me llafe, por me vepra, pa u përkulur asnjëherë nga vësh-tirësitë dhe duke bërë sakrifika të pashembullta. Ky është realiteti. Ç'tregon kjo? Kjo tregon atë mësim të madh, sipas të cilit, popujt e robëruar mund të fitojnë lirinë e humbur vetëm duke u ngritur me vendosmëri në luftë për çlirim kombëtar e shoqëror. Kjo u vërtetua edhe në luftën tuaj, me anën e së cilës ju i bëtë ballë me sukses për vite me radhë imperializmit amerikan, armikut më të egër, më barbar dhe më të armatosur të njerëzimit. Lufta juaj i shkaktoi atij një disfatë aq të madhe saqë miti i pathyeshmërisë së tij pësori një të çarë të pariparueshme, ajo theu shantazhin e bombës atomike dhe psikozën e frikës prej saj e të tmerreve që ajo mund të shkaktojë. Qëndrimi dhe lufta heroike e popullit vietnamez tronditën Ajzenhauerin, Xhonsonin, Niksonin, Hrushovin, Brezhnevkin dhe të gjitha bandat e armiqve të popujve, që tmerrohen nga luftërat revolucionare, i vunë Shtetet e Bashkuara të Amerikës para

vështirësish shumë të mëdha e të pakapërcyeshme, që, sipas mendimit tonë, po i çonin drejt disfatës së plotë në Vietnam. Kjo është e vërteta.

Megjithëse revizionistët sovjetikë, për të mos u demaskuar para opinionit publik botëror, mund t'ju kenë dhënë disa armë, luftën kundër imperializmit amerikan, kundër këtij përbindëshi, e bëtë ju, disfatën në fushën e betejës ia shkaktuat ju, prandaj edhe fitoret që u arritën ju përkasin vetëm juve. Kjo është më se e vërtetë, sepse mund t'i kesh të gjitha llojet e armëve, siç i ka imperializmi amerikan e, megjithatë, po nuk bëre luftë të drejtë, do të pësosh me siguri disfata. Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk mund të fitonin kundër jush, sepse udhëhiqeshin dhe udhëhiqen nga ideologjia e grabitësit dhe e vrasësit, kurse ne kemi ideologjinë tonë marksiste-leniniste. që synon çlirimini, pavarësinë dhe të ardhmen e lumtur të popujve të botës. Pra, ishin populli dhe komunistët vietnamezë ata që me luftë do t'i shkaktonin disfatë imperializmit amerikan dhe përkëtë ishim të bindur. Këtë të vërtetë e kemi mbrojtur me të gjitha forcat.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës meritonin disfatë të plotë në Vietnam. Ato duhej të shporreshin nga vendi juaj me kuç e me maç. siç thotë një shprehje e popullit tonë, kurse Kao Kia, Thieu dhe gjithë «ballistët» vietnamezojugorë të theynin qafën, të detyroheshin t'u hipnin vaporëve, me një fjalë, të largoheshin përfundimisht «me bisht në shalë», sepse vetëm kështu do të vendosej në Vietnamin e Jugut një qeveri me të vërtetë demokratike revolucionare. E tillë ka qenë dëshira jonë.

E donit ju një disfatë të plotë të imperializmit amerikan dhe të kukullave të tyre në Sajgon? Me siguri që e dëshironit. Si juve ashtu edhe neve na dhemb zemra për ata mijëra e mijëra vietnamezë që u vranë, për rrënimet e pashebullta që iu shkaktuan atdheut tuaj, prandaj nuk donim të shkonin kot gjithë ato sakrifica të mëdha që u bënë nga populli juaj. Pastaj fitorja e plotë dhe përfundimtare mbi këta armiq ka të bëjë me të ardhmen e Vietnamit. ajo ka rëndësi edhe për popujt e tjerë të botës.

Po për ç'arsye nuk është arritur disfata e plotë e imperializmit dhe e reaksionarëve vietnamezë, kur dëshira për një gjë të tillë ishte kaq e zjarrtë? Sipas mendimit tim, këtu kanë ndikuar qëndrimi me dy faqe dhe tradhtia e revisionistëve sovjetikë. Partia e Punës e Shqipërisë jo vetëm nuk e ka fshehur dhe nuk do ta fshehë kurrë këtë mendim, por ajo ka luftuar e do të vazhdojë të luftojë edhe kötej e tutje për ta demaskuar vazhdimisht këtë qëndrim të tyre. Personalisht nuk kam pasur rastin të bisedoj me ndonjë nga udhëheqësit kryesorë të Vietnamit të Veriut për revisionistët sovjetikë, por kam pasur mundësinë të këmbecj mendime me një nga udhëheqëset kryesore të Qeverisë Revolucionare të Përkoħshme të Republikës së Vietnamit të Jugut, me shoqen Bin¹. Në takimin që patëm së bashku, ajo më foli haptazi dhe unë, gjithashtu, i sola haptazi. Asaj i shfaqa pikëpamjen e Partisë sonë për revizio-

1. Nguyen Tin Bin, në atë kohë ministre e Punëve të Jashtme të Republikës së Vietnamit të Jugut, bëri një vizitë në vendin tonë në vitin 1972.

nistët sovjetikë, si dhe për Konferencën e Parisit. Pikëpamjen tonë për këtë konferencë nuk e kemi fshehur, shokë ambasadorë të Vietnamit. Ne kemi mbrojtur kurdoherë me të gjitha forcat dhe mundësitë tona luftën heroike të Vietnamit.

Kur thashë që nuk kam pasur rast të bisedoja me ndonjë nga udhëheqësit kryesorë të Vietnamit të Veriut për revizionistët sovjetikë, kisha parasysh dëshirën tonë për t'i vënë në dijeni edhe për veprimtarinë shumë të rrezikshme, që ata kanë zhvilluar ndaj Partisë dhe shtetit tonë. Ne i kemi vuajtur në kurriz intrigat e hrushovianëve. Besoj se ata nuk kanë qëndruar dhe as nuk do t'ua qëndrojnë kurrë ndonjëherë duarlidhur në veprimtarinë e tyre minuesë edhe ndaj jush, duke bërë presione edhe ndaj luftës së drejtë të popullit tuaj heroik për ta penguar e dobësuar atë.

Është e qartë për të gjithë se politika e revizionistëve sovjetikë është politikë imperialiste, që favorizon edhe planet amerikane. Gjersa ndjek një politikë alcance të ngushtë me imperializmin amerikan për ndarjen e botës, nuk mund të jesh kurrë për fitoren e plotë të popullit heroik të Vietnamit, në të kundërtën, duhet të jesh për likuidimin e një fitoreje të tillë. Nga kjo politikë, revizionistët sovjetikë as kanë hequr dhe as do të heqin dorë. Ata janë përpjekur vazhdimisht ta ndihmojnë dhe e kanë ndihmuar shumë fashistin Nikson për t'u tërhequr me «nder» nga lufta në Vietnam. Në këtë që po them kam parasysh gjithë politikën që kanë ndjekur dhe ndjekin kudo socialimperialistët sovjetikë.

Ne kemi menduar dhe mendojmë kështu për arsyen se sovjetikët, amerikanët dhe të gjithë reaksionarët e

tjerë kanë bërë përpjekje dhe kanë rënë në marrëveshje midis tyre për shuarjen e luftërave revolucionare kudo, për bashkekzistencë joleniniste, por hrušoviane, prandaj sot, në botë vihet re një prirje e theksuar anti-marksiste për takime e bisedime për çdo çështje. Vazhdon të jetë nijaft e përhapur pikëpamja se gjoja me anë bisedimesh midis krerësh imperialistë e revisionistë mund të zgjidhen problemet botërore dhe të vendoset për fatet e popujve. Shumë takime ka zhvilluar e përsëri do të bëjë Brezhanjevi me udhëheqës të ndryshëm të vendeve perëndimore, kështu vepron Titoja me Sadatin, kështu veprojnë udhëheqësit revisionistë polakë e të tjerë. Kudo vihet re një lëvizje e gjerë takimesh e bisedimesh, që shërbejnë për përhapjen në botë të pikëpamjeve se «imperializmi ka ndryshuar natyrën e tij agresive», se «situata në botë është qetësuar», se «imperializmi amerikan është bërë më humanitar, më pajtues» etj., etj. Të gjitha këto pikëpamje janë krijuar edhe në sajë të vijës dhe të veprimitarisë së gjithanshme tradhtare të revisionistëve hrušovianë, të Brezhanjevit etj. Në këto situata të rrëme, në këto ujëra, njerëzit që nuk mendojnë me kokën e tyre, bien lehtë; edhe luftët heroike të popullit tuaj ata nga këto pikëpamje e kanë gjykuar.

Ç'sjellin konkretisht këto pikëpamje? Këto sjellin disfatë. Ata që i përkrahin dhe i përhapin ato, thoshin se në Vietnam po derdhej gjaku kot, se imperializmi amerikan nuk mundej, se, gjersa me amerikanët po pukej edhe «vetë shteti i madh i sovjetëve», atëherë lufta e Vietnamit ishte bërë anakronike, ishte jashtë kohës që jetojmë etj., etj. Ata bünin kështu lojën e imperializ-

mit. Dukej që këto orvatje ishin një manovrim i imperializmit amerikan, sepse në të vërtetë ai ishte vënë në një krizë të rëndë politike, ekonomike dhe ushtarake. Dhe këtë krizë të rëndë atij ia kishin shkaktuar luftërat revolucionare të popujve, pra edhe lufta juaj që bënë të lindnin lëvizje të shumta dhe gjithfarë turbullirash edhe brenda Shteteve të Bashkuara. Për të dalë nga gjendja e vështirë, imperializmi amerikan u lidh edhe me bandën e Hrushovit nëpërmjet së cilës arriti të neutralizojë me sukses forcën e madhe sovjetike, e cila tani nuk është më leniniste.

Kështu si me sovjetikët, imperializmi amerikan manovroi edhe gjetkë dhe arriti disa suksese politike me karakter ndërkombëtar. Në të njëjtën kohë Niksoni përgatiste kushtet për të siguruar atë që kishte paramenduar, domethënë tërheqjen me «nder» nga Vietnami. Ai përpinqej të gënjente botën duke deklaruar se «amerikanët shkuan në Vietnam jo për ta shtypur, por për t'i dhënë liri dhe pavarësi popullit të Vietnamit të Jugut, që rrezikohej nga komunistët». Në realitet dihet se imperialistët amerikanë ndërhynë në Vietnam për të mbrojtur regjimin reaksionar të Ngo Din Diemit e deri atë të Thicut.

Sipas deklaratave tuaja, populli vietnamez do të vazhdonte luftën deri në fund. Kështu, në mars të vitit 1972, ju shpërthyet përsëri një sulm aq të fuqishëm në Vietnamin e Jugut sa i tronditët akoma edhe më shumë imperializmin amerikan. Niksonin dhe regjimin gjakatar të Sajgonit. Entuziazmi ynë për këtë sulm të gjerë u rrit më shumë dhe kishim arsyë. Nga ana taktkike dhe strategjike, na duket që e kishit zgjedhur drejt

momentin e sulmit, sepse atë e organizuat pikërisht në pragun e zhvillimit të zgjedhjeve presidenciale në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ky sulmi e rrezikonte personalisht Niksonin me një disfatë të rëndë në pragun e këtyre zgjedhjeve. Ky rrezik ishte real për të në qoftë se nuk do t'i vinin në ndihmë revizionistët sovjetikë dhe borgjezia reaksionare. Për të siguruar fitoren në këto zgjedhje, Niksoni u detyrua të bëjë lëshime në Konferencën e Parosit.

Ne, siç thashë më parë, ishim të bindur se fitorja e plotë mbi amerikanët dhe regjimin kukull të Sajgonit do të sigurohej duke i hedhur ata në det, ashtu siç hoddhët francezët si rezultat i fitores në Dien Bien Fu. Forca juaj ishte e tillë sa amerikanët nuk mund të rezistonin më tepër; ata mund të rezistonin e shumta akoma edhe një vit, gjatë të cilët Hanoin dhe Hajfongun mund t'jua shkatërronin krejt, por popullin vietnamez nuk do të arrinin ta mposhtnin. Në Vietnam imperializmi amerikan politikisht ishte i mundur, edhe ushtarakisht ai qëndronte me zor, kishte arritur, siç thotë populli, në buzë të varrit.

Pozitiv është fakti që amerikanët janë detyruar të pranojnë në marrëveshje se do të largohen plotësisht nga Vietnami i Jugut, do të çmontojnë të gjitha bazat ushtarake që kanë atje, do të heqin të gjitha minat nga ujërat territoriale, portet, gjiret dhe rrugët ujore të Vietnamit të Veriut, do të njohin pavarësinë, sovranitetin dhe integritetin tokësor të Vietnamit dhe bile të shpallin se nuk do të ndërhyjnë më në çështjen e tij. Por a do t'i respektojë këto premtimë imperializmi amerikan? Ashtu sikurse e thoni edhe ju, imperializmi është

i pabesë dhe ne jemi plotësisht dakord me këtë. Ju, gjithashtu, thoni se do të jeni vigjilentë ndaj tij. Edhe këtë drejt e thoni, sepse në marrëdhëniet me imperializmin amerikan dhe me revizionistët, që janë dinakë, pa vigjilencë nuk mund të ecet.

Sic dihet në marrëveshjen e Gjenevës të vitit 1954 Shtetet e Bashkuara të Amerikës bashkë me vendet e tjera morën përsipër të respektotonin pavarësinë e vendit tuaj, por kjo nuk i pengoi amerikanët të futeshin në Vietnamin e Jugut dhe ta shkelnin kështu zotimin që morën. Ashtu sic shkelën marrëveshjen e Gjenevës, imperialistët amerikanë mund të shkelin nesër edhe marrëveshjen e Parosit. Imperializmi është imperializëm dhe, kur ia lyp interesë, mund të futë hundët kudo pa përfillur as zërin e opinionit publik, as marrëveshjet që nënshkruan.

Në Vietnamin e Jugut tanë ka një situatë të ndërlikuar. Ashtu sic thatë edhe ju, atje ekzistojnë dy pushtete, dy qeveri dhe dy ushtri. Nga njëra anë është Qeveria Revolucionare e Përkohshme e Republikës së Vietnamit të Jugut me ushtrinë e saj të fortë, nga ana tjetër, qeveria kukull e Thieut me ushtrinë e saj.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Britania e Madhe dhe Franca njojin vetëm qeverinë e Sajgonit, të kryesuar nga Thieu. Në këto situata ne shpallim dhe përsëritim me forcë se njohim vetëm Qeverinë Revolucionare të Përkohshme të Republikës së Vietnamit të Jugut. Për këtë arsy, Partia e Punës e Shqipërisë do të vazhdojë të demaskojë me forcë klikën e Thieut, deklaratat e tij dhë të Niksonit, që pretendojnë se kanë të bëjnë vetëm me Frontin Kombëtar të Çlirimtë të Viet-

namit të Jugut dhe jo me Qeverinë Revolucionare të Përkozhshme të Republikës së Vietnamit të Jugut.

Ne mendojmë se duhet të mbështetet fuqimisht dhe botërisht Qeveria Revolucionare e Përkozhshme e Republikës së Vietnamit të Jugut, sepse ajo është një realitet dhe jo siç mendon Niksoni. Prandaj ky duhet të detyrohet t'i bëjë llogaritë pikërisht me këtë qeveri dhe jo me ushtarët e dërguar sipas marrëveshjes¹ nga kapitalistët, nga revisionistët Kadar e Gierek, që nuk përfaqësojnë luftën heroike të popullit vietnamez. Në kohën e kundërrevolucionit në Hungari, në vitin 1956, revisionisti Kadar u gjend në parlament në anën e këtij kundërrevolucioni, kurse tanë me paturpësi hiqet komunist i vendosur dhe vihet në dispozicion të vendosë «rregullin» në Vietnam me ushtarët e tij. Edhe Gierek ka qenë pjesëtar i bandës së kundërrevolucionit më 1956 në Poloni. Është ai që më vonë, në vitin 1970, urdhëroi të goditen me mitraloz punëtorët e Gdanskut dhe tanë na hiqet si komunist. Përse po i përmend këto? Sepse këto ngjarje në Hungari dhe në Poloni u zhvilluan nën ndikimin e revisionistëve sovjetikë dhe të dy këta që përmenda janë njerëzit e tyre.

Ne shqiptarët flasim vazhdimisht kundër revisionistëve sovjetikë, Hrushovit apo Brezhnjevit, sepse thë-

1. Sipas marrëveshjes së Parisit, për të kontrolluar zbatimin e saj parashikohej krijimi i tri komisioneve: Komisioni i Kontrollit Ushtarak Katërpalësh, Komisioni i Kontrollit Ushtarak Dypalësh dhe Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit dhe i Mbikëqyrjes. Ky i fundit do të përbëhej nga përsaqësuesit e katër vendeve: Polonisë, Hungarisë, Kanadasë, Indonezisë dhe do të kishte një kontingjent ushtarësh prej rreth 1 000 veta.

niet tona i kemi të bazuara. Është fakt se aktualisht revizionistët sovjetikë po i shtrijnë dorën Niksonit, janë në tratativa me të, kërkojnë kredi nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës etj. Ata formalisht mund të thonë shumë fjalë të bukura në favor të Vietnamit, por e vërteta është se, për hir të interesave të tyre të ditës, janë gati të mbyllin një sy në favor të Thieut dhe të imperialistëve amerikanë.

Në Vietnamin e Jugut nuk mund të jetohet në asnjë mënyrë me dy pushtete, atje duhet të ketë vetëm një pushtet. Për cilin pushtet jemi ne? Ne jemi për një pushtet demokratik, ku të marrin pjesë komunistë dhe patriotë, qoftë edhe budistë, por kurrë kriminelët, që vazhdimisht kanë vrarë e rrjepur popullin vietnamez dhe kanë shitur interesat e tij. Për hir «të pajtimit dhe të harmonisë kombëtare», siç thuhet në marrëveshje, as ju, as ne nuk duhet të mohojmë realitetin objektiv — luftën e klasave. Rruja jonë është krejt ndryshe nga ajo që ndjekin imperialistët amerikanë dhe Thieu.

Ne kemi bindjen se ju që bëtë luftën e armatosur dhe i detyruat amerikanët të pranojnë të kthehen andej nga erdhën, do të vazhdoni akoma të luftoni për t'i nxjerrë potkonjtë edhe kukullës së tyre, Thieut. Por veçanërisht kundër tij duhet kujdes. Të mos harrojmë luftën e klasave, shokë. Thieun ju e njihni më mirë nga ne. Ata që janë përreth tij dhe amerikanët, që mund të lënë brenda në Vietnamin e Jugut njerëz të tyre, me armatimet që u kanë dhënë e me dollarët që do t'u japin reaksionarëve të Sajgonit, kur të shikojnë se po rrezikohen dhe se ju po fitoni më tej terren (dhe ne jemi të bindur absolutisht se ju do të fitoni terren), do të

provokojnë. Thieu që tani, jo vetëm deklaroi, por po merr masa për të pushkatuar në vend të gjithë ata që «do të futen në Sajgon në mënyrë subversive». Ai deklaroi botërisht: «Ruajuni nga komunistët», «Ata do të na provokojnë». Kjo është një parapërgatitje për të formuar opinionin në favor të masave provokuese që ka ndër mend të marrë kur të humbasë terren. Atëherë Thieu me siguri do të bëjë provokacione për të shpëtuar nga situata dhe për të siguruar përkrahje nga jashtë. Përveç këtu qëndron rreziku i ndërhyrjes nga ana e amerikanëve, e Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit e të Mbikëqyerjes, e komisioneve të tjera dhe, më në fund, e «miqve» sovjetikë që do të turren gjoja për t'ju ndihmuar.

Cila është tendenca e zhvillimit perspektiv të ngjarjeve, sipas mendimit tonë?

Kjo perspektivë ka filluar të duket qysh tani. Senatorët amerikanë, sipas lajmeve që kemi lexuar, i pas-kan shkruar Komitetit Norvegjez që Niksonit t'i jepet çmimi «Nobël» i paqes. Pra, kriminelin më të madh të njerëzimit propaganda borgjeze po na e shet si mbrojtësin më të madh të paqes, si njeriun që po i ndërron faqen botës, që ka lidhur miqësi me Bashkimin Sovjetik dhe që po krijon mundësi të përmirësojë në perspektivë marrëdhëniet edhe me Kinën etj. Të tërë duaxhinjtë që i thurin Niksonit lëvdata pa kursim, lutin që ai t'u japë ndonjë ndihmë. Dhe Niksoni, ky xhelat gjakatar i popujve, do t'ua plotësojë me siguri këtë dëshirë atyre që i vënë aureolën e njeriut të paqes. Atij ia ka qejfi të paraqitet si paqësor dhe bujar, bile i pëlqen shumë të hiqet se ndihmon edhe Vietnamin.

Ne, nga ana jonë, do të ngremë zërin para opinionit publik botëror që krimineli i luftës Nikson dhe imperializmi amerikan janë të detyruar t'i paguajnë Vietnamit dëmshpërblime për luftën, ashtu sikurse gjermanët u detyruan t'u paguajnë pas Luftës së Dytë Botërore vendeve që pushtuan. (Vetëm Shqipërisë, së cilës, me gjithëse i shkaktuan dëme të mëdha, ata nuk i kanë paguar asgjë për to.) Pra ato që mendohet t'i jepin Shtetet e Bashkuara Vietnamit janë pikërisht dëmshpërblime dhe jo «ndihma» siç thonë amerikanët.

Vietnamit duhet ndihmuar me të vërtetë dhe bille fuqimisht nga miqtë e tij, të cilët do ta tregojnë veten edhe tanë se kush janë. Pavarësisht nga kjo, lufta duhet vazhduar me vendosmëri dhe kjo është e mundur, qoftë edhe duke shtrënguar rripin. Ne, siqiptarët, shumë herë e kemi shtrënguar rripin fort dhe armikut që na ka vrarë e gjakosur nuk ia kemi shtrirë kurrë dorën për ndihmë. Kjo, sipas mendimit tonë, ka rëndësi politike dhe teorike.

Ne jua themi pikëpamjen tonë haptas si marksistë-lininistë sepse e duam popullin tuaj dhe dimë që edhe ai na do. Me shokët dhe me miqtë ne nuk flasim me dorashka. Ne nuk mund të asfimojmë, as do ta themi kurrë, se Shtetet e Bashkuara të Amerikës po ndihmojnë Vietnamin për të shëruar plagët e luftës. Ne, gjithashu, nuk do të themi kurrë se Shtetet e Bashkuara të Amerikës pranuan të bëjnë paqe në Vietnam. Përkundrazi, do të pohojmë vazhdëmisht dhe me forcë se imperialistët amerikanë u thyen nga lufta heroike e popullit vietnamez dhe për këtë arsyе u detyruan të largohen nga Vietnami. Ne kurdoherë do të thérresim:

«Poshtë Thieu!», kurse, nga ana tjetër, do të brohorasim: «Rroftë Qeveria Demokratike e Vietnamit!».

Mendimi ynë është që në të tilla situata, çdo veprim yni duhet të ketë parasysh edhe interesin e lartë të revolucionit, sepse çdo lëshim në parime ka pasoja të rënda për revolucionin. Dihet se ç'dëme të rënda u ka shkaktuar popujve, marksizëm-leninizmit dhe çështjes së revolucionit tradhtia e revisionistëve sovjetikë. Të mos harrojmë se me tradhtinë revisioniste lëvizja komuniste botërorc pësoi dëme të mëdha. Megjithatë tani revolucioni po shkon përpëra, por, po të ecim duke fluturuar të themi vetëm se u arrit fitorja, nuk do të ishte e drejtë, sepse, krahas fitoreve, ka pasur edhe disfata.

Në vazhdim të bisedës shoku Enver Hoxha i pyeti ambasadorët vietnamezë për afatin 30-ditor të organizimit të konferencës ndërkombëtare, që do të garantonte përsundimin e lufiës dhe ruajtjen e paqes, për territoret e çliruara dhe përbërjen e tendencat e forcës së tretë politike në Vietnamin e Jugut. Pasi dëgjoi përgjigjet dhe i jalënderoi, shoku Enver Hoxha vazhdoi:

Ju e dini vetë, megjithatë dëshiroj t'ju shfaq këtë mendim: Në asnjë mënyrë mos lëshoni armët! Në asnjë mënyrë mos i bashkoni ushtritë, në qoftë se udhëheqja e forcave të armatosura nuk do të jetë plotësisht në duart tuaja! Në asnjë mënyrë mos u ndikoni nga revisionistët sovjetikë, sepse ata mund t'ju thonë: «Hajde, se tani askush nuk ju nget dot, Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk mund të suten më në Vietnam. Mos kini frikë edhe sikur Thieu të ketë njëzet gjeneralë në ushtrinë e bashkuar, kurse ju mund të keni vetëm një etj., sepse këtu jemi ne». Në dërrasë të kalbur mos shkelni,

shokë, ushtrinë mbajeni fort në duart tuaja, ndryshe ka rrezik të bini në katastrofë (gjë që mos ndodhtë kurrë!) dhe të detyroheni pastaj të ktheheni prapë nga e para!

Duhet përfituar edhe nga eksperienca e hidhur e të tjerëve. Në shqiptarët e përkrahëm Luftën Nacional-çlirimtare të popullit grek, të udhëhequr nga Partia Komuniste e Greqisë. Mirëpo, kur komunistët grekë u futën në ujërat e marrëveshjeve dhe dorëzuan armët, ne ramë në kundërshtim me ta, bile kundërshtimin tonë e çuam gjer te Stalini, i cili, në një takim që patëm me të, pasi na dëgjoi ne dhe komunistët grekë, tha se ne, shqiptarët, kishim të drejtë, ndërsa grekët jo, sepse kishin dorëzuar armët dhe se për të siguruar filoren atyre u duhej të fillonin luftën nga e para. Dhe kështu ndodhi, grekët e filluan prapë luftën, por në ndihmi të reaksionit grek erdhën anglezët. Lufta me reaksionin grek u zhvillua deri në kufi me Shqipërinë, ushtarët tanë lushtuan në mbrojtje të atdheut, duke mbrojtur kështu edhe partizanët grekë. U vranë nga ne, u vranë edhe nga ata. Këtë eksperiençë të hidhur që patën grekët, kurrë mos e provofshi ju, megjithatë, jemi të bindur se revisionistët sovjetikë, duke ndjekur vijën e tyre, do të përpinqen t'ju futin në këtë rrugë, se ata lutojnë që të rregullojnë për vete punët me amerikanët. Unë si shokë, miq e vëllezër që jemi, ju sola haptas e sinqerisht për sa ndiej e mendoj, sidoqoftë, siç thotë francezi, «Qomyrxhiu duhet të jetë zot në shtëpinë e tij», pra, ju veproni ashtu si mendoni vetë në vendin tuaj.

Të jeni të sigurt se Partia e Punës e Shqipërisë, Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë dhe mba-

rë populli shqiptar, si kurdoherë, në kohë të vështira
dhe në kohë të mira, do të jenë deri në fund me po-
pullin tuaj. Ne do t'ju mbështetim dhe do t'ju ndihmoj-
më me gjithçka kemi në rrugën tuaj të luftës, sepse
vetëm kjo rrugë do t'ju çojë në fitore.

Ju urojmë suksese për fitore të plotë në luftën ku-
ndër armiqve!

*Botohet për herë të parë sipas
shënimere të mbajtura në këtë
takim, që gjenden në AQP*

UNIVERSITETI — SIIKOLË E MADHE PËR PËRGATITJEN E KUADROVE DHE EDUKIMIN REVOLUCIONAR TË RINISË

*Nga biseda me rektori i Universitetit
të Tiranës¹*

27 janar 1973

Përgatitja e kuadrove në universitet ka rëndësi shumë të madhe për plotësimin e kërkesave të vendit tonë me njerëz të ditur. Ata që mësojnë në universitet duhet t'i bëjmë, në radhë të parë, kuadro të aftë nga ana politike dhe ideologjike, por të përgatiitur mirë edhe teknikisht që të jenë në gjendje të kryejnë me sukses detyrat që do t'u ngarkohen.

Universiteti ynë ka bërë përparime të mëdha, mund

1. Në këtë takim shoku Enver Hoxha dha porosi për edukimin revolucionar të rinisë në universitet në leftë kundër ndikimeve të huaja dhe për punën që duhet të bëhet atje për formimin e gjithanshëm të kuadrove të rinj. Por Agim Meroja, në atë kohë rektor i universitetit, nuk i vuri në jetë direktivat e Partisë për punën me rininë që për gabimet e tij të rënda u përjashtua nga Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH dhe nga Partia.

të themi pa u gabuar se njohuritë ideopolitike e teknike që jepen atje, në përgjithësi janë të një niveli të mirë. Universiteti i ka dhënë popullit shumë kuadro, që sot punojnë mjaft mirë në të katër anët e Shqipërisë. Ky fakt vërteton që universiteti çdo vit punon në kushte më të mira.

Preokupimi është, në radhë të parë, ngritja e cilësisë së mësimdhënies nga pedagogët dhe përvetësimi i dijeve shkencore nga studentët. Mua më duket se ky është një shqetësim i drejtë, që duhet të ekzistojë vazhdimisht. Ka ardhur koha që ky problem të shikohet me përparësi. Shumë probleme aktuale po bëhen gjithnjë e më të ndërlikuara si nga ana shoqërore dhe sidomos nga ana teknike. Prandaj zgjidhja e tyre nuk mund të jetë aq e lehtë kur nuk ka një ngritje të lartë profesionale dhe ideopolitike, veçanërisht në universitet, që është institucioni ynë shumë i rëndësishëm për përgatitjen e kuadrove të lartë.

Çështjen e kualifikimit pasuniversitar të kuadrove, Partia ka kohë që e ka ngritur. Ju bëni mirë që e merrni në diskutim këtë problem, i cili intereson shumë Partinë. Diskutimet që bëhen për këtë çështje janë të nevojshme dhe pas përfundimit të tyre duhet konkluduar e të vihen në jetë ato për të cilat do t'u vendoset. Tek intelektualët pas diskutimeve konkludimi është një çikë i zorshëm, sepse, për të arritur përfundime të drejta e të shpejta, kërkohen përpjekje, diçka më tepër nga ato të zakonshmet dhe më të organizuara, duke bërë edhe disa sakrifica, kurse punëtorët konkludojnë më shpejt.

Që të arrihet kualifikimi i kuadrove tanë, aktua-

lisht, mendoj se ka dy rrugë: ose të pranojmë mbingarkesën e disa pedagogëve (dhe kësaj nuk kemi si t'i shpëtujmë), ose disa pedagogë t'i lehtësojmë ca nga ngarkesa që kanë, për të bërë edhe kualifikimin e tyre. Pra, në kushtet tona duhet të fillohet nga puna për ta bërë këtë kualifikim dhe jo të diskutohet pa fund se cila mënyrë duhet përdorur. E theksoj këtë, se jemi të detyruar të veprojmë brenda kuadrit të gjendjes aktuale, domethënë të zhvillimit normal të universitetit lidhur me programet, kohën, eksperimentet shkencore, me tekstet. Natyrisht, të gjithë jemi dakord për domosdoshmérinë e këtyre kërkeseve, por çështja është sa punë duhet për ta arritur këtë. Me gjithë dëshirën nuk mund të merret përsipër kualifikimi i 700 pedagogëve dhe gjithë kuadrore me arsim të lartë jashtë universitetit. Prandaj, mendoj, që fillimisht, të përpinqemi për kualifikim teknik dhe arsimor të kuadrore që janë shkencëtarë dhe pedagogë të atyre degëve, për të cilat kemi nevojë të ngremë nivelin e kuadrore të ardhshëm, pra të studentëve. Që ta bëjmë këtë, duhet të zgjedhim, ta zëmë, 10 kuadro me perspektivë, të cilët, pas kualifikimit një ose dyvjeçar, këtu ose jashtë shtetit, të janë në gjendje të na përgatitin të tjerët. Kjo është një çështje organizative me rëndësi. Në qoftë se 10 vetat, që mora si shembull, nuk kanë nevojë për përgatitje të veçantë, le të merren masa menjëherë që të punojnë për kualifikimin e të tjerëve.

Këtu duhet pasur parasysh edhe ana tjetër e problemit. Të gjithë e dimë si i kanë marrë titujt shkencorë kuadrot që kemi sot. Ata që janë bërë docentë, bashkë-punëtorë të vjetër shkencorë dhe profesorë, sigurisht

janë nga njerëzit më të dalluar e më të përgatitur në punën mësimore dhe kërkimore-shkencore. Shumë prej tyre kanë bërë tekste, monografi, referate shkencore etj., mirëpo shkenca nuk ka fund dhe ata duhet të vazhdojnë të punojnë për ngritjen e tyre ideopolitike dhe tekniko-shkencore që të kryejnë ose të drejtojnë në një nivel të lartë punën mësimore dhe shkencore, që të zgjidhin dhe të përgjithësojnë nga ana teorike dhe praktike probleme të rëndësishme të ekonomisë dhe të kulturnës etj. Pra, ndaj këtyre kuadrove duhet të rriten kërkuesat, që të freskojnë më parë dijet që kanë e pastaj të përpilen të kualifikojnë kuadrot e degës së tyre. Fizikani ynë Sotir Kuneshka për një deri në dy vjet, duhet të kualifikojë disa kuadro në fushën e fizikës, por, që ta përfundojë me sukses këtë punë, më duket, se vetë ai ka nevojë t'i shtojë dituritë për disa njohuri të veçanta, për këtë qëllim është e domosdoshme që atij t'i vihen në dispozicion materiale studimi të shkencës botërore në fushën e fizikës dhe t'i jepet koha e mjaftueshme për t'i studiuar. Kjo punë nuk mund të bëhet vetveti, por duhet të organizohet mirë, gradualisht dhe jo përnjëherësh, se nuk ka mundësi. Ata kuadro që do të mendohet për kualifikim duhet të lehtësohen nga puna, le tu hiqen atyre disa orë, me kusht që të punojnë intensivisht dhe të mos thonë se nuk kanë kohë për të punuar për kualifikim. Këta njerëz duhet ta kuptojnë politikisht dhe ideologjikisht rëndësinë e madhe të kësaj detyre, prandaj, po që nevoja, për hir të interesave të atdheut, le të bëjnë më pak gjumë.

Ju ngrini çështjen se mjaft pedagogë në universitet

janë shumë të ngarkuar. Këtë fakt, ne nuk e hedhim poshtë, por mendimi im është se për të zgjidhur problemin, kërkohet kualifikimi i sa më shumë kuadrove. Kjo përbën një çështje shumë të mprehtë, prandaj është e domosdoshme që me këtë punë të merren vetë Ministria e Arsimit dhe e Kulturës dhe universiteti përtë vendosur konkretisht si do të kryhet kjo detyrë. Në çfarë fushash, sa njerëz dhe cilët do të merren me të, ç'materiale e sidomos ç'libra do të nevojiten etj. Në qoftë se do t'i futemi thellë këtij problemi, duhen parë deri edhe eksperimentimet me aparate etj. Të gjitha këto çështje të studiohen mirë që të merren masa konstruktive për edukimin e kualifikimin e pedagogëve.

Unë jam dakord me idenë që të përcaktohet me kujdes çdo gjë për shkallëzimin e drejtë të titujve shkençorë, me qëllim që ato të mos jepen në mënyrë subjektive. Nuk mund të jetë pedagog ai ose ajo, që sapo ka mbaruar shkollën e lartë. Sot, si ai që është pedagog prej disa vjetësh dhe ka kryer një kurs specializimi, edhe ai që mbahet në universitet, porsa mbaron shkollën, që të dy quhen pedagogë dhe shpërblehen njëlloj. Kjo nuk më duket me vend, sepse ne duhet ta stimulojmë punën që bëhet për kualifikimin e kuadrove. Këtu nuk është fjala për të nxitur te njerëzit egon borgjeze, por të nxitim në ta përpjekjet për progresin. Stimulimi i punës duhet konkretizuar. Kjo ide, pra, është e drejtë dhe duhet të zbatohet.

Është e nevojshme që njerëzit tanë të shkojnë edhe jashtë shtetit për specializim. Për këtë është filluar puna dhe do të vazhdojë, vetëm se atje duhen dërguar njerëz me perspektivë e të aftë, që kanë prirje dhe pasion

për të përvetësuar shkencën dhe, kur të kthehen, të jenë në gjendje ta zbatojnë në vend për një kohë të gjatë atë që ka kanë mësuar. Në caktimin e njerëzve që do të shkojnë jashtë shtetit për specializim, duhet të mbahet parasysh përvçë dashurisë dhe pasionit për shkencën edhe perspektiva, pra të zgjidhen të rinj të pasionuar që t'u shërbejnë sa më gjatë nevojave të vendit. Në caktimin e këtyre njerëzve të mos nisemi nga hatëre dhe nga shumë mbeturina që nxjerrin kokën në këto raste. Ndaj këtyre shfaqjeve të luftohet me ashpërsi.

Ju shtroni këtu çështjen e organizimit të shkollave të larta dyvjeçare te ne, gjë që duhet të studiohet nga organet kompetente sipas kushteve tona. Edhe unë jam në dijeni të eksperiencës së huaj në këtë drejtim dhe mendoj që këto shkolla janë të nevojshme edhe për ne, se kanë avantazhe. Ata që mbarojnë shkollën e mesme profesionale përgatiten për teknikë të mesëm. Më vonë do të nxjerrë krye prirja që, pasi të mbarojë dy vjet studimet e larta, i riu ose e reja të përpilen të mbarojnë edhe 2-3 vjet të tjera për të marrë diplomën e universitetit. Ne nuk i mbyllim dot me urdhër dyert e universitetit për këta të rinj, por këtë rrugë mund ta presim me anë të një trajtimi të arsyeshëm për pagën, stimujt etj. të atyre që do t'i ndjekin këto shkolla.

Vendi dhe ekonomia jonë kanë nevojë për kuadro me arsim të lartë. Ka qendra prodhimi si, për shembulli, Uzina e Mekanikës Bujqësore në Durrës, ku kam marrë vesh se janë pak inxhinierë, në një kohë kur atje duhen projektuar e prodhuar shumë makina për bujqësinë, pra,

nuk mjaftojnë dy inxhinierë mekanikë, ky numër është fare minimal. Në këtë uzinë ku ndëriohen makina duhen, gjithashtu, inxhinierë me përvojë. Partia i ka konstatuar këto mungesa. Ka raste kur jo të gjithë kuadrot janë vendosur në vendet e duhura, në ndonjë moment mund të ketë edhe *saturation*¹, prandaj sytë duhen mbajtur hapur që, duke pasur parasysh nevojat, të përgatiten aq kuadro me arsim të lartë sa nevojiten, dhe për ata sektorë ku nevojiten. Po pavarësisht nga numri i këtyre kuadrove, në industri, në bujqësi dhe përgjithësisht në ekonomi duhen mbajtur asër edhe kuadrot me arsim të mesëm.

Lidhur me shpërndarjen e kuadrove që mbarojnë universitetin, të mbahen parasysh jo vetëm nevojat e vendit, të degëve e të sektorëve të ndryshëm, por dhe aftësitë e cilësitë e tyre, të cilat duhen pasqyruar mirë në karakteristikat që u bën atyre universiteti. Këto karakteristika duhen bërë mirë, sepse në mjaft prej tyre, me gjithë porositë e orientimet e vazhdueshme të Partisë, nuk jepen ide të plota për kuadrin, duke u nisur që nga koha kur kuadri ka hyrë në universitet dhe gjersa ka mbaruar.

Karakteri i njeriut me kalimin e kohës ndryshon, prandaj, për ta studiuar atë në mënyrë sa më të plotë, duhen të dhëna të sakta, për prirjet dhe për vëçoritë e tij psikike e morale në periudha të ndryshme të jetës së tij, duke filluar që nga mosha më e re, kur vazhdon arsimin e përgjithshëm tetëvjeçar dhe të mesëm. Në të dhënrat që jepen të paraqitet drejt prirja që ka ky ose

1. Frëngjisht — ngopje, velje.

ai për këtë apo për atë punë, për këtë apo për atë vepriktari shoqërore etj. Këto të dhëna të shërbejnë si bazë për të përcaktuar se në cilën degë të shkollës së lartë duhet dërguar ky apo ai nxënës dhe jo të lihet kjo punë vetëm në dëshirën e nxënësit. Nga ana tjetër për këtë duhen marrë parasysh edhe mundësitet që kembi. Siç dihet, çdo maturant paraqet kërkesën e tij për të studiuar në sinkollën e lartë duke shënuar në të tri degë që i pëlqejnë më tepër. Por, duke plotësuar kërkesën për ndonjërin nga këto degë, nuk do të thotë se u jemi përshtatur prirjeve të studentit në qoftë se nuk jemi mështetur edhe në karakteristikën e hartuar për të nga trupi mësimor. Duke pasqyruar të dhëna sa më të sakta e të plota, atëherë mund të gjykohet se karakteristika që kanë bërë mësuesit për nxënësit, ose pedagogët për studentët janë objektive dhe se në to nuk mbisundon subjektivizmi. Kjo arrihet kur karakteristikën e bën jo vetëm një mësues ose pedagog, por shumë të tillë, bile bashkë me organizatën e rinisë. Nga mbledhja dhe analiza e drejtë e këtyre mendimeve e të dhënave të hartoherë karakteristika përfundimtare.

Edhe në shkollën borgjeze ekzistojnë këto kërkesa. Më kujtohet se kur isha mësues në Liceun e Korçës, çdo tre muaj, bënim karakteristikën për secilin nxënës. Në librat e asaj kohe gjenden shënime të tilla. Në shkollën borgjeze të vendove të ndryshme gjenden karakteristika të hartuara që në shëkullin e kaluar, mbasë edhe më përpara; atje gjenden të shkruara karakteristikat e nxënësve, që më vonë u bënë njerëz të shquar. Kështu në dokumente shkollore gjendet edhe karakter-

ristika e Napoleonit, megjithëse ai në fillim ishte një toger i thjeshtë.

Jam dakord që karakteristikat që jep universiteti duhet të mbahen parasysh nga organet kompetente për të vendosur në punë kuadrot me arsim të lartë. Por, kur gjykohet për prirjet e njërit, kur thuhet se ky meriton të jetë këtu ose atje, kjo duhet bërë me ndjenjë përgjegjësie të madhe dhe në mënyrë të organizuar mirë.

Në mbledhje të ndryshme ku marr pjesë mbaj shënimë për shokët që diskutojnë, për përshtypjet që më lë fjala e njërit apo tjetrit. Nuk përjashtoj që përshtypja ime e krijuar nga një rast i vetëm mund të jetë jo e plotë ose e gabuar, por unë, pastaj, mendimet që kam i ballafaqoj me ato të shokëve të tjerë. Këtë gjë mund ta praktikojnë të gjithë shokët e udhëheqjes në qendër dhe në bazë. Kështu, kur në sektorin e kuadrit vijnë edhe pikëpamjet e disa shokëve të tjerë për të njëtin kuadër, atëherë përshtypja ime e parë për të vërtetohet ose rrëzohet. Këtu ka disa arsyë, sepse diskutimi i mirë i shokut, që dëgjova, mund të ketë qenë edhe i rastit, mund që ai të ketë marrë kurajë ngaqë në mbledhje merrja pjesë unë, kurse herët e tjera nuk i ka ngritur problemet me guxim. Mund të ndodhë, gjithashtu, që ai të tregohet shumë i mirë e përparimitar për të fshehur disa karakteristika negative që ka. Pra, për të gjykuar kuadrin, duhet të merren shumë të dhëna dhe të dëgjohen mendimet e shumë shokëve.

Ja, për shembull, vetë ti, pasi ke qenë në ndonjë mbledhje plenumi partie në rrëth, ke sjellë ndonjëherë

në aparatin e Komitetit Qendror të Partisë mendime për ndonjë shok që ka diskutuar, duke vënë në dukje përshtypjen tënde që: ai shok ka këtë osc atë anë të shëndoshë, që politikisht e shtroi problemin shumë drejt kurse shoku tjetër nuk kritikoi me vend etj.?

Kjo punë ka rëndësi jashtëzakonisht të madhe dhe duhet bërë vazhdimisht, ndryshe si mund të argumen-ticet mendimi për punën e një kuadri të Partisë. Punonjësi i Partisë jep mendimin e tij për punën e mirë osc të dobët të një shoku, qoftë edhe për një aspekt të veçantë, nesër japid një mendim për të, në të njëjtin drejtim ose për diçka tjetër, shokë të tjerë, pra, japid mendime të reja dhe kështu ato shtohen. Mirëpo këto të dhëna duhet të shkruhen dhe të mbahen në kartoteka. Duke pasur shumë të dhëna për një njeri, atëherë kur vjen rasti për ta lëvizur në detyrë, për ta ngritur ose për ta ulur në përgjegjësi etj., rrithen mendimet e shumta dhe formohet një bindje reale për kuadrin, për anët e mira dhe për dobësitë që ka. Kjo te ne nuk bëhet gjithnjë si duhet dhe si porosit Partia. Është për këtë mungesë që bëhen gabime edhe në shpërndarjen e kuadrove.

Jam dakord për thellimin e demokracisë në universitet, por jo për demokraci formale. Të kuqtohet mirë se ku qëndron dhe çfarë është demokracia jonë e vërtetë. Ky koncept nuk formohet vetëm duke studiuar në libra, por sidomos në jetë në bazë të direktivave që jep Partia. Në udhëzimet që ka dhënë e jep Partia, ne duhet të gjejmë bazën e demokracisë sonë, që të mësojmë si ta përdorim. Demokraci, veç të tjerrave, do të thotë të shprehësh hapur atë që mendon

pra, të kesh lirinë e fjalës. Ky parim, që ka zbatuar Partia në vendin tonë, ka dhënë mjaft rezultate, por duhet punuar për ta thelluar më tej, sepse krahas guximit të shumë njerëzve, për të thënë hapur mendimet e tyre, shpesh vihet re, te disa të tjerë, njëfarë frenimi, hezitimi. Kjo është arsyjeja që Partia përpinqet të ngrejë masat, që ato të marrin pjesë aktivisht në të tëra punët e qeverisjes së vendit. Demokracia është jo vetëm e drejta për të shfaqur hapur atë çka mendon, por edhe detyrë që të pranosh një çështje për diskutim, pa u përpjekur të rrëzoshi padrejtësisht mendimet e të tjerrëve. Një qëndrim i tillë kundër zërit të tjetrit nuk bie kurrkund erë demokraci, por është autoritarizëm. Arsyen përsë ngjasin nganjëherë shfaqje të tilla, kundër demokracisë, Partia e ka shpjeguar dhe ka sqaruar edhe burimin e këtyre shfaqjeve.

Partia thotë se cilido ka të drejtë të kritikojë, me kusht që, në maskën e kritikës e të demokracisë, të mos fyejë të tjerët. Cilido duhet të jetë kërkues dhe parimore mbrojtjen e demokracisë socialiste, asnjë të mos tregohet oportunist dhe të mos kërkojë favore për vete në dëm të të drejtave të pjesëtarëve të tjerë të shoqërisë. Pa luftuar këto prirje nuk do t'i kemi krijuar kushtet për një demokraci të shëndoshië, të shprehur kudo, në të gjitha fushat e jetës. Direktivat e Partisë kanë qenë dhe janë që secili të thotë hapur e pa druajtje fjalën dhe mendimin e vet. Rrjedhimisht, edhe studentëve duhet t'u jepet më shumë e drejtë për të thënë fjalën e mendimin e tyre; ata mund dhe duhet të kritikojnë pedagogët, kështu pedagogët e studentët të kalojnë në mengenenë e krillikës reciproke dhe, në këtë rrugë, të

mësojnë çfarë është demokracia te ne, të njojin të gjitha të drejtat që kanë. Në qoftë se dekani i një fakulteti të universitetit nuk punon mirë, askush nuk e ka ndaluar organizatën-bazë të Partisë të diskutojë dhe të japë mendimin për punën e tij, bile të kërkojë që të vijnë në mbledhje të saj edhe shokë të tjera për të dëgjuar. Një gjë të tillë Partia jo vetëm nuk e ndalon, përkundrazi e përkrah. Demokracia te ne nuk është formale, ajo vepron realisht dhe duhet kuptuar drejt në përmbytje, që të ushtrohet për të mirën e përgjithshme. Po të vihet re që në zbatimin e demokracisë ka teka, ambicie, hakmarrje etj., atëherë kjo nuk është më demokraci, prandaj këtyre sjelljeve e veprimeve t'u vihet freri.

Kriteri kryesor që ndiqet te ne për zgjedhjen e njerezve është, në radhë të parë, besimi politik dhe aftësia për të kryer detyrën. Ky kriter duhet të zbatohet edhe në universitet për zgjedhjen e pedagogëve. Partia këtu duhet të punojë më shumë në drejtim të edukimit politik e ideologjik të pedagogëve dhe të studentëve. Ka disa pedagogë, që, për mungesë kapaciteti, për mungesë përgatitjeje nuk meritojnë të jenë në universitet, gjë që duhet shikuar me kujdes. Duhet luftuar mbështetja pa të drejtë e tyre, pse ky qëndrim çon në krijimin e grupeve për të përkrahur kuadrot e dobët dhe të paafte. Ata duhen lëvizur e të kalojnë për të dhënë mësim në shkollat e mesme. Kjo nuk është bërë jo se në universitet mungon kritika, as pse nuk zbatohet demokracia, por për arsyet e disa shfaqjeve të gabuara, që duhen luftuar me kujdes.

Të bëhet në universitet edhe qarkullimi i pedago-

gëve, por organizata-bazë e Partisë duhet të ketë kujdes që qarkullimi të mos bëhet nga pozita formaliste, që një pedagog të qarkullojë sa për të qarkulluar. Qarkullimi ka anën e tij pozitive sepse e freskon kuadrin, e edukon atë të mos punojë për të ruajtur kolltukun, por, në radhë të parë, për të dhënë kontributin e tij sa më efektiv nö ndërtimin e socializmit. Vënia në jetë e politikës së Partisë për qarkullimin e kuadrit në universitet duhet të rezultojë me sjelljen e njerëzve të rinj, më më tepër merita. Kur qarkullimi nuk bëhet sipas kritereve të drejta, ka pasoja negative që dëmitojnë punën, prandaj duhet parë me kujdes cili duhet të qarkullojë. Qarkullimi nuk duron burokratizëm, prandaj kur një njeri është i astë, ky duhet të caktohet të punojë atje ku jep më shumë dhe të mos bëhet një qarkullim formal. Çështja është që, para se të vendoset qarkullimi, të studiohet me kujdes nëse ka arsyë të bëhet qarkullimi në një vend pune dhe për një kuadër të caktuar. Në qoftë se ka, të bëhet, në qoftë se nuk ka, atëherë pse të bëhet një gjë e tillë?

Ndërmjet pedagogëve ka shumë elementë të mirë e të përshtatshëm, me një të kaluar të shëndoshë politike, por ata duhet të kenë edhe aftësi profesionale e shkenccore për të kryer detyrat e ngarkuara. Sigurisht, njerëzit që kemi, në universitet nuk do të shikohen symbyllur. Për këtë duhet pasur shumë kujdes. Në qoftë se dikush ka pasur një të afërm me qëndrim të keq, kurse vetë mban qëndrim të mirë dhe dënon hapur veprimtarinë e dënueshme, atëherë ai nuk mund të shikohet me përbuzje dhe as t'i mohohet puna e mirë që bën. Çështja është që organizatat e Partisë në univer-

sitet t'i böjmë luftarake në të gjitha drejtimet, kjo është e nevojshme, sepse puna e Partisë u jep tonin organizatës së rinisë dhe studentëve që janë anëtarë partie. Kam dëgjuar se në universitet ka organizata rinnie që nuk janë mbledhur për disa muaj. Nuk është aspak e lejueshme të mos mblidhet organizata e rinisë në universitet për një kohë të gjatë, ndryshe si do të edukohet rinia atje dhe si mund të mbahet ajo nën ndikimin e punës së Partisë.

Në vendin tonë për të gjithë është siguruar e drejta e punës, niveli i jetesës së masave punonjëse gjithnjë vjen duke u ngritur, prandaj nuk ka arsy e dhe nuk duhen lejuar shfaqje të parazitizmit, që, siç më kanë thënë, vërehen aty-këtu në Tiranë, sidomos në mosha të reja. Ky fenomen nuk ka bazë ekonomike te ne dhe është në kundërshtim me normat e moralit shoqëror, mirëpo ndodh sepse këta elementë janë lënë jashtë sférës së edukimit të familjes, të organizatës së pionierit, të organizatës së rinisë. A do të lejojmë të përhapen këto fenomene, që kanë filluar të nxjerrin veshët, e ka rrezik të bëhen plagë shoqërore? Jo, prandaj krahas punës së madhe edukuese dhe bindëse që duhet të zhvillojnë organizatat-bazë të rinisë dhe organizatat e pionierëve, shtëpitë e pionierëve duhet të kenë vende ku mund të venë të gjithë pionierët për t'u aktivizuar e jo të bredhin rrugëve pa kontroll. Këto masa medoemos do të merren se parandalimi i të tillë shfaqjeve është një çështje politike e organizatës së rinisë, e Frontit, e gruas. Ky problem ka rëndësi të madhe shoqërore. Ka edhe shfaqje të urryera, siç janë shpërdorimet e vjedhjet, që kryhen nga disa, kundër të cilëve duhet të

merren patjetër masa administrative e ligjore, por vetëm kështu këto mbeturina nuk mund të luftohen, prandaj të përpinqemi, para së gjithash, të edukojmë drejt masën e rinisë.

Partia i kritikon dhe përpinqet t'i ndregjë disa elementë, që kanë shfaqje në kundërshtim me moralin e shoqërisë sonë, por, megjithëkëtë, edhe në të ardhmen në rrugën tonë do të ndeshemi me shfaqje e ndikime të huaja, kundër të cilave vazhdimisht do të luftojmë pa pasur pretendime që t'i zhdukim menjëherë. Zhvillimi i vazhdueshëm i jetës dhe i vendit tonë do të kërkojnë masa të tjera të cilat, natyrisht do të diktohen nga kushtet e reja të ecjes përpara dhe mund të realizohen më shpejt e më mirë. Në disa drejtime të punës do të vihen re dhe vonesa e plogështi, mund të ketë përkëlo edhe arsyё objektive, por më shumë janë shkaqe subjektive që vijnë si refleks i rutinës, i burokratizmit etj., sëmundje këto që, siç dihet, nuk luftohen dot përnjë ditë.

Për sa i përket mungesës së disiplinës në universitetin tonë nuk ka gjëra të theksuara, megjithëkëtë nuk duhet të mbyllim sytë përpara rasteve negative. Rinia jonë është e shëndoshë, por jo e paprekshme nga ndikimet e huaja, prandaj duhet të thellohet puna në kup-timin e drejtë të raportit në mes demokracisë dhe disiplinës që, siç na mëson Partia, nuk e përjashtojnë, por janë në unitet me njëra-tjetrën.

Disa shfaqje negative janë shprehje e ndikimit të huaj që borgjezia mundohet të futë te ne nëpërmjet televizionit e rrugëve të tjera. Këtu e ka burimin, për shembull, mbajtja e leshrave të gjata nga disa të rinj.

Partia gjithmonë ka orientuar që zbatimi i vijës politike të saj është e domosdoshme të shoqërohet me masa organizative, ndryshe sukseset nuk do të jenë ato që synojmë të arrijmë. Kështu mund të veprohet edhe përkëtë çështje. Këtu kemi të bëjmë me çështje të karakterit ideologjik, që ka të bëjë me botëkuptimin e të rinjve. Në edukimin e këtyre ka rëndësi të madhe puna e organizatës së rinisë dhe sidomos e organizatës së Partisë, që duhet ta udhëheqë drejt punën e rinisë. Kjo është absolutisht e domosdoshme.

Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim, që gjenden në AQP

**PLOTËSIMI I DETYRAVE TË PLANIT MBETET
SI KURDOHIERË FRONTI KRYESOR I PUNËS
SË PARTISË DHE I MASAVE TË GJERA
PUNONJËSE TË QYTETIT DHE TË FSHATIT**

*Nga fjala e mbylljes në Plenumin e 3-të
të KQ të PPSH¹*

6 shkurt 1973

Jam dakord me raportin e me diskutimet që bënë shokët rreth problemave ekonomike që na shtrohen për të zgjidhur dhe me detyrat e propozimet që u bënë, të cilat duhet t'i thellojmë e t'i zbatojmë. Prandaj nuk do të zgjatem në ato që u thanë, por, si konkluzion, dëshiroj, në radhë të parë, të theksoj në këtë mbledhje disa çështje që lidhen me plotësimin e detyrave të planifikuarë për assortimentin e cilësinë e prodhimit, për

1. Ky Plenum që u mbodhi më 5 dhe 6 shkurt 1973 dëgjoi dhe miratoi raportin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH «Mbi plotësimin e planit të vitit 1972, detyrat kryesore për vitin 1973 dhe disa probleme për përsosjen e mëtejshme të drejtimit të ekonomisë», mbajtur nga anëtari i Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH dhe zëvendëskryetar i Këshillit të Ministrave, shoku Adil Çarçani.

furnizimin e shpërndarjen, për transportin e kontratat, të cilat përbëjnë kushte të domosdoshme në realizimin e planit të vitit 1973.

Plotësimi i detyrave të planit mbetet si kurdoherë fronti kryesor i punës së Partisë dhe i masave të gjera punonjëse të qytetit e të fshatit. Ne vazhdimisht kemi folur dhe do të flasim për këto detyra, që shprehin dinamikën e zhvillimit të të gjithë jetës sonë, të luftës për ndërtimin e socializmit. Por, kur flasim për detyrat e planit, shpesh i perceptojmë ato më të ngushta nga sa janë, më të kufizuara e të njëanshme. E kam fjalën këtu për mjaft komitete partie e organizata-bazë, për shumë organe ekonomike e shtetërore, kuadro e punonjës të degëve e të sektorëve të ndryshëm të ekonomisë që i shohin këto detyra kryesisht në shifrat globale, në volumet fizike apo të përllogaritura të prodhimit, ndërtimit, transportit, qarkullimit etj. dhe nënvleftësojnë ose lënë në harresë detyra po aq të rëndësishme e vendimtare të treguesve cilësorë dhe ekonomiko-financiarë të planifikuar ose që rrjedhin prej tyre. Nuk ka si shpjegohet ndryshe veçse me pakujdesi, nënvleftësim e cektësi kuptimi e vlerësimi të detyrave të planit, mos-plotësimi i një numri të konsiderueshëm asortimentesh të nomenklaturave të ndryshme për vitin 1972, nxjerrja akoma e disa prodhimeve me cilësi të dobët, tejkalimi i fondeve të ndërtimeve për objekte mbi dhe nën limit etj., etj.

Praktikave të tilla u duhet dhënë fund një herë e mirë, sepse të mendohet dhe të veprohet kështu, do të thotë të mos udhëhiqesh nga direktivat e Partisë, të mos i zbatosh ato me konsekuençë e vendosmëri, por

të udhëhiqesh akoma nga koncepte të ngushta e mikroborgjeze, nga gjykime të gabuara politiko-ideologjike që dëmtojnë rëndë punën tonë. Nuk mjafton të përsëritim disa herë këto që themi e të shkruajmë parulla e sloganë, por me kalem në dorë, në çdo muaj e javë, të analizojmë realizimin e detyrave, të vëmë përpara përgjegjësisë njerëzit që duhet të përgjigjen për këtë, qoftë ky shefi i sektorit, i repartit apo i kantierit, qoftë ky sekretari i Partisë apo ministri.

Disiplina e planit është një mjet i fuqishëm i Partisë, i shtetit dhe i masave punonjëse për të vënë nën një hap marshimin tonë përpara. Ai që e thyen atë, ai që e shkel, duhet ndrequr e ndëshkuar, ndryshe pengohet marshimi ynë. Kur flas për disiplinën e planit kam parasysh jo vetëm vëllimin e prodhimit, por edhe cilësinë e tij edhe koston e assortimentin, si dhe kohën në të cilën ai plotësohet dhe shpërndahet. Të gjitha këto e shumë të tjera përbëjnë atë kompleks të madh detyrash të planit, për plotësimin e të cilave duhet të mobilizohemi të gjithë.

Shpeshherë, për të justifikuar mosplotësimin e kësaj apo asaj detyre, na thuhet se plani pati mospërputhje, se nuk na erdhi në kohë furnizimi, se transporti nuk arriti që të përbushë në kohë detyrimet e tij, se në vend të kësaj detyre u realizua kjo tjetra e të tjera e të tjera. Unë jam në dijeni se të tilla gjëra ndodhin e do të ndodhin, por shtroj pyetjen: Përse ndodhin dhe si ndodhin këto? Kush duhet të mbajë përgjegjësinë për to dhe, së fundi, a mundet dhe a duhet që këto të mos ndodhin fare ose të jenë gjithmonë sa më të pakta?

Planin e vitit 1973 ne e shqyrtuam dhe e aprovuam.

U bënë për të një sërë mbledhjesh e diskutimesh, u bisuedua gjërësisht me punëtorët e kooperativistët për detyrat që ai parashikon dhe në përgjithësi u reflektuan drejt mendimet e tyre, si edhe ato të organeve drejtuese të rretheve. Pra ne kemi bindje se ky plan është real dhe i koordinuar drejt. Njëkohësisht të gjithë punonjësit gjykuani se ai është plotësisht i realizueshëm në të gjitha degët e ekonomisë dhe të kulturës. Si përfundim, pa u futur në shifrat, mund të themi se zhvillimi ekonomiko-kulturor për vitin 1973 është planifikuar drejt dhe mirë. Ai përfshin detyra të mëdha e të rëndësishme që janë vendimtare për realizimin e direktivave të Kongresit të 6-të të Partisë. Tani ne duhet t'i futemi me të gjitha forcat realizimit të tyre në çdo fushë dhe çdo njeri të mendojë për plotësimin e tejkalimin e detyrës dhe të detyrimeve të tij çdo ditë e çdo orë. Ndryshe do të krijohen shtigje për thyerjen e disiplinës së planit, për mosplotësimin e detyrave të tij. Pa një disiplinë të çeliktë, në zbatimin e detyrave të planit, ne nuk do të jemi në gjendje të mënjanojmë e të minimizojmë mosplotësimin e të gjithë treguesve tekniko-ekonomikë e finansiarë të planit për të cilët fola më sipër.

Kujdes të veçantë t'u kushtojmë asortimentit të prodhimeve dhe cilësisë së tyre. Ne nuk duhet të lejojmë që për arsyen thjesht subjektive të mos plotësojmë deri në një asortimentet e planikuara, sado të pakta e me vlera të vogla që të janë ato për prodhimin global. Asortimenti dhe cilësia e prodhimit të vihen në plan të parë, sepse ato janë në themel të qëllimit të prodhimit, përbëjnë kërkesën bazë të përdoruesit e të konsumatorit.

Të vijmë tani te zbatimi i detyrimeve kontraktuale

që rrjedhin po nga planet që ka çdo ndërmarrje e qendër pune e prodhimi. Edhe këtu, me sa më duket mua, ka akoma koncepte të ngushta, një trajtim formal e burokratik dhe aty-këtu një praktikë të huaj që shprehet me allishverishin «më jep, të jap», pavarësisht nga plani.

Ekonomia jonë socialiste është një unitet i lidhur organikisht dhe i bashkërenduar në bazë të një plani të shqyrtaar dhe të aprovuar në të gjitha hallkat e instancat përkatëse. Kjo lidhje dhe ky bashkërendim burojnë nga centralizimi i ekonomisë sonë në shërbim të ndërtimit socialist, i cili përjashton anarkinë kapitaliste, amullinë revisioniste dhe të ashtuquajturën vetëqeverisje. Si rrjedhim, çdo qelizë dhe njësi bazë e kësaj ekonomie punon, prodhon dhe shpërndan në harmoni të plotë me këtë lidhje organike, me këtë bashkërendim të planifikuar për t'ia arritur qëllimit. Çdo shhangje nga këto lidhje e bashkërendime krijon perturbacione në degë të tjera të ekonomisë, që, në një masë apo në një tjetër, ndihen në të gjithë vendin.

Ekonomia dhe shërbimet tona kulturoro-arsimore janë si një organizëm i gjallë që jeton e zhvillohet normalisht në sajë të funksionimit të rregullt të të gjitha organeve e qelizave të tij. Mjaft që njëri organ apo pjesë e trupit të mos kryejë funksionin e plotë normal të tij, që gjithë organizmi të pësojë çrrregullime, vuajtje e të sëmuret, të dëmtohet ky apo ai proces fiziologjik. Kështu duhet kuptuar edhe puna në ekonomi, kështu duhen vlerësuar në çdo kohë e vend detyrimet që rrjedhin nga planet tona e që shprehen në sistemin e kontraktiveve midis ndërmarrjeve, kooperativave dhe in-

stitucioneve të tjera. Këtej rrjedh se zbatimi me përpikëri i detyrimeve kontraktuale është pjesë e pandarë e detyrave të planit, është bile ndër më të rëndësishmet, sepse, sado që të plotësojmë mirë detyrat e prodhimit me të gjithë treguesit e tij, në qoftë se nuk zbatojmë në kohë kontratat me të gjitha kushtet e tyre, ne nuk kemi realizuar qëllimin kryesor të prodhimit material, domethënë vënien e tij në shërbim të përdoruesit e të konsumatorit.

Për sa i përket sistemit të kontraktiveve, mendoj se nuk ka ndonjë çështje që na çalon e pengon seriozisht, kurse për sa u takon kuptimit dhe vlerësimit të tij ka mjaft boshllëqe e të meta që duhen plotësuar e ndrequ. Akoma nuk po kuptohet, e në radhë të parë nga organet ekonomiko-shtetërore, se detyrimet kontraktuale për prodhimin, cilësinë, assortimentin, furnizimin, shpërndarjen, transportin, lëvizjen e mallrave e të prodhimeve etj., janë konkretizimi, materializimi dhe sanksionimi i detyrave të planit. Ngaqë nuk kuptohet kështu nga këto organe, si dhe nga vetë Partia në ndërmarrje, kooperativë dhe në rreth, as që ka një punë këmbëngulëse e të gjerë në zbatimin e tyre, nuk ka një disiplinë të rreptë në ndjekjen e plotësimin e tyre. Dhe më e keqja është se nuk luftohet me ngulm për të krijuar koncepte të drejta dhe kontratat të vlerësohen si dokumente bazë që përcaktojnë raportet e detyrimet e çdo njësie të ekonomisë ndaj së tërsës, por kërkohen e gjenden rrugë të shëmtuara të akraballëqeve, të miqësive e të njohjeve personale që të shpien në qorrashok. Jo, shokë, këtyre shfaqjeve, sado të rastit e të pakta që të jenë, u duhet dhënë goditja e duhur. U duhet

prerë rruga dhe u duhet treguar vendi atyre që i rëkomandojnë dhe i praktikojnë.

Në të njëjtën kohë Partia dhe organizatat e masave lypset t'i kushtojnë më tepër vëmendje e kujdes punës edukative dhe ideologjike për të shpjeguar bazën dhe thelbin e sistemit të kontraktive që rregullojnë marrëdhëni midis prodhuesve e përdoruesve të vlerave materiale. Të shpjegojnë mirë pasojat që rrjetet nga nönvlefësimet e shkeljet e tyre dhe të luftojnë për të rritur ndërgjegjen e përgjegjësinë personale të cilidh që ngarkohet me zbatimin e detyrimeve kontraktuale. Nuk duhet lejuar që fati i këtyre detyrimeve të zgjidhet në rrugë të shtrembër apo nga disa persona «të aftë» e «të rafinuar», por në rrugë shtetërore dhe me përgjegjësi të plotë.

Në kuadrin e kontraktive duhet të zgjidhen më mirë edhe një sërë çështjesh që kanë të bëjnë me furnizimin e prodhimit dhe të rrjetit të tregtisë me materiale, pjesë këmbimi e makineri, si dhe me mallra për treg. Është e vërtetë se, me gjithë përpjekjet e bëra në fushën e organizimit më të mirë të furnizimit, ndeshen edhe vështirësi e mungesa, si për prodhimin, ashtu edhe për furnizimin e tregut. Por, unë mendoj se në themel të këtyre mungesave dhe vonesave qëndron, në radhë të parë, thyerja e disiplinës kontraktuale, mosplotësimi në kohë, sasi, cilësi, assortiment dhe në transport i detyrimeve reciproke. Dhe këto shkelje shpesh bëhen përpara syve të organeve drejtuese ekonomiko-shtetërore dhe me dijeninë e tyre, duke mos i përdorur drejt kompetencat që kanë për shpërndarjen e mallrave e të prodhimeve të nomenklaturave përkatëse. Edhe organet

e tregtisë së jashtme duhet të punojnë më mirë për të siguruar e për të sjellë në kohë dhe me karakteristikat e kërkuaara mallrat e makineritë e kontraktuara, të mos fshihen pas frazave të përgjithshme për «vëشتirësitë e paparashikuara» që u dalin apo «ndryshimet e koniunkturave». Ashtu siç luftohet dhe djersitet në prodhim, ashtu të luftohet e të djersitet kudo e aq më tepër në ndërmarrjet e qendrat e punës që janë në shërbim e në lidhje me të.

Nuk duhen lejuar më situata të tilla si rastet që në Lushnjë apo në Lezhë ka domate e shalqi me tepricë, kurse në ndonjë qytet tjetër ndihet mungesa për ta. Nuk mund të pranohet që Uzina e Sodës Kaustike në Vlorë të pezullojë prodhimin e si pasojë të vështirësohen përpunimi i naftës, prodhimi i sapunit dhe i qelqit, për arsy se organet përkatëse nuk janë të afta të furnizojnë Uzinën e Sodës Kaustike me gurë gëlqerorë nga Kanina. Është e domosdoshme të vihen para përgjegjësisë të gjithë ata që nuk e vlerësojnë sa duhet e si duhet lëndën e drurit dhe e lënë pa transportuar atë nga pylli për muaj e vite, derisa kalbet e dëmtohet rëndë, kurse punëtorët në kombinatin e Laçit, për mungesë të lëndës së drurit, disa herë kanë pezulluar punën.

Jo vetëm të themi, por është e domosdoshme të kuptohet një herë e përgjithmonë se plani është ligj. Ai është i detyrueshëm për t'u zbatuar me përpikëri nga të gjithë, që nga Qeveria, nga komiteti ekzekutiv i këshillit popullor të rrëthit e deri në ndërmarrjet, nga personat zyrtarë dhe punëtorë. Kurrkush nuk ka të drejtë ta shkelë atë. Ndryshimet që dikton jeta, mund dhe duhet të bëhen vetëm nga ato organe kryesore të shte-

tit dhe të Partisë që e kanë aprovar planin. Janë, gjithashtu, të detyrueshme për t'u zbatuar edhe kontratat që konkretizojnë kushtet e zbatimit të planit dhe që sigojnë realizimin e tij. Asnjë ndërmarrje ekonomike që është palë kontraktuese nuk ka të drejtë të çlirohet nga detyrimi në mënyrë të njëanshme, vetëm me vullnetin e saj.

Në qoftë se një ndërmarrje nuk plotëson planin dhe kontratën sipas assortimentit, sipas cilësisë, kohës dhe të gjitha kushteve të tjera të parashikuara e të kontraktuara, kuptohet se këtu kemi të bëjmë me një faj që duhet vënë në dukje dhe duhet dënuar. Si dhe kush duhet të dënohet, si e kush do të dënojë dhe ç'dënimë do të zbatohen, kjo është një çështje që duhet parë me kujdes, por duhet parë, studiuar dhe vendosur. Unë mendoj se për mosplotësimin e detyrave të planit dhe të detyrimeve kontraktuale para ligjit duhet të përgjigjen, në radhë të parë, drejtuesit e drejtpërdrejtë të prodhimit, të ndërtimit e të shërbimit, komiteti ekzekutiv dhe ministria. Shkelje të rënda të mos lejohen që të kalojnë lehtë e vetëm me një kritikë apo vërejtje, por të zbatohen sanksione të ndjeshme morale e materiale, deri në vënien e shkaktarëve kryesorë përpara përgjegjësisë penale në rastet kur dëmi i shkaktuar ekonomisë është i madh. Punëtorët gjithashtu dhe çdo punonjës, duhet ta ndiejnë moralisht e materialisht këtë përgjegjësi, duke e lidhur më mirë pagën e punës së tyre me kryerjen e plotë të detyrës jo vetëm me sasinë, por edhe me cilësinë e me assortimentin. Në këtë kuadër organet e drejtësisë duhet t'i studiojnë më mirë problemet që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje të karakterit

civil në fushën e ekonomisë populllore. Unë mendoj se arbitrazhi i shtetit nuk mund dhe nuk duhet të zëvendësojë gjykatat në gjykimin e mosmarrëveshjeve civile, që lindin nga shkelja e detyrimeve kontraktuale.

Këto çështje të rëndësishme dhe probleme të tjera të kuptimit dhe të zbatimit me rigorozitet të hozrashotit, duke parë me kujdes sidomos ato që kanë të bëjnë me furnizimin materialo-teknik, duhen studiuar e duhen zgjidhur plotësisht, sepse zakonisht, prodhimit apo ndërtimit, mjetet financiare e materiale me plan u sigurohen, por në praktikë ndodh që, ndërsa për sigurimin e mjeteve financiare nuk krijohen pengesa, përmaterialet gjendja paraqitet më e ndërlikuar, prandaj pa siguruar mirë këto, problemet e tjera nuk mund të gjejnë zgjidhje të plotë.

Është pra e nevojshme, të formohet një komision qeveritar që gjatë vitit në vazhdim t'i studiojë këtë çështje më me hollësi dhe t'ia paraqitë Byrosë Politike për shqyrtim, sepse, me sa duket, këtu ka disa gjëra të vjetruara që s'i pranon kuadri i vrullshëm i zhvillimit të vendit dhe metodat e zgjidhjes nuk i përshtaten realitetit.

Shpesh ndodh që detyrimet kontraktuale nuk realizohen edhe për dobësitë që kemi akoma në transport. Transporti është bërë tani një hallkë e rëndësishme e ekonomisë, pa forcimin e së cilës nuk do të jemi në gjendje të zgjidhim mirë e në kohën e duhur një sërë detyrash të rëndësishme që kemi përpara.

„Që jetë ekonomike e vendit të mund të rrjedhë si lumë, — thoshte Stalini. — dhe industria e

bujqësia të kenë një nxitje për ta shtuar edhe më shumë prodhimin e tyre, duhet të kesh edhe një kusht tjetër, d.m.th. një qarkullim të gjerë të mallrave midis qytetit dhe fshatit, midis razoneve dhe krahinave të vendit, midis degëve të ndryshme të ekonomisë popullore»¹.

Në qoftë se zhvillimi i ekonomisë sonë varet deri në një farë shkalle nga zhvillimi i qarkullimit të mallrave e produkteve, që realizohen në çdo skaj të vendit tonë, ky qarkullim varet kryesisht nga transporti ynë tokësor e detar. Pra, transporti duhet organizuar e drejtuar më me kujdes dhe më mirë se deri sot. Nuk na lejohet neve të përdorim pa vend ato mjete që kemi. Nuk mund të shkohet më gjatë me shkeljen e planeve në ndërmarrje të ndryshme të transportit, sepse drejtori apo dispeçeri ka dhënë fjalën për të kryer këtë apo atë vëllim punc jashtë detyrate të planit dhe jashtë kontratave. Nuk mund të pranohet që, për paaftësi në organizimin e punës, të qarkullojnë qindra automjete bosh apo me gjysmëngarkesë në një kohë kur kontratat kryesore për mineralet tonë, për lëndën e drurit, karburantet e disa materiale ndërtimi të mos plotësohen në kohën e duhur dhe kur në Portin e Durrësit mbeten pa u transportuar 30 e 40 mijë tonë mallra të sjella me valutë nga importi.

Detyrat e mëdha që shtron plani i këtij viti kanë një rëndësi të veçantë për plotësimin e të gjithë planit të pesëvjeçarit të pestë. Ato duhen zbërthyer hollësisht.

1. J. V. Stalin, Veprat, vell. 13, f. 328.

dhe u duhen bërë të njohura Partisë e çdo punonjësi për të përçaktuar masat konkrete e të plota politike, organizative, financiare, administrative etj., që sigurojnë realizimin e plotë të tyre dhe jo një realizim në global, por zë për zë, tregues për tregues, në çdo njësi bazë, në çdo sektor e degë. Ne duhet të prodhojmë, por të prodhojmë atë që na nevojitet dhe në kohën e duhur e me veçoritë e karakteristikat e kërkua e cilësore e financiare dhe te përdoruesi t'i dërgojmë në asatin e planifikuar.

Dhe tanë dëshiroj të vë theksin mbi disa probleme të punës e të pagave. Kurdoherë që kemi marrë në shqyrtim planet vjetore apo pesëvjeçare të zhvillimit të ekonomisë e të kulturës, udhëheqjen e Partisë e kanë shqetësuar vazhdimisht çështjet e rendimentit dhe të organizimit të punës. Preokupimet në këtë drejtim shkaktohen nga kujdesi ynë për të përballuar probleme të caktuara me karakter politik, ekonomik e shoqëror, që kanë dalë nga njëra etapë në tjetrën, ose që janë parashikuar se do të dalin në të ardhmen.

Po ka vallë rritje të rendimentit të punës në ekonominë tonë? Ka, si s'ka, çdo vit e çdo pesëvjeçar. E megjithatë ne jemi të detyruar ta mbajmë kurdoherë të ngritur çështjen e rendimentit, sepse rritja e tij nuk ecën me ato ritme që na imponojnë stadi i sotëm i zhvillimit të ekonomisë, detyrat që kemi shtruar për intensifikimin e saj dhe vëmë re se kjo rritje pengohet nga disa të meta e dobësi serioze që shfaqen në organizimin e punës e të prodhimit.

Disa herë kemi theksuar se mbajtja për një kohë

të gjatë e normave të vjetra, tejkalimi i tyre pa ndonjë sforcim, mosbatimi sa duhet i normave teknike, mungesa e normave në disa sektorë e procese pune etj., kanë shkaktuar anomali të ndryshme. Në mjaft vende pune janë prishur përpjesëtimet e drejta të shpërblimit. Në disa sektorë e ndërmarrje, bile edhe në degë të ndryshme të ekonomisë, nuk ruhet më kategoria e caktuar në tabelën e pagave, duke dalë ato më pak të rëndësishme mbi ato më të rëndësishmet. Disa punëtorë marrin më shumë nga sa u takon.

Për të zhdukur disa nga anomalitë më të theksuara në fushën e normimit Byroja Politike, pas analizës që u bëri këtyre problemeve, porositi organet përkatëse që puna me norma të shtrihet në sa më shumë procese pune dhe t'i jepet prioritet zgjerimit të normave teknike në të gjitha degët e ekonomisë, me synim që brenda dy-tre vjetëve të ardhshëm normat statistikore të zëvendësohen kudo që është e mundur me norma progresive e teknike.

«Pa norma teknike, — ka thënë Stalini, — nuk mund të ketë ekonomi të planifikuar.»¹.

Prandaj normat teknike duhet të jenë baza orientuese, si për të përcaktuar masën e harxhimit të punës, ashtu edhe atë të pagesës. Lidhur me këtë i është rkomanduar Këshillit të Ministrave që të studiojë format dhe rrugët e diferencimit të shpërblimit për punën me norma teknike dhe me norma statistikore.

1. J. V. Stalin. Veprat. vëll. 14, f. 26.

Ne vendosëm në Byronë Politike, gjithashtu, që edhe në të ardhmen të mos ketë asnjo kufi në shpërblimin për tejkalimin e normave, por ama normat duhet të shtrojnë kërkesa më të forta, të jenë të mbësh-tetura teknikisht, në mënyrë që tejkalimi i tyre të mos bëhet në atë shkallë dhe me aq lehtësi, siç bëhet sot në mjaft raste. Një masë e tillë do të bëjë që punëtori të shfrytëzojë më shumë e si duhet kohën e punës, të organizojë më mirë punën dhe vandin e punës, të jetë më i disiplinuar dhe më i rregullt në punë. Si rrjedhim edhe rendimenti i punës do të jetë më i madh dhe do të rritet më shpejt, edhe në shpërblimin e në shpërndar-jen do të vendoset një kriter i drejtë me baza shkencore.

Byroja Politike i ka rekomanduar Këshillit të Ministrave që problemet e punës e të pagave, si çështje të röndësishme që kanë të bëjnë me përsosjen e mëtej-shme të marrëdhënieve socialiste të shpërndarjes, të vazhdojë t'i mbajë gjithmonë parasysh, t'i plotësojë dhe t'i thellojë më tej për të bërë rregullimet e përmirësimet e nevojshme, për të tashmen e për perspektivën. Këto rregullime e përmirësime duhet të mbështeten thellë-sisht në parimet e shëndosha marksiste-leniniste dhe të kenë si objektiv zhvillimin e vrullshëm e të harmoni-shëm të ekonomisë e të kulturës. Duke zbatuar këto parime, edhe në të ardhmen ne do të ndjekim rrugën e rritjes së pagës reale të punonjësve nëpërmjet uljes së çmimeve, megjithëse nuk përjashtojmë ndonjë ngri-tje të pagës nominale të punonjësve të kategorive të ulëta, duke u orientuar, në radhë të parë, nga nivelet e pagave të ulëta e të mesme më masive që rezultojnë në cieqët e ndryshme të ekonomisë. Por këtë duhet ta bëj-

më me kujdes, në mënyrë që prodhimi ynë, fondi i mallrave të caktuara për treg, t'i përgjigjet plotësisht fuqisë blerëse dhe të mos dëmtojë stabilitetin monetar.

Ne duhet të jemi të matur e parimore në përcaktimin e raporteve midis pagës së kategorisë më të ulët dhe asaj më të lartë, si për sot ashtu edhe për të ardhmen. Këto raporte duhet të vijnë duke u ngushtuar, relativisht, me mundësitë e zvogëlimit të kategorizimeve, si rrjedhim i një kualifikimi më të madh e më masiv të punonjësve, natyrisht duke u ruajtur nga tendenca e egalitarizmit dhe duke ruajtur stimulin e kualifikimit, të ngritjes së rendimentit, të vjetërsisë në punë, të vështirësisë në punë etj. Edhe numri i kategorizimit të vendeve të punës, në të ardhmen, duhet të vijë duke u zvogëluar, për arsyet e ngritjes së nivelit arsimor e tekniko-profesional të punëtorëve, që nga koha kur ata hyjnë për herë të parë në punë dhë gjatë procesit të ngritjes në kategori. Po kështu, pa shkuar në egalitarizëm, do të duhet të vijnë duke u zvogëluar edhe diferençat në koeficientin e pagës orare nga një kategori në tjetrën, si edhe diferençat në pagë midis punëtorëve, nga njëra anë dhe personelit inxhiniero-teknik e atij administrativ, nga ana tjetër.

Ne po luftojmë për ngritjen e vazhdueshme të mirëqenies, si në qytet edhe në fshat, dhe për ngushtimin e disnivelit ekonomiko-kulturor midis tyre. Prandaj të kemi kurdoherë parasysh që në studimin dhe në trajtimin e problemeve të pagave, bashkë me punëtorët dhe punonjësit e administratës, të përfshihen edhe kooperativistët. Kjo duhet bërë, se ne nuk mund të shkojmë me mendimin se, meqë punëtorët dhe punonjësit e qy-

tetit paguhën prej shtetit dhe përbëjnë një numër më të vogël se fshatarësia, mund të ndërmarrim veprime për përmirësimin e mëtejshëm të jetesës së tyre, pa marrë parasysh të tërë tablonë, pa i harmonizuar dhe pa i lidhur të gjitha çështjet.

Byroja Politike mendon se parimi socialist i shpërbimit -secilit sipas punës- gjen konkretizimin e drejtë në pagesën e punëtorëve sipas vendit të punës, mbështetur në kategorizimin e vendeve të punës. Që këtë lind nevoja që kategorizimet e vendeve të punës, si për punën me copë, ashtu edhe për punën me kohë, të bëhen shkencërisht dhe të azhurnohen në periudha të caktuara tok me zhvillimin dhe modernizimin e ekonomisë në përgjithësi dhe brenda degëve në veçanti. Krahas me këto, ne duhet të kemi librat e kualifikimit të punëtorëve, të cilët duhet t'u korrespondojnë kërkesave që shtrohen për kategorizimin e vendeve të punës.

Byroja Politike dha orientime që të studiohet zë-vendësimi i kategorizimit personal të punëtorëve me atestimin zyrtar kulturor e profesional të tyre¹. Kërkesat për atestimet do të bëhen në bazë të diturive që fitohen në tërë sistemin e shkollave e të kurseve që kemi krijuar. Këtë kulturë të shumanshme ne e japim jo vetëm për zhvillimin e ekonomisë socialiste, por edhe për të gjitha aktivitetet që lidhen me të. Nevojat konkrete të prodhimit nuk mund dhe nuk duhet të përjashtojnë punëtorët nga kultura teoriko-shoqërore, nga kultura që i mëson ata të organizojnë e të drejtojnë sistemin e ri socialist. pse, ndryshe, largohemi nga parimi dhe na

1. Shih në këtë vëllim shënimin e faqes 92.

krijohet kështu një kastë burokratësh e teknokratësh.

Kuptohet se problemet e pagave nuk janë vetëm probleme të rëndësishme e parimore, por edhe të lidhura ngushtë e në vartësi me plotësimin e detyrave në fushën e prodhimit material. Sado që të ekzistojnë dëshira dhe vullneti për t'i përmirësuar ato, në fund të fundit, po nuk rritëm intensivisht prodhimin material, po nuk realizuam të gjitha detyrat e planifikuara, nuk mund të realizojmë as parashikimet tona në fushën e rritjes së pagës reale dhe të rritjes së mirëqenies.

Dhe më në fund më lejoni të them diçka mbi disa probleme ekonomiko-organizative të ekonomive bujqësore.

Ideja dhe kërkesat themelore të Letrës së Komitetit Qendror të Partisë të 8 janarit 1971¹ për bujqësinë dhe më vonë të direktivave të Kongresit të 6-të të Partisë, përbëjnë thelbin e detyrave tona për t'i shndërruar ndërmarrjet dhe kooperativat bujqësore, brenda një kohe sa më të shkurtër, në ekonomi moderne të prodhimit të zgjeruar socialist. Analizat e bëra në mjaft rrethe dhe një studim i veçantë që u bë në kooperativën bujqësore të Plasës në rrethin e Korçës «Mbi disa probleme themelore ekonomiko-organizative të ekonomive bujqësore», si dhe përgjithësimet e bëra në këtë studim, trajognë se gjatë dy vjetëve të fundit janë shënuar disa hapa përpara. Këta hapa janë bërë sidomos në drejtim të përmirësimit të llogarisë, të planit, të forcimit me

1. Shih: „PPSH Dokumente Kryesore“, vël. VI, Tiranë, 1978, f. 9.

kuadro, të studimit kimiko-pedologjik të tokave etj. Megjithatë, për problemet e mëdha që lidhen me aspektin ekonomiko-organizativ të prodhimit e të punës dhe me vënien e tyre mbi baza të shëndosha shkencore, ka akoma një kuptim jo të thelluar dhe një punë të përciptë.

Një nga kërkesat themelore për vendosjen e prodhimit bujqësor mbi baza shkencore është thelli i mëtejshëm i përqendrimit dhe i specializimit të prodhimit. Në stadin e tanishëm të shoqërizimit dhe të zhvillimit të prodhimit bujqësor, veçanërisht në zonat fushore të vendit, është e domosdoshme që të përcaktohen për çdo ekonomi bujqësore, mbi baza më të studiuara e shkencore, degët kryesore të prodhimit, të cilat duhet të mbështeten më mirë, si në kërkesat e ekonomisë, të planit të shtetit, ashtu edhe në kushtet natyroro-ekonomike të terrenit. Krahas me këto, duhet të studiohen e të përcaktohen një për një degët plotësuese e ndihmëse të prodhimit, të cilat me veçoritë e tyre duhet të bashkërendohen e të harmonizohen në mënyrë e në përpjesë-time të tilla që jo vetëm të mos cenojnë e të bëhen pengesë, por përkundrazi të ndilimojnë efektivisht për zhvillimin e gjithanshëm të degëve kryesore. Roli, vendi dhe madhësitë e degëve kryesore e plotësuese nuk duhet të vendosen as në rrugë administrative, as në mënyrë spontane, siç ngjet shpeshherë, por në përputhje me kushtet konkrete të çdo ekonomie, mbi bazën e analizave e të studimeve të thella. Tani ne i kemi të gjitha mundësitë për të kryer studime të tilla me karakter ekonomiko-organizativ.

Ne duhet t'i vendosim prodhimet, në radhë të parë, në ato rrethe dhe në ato ekonomi bujqësore ku kushtet

natyrore-ekonomike janë më të përshtatshme dhe ku merren e mund të merren rendimente më të larta e me më pak shpenzime pune e prodhimi. Ne duhet të kemi ekonomi bujqësore të specializuara jo vetëm për drithë, për pambuk, për panxhar, për duhan, për perime e qu-mësht, për pemëtari ose të kombinuara midis tyre, por edhe për lulledielli, oriz, mish, vezë etj. Duke bërë një rishpörndarje më të studiuar të detyrave të prodhimit midis rrëtheve, midis kooperativave dhe brendapër-brenda tyre, në bazë të një programi të studiuar, pa u nxituar, por me hap të vendosur përpara, duhet të realizohet sa më parë rritja dhe zhvillimi në çdo ekonomi i disa degëve të prodhimit, nga njëra anë, dhe zvogëlimi dora-dorës e më në fund likuidimi i tyre në disa rrëthe apo ekonomi, nga ana tjeter. Eksperiencia tregon se degët e prodhimit të zhvilluara në përpjesëtime të vogla janë irentabël dhe për to kujdesi është i pamjaftueshëm.

Sot, kur shtrojmë nevojën e përmirësimit të plotë të bonifikimeve të bëra në fushë dhë të sistemimit si-përsaqësor të tokave, domosdoshmërinë e përcaktimit shkencor të degëve kryesore, plotësuese e ndihmëse në ekonomitë bujqësore, kur po ngremë me ritme të shpejta shkallën e mekanizmit dhe të kimizimit të bujqësisë, kur po futim gjerësisht farëra me fuqi të lartë prodhimi dhe metoda të reja shkencore në prodhim, paracak-timi i radhës së mbjelljes dhe i ndërrimit të kulturave bujqësore sipas një projekti me afat të gjatë, përbën një nga hallkat më të rëndësishme për organizimin e prodhimit bujqësor mbi baza shkencore. Ky projekt, i shoqëruar me sistemin e plehërimit, me sistemin e punimit të tokës dhe me masa të tjera agroteknike, duhet

të mbështetë në mënyrë të disiplinuar e me baza shkençore ngritjen sistematike të pjellorisë së tokave, pra shtimin e pandërprerë të rendimenteve të bimëve bujqësore. Me futjen dhë aplikimin e qarkullimeve bujqësore, të cilat duhet të janë elastike dhe të mbajnë mirë parasysh kërkuesat e ekonomisë në tërësi dhe kushtet konkrete e specifike të çdo ekonomic bujqësore, do të ngrihen në një nivel më të lartë planifikimi, organizimi dhe drejtimi shkencor i prodhimit.

Vendosjes së kulturave bujqësore dhe të llojeve të ndryshme të bagëtisë në territorin e çdo ekonomie bujqësore, është e domosdoshme t'i përgjigjen më mirë se deri sot edhe format e organizimit të prodhimit e të punës. Pas Letrës së Komitetit Qendror të 8 janarit të vitit 1971, në të gjitha ekonomitë bujqësore u morën një varg masash për krijimin e sektorëve dhe për riorganizimin e forcimin e brigadave të prodhimit. Mirëpo jo kudo janë zbatuar si duhet kriteret dhe orientimet e Komitetit Qendror për këto çështje. Në stadin e tanishëm të zhvillimit të kooperativave bujqësore duhet të kapërcehen medoemos e sa më shpejt cdhc ato kontradikta që ekzistojnë midis organizimit të prodhimit të madh bujqësor socialist, nga njëra anë, dhe formave të organizimit të punës e të prodhimit, nga ana tjeter. Sektorët e prodhimit nuk mund dhe nuk duhet të ndërtohen as mbi bazën e ish-fshatit, as mbi bazën e ish-kooperativave të vogla. Sektorët nuk kanë karakter thjesht administrativ, ata nuk mund të janë rezultat i një bashkimi mekanik të veprimtarisë së disa brigadave të prodhimit, por një unitet ekonomiko-organizativ që realizon prodhimin.

Sektorët dhe brigadat duhet të ndërtohen, në radhë

të parë, mbi bazën e vendosjes në mënyrë shkencore të prodhimit të madh socialist, pra pas një studimi të hollësishëm e në kompleks të të gjithë faktorëve ekonomikë e organizativë. Përasnje arsyet e formaliste e dogmatike ato nuk duhet të cenojnë e të dëmtojnë organizimin e drejtë e racional të proceseve teknologjike të prodhimit, sepse nuk është prodhimi që duhet t'u nënshtronhet formave organizative, por janë e duhet të jenë format organizative në funksion, në shërbim të prodhimit.

Organizimi shkencor i prodhimit bujqësor kërkon që t'u hyjmë më thellë problemeve me karakter ekonomik e organizativ. Koniteti i Partisë i Rrethit të Tiranës, duke vënë në jetë direktivat e Kongresit të 6-të të Partisë, ndërmori një studim konkret dhe nxori konkluzione e detyra të rëndësishme për zhvillimin intensiv të prodhimit bujqësor. Ky studim nuk u bë nga zyra, as nga një grup i kufizuar kuadrosh e specialistësh të bujqësisë. Për të, nën drejtimin e organizatave të Partisë, u aktivizuan dhe u tërroqën mendime nga tërë punonjësit e bujqësisë, të cilët, duke vlerësuar drejt epërsinë që kanë përqendrimi e specializimi i prodhimit bujqësor e blegtoral, profilizimi i kooperativave për prodhimet kryesore, vendosja e një strukturë shkencore të kulturave bujqësore e të degëve të tjera të prodhimit, si dhe përsosja e mëtejshme e organizimit dhe e drejimit të punës e të prodhimit, përcaktuan në mënyrë të hollësishme masat dhe detyrat për çdo njësi bazë prodhimi, si për vitin në vazhdim, ashtu edhe për vitet e tjera të pësëvjeçarit. Duke i vënë vetes detyrën për të zgjidhur më mirë se deri sot prodhimin e drithit, perimeve, qumë-

shtit, frutave, mishit dhe të vezëve, ekonomitë bujqësore të rrethit, nëpërmjet studimeve të veçanta, kanë përcaktuar edhe rrugët konkrete për realizimin e kësaj detyre.

Konkluzionet që dalin nga studimet e mësipërme duhet të shërbejnë si bazë orientuese ku mund të mbështeten Ministria e Bujqësisë, organet e bujqësisë në rrethe dhe në ekonomitë bujqësore për të studiuar e për të përcaktuar, në përputhje me kushtet e veçanta të çdo rrethi dhe ekonomie, degët kryesore e plotësuese të prodhimit, bashkërendimin e drejtë midis tyre, vendosjen racionale të strukturës së kulturave bujqësore dhe mbi këtë bazë, hartimin e qarkullimeve bujqësore, organizimin e sektorëve e të brigadave etj. Këto studime të kryhen dhe të fillojnë të zbatohen në të gjitha ndërmarrjet bujqësore dhe kooperativat e tipit të lartë deri në vjeshtën e vitit të ardhshëm dhe brenda vitit 1975 të shtrihen në të gjitha ekonomitë bujqësore të zonave fushore.

Me gjithë rritjen e prodhimit bujqësor e blegtoral, prapëseprapë në këta dy vjet janë krijuar deficite të tilla që e rëndojnë seriozisht ekonominë tonë. Prandaj marrja e një tog masash në fushën e përsosjes së organizimit e të drejtimit të prodhimit bujqësor, vendosja e tij gjithmonë e më mirë mbi baza shkencore, ndërmarrja dhe zbatimi i studimeve komplekse, kërkojnë nga organet e Partisë e të pushtetit një punë të gjerë e sistematike, këmbëngulëse e të kualifikuar për të thyer rutinën dhe empirizmin në të gjitha drejtimet, për t'i ngritur sa më shpejt ekonomikisht dhe organizativisht ndërmarrjet dhe kooperativat bujqësore në një nivel më të lartë, në

mënyrë që të krijohen kushte dhe mundësi sa më të gjera për plotësimin dhe tejkalimin e planit të prodhimeve bujqësore e blegtorale në të gjithë zërat.

T'i përvishemi pra punës, të mobilizojmë të gjitha energjitet e mundësítë tonë për të realizuar me sukses të plotë planin e vitit 1973.

Shokë,

Byroja Politike më ka ngarkuar t'i parashtroj për diskutim këtij Plenumi propozimin për shtimin e një sekretari tjetër të Komitetit Qendror. Ky propozim ka lindur nga nevoja se dy nga sekretarët e Komitetit Qendror, shokët Hysni Kapo e Haki Toska, janë shumië të ngarkuar me punë.

Kjo masë është e domosdoshme të merret edhe për një arsyet tjetër të rëndësishme. Partia, në përgjithësi, duhet të ketë kujdes për shëndetin e gjithë anëtarëve të saj, po në mënyrë të veçantë ajo duhet të ketë kujdes për udhëheqësit, sidomos për ata, të cilëve është duke u kaluar mosha. Sigurisht, nuk ka asnjë shok partie, ca më tepër kur këta janë anëtarë të Plenomit të Komitetit Qendror, që edhe i kaluar nga mosha të jetë, të dëshirojë të lehtësohet nga punët e Partisë. Mirëpo vjen një kohë që në ngarkesën e sëcilit nga ne duhet të vihet një kufi, pse Partia dëshiron që shokët të rrojnë sa më shumë, me qëllim që t'i shërbejnë asaj dhe popullit për një periudhë kohe sa më të gjatë. Propozimi për lehtësimin e ngarkesës së dy shokëve që përmenda, ka lidhje, pra, edhe me arsyen e dytë. Kjo që po them, mund të bëhet,

kur shihet nevoja për arsyen se Partia ka përgatitur një mori kuadrosh, i ka edukuar, i ka ngritur dhe këta, në punë dhe në luftë për zbatimin e vijës së Partisë, kanë fituar një eksperiencë të madhe. Partia dhe ne, udhëheqësit e saj, e kemi për detyrë t'u hapim kuadrove çdo ditë e më tepër horizonte dhe perspektiva pune. Kjo do të thotë që ne duhet t'i ndihmojmë ata vazhdimisht që të bëhen udhëheqës të aftë për të marrë përsipër përgjegjësi të plotë. Kjo do të thotë, gjithashtu, që kuadrot, brenda vijës së Partisë, të mendojnë me kokën e tyre, të bëhen të guximshëm dhe për shumë probleme të marrin vendime vetë, brenda parimit të kolegjalitetit.

Me këtë rast, theksoj se është e nevojshme të mbahet kurdoherë parasysh se ashtu si kuadrot më të lartë duhet të vënë në korent dhe të ndihmojnë vartësit e tyre për detyrat që duhet të kryejnë, edhe vartësit të mbajnë në korent eprorët për punën që kanë bërë për zgjidhjen e problemeve. Kjo nuk duhet kuptuar në asnjë rast që vartësit t'u raportojnë eprorëve çikërrima, probleme të vogla, të cilat duhet t'i zgjidhin me përgjegjësi ata që janë ngarkuar me këto punë. Sa më lart që të kalohet në udhëheqje dhe në përgjegjësi, aq më shumë lind nevoja e thellimit në problemet kapitale dhe heqja dorë nga çikërrimat.

Duhen bërë përpjekje nga vartësit që çështjet, për të cilat kërkohet ndihmë e bashkëpunim, si edhe ato për të cilat kërkohet të merren vendime, të jenë të përgatitura mirë e koncize, prandaj nga cilido kuadër dhe i çfarëdo kategoric që të jetë ky, të hiqet dorë nga ai lumë i pambaruar e i lodhshëm fjalësh e materialesh që u hanë kohë eprorëve të tyre.

Natyrisht, këto që po them përbëjnë çështje të metodës dhe të stilit në punën e Partisë dhe të organeve shtetërore që Partia kurdoherë i ka trajtuar dhe do të vazhdojë t'i ngrejë edhe në të ardhmen. Stili dhe metoda jonë e punës kanë ardhur duke u përsosur gjithnjë e më shumë. Megjithatë, na mbetet akoma shumë për të bërë. Stili dhe metoda jonë e punës nuk përsosen më tej, në rast se gjithsecili nuk mendon thellë për vendosjen e një regjimi pune sa më të përshtatshëm për kryerjen sa më shpejt, sa më mirë dhe sa më pastër të detyrave që i janë ngarkuar, për marrjen e mendimeve dhe për sqarimin e ndihmësve që secili ka në varësi, si dhe për kontrollin e punës së tyre. Kjo është një detyrë e përditshme që shërben për mbarëvajtjen e punës, njëko-hësisht edhe për ruajtjen e shëndetit të shokëve. Kjo shërben natyrisht edhe për të fituar kohë, e cila nuk duhet të humbasë duke bërë punë që duhet t'i kryejnë të tjerët, vartësit. Është e domosdoshme që koha të shfrytëzohet më tepër për thellimin në problemet e mëdha që na vihen përpara për të zgjidhur, qoftë neve këtu, udhëheqjes kryesore, qoftë shokëve të bazës, bile deri edhe te punëtorët e thjeshtë. Që të gjithë në sferën e punës së tyre e kanë për detyrë të reflektojnë, sepse edhe në punët me horizonte më të ngushta ekzistojnë kurdoherë çështje të rëndësishme dhe më pak të rëndësishme, çështje për të cilat duhet thelluar më shumë, si dhe çështje të rutinës.

Për problemen që preka më lart, Byroja Politike propozon të diskutohet kandidatura e shokut Petro Dode për sekretar të Komitetit Qendror. Atë e njohim të gjithë, prandaj mendoj se nuk üshtë nevoja t'i bëjmë

biografinë si anëtar partie, si pjesëmarrës i Luftës Nacionalçlirimtare dhe më vonë si udhëheqës partie. Shoku Petro kurdoherë ka luftuar dhe ka punuar mirë, me vullnet, me kurajë dhe me kompetencë, në rrugën marksiste-leniniste, ai është treguar vazhdimisht besnik i vi-jës së Partisë.

Dëshiroj tani të theksoj, vetëm për informim, sektorët për të cilët është menduar të punojë shoku Petro Dode si sekretar i Komitetit Qendror. Sektori kryesor me të cilin do të ketë të bëjë ai është sektori i bujqësisë. Atij do t'i ngarkohen, gjithashitu, edhe disa sektorë të tjera ekonomikë. Veçanërisht për çështjet e bujqësisë të gjithë e dimë se shoku Petro ka punuar për një kohë të gjatë në Komisionin e Planit të Shtetit e është marrë edhe si sekretar i parë i komitetit të Partisë atje ku është dërguar dhe është treguar i aftë. Ai i kupton mirë detyrat që i ngarkohen, prandaj kemi bindjen se edhe detyrën e re do ta kryejë. Shoku Petro Dode me eksperiencën e tij të gjatë në bazë do të na japë një ndihmë të madhe në këto drejtime neve, sekretarëve të tjera të Komitetit Qendror. Edhe ne, nga ana jonë, me sa të na jetë e mundur, do ta ndihmojmë atë vazhdimisht në detyrat që do t'i caktohen.

Tani le të hidhemi në një çështje tjetër.

Byroja Politike propozon që gjatë këtij viti të bëhen dy mbledhje të Plenumit të Komitetit Qendror të Partisë. Nëse do të jetë dakord Plenumi, mbledhja e parë është menduar të bëhet nga muaji qershor, duke pasur për rend dite thellimin e luftës ideologjike të Partisë kundër shfaqjeve të huaja, në art e në letërsi e në fusha

të tjera dhë në edukimin ideoestetik të njerëzve dhe mbledhja e dytë parashikohet aty nga fundi i vitit për hartimin e Kushtetutës së re.

Para se të përfundoj, dëshiroj të them që tash disa mendime për mbledhjen e parë të Plenumit të Komitetit Qendror që do të bëjmë në muajin qershor.

Siq e konstatuam, ky Plenum i Komitetit Qendror kishte për qëllim diskutimin e problemeve ekonomike që na shtrohen përpara për të zgjidhur. Këto probleme neve nuk do të na pengonin, në rast se do të dëshironim të merrnim në studim edhe disa probleme të tjera të karakterit kulturor dhe shoqëror. Por, menduam, siç propozuam e vendosëm, që të bëjmë një mbledhje tjetër të posaçme për këto çështje, me qëllim që ato t'i theullojme më tej.

Sot unë dëshiroj të theksoj disa detyra të domosdoshme që duhet të kryejmë, përpara se të vijmë në atë mbledhje plenare të Komitetit Qendror. Do të ishte krejt e pamjaftueshme që në Plenum shokët të vinin me nga një diskutim stereotip në xhep, me fraza tingëlluese dhe me numërim faktesh e ndodhish.

Sigurisht fakte e ndodhi, të mira dhe të këqija, mund të ketë shumë e nuk është keq që ato të sillen këtu, por nuk do të jetë i mjaftë numërimi i tyre. Në radhë të parë, ne duhet të gjejmë shkakun dhe arsyen e atyre anëve të këqija që shfaqen në shoqërinë tonë. Por edhe kjo nuk do të jetë e mjaftueshme, në rast se lufta nuk bëhet konkrete, e gjallë, revolucionare nga Partia, nga rinia, nga klasa punëtore dhe nga gratë, personalisht nga ne si komunistë dhe si udhëheqës, si shokë dhe si prindër. Dhe disa shfaqje të këqija veçanërisht në rini,

janë bërë shqetësuese, bile shumë shqetësuese. Ne nuk mund të futim gjithë rininë tonë heroike dhe të pastër në radhët e atij numri të rinjsh që bartin të tilla shfaqje të këqija, por të parët nuk duhet të na bëjnë të harrojmë të dytët.

C'janë këto shfaqje? Shkurtimisht po i them: vjedhja e xhepave, arroganca prej keqbërësish, gjeste të hapëta rrugaçërie nëpër rrugë e vende publike, indisiplinime nëpër shkolla, djem në numër të madh me leshra të gjata si të grave dhe gra e vajza tonë të ngjyrosura, duke qëndruar në mënyrë të pahijshme nëpër kafe përparrë gotave të konjakut, me cigare në gojë e këmbën mbi këmbë. Mjerisht, në mes të të tillë të rinjve ka djem e vajza të shokëve komunistë, djem e vajza të punëtorëve.

A mund të mos shqetësohet Partia për këto ndodhi të këqija që disa elementë pretendojnë sikur kjo na qenka kërkesa e jetës, kërkesa e demokracisë? Midis tyre ka edhe të tillë rrufjanë politikë, të cilët me ndërgjegje duan ta minojnë atmosferën e shëndoshë moral-politike të vendit përparrë rrëthimit agresiv imperialisto-revizonist. Këtyre ne duhet t'u thyejmë brinjët, pse këta janë armiqjtë më të egër e më dinakë të Partisë, të vijës së saj, të socializmit. Ndaj tyre s'duhet të kemi mëshirë, po t'i zbulojmë dhe t'i ndëshkojmë hapur, pa druajtje, pa frikë, se këta shkelin demokracinë tonë proletare. Partia nuk mund të lejojë të degjenerohet rinia nën parullat false të demokracisë dhe me luksurën¹ kapitalisto-revizoniste të literaturës e të artit gjoja flakë-

1. Nga frëngjishtja — shtiturje, degjenerim.

rues për të mbytur rininë tonë në llumin e pervertimit¹. Jo! Partia dhe populli nuk do të lejojnë kurrë që disa vagabondë modernistë të komprometojnë të tashmen dhe të ardhmen, që po ndërtohet me gjak e me djersë.

Ndërsa këtyre ne duhet t'u japim grushtin e rëndë, disa të rinj, që kanë filluar t'u pëlqejnë këto vese të këqija, sa nuk është vonë, na bie detyra t'i edukojmë dhe t'i sjellim në rrugë të drejtë. Të mos lëmë kurrsesi, shokë, që një mollë e krimbur të na prishi gjithë shportën me kokrra të kuqe, të pastra e të bukura.

Pse na ngjasin këto gjëra? Nuk do të zgjatem për të bërë sot një analizë të hollësishme, por ne duhet të reflektojmë thellë në çështjen nëse e bëjmë mirë punën tonë edukative, politike, morale dhe ideologjike me njërezit? Unë mendoj se po të thellohem si marksistë që jemi dhe po t'i bëjmë një analizë kritike kësaj pune, do të afirmojmë se kemi shumë boshllëqe në këto çështje kaq të rëndësishme.

Me gjithë punën e madhe që bën Partia për revolucionarizmin e gjithë jetës së vendit, në shumë drejtime ka neglizhenca të theksuara, interesohemi seriozisht për problemet ekonomike, po harrojmë problemet e imprehta moralo-politike, flasim për demokracinë e vërtetë dhe lejojmë që nën këtë maskë të zhvillohen gjëra të këqija, flasim për zhvillimin realist të jetës kulturore, po lejojmë të zhvillohen para syve tanë «etika» borgjeze nga vagabondë, flasim për një jetë plot dinjitet, për një jetë të kulturuar socialiste, duke luftuar si konservatorizmin ashtu edhe liberalizmin dhe nga ana

1. Nga frëngjishtja — korruptim, çoroditje.

tjetër lejojmë njerëz të çoroditur e konservatorë që të kthehen tek e kaluara, ose lejojmë elementë liberalë të rrezikshëm që, nën maskën e luftës gjoja kundër konservatorizmit, të luftojnë vijën e drejtë të Partisë dhe të na propagandojnë jetën e shthurur të shoqërisë kapitaliste.

Partia dhe njerëzit e saj duhet të lejojnë vallë të tilla lëshime të rrezikshme? Krahas këtyre problemeve të mëdha, shokë, na lejohet vallë të vëmë përballë tyre nga rëndësia realizimin ose jo të planit në një fabrikë tullash? Planet i realizojnë njerëzit të udhëhequr nga Partia dhe ata i realizojnë ato mirë ose keq, kur janë edukuar mirë ose keq prej saj.

Partia është e fortë, pse është me popullin dhe për popullin. Në qoftë se fjala e drejtë e Partisë nuk kuptohet mirë, nuk përqafohet dhe nuk zbatohet nga populli, asgjë nuk mund të na ecë mirë. Në rast se Partia nuk është në pararojë në mënyrë të organizuar, në rast se komunistët nuk janë në pararojë për të zbatuar më së miri çdo gjë që na mëson Partia, atëherë asgjë nuk do të na ecë mirë. Gjithashtu, në rast se Partia, nën shembullin dhe nën drejtimin e saj, nuk i hedh si duhet në luftë dhe në mënyrë të organizuar të gjitha organizatat e masave, leva të saj dhe këto të punojnë për të edukuar me punë e në luftë çdo individ, që të jetojë në rrugën e Partisë, atëherë asgjë nuk do të na ecë mirë.

A e bëjmë ashtu si duhet gjithë këtë punë? Pa errësuar sukseset, në mënyrë kritike, duhet të njohim se kemi të meta në këto drejtime. Partia ngarkohet me përgjegjësi, në radhë të parë, për këto që ngjasin dhe Partinë të mos e shikojmë në hava, prandaj personalisht

ngarkohemi me përgjegjësi ne komunistët për disa shfaqje të shëmtuara që duken në shoqërinë tonë. Ne ngarkohemi me përgjegjësi të madhe kur ndonjë nga familjet tona s'ka harmoni, kur shohim që prindërit lihen pas dore në kohën e pleyberisë. Ngarkohemi me përgjegjësi kur kalanët marrin rrugë të shtrembër dhe, megjithëse prindërit i shohin që nuk mësojnë, që hyjnë e dalin në shtëpi me flokë deri në supç, i shohin të pinë cigare apo të përdorin rrugë të padrejta për të kënaqur tekat dhe akoma më keq të vjedhin, nuk reagojnë, por ka dhe prindëri të atillë që, si pa gjë të keq, edhe pse është komunist thotë: «S'kam ç'u bëj, le t'i futë në burg shteti». Çfarë zgjidhje e tmerrshme!

Shumë faj kanë organizata e bashkimit të rinasë dhe ajo e bashkimeve profesionale për këto shfaqje që ngjasin në gjirin e tyre. Duhen parë në sy dobësitë e punës së këtyre organizatave, shokë, që të mund të ndreqim gabimet. Në punën edukative të tyre ka dobësi, ka lëshime, ka përcipmëri dhe formalizëm. Nga vjen kjo? Unë mendoj se u është rritur diçka mendja nga sukseset dhe nuk kuptohet e nuk përdoret kurdoherë drejt besimi i madh që Partia ka tek ato, nuk kuptohen si duhet demokracia proletare, disiplina proletare, shijet dhe estetika proletare. Për këto boshllëqe e të meta s'janë fajtorë vetëm organizatat që përmenda, pse fajtore, në radhë të parë, është Partia që nuk ua mëson këto si duhet. Por, duhet njojur se edhe shokët e organizatave të masave nuk luftojnë sa duhet në mënyrë revolucionare për gjithë këto që ngjasin nën hundën e tyre. Ndoshta ka ndonjë që mendon se dikush tjetër duhet të interesohet për këto çështje. Po kush? Mos vallë

Ministria e Punëve të Brendshme? Sa gabim e ka, në rast se ndonjëri mendon kështu!

Ç'rol të madh ka gruaja në shoqëri e në familje! Po a e luan ajo plotësisht këtë rol? Jo, është larg kësaj detyre. Prandaj gruan duhet ta bëjmë më aktive, më revolucionare, të bëjmë që t'i dëgjohet fjala, por edhe ajo fjalën ta kuptojë si duhet dhe ta zbatojë si duhet. Liria dhe të drejtat e gruas janë, si me thënë, të shenjta. Partia ato i ka mbrojtur dhe do të vazhdojë t'i mbrojë deri në fund. Por, nga gratë dhe nga vajzat tona duhet kuptuar se liri nuk do të thotë ajo që bëjnë disa, që mbushin gishtërinjtë me unaza, që vishen me minifunde, apo që lustrohen si në bulevardet e Romës. Demokraci për ne nuk do të thotë të lihen nënët dhe vjehrrat plaka pa bukë. Ne që jemi kundër këtyre shfaqjeve të huaja, nuk jemi Savonarola¹, por jemi kundër Savonarolave. Ne jemi marksistë-leninistë, jemi për një grua shqiptare plot dinjitet, plot shëndet, plot dituri dhe plot liri e demokraci proletare socialiste.

Të mykuri konservatorë përparrë këtyre kritikave të drejta s'do të mungojnë të thonë: «Partia po tërhiqet nga ato që ka thënë deri tash». Jo! Partia asnë gri-më nuk tërhiqet nga ato që ka thënë, përkundrazi ajo ecën e patundur në rrugën e saj të drejtë. Këto që po kritikojmë dhe që po ndreqim janë pikërisht refleks i konservatorizmit të vjetër dhe nxitje nga liberalizmi për të përfituar nga momentet tranzitore të kalimit. Kë-

1. Savonarola — prift italian i shekullit të 15-të, që predikonte asketizmin, heqjen dorë nga stollitë, nga qejfet e nga komoditetet dhe përdorimin e mjeteve të dhunës së ashpër ndaj njerëzve me vese.

to janë refleks i presionit të ideologjisë borgjeze dhe re-visioniste.

Po do të lidhim ne duart përpara këtyre shfaqjeve antisocialiste? Jo, ne duhet t'ua shkulim atyre barin nën këmbë. Po mos duhet të presim mbledhjen tjetër të Plenumit që propozon Byroja Politike për t'i shtruar këto probleme të rëndësishme? Unë mendoj që jo. Ashtu siç kemi vepruar kurdoherë, ne duhet ta rrahim hekurin sa është i nxehjtë. Kemi akoma katër-pesë muaj përpara Plenumit, prandaj, të punojmë që ta përgatitim këtë, ashtu siç na mëson Partia, në mënyrë revolucionare. Të ngremë në këmbë Partinë, organizatat e masave, të punojmë brenda në familje dhe t'i shtrojmë këto probleme, të shtrojmë vijën e Partisë dhe shtrembërimet që i bëhen kësaj, të shpjegohen tendencat dhe qëllimet përsë bëhen këto shtrembërimi. Me një fjalë, t'i vihet gishti plagës, shokë, dhe jo t'i vihet vërdallë, të kritikohen drejt dhe pa druajtje të gjithë ata që nuk ecin në këtë rrugë, të kritikohen, gjithashtu, indiferentët, të cilët janë edhe më të rrezikshëm se fajtorët, pse indiferentët shuanjë frymën revolucionare të opinionit publik. Njerëzit e sëmurë t'i ndreqim, t'i bindim dhe jo t'u presim kokën. Masat administrative dhe represive nuk janë në metodat tona, këto masa ne i marrim kundër atyre që thyejnë ligjet dhe mbushin kupën dhe këto diktatura e proletariatit, kur e lyp nevoja, do t'i përdorë për interesin e popullit dhe të socializmit.

Partia të tillë çështje i ka bërë kurdoherë të masave të gjera, këto i kanë aprovuar dhe kemi pasur suksesë në zgjidhjen e tyre. Çdo problemi duhet t'i jepet masa e duhur, e theksoj masa e duhur, as të fryhet e të

ekzagjerohet, po as të minimizohet. Çdo problem nuk duhet thjeshtësuar në minimum, domethënë, me hir o me pahir, merr tani gërshtërën në duar dhe priji leshrat, o djalë, e kështu me radhë. Jo, atyre djemve që lënë leshrat e gjata ose vajzave që ngjyrosen e vishen me minifunde u duhet sqaruar botëkuptimi i huaj. Këto nuk janë vetëm çështje të shfaqjeve të jashtme, po janë botëkuptime filozofike të brendshme, të cilat në fillim duken si të thjeshta, por më vonë bëhen shije me të vërtetë çoroditëse dhe filozofi reaksionare. Këtij rrezi-ku ne duhet t'i dalim përpara.

Tash ne jemi përpara zgjedhjeve në Parti dhe pikërisht për këto arsyе i shtrova këto konsiderata. Unë mendoj se nga problemet që duhen diskutuar, është e këshillueshme të jenë edhe këto që preka shkurtimisht këtu, prandaj, Partia të veprojë pa vonesë. E ritheksoj që këtyre çështjeve është mirë t'u jepet vendi dhe rëndësia e duhur, që as të mos na errësojnë problemet e tjera, por as këto të fundit të minimizojnë të parat. Çdo gjë duhet të ketë vendin e vet.

Të ruhemë, gjithashtu, nga ekzagjerimet e dëmshme e të rrezikshme, si dhe nga thashethemet. E ritheksoj këtë, se disa herë harrohet masa. Nuk është rinia jonë trime, heroike dhe e pastër që i ka këto vese, po janë disa të rinj që ne duhet t'i ndreqim dhe gjithë të rinjve e të moshuarve t'u tre gojmë rrezikshmërinë e këtyre rrugëve. Të moshuarit dhe komunisët të mos mendojnë se nuk kanë përgjegjësi për këto shfaqje. Ata kanë, bile në disa raste kanë përgjegjësi morale më shumë sesa i riuj fajtor.

Partia këto çështje duhet t'i kuptojë dhe t'i shpje-

gojë qartë, ashtu sikurse e ka bërë pérherë, por, që ta bëjë më mirë këtë punë, shfaqjet jo të shëndosha, që kanë filluar të duken në trupin e shoqërisë sonë të shëndoshë, duhen pasur parasysh se nuk janë fenomene të izoluara, po një shtëllungë sijesh që kanë filluar të nxjerrin veshët në teatër, në muzikë, në radio e në televizion, në literaturë etj., të cilat Plenumi i ardhshëm i Komitetit Qendror do t'i shtjellojë më gjerë. Prandaj të përgatiteimi sa më mirë pér këtë Plenum, pse kjo do të jetë një punë frytdhënëse me rëndësi pér Partinë dhe pér popullin.

*Botuar pér herë të parë,
me shkurtim, në librin:
Enver Hoxha, «Raporte e
fjalime 1972-1973», f. 189*

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

LIGJET TONA SHPREHIN POLITIKËN E PARTISË DHE VULLNETIN E POPULLIT

*Diskutim në mbledhjen e Presidiumit
të Kuvendit Popullor të RPSH¹*

15 shkurt 1973

Jam dakord me raportin e paraqitur nga aparati i Presidiumit.

Në rrëthin e Elbasanit, si në tërë vendin tonë, organet shtetërore, të udhëhequra nga mësimet e Partisë, kanë përmirësuar metodën e punës së tyre në drejtim të forcimit të ligjshmërisë socialiste. Ky konkluzion nuk do të thotë që të mjaftohemi me atë çka është arritur, pse sa më tepër të forcohet rendi ynë ekonomiko-shoqëror, sa më lart të ngrihet niveli i forcave prodhuese dhe të përsosen marrëdhënet socialiste në prodhim, aq më i mprehtë bëhet problemi i njohjes dhe i zbatimit të ligjeve të vendosura nga pushteti popullor.

Duke e vlerësuar ligjshmërinë socialiste si parim të

1 Në këtë mbledhje u shqyrtua raporti i paraqitur nga aparati i Presidiumit të Kuvendit Popullor për përmirësimin e metodës së punës në drejtim të forcimit të ligjshmërisë socialiste.

rëndësishëm të shtetit të diktaturës së proletariatit dhe si një nga metodat kryesore për vënien në jetë të detyrave të tij, Lenini theksonte:

«Sa më shumë që ne futemi në kushtet, të cilat janë kushtet e një pushteti të qëndrueshëm e të fortë, sa më tej shkon zhvillimi i qarkullimit qytetar, aq në mënyrë më kategorike duhet lëshuar parulla e fortë e realizimit të një ligjshmërie revolucionare më të madhe...»¹.

Nga ky mësim i Leninit del se organet e pushtetit dhe të administratës shtetërore, në qendër e në bazë, duhet të punojnë gjithnjë e më shumë jo vetëm për njohjen e ligjeve, që është vetëm njëra anë e problemit, por, në të njëjtën kohë, të përqendrojnë të gjitha përpjekjet për zbatimin e plotë, të drejtë dhe pa asnjë lëshim të tyre.

Politika e Partisë sonë dhe ligjshmëria socialiste nuk janë të ndara njëra nga tjetra, përkundrazi, ato veprojnë në unitet, sepse kanë në themelin e tyre ideologjinë marksiste-leniniste dhe synojnë arritjen e qëllimeve të përbashkëta. Ligjet në Republikën Popullore të Shqipërisë shprehin politikën e Partisë dhe vullnetin e masave punonjëse të udhëhequra nga klasa punëtore, prandaj vënia në jetë e tyre do të thotë zbatim i politikës dhe i vijës së Partisë. Në të kundërtën, shkelja e ligjeve është shmangje nga politika e Partisë. Kjo është

1. V. I. Lenin, Veprat, vël. 33, f. 188.

arsyeja që Partia vazhdimisht i ka porositur organet shtetërore dhe ekonomike, organizatat shoqërore dhe türë qytetarët të njohin dhe të zbatojnë ligjet e shtetit.

Çdo qytetar duhet t'i njohë ligjet, të cilat i sigurojnë të drejta dhe e ngarkojnë me detyra për ndërtimin e shoqërisë socialiste. Ligjet tona i tregojnë qartë qytetarit se çfarë duhet t'i japë ai shoqërisë dhe çfarë mund të kërkojë prej saj. Kur themi që çdo qytetar duhet t'i njohë ligjet, nuk pretendojmë që t'i bëjmë të gjithë njerëzit juristë, por shtrojmë detyrën që secili të njohë ato ligje, vendime, urdhëresa etj., që rregullojnë sferën e marrëdhënieve shoqërore ku punon. Lufta e ndërgjegjshme e punonjësve për ndërtimin e shoqërisë sociale, kërkon patjetër njohjen e tyre me ligjet e shtetit të vet në ato fusha ose drejtime që u dikton jeta, prandaj në këtë rrugë duhet të orientohet edhe puna e Partisë dhe e shtetit për popullarizimin e ligjeve.

Në qoftë se kërkohet njohja dhe zbatimi i ligjeve nga qytetarët, ca më tepër, bile në një shkallë më të lartë, kjo detyrë u takon organeve shtetërore dhe organizatave shoqërore të çfarëdo hallke, pa përjashtim, kudo që shtrihet veprimtaria e tyre.

Që të zbatohen ligjet me përpikëri, në radhë të parë duhet punuar që krahas ndërgjegjes politike të ngrihet në një shkallë më të lartë edhe ndërgjegjja juridike e njerëzve tanë, domethënë të zhvillohen më tej njohuritë dhe përgjegjësia e tyre për respektimin e normave të së drejtës sonë sociale. Ndjenja e respektimit të normave të së drejtës sociale dhe e zbatimit të tyre në shoqëri, varet shumë nga kuptimi ideologjik i përbajtjes së normave juridike, nga fakti që masat punonjëse janë të

bindura se ligjet e shtetit tonë mbrojnë rendin socialist, të drejtat dhe interesat e tyre.

Nga raporti që na është paraqitur rezulton se gjatë viti 1972 në rrethin e Elbasanit, me gjithë përmirësimet e bëra, veç të tjerave, janë vërtetuar mjaft raste shkeljesh të dispozitave ligjore nga punonjës të organeve ekonomike dhe të administratës. Po pse janë vërtetuar këto shkelje nga kuadrot e ekonomisë dhe të administratës në këtë rreth? Nuk e kuptojnë shokët që punojnë në këto organe se sa dëm të madh u sjellin interesave të Partisë dhe të shtetit këto qëndrime në kundërshtim me ligjet? Këtë ata duhet ta dinë mirë, se ka kohë që, jo një herë, po shumë herë, u është shpjeguar se çdo shkelje e ligjit është një shteg nga ku mund të depërtojë armiku i klasës.

Unë mendoj se duhet dënuar rëndë prirja e dëmshme e disa personave për të krijuar kontradikta midis interesit të përgjithshëm të mbrojtur nga ligji dhe interesit të një organi shtetëror, të një institucioni, ndërmarrjeje apo të një qytetari të veçantë. Disa nga këta persona, duke vështruar vetëm nga një kënd i ngushtë i interesave më të vegjël, e humbasin shikimin nga fusha e gjerë e interesave më të mëdhenj. Ndaj këtyre njerëzve, që shkelin ligjet, Partia do të vazhdojë të punojë për t'i edukuar e për t'i bindur, duke përdorur të gjitha format e njoitura, sepse metoda e bindjes është e drejtë, jep rezultate të kënaqshme dhe ka rëndësi të dorës së parë për edukimin e njerëzve. Por, siç dihet, ka një raport të drejtë të vendosur nga Partia për kombinimin e mirë të metodës së bindjes me atë të masave administrative. Ashtu sikurse bindja, edhe masa admi-

nistrative te ne i shërbën edukimit. Ai që disbalancon këtë raport, duke përdorur vetëm njëren metodë edukimi dhe duke mohuar tjetrën, shkel një parim të rëndësishëm. Kjo do të thotë se ai që shkel ligjin, që bën hatëre dhe akraballëqe, duhet ndëshkuar sipas parashikimeve të tij.

Eshtë kundër ligjit fakti që mbi njëqind kuadro të kooperativave bujqësore kanë përfituar pa të drejtë shpërblimin e plotë për periudhën që ishin në stërvitjen ushtarake, në një kohë që shokëve të tyre, kooperativistëve të thjeshtë, u është mbajtur përqindja e caktuar sipas rregullit ligjor. E njëjtë gjë mund të thuhet edhe për çrregullimet e konstatuara të disa kuadrove në zbatimin e dispozitiveve mbi zhëmtimin e arkës së shtetit për dëmet e shkaktuara në industri, në ndërtim e në komunikacion, për të cilat bëhet fjalë në raport. Këta shokë nuk kanë mbajtur parasysh atë që u ka mësuar vazhdimisht Partia dhe që sankzionohet shprehimisht në Kushitetutën tonë: «Të gjithë shtetasit janë njëlloj përrpara ligjit. Ata kanë për detyrë të konformohen me Kushitetutën dhe me ligjet. Nuk njihet asnjë privilegji për shkak origjine, pozite, pasurie ose shkalle kulture».

Shfaqjet e liberalizmit në marrjen e masave përmoszbatin e ligjeve të shtetit disa herë «justifikohen» me shprehje të tillë si ai për faj të të cilit nuk u realizua plani në sasi, cilësi apo assortiment, ose ai që i shkaktoi këtë dëm pasurisë socialiste, eshtë shok i mirë etj. Këto arsyetimo s'janë aspak të drejta. Po pse shoku i mirë punon keq, dëmon ton ekonominë e ngritur me djersën e popullit dhe, me gjithë këshillat e herëpashershme, nuk korrigjohet? Ai mund të ketë qenë i mirë, por në

rastin e fundit ka vepruar keq dhe, që të mos prishet më shumë, duhet të kurohet. Natyrisht në dhënien e ilaqit të kihet parasysh shkalla e sëmundjes dhe rreziku që ajo paraqet ashtu siç parashikon vetë ligji ynë. Ve-tëm kështu shoku për të cilin po flasim do ta kuptojë gabimin dhe bile do ta falënderojë shoqërinë, që e ndëshkoi jo për t'u hakmarrë me të, po për ta ndrequr.

Partia dhe organet e pushtetit në rrethe duhet të punojnë vazhdimishit për të mësuar konkretisht (dhe jo në mënyrë të përgjithshme) shkallën e njohjes dhe të zbatimit të ligjeve nga komunistët, kuadrot dhe masat. Kjo punë të vlerësohet si tregues me rëndësi për kuptimin dhe zbatimin e politikës së Partisë në rreth. Unë mendoj se është c domosdoshme që jo vetëm në rrethin e Elbasanit, po edhe në rrethe të tjera Partia dhe pushteti të analizojnë herë pas here në mënyrë të posaçme shfaqjet më tipike të liberalizmit në zbatimin e ligjshëmërësë socialiste, sidomos në realizimin e planit ekonomik të shtetit dhe të kontratave, që lidhen me zbatimin e tij. Konkluzionet që do të nxirren me këtë rast të diskutohen me të gjithë kuadrot kryesorë, me qëllim që t'u pritet rruga disa prirjeve, të cilat, po të vazhdojnë të trashen, në të ardhmen mund të bëhen më të rrezikshme.

Po nga cilat organe mund të ndihmohen më shumë Partia dhe pushteti për parandalimin e shkeljeve të ligjeve? Sigurisht nga organet e drejtësisë, që janë të ngarkuara posaçërisht me mbikëqyrjen e zbatimit të përpiktë dhe të drejtë të ligjeve dhe të dispozitave të tjera ligjore, nga institucionet, organet lokale të pushtetit, nga organizatat shoqërore, nga personat zyrtarë

dhe nga qytetarët. Është e vërtetë se organet e drejtësisë tani përpinqen t'i ushtrojnë më mirë se përpara detyrat për parandalimin e shkeljes së ligjeve, por përsëri, sikurse konstaton raporti për rrethin e Elbasanit, nuk është arritur plotësisht ajo që kërkon Partia prej tyre.

Gjykata e rrethit të Elbasanit gjatë vitit 1972 nuk ka ngritur para organeve të Partisë dhe të pushtetit në rrëth ndonjë problem shqetësues për shkeljen e ligjeve. Po pse nuk është vepruar në këtë drejtim nga ana e saj, vallë nuk ka probleme për të ngritur? Doemos probleme shqetësuese ka pasur dhe këtë e provojnë konstatimet që bëhen në raportin e aparatit të Presidiumit. Organet e drejtësisë çdo ditë, bile qdo orë, ndeshen me problemet e ligjshmërisë, se ata me këtë punë merren. Për të qenë më të zhdërvjellët në këtë drejtim, unë mendoj që, para së gjithash, këto organe duhet të vazhdojnë të theullohen më shumë në kuptimin politik të detyrave të tyre. Krahas punës për hetimin dhe gjykimin e drejtë dhe të shpejtë të çështjeve, prokuroritë dhe gjykatat të merren me ngritjen e problemeve shqetësuese me karakter politik, ideologjik dhe organizativ, si dhe me propozimin e masave politike që mendojnë ata për mënjanimin e shkeljes së ligjeve.

Në raportin e aparatit të Presidiumit vërehet, gjithashtu, se, kur organet e drejtësisë në rrëth sinjalizojnë për të metat në zbatimin e ligjeve nga organet e pushtetit, të administratës shtetërore dhe të ekonomisë, nuk raportojnë si duhet për të metat në punën e tyre. Ky qëndrim nuk është i rekomandueshëm. Gjykatat dhe prokuroritë jepin llogari për punën e tyre, ata përgjigjen para Partisë, shtetit dhe popullit. Këto organe duhet

të respektojnë orientimet e qarta të Partisë dhe porositë e Presidiumit të Kuvendit Popullor.

Prokuroritë dhe gjykatat duhet t'i njojin më mirë problemet që preokupojnë Partinë dhe pushtetin në rreth, ato duhet t'i kapin më shpejt shkeljet e ligjshëmërës në sektorët ekonomikë që të dinë pastaj të çmojnë politikisht pasojat e dëmshme që vijnë nga shkelja e ligjeve në këtë fushë. Kështu ato duhet ta ngrenë zërin fort dhe deri në fund për t'u marrë masat e nevojshtme kundër zvarritjeve burokratike dhe plogështisë që pengojnë realizimin e planeve ekonomike, kontratave etj. dhe të luftojnë kundër tyre, sikurse dhe kundër vjedhjeve e shpërdorimeve të pasurisë. Në këtë drejtim të kihet kurdoherë parasysh mësimi i Leninit që thoshte:

«...gjykatat popullore t'i kushtojnë më shumë vëmendje ndjekjes gjyqësore të burokratizmit... dhe të plogështisë në drejtimin e ekonomisë. Proceset mbi çështjet e këtij lloji janë të domosdoshme... për të arritur qëllimin praktik: suksese ekonomike më të mëdha»¹.

Prokuroritë të mos kufizohen vetëm në denoncimet që marrin nga drejtoret e ndërmarrjeve për dëmet e shkaktuara në fushën ekonomike, por, në rrugën e kontrollit të përgjithshëm, të tregojnë më tepër iniciativë në kapjen e problemeve. Në këtë drejtim kam përshtypjen se nuk punohet mirë. A kemi ne ligje që

1. V. I. Lenin, Veprat, vël. 33, f. 193.

i autorizojnë këto organe të veprojnë aktivisht në këtë drejtim? Po kemi, por edhe në qoftë se ka ndonjë dispozitë ligjore që duhet rregulluar për të rritur rolin aktiv të organeve të drejtësisë në këtë drejtim, le ta studiojmë mirë çështjen dhe ta ndreqim.

Partia, duke pasur parasysh veçoritë që paraqit çdo organ i drejtësisë, punën e secilit prej tyre e ka ndërtuar në bazë parimesh shumë të drejta dhe demokratike. Këto parime nuk ndalojnë aspak ndonjë ndryshim që mund të bëhet në ligjin mbi organizimin gjyqësor dhe në atë të prokurorisë, në qoftë se këtë e diklojnë kushtet e reja të zhvillimit tonë dhe nevojat e përmirësimit të mëtejshëm të punës në përputhje me këtë zhvillim. Unë nuk kam ndonjë propozim konkret në këtë drejtim, por le të diskutohet çështja me organet e gjykatave dhe të prokurorive në qendër e në bazë, të studohet mirë problemi dhe, po të shikohet me vend, të bohen propozime konkrete.

Unë, shokë, pa nënvlefësuar aspak sukseset e arriitura, vura në dukje shkurtimisht disa probleme që mendoj se kanë rëndësi për zbatimin e ligjshmërisë sonë revolucionare nga organet shtetërore, organizatat shoqërore, nga komunistët, kuadrot dhe nga qytetarët. Undala pak për disa anë të punës së organeve të drejtësisë, sepse desha të theksoj rolin dhe detyrat e tyre shumë të rëndësishme për të mbështetur në mënyrë më të studiuar dhe më efikase punën e Partisë dhe të pushtetit, për të forcuar më shumë ligjshmërinë tonë socialiste.

Duke u bazuar në sukseset e arriitura, në orientimet e Partisë për vlerësimin serioz të problemit dhe në pu-

nën e vazhdueshme të organeve shtetërore dhe të vetë qytetarëve për njohjen dhe zbatimin e ligjeve të push-tetit populor, unë shpreh bindjen se në të ardhmen rezultatet do të janë më të mëdha.

*Botuar për herë të parë
në librin: Enver Hoxha,
-Reporte e fjalime 1972-
-1973-, f. 212*

*Botohet sipas librit:
Enver Hoxha, "Për pushtetin
populor (Përmbledhje
veprash)", f. 525*

ÇDO GJË NË VENDIN TONE BËHET PËR RININË

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

23 shkurt 1973

Ju, shokë të rinisë, që ju kemi thirrur këtu keni gjë tjetër të re për t'i shtuar raportit që na keni dërguar? Po Agim Meroja² është këtu? Të thirret të vijë, se mban edhe ai përgjegjësi për punën e rinisë. Mund të na flisni pak më konkretisht, duke përmendur edhe emra se kush ka ndikuar negativisht, kush ka mbajtur qëndrim liberal ndaj direktivave të Partisë për çështjen e edukimit të rinisë, dhe që, sipas mendimit tuaj, ka sjellë si rezultat atë që disa të rinj të mos sillen e të mos jetojnë në bazë të normave të moralit tonë proletar,

1. Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit të paraqitur nga KQ i BRPSH «Mbi disa çështje që u ngritën në Kongresin e 6-të të BRPSH dhe që kanë të bëjnë me organet e Partisë e të shtetit».

2. Në atë kohë rektor i Universitetit të Tiranës. Më parë ishte sekretar i parë i KQ të BRPSH dhe përgjigjej për punën me rininë.

pra kanë rënë në liberalizëm? Kur themi, disa të rinj, nuk kemi parasysh gjithë rininë.

Ka disa që thonë se «këto shfaqje janë disa karakteristika të moshës», «janë periodike», «që do të zhduken me kalimin e kohës» etj., etj. Cilat, vjedhjet e xhepave, mosndjekja e mësimeve në rregull, marrja e notave negative, kalimi me zor i klasës nëpër shkolla etj. këto janë karakteristikat e moshës së rinisë?! A janë trajtuar mirë ideologjikisht problemet dhe a janë nxjerrë buri met e shkaqet nga të cilat rrjedhin këto akte e qëndrime liberale? Shkaqet e këtyre qëndrimeve janë kopjim e imitim nga bota e jashime, shtrembërim i vijës së Partisë, apo çfarë?

Mirë se njëri që vodhi diçka, u përjashtua nga shkolla apo nga organizata e rinisë, po kundër disa mendimeve e pikëpamjeve filozofike antimarksiste, që sillen nga jashtë dhe që depërtojnë e fliten edhe në universitet, jo në katedrat, por nga disa, nëpër qoshe, bëhet luftë apo jo? Nëse jo, përse nuk bëhet kjo luftë? Kush janë këta që qenkan kaq të zotë sa të mbrojnë teoritë dekadente të huaja dhe të tjerët, që hiqen se mësojnë ditë e natë marksizëm-leninizmin, nuk janë në gjendje t'i demaskojnë e t'i hedhin në plehra këto teori, bashkë me njerëzit që i predikojnë haptazi ose në mënyrë të fshehtë? Ka njerëz, për shembull, në organizatat e rinisë, që mbrojnë Pikasonë ose piktorë të tjerë dekadentë? Nuk ka. A njihen këto çështje në organizatë? Ndihet nevoja për t'i sqaruar nga ana teorike dhe për të mbësh tetur drejtësinë e pikëpamjeve marksiste-leniniste të Partisë, apo vetëm thuhet që duhet të ngrihen probleme të tilla dhe në të vërtetë nuk ngrihen fare?

Këto probleme duhet të jenë të qarta, e jo të na thuhet këtu me dy fjalë: «ngrihen», «ngrihen pak ose s'ngrihen fare». Këto çështje thuhën në mbledhje e shkruhen nëpër gazeta, por trajtohen cekët e në mënyrë të përgjithshme dhe, si rrjetohim, dalin disa njerëz që në fakt propagandojnë dës vënë në jetë teoritë borgjeze në art, në kulturë etj.

Kur organizohen diskutime, a ngrihen shokët e Partisë ose të rinisë, që kanë eksperiencë dhe përgatitje politike e ideologjike, për t'i orientuar këto diskutime për vlerat ideore të veprave kulturore, artistike etj.? Këtu nuk e kam fjalën për gabimet gramatikore ose për ndërtimin e veprës në kuptimin që kjo ide të shprehoj në fund e ajo në krye, por për të sqaruar anën politike të çështjes që trajtohet, duke thënë fjalë vjen: «Këtu problemi nuk është shkruar drejt politikisht; kjo ide është e shtrembër nga pikëpamja ideologjike» etj. A kanë përdorur Partia dhe rinia forma të tillë pune?

Unë nuk e kuptoj pse të mungojë guximi te kjo rini kaq trime, për të hedhur poshtë një vepër që nuk vlen, të këtij apo atij shkrimitari, kur kësaj rinnie nuk i ka munguar guximi për të vajtur në luftë e për t'u vrarë me armiqëtë.

Këto shfaqje të huaja, për të cilat flitet këtu, siç janë disa pjesë teatrale, muzikore, disa këngë etj., nuk i ka bërë punëtoria e uzinës, por i kanë bërë të tjerët. Sipas mendimit të rinisë, janë bërë me qëllim apo pa qëllim gabimet në këto krijime letrare e artistike? Disa të rinj, siç thoni ju, nuk e kanë pasur atë zotësi politiko-ideologjike që t'i kapin shpejt dhe t'u kundërvihen përnjëherësh shfaqjeve të huaja. Por, kur i kanë vënë re

në ndonjë rast, a janë thelluar për të parë nëse idetë janë shprehur me qëllim? Si mendoni ju, duhet të organizohej ndaj këtyre shfaqjeve e ndikimeve të huaja një rezistencë efikase që ato të hidheshin në plehra?

Pasi shokët iu përgjigjën pyetjeve të bëra dhe diskutuan rreth problemeve që u shtruan, shoku Enver Hoxha vazhdoi:

Më duket se problemi vihet shtrembër që në fillim. Sekretariatit të Komitetit Qendror të Partisë në vend që t'i bëhet, në radhë të parë, një pasqyrë konkrete, qoftë edhe e shkurtër por e qartë, për problemet politike, ideologjike, morale dhe organizative të rinisë, si u priten prej saj vendimet e Kongresit¹, si po vihen në jetë këto vendime etj., që nga fillimi dhe deri në mbarim, këtu kalohet në kërkesa ndaj organeve të Partisë, atyre shtërorë dhe institucioneve kulturore. Unë nuk them të mos bëhen kërkesa, por këto të mos jenë të njëçanshme, jo vetëm nga çështja se këtu nuk po na flitni për organizatën e rinisë, por edhe në kërkesat sikur të qëndrohet, këtu s'duhet të ketë njëanësi. Është e lejueshme të kërkoni, por, sigurisht, do të kërkohet edhe nga ju.

Në qoftë se ju e thoni në mënyrë aq kategorike shprehjen «sikur nuk kuptohen shqetësimet e rinisë, kërkesat, interesat dhe problemet e saj» (gjë që unë nuk e gjej as të drejtë dhe as reale), atëherë vihet pyetja: A e vlerësoni ju drejt interesimin e madh që tregojnë Partia dhe pushteti për rininë? A i çmoni ju drejt mjetet e mëdha materiale që janë vënë në dispozicion të edukimit të rinisë në të gjitha sferat? A i çmoni dhe a i

1. Kongresi i 6-të i BRPSH.

shsrytëzoni ju këto si duhet? A i vlerësoni këto brenda zhvillimit të përgjithshëm të vendit dhe nevojave të këtij zhvillimi? Mua më duket se për t'iu përgjigjur të gjitha këtyre pyetjeve, duhet reflektuar më parë dhe, po të reflektohet, nuk mund dhe nuk duhet të dilni në atë konkluzion që keni dalë.

Në raportin që na keni paraqitur, disa herë kam hasur në përdorimin nga ana juaj të termit „shqetësimet e rinisë“. Nuk e kuptoj dot për çfarë shqetësimesh bëni fjalë? Ç’janë këto brengë që brejnë zemrën e rinisë sonë? Në qoftë se ju e përdorni këtë term sa për ta përdorur, bëni gabim. Në qoftë se e mendoni atë seriozisht, atëherë le të diskutojmë seriozisht, pse është me rëndësi të sqaroheni edhe ju, edhe ne.

Unë mendoj se rinia jonë është më e lumtura dhe më e gëzuara në botë. Çdo gjë në vendin tonë bëhet e ndërtohet për rininë, ajo rron në një vend socialist të lirë nga çdo pikëpamje dhe edukohet në mënyrë të shëndoshë, ajo rron në një vend demokratik, ku gjëzon të gjitha të drejtat, po ka natyrisht edhe detyra.

Që kur lind fëmija në vendin tonë prindërit e të afërmít ajo i ka në punë, jeta ekonomike e familjeve te ne është përmirësuar shumë. Përveç kësaj, për fëmijët shteti bën çmos (dhe s’ka bërë pak), ai ka ngritur kudo për ta çerdhe, kopshte, shtëpi pushimi, spitale. Fëmijët në Shqipëri sot rriten të ushqyer mirë, vishen, mbathen, venë në shkollë. Shkollat e të gjitha niveleve janë të çelura për të tërë dhe falas. Kur sëmuren fëmijët, shërimi si për të gjithë edhe për ta bëhet, gjithashitu, falas. Të rinjve e të reja ve të shumë familjeve, të cilët shkojnë në shkollat e mesme e në universitet, shteti u

jep bursë. Kur ata dalin në punë, marrin rroga të mira, qiratë te ne janë fare të lira, sigurimet shoqërore shtetërore po si te ne. Me miliona e miliona kopje librash janë botuar e vazhdojnë të botohen. Përveç organeve qendrore të shtypit, gazeta ka gati kudo, në çdo rrith, në qytete, në Ishatra ka shtëpi kulture, në uzina e në fabrika ka biblioteka etj. Teatro, kinema, estrada profesioniste dhe amatore janë ngritur me shumicë në të gjitha anët. Gati çdo qytet ka nga një stadium të madh, në mos dy, pa folur pastaj për mijëra fusha sportive më të vogla. I tërë vendi është shumë piktoresk, nga më të bukurit në botë, të rejat e të rinjtë tanë mund të shkojnë dhe shkojnë kudo. Ata mësojnë, punojnë, jetojnë, bëjnë turizëm dhe asnjë pengesë nuk ka për ta, pse imbarë pulli ynë, Partia dhe pushteti e çmojnë lart rininë tonë, e cila e meriton këtë plotësisht. Atëherë vihet pyetja: Çfarë shqetësimesh e brejnë rininë tonë?

Jo, shokë të rinisë, realiteti nuk është kështu si thoni ju. Që duhet të bëhen akoma shumi e më shumë, kjo është e drejtë. Që ka edhe disa njerëz që nuk kujdesen ose nuk i kuptojnë si duhet këto çështje edhe kjo është e vërtetë. Ka pastaj edhe nga ata për të cilët qaheni ju në raport, por, nga ana tjetër, edhe ju vetë duhet të shihni më mirë në sy të metat tuaja.

Le të marrim çështjen e frontit të kulturës në edukimin e rinisë. As këtë problem ju nuk e shikoni shumë drejt, bile e ngushton i këndin e shikimit të kulturës që është një fushë e gjerë. Këtë gjerësi ju e harroni dhe frontin e kulturës për edukimin e rinisë e reduktoni, duke thënë se «në një sërë rrethesh nuk përgatitet asnjë premierë teatrale me probleme të rinisë», se «së-është

bërë asnjë film artistik për rininë.., «botimet letrare janë të pakta dhe të një niveli të ulët», «botime shkencore për rininë s'ka». Ta shtrosh kështu problemin, do të thotë ta shtrosh cekët dhe pse të mos e themi më hapur, shokë udhëheqës të rinisë, të krijohet përshtypja sikur fajin e kanë të tjerë dhe jo ju që bëni raportin ose që jeni drejtuesit kryesorë të organizatës së rinisë.

Fronti kulturor për edukimin e rinisë nuk qëndron në përgatitjen e një ose dy filmave, të një ose dy pre-mierave që nuk janë bërë. Që të bëhen këto (dhe është e drejtë të bëhen jo kaq, po edhe më shumë), duhet të luftojmë që të gjithë, duke mos harruar as ju; por çështja e frontit të kulturës nuk qëndron vetëm në këto që thashë, pse janë një pjesë shumë e vogël e punës së këtij fronti të madh e kompleks.

Fronti i madh i kulturës për rininë tonë është shkolla, ku merret dituri, ku mësohet shkenca, filozofia dhe kur të rintjtë e të rejat dalin nga bankat e shkollës, suten në bankat e punës që quhen torno, tokë, blegtori, në luftën për jetën. I gjithë ky front i gjerë aktiviteti për të prodhuar të mira materiale është njëkohësisht një front i madh kulture. Të dy këto fronte janë të hapëta nga të dyja anët e kanateve për rininë, e cila merr pjesë gjallërisht në fillim si nxënëse, më vonë edhe si edukuese dhe krijuese. Prandaj organizata e rinisë duhet t'u vërë rëndësi më të madhe këtyre dy fronteve të kulturës për edukimin e masës së rinisë, pse këto janë kryesoret. Në kemi suksese të mëdha në këto dy fronte.

Rinia jonë, në përgjithësi, mëson, edukohet dhe punon mirë. Por mund dhe duhet të punojë e të mësojë

edhe më mirë, pse i janë krijuar të gjitha mundësitë. Them se ajo duhet të punojë e të mësojë më mirë, se në këto drejtime duken mjaft boshllëqe të karakterit subjektiv, boshllëqe që s'mund t'u ngarkohen vetëm të rinjve, por edhe mësuesve e pedagogëve, komunistëve dhe udhëheqësve të rinisë, drejtuesve të organeve ekonomike dhe shtetërore.

Sigurisht luftohet kundër këtyre të metave dhe bëhen përmirësimë të vazhdueshme, por, pa nënveftësuar përgjegjësinë e të tjerëve, që Partia dhe Qeveria i këshillon dhe i qorton vazhdimisht të korrigjohen, unë dua të theksoj se vetë organizata e rinisë, kudo që ekziston si organizatë dhe udhëheqja e saj nga lart e deri në bazë, frontit të madh e vendimtar të kulturës për edukimin e rinisë, ashtu siç e përmenda më lart nuk po i vë rëndësinë e duhur dhe bën një punë formale, rutinë, bile ka raste që nuk bën fare. Jo një herë, po shumë herë më ka qëlluar të bisedoj me nxënës të shkollave të mesme të arsimit të përgjithshëm dhe me studentë, edhe nga ata më të mirët e shumë të mirët dhe kam vënë re se nuk njohin lëvizjet e rëndësishme shoqërore e historike të epokave të ndryshme të historisë, se nuk kanë asnjë sije njohurie, të paktën nga janë, mbi disa shkrimitarë e filozofë që kanë bërë epokë në mendimin njerëzor.

Mund të pranohet një gjë e tillë si normale? Sigurisht saj kanë pedagogët për këtë, por nxënësit dhe studentët janë vallë nuk janë fajtorë? Po organizata e rinisë ç'po bën që nuk i edukon këta të rinj të plotësojnë kulturën e tyre, qoftë në shkollë, qoftë jashtë shkollës? Ç'rëndësi ka nëse u bë apo nuk u bë një shfa-

qje teatrale ose një film më shumë, kur i riu ose e reja që ka mbaruar shkollën e mesme e të lartë, jo vetëm nuk merr mundimin të lexojë pjesë letrare, komedi apo drama me famë botërore, por nuk di as kush janë disa autorë të tillë si Shekspiri, Molieri e të tjerë si këta?

Shokët e rinisë mund të thonë, «ja, mbledhje po bëjmë». Bëni mbledhje, shokë, po mua më thonë se ka me qindra studentë që marrin nota pesa dhe ka shumë që përjashtohen se nuk mësojnë, se sillen keq etj. Kjo, shokë, është shqetësuese për Partinë dhe shqetësimi është me baza. Për mungesa të kësaj natyre duhet të shqetësoheni ju dhe jo për shqetësimet imagjinare ose të sëmura të disa të rinjve.

Pse na ngjasin një sërë qëndrimesh e sjelljesh të papëlqyera në shoqërinë tonë të pastër? S'janë vetëm disa të rinj që sillen keq, pse ka edhe burra, por kjo nuk duhet të na bëjë të harrojmë të rinjtë, duke lëshuar me mendjelehtësi shprehjen: «Epo të rinj janë».

Edukata e njerëzve është një nga preokupimet më të mëdha që duhet të kemi dhe kjo fillon në familje dhe vazhdon e plekset më pas me shkollën, pastaj me punën, me shoqërinë. Në çdo etapë, në çdo ambient ekzistojnë të ne format dhe mënyrat, një kompleks i tërë për edukimin e tyre. Nuk mjafton vetëm të shesësh mend në këtë drejtim, por edhe të blesh nga të tjerët, nuk mjafton vetëm të kërkosh, por edhe të japësh, të bëhesh shembull, të jesh kurajoz, krijues dhe joindiferent.

Prandaj, shokë të rinisë, front kryesor të kulturës për edukimin e rinisë duhet të konsideroni shkollën. T'i vini rëndësi shumë të madhe përvetësimit të kulturës së gjerë e të shumanshme, gjatë viteve që rinia kalon

në shkollë. Ta shikosh kulturën për edukimin e rinisë në një prizëm të ngushtë, se sa shfaqje përgatiten me tema për rininë, se duhen botuar libra shkencorë të veçantë për rininë, se duhet të shkruhen romane me tema vetëm për rininë, se Teatri i Operës dhe i Baletit është nevoja të përgatitë baleta të posaçme për rininë etj., nuk është e rekomandueshme. Kjo e ngushton shumë sferën e edukimit të rinisë, e izolon këtë nga mundësitë e mëdha që i janë krijuar dhe, fundi i fundit, nuk është as reale. Rinia vetë nuk ta pranon këtë korinizë, ajo këtë e ka thyer me kohë dhe mirë ka bërë.

C'do të thotë të shkruash romane të posaçme për rininë? Unë nuk them që të mos shkruhen edhe të tilla, të bukura dhe në numër gjithnjë më të madh. Partia i ka frymëzuar dhe do të vazhdojë t'i frymëzojë shkrimitarët edhe në këto drejtime, por kjo nuk do të thotë që organizata juaj të rrrijë duarlidhur. Autorë të rinj e të talentuar ka, atëherë pse nuk i nxitni posaçërisht ju për këtë gjë? Por edhe me urdhër këto nuk bëhen. Përveç kësaj, e gjithë literatura jonë është për rininë, pse është me përbajtje socialiste, është e freskët si rinia, ajo përshkruan jetën tonë, ndjenjat, luftërat, dashurinë e pastër, klasën punëtore dhe luftën e saj, përpjekjet e Ishatarësisë sonë kooperativiste, me një fjalë zhvillimin e jetës sonë në të gjitha aspektet. S'ka gjini të literaturës sonë, ku të mos flitet për jetën, përmendimeit, ndjenjat dhe luftën e rinisë sonë. Po kjo rini mos vallë rron e veçuar nga prindërit, nga gjyshërit, nga shokët, nga miqtë, nga populli? Jeta e saj, ndjenjat e saj janë të pleksura. S'ka të ri e të re mbi 13 vjeç te ne që të mos u turret me etje romaneve, vjershavë etj., që

nxjerrin vazhdimisht në dritë shkrimtarët dhe poetët tanë.

Sa mirë do të jetë, dhe kështu duhet, që edhe për të vegjlit të kemi botime më të thjeshta, edhe për të rinjtë e të rejet deri në njëfarë moshe të kemi disa krijime letrare më të thjeshta, më të kuptueshme. Të tilla krijime duhen botuar dhe duhet t'i shtojmë. Prandaj, ju të rinjtë, përktheni e krijoni edhe nga këto krijime të bukura e të përshtatshme dhe me siguri do t'ju botohen, por veç të mos i vini barrikadë ose ndarje literaturës për të rinjtë dhc asaj për të moshuarit. Ne nuk rrojmë në një regjim borgjez, prandaj e gjithë literatura që botojmë ne mund dhe duhet të vihet pa frikë në duart e rinisë, pse në të s'ka moral korruptues, ajo nuk është një literaturë pornografike dhe banditeske, por është pikërisht e atillë që edukon në mënyrë revolucionare dhe në rrugën e moralit proletar gjithë njerëzit tanë. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për teatrin, për baletin, për vallet popullore, për muzikën, për radion dhe për televizionin tonë. Çdo gjë te ne është në shërbim të edukimit të njeriut të ri, çdo gjë është dhe në përgjithësi zhvillohet në rrugë të drejtë. Por në mes tyre ka pjesë shumë të mira, ka të mira, ka mesatare, ka ndonjëherë edhe me gabime. Po edhe në këtë fushë ka luftë, ka përpjekje. Çdo gjë zhvillohet, e vjetra që depërtton luftohet e zëvendësohet me të renë. Edhe presioni i borgjezisë bën punën e vet, përpiqet të gjëjë të cara, nganjëherë edhe gjen, po luftohet edhe ai e zëvendësohet me të mirën, mprehet vigjilanca, merr hov krijimtaria pozitive. A mund të mendohet për një grimë që rinia jonë të përjashtohet nga gjithë ky zhvillim, nga kjo pjesëmarrje, nga kjo krijimtari, nga

kjo luftë që bëhet te ne? Në asnjë mënyrë jo, ndryshe kemi vrarë veten.

Në Luftën Nacionalçlirimtare, në momentin më kulminant të vështirësive e të tragedisë së kombit tonë, në momentet më me përgjegjësi të asaj kohë, rinia jonë u gjend në ballë të betejave dhe heroizmat e saj do të këndohen si legjenda në shekuj. A mundej që ne t'u thoshim në ato momente historike të rindjeve e të reja: «Rini në shtëpi, se lufta nuk është për ju, ajo është për burra!»? Po të bënim kështu sot nuk do të kishte Shqipëri të lirë socialiste. Literatura jonë aktuale, pra, kujt i këndon? Ajo u këndon pikërisht këtyre heroinave e heronjve 18-20-vjeçarë që komandonin brigada e divizione. A ka tema më të përshtatshme për rininë tonë se këto të kësaj periudhe heroike? Nuk ka. Rinia jonë duhet të dijë nga dolën gjithë këto vajza e këta djem me bark bosh, me këmbë zbathur, por me zemër luani që sakrifikuani deri jetën e tyre. Ky populli ynë trim e luftëtar i nxori ata nga gjiri i vet. Pse, a nuk janë të përshtatshme për rininë tonë vepra si «Komisari Memo» i Dritëro Agollit, «Kronikë në gur» ose «Gjenerali i ushtrisë së vdekur» të Ismail Kadaresë apo «Lumi i vdekur» i Jakov Xoxës e vepra të tjera si këto? Nuk është as mirë, as drejt të vëmë mure pa themelë në kulturën e shëndoshë të rinisë, por ta edukojmë, ta nxitim atë të lexojë, të lexojë dhe përsëri të lexojë dhe të nxjerrë mësime nga këto lexime.

Me këtë nuk dua të them që nuk lexohet. Në këtë drejtim ka përparime të dukshme, por të mos kënaqemi. Unë i drejtohem veçanërisht rinisë që të lexojë dhe të studiojë edhe më shumë akoma, se atdheu pret shumë

prej saj. Ne, të mos huarit, i ndiejmë boshllëqet e dijeve tona, se të tjera kushte kanë qenë ato tonat kur ishim të rinj, shumë halle tragjike na qenë vërsulur atëherë mbi kokë, prandaj duam dhe luftojmë që rinia jonë të mos ketë boshllëqe në dituri, pse të gjitha mundësitë dhe kushtet i ka, dhe më të mira akoma do t'i ketë dhe do t'i krijojmë në të ardhmen, me punë, me djersë dhe me dituri.

Dëshiroj, gjithashtu, t'i them rinasë se ne mund dhe duhet të shtypim edhe më shumë libra shkencorë, vepra letrare e botime të tjera për të. Jo se na pengon diçka nga vullneti për ta bërë këtë, por duhet ditur se kaq janë mundësitë aktuale të shtetit tonë. Ne po ndërtojmë shtypshkronja më të mëdha e më moderne nga këto që kemi dhe me siguri do të vijë shpejt koha që edhe më shumë të shtypim, por ua lë të rinjve e të rejave ta gjykojnë këtë çështje me njendjen dhe ndërgjegjen e tyre të pastër, se Partia më ka mësuar të kemi një bindje absolute te rinia dhe te gjykimi i drejtë i saj. Mos vallë pak janë botuar dhe botaohen literaturë artistike, literaturë shkencore, revista letrare e shkencore, tekste shkollore të të gjitha lëndëve e kategorive, gazeta politike, letrare, shkencore, leksione, studime të veçanta? Apo janë pak librat e huaj që vëmë çdo vit në dispozicion të inteligjencies sonë studioze në institucionet e ndryshme, si në Bibliotekën Kombëtare, në atë të universitetit, në bibliotekat e ministrive e deri tek ato të ndërmarrjeve? Ne themi që s'janë pak dhe jam i bindur se edhe rinia është në një mendje me ne. Vetëm se këto duhen shfrytëzuar seriozisht, shumë seriozisht.

Anembanë vendit sot s'ka fshat pa bibliotekë, pa

lëre qytetet, ku biblioteka gjen kudo. Po frekuentohen ato? Edhe po, edhe jo. Na thuhej se në to duhej nga një bibliotekar dhe shteti vuri nga një me rrrogë. S'kanë kulturë u tha, dhe u vunë njerëz me shkollë. Shokët e rinisë qahen se si bibliotekat, ashtu edhe shtëpitë e kulturës na kthehen në depo. Sa keq shokë! Po kush e ka fajin? Mos ka thënë Partia vallë që ato të kthehen në depo? Po ju ç'bëni, pse i lejoni? Ku janë komunistët, ku janë të rinxjtë? Si mund të lejohet të na ngjasin këto gjëra në kohën tonë të socializmit?

Më lejoni t'ju them diçka nga të kohës së kaluar të rinisë sonë në Gjirokastër, këtu e 50 vjet më parë. Ne vetë, nxënësit, me nga një lek që me vështirësi na e siguronin dhe na e jepnin prindërit tanë të varfér, kishim hapur dy klube në qytet, kishim ngritur biblioteka me librat tanë shumë të paktë, vetë kishim blerë disa vegla muzikore, ndonjë mandolinë e kitarë, të cilave mësuam t'u binim dhe me to dilnim në popull. Keni parasysh se klubet i fshinim dhe i pastronim vetë me radhë. Ndonjëri që dinte ndonjë gjuhë të huaj, lexonte libra dhe pastaj na mbledhje atje e na tregonte ngjarjet. Tani më janë zbardhur fllokët, megjithatë nuk mund ta harroj kurrë një Samuel Kofina, i cili tërë ditën lodhcj me topa beze në krah për të shitur ndonjë metër, kurse në mbrëmje, edhe ashtu si ishte i lodhur, vinte të na fliste herë për autorët e vjetër grekë si Homerin, Aristofanin dhe ndonjëherë për Alen Pinkertonin. As që mund të harroj, gjithashtu, Kamber Bilalin, njeri fukara me pantallona të grisura, që ditën punonte dhe lexonte dhe në mbrëmje vinte na fliste për romanet e Aleksandër Dymasë etj., na i tregonte pjesë-pjesë, me episode. Po sct,

si mund të na lejohet të sillemi kështu me librat, me bibliotekat dhe me shtëpitë e kulturës?

Edhe çështjen e argëtimit të rinisë, natyrishët, ne duhet ta shikojmë në mënyrë të gjerë dhe realisht. Por, para së gjithash, mendimi im është se shteti nuk ka qëndruar duarlidhur as në këtë drejtim. Ai ka investuar vazhdimisht fonde të konsiderueshme dhe përsëri do të investojë edhe paskëtaj, pse nevoja ka. Por të gjitha ato çka kemi ndërtuar dhe krijuar janë për rininë dhe ajo duhet t'i konsiderojë të sajat, t'i shfrytëzojë si duhet dhe të kujdeset për mirëmbajtjen e tyre e jo t'i prishë. Përveç kësaj, edhe iniciativa e bazës, sidomos e vetë rinisë, duhet të jetë më e gjallë e më frytdhënëse në këtë drejtim. Prandaj të reflektohet më thellë për ato çka thashë. Unë besoj që s'ka shtëpi kulture, ku të mos ketë vegla të ndryshme muzikore, shumë nga të cilat janë prodhuar brenda, janë sjellë edhe nga jashtë, dhe që të gjitha së bashku kanë ndihmuar shumë për argëtimin dhe edukimin e rinisë. Në këtë fushë, ka një zhvillim të madh, një përparim i madh është bërë kudo. Rinia i ka këto mjete në duart e saj, gjë që e shohim në estrada e në festivale. Kjo është një könaqësi e madhe. atëherë përse ta nënveftësojmë? Që duhen edhe më tepër, s'ka dyshim që po, dhe për këtë duhen bërë përpjekje, por të na errësohet çështja e të thuhet se çobanët që rrinë në verë në malet e Lenies e të Gramozit nuk paskan një radio ose atje nuk vete filmi, kjo është të flasësh në erë. Çdo çoban mund të blejë fare mirë një radio me bateri, po të dojë, se në treg ka dhe ditë-puna e tij është më e madhe nga e të tjerëve dhe jo të pritet që çdo gjë ta bëjë shteti. Shokë të rinisë, ju kërkon klube të shumta

të veçanta për rrininë në qytete dhe kjo, kudo ku të ketë mundësi, le të bëhet, por nga sa di unë edhe nga këto janë ndërtuar, janë pajisur me gjithçka, bile edhe me bilardo, po pastaj janë mbyllur sepse u larguan nga qëllimi për të cilin u ngritën. Kërkesa bëni, por njëkohësisht keni edhe detyra. Rinia kudo bën shumë, shumë gjëra të mira dhe kjo është karakteristika e saj, por më kanë thënë se shtëpinë e pushimit të bashkimeve profesionale në Voskopojë që iu dha studentëve për të kaluar pushimet shkollore të dimrit, gjatë ditëve që ata qëndruan atje, e dëmtuan. Kështu nuk mund të ecet shokë, shteti shpenzo e ndërto dhe ju dëmto. Kështu në mjaft vende janë ndërtuar kënde lojërash për fëmijë, po ato u zhdukën pa nishan, dikur u vunë telefona nëpër rrugë, ata u prishën nga disa të rinj të çrregullt.

Dakord që nuk i bën e gjilhë rinia këto, asnjeri nuk e thotë këlë, por ama janë të rinj ata që bëjnë veprime të këtilla, prandaj organizata e rinisë veçanërisht ka përgjegjësi për të gjitha këto gjëra të papëlqyera që ngjasin. Me policë mendoni ju, shokë udhëheqës të rinisë, t'i ruajmë këto që ndërtojni apo me edukim? Këtë punë edukative a jeni të ndërgjegjshëm se në një shkallë të madhe i pörket ta bëjë vetë organizata e rinisë, pa folur këtu për përgjegjësinë e madhe që kanë, gjithash, Partia, shkolla, familja, gjithë shoqëria? Nuk duhet harruar pastaj se atë edukatë që jepet dhe ashtu si jepet, me anët e mira dhe me të metat e saj, rinia duhet ta bëjë të sajën, të mirën ta rrënjosë në karakterin e saj, të keqen ta shkelmojë, nën çdo formë që të parqitet.

Pse nuk shpenzohen fondet që janë caktuar për ne-

vojat e rinisë? Në qoftë se është kështu, pse Partia dhe ju të rinjtë nuk e bëni këtë çështje të madhe? Ju mund të na thoni se nuk ju dëgjojnë dhe për këtë arsy e sollët çështjen në Sekretariat. Nuk them që ju bëtë keq që e sollët çështjen deri këtu dhe ne do t'u tërheqim vëmendjen organeve të Partisë dhe atyre shtetërore që shkelin ose që nuk i zbatojnë vendimet, por edhe juve ju them se puna nuk mbaron me kaq, duhet të luftohet fort në bazë, veçanërisht nga ju, kundër shtrembërimeve, kundër burokratizmit, rutinës e mospërfilljes.

Interesimi për zhvillimin e fizkulturës dhe të sporteve është me rëndësi të madhe. Partia këtë e ka theksuar kurdoherë. Edhe masa janë marrë e investime janë bërë, janë bërë, gjithashtu, edhe teorizime të shumta dhe vazhdojnë të bëhen për mënyrën, për metodat etj., etj. Por këto teorizime, sado të mira që të jenë, nuk japid shumë bukë, në rast se nuk ngjallin në rini dashurinë dhe domosdoshmërinë absolute për ushtrimin nga ana e saj të kulturës fizike. Në qoftë se rinia nuk e kupton këtë si një çështje që ka të bëjë me forcimin e shëndetit dhe jo për snobizëm, atëherë, sado mjete të vihen në dispozicion, nuk mund të ketë fizkulturë dhe sport në masën e rinisë. Dhe mjete janë vënë, mundet deri tanë akoma pak, por ato nuk përdoren si duhet.

Na kërkohet të hapim nëpër qytete dyqane të vëçanta për shitjen e veglave sportive. Edhe dyqane mund të hapen, po ato duhet të mbushen me artikuj sportivë. Të mos kërkojmë nga një të tillë në çdo qytet, por të hapim hëpërhë një ose dy. Më parë duhet menduar në mënyrë rationale çfarë nevojitet dhe sa kemi mundësi të bëjmë dhe jo të premtojmë e të mos bëhet gjë.

Ju na thoni se Qeveria ka marrë vendim që në çdo fshat, si dhe në lagjet e disa qyteteve të mëdha, të ndërtohen fusha lojërash të ndryshme. Ky është një vendim i mirë, sido që është shumë i guxiimshëm nga shtrirja. Por ja që ju na thoni këtu se një vit ka kaluar dhe as gjë nuk është bërë për zbatimin e këtij vendimi. Dëshiroj t'ju pyes, shokë: Po ju a c keni ndihmuar Qeverinë që t'i bëjë këto gjëra për ju, apo keni pritur dhe pritni që çdo gjë t'ju vijë deri në vend me tren, me kamion dhe në datën e caktuar? Unë besoj se këtë vendim të Qeverisë nuk e keni shikuar si duhet as ju, as rrethet, as ndërmarrjet. Unë mendoj se shteti duhet të ndihmojë medoemos në këtë drejtim, por në asnjë mënyrë të mos pritet çdo gjë nga shteti, pse shumë e shumë gjëra duhet t'i bëni vetë me iniciativën tuaj, duhet t'i bëjnë ndërmarrjet, t'i bëjnë rrethet.

Të gjitha mundësitë janë që të krijoni ju vetë terrene të vogla sportive në lagjet e qyteteve, të ndërtoni me ndihmën e ndërmarrjeve fusha lojërash për pionierët, të bëni ekskursione në vende piktoreske dhe mendoj se nuk është e domosdoshme të ngremë një dyqan të posaçëm për të bërë këpucë alpine dhe as që jemi në gjendje hëpërhë të sjellim me mijëra ski nga jashtë për këtë lloj sporti që nuk është i zhvilluar akoma te ne, prandaj ta zhvillojmë atë më parë me ski primitive, që vetë të rintjtë mund t'i bëjnë.

Është e drejtë kritika që u bëni ju mësuesve që nuk kujdesen për edukimin jashtëshkollor të fëmijëve, që është pjesë përbërëse e detyrës së tyre. Kush e kupton ndryshe këtë, ai gabon. Natyrisht, ky interesim du-

het të shoqërohet edhe nga organizata juaj, nga familja dhe nga tërë shoqëria.

Ju ankoheni, gjithashtu, me të drejtë për mungesë si në numër dhe në cilësi të shkrimeve për pionierët. Shkrimtarët tanë duhet të reflektojnë thellë për këtë mungesë me rrjedhime të rënda. Këtu ju jep të drejtë juve, por njëkohësisht ju them se kaq të rinj me talent që kanë dalë nga radhët tuaja, që njojin jetën e ndjenjat e pionierëve, që kanë qenë më parë vetë të tillë, çfarë bëjnë? Po ju çfarë bëni me ta? Sa ndikoni ju tek ata që të specializohen në këtë drejtim? Mos ju duket vallë shkrimi për të vegjlit si diçka e lehtë, pa rëndësi, pa perspektivë, pa «famë»?

Prandaj Komiteti Qendror i Partisë u bën thirrje shkrimtarëve tanë të talentuar që të mos harrojnë të shkruajnë si për rininë ashtu dhe për pionierët. Letërsia për fëmijët është shumë e rëndësishme, shumë e domosdoshme dhe vetëm njerëzit me talent dhe të pasionuar mund të nxjerrin krijime të këndshme dhe edukative për lulet më të bukura të kopshlít tonë socialist.

Ju keni bërë mirë që u jeni drejtar me një material tuajin organeve ekonomike dhe deri Këshillit të Ministrave për disa probleme kryesore që ngre rinia për çështje ekonomike. Unë nuk jam njojur me këtë raport tuajin, por një sërë çështjesh të rinasë në prodhim i njoh. Mendimi i Partisë është se rinia qëndron në pararojë dhe punon kudo shumë mirë, kjo është karakteristika dalluese e saj. Por edhe nga ana e saj, si edhe tek të tjerët, ka të meta në punë.

Ju shprehni dëshirën e rinasë kooperativiste që të punojë me orar të kusizuar dhe brenda kësaj kohe të

realizojë e të tejkalojë planin etj. Kjo është një dëshirë, por që për fat të keq nuk po realizohet as në fabrika, ku disiplina në punë është më e madhe, pa lëre në koooperativat bujqësore. Për këtë kur them në fabrika flas me kompetencë, me kronometrime dhe jo me hamendje. Punëtorët në fabrika, për të mos folur për nëpunësit, të cilët zor është të kontrollohen, në vend që të punojnë tetë orë plot, punojnë gjashtë deri gjashtë orë e gjysmë që maksimalja shtatë orë. Në fshat koha e punës zbret deri në pesë ose në gjashtë orë. Atëherë pse bëni fjalë për të bërë tetë orë, apo çë rinia e fshatit të bëjë pesë orë në ditë? Mund të më thuhet se kjo nuk është kështu. Mundet, po atëherë na e vërtetoni. Por vetëm të dini një gjë, se i riu në kooperativë s'punon i izoluar, ai punon në brigadë, prandaj tok me brigadën duhet ta fillojë dhe ta mbarojë punën. Të mos harrojmë, gjithashtu, se puna e punëtorit kontrollohet, sido që ky kontroll duhet forcuar akoma, po duhet kontrolluar, gjithashtu, edhe shata që hedh kooperativisti, pse nga goditja e shatës varet vonesa në punë, apo ikja shpejt, kurse lekët ai i merr në çdo 15 ditë dhe rezultatin e punës e sheh në fund të vitit. Ju thoni me lehtësi se ky pretendim i rinisë fshatare nuk është i tepruar, por mos harroni se edhe prodhimi bujqësor ka kërkuesat e veta, ka disiplinën e fortë të tij, mënyrën dhe sasinë e punës i ka të llogaritura. Shumë nga drejtuesit e bujqësisë në fillim marrin zotime dhe bëjnë premtime të bujshme, kurse në fund shohim të krijohen shumë deficite. Në bujqësi ka, gjithashtu, brigada të së njëjtës kooperativë, ku punojnë të rinj të atillë që natën e bëjnë ditë dhe bëjnë mrekulli, kurse ka brigada të tjera ku, megji-

thëse ka mjaft të rinj, qëndrojnë shumë prapa. Kjo nuk do të thotë se rinia e fshatit nuk argëtohet e nuk çlodhet. Megjithatë puna duhet organizuar më mirë, mekanizmat duhen përdorur më mirë, shumë punime duhen mekanizuar që të fitohet kohë, por të bëhet ashtu si thoni ju, më duket se do të jetë e zorshme. Të rinjtë e të rejet kooperativiste të plotësojnë më parë është së bashku me kjo përfundimtore bujqësore nuk është diçka e fiksuar si në fabrikë, pse në bujqësi do të duhet të punohet edhe më shumë, pasi ka momente që kooperativistët lidhin duart, jo se duhet t'i lidhin, por këtë e bëjnë përfundimtore të pirë cigare, apo përfundimtore të bërë muhabete pa mbarim.

Gjithashutu, mua më duket si një gjë e pakonceptueshme që, meqenëse në disa vende pune punohet me tri turne, në to ne duhet të ndryshojmë krejtësisht ndërtimin e gjithë punës kulturore, artistike, sportive etj. Ndonjë gjë e vogël, kur ka mundësi, le të shikohet, si fjala vjen, ndonjë kinema të punojë edhe në mëngjes përfundimtore e turneve të dyta e të treta, por që të bëjmë ndryshime rrënjosore në këtë drejtim, kjo është e vështirë, sepse neve na mungojnë mjetet, personeli etj., etj.

Më falni, shokë të rinisë, se mund t'ju duket sikur kjo biseda ime përmban një sërë qortimesh përfundimtore tuaj. Kjo deri diku është e vërtetë, por duhet thënë se në punën e rinisë sonë ka shumë të mira që janë të mëdha, si në numër, ashtu edhe në vlera morale, ideologjike dhe politike, dhe shumë fryshtëzuese përfundimtore gjuhë, por midis gjithë këtyre ka edhe të meta. Këto të meta na lejohet t'i fshehim? Jo, shokë! Kështu nuk na

mëson Partia, përkundrazi ato duhet t'i vëmë mirë në dukje, me qëllim që t'i ndreqim dhe sa më shpejt.

Mund të përdorja edhe një formë tjeter pak më të lehtë për t'i vënë në dukje të metat që parashtrova, por unë mendova se shokët e Sekretariatit të Komitetit Qendror të Rinisë pavarësisht se janë të rinj nga mosha, janë komunistë të pjekur, atyre Partia dhe rinia u ka dhënë të drejta dhe u ka ngarkuar detyra të rëndësi-shme. Pastaj këta shokë le t'i dëgjojnë këto vërejtje nga ne, kështu siç i mendojmë, pse ata dinë vetë se si t'i gjejnë format më të përshtatshme për t'ia shtuar rinisë. Në e kuptojmë fare mirë rininë tonë të mrekullueshme dhe jemi më se të bindur se edhe rinia na kuption ne të brezit më të vjetër.

Lufta e Partisë për edukimin e punonjësve dhe të rinisë, përveç të tjerave, duhet parë edhe në lidhje me luftën që bëjnë armiqtë imperialistë e revizionistë kundër vendit tonë, me presionin ideologjik që ata ushtrojnë mbi njerëzit tanë.

Partia ka folur e flet vazhdimisht për rrithimin imperialisto-revisionist. Më duket se kjo tezë realiste e Partisë shprehë nga disa kuptohet ngushtë, ajo merret vetëm si nocion gjeografik dhe si një paralajmërim që të jemi kurdoherë të gatshëm ushtarakisht për t'i bërë ballë agresionit eventual të këtyre armiqve të egër të atdheut tonë socialist. Por kjo është e një-anshme.

Është e domosdoshme të kuptohet thellë se rrithimi imperialisto-revisionist shprehet çdo ditë e çdo orë me anë të presionit të madh ideologjik, që ka për qëllim të çoroditë mendjet e atyre njerëzve tanë të shkujdesur,

të shthurë ekonominë dhe organizimin tonë, të degjenerojë politikisht e moralisht masat e në mënyrë të veçantë rininë e inteligjencien tonë, të dobësojë fryshten revolucionare e të ushqejë indiferentizmin dhe apolitizmin. Me këtë rrugë revizionistët morën pushtetin në Bashkimin Sovjetik dhe në shumë vende të tjera. Këtë eksperiencë të hidhur asnjëherë të mos e harrojmë.

Elementi armik brenda vendit, i nxitur nga imperializmi e revizionizmi, në forma nga më të ndryshmet i ka përvetësuar dhe përpinqet t'i zbatojë këto taktika në luftën e vet kundër Partisë e pushtetit popullor. Armiku nuk del dot haptazi kundër vijës së Partisë, sepse e di që mbi të do të bjerë i fuqishëm grushti i pushtetit popullor, por përpinqet të deformojë direktivat e Partisë e të pushtetit. Ai ka frikë të dalë hapur, për shembull, kundër kooperativave bujqësore apo të sabotojë siç do ai prodhimin, sepse e di që e pëson shumë keq, por në forma të ndryshme ai nxit shthurjen e disiplinës në punë, atje ku mundet inkurajon tendencat për të vënë mbi gjithçka interesin e ngushtë personal, përpinqet të pengojë iniciativat revolucionare për vendosjen e normave të përparuara, për rritjen e rendimentit etj. Elementi armik nuk bën dot haptazi thirrje kundër pushtetit popullor, kundër socializmit, sepse e ka provuar dhe e di se vetë masat punonjëse, vetë rinia jonë revolucionare do t'i hidhej në fyt për ta varrosur të gjallë, prandaj, për t'ua arritur qëllimeve të tij armiqësore, përpinqet të degjenerojë pushtetin e rendin tonë socialist me anë të inkurajimit të liberalizmit e të indiferentizmit, të hapjes së shtigjeve përfutjen te ne të ndikimeve të huaja, si në arte e letërsi, në mënyrën e

sjelljes, në modë etj. Prandaj ne duhet të jemi vigjilëntë që të vëmë re jo vetëm shfaqjet dhe ndikimet e huaja që janë evidente për t'u kuptuar, por edhe ndonjë prirje të maskuar në disa shkrime që botohen për letërsinë, për teatrin ose për muzikën tonë, me qëllim që të diktohen me kohë disa njolla, të cilat, po t'i lëmë pa goditur, do të trashen e do të bëhen me brirë. Është e domosdoshme që këto probleme të bëhen objekt i luftës sonë ideologjike në frontin e letërsisë dhe të arteve, sidomos për disa gjëra që nuk tingëllojnë mirë.

Një nga format e punës për të ngritur nivelin ideo-politik e kulturor dhe për të mprehur vigjilencën e njerëzve tanë janë diskutimet dhe debatet, prandaj të mos u sillet asnjë pengesë ballafaqimit të mendimeve të kundërta dhe rrahjes së gjithanshme të problemeve. Diskutimi në tym, pa u përgatitur dhe sa për të thënë diçka, është i gabuar. Të flasësh për të aprovuar diçka, pa ditur përse është çështja, do të thotë të shprehësh mendime pa baza dhe pa vlerë. Diskutimi objektiv, në bazë të një shkalle njohjeje të mjaftueshme, është kurdoherë i dobishëm. Duke gjykuar për një vepër letrare ose artistike, mund të ngresh anët e mira dhe të këqija në drejtim të stilit, të ndërtimit, të gjuhës etj., si dhe të natyrës politike dhe ideologjike të saj. Të metat në stil, në ndërtimin e veprës, në bukurinë e shprehjeve etj., janë të meta të rritjes, ndërsa çështjet e natyrës politike dhe ideologjike janë jashtëzakonisht të rëndësishme. Ne mund të pranonim një vepër të shkruar dobët nga ana stilistike, por nuk mund të pranojmë në asnjë mënyrë një vepër ku ka dhe mbrohen pikëpamje reaksionare. Diskutimi në të gjitha këto fusha është

i nevojshëm, bile i domosdoshëm, ai duhet të bëhet i gjallë dhe revolucionar, sidomos kundër pikëpamjeve të huaja.

Ka raste kur shprehet ndonjë mendim i çoroditur, sipas të cilit u dashka që ne të ndjekim symbyllur rrugën e zhvillimit evropian. Jo, shokë, ne nuk mund dhe nuk duhet të ndjekim «rrugën e Evropës», përkundrazi është Evropa që duhet të ndjekë rrugën tonë, pse nga pikëpamja politike ajo është shumë prapa nesh, është shumë larg asaj për të cilën luftuan Marks, Engelsi, Lenini dhe Stalini dhe për të cilën lufton sot Partia jonë. Sigurisht, nuk mund të mohohet që në Evropë ka edhe gjëra të mira, sidomos në drejtim të zhvillimit të shkencës dhe të teknikës. Këto realizime nuk i hedhim poshtë, por në asnje mënyrë nuk mund të pranojmë që politikisht «të zhvillohem si pas rrugës evropiane». Është krejt ndryshe kur përpinqemi të marrim nga vendet josocialiste diçka në fushën e zhvillimit material. Në jetën e përditshme përdoret nganjëherë shprehja: «E ka nxjerrë fröngu këtë». Populli ynë e ka përdorur këtë shprehje për të vënë në dukje mjeshtërinë dhe zotësinë e atij që e ka prodhuar atë dhe nuk është vështirë të kuptosh se sendi i ardhur nga jashtë që të pëlqen nuk është aspak vepër e borgjezisë së korrupuar, por e klasës punëtore dhe e asaj inteligjencie teknike të vendit ku është prodhuar, e cila është shkrirë në punë dhe shfrytëzohet egërsisht nga kapitali dhe jeton në vuajtje e në mjerim. Duke i pasur mirë të qarta këto çështje, atëherë do të jemi nü gjendje t'u kundërvihemi si duhet dhe t'u tregojmë vendin atyre, që, për

qëllime politike të caktuara, na rekomandojnë të ndjekim «rrugën evropiane të zhvillimit».

Ka disa që mendojnë se vrulli i luftës kundër shfaqjeve e ndikimeve të huaja do të zgjatë një muaj ose e shumta një muaj e gjysmë, pastaj ai do të bjerë dhe do të kalohet në ndonjë tjetër slogan. Jo, shokë, Partia ka punuar, punon e do të punojë vazhdimesh që te ne zhvillimi i revolucionit në fushën e ideologjisë e të kulturës, që karakterizohet nga lufta klasore kundër të gjitha formave të ideologjisë së huaj, nuk do të zhvillohet as për një muaj dhe as për dy, po për një kohë shumë të gjatë, për dhjetëra e dhjetëra vjet.

Shfaqjet e ideologjisë borgjeze e revisioniste janë dukur veçanërisht këto vitet e fundit, kur Partia po lufton me intensitet dhe frontalisht për revolucionarizimin e saj, të rinasë dhe të të gjitha masave të gjera të popullit. E keni konstatuar këtë fenomen ju shokët e rinasë? Pse filluat të vepronit ju vetëm kur sola unë në Presidiumin e Kuvendit Popullor? Nuk qenë ngritur ndonjëherë tjetër më parë nga Partia këto probleme?!

A ta merr mendja ty shoku Ilia¹, që, për shembull, rinia e Vlorës, me gjithë ato tradita të mëdha heroizmi e luftëresh shembulllore për Shqipërinë kundër Italisë borgjeze dhe fashiste, ta presë me brohoritje vënien në skenë të këngëve të shthurura italiane, të kënduara në italisht, për dashurinë? Kjo gjë nuk u lejua të bëhej, por ata që drejtojnë këto punë e kishin vënë në plan dhe bënин prova për t'i shfaqur të tilla këngë. Një pjesë

1. Ilia Kongo, në atë kohë sekretar i parë i Komitetit të BRPSH për rrethin e Tiranës.

e rinisë, meqë nuk kishte sinjalizim dhe meqenëse ai që e vinte në skenë pretendonte se «i kishte ardhur pëlqimi nga lart», nuk ishte çudi që mund t'i duartrokiste këto këngë pa përmimbajtje të shëndoshë. Ne duhet të punojmë që njerëzit të gjykojnë vetë dhe, kur shohin skena të tillë, të kenë guximin e të thonë: «Qërohu këtej me këtë shfaqje! Në qoftë se vërtet ke marrë aprovimin në Tiranë, u shkruaj atyre që të kanë thënë, se nuk janë në rregull. Ne, këtu në Vlorë, nuk këndojmë këngë të shthurura dashurie italiane».

Ju nuk duhet të tërhiqeni nga pikëpamjet tuaja edhe kur ju thonë se këtë çështje e ka parë dhe e ka vendosur Partia, sepse, nën maskën e Partisë, në disa raste, mund të fshihen shumë gjëra të këqija. Në qoftë se kritika për radiotelevizionin bëhet deri në njëfarë shkalle, por nuk shkon gjer në fund, atëherë problemet rrumbullakosen dhe, për të mbuluar dobësitë, thuhet: «Epo këto i ka vendosur Partia», «Këto i di Partia». A e kuptioni ju, se kështu mund të bëhen gabinie të mëdha? Partia, direktivat i ka të drejta, por ato shtrembërohen nga disa njerëz. Këta që shtrembërojnë direktivat e Partisë, t'i vëmë përpara përgjegjësisë, duke luftuar mendimet e tyre nëpërmjet diskutimit dhe debateve, të cilat, kur zhvillohen në frymë të drejtë marksiste-leniniste, ndihmojnë shumë për të gjetur rrugën e daljes. Në qoftë se edhe diskutimet e forta nuk e zgjidhin çështjen, atëherë Partia shikon thellë tërësinë e problemit dhe nxjerr konkluzionin e saktë se kush ka përgjegjësi. Tashti që u ngrit me të madhe ky problem nga Partia, të tërë ata që kanë gabuar i kanë mbledhur këmbët.

Pse nuk e botuat ju në gazeten «Zëri i rinisë» artikullin që ishte përgatitur për Festivalin e 11-të të Këngës në Radiotelevizion? Në atë shkrim ju shprehni mendimet që kishit për festivalin. Ishin ose jo të drejta ato që përbante artikulli, atë e vendosni ju, sepse «Zëri i rinisë» është organ i Komitetit Qendror të BRPSH. Asnjë të drejtë nuk kishte Todi Lubonja t'jua kërkonte artikullin për ta shikuar para botimit. Ai e bëri këtë, pasi kisha folur unë në Presidiumin e Ku-vendit Popullor, ku, midis të tjerash, kritikova festivalin, sepse para kësaj kohe ai notonte në sfera kënaqësie. Ju ia dërguat pa arsyesh shkrimit Todit, i cili, pasi e lexi, ju kishte shkruar se artikulli ishte «as mish, as peshk». Ku ishte guximi juaj që, pavarësisht nga mendimi i një tjetri, të botonit në shtyp mendimet tuaja ashtu si i kishit dhe të merrnit përgjegjësi përpara Partisë? Në qoftë se ju nuk do të kishit mendime të drejta, Partia do t'ju kritikonte dhe do t'ju sqaronte. Në qoftë se e kishit mirë. Atëherë do të hynit në një konflikt të domosdoshëm me shokët e radiotelevizionit dhe do ta ndihmonit Partinë. Në rastin konkret ju mund t'i thoshit Todi Lubonjës: «Ne kemi mendimin tonë, çfarë do ti që po na ndërhyjn?». Siç tha shoqja Lumturi [Rexha]¹ as ju, as disa të rinj, që kishin mendime për festivalin, Todi nuk ju pyeti. Atëherë, me ç'të drejtë ai kërkoi të kontrollonte artikullin që deshët të botonit? Në këtë rast ju duhej t'i kishit thënë: «Pakthe krahët dhe mos u fut aty ku s'të takon!».

1. Në atë kohë, sekretare e KQ të BRPSH.

Ju mund të na thoni se artikulli nuk ishte në rregull. Po të jetë kështu, bëtë mirë që nuk e botuat në gazetë, sepse mund të krijohej një situatë jo e kënaqshme për rininë dhe udhëheqjen e saj. Por unë e ngrë problemin nga pikëpamja e mbrojtjes me kurajë të mendimeve dhe e mbajtjes së përgjegjësisë për veprimet që kryeni. Edhe po ta kesh gabim një mendim, është më mirë ta thuash sesa ta mbash në kokë.

Edhe kur një shfaqje teatrale e shikon ndonjë nga udhëheqësit, kjo nuk do të thotë që ai të realizojë menjëherë, aty për aty, në të tëra hollësitë, anët e mira dhe të dobëta të pjesës që shfaqet. Në qoftë se udhëheqësit i kërkohet mendimi menjëherë, ai mund të thotë aty për aty edhe diçka jo shumë të bazuar, por, kur kthehet në shtëpi dhe reflekton dalngadalë, atëherë është në gjendje të japë një gjykim më të saktë. E mira është që në këto raste, të mos shpejtohem i dhënien e mendimeve, sidomos kur diçka shfaqet për herë të parë.

Unë, kur pashë dramën «Njollat e murime», që në fillim nuk e aprovova. Kur dola në pushim, Thoma Deliana më shfaqi mendimin se ajo ishte «shumi e bukur», «pjesë e re», «novatore» ctj. Unë nuk thashë asnje mendim. Pasi e pashë gjer në fund, atëherë i thashë Thomait se drama më dukej e gabuar dhe, sipas mendimit tim, nuk e vlente të shfaqej më në skenë.

Edhe kur u organizua festivali i fundit në radio-televizion, disa këngë mund të ishin të bukura, prandaj ndonjë shok me përgjegjësi mund të ketë thënë fjalë të mira për to. Por, ata që janë të predispozuar të përziejnë të mirën me të keqen, mezi presin për t'i

marrë kapital këto fjalë dhe për të interpretuar e propaganduar çdo gjë sipas dëshirës së tyre.

Unë nuk e barazoj gabimin e një të rrituri me pikëpamje moderniste me atë të një djali të ri, që nuk e kuption të keqen, duke kujtuar se ajo është e mirë, pasi i thonë sikur gjoja e ka rekomanduar Partia. Këtë gjë i riu e mendon me gjithë shpirt, sepse për Partinë ai është gati të hidhet në zjarr. Por, njerëzit me pikëpamje moderniste, që synojnë për ta çuar rininë në një rrugë të shtrembër dhe punojnë shtatë-tetë muaj të tërë për të shfaqur publikisht gjëra të papëlqyera, duhet të gjykohen ndryshe. Kur këta thonë që «kështu gjykoi udhëheqja», se «për të kënduar në festival këto këngë, dha urdhër udhëheqja, që i shikon më mirë këto gjëra» etj., kanë për qëllim të mbytin kritikën nga poshtë. Pikërisht këtu qëndron një nga anët e dobëta të kësaj çështjeje. Me këto parulla, të tillë njerëz duan t'i rrumbullakosin e t'i mbulojnë sajet e tyre para të rinjve dhe masave, duke e paraqitur çështjen sikur një shok udhëheqës i Partisë i ka thënë një shoku të tyre, se gjoja i ka pëlqyer shumië kjo osc ajo pjesë, e cila është luajtur në skenë. Këto llafe qarkullojnë gojë më gojë dhe fjala që mund të ketë thënë ndonjë shok që: «Kjo vepër apo këngë sikur nuk ishte e keqe», shndërrohet në mendim të udhëheqjes, sikur gjoja ajo është shprehur se qenka shumë e mirë!¹

1. Njerëz me pikëpamje moderniste e liberalce, spekulonin me shprehjet: «Kështu mendon udhëheqja». «Këtë e di udhëheqja». Në të vërtetë, fyrmenzues i pikëpamjeve dhe i tendencave të shtrembra ishte Fadil Paçrami, i cili, duke qenë anëtar i KQ të Partisë dhe sekretar i Komitetit të Partisë të Tira-

Nuk rrezikohet Partia kur edhe një udhëheqësi kryesor të saj, që ka bërë një vlerësim të gabuar, t'i thuhet: «Ti, shok, ke vepruar gabim!» Në një rast të tillë, përkundrazi i bëhet shumë mirë Partisë dhe vetë udhëheqësit që të ketë mendjen dhe të mos nxitohet herë tjetër në vlerësimet që bën. Prandaj, të mos thuhet mendimi, duke u nisur nga fakti se këtë çështje e paska parë një shok i Partisë. Kjo është jo një herë, por dhjetë herë e rëndë. Në këtë drejtim duhet kuptuar rëndësia e madhe e kurajës komuniste për të luttuar të metat ashtu si mendon secili. Diskutimi dhe debati nxjerrin në pah të vërtetën.

E dini se çfarë thonë njerëzit, more shokë? «Pse këto probleme i ngre shoku Enver dhe nuk i ngrenë edhe shokët e tjerë të udhëheqjes?» Këta që shprehen kështu janë njerëz të mirë, por naivë. Ata nuk e kuptojnë që s'është e vërtetë se këto çështje i kap dhe i ngre vetëm unë; ato i ngrenë gjithë shokët e udhëheqjes. Unë, si Sekretar i Parë i Komitetit Qendror të Partisë, bëj përgjithësimin e tyre në bazë të problemeve që ngrenë udhëheqja, Partia dhe opinioni shoqëror; këto i ngre lufta jonë si nevojë objektive për ndërtimin e plotë të socializmit në Shqipëri. Ndonjëri, këtë çështje e ngre edhe me qëllime të këqija për të lënë të kuptohet sikur shokët e tjerë të udhëheqjes nuk vlekan. Kjo paraqitje e shtrembër e realitetit është një nga çështjet më të rrezikshme. Prandaj të punojmë për të arritur në atë që populli dhe Partia të mos e

nës, për propagandën, krijonte përshtypjen sikur ato që thoshte ai ishin të udhëheqjes së Partisë.

shohin gjithçka vetëm nga një person, por forcën ta shikojnë në veten e tyre, në vijën e drejtë të Partisë, te njerëzit dhe kuadrot e qendrës dhe të bazës, në udhëheqjen kolegjiale, në unitetin e mendimit dhe të veprimit. Të mos gënjehem kur thotë dikush: «Shumië mirë që keni shokun Enver!». Të mos kënaqemi kur dëgjojmë të tilla shprehje, sepse këto, siç thashë, kanë edhe presën tjetër të rrezikshme.

Guximi juve të rinjve nuk ju mungon, por mos i nënvlerësoni kapacitetin, mendimet e kulturën që keni. Kur unë fola në Presidiumin e Kuvendit Popullor, festivali i këngës në radiotelevizion kishte mbaruar. Ne, këtu, bashkë me shokët, kishim kohë që patëm shfaqur mendime rreth këtij festivali dhe kishim dënuar anët e tij të këqija. Por, gjatë kësaj kohe, unë mora shumië letra nga rinia, të cilat jo vetëm na i përforcuan mendimet që kishimi kristalizuar për festivalin, por na dhanë të kuptojmë se rinia jonë nuk është në ato pozita që mund të hajë çfarëdo ushqimi që mund t'i japidisë disa njerëz të veshur me autoritet. Arsyetimet që parashtrohen në këto letra ishin shumë të shëndosha dhe të drejta¹. Unë gjeta rastin në Presidiumin e Kuvendit Popullor dhe, duke marrë shkas nga çështja që shqyrtohej atje, fola për problemet që dihen², duke

1. Ky qëndrim i shëndoshë i rinisë së vendit tonë u shpreh edhe në faqet e gazetës «Zëri i rinisë», në diskutimin e gjerë që u zhvillua në këtë kohë për Festivalin e 11-të të Këngës në Radiotelevizion, si edhe për «të bukurën dhe të kulturuarën në jetën dhe në artin tonë», ku morën pjesë të rinj e të reja të profesioneve të ndryshme nga të katër anët e vendit.

2. Shih në këtë vëllim, f. 1.

përmendur të metat e shokëve, veçanërisht të Agim Meros, që duhej të reflektonte më shumë, pse deri kohët e fundit ai kishte qenë sekretar i parë i Komitetit Qendror të BRPSH dhe sot është rektor i universitetit.

Këtu, në këtë drejtim, vihen re disa kontradikta që mund të mendohet se i nxjerr në dukje situata revolucionare në ngritje, por këto shfaqje nuk kanë thjesht këtë karakter, prandaj parulla e ngritjes revolucionare, që përmendet në këtë rast, të mos na gënjejë. Ne po e përmirësojmë vazhdimisht nivelin e jetesës së popullit, arsimi dhe kultura po zgjerohen, duke ngritur çdo ditë nga të katër anët shkolla dhe institucione të reja kulturore, në dyqanet tona qytetari ka ç'të blejë etj., atëherë pse të ketë vjedhje, grabitje dhe disa shfaqje të tjera të shëmtuara? Prandaj të thellohem si duhet në këto drejtime për të gjetur shkaqet e vërteta.

Është e domosdoshme që Partia t'i trajtojë ideologjikisht mirë shfaqjet që kanë lindur si rezultat i qëndrimeve liberale dhe ku e kanë burimin ato, se sjelljet e këqija vijnë edhe duke kopjuar symbyllazi nga bota e jashtme, edhe nga shtrembërimi i vijës së Partisë. Është e domosdoshme të luftohet me këmibëngulje, në radhë të parë, kundër pikëpamjeve filozofike antimarksiste që sillen nga jashtë dhe trajtohen andej-këtej qosheve, dhe në çdo rast ato duhet të trajtohen thellë dhe të goditen ata që i propagandojnë dhc i mbrojnë haptazi apo në mënyrë të fshehtë në fushën e artit, të kulturës, në jetën tonë të përditshme. Dhe atëherë rinia jonë trime, së cilës nuk i ka munguar asnjëherë guximi, do të bëhet e qartë dhe, kur ndeshet me të tilla pikëpamje, do të jetë në gjendje të hedhë poshtë

një pikëpamje të gabuar ose një vepër letrare apo artistike që nuk vlen, do të gjykojë vetë dhe do të ketë kurajën të kundërshtojë çdo gjë që nuk përputhet me vijën e Partisë që shtrembërohet nga disa njerëz.

Partia ka për detyrë që të edukojë drejt gjithë puttonjësit dhe masat e rinisë për të irritur vazhdimisht vigjilencën revolucionare ndaj rrezikut të madh që paraqit presioni i vazhdueshëm imperialisto-revizonist ndaj vendit tonë dhe veprimitaria e armiqve të klasës. Askujt nuk i lejohet ta marrë lehtë këtë luftë, të rrojë në eupori, përkundrazi, secili e ka për detyrë të luftojë me radhë të shtrënguara duke pasur parasysh rrezikshmërinë që paraqitin tani përpjekjet e gjithanshme të armiqve kundër nesh, që janë, si të thuash, edhe njëfarë parapërgatitje e llogaritur nga imperialistët e revisionistët për veprime akoma më të acaruara e më agresive kundër Shqipërisë socialiste. Veçanërisht nuk duhet ta marrë lehtë këtë luftë rinia, që, për natyrën dhë moshën e saj, për mungesën e eksperiencës, është objekt i këtij presioni të madh ideologjik nga ana e armiqve, të cilët me çdo kusht vazhdimisht përpiken e do të përpiken ta vënë brezin e ri në kundërshtim me brezin më të vjetër.

Ju, shoku Sekretar i Parë i Komitetit Qendror të Rinisë, në diskutimin tuaj përmendët punën që do të bëni për një sërë problemesh. Shumë mirë për sa do të bëni, por ju këshilloj të mos kënaqeni duke folur në vija të përgjithshme rreth direktivave që janë lëshuar nga Partia. Kur thoni «duhet t'i vëmë gishtin plagës», ta vini gishtin me të vërtetë në plagë, me drejtësi, pa qenë as të ashpër, por as liberalë. U shpjegoni atyre

të rinxje që kanë të meta se ku të çojnë këto dhe i kë-shilloni për të ardhur në rrugë të drejtë. Në qoftë se ndonjëri nuk ndreqet me punën individuale të shokëve dhe me atë që është bërë në organizatë, e kritikoni përparrë masës; në qoftë se edhe kështu nuk merr vesh, atëherë të merren masa të tjera me karakter edukativ. Unë nuk besoj që organizata e Partisë, ajo e rinisë dhe të gjitha levat e tjera, kanë ndenjur pa folur kundër shfaqjeve të huaja, po e keqja është se për ato janë thënë më shumë fjalë të përgjithshme, punët nuk janë marrë shtruar, prandaj dhe rezultatet nuk janë të kë-naqshme.

Thashë më lart se këtë luftë duhet ta bëjmë me radhë të shtrënguara. Kjo do të thotë që çdo komunist, çdo i ri e patriot të ketë gjithnjë parasysh se ne ndërtojmë socializmin në kushtet e bllokadës imperialisto-rezisioniste. Mirëpo ky fakt shpesh nënveftësohet dhe kujtohet se bllokadës mund t'i bëhet ballë pa sakrifika. Një pikëpamje e tillë e gabuar shprehet edhe në kërkësat që bëhen, pa baza e pa kriter, që çdo gjë ta bëjë shteti, ajo duket edhe në lëshimet që vihen re jo vetëm në lëmin ideologjik e moral, por edhe në ekonomi. Është fakt që te ne, si në qendrat e punës, në fshat, në shkolla e kudo, disiplina e punës nuk është kurdoherë në lartësinë e duhur, shpesh nxirren prodhime me cilësi të dobët, tejkalojen normat sepse këto nuk janë të bazuara, mësohet sa për të marrë notën 5 apo 6, e kështu me radhë. Dhe ndodh shpesh që pak ngrihet zëri kundër këtyre fenomeneve negative, pak kërkohet llogari, ndërsa, po të mos ketë diçka në treg, për këtë nuk mungojnë të shkruajnë deri edhe në Ko-

mitetin Qendror apo në Qeveri. Që të ketë tregu me bollëk, më parë ne vetë duhet të prodhojmë me bollëk. Pastaj Partia ka theksuar gjithnjë se për të qenë gati për çdo të papritur, përveç furnizimit të rregullt të tregut, ne kemi nevojë edhe për rezerva. Por si do t'i krijojmë këto? Vetëm me punë të ndërgjegjshme, me një disiplinë të fortë shtetërore proletare, duke bërë një jetë më të thjeshtë e jo duke lëshuar dorën e duke ushqyer prirjet për të kënaqur luksin mikroborgjez të disave.

Prandaj duhet të punojmë më mirë për edukimin e punëtorëve, kooperativistëve, inteligjencies dhe rinisë me botëkuptimin tonë komunist. Ne duhet të vendosim kudo një disiplinë të rreptë në prodhim e në çdo punë të bazuar në një edukatë të shëndoshië proletare. Kështu do të luftohet edhe liberalizmi që shfaqet në një raste.

Luftha kundër ndikimeve e shfaqjeve të huaja, luftha për edukimin revolucionar të masave, sidomos të rinisë, duhet bërë kurdoherë sipas mësimeve të Partisë, pa kaluar në ekstremizma. Këtë ta kemi mirë parasysh të gjithë, ndryshe, çdo veprini i pamatur apo i nxituar do të shfrytëzohet nga armiku për të spekuluar, duke interpretuar masat e drejta revolucionare ideologjike, politike, administrative dhe ekonomike që merr Partia, si restrikione, si represione dhe sikur situata në vendin tonë nuk është e shëndoshë.

Shokët duhet të mendohen, të thellohen e të reflektojnë mirë për këto probleme, sepse vetëm kështu ata do të jenë në gjendje të bëjnë kritikat e duhura për dobësitë që konstatojnë. Por kritikat nuk duhet të yijnë

vetëm nga lart, ato duhet të vijnë sidomos nga poshtë. sepse kritikat nga lart, krahas anëve shumë të mira që kanë, pasi në to pasqyrohet eksperiencia politike më e madhe e shokëve drejtues, që kanë rast të kenë në duar mjast të dhëna nga burime të ndryshme etj., ka edhe anët e veta të këqija, për arsyen se ata njerëz që gabojnë dhe që kritikohen vetëm nga lart. mund të hiqen si viktima në sytë e të tjerëve.

Partia dhe udhëheqja e saj kërkojnë që mendimet për cilindot të shprehen haptazi, prandaj të spastrohen njerëzit, si të thuash, nga ana shpirtërore dhe të kri-johet një situatë e tillë ku njeriu që kritikon drejt, ta ndiejë veten të lumtur dhe të krijojë tek i kritikuari jo ndjenjën e zemërimit dhe të hakmarrjes, por dashurinë e madhe, në radhë të parë, për tërë Partinë dhe udhëheqjen e saj. Në qoftë se ia arrijmë këtij qëllimi, do të kemi korrur një fitore të madhe. Në këtë drejtim ne duhet të punojmë shumë, ndryshtë nuk do të arrijmë atë që synon Partia dhe ajo që do të realizohej do të ishte plotësimi formal i qëllimeve të larta të saj. njëfarë respekti i dyshimitë, që nuk i nevojitet Partisë së komunistëve.

Besoj se më lejohet të ngre këtu në mbledhjen e Sekretariatit të Komitetit Qendror të Partisë një çesh-tje, para se t'ia them vetë Fadil Paçramit. Më raportuan që kur u bë mbledhja e shkrimtarëve dhe e arti-siave, për të analizuar të metat e punës me sy kritik. Paçrami është ngritur dhe, në mënyrë jokomuniste, përparrë gjithë atyre që merrnin pjesë në mbledhje, ka thënë: «S'kam asnjë përgjegjësi për festivalin. Për këtë gjë përgjegjësinë e ka Komiteti Qendror i Partisë, sepse

radiotelevizioni është një institucion qendror!». Kur dëgjova këto fjalë m'u kujtua sulmi që iu bë Partisë dhe udhëheqjes së saj nga trockistët jugosllavë në Konferencën e Partisë të Tiranës. Unë nuk e akuzoj Fadil Paçramin si trockist, as si njeri të jugosllavëve, por del se ai është një person që nuk po realizon përgjegjësitë e tij të mëdha. Ai është sekretar i Komitetit të Partisë të Tiranës, që merret me propagandën. Si është e mundur që Fadili s'paska asnje përgjegjësi për ato shfaqje liberalizmi që janë dukur në Tiranë? Fadil Paçrami i akuzon shokët e aparatit të Komitetit Qendror të Partisë, se gjoja janë konservatorë! Jo, komunisti nuk duhet të gjykojë e të flasë kështu. Ai duhet të qëndrojë drejt përpara përgjegjësive dhe gabimeve që ka. Partia do t'i ndreqë situatat, do të ndreqë edhe njerëzit.

Këto që thashë duhen kupluar thellë dhe duhen pasur parasysh vazhdimisht nga gjithë shokët e Partisë dhe nga rinia, që është e ardhmja e Partisë, ajo që do të marrë në dorë stafetën. Sa më e pastër dhe sa më e guximshme të jetë rinia jonë, aq më e përjetshme do të jetë vepra e Partisë. Duhet ta mbajmë kurdoherë ndërgjegjen tonë të pastër, ashtu siç bëjmë çdo ditë për të mbajtur të pastër shtëpinë dhe trupin tonë, prandaj të punojmë pa u lodhur për të arritur në atë që populli dhe Partia të shikojnë se forca qëndron në veten e tyre, në vijën e drejtë të Partisë, në njerëzit, në kuadrot e qendrës dhe të bazës, në udhëheqjen kolegjiale, në unitetin e mendimit dhe të veprimit.

Pasi i thashë të gjitha këto, pasi i qortova disa nga shokët tanë, udhëheqës të rinisë, përsëri dëshiroj të theksoj se, pavarësisht si i paraqitin ata këto probleme

nga forma ose nga përmbajtja e tyre, nuk na lejohet as neve shokëve të Partisë, as atyre të Qeverisë, as shokëve të pushtetit në bazë, as drejtuesve të ndërmarrjeve ekonomike që kërkesat e rinisë t'i lëmë pas dore, ose të mos merren në shqyrtim seriozisht, por të bëhen përpjekje që të zbatohen vendimet.

Prandaj të biem dakord me propozimin e rinisë që në rrethe, për këto çështje, të mblidhet komiteti ekzekutiv dhe përgjegjësit e tjerë rreth byrosë së komitetit të Partisë dhe atje, shokët e rinisë të shtrojnë fort dhe drejt mendimet që kanë për këto punë, të diskutohen, të merren vendime të prera dhe të ndiqen që të zbatohen e të vihen në vend vendimet e Komitetit Qendror të Partisë, të Qeverisë dhe të vetë Komitetit Qendror të Bashkimit të Rinisë së Punës.

*Etuar për herë të parë
me shikurtime në librin:
Enver Hoxha, «Raporte e
fjelime 1972-1973», f. 222*

*Botohet i plotë sipas tekstit
të nxjerrë nga procesverbali
i mbledhjes së Sekretariatit
të KQ të PPSH, që gjendet
në AQP*

MEI DISA PROBLEME TË LËNDËVE SHOQERORE NË UNIVERSITET DHE NË SHKOLLAT E LARTA

Diskutim në mbledhjen e Sekretaritit
të KQ-të PPSH¹

23 shkurt 1973

Studimi i marksizëm-leninizmit në shkollat e larta dhe të mesme është një problem me rëndësi të madhe.

Përvetësimi i lëndëve të kësaj shkencë, për të kup-tuar dhe zhvilluar drejt problemet e ndërtimit të socializmit, që i vihen përpara vendit aktualisht dhe në perspektivë, është i domosdoshëm, prandaj si nga pedagogët, ashtu dhe nga nxënësit e studentët, duhet të bëhen përpjekje të mëdha në këtë drejtim.

Që filozofia jonë t'u rrënjoset si botëkuptim nxënësve, studentëve dhe pedagogëve, ne duhet t'i nxitim qhe t'i udhëheqim ata në dy drejtime: në studimin e thellë dhe të aplikuar të kësaj shkencë e në lidhjen e saj me veprimtarinë, luftën dhe jetën e përditshme të tyre.

Të mësosh marksizëm-leninizmin dhe të veprosh

1. Në këtë mbledhje u diskutua rrëth raportit të paraqitur nga Universiteti i Tiranës «Mbi disa probleme të lëndëve marksiste-leniniste në universitet».

në kundërshtim me të në praktikë e në jetë, qoftë dhe në raste të shkëputura, do të thotë që ky mësim nuk të ka vlejtur.

Qoftë te studenti, qoftë te pedagogu mësimi i kësaj shkencë varet shumë jo vetëm nga përpjekjet dhe studimi individual, por edhe nga mënyra e zhvillimit të saj gjatë orëve të mësimit.

Por shpesh nga të dyja palët nuk veprohet drejt: disa e lënë pas dore; ka pastaj nga ata që nuk bëjnë përpjekje për ta kuptuar dhe për ta përvetësuar plotësisht. Disa pedagogë nuk janë të aftë në zotërimin e lëndës dhe as që bëjnë përpjekje serioze që të aftësohen, prandaj zbatimi i programeve nga ana e tyre bëhet në mënyrë formale.

Këtu qëndron, më duket mua, e keqja e parë. Në qoftë se luftohet kundër të gjitha këtyre dobësive, atëherë me masa të mëtejshme ne mund dhe duhet ta përmirësojmë punën, si në dhënen, ashtu edhe në të mësuarit e marksizëm-leninizmit.

Dhënia dhe të mësuarit e kësaj shkencë formojnë një të tërë të përbashkët si për studentin edhe për pedagogun. Që ta japësh mirë marksizëm-leninizmin, është e domosdoshme që më parë të mësosh vetë, pse vetëm po të mësosh mirë, je në gjendje tu japësh mësim të tjera, qoftë në shkollë, qoftë jashtë shkollës, në jetë. I gjithë ky proces zhvillohet me qëllim që të krijohet botëkuptimi marksist-leninist.

Në këtë proces hyn edhe çështja e kualifikimit dhe e specializimit të pandërprerë të pedagogëve. Thuhet se përpjekjet për kualifikimin e tyre janë të pakënaqshme. Kjo është e vërtetë, prandaj na bie barra të ma-

rrim masa të mëtejshme që t'i kualifikojmë. Por duhet të njohim, gjithashtu, se ne kemi edhe pedagogë të filozofisë, të cilët, pa kaluar fare nga shkolla apo kurse speciale kualifikimi, janë të zotë dhe dallohen nga shumë të tjera. Për ç'arsye? Sepse ata studiojnë sistematikisht, bëjnë përpjekje të zgjerojnë çdo ditë horizontin, e lidhin mirë teorinë me praktikën, çdo problem ua bëjnë të qartë dhe interesant studentëve dhe, duke qenë të tillë, ata dinë ta lidhin marksizëm-leninizmin me specifiken e shkencave të ndryshme.

Leksionet dhe seminaret që zhvillohen mbi teorinë tonë, sigurisht, nuk u përshtaten si duhet veçorive të specialiteteve dhe problemeve të ndryshme që na dalin përpara. Prandaj duhet të punohet edhe në këtë drejtim. Por kjo është e lehtë të thuhet me fjalë, por nuk është aq e lehtë të bëhet, në rast se jo vetëm pedagogët e filozofisë, po edhe punonjësit e specialiteteve të tjera nuk thellohen në punimet e tyre, nuk i lidhin dhe nuk i shpjegojnë këto veçori e specialitete me teorinë tonë të marksizëm-leninizmit. Po të punohet si duhet në këtë drejtim, atëherë krijohet për nxënësit dhe studentët një fushë shumë më e gjerë studimi, me baza më të shëndosha e të shumanshme, e ilustruar, pra, më e kuptueshme, më e prekshime, më e lidhur me realitetin objektiv të zhvillimit dhe të mendimit, të filozofisë marksiste-leniniste.

Mund të ekzistojë dhe ekziston uniformiteti i programeve në dhënien e marksizëm-leninizmit. Në këtë drejtim mund të bëhen rregullime, por jo thjeshtime (pse është rrezik që një gjë e tillë mund të ngjasë), gjithashtu, duhet të kihet parasysh se kjo punë kërkon një

kujdes të madh dhe një përgatitje të thellë nga ana e atyre që do ta marrin përsipër. Rregullimet formale dhe manipulimet e pavlefshme duhet t'i mënjanojmë. Është e nevojshme, mendoj unë, të fillojmë nga ajo që pädagogët dhe filozofët tanë të lëndës në fjalë dhe të lëndëve të tjera ta kryejnë detyrën si duhet në profesionin e tyre, duke zbatuar mënyrat që përmenda më lart. Në rast se do të vazhdohet vetëm me diktime të kurseve, pa kurrsarë brumi personal, por duke bërë një përbledhje të thatë fjalësh e frazash, shumë herë të rënda. Nuk mund të arrihet në aië që synojmë, në përgatitjen e teksteve të difereneuara të filozofisë sipas problemeve specifike.

Çështjet specifike kërkojnë njohjen e thellë të problemit, si edhe njohjen e thellë të marksizmit, që të mund të vendosësh mirë në vendin e duhur dhe në evidecë lidhjet midis tyre. Një njeri i rutinës dhe i burokracisë, që kërkon të hedhë lumin me pak njohuri që i ka fituar dikur, nuk mund ta bëjë një gjë të tillë. Në duhet të përgatitim dhe të edukojmë njerëz të pasionuar, kërkues e këmbëngulës për këtë punë kaq shumë të nevojshme dhe të rëndësishme.

Problemi i zhvillimit të mendimit tonë në universitet dhe në shkollat e tjera të larta të vendit, në përgjithësi, nuk është shumë aktiv dhe mund të thuhet që ka mbetur në vend, sepse pedagogu bën leksionin, ndërsa nxënësit mbajnë shënimë (natyrisht ashtu si i mbajnë), pastaj organizohen disa seminare. Që të dyja palët, si me thënë, kanë rënë në një ujdi të heshtur, studenti nuk zhvillon mendime të mëtejshme mbi ato çka i është thënë në auditor nga ana e pedagogut, në mënyrë të

gjerë, të afirmuar dhe të plotësuar në studime dhe me ide e sugjerime që i lindin gjatë punës; edhe pedagogu është i sigurt për një gjë të tillë, megjithatë as ky nuk shqetësohet që nga ana e vet të zhvillojë më tej horizontin e dijeve të tij dhe të përgatitet për çdo të papritur që mund t'i dalë.

«Këtë situatë s'po mundim ta çajmë», thuhet në relacionin e paraqitur nga Universiteti i Tiranës. Po, kjo mund të çahet vetëm duke vepruar në të kundërtën e asaj që thashë më lart. Me dekret kjo, natyrisht, s'bëhet, por, po ta marrë mirë gjendjen në dorë Partia, rinia, rektorati dhe tërë trupi mësimor, çdo gjë çahet. Të qëndrosh vetëm me konstatime, nuk mund të arrish në asgjë. Qarjet s'të japid bukë, përkundrazi, bukë të jep të punuarit dhe bile të punuarit mirë të tokës. Unë nuk e kuptoj ç'do të thotë shoku rektor me atë që shpreh se «duhet të sigurohet një elasticitet më i madh në planet mësimore, në oraret mësimore dhe të përsoset struktura dhe shtrirja e lëndëve.. Që lind nevoja të bëhen përmirësimë në të gjitha këto çështje, edhe unë mendoj se duhet, por të bëhen gjëra të papjekura, gjoja për të zhvillouar debatin dhe, në fakt, ta thjeshtojmë e ta minimizojmë çështjen në një diskutim banal, kjo më duket është e dëmshme. Këto përmirësimë, në qoftë se bëhen, duhet të kryhen me kompetencë në lëndën e mësimit, duke mos harruar se marksizëm-leninizmi, si shkencë e si filozofi, mësohet në universitet dhe në shkollat e tjera të larta, ku parashikohet që studentët i kanë marrë nacionet bazë që në shkollën e mesme dhe se, veç kësaj, ata rrojnë në një ambient socialist dhe punojnë në një vend socialist.

Një çështje tjetër që mendoj të kihet parasysh është të ruhem i nga teorizimet intelektualiste, autorët e të cilave hedhin shumë plane e sugjerime në tryezë për reforma e përshtatje, por bëjnë pak studime të thelluara mbi ato qëka propozojnë dhe ca më pak studiojnë për të zotëruar lëndën sa më mirë e sa më thellë, kusht i domosdoshëm për ta bërë mësimdhënien dhe debatin sa më interesant.

Partia dhe rektorati të mos heqin dorë nga studimi i propozimeve, por, duke i parë ato, të ngulin këmbë më tepër që studentët dhe pedagogët të studiojnë më shumë, të zhvillojnë debate, të zgjerojnë e të thellojnë mendimet, pse nga këto do të na dalin nevojat, format e metodat dhe me çfarë materiale më të mira e më të plota mund t'i zëvendësojmë të vjetrat.

Shoku rektor i universitetit më duket sikur e skematizon ca çështjen e shfrytëzimit të prirjeve të vëçanta të pedagogëve si lektorë, si drejtues seminaresh, si bashkëpunëtorë shkencorë. Prirje të ndryshme ekzistojnë në njerëzit, po ato nuk qëndrojnë në vend, përkundrazi, zhvillohen dhe cilido, atje ku specializohet, krijon dhe përpunon më tej stilin dhe metodën e punës së vet më të përshtatshme me specialitetin.

Specialiteti nuk ekskludon nxitjen në një zhvillim më të gjerë të kulturës. Derisa në universitet kemi të bëjmë me pedagogë të këtij institucioni të lartë, unë gjykoj se asnjëri prej tyre nuk mund të thotë që s'ka pse të jetë edhe lektor i mirë ose drejtues seminari, ashtu sikurse një pedagog filozofie, të cilit i kërkojmë që «filozofinë ta bëjë më elastike» e më të përshtatshme për degët e tjera, nuk mund ta mbyllim në libra, larg eks-

perimenteve, laboratorëve apo ligjeve të industrisë dhe të monedhës.

Është, pra, e domosdoshme që pedagogët e filozofisë të zhvillojnë edhe kulturën e përgjithshme, por në këtë kulturë të përgjithshme hyjnë sidomos edhe ato që thashë më lart. Mungesa e kuadrove është e vërtetë se ndihet në shkollat e larta. Po ç'duhet të bëjmë? Të bëjmë përpjekje për të ngritur seriozisht dhe në mënyrë të kontrolluar nivelin e atyre që kemi dhe të mos qajmë se nuk janë të zotë, pse nga kjo s'del gjë. Njëkohësisht, të marrim masa që të përgatitim edhe të tjcrë të rinj me një plan më të studiuar. Në radhë të tretë, të pengojmë largimin e kuadrove nga kjo osc ajo katedër, përderisa aty të kemi një numër të mjaftueshëm; kurse përbajtjen e studentëve që mbarojnë fakultetet, në universitet dhe në shkollat e tjera të larta të veprohet siç kemi vendosur në Byronë Politike.

Për problemin e normës mësimore shoku rektor na parashtron një sërë arsyetimesh, që mund të jenë të drejta dhe të arsyeshme të bëhen, por për këto nuk është e mundur të vendosim sot këtu në Sekretariat, pse kjo do të jetë një çështje e zgjidhur jo si duhet, në rast se nuk e marrin ta studiojnë, së pari e së toku, Ministria e Arsimit dhe e Kulturës dhe Universiteti i Tiranës.

Disa pedagogë mund të jenë të ngarkuar, por vihet pyetja: Sa janë këta? Pse janë të ngarkuar dhe a jemi ne në gjendje ta ndryshojmë tanë për tanë këtë situatë? Disa pedagogë duhen lehtesar nga diçka për t'u ngarkuar me diçka tjetër më të rëndë a më të lehtë ose më të kualifikuar? Duhet të krijohen degë të reja, specializime pasuniversitare e të tjera? Kuptohet se, megji-

thëqë disa prej këtyre duhen, është e zorshme që t'i vendosim ne këtu, në Sekretariat. I bie detyrën Ministrisë së Arsimit dhe të Kulturës t'i shqyrtojë me kujdes këto probleme dhe të marrë masat e mundshme ose të punohet me plan që të gjitha këto nevoja të plotësohen në perspektivë.

Problemi i studimeve shkencore shqiptare filozofike, ekonomike apo i fushave të tjera nuk mund të thuhet se është fare në fazën e diletantizmit, siç është shprehur shoku rektor, për arsyen se te ne janë bërë edhe studime me vlerë, edhe përgjithësime, dhe përpjekjet vazhdojnë në këtë drejtim. Kjo çështje nuk duhet shikuar vetëm nga prizmi i ngushtë i universitetit dhe të dilet në një konkluzion jorealist. Por që duhet pohuar se në universitet, dhe jo vetëm atje, duhet forcuar puna është e drejtë dhe duhet të punohet në këtë drejtim. Ne duhet të ecim më me ngulim dhe më me kompetencë në këtë drejtim.

Propozohet të krijohen në sektorin e filozofisë të universitetit disa bërthama të punës shkencore për etikën, për estetikën, për ateizmin etj. Mundet që këto të jenë të nevojshme e të dobishme. Bëni një bisedim të frytshëm për këtë çështje me shokun Ramiz, me punonjësit e Institutit të Studimeve Marksiste-Leniniste pranë Komitetit Qendror, me ata të Ministrisë së Arsimit dhe të Kulturës e të Shkollës së Partisë «V. I. Lenin» dhe vendosni.

Për sa i përket dhënies së marksizëm-leninizmit në filialët e universitetit dhe në institutet e larta të vendit, gjendja në to është ashtu si na e raporton Universiteti i Tiranës e që korrespondon edhe me raportet dhe të dhë-

nat e Partisë. Pedagogët nuk janë në lartësinë e duhur, metoda dhe stili i tyre në punë lë shumë për të dëshiruar. Prandaj ndihma nga universiteti duhet të jetë e vazhdueshme, më e organizuar dhe më e kualifikuar se deri tani. Të pranueshme janë edhe propozimet e rektoretatit për seminaret që duhet të organizohen nga Ministria e Arsimit dhe e Kulturës, si dhe nga ana e aparatit të Komitetit Qendror të Partisë me pedagogët e këtyre filialeve etj.

Për sa u përket disa problemeve të tjera, siç është ai i përgatitjes së kuadrit, le të ngarkojmë për këto shokun Ramiz për t'i diskutuar me shokët përkatës dhe të vendosin së bashku.

*Botuar për herë të parë
në librin: Enver Hoxha,
«Raporte e fjalime 1972-
-1973», f. 251*

*Botohet sipas librit:
Enver Hoxha, «Për shkencën
(Përmbledhje reprash)»,
vëll. I, f. 513*

RRITJA E KLASËS PUNËTORE — TREGUES I RËNDËSISHMËM EKONOMIK, SHOQEROR E IDEOPOLITIK

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

26 shkurt 1973

Jam dakord me studimin e paraqitur nga Institut i Studimeve Marksiste-Leniniste, si dhe me diskutimet e zhvilluara nga shokët.

Studimi është i mirë dhe i argumentuar. Ai do ta ndihmojë shumë Partinë në punën për rritjen dhe kaltjen e mëtejshme të klasës punëtore. Ky material, në të cilin janë arritur konkluzione të vlefshme, plotësuese, të veçanta, gradualisht duhet të studiohet me vëmendje nga të gjithë, të punohet edhe në Parti, veçanërisht me ata kuadro që merren me çështjet teorike, organizative dhe ekonomike, si dhe në format e ndryshme të edukimit teorik. Sigurisht, përfundimet e këtij studimi du-

1. Në këtë mbledhje u diskutua rrëthi studimit «Mbi disa probleme të rritjes e të strukturës ekonomiko-shoqërore të klasës punëtore», paraqitur nga Institut i Studimeve Marksiste-Leniniste, pranë KQ të PPSH.

het të mbahen parasysh edhe nga Komisioni i Planit të Shtetit, sepse ato ndihmojnë që të ndërtohen plane më të studiuara në të ardhmen.

Si të gjithë shokët, edhe unë jam dakord që rritja e klasës punëtore është një tregues ekonomik, shoqëror dhe ideopolitik me shumë rëndësi. Këtë proces ne duhet ta konsiderojmë normal dhe të kënaqshiem. Por, të mos harrojmë se zhvillimi i vendit na ngarkon me detyra të shumta për kalitjen klasore, ideologjike dhe profesionale të klasës punëtore. Duhet të kemi kujdes që kur shokët na evidencojnë disa shfaqje jo të mira në jetën e shoqërisë sonë, për to të mos ua hedhim të gjitha fajet rinisë intelektuale dhe studentëve, por t'i kthejmë sytë një çikë më mirë edhe nga klasa punëtore, sidomos nga elementët e rindërtimit që kanë ardhur në radhët e saj, të cilët kanë një stazh në prodhim prej 2, 3 ose 4 vjetesh. Një pjesë e këtyre punëtorëve të rindërtimit janë futur në punë, pasi nuk kanë ndjekur dot shkollat, sepse u ka munguar vullneti e disiplina për të mësuar. Kjo ka ndodhur se për ta nuk është treguar kujdesi i duhur, qoftë nga prindërit, qoftë nga shkolla, qoftë edhe nga organizata e rinisë. Disa nga këta janë ca të shthurur, se nuk kanë detyrime nga ana materiale dhe ekonomike, meqenëse prindërit i kanë në punë. Duke qenë kështu, ata mendojnë: „Ku rafsha, mos u vrafsha“, pra, manifestojnë shfaqje të ideologjisë së huaj. Flokët e gjatë nuk i lënë vetëm një numër studentësh, por edhe mjast nga punëtorët për të cilët po flas. Prandaj, të mos mbyllim sytë ndaj këtyre njerëzve që bëredhin klubeve, duke pirë birrë në kohën e punës dhe gjykojnë me mendjelehtësi se s'është ndonjë gjë e madhe, as shkelje disipline kur

s'venë tri-katër ditë në punë. Nga të gjitha këto del e qartë se ne ngarkohemi me shumë detyra të mëdha për kalitjen e klasës punëtore dhe, veçanërisht të këtyre të rinjve, që, megjithëse quhen punëtorë, s'janë bërë akoma të tillë, nuk e kanë sa duhet të zhvilluar ndjenjën e klasës, bile, si të thuash, nuk kanë futur as veshin në radhët e klasës.

Natyrisht, rritja e madhe e klasës punëtore, ka ardhur si rezultat i zhvillimit të industrisë, të minierave, të ndërtimit etj. Prandaj edhe koha mesatare në punë e punëtorëve tanë është 9 vjet e gjysmë, kurse mosha mesatare e tyre 34 vjeç.

Siq shihet, shumica dërrmuese e punëtorëve tanë janë të rinj, të freskët, të gjallë e revolucionarë, sepse kanë një moshë të tillë, në të cilën njeriu është në kulmin e shëndetit e të forcës, me aftësi të mëdha fizike, i zoti për të mësuar, për të krijuar dhe për të prodhuar. Këtë përbërje rinore të klasës punëtore ne duhet ta shfrytëzojmë mirë nga qdo anë, sepse janë të gjitha mundësítë për të bërë hapa shumë më të mëdhenj e më të shpejtë përparrë nga ala që kanë bërë punëtorët e vendeve të tjera. Kjo do të arrihet me siguri, për arsyen se klasa punëtore te ne është në fuqi.

Nivelin e klasës punëtore do ta shikojmë edhe me rezultatet në prodhim, pra. jo vetëm nga ana formale, por dhe me atë sy se çfarë prodhon e si prodhon.

Si gjithë shokët edhe unë mendoj se Partia jonë nuk ka rënë në gabimin që kanë bërë vendet kapitaliste dhe disa vende të tjera të ashtuquajtura socialiste, të cilat industrinë, pra edhe klasën punëtore, i grumbulluan në disa qendra e qytete të mëdha. Ne i ndërtuam

objektet e industrisë sonë mbi bazën e kushteve konkrete objektive, duke marrë parasysh dhe drejtshpërndarjen e lëndëve të para, si dhe shumë faktorë të tjera shoqërorë dhe ekonomikë. Në këtë mënyrë përmirësuam strukturën e klasës, pra edhe të qendrave të banuara; krijuam punë në çdo zonë për njerëzit tanë; nuk rrithëm shpenzimet e prodhimit; ndihmuam në zhvillimin e gjithanshëm të të gjitha rretheve dhe përmirësuam jetesën e popullit në mënyrë pak a shumë uniforme, të barabartë.

Duke studiuar të dhënat për strukturën shoqërore të popullsisë sonë që nga viti 1950 e deri në vitin 1975, mund të themi se ajo është formuar normalisht dhe në përpjesëtim të drejtë. Kjo strukturë shoqërore e punonjësve tanë vë në dukje se hopi i klasës punëtore ka qenë i rregullt, i balancuar, i nevojshëm; ai është bërë pa thithur nga fshati krahë pune jashtë masës dhe nevojave, pa krijuar papunësi. Ai ka ndihmuar edhe në mekanizmin e punimeve bujqësore për t'u bërë ballë nevojave që lindin nga largimi i punonjësve të fshatit për në qendrat e punës të qyteteve. Kështu do të zhvillohet ky proces dhe në të ardhmen. Por këtë duhet ta bëjmë kurdoherë të organizuar dhe të kontrolluar, ndryshe do t'i shkaktoheshin dëme të pallogaritshme ekonomisë kombëtare në tërësi dhe bujqësisë në veçanti. Këtu del edhe çështja e atyre njerëzve në qytete, që për faj të tyre nuk janë në marrëdhënie pune. Kjo gjë duhet studiuar, zgjidhur mirë e me kujdes, me qëllim që forcat e punës nëpër qytete të mos mbeten pa punë, se, po nuk u studiuia sot, më vonë mund të vështirësohet edhe më shumë. Këta që dalin si kontingjent për punë çdo

vit, vitet e tjera mund tē shiohen. se do tē grumbullohen njëri kontingjent pas tjetrit (sigurisht ata që nuk do tē kenë mundësi tē zihen me punë). mbasi rritja e popullsisë vazhdon. E vërteta është se për ata që kërkojnë punë, nuk ka një studim dhe një pasqyrë tē saktë statistikore. Të thuash fjala vjen që Korça ka kaq veza tē pazënë me punë dhe se tē türë këta nuk duan tē venë tē punojnë atje ku i dërgojnë, pa u ndalur në analizën konkrete tē kësaj gjendjeje, nuk është e drejtë. Prandaj, problemi kërkon një studim tē thelluar dhe tē mos flitet në mënyrë tē përgjithshme. Vetëm duhet tē kuptojmë një gjë, që qoftë korçari, qoftë vlonjati, tē türë na venë me gjithë qejf atje ku kemi nevojë, po t'u sigurohen kushtet për punë e banim.

Sipas illogarive tē përafërtë tē bëra në studimin që na është paraqitur, rezulton se popullsia e vendit tonë në vitin 1990 do tē arrijë në mbi 3 300 000 veta. Fshati, brenda 20 vjetëve tē ardhshëm, do tē ketë 540 000 veta në punë, kurse për qytetin kjo shifër mund tē arrijë në 140 000. Në duhet tē parashikojmë që për arsyet zhvillimit, tē modernizimit, tē mekanizimit tē proceseve të punës dhe tē ngritjes së nivelit agroteknik dhe kulturor tē punonjësve tē saj, bujqësia do tē lirojë forca pune, tē cilat, sipas mendimit tim, nuk duhet tē marrin rrugën e qytetit në mënyrë spontane. Përkundrazi, kjo punë duhet tē bëhet vazhdimisht e studiuar dhe e balancuar, në përputhje me nevojat e industrisë dhe tē bujqësisë. Them edhe tē bujqësisë, sepse në duhet tē udhëhiqemi nga një studim më i thellë i gjendjes së krahëve të punës në rrëthet kodrinore dhe malore, ku edhe tash ndihet nevoja për krahë pune. Kjo kërkesë për punonjës

të bujqësisë do të ndihet edhe nesër. Mekanizimi i bujqësisë nuk do të arrihet të bëhet njëloj, si në fushë edhe në malësi. Sidoqoftë, perspektiva e shtimit të popullatës së vendit tonë është e shkëlqyer dhe, tok me të, edhe perspektiva e shtimit numerik të klasës punëtore është shumë pozitive. Mirëpo, këto lëvizje duhet t'i bëjmë me kujdes, duke pasur parasysh edhe zhvillimin e fshatit, edhe fushat, edhe kodrat, edhe malet, edhe industrinë.

Duke u bazuar në këtë perspektivë, detyra e Partisë dhe e pushtetit tonë popullor është që të studiojnë në mënyrë të vazhdueshme, çdo vit e çdo pesëvjeçar, burimet e punës. Kjo është njëra anë e problemit. Por, që të zgjerohen në mënyrë ritmike këto burime pune, është e domosdoshme të bëhen investime, gjë që kërkon shtimin e të ardhurave kombëtare në përpjesëtime të atilla që të mundim t'u bëjmë ballë nevojave të reja që do të na paraqiten në të ardhmen.

Për këtë problem të madh është e nevojshme të kemi kurdoherë parasysh një sërë faktorësh që po luftojnë vazhdimisht për t'i përdorur në realizimin e planeve tonë ekonomike dhe socialkulturore.

Drejt u tha këtu se nuk dihet çfarë momentesh do të na vijnë paskëtaj. Shpeshherë, nga shumë njerëz, rrëthimi imperialisto-revisionist kuptohet cekët dhe nënvlërësohet, duke menduar se mund t'i bëhet ballë me lehtësi e pa sakrifica. Ky koncept i gabuar reflektohet edhe në kërkësen për sa më tepër investime nga shteti për shumë e shumë gjëra, të menduara e të pamenduara. Nuk është e drejtë që për rrëthimin të flitet me parulla të përgjithshme, pa kurrfarë baze. Në qoftë se do të jemi vigjilentë dhe do të mendojmë seriozisht

për eventualitetin e një kohe të keqë e shumë të vështirë, është e domosdoshme t'i bëjmë të ndërgjegjshëm të tërë njerëzit, se kjo kohë duhet të na gjejë plotësisht të përgatitur nga të gjitha anët. Kjo do të thotë jo vetëm të realizojmë planet e prodhimeve, por të krijojmë edhe rezerva të çdo lloji, duke shtuar prodhimet dhe duke ulur shpenzimet. Mirëpo rezervat nuk mund të sigurohen pa krijuar te njerëzit një botëkuptim të drejtë për ekonominë socialiste, për pronën e përgjithshme, pa krijuar në ndërgjegjen e gjithsecilit ndjenjën e zbatimit me përpikëri të madhe të disiplinës proletare shtetërore në punë, të regjimit të kursimit në familje e kudo. Po nuk u përpoqëm me të gjitha forcat në këtë drejtim, atëherë ato që themi për këto çështje të rëndësishme janë fjalë boshe.

Është e pakuptueshme që, nga njëra anë, mbahen shumë referate e flitet shumë për disiplinën e planit e për kursimin dhe, nga ana tjeter, paraqiten kërkesa të çuditshme për investime dhe shkaklet disiplina shtetërore! U kam thënë shokëve që për të tëra këto shfaqje negative të mos ia hedhin sajin vetëm ndikimit të huaj nëpërmjet radios, televizionit etj., sepse, po të ishte vetëm ky ndikim që na i kultivon këto shfaqje, ne, që nesër, mund të merrnim masa administrative për ta ndaluar apo kufizuar atë. Por, çështja qëndron më tepër në kuptimin e thellë nga ana e klasës punëtore dhe e lshatarësisë kooperativiste të rëndësisë së punës, të disiplinës së rrepi të shtetërore dhe të ngritjes së mëtejshme të ndërgjegjes revolucionare. Ç'do të thotë që me 5-6 orë punë të realizohen normat 135-140 për qind dhe të mbushet xhepi me para, pa derdhur shumë djersë? Ku është

kërkesa e fortë e llogarisë: për prodhimin e mallrave jo sipas cilësisë dhe standardit shtetëror, për uljen e kostos, për mosrespektimin e planit brenda afateve të caktuara, për shkeljen e disiplinës kontraktuale etj.? Të tëra këto shfaqje, ku më shumë e ku më pak, po manifestohen në jetë, por shkelësit e ligjeve dhe të rregullave nuk po i shqetëson njeri!

Këta njerëz që nxjerrin të ardhura me pak ose me shumë pak lodhje, edhe pse dëgjojnë leksione e referate të tëra për disiplinën proletare ruajnë në ndërgjegjen e tyre mbeturina të theksuara, që dëmtojnë ekonominë dhe politikën e Partisë e të pushtetit popullor. Janë pikërisht këta persona që udhëhiqen nga një mentalitet liberal edhe në marrëdhëniet me fëmijët e tyre, të cilët i edukojnë keq. Kjo vihet re te disa prindër të paformuar mirë nga ana ideopolitike dhe kulturore, që u thonë fëmijëve: «Çfarë do ti, të keqen mami, para? Na!». Dhe fëmija, me këto të holla, vete blen cigare e vesh pantallona kauboj; vete disa herë në ditë në kinema e në stadiume dhe sillet lart e poshtë. Si është e mundur të lejohen këto qëndrime, që nuk i premtojnë atdheut asgjë të mirë? Në qoftë se ne vëmë një disiplinë të rrepëtë, të bazuar në edukatën proletare, për prodhimin dhe për tërë ekonominë tonë, atëherë babai ose nëna, kur të vejë në shtëpi, do t'i thotë djalit ose vajzës: «Pă hajde një çikë këtu e bëje këtë punë!». Dhe, kur të jetë rasti për t'i dhënë të holla, do ta këshillojë: «Merri këto dy lekë, që t'i kesh për tërë javën, por mos harro se këto i kam fituar me djersë». I përmenda këto për të treguar se liberalizmi që nxjerr kokën herë pas here e ka burimin edhe në disa qëndrime jo të drejta që mbahen ndaj

të rinjve. I riu që merr nga prindërit 120 e 200 lekë në muaj për të plotësuar jo nevojat, po tekat e tij, natyrisht do të ketë prirje të imitojë edhe shfaqjet e huaja që shikon nëpërmjet televizionit. Prandaj Partia duhet t'i shohë këto çështje në të tëra drejtimet, për të përcaktuar mirë përbajtjen dhe mënyrën e edukimit. T'i jepet prioritet sidomos edukimit nëpërmjet punës, ndryshe edukimi vetëm me fjalë është i sipërfaqshëm, ka pak dobi dhe është më pak efektiv.

Që të jemi në gjendje t'u bëjmë ballë nevojave që do të na paraqiten në të ardhmen, duhet të fillojmë qysh tanë përgatitjet sepse është krijuar një situatë e tillë sa shumë njerëz, bile edhe disa nga ata që janë në dijeni të këtyre gjërrave, nuk po i vlerësojnë si duhet problemet.

Të tërë e dinë se në të gjitha vendet e botës çmimet janë ngritur vazhdimisht dhe po ngrihen ditë për ditë. Në vendin tonë çmimet nuk ngrihen aspak, përkundrazi ulen. Në dyqanet tona ka plot mallra me çmuime të arsyeshme. Por disa kritizerë dinë vetëm të kritikojnë, të kritikojnë e të kritikojnë, që mallrat të jenë më të shumta e më të lira, megjithëse përpjekjet e duhura për të arritur këto synime, nga disa, nuk bëhen në shkallën që nevojitet. Nuk është aspak e drejtë të kërkohen gjëra jashtë mundësive dhe kushteve reale. Është lehtë të kërkosh, por duhet të dish se si mund të sigurohen ato që ka nevojë populli. Të thuash «duhet kjo e duhet ajo» nuk është ndonjë gjë e madhe, por të sigurosh atë që duhet, duke punuar e duke derdhur djersë, kjo është çështja kryesore. Jo vetëm kaq, por është e domosdoshme të luftojmë të gjithë kundër koncepteve të gabua-

ra që ekzistojnë aty-këtu në popull dhe deri në kuadro që, për çdo gjë që na nevojitet për të blerë, dyqanin ta kemi te dera dhe në çdo kohë, sikur notojmë në mish, në gjalpjë, në sheqer. Në këtë drejtim, më duket mua, bëhen lëshime. Ne duhet të marrim masa që të mos lejojmë në esnjë mënyrë gjëra të tillë, bila aq më tepër të mos lejojmë disa pikëpamje jo të drejta që shkruhen deri edhe në gazetë, sepse këto mund të nxitin opinionin publik për pretendime.

Këtu jemi në mbledhjen e Byrosë Politike, prandaj mund t'u flosim hapur për qëndrimet e Kinës në fushën e marrëdhënive ndërkombëtare, të cilat bëjnë që t'u lindin të gjithëve disa pikëpyetje dhe të mendojnë: «Pse e bëri Kina këtë hap, pse e bëri atë tjetrin?». Njerëzit tanë i kuptojnë vijën dhe taktykën e drejtë të Partisë sonë, po disa nuk shohin larg dhe nuk mendojnë se si do të vejë puna nesër, në qoftë se qëndrimi i Kinës rrrokulliset. Prandaj, situata duhet t'i bëjë njerëzit tanë të mos kërkojnë investime pa vend, por t'i nxitë për të përfunduar çdo objekt sa më parë e për t'i futur sa më shpejt në prodhim e me sa më pak shpenzime etj., etj. Ne kurrë nuk do të dëshironim të ngjasë kjo me Kinën, por, në këtë drejtim, kemi eksperiencë të hidhur, sepse i kemi hequr në kurriz të gjitha pasojat që kanë rrjetdhur nga qëndrimet e padrejta të të tjerëve ndaj nesh. Sikur të mendojmë për një çast qëndrimin tonë parimor, pa pasur përkrah Kinën, atëherë, si një vend i vogël me dy milionë e ca banorë, ne do të mbetemi i vetmi vend socialist kundër gjithë botës imperialisto-revisioniste. Në një rast të tillë, presioni që do të ushtronë mbi ne do të ishte shumë më i madh. Megjithatë,

edhe kësaj situate ne duhet dhe do t'i bëjmë ballë. Prandaj, sa kohë që jemi në situata të mira, të cilat janë arritur në sajë të vijës së drejtë të Partisë, të heroizmit të masave të popullit etj., të përpinqemi që ta forcojmë akoma më shumë politikisht dhe ekonomikisht vendin tonë. Krahas kësaj, ne duhet ta përgatitim popullin për çdo eventualitet, që të rrojë thjesht sipas të ardhurave që ka e, po që nevoja, edhe me sakrifica.

Sigurisht, orientimet që këshillohen në studimin e paraqitur, duhet të mbahen parasysh në planifikimet dhe detyrat tonë. Nëse duhet të qëndrojmë edhe në të ardhmen në atë masë akumulimi që kemi sot, kjo çështje mund të diskutohet konkretisht, në çdo rast, kur hartojmë planet pesëvjeçare. Sipas jorganit t'i shtrijmë dhe këmbët. Ne mund ta planifikojmë aq sa e kemi sot normën e akumulimit, por, në rast nevoje, do të na duhet edhe ta rritim atë ca më shumë. Por për këtë është e domosdoshme rritja në një nivel shumë të lartë e rendimenteve, e mekanizmit të proceseve të punës dhe e kursimit, ndryshe do të jetë e vështirë të mbahet lart shtesa e të ardhurave kombëtare.

Unë mendoj se orientimet që jepen për alternativat, për të shtuar dhe për të kursyer njëkohësisht fondet e investimeve, në përgjithësi janë parimi të drejta.

Studimi është i vlefshëm pse, duke bërë një pasqyrë për disa probleme të klasës punëtore, ai na lidh me të dhë na kujton disa çështje që ne po i zbatojmë, por që duhet t'i përmirësojmë e t'i thellojmë akoma siç janë, për shembull, rritja e rendimenteve, mekanizimet etj. Këto kanë të bëjnë me kursimet, me thellimin e revolucionit tekniko-shkencor, me heqjen e fuqisë pu-

nëtore të tëpërt, e cila ndodh që ka raste të mbahet edhe kur nuk është e nevojshme; me pakësimin e numrit të punëtorëve ndihmës dhe numrit të drejtuesve që, sipas mendimit tim, është akoma i madh. Unë mendoj se në një kohë, kur niveli teknik i ndërmarrjes ngrihet në një bazë të re më të lartë, duhet të bëhen akoma disa shkurtime.

Përveç këtyre, dua të theksoj çështjen që numri i punonjësve në degët e prodhimit material duhet të mbi-zotërojë kurdoherë mbi ata të degëve shoqërore-kulturore dhe të shërbimeve. Këtë gjë, që shtrohet me të drejtë në materialin e Institutit të Studimeve Marksiste-Leniniste, duhet ta kemi parasysh edhe tash, edhe më vonë. Natyrisht, nuk duhet të ndikohemi nga kjo për të lënë pas dore shërbimet, sepse edhe për to kemi shumë nevojë.

Me këtë rast, ne i porositim shokët e Institutit të Studimeve Marksiste-Leniniste që të vazhdojnë t'i jepin Partisë studime të tillë me vlerë, se për to kemi shumë nevojë.

*Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbal i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH,
që gjendet në AQP*

TA PËRSHKRUAJMË REALISHT LUFTËN TONE, QË NGA FILIMI E GJER NË FUND

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ-të PPSH¹*

26 shkurt 1973

Unë, sikurse shokët, jam dakord me maketin e vëllimit të parë të librit të «Historisë së Luftës Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar»², prandaj nuk kam shumë vërejtje për të bërë rreth tij.

Më lejoni të përgëzoj me këtë rast Institutin e Studimeve Marksiste-Leniniste që ka hartuar maketin. Vëllimi i parë i këtij libri që diskutuam sot e që përfshin

1. Në këtë mbledhje u diskutua edhe rreth relacionit për disa çështje të historisë së Luftës Nacionalçlirimtare.

2. Vëllimi 1 i «Historisë së Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar», parashikuar në dy vëllime, doli më 1975.

Me vendim të KQ të PPSH, më 1983, nga Institut i Studimeve Marksiste-Leniniste u fillua puna për hartimin dhe përgatitjen e një botimi të ri të «Historisë së Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar» në 4 vëllime. Në nëntor 1984 doli vëllimi 1 dhe në mars 1986, vëllimi i 2-të; ndërkohe vazhdon puna për përgatitjen e vëllimit të 3-të e të 4-t.

periudhën nga prilli i vitiit 1939 deri në shtator të vitit 1943, është një vepër që do t'u shërbejë Partisë, rinisë dhe tërë masave punonjëse për të marrë dijeni mbi luftën e madhe të popullit tonë. Mënyra e parashtrimit të fakteve, paraqitja e drejtë dhe realiste e ngjarjeve në libër, si dhe stili i shkrimtit janë të rrjedhshëm.

Unë kam lexuar tekste të ndryshme historike të disa popujve, vçcanërisht të atij francez. Për historianë e Francës, për shembull, kam lexuar tekstin e shkruar të historianit të quajtur Ten¹, në të cilin përfshihet edhe epoka e revolucionit borgjez. Tendenca e Tenit, siç gjykoj unë, është konservatore, kurse autor i tjetër, Mishle², që ka hartuar, gjithashtu, historianë e Francës dhe të revolucionit francez, është nga më ekzaltuesit e këtij revolucioni dhe me prirje liberale. Një tjetër, Alber Matiez³, është autoritet mjaf i njojur. Ky e analizon revolucionin francez fill e për pe, në mënyrë radikale dhe realiste. Ai nuk bën teprime kur përshkruan dhe interpreton faktet, as kur shpreh mendimet e tij rreth ngjarjeve historike. Vepra e socialistit Zhores⁴ ka karakter tjetër, sepse ai nuk ka shkruar historianë e këtij revolucioni, por ka bërë analizën sociale të tij. Natyrisht, autorët që kanë shkruar për periudha të ndryshme të historisë së Francës e sidomos për atë të revolucionit borgjez të këtij vendi, janë nisur nga pozitat e tyre

1. Ipolit Ten (1828-1893), filozof, kritik e historian francez.

2. Zhyll Mishle (1798-1874), shkrimtar dhe historian francez.

3. Alber Matiez (1874-1932), historian francez.

4. Zhan Zhores (1859-1914), orator, historian dhe veprimtar i njojur politik francez.

klasore. Por në shkrimet e teksteve të historisë që ka përgatitur secili janë shprehur nuanca të veçanta, sipas individualitetit të çdo autorit. Ne, sigurisht do të shprehim në tekstet tona jo disa nuanca, por do të bëjmë vlerësimin e ngjarjeve, duke u nisur nga pozitat shkenccore të marksizëm-leninizmit.

Teksti i historisë që po përgatitet, me disa korrigjime të vogla, me disa cilësime etj., etj., sipas disa vërejtjeve të drejta që bënë shokët. është e nevojshme të përmbajë pikërisht ato të dhëna që parashtrohen në maket. Mendoj se përshkrimi i disa aksioneve të çetave tona, që kanë bërë jehonë të madhe në kohën e luftës, nuk duhen konsideruar si hollësi të panevojshme, por si fakte që duhen pasqyruar në tekstin e «Historisë së Luftës Nacionalçlirimtare». Për ngjarje dhe fakte të kësaj lufte është shkruar edhe tjetër herë, prandaj, sikurse u tha këtu, më vonë mund të shkruhet përsëri për të. Do të shkruhet, gjithashtu, edhe «Historia e Artit Ushtarak Popullor të Luftës Nacionalçlirimtare»¹ etj.

Duke vënë theksin herë në një aspekt të luftës e herë në një tjetër, me kohë, do të shkruhen disa libra për historinë e Luftës sonë Nacionalçlirimtare. Në një tekstu historie, për shembull, mund të paraqitet lufta për shkatërrimin e pushtetit të vjetër feudalo-borgjez dhe vendosja mbi gërmadhat e tij e pushtetit të ri popullor,

1. Me vendim të Plenarit të 5-të të KQ të PPSH (27 qershor 1978), filloj puna për hartimin e tekstit të «Historisë së Artit Ushtarak Popullor të Luftës Nacionalçlirimtare», nga Ministria e Mbrotjes dhe Akademia Ushtarake, në bashkëpunim me Institutin e Studimeve Marksiste-Leniniste. Teksti ka përfunduar si maket e po përgatitet për botim.

në një tjetër mund të shkruhet jo si studim shoqëror, po si histori, pjesëmarrja në Luftën Nacionalçlirimtare të foreave sociale të vendit tonë, duke paraqitur në të, më përbledhur, disa fakte dhe duke trajtuar më gjerë disa të tjera, që flasin për shkallën e pjesëmarrjes në luftë të klasës punëtore, të fshatarësisë, të rinisë, të gruas etj. Ka shumë probleme të veçanta për të cilat do të mendojnë dhe do t'i trajtojnë historianët tanë marksistë-leninistë.

Historianët tanë duhet t'i japid popullit një tekst të historisë së Luftës Nacionalçlirimtare që të pasqyrojë në mënyrë të saktë çfarë ka ngjarë, cilat ishin qëllimet e kësaj lufte, si u arrit pjesëmarrja e madhe e popullit në të nën udhëheqjen e Partisë, cilat ishin direktivat kryesore për grumbullimin e foreave, për zhvillimin e luftës, për krijimin e ushtrisë, për thyerjen e armikut, për shkatërrimin e pushtetit të vjetër të tij dhe për ngritjen e pushtetit të ri etj.

Tani po shkruhen edhe historikët e brigadave partizane, që kanë një vlerë shumë të madhe dhe, të gjithë së bashku, pasqyrojnë historinë e Luftës sonë Nacionalçlirimtare. Megjilhatë, akoma ka mundësi dhe vend për të shkruar libra të tjerë për Brigadën e Parë, të Pestë, të Gjashtë etj., duke i zhvilluar më tej idetë, mendimet dhe aksionet që kanë kryer ato, duke kombinuar luftën e tyre edhe me problemet sociale.

Përveç historikëve të brigadave, vazhdojnë të shkruhen historikët e qarqeve e të rretheve, të cilët, gjithash, kanë rëndësi të madhe për historinë e Luftës Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar. Këta historikë të mos mbeten vetëm dokumente arkivore, por të stu-

diohen, të shfrytëzohen dhe t'u jepet forma e historisë së gjallë, sepse ata plotësojnë historinë e Luftës sonë Nacionalçlirimitare.

Në një libër historie si ky që na paraqitet, është e pamundur, të futemi në hollësi më të vogla. Por, prej tij, nuk mund dhe nuk duhet të hiqen apo të krasiten ato fakte që janë vënë, ato veprime të mëdha ose «të vogla», sepse nuk mund të shkruhet historia e luftës në vija të përgjithshme. Çdo veprim, për t'u vlerësuar, duhet parë në lidhje me kohën kur është kryer. Në këtë kuptimi edhe ndonjë ngjarje që sot duket e vogël, por që në kohën e vet ka bërë jehonë të gjerë dhe ka sjellë pasoja të mëdha, mendoj se mund të futet në tekstin e historisë.

Ne duhet ta përshkruajmë realisht luftën tonë, që nga fillimi e gjer në fund. Lufta filloi me aksionet e vogla dhe u rrit gjer në aksione shumë të mëdha dhe heroike. Kjo paraqitje ka rëndësi të madhe për të kuptuar mirë se si u përgatit dhe u ngrit populli për luftë, si edhe për të treguar jo vetëm origjinalitetin e luftës sonë, por edhe karakterin popullor të saj.

Mirë është vepruar duke shprehur në tekstu se Partia jonë është mbështetur në mësimet e leninizmit dhe në përvojën e Revolucionit të Tetorit. Por, unë do të thosha se më parë duhen përmendur përvoja shekullore dhe traditat e shkëlqyera të popullit tonë në luftërat e gjata që ai ka bërë vazhdimisht kundër armiqve okupatorë. Gjyshërit dhe stërgjyshërit tanë, populli ynë heroik, ka ditur të luftojë në çeta, me armë në dorë si partizanët edhe më përpara nga sovjetikët. Prandaj, është e domosdoshme që të theksohen mirë këto, se kanë

një vlerë të jashtëzakonshme, jo vetëm për të treguar realitetin se kështu u krijua ushtria jonë dhe se prej saj u mund armiku, por sepse këto fakte vlejnë si një shembull konkret edhe për gjithë popujt e vendeve të tjera, që kanë dëshirë të studiojnë dhe të mësojnë se në ç'mënyrë duhet të fillojë lufta popullore dhe si mund të përfundojë ajo me sukses të plotë.

Lufta jonë Nacionalçlirimtarë filloi kundër pushtimit italian. Në pjesën e parë, ku janë shkruar nga dy radhë përmes manovrat e imperializmit dhe të fqinjëve, pa u futur në shumë hollësi, në një paragraf prej gjysmë faqeje, mund të përcaktohen qartë qëllimet imperialiste edhe veprimet e tyre djallëzore për copëtimin e Shqipërisë. Aty të përmenden edhe lakmitë e intrigat e fqinjëve: të Italisë, në Luftën e parë të Vlorës, si dhe ato të serbëve e të grekëve. Mundet që ju nuk jeni zgjatur në këtë drejtim, sepse përmes këto është shkruar edhe në tekstin e «Historisë së Shqipërisë», por kjo nuk mund të bëhet pengesë përmes të shkruar diçka edhe në këtë vëllim.

Aty ku flitet përmes sulmin e fashistëve italianë kundër Greqisë, do të mendoja të formulohej e të shtohet një paragraf i shëndoshë politik, ku të dalë qartë se populli shqiptar, që ishte vetë i pushtuar, jo vetëm nuk e pranoi pushtimin e këtij vendi sqinj, por, kur mori vesh se u sulmua edhe Greqia, u ngrit i téri në këmbë përmes kundërshtuar pushtuesin e përbashkët, të cilin e lutftoi gjer në fund. Shumë shqiptarë, të mobilizuar, me këtë rast, kundër dëshirës së tyre, përmes të luftuar në radhët e ushtrisë italiane, në shenjë proteste, dezertuan nga radhët e saj. Kjo duhet të vihet, sepse, në realitet,

ky ishte qëndrimi i vërtetë që mbajti populli ynë gjatë agresionit fashist italian kundër popullit grek. Ky paragraf të shkruhet si një aksiomë, sepse dihet botërisht që populli ynë kurrë nuk i ka aprovuar pushtimet e fashistëve nga të cilët ai ka pësuar edhe vetë. Nga ana tjetër, ky paragraf do të lërë të kuptohet se megjithëqë reaksionarët grekë janë sjellë vazhdimisht keq me popullin shqiptar, ky i fundit në çastet më të vështira për popullin grek, u ngrit në përkrahje të tij.

Fakti që për disa çështje është shkruar edhe në tekstin e «Historisë së Partisë» ose të «Historisë së Shqipërisë» mendoj se nuk duhet t'ju pengojë në përcaktimin nga ana teorike të qëllimit të revolucionit populor dhe të Luftës Nacionalçlirimtare, siç ishin, për shembull, çështja e marrjes së pushtetit, shkatërrimi i pushtetit të vjetër etj. Sipas gjykimit tim, duhet të qartësohet e të përeaktohet mirë nga ana teorike se në funksion të këtyre qëllimeve u zhvillua dhe u realizua me sukses procesi i Luftës Nacionalçlirimtare, i krijimit të çetave partizane dhe i njësive më të mëdha të Ushtrisë sonë Nacionalçlirimtare. Të vihet mirë në dukje, gjithashtu, rëndësia politike e krijimit të Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar e të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë së Nacionalçlirimtare, pavarësisht se për to është shkruar edhe në tekstet e «Historisë së Shqipërisë» e në atë të «Historisë së Partisë». Mendoj se këto gjëra duhet të vihen medoemos në tekstin e «Historisë së Luftës Nacionalçlirimtare».

Unë sihe shokël nuk jemi dakord me arsyetimin, sipas të cilët teksti është i historisë së shqiptarëve, prandaj të flitet në të edhe për historinë e Kosovës e të

Çamërisë. Ky mendim nuk më duket i drejtë. Është me vend pikëpamja e Institutit të Studimeve Marksiste-Leniniste që këtu silitet për bashkëpunimin e çetave partizane të Shqipërisë së Veriut me çetat e para të Kosovës dhe të Maqedonisë. Është fakt historik i pamohueshëm që njësi të mëdha të Ushtrisë sonë Nacionalçlirimtare e ndoqën pushtuesin gjerman edhe në Kosovë, prandaj luftimet tona në Jugosllavi duhet t'i përshkruajmë mirë. Të mos harrojmë se është e nevojshme të bëjmë në këtë tekst edhe një vlerësim të Lustës Nacionaçlirimtare të popujve të Jugosllavisë ku të dalë që dy ushtritë tona bashkëpunuani në luftime kundër të njëjtë armik. Në këtë tekst, të pasqyrohet pra, fakti se ne i ndihmuam ata për çlirimin e popujve të Jugosllavisë etj., duke bashkëpunuar në vijën e Lustës Nacionaçlirimtare. Në kuadrin e bashkëpunimit me Lustën Nacionaçlirimtare të popujve të Jugosllavisë, ndaj së cilës Partia jonë dhe Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacionaçlirimtare kanë mbajtur një qëndrim të drejtë, ne kemi ndikuar në zhvillimin me sukses të Lustës Nacionaçlirimtare në Kosovë.

Që të mos lutet historia në skema e kallëpe, jam i mendimit të mos bëhen në tekst konkluzione për probleme të përgjithshme ose të veçanta, qoftë në fund të çdo kapitulli apo në fund të librit. Konkluzionet le t'i bëjnë vetë lexuesit apo studiuesit e historisë.

Mirë do të jetë të mos taprohet me citatet e nxjerra nga dokumentet e armikut, që vërtetojnë disa ngjarje të vërteta, sepse për to dëshmojnë shumë fakte historike. Mund të përdoren vetëm ato citate që bëjnë fjalë për jehonën e luftës sonë, për dëmet e pësuara prej tij

etj. Në raste të tjera materiali i armikut mund të përdoret me perifrazime, por s'ka nevojë të citohet tekstualisht.

Në tekstin e historisë jam i mendimit të përdoret terminologjia ushtarake e kohës dhe jo ajo që kemi sot.

Për sa u përket shënimit të emrave, jam dakord edhe unë me pikëpamjen e Institutit të Studimeve Marksiste-Leniniste. Ashtu sikurse tha shoqja Nexhmije [Hoxha], ne do të përmendim emra, po të mos futemi në hollësi. Historinë dhe luftën nuk e bënë as 10, as 20 ose 40 veta, po qindra e mijëra njerëz nga masat e popullit, emrat e të cilëve nuk mund t'i nxjerrim të türë në këtë histori. Natyrisht, sipas kritereve që keni vënë ju, do të përmenden me emër ata që u dalluan më shumë në luftë. Ne duhet t'u shpjegojmë drejt atyre që do të pretendojnë, t'i sqarojmë se nga kjo ose ajo brigadë, janë vënë vetëm emrat e dëshmorëve, të komandantëve dhe të komisarëve dhe jo të të gjithë partizanëve e kuadrore, shumica e të cilëve do të përmenden në historikët e qarqeve dhe të brigadave etj. Prandaj, çështjen e emrave ta shpjegojmë drejt, se ky është një tekst i historisë së përgjithshme të luftës, ku nuk mund të shkruhet gjithçka me hollësi.

Në përgjithësi të gjithë jemi dakord me maketen që na është dërguar për ta lexuar.

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbal i mbledhjes së Byrosë

*Politike të KQ të PPSH,
që gjendet në AQP*

QËLLIMIN STRATEGJIK TA REALIZOJMË PA SHKELUR PARIMET

Nga biseda me ambasadorin e RDP të Koresë

13 mars 1973

Në fillim të takimit, ambasadori korean i transmetoi shokut Enver Hoxha mesazhin që Kim Ir Seni u drejtonte Partisë dhe shtetit tonë, me anën e të cilit kërkonte përkrahjen e vendit tonë për përpjekjet e popullit dhe të qeverisë së Koresë së Veriut për ribashkimin e vendit dhe për demaskimin e politikës reaksionare të imperializmit amerikan e të klikës së Pak Çen Hisë. Pastaj fjalën e mori shoku Enver Hoxha:

Ju falënderoj për ardhjen tuaj në këtë takim dhe për transmetimin e këtij mesazhi. Unë nuk pata mundësi të takohesha me ministrin e Arsimit të vendit tuaj, që vizitoi kohët e fundit Shqipërinë, por besoj se kjo mungesë plotësohet sot në bisedën me ju. Ne kemi pasur kurdoherë parasysh faktin se uniteti ideologjik e politik midis nesh ka rëndësi të madhe, sepse nga ky unitet dhe nga zbatimi me konsekuençë i marksizëm-leninizmit, varet kontributi ynë në revolucionin proletar të përbotshëm.

Populli korean është popull trim, që gjithmonë ka luftuar për liri e pavarësi. Populli shqiptar ruan për të ndjenja të simpatisë dhe të miqësisë. Ne kurdoherë kemi dashur dhe dëshirojmë që marrëdhëniet tona të miqësisë dhe të solidaritetit të shkojnë duke u forcuar e duke u kalitur në rrugën e marksizëm-leninizmit. Në këtë çështje nuk ka rëndësi fakti që jemi larg gjeografikisht.

Vizitën që kam bërë në Kore¹, kontaktet që kam pasur me popullin tuaj, i cili më ka bërë përshtypje si një popull i dashur, i singertë e punëtor, unë i kujtoj kurdoherë me kënaqësi. Nga ajo kohë kanë kaluar shumë vjet. Ne e kemi ndjekur nga afër punën tuaj në të gjitha fushat e aktivitetit dhe e dimë se çdo gjë e keni arritur me vështirësi, me përpjekje dhe me luftë të ashpër kundër imperializmit amerikan dhc klikës së Koresë sö Jugut, që ushtrojnë presion të madh ndaj Republikës Demokratike Popullore të Koresë. Për këtë mund të përmendim, për shembull, incidentin e anijes spiune «Pueblo»², ndaj të cilit populli korean qëndroi i fortë.

Në çdo moment të vështirë, që keni kaluar, ne kemi qenë kurdoherë pranë jush. Edhe vendi ynë ka kaluar momente të tilla. Ne mendojmë se ndaj vendit tuaj ushtrohen edhe presione të tjera, që nuk i dimë, por i marrim me mend. Revisionistët sovjetikë nuk luftojnë

1. Në shtator 1956.

2. Anija amerikane «Pueblo», e projektuar për spiunazh elektronik, me një ekuipazh prej 82 vetash, u kap më 23 janar 1968 në ujërat territoriale të Republikës Demokratike Popullore të Koresë.

vetëm kundër nesh, shqiptarëve. Mbi partitë dhe popujt ata bëjnë presione nga më të ndryshmet për t'i gjunjëzuar dhe kjo është vërtetuar katërcipërisht si në përvjetorin e Partisë e të popullit tonë ashtu edhe në atë të popujve të tjerë e të lëvizjeve revolucionare në botë.

Mësuam me kënaqësi se me rastin e përvjetorit të 20-të të vdekjes së Stalinit, në organin e Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Koresë ishte botuar një shkrim në mbrojtje të çështjes së Stalinit, emrin dhe veprën e të cilit e kanë sulmuar dhe e sulmojnë revisionistët sovjetikë. Artikullin e lexuam. Është qëndrim marksist-leninist kur shkruhet drejt për Stalinin. Partia jonë e ka mbrojtur dhe do ta mbrojë me të drejtë këtë klasik të marksizëm-leninizmit nga era dhë furtuna e revisionistëve modernë, për të cilët është e qartë se kush e mbron Stalinin, është armik i tyre.

Ju lutem t'u transmetoni shokut Kim Ir Sen dhe shokëve të tjerë të udhëheqjes së partisë dhe të qeverisë suaj falënderimet e mia dhe të shokëve të tjerë të udhëheqjes sonë për mesazhin që na dërguan dhe u thoni se e konsiderojmë të drejtë preokupacionin e tyre përibashkimin e vendit. Po të mos preokupoheshit vetë ju për problemin jetik të vëllezërve në Jug, ky do të ishte një gabim i madh fatal. Marksizëm-leninizmi na mëson të kryejmë revolucionin dhe të ndihmojmë në luftën e tyre për t'u çliruar të gjithë të shtypurit e botës, pra edhe punonjësit e Koresë së Jugut, që jetojnë nën skllavërinë e imperialistëve amerikanë dhe të klikës në shërbim të tyre.

Përcaktimi i objektivave kryesorë të taktikës lidhur me Korenë e Jugut është i nevojshëm dhe i domosdosh.

shëm. Në taktikën tuaj, qëndrimi ndaj imperializmit amerikan dhe klikës së Pak Çen Hisë, që i ka shitur atij atdheun dhe popullin, duket qartë. Kurse ka edhe një taktikë që është revizioniste, e cila i var shpresat tek imperialistët amerikanë, te «zemërbutësia» e tyre, te «zemërbutësia» e Niksonit dhe te «dobësimi» i imperializmit amerikan. Duke u nisur nga këto teza të gabuara, nga ana e revizionistëve arrihet në kompromise me imperialistët.

Çështje tjetër që të türheq vëmendjen është se në mesazh u jepet rëndësi si avantazheve, ashtu edhe rreziqeve. Cilat janë këto rreziqe? Përballë jush ndodhen imperializmi amerikan dhe borgjezia e madhe reaksionare e Koresë së Jugut. Armiqtë e jashtëm dhe të brendshëm janë kundër socializmit, kundër komunizmit. Reaksiioni vendës mund edhe të lëshojë pe, mund të bëjë edhe lëshime, por në rast se Republika Demokratike Popullore e Koresë do të epej, do të bënte koncesione në favor të armikut, ajo do të binte në oportunitzëni. Por ne kemi besim se ju nuk do ta bëni këtë, por do të qëndroni në mbrojtje të atdheut, në mbrojtje të pavarësisë së tij. Mirëpo ky qëndrim nuk u pëlqen as imperialistëve amerikanë, as revizionistëve sovjetikë, as imperialistëve japonezë dhe as klikës së Pak Çen Hisë. Për marksistë-leninistët, një qëndrim i tillë do të thotë forcim i pavarësisë ekonomike, i gjendjes moralo-politike të partisë dhe të popullit, i unitetit midis tyre, forcim i mbrojtjes.

Për ribashkimin e vendit është e nevojshme që në Korenë e Jugut të krijohet një lëvizje e madhe revolucionare, e cila, natyrisht, nuk mund të kristalizohet në

një muaj ose në një vit, sepse kjo kërkon më shumë kohë. Për këtë, siç na mëson marksizëm-leninizmi, duhet të kombinohen e të përdoren me sukses format legale dhe format ilegale të luftës, sepse në rastin tuaj, sa më shumë fitore të arrijë Republika Demokratike Popullore e Koresë në ndikimin e saj në Jug, aq më e ashpër do të jetë goditja e imperialistëve amerikanë dhe e klikës së Pak Çen Hisë ndaj saj.

Imperialistët dhe borgjezia në Korenë e Jugut kërkojnë t'i shpëtojnë vdekjes dhe do të godasin kur të shikojnë se revolucioni do të ngjitet, prandaj nuk mund të mendohet kurrsesi se liria dhe bashkimi kombëtar do të fitohen pa armë. Natyrisht, përgatitje do të bëhen dhe taktika do të përdoren, me qëllim që armiku të imposhtet sa të jetë e mundur më shpejt, por nuk duhet harruar se aktualisht ka disa rrëthana që janë në disfavor të revolucionit. Imperializmi amerikan po ndihmohet në shumë forma nga revisionistët sovjetikë.

Situata është e tillë që imperialistët amerikanë dhe socialimperialistët sovjetikë ushqejnë dhe përhapin pikëpamjen se çdo gjë mund të zgjidhet me bisedime, me marrëveshje. Mirëpo jo çdo gjë mund të arrihet me bisedime e me marrëveshje. Kjo nuk do të thotë se Partia jonë është kundër bisedimeve. Ajo mendon se duhet biseduar në barazi të plotë, duke mbrojtur parimet deri në fund, pa bërë lëshime. Në kemi një strategji, të cilën duhet ta realizojmë, por këtë ta arrijmë pa shkelur parimet. Në qoftë se ka për të lëshuar, le të lëshojë armiku. Në rast se ne duhet të lëshojmë gjysmë (dhe kjo të mos jetë e rrezikshme për ne), armiku duhet të detyrohet të lëshojë shumë më tepër.

Siç dihet, në Vietnam është zhvilluar luftë, luftë me të vërtetë heroike, mirëpo pushtetin në Vietnamin e Jugut nuk e ka marrë akoma populli. Atje ka sot dy pushtete, pushteti i Thieut dhe pushteti i Frontit Kombëtar të Çlirimit. A do të merret pushteti nëpërmjet bisedimeve me amerikanët, apo me anë komisionesh si ai që përbëhet nga polakë, indonezianë, kanadezë e hungarezë? Ne mendojmë se është vështirë të arrihet ky objektiv kryesor pa goditje, pa armë, pa luajtur përsëri gishti. A mund të themi se se imperialistët amerikanë dhe Pak Çen Hia do të tërhiqen vetë, me dashje, nga Seuli? Jo, edhe këtë nuk mund ta themi. Ata do të tërhiqen pa dashjen e tyre dhe kjo do të ndodhë kur t'u bëhet i pamundur qëndrimi në Korenë e Jugut. Kush mund t'ua bëjë këtë të pamundur? Në radhë të parë, ngritja gradualisht në revolucion e popullit të Koresë së Jugut, ku me forma të ndryshme do të rriten dallgët e fuqishme të revolucionit, qëndrimi i Republikës Demokratike Popullore të Koresë dhe mbështetja e revolucionarëve, e popujve dhe e partive të vërteta marksiste-leniniste.

Të jeni të sigurt se vendi ynë kurdoherë do ta mbështetë çështjen e drejtë të popullit korean dhe në të gjitha forumet ndërkombëtare do të demaskojmë imperializmin amerikan. Krahas kësaj, ne do të vazhdojmë të demaskojmë si gjithnjë klikën e Pak Çen Hisë dhe të gjitha ato vende «socialiste» që në një mënyrë ose në një tjetër do të orvaten të mbajnë marrëdhënie me këtë klikë tradhtarësh të popullit korean dhe do ta ndihmojnë atë. Ata që ndihmojnë klikën e Pak Çen Hisë, që mbajnë lidhje me Thieu ose me Lon Nolin, siç bëjnë revolucionistët hrushovianë sovjetikë, nuk janë komunistë,

por armiq iu socializmit, janë borgjezë e kapitalistë me maska socialiste, që për interesat e tyre nuk ngurrojnë të shesin çdo vend. Prandaj ne e ndiejmë për detyrë internasionaliste dhe deklarojmë se sa herë që do të preket çështja koreane në forume ndërkombëtare, do ta mbrojmë atë, sepse ajo është një çështje e drejtë dhe, kur të shikojmë që revisionistët sovjetikë do të intrigojnë, do t'i godasim me foreë, nuk do t'i lëmë në asnje rast pa i demaskuar.

Partia e Punës e Koresë besoj se e kupton qëndrimin që mbajmë ne ndaj revisionistëve sovjetikë. Këta armiq po zbatojnë në Evropë dhe në kontinente të tjera një politikë imperialiste. Revisionistët sovjetikë kanë grumbulluar një milion ushtarë në kufirin me Kinën; Lindjen e Mesme e mbajnë nën presion, gjë që është në favor edhe të imperialistëve amerikanë e të sionistëve të Tel-Avivit; ata po përpinqen të organizojnë të gjitha ato klika kapitaliste e reaksionare në Azi, në Afrikë, në Amerikën Latine e kudo në botë, me të cilat kanë lidhje të ngushta. Për këtë arsyе kemi luftuar dhe do të luftojmë deri në fund kundër tyre ne, shqiptarët, dhe jo se na ka hipur në kokë, siç thonë disa. Ky është një qëndrim i drejtë parimor që synon të mbrojë pastërtinë e marksizëm-leninizmit dhe të ndihmojë në zhvillimin e revolucionit proletar kudo në botë.

Shoku ambasador, i transmetoni udhëheqjes suaj përshëndetjet tonë dhe e siguroni atë se Partia e Punës e Shqipërisë, Qeveria dhe populli shqiptar do të jenë kurdoherë përkrahës të çështjes së drejtë të popullit korean, të luftës së tij për bashkimin e atdheut të vet. Kjo situatë jonormale që ekziston sot në Kore, është

krijuar nga imperializmi amerikan. Prandaj, me mundësitetë që kemi, fjalën tonë për çështjen tuaj do t'ua themi miqve tanë kudo në botë dhe do ta mbrojmë atë deri në fund, sepse kjo është në interes të çështjes së përbashkët.

Botohet për herë të parë sipas shënimere të mbajtura në këtë takim, që gjenden në AQP

**SI DUHET KUPTUAR DHE SI DUHET LUFTUAR
RRETHIMI IMPERIALISTO-REVIZIONIST
I VENDIT TONË DHE EFEKTI
I PRESIONIT TË TIJ MBI NE**

*Fjala në mbledhjen e përgjithshme të komunistëve
të aparatit të KQ të Partisë për dhënie llogari e zgjedhje*

15 mars 1973

Mbi këto çështje me rëndësi jetike kemi folur shumë herë në mbledhje partie dhe me popullin, në forme të ndryshme dhe me shokë të veçantë, kurdoherë që ishte në rend të ditës problemi ose kur ky problem lidhej edhe me çështje të tjera. Përsëri dha veçanërisht me shokët sekretarë të Komitetit Qendror e ngritëm këtë çështje që ta kemi në çdo moment parasysh dhe ta ngrëmë në Parti herë pas here konkretisht, lidhur me jetën, me gjendjen dhe jo vetëm si një parullë politiko-ideologjike.

Partia lufton shumë në këtë drejtim dhe prandaj gjendja e brendshme është e shëndoshë. Por e drejta është të themi, dhe duhet ta shikojmë gjendjen në sy, se ka shokë dhe qytetarë që nuk i futen shumë thellë këtij realiteti. Disa e nönvlefësojnë me një pakujde-

si të habitshme, duke thënë: «Jemi shumë të fortë, s'kanë q'na bëjnë». Disa të tjerë mendojnë se, duke i përdorur këto vetëm si formula politike në disa fjalime e biseda të tyre, e kanë mbaruar punën, e kanë luftuar rrëthimin, e kanë dobësuar dhe likuiduar ndikimin armik dhe flenë mendjen, se i kanë sqaruar masat.

Luftën kundër rrëthimit kapitalist disa e kuptojnë në mënyrë të njëianshme dhe jo në kompleksin e saj. Këta njerëz thonë dhe arsyetojnë afërsisht kështu: «Ne, shqiptarët, jemi të guximshëm dhe trima dhe po të na turret rreziku nga jashtë, do t'uua tregojmë qejfin armiqve që do të na sulmojnë. Mjafton që të jemi ushtarërakisht të fortë, që të kemi një ushtri të fortë dhe këto dy gjëra ne i kemi, i zhvillojmë dhe i kalitim. Këto janë, pra, një koracë e padepërtueshme nga armiku». Kjo nuk është aspak e plotë, por edhe po të qëndrojnjë vetëm në këta dy faktorë, prapë koraca është e depërtueshme nga ndikimi i presionit borgjezo-kapitalisto-revisionist, në rast se edhe çështjen e trimërisë, të mbrojtjes dhe të ushtrisë ne nuk e lidhim me gjithë zhvillimin e vendit.

Njeriu është trim, në rast se i mësohet dhe arrin të kuptojë e të zbatojë me vullnet e vetëdije përse është trim, ç'duhet të mbrojë, përse duhet ta mbrojë, se atë që do të mbrojë e ka krijuar vetë me gjak, me djersë, me punë e me mundime. Këto qëllime i kanë udhëhequr e frymëzuar shqiptarët në të kaluarën, prandaj ata janë treguar trima. Këto duhet të na udhëheqin edhe sot, idealet e shenjta të Partisë dhe të popullit.

Gjatë historisë ka pasur edhe tradhtarë, që i kanë luftuar këto ideale, ka ekzistuar lufta e klasave dhe kjo vazhdon të ekzistojë, ka pasur trima, ka pasur edhe të

frikshëm, ka pasur njerëz që i kuptonin çështjet drejt dhe luftonin deri në vdekje për to, ka pasur të tjerë, që lëkundeshin, që hezitonin e zvarriteshin. Disa nga këta ngriheshin dhe edukoheshin, të tjerë rrëzoheshin. Ky proces bëhet edhe tani në përpjesëtime më të favorshme për anën pozitive, por të mos harrojmë se bëhet e do të bëhet, njerëzit nuk janë prerë të gjithë me një masë.

Aktualisht në krye është Partia, është klasa punëtore në fuqi, po ndërtohet socializmi dhe edukohet njeriu i ri. Mirëpo ky njeri i ri, që po edukojmë dhe kalitim, a e kupton si duhet çështjen e mbrojtjes së atdhcut nga ana ushtarake? Në përgjithësi ne mund të pohojmë se e kupton dhe kemi shumë suksese në këtë drejtim, por të imbyllim sytë në të metat që vërtetohen në këtë çështje, nuk na lejohet.

Ne duhet të luftojmë të rrethuar kundër arniqve të shumtë dhe me armë më moderne se tonat e më të mëdha në numër. Atëherë Ushtria jonë Popullore duhet të jetë e edukuar në perfeksion me artin ushtarak modern, t'i zotërojë mirë armët, të dijë t'i përdorë si duhet, të jetë e disiplinuar, e guximshme, e aftë politikisht e ideologjisht, të jetë me prapavija të shëndosha etj., etj. Por në këtë drejtim ka të meta, lëshime, mjaft nënvllef-tësimë në dhënien e mësimit, në organizim, në edukim, ka liberalizëm, burokratizëm, rutinë.

Luftohet kundër këtyre të metave? S'ka dyshim që luftohet, por të mos harrojmë se janë pikërisht këto shfaqje që e bëjnë koracën e mbrojtjes të depërtueshme. Këto shfaqje çfarë janë? Janë armiqësore, bëhen me qëllim, apo ka gisht armiku i jashtëm a i brendshëm në to etj.? Si të duash mund t'i quash, por kurrë nuk gabon,

po i quajte këto shfaqje krejt të huaja për ne, të cilat duhet t'i ndreqim, t'i spastrojmë, t'i zhdukim, se rrezi-kojnë edhe konceptin e vërtetë të trimërisë, edhe mbrojtjen e atdheut.

Në gjithë këtë proces edukimi, korrigjimi e spastrimi, ne do të dallojmë cilat janë me qëllim armiqësor dhe cilat bëhen pa dashje, por që çojnë njëlloj ujë në vijën e armikut. Qëllimi i armikut është që më parë të të njohë terrenin, të të tatojë pulsin, të të ulë vigjilencën me një mijë mënyra, të të shthurë dhe pastaj të të godasë.

Tani në këto koniunktura këtë taktkë përdorin armiqëtë, duke bërtitur se «ekziston paqja» dhe «bashkek-zistenea paqësore». Nesër të vjen sulmi dhe sulmit eventual duhet t'i përgatitemi ta kundërshtojmë dhe ta mundim. Asnjëherë nuk mund të themi me mendjelehtësi: «Hë mo, se jemi të fortë, s'kanë ç'na bëjnë», por duhet të bëhem me të vërtetë të fortë. Nuk mundet, gjithash-tu, asnjëherë të themi me mendjelehtësi: «Hë mo, pa kur të vijë lufta, atëherë do ta tregojmë». Duhet të përgati-temi për këtë luftë, në qoftë se vjen. Presioni i armikut është i madh që të na bindë ne se «nuk ekziston asnjë rrezik për Shqipërinë socialiste», prandaj «s'lini të qetë». Armiqëtë na quajnë ne konservatorë dhe dëshirojnë që ne të jemi liberalë.

U drejtohem disa njerëzve tanë se po, «ne jemi konservatorë përpara armikut të klasës brenda dhe jashtë, pse duam të konservojmë lirinë, pavarësinë dhe sovranitetin e atdheut që i kushtuan popullit brez pas brezi kaq gjak. Ne jemi konservatorë, se duam të konservojmë e të zhvillojmë për popullin fitoret e mëdha që kemi arritur. Ne jemi konservatorë edhe kundër liberalizmit

degjenerues të socializmit, të rinisë, të gruas, të artit, të kulturës, siç po bëjnë dhe siç na këshillojnë imperialisto-revisionistët».

Disa si Fadil Paçrami¹ e ndonjë tjetër, i kishte ngrënë meraku që të dinin se kush ishte rreziku kryesor aktual, konservatorizmi apo liberalizmi? Partia e ka thënë me kohë se që të dy janë të rrezikshëm, se duhet luftuar në të dy krahët dhe Partia kështu ka bërë. Është e gjallë, e vazhdueshme, e prekshme historia e revolucionit tonë që po zhvillohet. Por mos duan këta shokë mendjeshkurtër që ne të pohojmë për ta se rreziku kryesor aktual është konservatorizmi? Të më falni, por kjo është teza e armikut. Edhe ne u vëmë pyetjen këtyre shokëve: «Jeni ju me tezën e Partisë apo të armikut të klasës?». Këta shokë duan që ne të pohojmë se liberalizmi nuk qenka armiku kryesor. Por kjo është teza e armikut. Ne bëjmë pyetjen: «Ju jeni me tezat e Partisë apo me tezat e armikut?».

Jo! Partinë tonë nuk do ta gjeni kurrë në besasi, ajo nuk do ta deformojë kurrë teorinë e saj as nga ana konservatore as nga ana liberale, por do të ruajë pastërtinë e marksizëm-leninizmit dhe do të luftojë kurdoherë me

1. Nën petkun e luftës kundër konservatorizmit Fadil Paçrami përpigjet tu hapte rrugë ndikimeve borgjezo-revisioniste në letërsi e arte, t'i largonte këto nga rruga e Partisë dhe e socializmit. Por qëndrimi i vendosur marksist-leninist i Partisë dhe i shokut Enver Hoxha bënë që armiqtë të dështonin. Këto probleme rrithen edhe në bisedën që shoku Enver Hoxha zhvilloi me Fadil Paçramin më 30 mars 1973 (shih në këtë vëllim, f. 366), por më gjërë ato u analizuan në Plenumin e 4-t të Komitetit Qendror të PPSH, më 26-28 qershor 1973.

këtë busull të drejtë, kështu siç është e pastër, krijuese, rrugërrësyese, revolucionare.

Borgjezia, reaksiuni, imperialistët e revizionistët Partisë sonë dhe politikës sonë të brendshme e të jashtme po i vënë një mijë epitete: «Staliniste, kortina e hekurt, lufta e stohtë, konservatore, shkatërruese e fesë dhe e traditave të lashta etj.». Tani së fundi dëgjohen zëra: «Shqipëria filloi të hapë kufijtë, Shqipëria filloi të liberalizohet, Shqipëria po kthen fytyrën nga Perëndimi etj.».

Pavarësisht nga parullat që përdoren, ne duhet të kuptojmë përse i përdorin këto armiqjtë, ku e kanë qëllimin dhe ku duan të arrijnë. Imperializmi, revizionizmi dhe borgjezia reaksionare duan me çdo kusht e me çdo mjet të thyejnë rezistencën dhe luftën që bën populli ynë për të mbrojtur lirinë politike, ekonomike, ideologjike, kulturore, për të mbrojtur pavarësinë, sovranitetin dhe socializmin, ata duan të thyejnë, në radhë të parë, qëndrimin marksist-leninist të Partisë sonë, që është faktori vendimtar i të gjitha këtyre fitoreve të popullit.

Ne jemi i vetmi vend në Evropë dhe e vetmja parti komuniste që lufton me heroizëm, që i reziston me sukses këtij presioni kaq të madh që po i bëhet ditë e natë. Të gjitha ish-partitë komuniste të Evropës, me atë të Bashkimit Sovjetik (dhe të qëndrojmë në Evropë e të mos shtrihemi në të gjithë botën), tradhtuan marksizëm-leninizmin, kauzën e proletariatit, të revolucionit e të popujve të tyre. Ato tradhtuan kauzën e socializmit dhe i kthyen vendet e tyre në vende kapitaliste. Partia e Punës e Shqipërisë nuk tradhtoi, qëndroi në

këmbë e patrembur, e pathyeshme, mbron parimet, mbron socializmin, atdheun e vet, revolucionin. Kjo nuk mund të pritej dhe as të konceptohej dot, as nga imperialistët dhe as nga tradhtarët revisionistë.

Shqipëria socialiste është një vend i vogël, Partia e Punës e Shqipërisë është një parti e vogël, mund të thonë disa. Jo, nuk është ashtu, pse idetë që ato mbrojnë janë të mëdha, ato janë e ardhmja e botës dhe pish-tari i ndritur vazhdimisht në Shqipërinë socialiste jo vetëm vë në dukje me qartësi tradhtinë dhe gjëmën që u kurdisin popujve imperialisto-revisionistë, por ai i djeg e i përcëllon këta me hekur të nxeh të. Pikërisht pse Republika Popullore e Shqipërisë dhe Partia e Punës e Shqipërisë janë të vogla, shërbijnë si një shembull i madh i një luftëtarit të madhi kundër një kuçedre me shumë kokë. Të parë në këtë prizëm realist imperialisto-revisionistëve u vihet si detyrë të na shtypin; popullit shqiptar dhe Partisë së Punës të Shqipërisë u vihet detyrë të rezistojnë, të mos thyhen dhe të fitojnë në këtë luftë.

Po janë me baza ata tituj që imperialisto-revizonistët dhe lakenjtë e tyre të hapët e të maskuar i vënë popullit shqiptar dhe Partisë së Punës të Shqipërisë? A mund të quhen konservatorë një popull dhe një parti si tanët, që në disa dekada rrëzuan shekujt e errësirës e të sklavërisë? A mund të quhen konservatorë një parti dhe një popull si tanët, që me armë në dorë luf-tuan, mundën armiqtë e fuqishiëm të jashtëm dhe armiqtë shekullorë të brendshëm, që morën pushtetin në dorë dhe vendosën në vendin e tyre diktaturën e proletariatit, që kryen një sërë reformash kapitale nga më

progresivet, që bënë Reformën Agrare dhe ndërtuan socializmin në fshat, që likuiduan klasën e bezlerëve, të kapitalistëve, të kulakëve e të fajdexhinjve, që likuiduan shfrytëzimin e njeriut nga njeriu, ngritën një industri moderne, një klasë të tërë punëtore që është në drejtim të fateve vendit, që krijuan dhe që përpunuuan një administratë të përshtatshme për një vend socialist dhe e modernizuan atë, ashtu sikurse modernizuan industrinë, bujqësinë, ushtrinë e të gjithë sektorët e tjerë të jetës së vendit?

A mund të quhen konservatorë një parti dhe një popull që bënë një revolucion kaq të thellë, kaq progresist në jetën shoqërore, që nxorën gruan nga errësira dhe i dhanë asaj të gjitha të drejtat e të gjitha barazitë me burrat e në të gjitha lëmet e jetës, që shkelmuani përgjithmonë zinxhirët barbarë që e bënин gruan skllave të burrit dhe të shoqërisë, që shkelmuani kanunet e egra, doket e zakonet e këqija, që i hapën gruas fushën e gjerë të jetës plot dinjitet, rrugën e punës, të mësimit e të diturisë?

A mund të quhet konservatore Partia jonë që i solli lumturinë rinisë, që i hapi asaj shkolla nga të katër anët për t'u pajisur me dituri, me kulturë, me moral të lartë proletar, që i krijoj asaj çdo gjë që të rritet e shëndetshme, të bëhet e aftë dhe e denjë për të mbajtur stafetën që i dorëzohet dhe të punojë me ndërgjegje të lartë e të pastër, që kur t'ua dorëzojë stafetën brezave të ardhshëm, kjo stafetë të mos jetë e cenuar, e krimbur, po e shëndoshë dhe me suksese të mëtejshme të arritura vetëm në rrugën e ndershme marksiste-leniniste të popullit e të Partisë?

A nuk ishte vallë një nga aktet më heroike, më të guximshme, më të pjekura, më të matura e më të goditura grushti dërrmues që iu dha te ne dogmës së fesë, kësaj plage shekullore, kësaj merimange të zezë të helmatisur? I paktë ishte, konservator ishte likuidimi i pushtetit të fesë me aparatet dhe kuadrot e saj? Kjo ishte një ndërtesë shekullore, shpirtërore dhe materiale, Partia dhe populli e shkatërruan këtë ndërtesë brenëda disa dekadave, por lufta është akoma larg të ketë imbaruar për ta shkulur këtë kancer nga ndërgjegjja e njerëzve. Kancerit nuk i është zbuluar akoma ilaçi shfaroës, fesë po, dhe në këtë drejtim, po të luftohet me konsekuencë dhë me bindje, nuk do të duhen më shekuj, por disa dekada, disa gjenerata. Lufta kundër ideo-logjisë fetare është e lidhur ngushtë me luftën kundër imperializmit e revizionizmit, është e lidhur me luftën për socializëm dhe komunizëm.

Të tilla pyetje, siç bëra më lart, mund të bëjmë për çdo fushë, për çdo aktivitet të jetës sonë të re. Pra, nuk jemi ne konservatorët, por konservatorë janë ata që na quajnë ne konservatorë, janë imperialistët, feudalët, borgjezët, kapitalistët, klerikët dhe gjithë duaxhinjtë e tyre. Ata synojnë të na rrëmbejnë përsëri ato që fitoi populli dhe Partia dhe që ishin të popullit e të Partisë. Ata duan të na grabitin lirinë, demokracinë, pavarësinë, sovranitetin. Kështu ata kërkojnë që Shqipëria socialeste të mos jetë më socialiste, por e varur kokë e këmbë nga ata.

Që tū mos jetë më sociale Shqipëria, këta konservatorë, reaksionarë e banditë duan që tokat t'u kthehen kulakëve, latifondistëve ose një brezi kapitalistësh

të rinj, pra, të shkatërrohet sistemi socialist në fshat dhe bujku të kthehet në gjendjen e vjetër, me leshra të gjata, këtë herë deri në vesh e në supe si gratë, i veshur me rroba sintetike ekstravagante dhe me shpirt prej skllavi, që fabrikat të bëhen pronë e një borgjezie të re dhe klasa punëtore të punojë në zinxhir për ta dhe për padronët e tyre të huaj. që gruaja shqiptare të korruptohet shpirtërisht dhe fizikisht, të rropatet në punë, që rinia të degjenerohet, të hidhet holahup e të marrë narkotikë, që shkollat të mbyllen, që vagabondazhi, krimet, papunësia dhe emigrimi të lulëzojnë dhe feja e kisha të sundojnë mbi shpirtrat dhe ta ndihmojnë këtë degjenerim që ata e quajnë «modernizëm», «liberalizëm».

Këta armiq të betuar të njerëzimit përparimitar, të progresit dhe të përparimit na qenkan «modernët, të përparuarit, të qytetëruarit», kurse ne jemi «jomodernët, barbarët, të egrit, të prapambeturit, konservatorët e vjeturinave» që gjoja u ka kaluar koha. Në qenkemi «anakronikët e shekullit». Po të cilit shekull? Kuptohet të shekullit të tyre të ndyrë, të degjenerimit, të turpit, të skllavërimit.

Por modernët me tërë kuptimin e fjalës jemi ne, pse lusfojmë në shekullin që triumfoi revolucioni, se ne lusfojmë për revolucionin, për socializmin, për komunizmin, sepse ne udhëhiqemi e frymëzohemi për çdo gjë e në çdo kohë nga idetë e pavdekshme të Marksit, Engelsit, Leninit e Stalinit, sepse revolucioni është progresi, përparimi, e ardhmja e njerëzimit.

Po si bëhet që reaksiioni i zi konservator botëror na akuzon ne për konservatorë, kur nuk jemi të tillë,

si mundet të na identifikojë ai me veten e tij? Nuk ka këtu kontradiktë? Në aparençë të rreme këtu ka kontradiktë, por e shikuar kjo në prizmin e tij, nuk ka. Reaksiioni botëror hiqet dhe bën një propagandë të madhe se ai «nuk është konservator në asgjë, ai është progresist». Kapitalizmi për të gjoja nuk është ai i pari, ka ndryshuar, është bërë më progresist, më liberal, më njerëzor, nuk është më shtypës e gjakpirës i popujve dhe i progresit, nuk është më luftënxitës, nuk është më vrasës dhe spekulues i djersës dhe i mundit të njerëzve. Sipas tyre «kohët ndryshuan, ndryshuan edhe njerëzit, kapitalizmi zhvilloi forcat prodhuese, u dha atyre shumë liri, shumë të drejta edhe mbi vetë gjoja ndërmarrjet kapitaliste; ndryshuan strukturat e klasave, u zvogëluan dhe po shkojnë duke u shuar antagonizmat e klasave, po shuhet lufta e klasave dhe kjo nuk është më motori lëvizës i historisë. Dolën faktorë të tjerë në skenën e shoqërisë, si revolucioni tekniko-shkencor etj., etj.».

Me fjalë të tjera, për ta «teoria e Marksit dhe e Leninit është vjetruar, e ka humbur vlerën dhe jo vetëm kaq, por si e tillë ajo është një teori frenues e përparimit, e progresit dhe e mirëqenies, ajo është bërrë një koncept teorik konservator, anakronik». Pra, sipas tyre, «të gjithë ata që i qëndrojnë besnikë teorisë së Marksit dhe të Leninit janë konservatorë». Kështu, sipas tyre, ka «komunistë konservatorë dogmatikë», në mes të të cilëve jemi edhe ne që i qëndrojmë besnikë teorisë së marksizëm-leninizmit dhe luftojmë për triumfin e saj. Ka edhe «komunistë liberalë me sytyrë njerëzore», që janë tradhtarët e marksizëm-le-

ninizmit, të çdo ngjyre e të çdo kallëpi, me revisionistët sovjetikë, titistët e të tjerë në krye.

Marrja e fuqisë në Bashkimin Sovjetik dhe në shumë vende të demokracisë popullore nga revisionistët modernë ishte një fitore e madhe për imperializmin dhe reaksiونin botëror. Revizionizmi modern ishte një variant i ideologjisë reaksiونare borgjeze dhe pati për synim dhe realizoi transformimin e partive marksiste-leniniste të këtyre vendeve, në parti reaksiونare borgjeze fashiste dhe të socializmit, që po ndërtontej në to, në sistem kapitalist. Kjo tradhti bëri që të shpërthente në zinxhir tradhtia në një numër shumë të madh partish komuniste e punëtore në të gjitha kontinentet.

Revisionistët hruščovianë me Kongresin e tyre të 20-të dhe me shpifjet e dënimin e Stalinit, me rehabilitimin e tradhtarëve të revolucionit e të socializmit, gjoja viktima të tij, me liberalizimin në shkallë të gjerë të jetës së partisë dhe të masave gjoja të shtypura, i përgatitën shtratin dhc i hapën rrugën kapitalizmit në Bashkimin Sovjetik. Ky proces transformimi u zhvillua me hapa të shpejtë në Bashkimin Sovjetik dhe në mjaft vende të demokracisë popullore që njihen. Bashkimi Sovjetik u shndërrua shpejt në një fuqi të madhe socialimperialiste, partner dhe aleat i imperializmit amerikan në ndarjen e sferave të influencës, në sundimin e botës, në shuarjen e luftërave nacional-clirimtarë të popujve e të revolucioneve.

Të gjithë këtë proces ne e kemi jetuar, Partia jo-në e ka analizuar në të gjitha skutat dhe në krye të popullit të vet ka luftuar dhe po lufton me ashpërsinë më të madhe e me sukses kundër tradhtarëve të mark-

sizëm-leninizmit dhe aleatëve të tyre, imperialistëve të ndryshëm, me ata amerikanë në krye.

Nuk do të zgjatem këtu në këtë analizë, por nga ajo që kemi bërë dhe nuk e kemi bërë keq, në bazë të atyre faktave dhe të atyre dokumenteve të vërteta që kemi mundur të kishim dhe duke hedhur poshtë trillimet, shpifjet e falsifikimet e revizionistëve hrushovianë, tradhtia revizioniste mundi të triumfonë për arsyen Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik, pas vdekjes së Stalinit, nuk u gjend në pozita të shëndosha revolucionare. Ajo e kishte humbur shpirtin revolucionar të kohës së lavdishme të Revolucionit të Madh të Territorit, të luftës civile dhe të luftës kundër ndërhyrjes, të kohës së luftës për realizimin e pesëvjeçarëve të mëdhenj dhë të luftës së drejtë dhe të ashëpër të klasseve kundër trockistëve, buharinistëve, zinovievistëve e kulakëve, kundër tradhtisë në ushtri dhe të Luftës së Dytë të madhe Botërore.

Pas luftës normat leniniste në parti dhe në shtet ruheshin, por si duhet nuk zbatoreshin, mungonte disiplina revolucionare, nuk luftohej si duhcj kundër burokracisë, rutinës, shabllonizmit dhe një sërë vesesh të tjera që e dobësonin strukturën e partisë dhe të shtetit sovjetik. Këtu, në errësirë, lindën dhe lulzuan Hrushovët, që nga një anë këndonin himne, nga ana tjetër lëshonin dorën dhe përgatiteshin për të ardhmen.

Armi i më i rrezikshëm është ai që harrohet. Këtë armik Partia Bolshevikë e harroi, prandaj Bashkimi Sovjetik pësoi këtë katastrofë, prandaj pësoi këtë dëm të madh komunizmi ndërkombëtar.

Gjithë lajtmotivi i tradhtarëve hrushovianë ishte

pajtimi ideologjik me imperializmin amerikan dhe me kapitalizmin, bashkekzistencë paqësore, shuarja e luftrave revolucionare, marrja e pushtetit me rrugë parlamentare, bashkëpunimi i gjërë e i singertë ekonomik, shkëmbimi i lirë i eksperiencës, dhënie e marrje kredisht ekonomike, zhvillimi i turizmit dhe i ideve, e gjithë gama e një liberalizmi të shfrenuar dhe degjenerues. E gjithë kjo bëhet nën parullën «për mbrojtjen e paqes», «për një botë pa armë e pa luftëra», «për lulëzimin dhe përparimin e njerëzimit», «për triumfin e socializmit njerëzor me sytë humanitare».

Është e kuptueshme se u çel një treg i madh për përhapjen e ideologjisë borgjeze reaksionare; revizionizmi u bë një cirak i zellshëm i përhapjes së tyre, u bë një partner i denjë i imperializmit amerikan dhe botëror për përhapjen, përkrahjen dhe mbrojtjen e mënyrës së jetesës amerikane, të të menduarit perëndimor, me të gjitha të këqijat që sjellin këto me vete për degjenerimin e shoqërisë, të gruas, të rinisë.

Muzika, radioja, literatura, vallet, xhazet, narkotikët, vrasjet, kurvëria, shitja e atdheut në ankand, vërvshimi i kapitaleve amerikane, blerja e sekreteve prej tyre, blerja e njerëzve, blerja e truve, u bënë të modës, monedhë korente, bile në një mënyrë të atillë që qoftë individ, qoftë ndërmarrje, qoftë shtet që nuk vepron në mënyrë të tillë «ai nuk është në vete, ai është i lënë nga trutë e kokës, ai është prapanik, ai nuk është modern». Deti u bë kos dhe njerëzve të tillë u ka humbur luga. «Oburra, thonë ata, të rrojmë në eufori, në gëzim, të dëfrezë rinia, rinia do të renë, do modernen! Ç'janë këta konservatorë që na pengojnë të bëjn-

më si të duam, duam liri, duam demokraci, duam të flemë me gra nëpër rrugë e nëpër parqe, që ne djemtë të lëmë leshrat e gjata si të grave, të vëmë kryqe në qafë, të vemi në kisha, të na hapen klube pornografi-ke, të kemi nga një veturë private, duke pritur që të kemi edhe nga një avion në dispozicion». E tillë është jeta atje, e tillë kuptohet ajo në vendet kapitaliste dhe revizioniste. Ka njerëz që çuditën me shqiptarët, por të mos harrojmë se ka shumë bile nga ata që jo vetëm çuditën, por që janë armiq të egër dhe na kanë në grykën e pushkës. Edhe ne nuk qëndrojmë pas, i kemi ata në grykën e topit.

I madh e i vogël në vendin tonë duhet ta ketë të qartë dhe Partia vazhdimisht duhet t'u bëjë të qartë se imperialistët, revisionistët dhe gjithë kapitalistët e botës e kanë halë në sy Shqipërinë socialiste, asnjeri dhe asnjëherë nuk ia do të mirën. Për sa u përket veprimeve kundër nesh ato janë dhe mund të jenë të ndryshme nga intensiteti. nga lloji, nga mënyrat e rrethanat. Ne duhet të jemi kurdoherë të përgatitur për t'u bërë ballë, për t'i evituar, për t'i zhdukur qoftë provizorish, për t'i luftuar me atë intensitet që para-qiten dhe asnjëherë të mos bëjmë kompromis në dëni të çështjeve, të interesit të atdheut tonë dhe të parimeve. Duhet të jemi vigjilentë, jo vetëm ne, udhëheqja, por i gjithë populli, çdo njeri.

Imperialistët, revisionistët dhe borgjezia reaksionare i bëjnë kështu llogaritë: «Shqipëria është një vend i vogël, ne në çdo moment me një ndërhyrje tonën ia ndërrojmë faqen regjimit, pavarësisht se shqiptarët janë kokëfortë, janë trima dhe do të luftojnë, por asgjë

nuk mund të rezistojë përpara forcës sonë dhe sidomos tani që në mes nesh, fuqive të mëdha, merremi edhe vesh». «Megjithatë, thonë këta agresorë eventualë, ne i kemi provuar të gjitha mënyrat e forta dhe subversive, edhe me armë, edhe me blokada ekonomike kundër Shqipërisë dhe e vërteta është se nuk kemi pasur sukses. Tani hëpërhc le të përdorim taktikën tjetër që na ka dhënë aq fryte në disa vende: degjenerimin me rrugë paqësore, infiltrimin me mjete të tjera, me buzë-qeshje, me ca bërje tregti, me shtypjen e ndonjë libri të tyre, me bërjen e ndonjë filmi etj. Me këtë mënyrë ne thyem «stalinistët» në Bashkimin Sovjetik, ia arri-tëm qëllimit në vendet e tjera socialiste, atëherë përsë të mos ia arrijmë edhe në Shqipëri? Fundi presim se një mëngjes do të vdesin edhe këta të vjetrit që pengojnë. Pra, kemi kohë, le të punojmë nga brenda, sigurisht të kapemi nga ata që akoma janë të paformuar, të njohim prirjet, t'i nxitim në një mënyrë ose në një tjetër dhe ta lëmi situatën të piqet për ta marrë kalanë nga brenda, pse edhe murit me kokë nuk mund t'i bishet, se të del gjak».

Një arsyetim të tillë bëjnë në vija të përgjithshme armiqtë e jashtëm dhe ata të brendshëm të Partisë dhe të popullit. Po ne ç'duhet të bëjmë? Arsyetimin e kundërt, analizën reale të gjendjes dhe të veprojmë drejt dhe energjikisht që planet e armiqve të dështojnë. Po a mund të dështojnë këto plane? Me siguri mund të dështojnë, në rast se ne luftojmë. Në rast se jo, dhe na zë gjumi, e mori lumi Shqipërinë socialiste në mos sot, nesër. Të mos harrojmë tragjedinë e Bashkimit Sovjetik, ajo të na shërbejë si mësim.

Armiku i jashtëm aktualisht synon kundër nesh dobësimin e frontit tonë të brendshëm, domethënë dobësimin e regjimit tonë socialist dhe, në radhë të parë, të kokës udhëheqëse të tij, Partisë së Punës të Shqipërisë. Kurdoherë armiqëtë e jashtëm koordinojnë veprimet e tyre të dukshme e të padukshme me clementët armiq të brendshëm, të cilët veprojnë me mënyra e forma të ndryshme për dobësimin e regjimit të proletariatit që i shtyp dhe çdo aktivitet të tyre ata e lidhin me propagandën, me veprimet, me koniunkturat politike të aleatëve të tyre të jashtëm. Kjo aleancë mund të jetë e organizuar me sije të fshehta, mund të mos jetë me të tilla, por aleanca dhe bashkëveprimi ekzistojnë e forcohen sa më të shkujdesur të jemi dhe sa më tepër të na mungojë neve vigjilencia revolucionare.

Të mos mendojnë disa se vetëm ne e zhvillojmë luftën e klasave kundër armiqve, edhe këta e zhvillojnë atë kundër nesh. Natyrishë bilanci i forcave dhe i fitoreve në fushat e betejave të luftës së klasave nuk ka proporcione në drejtim të potencialit të shumanshëm nga ana e diktaturës së proletariatit që është në fuqi në vendin tonë socialist. Por armiku i klasës, pikërisht për arsyen se do të dalë i gjallë nga kjo luftë, që të mund të godasë pastaj më fort, ka mësuar të luftojë në këto situata të vështira për të, ai vepron ilegalisht, duke qenë legal, ai hedh gurin dhe fsheh dorën, ai i bie gjoksit, bën be e rrusë se është me këtë regjim, të cilin e urren, ai ka mësuar të maskohet dhe të ruhet nga furtunat e nga rrufetë, ai ka ombrellën e atyre «njërrëzve të mirë», por shumë naivë që, kur Partia dhe pushteti ngrenë probleme akute, thonë: «Hë mo, kjo

një valë është, kaloi muaji dhe u harrua». Ai shfrytëzon, fryn, përhap të gjitha çështjet që i vijnë në dorë dhe që i bien në vesh, ai nxit dobësitë e njerëzve, shfrytëzon autokritikat në interesin e tij, ai mbjell konfuzionin, anarkinë, indisiplinën, nxit dëshirat e ekzaggjuara, nxit vjedhjen, rrugaçerinë, dhe këto s'i bën hapur, pse ruhet, i lë t'i bëjnë të tjerët, shumë herë mundësisht «njerëzit e mirë» që të komprometohen edhe ata, të shtojë kështu radhët e tij.

Hidhuni një sy statistikave të njerëzve që kanë bërë krimë dhe do të shikojmë se shumica dërrmuese e tyre janë nga shtresa të varfsra, me origjinë të vuajtur, që çdo gjë i lidh dhe asgjë nuk i ndan nga regjimi socialist. Brenda këtyre statistikave do të shikosh një varg përqindjesh të mëdha të rinjsh që asgjë nuk i ndan nga regjimi ynë. Pse ngjet kjo? Ka shumë arsyet. Këta s'janë shtyrë të kryejnë krimin vetëm se i ka nxitur filan armik. Kjo është një, por ai nuk ka lindur kriminel e vjedhiës, ai ka shkarë gradualisht në këtë rrugë të kundërt me moralin proletar, me ligjet e diktaturës, me normat e Partisë, me disiplinën dhe rregullat e shtetit në punë. Ai ka kaluar nga disa etapa për të arritur në rrugën e krimit. Ku është fajtori? Kush është fajtori? Vetëm ai që është përpara prokurorit? Disa thonë po, ta dënojmë! Por ka edhe një gjykatës, ka edhe një prokuror akoma më të rreptë se ata që jepin dënimë përfaje penale dhe kjo është ndërgjegjja, ndërgjegjja e pastër e njeriut të ndershëm, komunist ose jo, ndërgjegjja kolektive socialiste, e cila duhet të dënojë prindërit, familjen, shkollën, ndërnarrjen, organizatat e masave, mbarë opinionin që e lanë këtë

person të shkojë në rrugën e krimit, që e lanë të shtojë radhët e armiqve të atdheut tonë socialist.

A duhet të na vrasë ne ndërgjegjja, shokë, për këto gjëra të papëlqyera që ngjasin? A mbajmë ne përgjegjësinë kryesore për to? Apo të themi si Fadil Paçrami e disa të tjërë: «Unë s'kam asnjë përgjegjësi për këtë! A na lejohet neve të mbyllim sytë përpëra këtyre gjërave të papëlqyera e të rrezikshme, pavarësisht se nuk janë në një numër të madh? Në asnjë mënyrë jo. Në qoftë se sot janë pak, po i le, nesër do të bëhen shunië.

Disa mendojnë shumë gabim. Këta thonë: «Përse t'i ngremë këto çështje, të mos i bëjmë bujë, të mos prishim atmosferën kaq të gëzueshme që ekziston, të mos prishim «namin e rinisë, të fshatarësisë, të punëtorit», të mos bëjmë një gjë të tillë, se populli do të thotë: «Ç'ka bërë Partia, pse i lejoi Partia, le të marrim masa të heshtura etj»».

Një mendim i tillë nuk është revolucionar, ai duhet të luftohet. Asnjëherë nuk e ka qortuar populli Partinë, kur i ka thënë dhe ajo kurdoherë i ka thënë gjërat copë, hapur, ashtu siç janë, përkundrazi ai e ka dashur dhe lë kokën për Partinë, pikërisht se kjo flet hapur. Pse Partia duhet të mos kurojë me guxim disa sëmundje që shfaqen në trupin e shëndetshëm të shoqërisë sonë socialiste? Apo mos vallë duhet ta lërë këtë trup kaq të bukur të gangrenizohet? Në asnjë mënyrë jo, se atëherë kemi bërë krimin më të madh.

T'i thuash hapur të metat, rreziqet dhe t'i kritikosh e t'i luftosh, po, kjo e ka karakterizuar kurdoherë Partinë tonë. Mos i ka rënë vallë nderi Partisë që ka

vepruar kështu? Jo, nderi i saj është ngritur deri në qiel dhe ndrit si dielli.

Përse do t'i bjerë nami rinishë, fshatarësisë, punëtorisë etj., kur flasim për të metat dhe gabimet e tyre? Mos këta janë pa gabime? Një fjalë e urtë thotë: «Ai që s'punon, nuk gabon». Në qoftë se janë punëtorët dhe fshatarët që punojnë, janë ata dhe s'ka njeri. Atëherë t'i fshehim gabimet e njëri-tjetrit, të krijojmë situata false? Këto nuk na i ka lejuar dhe nuk do të na i lcojë kurrë as Partia, as klasa punëtore.

Partia duhet të mobilizojë gjithë opinionin e vendit tonë dhe të krijojë një front të hekurt kundër frontit armik; i përbërë nga ata të jashtmit dhe nga të brendshmit dhe opinioni të kuptojë drejt e thellë se ky front armik, ky presion i armikut nuk është as imajinar as hipotetik, por real, konkret dhe, pra, lufta kundër tij duhet të bëhet realisht, konkretisht, politikisht, ideologjikisht dhe praktikisht. Mendjemadhësia e fodullëku në këtë problem kyç të çojnë në rrugën e harresës së armikut, në nënvlejtësimin e rrezikshmërisë së tij.

Euforia e pabazuar krijon situata të vështira dhe shërben si një mbulesë që u hedh përsipër të metave e gabimeve dhe kjo i përngjet atij jorganit që përdor për t'u mbrojtur nga të ftohtit, kurse ai është pa efekt nga ethet që të kanë mbërthyer trupin dhe të shkaktojnë dridhmat. Kjo krijon deziluzione, pakënaqësi, dekurajime. Të mos trembemi ta shohim realitetin në sy dhe të marrim masa të përshtatshme me këtë realitet.

Lufta kundër mbeturinave mikroborgjeze në ndërgjegjen e njerëzve shumë herë mendohet me lehtësi

dhe reduktohet në një luftë ideologjike nëpërmjet leksionesh e konferencash dhe, meqë është një luftë e gjatë dhe këto mbeturina shfaqen te njerëzit tanë, jo vetëm te njerëzit e popullit, por edhe në klasën punëtore dhe te pararoja e saj, te komunistët, mendohet se kemi kohë t'i zhdukim me javashllék e butë-butë, në vend që të shihet se ky është fronti më i madh i luftës sonë, më i ndërlikuari, më i dëmshmi e më i rrezikshmi që kërkon vëmendjen më të madhe të Partisë, të pushtetit e të masave dhe rigorozitetin më të madh luftarak.

Të mos i nënveftësojmë këto se i quajmë «mbeturina». Mbeturina të jep përshtypjen e gjérave të parëndësishme, të kalueshme, të shërueshme shpejt dhe pa konsekuencia të rënda, pa llore të rrezikshme që jo e jo. Ka shumë njerëz, edhe komunistë, që kështu i kuptojnë këto shfaqje kaq të rrezikshme për formimin e njeriut të ri dhe ndërtimin e shoqërisë socialiste dhe ata tregohen mjaft liberalë përpara këtyre shfaqjeve, nuk thollohen në brendinë e tyre, në konsekuencën që kanë në jetë. Këtu është fronti më i gjerë i punës armiqësore, pse këto mbeturina, siç i quajmë, janë shfaqje të ideologjisë së armikut, i cili na lufton me duart tonë, me njerëzit tanë, që, me dashje pa dashje, çojnë ujë në mullirin e armikut.

Këto shfaqje ne i quajmë «mbeturina» vetëm për arsyen dhe në drejtim të njerëzve besnikë të pushtetit popullor dhe të Partisë, pse në mes të dhjetë të mirave, ata kanë edhe ndonjë shfaqje të tillë. Ndërsa për elementin armik ato as kanë qenë ndonjëherë dhe as do të jenë «mbeturina», por ideologji e vërtetë e tyre dhe drejtim për aksion. Mirëpo këto mbeturina mikro-

borgjeze nuk janë as një as dhjetë dhe as njëlloj, si nga lloji e nga intensiteti, ashtu edhe nga mënyra që shfagjen. Vetëm një gjë kanë të përbashkët, ato janë të dëmshme, shumë të dëmshme.

Partia dhe të gjitha levat e saj po bëjnë një punë kolosale këmbëngulëse e me sukses kundër tyre. Kudo ka heroizma në punë, ka ndërgjegje, ka ndershmi. Njerëzit kaliten dhe edukohen me moralin proletar. Kjo është e pamohueshme, evidente, e prekshme. Kapërcehen me heroizëm e pjekuri vështirësi të panumërtë, pse kjo është një luftë e përditshme që nuk ecën dhe nuk mund të ecë si në gjalpë. Kjo është shumë pozitive, reale, inkurajuese dhe frymëzuese. Kjo përbën forcën e pathyeshme të Partisë sonë, të ideologjisë marksiste-leniniste, të diktaturës së proletariatit.

Por, kjo situatë e shëndoshë nuk duhet të na bëjë që të nënvlejtësojmë rrezikshmërinë, për aq sa është, të këtyre mbeturinave dhe t'i trajtojmë ato dhe konsekucat e tyre në mënyrë liberale, pse duhet të njohim që ka edhe liberalizëm në trajtimin e tyre, gjë që mund të bëjë që këto «mbeturina» të shndërrohen në botëkuptime filozofike borgjeze dhe të kenë si konsekuecë sëmundje të rrezikshme shoqërore.

Lufta e klasave që zhvillon Partia kam përshtypjen se kuptohet ngushtë nga disa, sikur kjo drejtohet vetëm kundër armikut të klasës si person, si individ dhe nuk kuptohet thellë thelbi i saj ideologjik, lufta ideologjike e klasës punëtore kundër ideologjisë borgjeze e mikroborgjeze dhe këtu suten edhe të famshmet «mbeturina», edhe një sërë të tjera që ne i quajmë në mënyrë korente «të meta, gabime, shtrembërimë, indisiplinime

etj». Bartësit e të gjitha këtyre janë njerëzit që rrojnë, punojnë dhe lustojnë mbi këtë truall tonin, ku ndërtohet socializmi, ku ndeshet e reja me të vjetrën, ku zhvillohet në fakt kjo luftë e klasave. Këto shfaqen në jetë dhe në punë dhe duhen lustuar me të gjitha format, me të gjitha mjetet në çdo kohë dhe në çdo klasë ose shtresë të popullsisë që duken, por që shfaqen më shumë e më shpesh tek intelektualët, pastaj te fshatarët dhe më pak te punëtorët. Kjo kështu është në përgjithësi, por ky kategorizim nuk duhet të na çojë në ato konkluzione se burimin e këtyre shfaqjeve do ta gjejmë vetëm tek intelektualët dhe te fshatarët, kurse klasa jonë punëtore është e pastër nga këto shfaqje të rrezikshme.

Ka thyerje të disiplinës në punë, në mësim, në sjelljen civile prej qytetari të një vendi socialist, në shkolla, në universitet, në nxënës e studentë dhe në pedagogë, të tilla ka në punë dhe në jetë, natyrisht shumë herë të një natyre tjetër, por jo më pak të rrezikshme. Në fshatarësinë tonë kooperativiste ka thyerje të rëndësishme e të rrezikshme të disiplinës proletare. Në fabrika e në ndërmarrje ku militon klasa punëtore ka mosrealizime të palejueshme plani, ka tejkalime skandaloze të normave, tectorëshi nuk zbatohet kurdoherë e kudo, ka shpërdorime e vjedhje të pasurisë socialiste, ka arrogancë, hatëre e karrierizëm në një numër nëpunësish të vegjël e të mëdhenj etj., etj. që ç't'i numëroj këtu, pse Partia dhe pushteti po ndeshen çdo ditë me to.

Bartësit e këtyre pikëpamjeve të huaja antisocialiste mos janë vallë që të gjithë armiq të socializmit? Në asnjë mënyrë jo, se po të ishte kështu, socializmi do të ishte në rrezik në vendin tonë. A mos vallë armiku

i jashtëm, qoftë dhe ai i brendshmi vete u thotë në vesh nxënësve e studentëve: «Thyeni disiplinën në shkollë, pse vrissni mendjen të mësoni, lini mësimin pa leje dhe shkon si shëtisni?». Ose mos vallë ata u thonë pedagogëve të këtyre nxënësve e studentëve: «C'nevojë keni të zgjeroni njohuritë tuaja, përse të interesoheni ju për edukimin e nxënësve jashtë shkollës?». Apo mos u thonë fshatarëve që të mos i zbatojnë si duhet ligjet e agroteknikës apo punëtorëve «në vend të tetorëshit, punoni vetëm gjashtë orë, as mos ia vini veshin cilësisë, assortimentit, por përpinquni sa më shumë të përfitonit për vete duke tejkaluar normën? Në asnjë mënyrë jo.

Atëherë përse na ngjasin këto? «Presioni i jashtëm» thuhet dhe çdo gjë shpjegohet. Mirëpo nuk është tamam kështu. Presioni i jashtëm arnik është i madh dhe nuk na lejohet ta nënvleftësojmë, por duhet të njohim mirë se na qenka edhe «presioni i brendshëm», i thellë i brendshëm në veten tonë që ne nuk e luftojmë si duhet në ndërgjegje me një edukatë të shëndoshë, nuk e luftojmë as si duhet kur ky presion shfaqet në punë dhe në jetë me të gjitha konsekuençat e tij të këqija.

Kapitalizmi ka ligjet e tij, ka disiplinën e tij në punë, të cilën e zbaton me rigorozitetin më të madh, kuptohet, në favorin e tij dhe në dëm të klasës punëtore që e shtyp dhe i pi gjakun e djersën. Socializmi, që është shteti i punëtorëve në aleancë me klasën fshatare, ka ligjet e veta, ka disiplinën e vct në punë që duhet ta zbatojmë me rigorozitet për të mirën e klasës dhe të masave të gjera të popullit, për mirëqenien e të gjithëve dhe, pra, të gjithsecilit. Mjaft herë nuk ngjet kë-

shtu te ne. A është në nderin e punëtorëve tanë që të na japë mësim një teknik gjerman nga Gjermania Perëndimore që kishte ardhur në Shqipëri për të montuar fabrikën që na kishte shitur? Ai e fillonte punën në orën e caktuar. Punëtorët tanë, që punonin me të, jo vetëm që vinin me vonesë, por në çdo moment që u tekej, linin punën, hynin e dilnin, pushonin, pinin duhan. Gjermani një herë, dy herë, miqësisht u bëri vërejtje tanëve, po më në fund nuk iu durua, mbylli derën, hodhi çelësin në xhep dhe u tha: «Këtu kemi ardhur pér të punuar dhe jo pér të dëfryer, te ne ndonjë punëtor po tò bëjë kështu si ju, padroni e hedh në rrugë dhe vdes pér bukë».

Pikërisht në vendin tonë socialist njerëzit nuk vdesin pér bukë, nuk vuajnë nga papunësia, i kanë, i shtojnë dhe do t'i shtojnë e duhet t'i shtojnë çdo ditë të mirat materiale e shpirtërore me punë, me djersë, me luftë, me sakrifica, me edukatë. Janë pikërisht këto mësimet jetëdhënëse të Partisë sonë marksiste-leniniste, këto ligje të diktaturës së proletariatit, që e kanë krijuar këtë situatë, prandaj punonjësit tanë duhet t'i studiojnë themellë, t'i kuptojnë themellë dhe të luftojnë fort pér t'i zbatuar e pér t'i mbrojtur në jetë. Nuk duhet të shkelen ligjet dhe normat e Partisë në asnjë kohë dhe nga askush, nuk duhet të shkelen ligjet e diktaturës së proletariatit, nuk duhet të abuzohet me lirinë, me demokracinë proletare. Çdo lëshim, çdo abuzim, çdo liberalizëm, çdo nënveftësim i gabimeve, i të mëtave, sjell dëme të pallogaritshme, kalbëzon gjendjen. Askush, përveç armiqve, nuk e do që të vijë një gjendje e tillë. Por ajo mund të vijë në rast se nuk luftojmë të gjithë si një

trup rrëth Partisë dhe Qeverisë sonë kundër këtyre shfaqjeve.

Këto shfaqje nuk janë të reja dhe nuk kanë lindur e as që lindin në një ditë. Ka rrëthana që u japin spunt disave. Partia reagon dhe vë në dukje rreziksh-mërinë e tyre dhe mënyrën e lustimit në të gjitha frontet. Disa njerëz e kuadro drejtues këto reagime i kon-siderojnë si «fushata», si gjëra të papritura dhe bëjnë pyetjen: «Si na ngjanë, si nuk i pamë?». Ky është një mendim i gabuar jorealist. Partia i ka parë këto më kohë, i ka paralajmëruar, është mobilizuar dhe ka luf-tuar kundër këtyre shfaqjeve. Por më drejt, njerëzit që shfaqin të tillë mendime duhet të jenë më kurajozë dhe të thonë se «kemi vepruar me fushata, disa herë përciptas, kemi lënë njëren, kemi zënë tjetrën, kemi vlerësuar një problem dhe kemi nënveftësuar tjetrin dhe ca më keq kemi pasur frikë të ngrinim zërin për të shfaqur mendimin». Kur i pyet: «Nga kush keni pa-sur frikë?», ala përgjigjen se «mos na akuzonin konser-vatorë». Po pse përgjigje është kjo!? Këtu këta shokë kanë nevojë të bëjnë një analizë të ndërgjegjes dhe të punës së tyre.

U ngrit çështja e televizonit, e radios, e festivalit, me një fjalë e shfaqjeve të huaja në letërsi e në art. Disa shqyen sytë dhe bënë të habiturin, disa thanë se fajin e ka televizioni italian, disa e minimizuan reagimin e drejtë të Partisë dhe e reduktuan në qafëleshët, Që televizioni italian ka influencuar në këtë drejtim, s'ka dyshim, por masat e popullit s'ka shumë muaj që po e shikojnë këtë; drejtuesit e televizonit dhe të arte-ve ka kohë që po e shohin televisionin, që dëgjojnë mu-

zikë të çfarëdolloji, që lexojnë, gjithashitu, literaturë të huaj. Këtë do ta analizojmë, por Partia këto probleme në art e në kulturë nuk i ka ngritur për herë të parë, ajo i ka luftuar vazhdimesht devijimet në vijë, pse ka njerëz që kanë devijuar nga vija e Partisë dhe pikërisht kanë devijuar drejt liberalizmit, drejt «modernizmit», duke imituar të shëmtuarën, të çoroditürën, degjencruesen dhe këtë e bënin pse gjoja këshitu e do rinia, pse rinia do të renë, pse rinia do të dëfrezë etj. Edhe kjo do të analizohet.

Përse iu adoptuan këtyre parullave disa udhëheqës të organizatës së rinisë, derisa të shtrembërojnë edhe direktivat e Partisë që synonin jo të dobësonin, por të forcën punën organizative të rinisë, punën politike dhe ideologjike? Ç'i shtyu këta udhëheqës rinnie të kalonin në gabime oportuniste të djathhta dhe të lejonin që nü rininë tonë të shfaqen gjëra të papëlqyera? Edhe këtë do ta analizojmë.

Por duhet të kuptojmë se nü punë, nü fabrika, nü ara, nü shkolla e nü zyra mbahet një qëndrim i butë, një qëndrim oportunist dhe liberal ndaj mbeturinave dhe të këqijave, të metave e gabimeve, si dhe kundër bartësve të tyre. Atëherë nü shkollë, nü shoqëri, nü familje e nü rrugë krijohet një ambient jo i shëndoshë, bëhet një jetë jo e vërtetë proletare, prindërit ngurrojnë të këshillojnë fëmijët ose i teprojnë përkëdheljet dhe u përm bushin me lehtësi tekat e tyre, pse me lehtësi të madhe i tejkalojnë normat edhe mbi 40 për qind. Atëherë «lirisht të vejë të bëjë qejf fëmija, të vejë çdo natë ose çdo ditë nü cinema dhe nü çdo ndeshje futbolli. Ç'punë prish pse fëmija nuk mblidhet me kohë

në shtëpi e nuk i vihet mësimit?». Nënët dhe vjehrrat s'guxojnë t'u thonë një fjalë o një hall djemve e nuseve, se i pret rruga, të sharat, pse ato janë konservatore dhe këta janë modernë.

Në një situatë të tillë humbet dashuria dhe respekti ndaj njëri-tjetrit dhe, kur këta mungojnë për të afërmit e mirë e të ndershëm, atëherë për të tjerët, për shoqërinë, me siguri këta janë formalë e pa baza, për të tillë njerëz, nuk mund të ketë norma proletare në ta, ashtu siç nuk mund të ketë norma proletare në dëshira dhe në kërkesa të ekzagjeruara, të parakohshme e pa vend nga punonjësit dhe ca më keq nga kuadro të fantaksur.

Gjendja ekonomike e vendit tonë mund të themi se nuk është e keqe, por e kënaqshme. Kjo i detyrohet vijës së drejtë të Partisë, punës së palodhshme të prodhuesve, zhvillimit të këtyre forcave sipas ligjeve shkencore të marksizëm-leninizmit, administrimit të drejtë të të ardhurave kombëtare, investimeve gjithnjë në rritje etj., etj. Në tregjet tona ka pasur nga çdo gjë, çnimet e tyre asnjëherë nuk janë ngritur, por janë ulur, kurse në vendet revisioniste e kapitaliste çnimet ngrihen çdo ditë dhe këto vende janë mbërthyer në darën e krizës së madhe ekonomike e monetare. Në e dimë se fuqia blerëse e popullatës sonë është e mirë dhe dëshirat e nevojat rriten. Të gjithë dëshirojmë dhe luftojmë që këto dëshira e nevoja të plotësohen, por të gjithë nuk e kuptojnë drejt dhë nuk veprojnë drejt në këto drejtime, pse këto çështje i shikojnë nga këndi i tyre personal, nga këndi i tyre i mikrobotës.

Që të kesh më shumë, duhet të prodhosh më shumë, që të kesh gjëra të mira, të bukura e të lira, duhet të

punosh mirë, të jesh i disiplinuar në punë, të edukohesh teknikisht, të punosh tetë orë, bile edhe më shumë ngandonjëherë, të prodhosh me cilësi të mirë sipas assortimenteve të caktuara dhe në kohën e caktuar, të livrosh mallin, domethënë të realizosh kontratat, detyrimet, planet. A i kryejmë të gjitha këto si duhet? Jo. Atëherë a është e drejtë që të bëhen kërkesa të pamatura, të padrejta, kur nuk marrim masa të forta që të realizohen si duhet planet në bujqësi, në industri, në miniera, në transport, në shkolla, në tregti? Të gjitha këto janë të lidhura.

Po si, të mos bëjmë kërkesa? Medoemos të bëjmë, por jo të thyejmë xhamë e porta për të marrë aparate televizori. Këta, qoflë edhe veglat me të cilat prodhojen, vijnë nga jashtë, prandaj këtu ka një kufi. Janë vënë rregulla në shitje, të cilat duhet t'i respektosh dhe jo të fillosh të kritikosh pushtetin, kur ti vetë nuk realizon kromin, këpucët etj.

Kjo punë është edhe me frigoriferët. «Ne kemi fabrika, thonë disa, prandaj, oburra, të bëjmë frigoriferë, të prodhojmë lavatriçe, pse duhet të lehtësojmë punën e gruas». Ne kemi bërë plot gjëra për lehtësimin e punës së gruas dhe duhet të bëjmë akoma në këtë drejtim, se ato që kemi bërë janë pak, por t'i kërkosh këto gjëra menjëherë, pa u menduar me se do të bëhen, duke thënë vetëm se «duhet», atëherë mund të flasësh në hava, siç bënte një ditë një gazetar i «Bashkimit», i cili kë nuk vuri në grykën e topit: pushtetin, ministritë që nuk hapin në çdo lagje të Gjirokastrës restorante me gjellë «oreftiko» dhe gati xhaba, që kështu të mos lodhet gruaja gjirokastrite, në një kohë kur në të gjitha lagjet e

këtij qyteti ka nga një e nga dy dyqane dhe në qendër plot mensa e restorante, kur në çdo ndërmarrje ka mensa me shumë gjellë, të cilat shteti i subvencionon. Dhe ky njeri, gjoja i pushtetit, bën një punë antishitetërorë dhe orvatet kësisoj të bëjë të pakënaqura gratë e Gjirokastrës. Nënët dhe motrat gjirokastrite, që unë i njoh mirë, u varin teneqenë njerëzve të tillë.

Por në këto kërkesa të fryra, pa baza, irrealë e të rrezikshme për ekonominë tonë, më të rrezikshmet janë ato të udhëheqjes së rretheve, të cilat i kemi parë dhe vazhdojmë t'i shikojmë kur hartojmë planet pesë ose njëvjeçare. Në qoftë se mund t'i falet dhjetë herë një individi në kërkesat që bën, një udhëheqjeje nuk mund t'i falet as maja e thoit, për arsy se ajo e di përsë nuk realizohet plani i rrethit të vet, ajo njeh mirë vështirësitë materiale dhe monetare, jo vetëm si rreth, por edhe si republikë. Megjithatë, ajo bën kërkesa, duke thënë «po të na dalë» ose duke e arsyetuar vetëm «pse çshtë e nevojshme», por jo të lhotë se «duhet të nder këmbët, sa kam jorganin» dhe gjatësinë e këtij jorgani ia kanë bërë të qartë.

Të gjitha këto gjëra dhe të tjera si këto duhet të na tërheqin seriozisht vëmendjen dhe të marrim masa të drejta e radikale e të mos kufizohemi vetëm te problemi i flokëve të gjatë të disa të rinjve. «Këta flokë» i kanë rrënjet thellë duke jo në sipërsaqe dhe nuk zhduken aq lehlë, duke i qethur një herë në 20 ditë, siç mund të bëhet me flokët e vërtetë. Këto të këqija, këto imbeturina duhet t'i shkulim nga rrënjet me një punë të shkathët e të thellë ideopolitike dhe, në mënyrë të veçantë gjatë punës, gjatë veprimit. Vetëm kështu teoria rrë-

njoset në ndërgjegjen e njerëzve dhe këta ndreqen dhe ecin drejt me tërë kuptimin e fjalës në rrugën që na tregon Partia.

Më lart thashë se socializmi dhe diktatura e proletariatit ka ligjet e veta. Këto ligje duhet të zbatohen me rigorozitet. Asnjë frymë liberalizmi nuk duhet lejuar absolutisht. Kudo duhet të vendoset disiplina e fortë proletare dhe pa hezitim të ndëshkohen në bazë të ligjeve të gjithë ata persona, cilëtdo qofshin, që e shkelin këtë disiplinë pune në prodhim, në shkolla, në zyra, që shkelin disiplinën dhe planin në të gjithë gamën dhe në të gjitha format, që shkelin normat e Partisë dhe ligjet e shtetit.

Puna është nder për njerëzit e vendit tonë, prandaj as nuk mund të kuptohet dhe as nuk mund të pranohet që të ketë njerëz, dhe sidomos të rinj, që të lidhin duart dhe të bredhin rrugëve poshtë e lart pa punë. Bijtë dhe bijat më të mira të popullit derdhën gjakun për këtë tokë dhe për këtë liri që gjëzojmë sot, kurse njerëz që bredhin kot dhe nuk duan të derdhin një pikë djersë për atdheun, ata s'bëjnë tjelër gjë veçse abuzojnë me këtë liri. Unë u them atyre të shkojnë që nesër dhe bile me vrap të punojnë dhe jo' atje ku ua ka qejfi, por kudo ku ka nevojë atdheu. Diktatura e hekurt e proletariatit të godasë rreptë, të mos ketë asnjë mëshirë dhe asnjë hezitim për parazitët, pse këta janë nga armiqtë më të rrezikshëm të atdheut tonë socialist.

Diktatura e proletariatit me organet e saj duhet t'i mbrojë deri në një të drejtat e qytetarëve, por ajo, gjithashtu, duhet t'i kërkojë çdo qytetari që të kryejë detyrën me përpikëri. S'ka e s'mund të ketë njëanësi në

këtë çështje. Çdo njeri ka të drejta, po njëkohësisht ka edhe detyra, prandaj askujt nuk i lejohet që të drejtat t'i kërkojë, ndërsa detyrat t'i lërë pas krahëve. Kush nuk kryen detyrat dhe përpinqet të maskohet, kjo do të thotë se te ky njeri nuk po bëjnë efekt këshillat e mira, puna edukative dhe ajo politike, ai abuzon në to. Atëherë të ndëshkohet pa hezitim cilidh që shkel ose u bën bisht ligjeve, urdhëresave e rregulloreve që kanë vënë klasa punëtore dhe Partia, gjithashtu, cilidh nga ata punonjës, të emëruar apo të zgjedhur, që nuk i zbaton si duhet këto ligje, urdhiëresa e rregullore, duhet të ngarkohet pa hezitim me përgjegjësi penale dhe t'i jepet gjyqit.

Duhet të vendoset disiplina e rreptë proletare në punë, që nga vajtja në orë të caktuar në të, nga zbatimi absolut i tectorëshit dhe i pushimeve vetëm në kohën e caktuar dhe për aq sa është caktuar, e deri te disiplinë e prodhimit, e planit etj. Ndaj atyre që nuk i zbatojnë këto dhe që nuk i respektojnë këto kërkesa të domos-doshme, duhet të mierren masa, që nga këshillimi (dhe në këtë gjë të mos abuzohet) deri te përjashtimi nga puna. Dhe ndëshkimi të shënohet qartë në librezën e punës të të tillë njerëzve të padisiplinuar që abuzojnë, të cilët të mos nendenjnë se do të dalin nga dera dhe do të hyjnë përsëri nga penxherja. Pa punë shteti i proletarëve nuk do t'i lërë, por kësaj here ata do të venë të punojnë atje ku e shikon shteti të nevojshme.

Të gjithë ata punonjës që dëmtojnë pronën e përbashkët socialiste, duhet ta zhdëmtojnë atë, duke ua mbajtur nga rruga. Në qoftë se ligjet në këtë drejtimi nuk janë të plota, të mierren masa që të plotësohen. Nuk mund të lejohet më, siç është vepruar deri tani, që nën

shenjën e edukimit të abuzohet nga disa njerëz të pandërgjegjshëm.

Kundër vjedhësve të pasurisë së përbashkët dhe të privatëve diktatura e proletariatit dhe organet e saj duhet të tregohen të pamëshirshëm. Për armiqjtë e popullit dhe të socializmit, në mes të të cilëve hyjnë edhe vjedhësit, s'duhet të ketë asnjë mëshirë, asnjë lëshim. Asnjë falje të mos ketë për ata që bëjnë të tilla faje, por as ndaj atyre që përpinqen të zbutin dënimet për ta.

Unë propozoj që të rishikohet ligji, ku të përcaktohet shumë më rëndë përgjegjësia e prindërve të atyre fëmijëve që nuk kanë arritur moshën ligjore dhe që marrin rrugën e vagabondazhit.

Ministria e Arsimit dhe e Kulturës ka lejuar të abuzohet në vijën e drejtë demokratike proletare që është vendosur në shkolla, prandaj është përgjegjëse për këto lëshime. Por kjo nuk lehtëson as përgjegjësinë e organizatave të Partisë dhe të rinisë në shkolla dhe as trupin mësimor. Prandaj të vendoset kudo disiplina proletare dhe mësimore nga nxënësit dhe studentët, si në ndjekjen rregullisht dhe pa bërë asnjë mungesë të paarsyshtme, ashtu edhe në nxënien e mirë të mësimeve.

Gjithashtu, mësuesit dhe pedagogët duhet të vihen përpara përgjegjësisë së rëndë që ta japid mësimin në nivelin që kërkohet dhe për këtë të bëjnë përpjekje të vazhdueshme dhe si duhet për t'u lartësuar vetë. Ata kanë, gjithashtu, përgjegjësi të madhe jo vetëm për edukimin shkollor, por edhe për edukimin jashtëshkollor të nxënësve dhe të studentëve të tyre.

Me mijëra e me mijëra punonjës, pa shkëputje nga puna, ndjekin sot kudo shkollat në vendin tonë. Kjo

është një gjë shumë e mirë, e nevojshme, e domosdoshme për ata vetë dhe për shoqërinë. Shteti këtyre u bën shumë favore që, të kthyera në fonde monetare, arrijnë në shuma të mëdha. Por ngjet që në fillim të shumtë janë ata që regjistrohen, të cilët përsitojnë nga favorët që u jepen, mirëpo në fund të vitit shumica u bën bisht provimeve. Kësaj i thonë thjesht të abuzosh. Këta njerëz duhet t'i vrasë ndërgjegjja, por ka ardhur koha që duhet t'i vrasë një çikë edhe «xhepi». Unë mendoj që Qeveria ta rishikojë këtë çështje në drejtim që të gjithë ata që kanë përsituar nga këto favore, në rast se nuk kalojnë në provim, të paguajnë gjithçka që abuzivisht i kanë marrë shoqërisë.

Me këto që thashë dhe me të tjera që nuk i përmenda, por që duhet t'i thellojmë më tej në çdo sektor, mos ndryshon vallë vija e Partisë? Në asnje mënyrë jo. Këto Partia na i ka thënë dhe na i përsërit vazhdimit. Në çdo direktivë të Partisë dhe në çdo kohë do t'i gjejmë këto çështje. Këto janë bërë ligje, zakone, urdhëresa, rregulllore. Punohet, luftohet, frymëzohemi prej tyre. Ne nuk do të heqim dorë kurrë nga politika e bindjes, nga puna politike e thellë dhe e vazhdueshme me njerëzit. Në radhë të parë e mbi të gjitha ne duhet të punojmë që t'i edukojmë njerëzit tanë ideologjikisht, me teorinë marksiste-leniniste të Partisë. Ne nuk e braktisim nëasnje rast këtë rrugë që është kryesorja, vendimtarja për t'u kthyer në rrugën e masave administrative. Njerëzit e paformuar mund të bien lehtë në këto gabime. Natyrisht këta njerëz do të zgjohen tanë nga gjumi oportunist e liberal që i ka zënë dhe do të marrin «kërbagin» për t'u rikthyer përsëri në gjumin

oportunist. Çështjet duhet të shikohen drejt dhe të qën-drohet drejt ndaj tyre.

Duhet njojur se ka shumë liberalizëm e lëshime në këto çështje. Nga disa jeta është marrë lehtë, pa kokëçarje e pa shumë mundime. Disa të tjerë luftën e madhe, të vështirë e të lavdishme që ka ndërmarrë Partia dhe po e zhvillon me dekada të tëra për revolucionarizmin e njerëzve dhe të gjërave e kanë menduar si të arritur, si të fituar në të gjitha frontet dhe në të gjitha të papriturat e jetës dhe lëshojnë orë e çast komunikata sloganesh, që vënë njerëzit në gjumë, pikërisht kur disa shkelin ligjet, rregulloret, vjedhin dhe adoptojnë mënyrën e urryer të jetesës të borgjezëve reaksionarë.

Këtu është çështja të shkunden njerëzit, opinioni dërrmues i shëndoshë i vendit tonë t'i vërë me shpatulla në mur ata që bëjnë keq, që sillen keq, që mendojnë keq.

Këshillat e mira, edukata politike dhe ideologjike, është për të gjitha masat, kurse ndëshkimet janë vetëm për ata që i meritojnë këto dhe jo për njerëzit e mirë. Të këqijtë janë një pakicë, të mirët janë shumica dërrmuese dhe atje ku ka të këqij, ka edukim, por ka edhe masa, kur puna edukative nuk u bën efekt; këtë, na mëson Partia, asnjëherë të mos e harrojmë. Prandaj vijën e Partisë ta zbatojmë plotësisht dhe jo në mënyrë të çalë.

Duhet t'i edukojmë njerëzit tanë që t'i kuptojnë thellë problemet, ideologjikisht dhe politikisht. Ne nuk duhet të heqim dorë kurrë nga politika e bindjes dhe e sinqerimit, por diktatura e proletariatit dhe ideologjia

jonë nuk lejojnë që në këtë fazë të ashpër të luftës së klasave, në këtë rrethim kapitalist ne të qëndrojmë vetëm me këtë formë edukimi për ata që thyejnë ligjet, për ata që nuk u bëhet vonë të lënë punën kur të duan dhe të kthehen atje kur të duan, pse asnjeri nuk u thotë ku ishe, ose të prodhojë si t'i dojë qejfi dhe rrrogëta marrë të plotë ose të dëmtojë pasurinë e përbashkët socialiste dhe të shpëtojë vetëm me një autokritikë. Këta liberalizma e lëshime të dënueshme duhet të marrin fund menjëherë. Partia dhe Qeveria duhet të tregohen të rrepta në drejtësinë e tyre në këto çështje, po ashtu të rrepta duhet të tregohen edhe gjykatat popullore. Formalizma, kuptime burokratike në gjykatat tonë nuk duhet të lejohen, po të zhvillohet në to sryma revolucionare. E drejta e gjithsecilit duhet të mbrohet, por jo në dëm të kolektivit. Duhet t'i sigurohen personit të drejtat, por duhet t'i kërkohet edhe zbatimi i detyrave që ai ka.

Sigurimet shoqërore duhet të mbrohen dhe të zbatohen për punonjësit, por këta duhet të krycijnë deri në një detyrat që kanë ndaj punës, përndryshe ato nuk duhet të veprojnë në favorin e tyre.

Me fjalë të tjera, ligjet e diktaturës duhet të hyjnë si duhet në veprim dhe jo t'i mbulojë ndryshku që quhet në këtë rast liberalizëm, indiferentizëm, burokratizëm, hatërllëqe, krushqillëqe, njohje dhe miqësi. Dhe shumë herë këto mbulohen me çështjen «po bëjmë punë politike, janë njerëz të rinj, pa eksperiencë, do të piqen». Populli thotë: «Duhet të rrighet me vaj e me uthull», prandaj diktatura e proletariatit dhe Partia e saj, krahas punës edukative e bindëse, duhet t'i përdorë

me durim, me pjekuri sa herë është e nevojshme e pa ngurrim të gjitha masat, se këto janë për të mirën e njerëzve tanë, janë për socializmin dhe për një të ardhme më të mirë.

Prandaj të gjithë në këmbë, me forca kurdoherë të shumëfishuara, me heroizëm, me pjekuri dhe me frymën revolucionare që karakterizon popullin tonë, të mbështetur e të frysmezuar suqimisht nga vija e drejtë marksiste-leniniste e Partisë sonë, t'i përvishemi punës për të realizuar gjithsecili e të gjithë së toku detyrat që na takojnë e që do ta bëjnë atdheun tonë socialist kurdoherë e më të fortë, më të begatshëm e më të bukur!

*Botuar për herë të parë në
broshurën: Enver Hoxha.
-Si duhet kuptuar dhe si
duhet luftuar rrethimi im-
perialisto-revizionist i ven-
dit tonë dhe efekti i presio-
nit të tij mbi ne». Tirana,
1973*

*Botohet sipas librit:
Enver Hoxha «Raporte e fja-
lime 1972-1973», f. 260*

EKONOMITË MODERNE KËRKOJNË FORMA E METODA TË REJA PUNE

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

26 mars 1973

Megjithëse shokët e Byrosë Politike në diskutimet e tyre i ngritën drejt problemet, kisha edhe unë për të thënë disa fjalë.

Në radhë të parë, jam dakord me vërejtjet që u bënë në lidhje me nevojën për një kuptim të drejtë të sektorëve e të brigadave në kooperativat bujqësore, për të cilat, duhet të qëndrojmi në përcaktimet që janë dhënë më parë dhe që janë të bazuara e tö vërtetuara në jetë.

Sektori, siç e kemi thënë, nuk duhet ndërtuar në

1. Në këtë mbledhje u diskutua rreth studimit «Mbi disa probleme themelore organizativo-ekonomike të ekonomive bujqësore», që kishte si objekt përvojen e mirë të Kooperativës Bujqësore të Tipit të Lartë të Plasës, në rrethin e Korçës. Siç doli më vonë, Mehmet Shehu, që mungoi në këtë mbledhje, «për arsy shëndetësore», ishte kundër përhapjes së kësaj përvoje.

bazë fshati, po në bazë prodhimi, sepse është njësi organizative e prodhimit, ndërsa brigada është njësia bazë e prodhimit. Si e tillë, brigada duhet të lidhet jo vetëm me bimët, por edhe me tokën, edhe me bimët. Tokat dhe bimët nuk mund të ndahen midis tyre. Bimët janë në tokë, ato nuk mund të zhvillohen jashtë tokës. Brigada duke ndjekur bimët duhet mendoemas të interesohet edhe për tokat.

Kur paraqitet nevoja, të mos hezitojmë që një brigadë ta dërgojmë në ndihmë të një brigade tjetër dhe të nxjerrim nga kjo konkluzionin që asaj të mos i kërkojmë llogari për parcelën e tokës, por vetëm për bimët që mbjell në të. Unë jam dakord që ndihma brigadave të tjera, për punët urgjente, të jepet kur ka nevojë, sepse bujqësinë e ndihmon edhe qyteti. Prandaj nuk ka arsyë që kooperativistët të mos venë në ndihmë të njëri-tjetrit. Por kjo, në asnjë mënyrë nuk duhet të çojë në atë që brigada të shthurct dhë të mbetet vetëm si një nocion. Përkundrazi, brigada duhet të ekzistojë si një unitet pune i komanduar dhe këtu nuk bëhet fjalë as për 10 për qind që mund të marrë plus, në rast tejkalimi të planit të prodhimit ose minus në rast mosrealizimi për arsyec se forcat lëvizin. Këto duhet t'i komandojnë një shtab sektori, i cili i ka si brigada, si batalione, si skuadra dhe urdhëron që sipas periudhave të punojnë njëra këtu, tjetra atje e kështu me radhë. Pra, brigadat në bujqësi edhe ndihmë t'i japin njëra-tjetrës, edhe të qëndrojnë e të punojnë si reparte të organizuara mirë dhe me disiplinë të fortë, në tokat ku ndodhen bimët që kanë në plan. Ndryshe nuk mund të kemi bujqësi të përparuar.

Unë mendoj se studimi i këtyre problemeve organizativo-ekonomike të ekonomive bujqësore nga ana e Ministrisë së Bujqësisë dhe e sektorit të aparatit të Komilitit Qendror të Partisë që merret me problemet e bujqësisë, ishte i nevojshëm dhe urgjent. Konkluzionet që janë nxjerrë nga ky studim, që bazohet si në agro-teknikën moderne ashtu edhe në përvojën tonë të pasur teorike-praktike, në përgjithësi, janë të drejta dhe të zbatueshme në kushtet tona, natyrisht, duke ua përshtatur si nevojave të ekonomisë së vendit tonë në tërësi, ashtu edhe veçorive të rracheve, të kooperativave dhe të ndërmarrjeve bujqësore. Këtë të mos e harrojmë asnjëherë. Për çdo çështje që kërkojmë të zgjidhim, duhet të bazohemi kurdoherë në realitetin tonë, në kushtet tona konkrete dhe jo në teoritë e ndryshme. Teoria të na shërbejë për të na udhëhequr konkretisht në veprimtarinë praktike, në situata të caktuara, të cilat t'i shohim ashtu siç janë, t'i përmirësojmë dhe t'i përsosim ato vazhdimi. Këtë e them për arsyen, kur bëhen studime, ka shokë që fluturojnë, që kujtojnë se kanë zbuluar Amerikën dhe me kaq vetëkënaqen sikur i zgjidhën të gjitha çështjet. Por nuk është ashtu. Duhet që secili të bazohet e të luftojë në realitetin tonë, në veçoritë e vendit, të gjendjes. të kohës, të kushteve konkrete, siç do ta shpjegoj edhe më poshtë.

Ekonomitë moderne, drejt të cilave ne shkojmë në bujqësi, kërkojnë forma dhe metoda të reja pune, koncepte të reja, qoftë në trajtimin e tokës, në pasurimin dhe në shfrytëzimin e saj racional, qoftë në prodhimin e zgjeruar socialist. Sigurisht me shërbimet që i bëhen tokës ne kemi një qëllim: t'u krijojmë bimëve të ndry-

shme që mbillen në të, kushte sa më të mira zhvillimi e prodhimi që të marrim rendimente të larta. Prandaj kurdoherë dhe në të gjitha drejtimet, është e domosdoshme që studimet shkencore të thellohen dhe të na shërbejnë për zhvillimin e vazhdueshëm të bujqësisë sonë socialiste.

Në shkencën bujqësore ekzistojnë premissa dhe ligje, të cilat janë zbuluar dhe janë njojur por, sipas mendimit tim, të gjitha nuk mund të janë të zbatueshme në çdo kohë, në çdo vend dhe në çdo kusht. Zbatimi i tyre nuk duron as dogmatizmin, as liberalizmin. Studimi teorik dhe zbatimi praktik duhet të gërshetohen në mënyrë të atillë që këto ligje të natyrës, këto ligje biologjike, të zotërohen dhe të krijohen ato kushte të veçanta, me qëllim që këto ligje të bëhen të zbatueshme dhe prej tyre të nxirren konkluzione teorike dhe detyra praktike për të vepruar si duhet mbi tokën, bimët, kafshët.

Por, ashtu siç ekzistojnë ligjet objektive të natyrës në bujqësi, ekzistojnë edhe ligjet që krijojnë dhe vënë në jetë njerëzit. Këto ligje duhet të janë të lidhura, të harmonizuara me ato të natyrës, pra, me njëri-tjetrin, t'i shërbejnë njëri-tjetrit. Sigurisht, si në çdo gjë edhe këtu, ekzistojnë dhe lindin kontradikta, nga përplasja dialektike e të cilave del një formë e re më e përsosur, më progresive. Kështu, këto bëjnë që të thellohet mendimi shkencor dhe të përsoset zbatimi konkret i tij. Shumë herë mendimi shkencor ecën më shpejt se zbatimi i tij praktik, për arsyе se gjatë rrugës hasen shumë pengesa objektive dhe subjektive. Që të sheshohen këto nevojitet njëfarë kohe. Këtu luajnë rol edhe botëkuprimet, edhe format organizative që përdoren ose që zba-

tohen në bujqësi; luajnë rol, gjithashtu, edhe faktorë psikologjikë e materialë.

Zhvillimi i bujqësisë sonë, që nga Çlirimi e këtej, siç e dimë, ka kaluar nga disa etapa. Nga ekzistencë e pronës private, që u zhduk dhe u zëvendësua me pronën kolektive, ajo kaloi në kooperativat bujqësore të veçuarra, pastaj në kolektiva më të mëdhenj, në kooperativat e bashkuara. Krahas këtyre ekzistonin ndërmarrjet bujqësore, ndërsa tashti ne kaluam në kooperativat e tipit të lartë. Tok me këto forma, brenda tyre, u zhvilluan edhe forma e metoda organizimi, pune e drejtimit të reja më të përparuara që i kërkonin situatat, që i kërkonin ligjet dialektike të zhvillimit, për t'iu përgjigjur më mirë nevojave në rritje, agroteknikës moderne, mekanizmit që po shtohej, ujitjes, kimizimit etj. Por, në të gjitha këto nuk ekzistojnë forma dhe metoda të njëjtë organizimi. Diku ato janë më të përparuara, diku më të prapambetura.

Sigurisht, të gjitha këto, i dhanë një gjallëri të pararë bujqësisë sonë, e cila ecën drejt progresit dhe jo drejt stanjacionit e regresit. Bujqësia jonë mund të mos i ketë arritur akoma rendimentet botërore, por ne nuk duhet të harrojmë ato gjëra pozitive që kanë ndodhur e po zhvillohen në vendin tonë dhe as ato fenomene negative që kanë ngjarë në bujqësinë e vendeve kapitaliste.

Kapitalizmi e ka braktisur fshatin, i ka lënë djerrë tokat në hapësira të pasund, në një kohë që në qytete me miliona njerëz qëndrojnë të papunë. Te ne ngjet e kundërta e këtij procesi. Kapitalizmi e ka përqendruar bujqësinë në fushat më pjellore, të cilat i shifrytëzon në

mënyrë intensive, kuqtohet me metoda nga më modernet, por, për treg, për xhepin e për interesat e kapitalistëve dhe aspak për interesat e popullit. Ne, siç e dimë, gradualisht dhe me aq sa kemi mundësitë, po futim kudo, në gjithë ekonomitë tona bujqësore, mjetet e mekanizuara, plehrat kimike, agroteknikën moderne etj., sepse të ne punohet për interesat e gjithë popullit. Kjo është rruga e drejtë. Këto janë avantazhe të mëdha të sistemit tonë socialist, kurse minuset që ekzistojnë akoma në mekanizm, nü kimizim, në ujitje, në farëra elite, në zbatimin më gjerësishët e me rreptësi të agroteknikës moderne etj., po kapercchen graduallisht. Edhe kapitalistëve u është dashur shumë kohë përt'i arritur të gjitha këto që përmenda, por ata e bënë këtë me gjakun dhe me djersën e fshatarësisë.

Studimi, që na paraqitet sot, bazohet në një realitet objektiv. Nuk mund të themi se ai është diçka krejt i ri. Përkundrazi, atë duhet ta konsiderojmë si një perfeksionim të atyre gjërave mbi të cilat po punohet. Me këtë dua të theksoj se kjo është diçka pozitive dhe më e përparuar, në vazhdim të asaj që kemi. Të mbajmë parasysh se atë që kemi, duhet ta perfeksionojmë, se ajo nuk është diçka e arritur tërësisht, e kapercyer, e përsosur dhe, si të tillë ta lëmë pa e perfeksionuar. Nga ana tjetër, të mos mendojmë se kjo që do të bëjmë sot, do të na zgjidhë çdo gjë.

Më konkretisht: Letra e Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë e 8 janarit 1971 shtroi shumë probleme të rëndësishme pür bujqësinë tonë. Ato ishin probleme urgjente që i nxirrte koha dhe nevoja, se pa zgjidhjen e tyre bujqësia nuk mund të ekte përpara.

Këto ishin probleme që kishin të bënин me tokën, me përmirësimin e organizimit, me planifikimin ekonomik e financiar etj. Nën këtë drejtim dhe nën këtë shtytje përfunduan matja dhe specifikimi i tokave, u bënë harat pedologjike dhe agrokimike, u përpunuan dhe u forcuan organizimi e drejtimi i punës, u forcuan planifikimi e finansat dhe u bënë një tog përmirësimesh agro-teknike e zooteknike.

Mirëpo në këto çështje kardinale duhet thelluar e përsosur puna çdo ditë, pse, pa e bërë këtë, nuk mund të ecet më tej; mendimi shkencor më i përparuar, që thashë më parë, nuk mund të gjejë zbatimin e përshiqshëm. Direktivat e Partisë nuk janë çështje fushatash. Kur themi të korrim grurin, atë mund ta quajmë një fushatë, por çfarë grurë a misër duhet mbjellë, në ç'toka duhet mbjellë, si duhet bërë qarkullimi ose renditja e bimëve etj., këto nuk janë fushata. Çdo direktivë e re që hidhet. është e bazuar në të dhëna të mëparshme dhe ka një objektiv për të ardhmen. Kjo presupozon që direktiva e re të bazohet në direktivat e realizuara më parë. Proseset bujqësore janë hallka të një zinxhiri, kështu që çdo këputje e njërsës prej hallkave, dëmton tërë procesin.

Sic e dimë, ne kemi pika të dobëta në bujqësinë tonë. Një nga këto pika të dobëta është akoma mos-përqendrimi dhe mungesa e specializimit të bimëve në shkallë rrathi dhe ekonomie. Sigurisht, kjo është jo vetëm një situatë e trashëguar, por edhe e dikuar nga gjendja dhe nga rrethanat e zhvillimit të vetë kooperativave e të nevojave ekonomike të vendit, si dhe nga mungesa e rezervave në prodhime bujqësore, që rridhte

nga prodhimtaria e paktë. Natyrisht, kjo prodhimtari tash po ngrihet dhe nuk ka qëndruar në vend, qoftë në çështjen e rajonizimit të disa bimëve, siç janë disa bimë industriale, qoftë në çështjen e drithërave në përgjithësi. pse këtu kemi ecur nga nevoja e madhe për to dhe nga orientimi kryesor, i drejtë, që drithërat e bukës duhet t'i kemi parasysh në radhë të parë.

Po ashtu, për pemët frutore orientimet, në përgjithësi, kanë qenë të drejta. Këtu, natyrisht, ka një konfuzion të madh për sa u përket cilësive të pemëve, llojeve e varieteteve të tyre, ndërsa se ku duhet të shtrihen pemët dhe vreshtat, ky është një problem tjetër. Për këtë ka orientime. Kështu, nü përgjithësi, ekonomitë bujqësore kanë nga një ose dy bimë kryesore si orientim, por kjo natyrisht duhet perfektionuar, korrigjuar e plotësuar dhe duhet bërë në baza sa më shkencore, si dhe në të dhënrat e praktikës e të traditës sonë bujqësore. Një gjendje e tillë ka bërë që në çdo ekonomi bujqësore të zhvillohen shumë degë, të mos ruhen në to as proporcionalitetë racionale; të duket në to spontaneiteti dhe shumë herë, të harrohet kriteri shkencor. Kjo situatë jonormale, për të mos thënë kaotike, as nuk ka mbajtur parasysh strukturën e tokës dhe as nuk e ka ruajtur pjellorinë e saj. Nga ana tjetër ajo nuk ka lejuar qarkullimin e drejtë të bimëve.

A ka ardhur koha për një thellim të mëtejshëm të rajonizimit dhe të përqendrimit të prodhimit bujqësor e të një qarkullimi shkencor të bimëve dhe, mbi këto baza, edhe të thellimit të specializimit të rretheve dhe të ekonomive bujqësore? Po, ka ardhur, dhe unë jam dakord me studimin që është bërë për këtë çështje. Në

këtë drejtim duhet të mbahen kurdoherë parasysh si nevojat e ekonomisë popullore e kushtet natyroro-ekonomike, ashtu edhe kërkesat organizativo-ekonomike e teknike të vetë prodhimit bujqësor.

Unë jam dakord, gjithashtu, në përgjithësi, me të gjitha çështjet e studimit të paraqilur për shqyrtim, që konkretizohen në pikën e parë të projektvendimit të hartuar mbi bazën e tij. Për sa i përket pikës së dytë të projektvendimit, unë jam dakord edhe me atë, por dua të theksoj që të kihet parasysh për të evituar organizimet shabllone, organizimet për organizime dhe të mos qëndrojmë gjithnjë në të tilla organizime. Në këto përcaktimë duhet të studiohen çështjet ekonomike e financiare që kanë lidhje me të ardhurat e kooperativistëve e të brigadave të ndryshme. Të mos krijohen perturbacione në paga nga një brigadë në tjeterën që të kalohet kjo gjë lehtë e përciptas, pse gjoja e do interesit i bimëve.

Studimi që është bërë nga shokët në Kooperativën Bujqësore të Plasës, në rrethin e Korçës, sipas mendimit të, është një studim shumë i mirë. Unë i përgëzoj shokët për këtë çështje që pörbën një thellim shkencor të direktivave të Kongresit të 6-të të Partisë dhe të vendimeve të tjera të Komitetit Qendror. Afatet e përgjithësimit të këtij studimi, në rrethin e Korçës është në të gjitha rrethet dhe zbatimi i vendimeve që do të merren, janë me rëndësi. Datat e përcaktuara, koha e duhur etj., mund të pranohen në rast se janë llogaritur mirë.

Në gjithë këtë punë që do të kryhet, të mos harrohet për asnjë çast ajo që theksuan edhe shokët, objek-

tivi kryesor e vendimtar: realizimi dhe tejkalimi i planeve në bujqësi. Po s'e patëm këtë parasysh, ne do të dëmtohemi rëndë. Ne e dimë që çka do të bëjmë, në bazë të këtij studimi, është më e leverdishme se aktualja, domethënë, do të prodhohet më shumë, më mirë dhe më lirë dhë, nga të gjitha prodhimet që ka nevojë ekonomia jonë. Por, këto duhet të prodhohen e nuk duhet të ketë ndalesë prodhimi, duke u justifikuar se «ishim duke bërë organizimin», «u morëm me atë dhë harruam këtë» etj. Një gjë e tillë do të jetë shumë e dëmshme për ekonominë; ajo, gjithashtu, nuk do të jetë as inkurajuese për zbatimin me sukses të së resë. E vjetra do të na mundojë. Jo vetëm në bazë, po edhe lart do të ketë zëra që do të thonë: «Mos u shpejtuam? Mirë e kishim më parë» etj. Çështjet e bujqësisë janë serioze, prandaj kërkohet një mobilizim i madh, një ndarje pune shkencore dhe një kontroll i rreptë për zbatimin e detyrave.

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbali i mbledhjes së Byrosë

*Politike të KQ të PPSH,
që gjendet në AQP*

PËRPARIMIN E SHOQËRISE TA MATIM ME PËRPARIMIN E GRUAS

*Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

26 mars 1973

Pasi bëri disa pyetje e ndërhyrje për mënyrën e zgjedhjes së delegateve për në Kongres, për organizimin e mbledhjeve me gratë në bazë lagjeje e qendre pune, si dhe për funksionimin e komisionit për problemet e gruas pranë aparatit të Komitetit Qendror të Partisë, shoku Enver Hoxha tha:

Shokët që diskutuan, bënë shumë vërejtje për përmirësimin e punës, të cilat ju, shoqe të BGSH, duhet t'i keni parasysh kur të bëni raportin që do t'i paraqitni Kongresit. Edhe unë jam dakord me raportin në përgjithësi dhe dëshiroj të mos i hyj atij në detaje, por mendoj që ti, shoqja Vito [Kapo], t'i komunikosh Kryesisë

1. Në këtë mbledhje, midis të tjera sh., u diskutua rreth raportit të Kryesisë së Këshillit të Përgjithshëm të BGSH -Mbi realizimin e detyrave kryesore të caktuara nga Kongresi i 6-të i BGSH dhe detyrat që mendojmë të zënë vend në raportin e Kongresit të 7-të të BGSH».

së Bashkimit të Grave të Shqipërisë se Byroja Politike mendon që organizata e gruas të mos e ndryshojë strukturën organizative që ka sot¹.

Me këtë rast dëshiroj të ritheksoj disa çështje parimore dhe disa çështje të tjera të veçanta, të cilat, natyrisht, nuk janë të reja.

Mbajtja e Kongresit të 7-të të Grave të Shqipërisë, që do të zhvillohet sipas direktivave të Kongresit të 6-të të Partisë së Punës të Shqipërisë, ka një rëndësi të madhe, pse do t'i japë një hov të ri të mëtejshëm ndërtimit të socializmit në vendin tonë.

Gratë dhe të rejat, përkrah burrave dhe të rinjve, janë një forcë kolosale progresive, revolucionare. Partia dhe populli u detyrohen shumë atyre, por edhe ato u detyrohen, gjithashtu, shumë Partisë dhe popullit. Pra ekziston një komunitet dhe një unitet idealesh, qëllimësh, mendimesh dhe veprimesh në mes tyre, i çeliktitë dhe i pazgjidhshëm kurrë. Mbi këto baza është ndërtuarjeta e re socialiste në vendin tonë dhe së toku luftohet për të konsoliduar fitoret dhe për të korrur fitore të reja. Sigurisht, këto fitore nuk janë arritur me lehtësi, ashtu sikurse edhe ato që do të korren në të ardhmen nuk do të arrihen pa mundin e pa përpjekje, pse në ecjen tonë përpara, në përgjithësi, dhe në atë të gruas,

1. Është fjala për një propozim që kishte bërë Kryesia e Këshillit të Përgjithshëm të BGSH lidhur me mënjanimin e mbledhjes së përgjithshme të organizatës së gruas në lagje. Byroja Politike e KQ të PPSH jo vetëm që nuk e miratoi këtë propozim, por udhëzoi që të forcohet roli i organizatës së gruas në lagje, ku gratë ta thonë fjalën e tyre si për probleme të punës, edhe për çështje shoqërore.

në veçanti, kuptohet, ekzistojnë pengesa, por jo të pakapërcyeshme.

Është fakt që Partia dhe lufta e saj i hapën gruas fushën e lirisë, të demokracisë, të punës, i ngritën personalitetin dhe e bënë të barabartë në çdo gjë me burrin. Këlo janë fitore të mëdha themelore, të arritura dhe të pakontestueshme. Detyra e madhe qëndron në atë që këto tash duhen thelluar në të gjitha aspektet dhe shfaqjet e jetës. Kush mendon se në praktikën e gjërave, në jetë, çdo gjë ka arritur perfeksionin, gabohet. Duhen shumë luftë e shumë punë akoma, duhet t'u bëhet një luftë e vazhdueshme sidomos koncepteve të gabuara. Kjo luftë nuk mund të zhvillohet pa u ngritur njerëzit, burra e gra, të reja e të rinj, politikisht dhe ideologjikisht dhe po që se parimet marksiste-leniniste të Partisë nuk zbatohen në mënyrë korrekte në jetë.

Të jemi të ndërgjegjshëm se e kaluara na mundon gati njëlloj, si burrat, dhe gratë. Të dyja palët, në një mënyrë ose në një tjetër, shfaqin në jetë dhe në punë mendime prapanike, frenuese. Në disa momente këto mendime dalin në pah dhe bëhen pengesë, disa herë ato të burrave, disa herë të tjera ato të grave. Atavizmi¹ i burrit për sundim spikat shpesh dhe dëmton shoqërinë, por edhe atavizmi i gruas për t'u nënshtruar spikat po ashtu dhe dëmton shoqërinë. E njëjtë sëmundje, e kundërt në të dy polet, që zhvillohet në shoqëri duhet të luftohet në të dy krahët, dhe jo në mënyrë të njëanshme, ndryshtë krijohet reaksion. Të luftosh arrogancën dhe

1. Karakteristikë e të parëve të largët, që nuk shfaqet në brezat e ndërmjetëm, por që përtërihet në ata të mëvonshmit.

prepotencën, pa luftuar servilizmin dhe nënshtrimin, nuk mund të arrish kurrë në rezultatet që dëshiron.

Edhe harmonia në mes burrit dhe gruas në familje dhe në shoqëri është një çështje shumë e rëndësishme, e domosdoshme, e dorës së parë. Kjo harmoni, të mos harrojmë, atakohet nga shumë shigjeta, të dukshme dhe të padukshme, që lehtë nuk mund të thyhen, veçse nga një edukim i madh politiko-ideologjik. Kur burri është konservator ndaj gruas, të mos kujtojmë se është i tillë vetëm ndaj gruas së vet, të cilën mund ta dojë shumë, por ai është konservator edhe ndaj të tjera, edhe në drejtim të një sërë çështjesh të tjera. Botën. pra, ai e shikon jo me syrin dhe me ndjenjat e një revolucionari.

Frika ose nënshtrimi i gruas ndaj burrit të vet nuk ka konsekuenca jo të mira vetëm në familje, këto ndjenja ajo nuk mund t'i zhdukë as në shoqëri dhe as në punë, ajo i trembet jetës, u trembet të papriturave, guximi i saj mpihet.

Shumë ndodhi duhet t'i analizojmë thellë dhe drejt. Të marrim, për shembull, çështjen me rëndësi, për të cilën ka lëshuar direktivë Partia, atë që gruaja të edukohet, të mbështetet, të ndihmohet dhe të ngrihet me guxim në përgjegjësi. Kjo direktivë i dha një hov të mirë çështjes. Kaloi koha dhe kjo direktivë nuk u mbajt si duhet ngritur, ritmi i ngritjes së shoqeve në përgjegjësi nuk u rrit me rritjen e numrit të grave dhe të vajzave që fitonin dituri dhe eksperiencë. Jo vetëm nuk u rrit, por edhe numri i atyre që u ngritën në përgjegjësi filloj të zbresë përsëri. Që këtu duket shkelja e direktivës, për korrigjin e së cilës s'ka dyshim që duhen marrë masa, por në këtë çështje, në përgjithësi, vepron mosbesimi i

burrave ndaj zotësisë së grave, vepron konservatorizmi, prandaj duhen luftuar patjetër të gjitha këto të këqija. Por nuk duhet harruar që as nënvllesi esuar se edhe te shoqet kuadro ka munguar ai guxim i fortë revolucionar, lufta kundër këtyre mbeturinave nga ana e tyre nuk është zhvilluar me atë *mordant*¹, pse atje ku është bërë, «vullneti» i burrave është thyer. Gruaja, dhe sidomos gruaja kuadër, e di se Partinë e ka me vete për ta mbrojtur dhe për ta mbështetur, por atavizmi, për të cilin fola më lart, ka qenë më i fortë në të dy polet, si në burrat, edhe në gratë.

Në gazeten «Zëri i popullit», me firmën «një grup shoqesh» kritikoheshin me të drejtë ata shokë që në një mbledhje, ku do të përcaktohej një numër i madh, rreth 50 temash, për një seminar, kishin caktuar vetëm 4 shoqe. Të them të drejtën, megjithëse shokët në fjalë gabonin, ky «grup shoqesh» më la përshtypjen se «po qante». Unë mendoj se, në vend që «të qanin», të venin më mirë përpara shokëve me listën e shoqeve në dorë dhe t'u impononin mendimin e tyre, se shoqet që propozonin ishin plotësisht ië aftë të mbanin referate dhe kumtesa. Kësaj i thonë të luftosh, mendoj unë.

Nuk dua të zgjatem sot në këto çështje, pse kemi folur dhe vazhdimi shi do të flasim e do të luftojmë për to, por dua t'i përimbledh me këto fjalë: Partia asnjeherë e për asnjë moment nuk duhet të pushojë luftën e saj të lavdishme për mbrojtjen e të drejtave të gruas, ta bëjë këtë të zonjën, të aftë e trime që të drejtojë Partinë, shtetin, ekonominë socialiste, ekonominë dhe jetën

1. Frëngjisht — mprehtësi.

e familjes në një radhë me burrin. Partia nuk kërkon mëshirë për çështjen e gruas shqiptare, por ka vendosur, kërkon dhe do t'i forcojë drejtësinë dhe bërazinë për të.

E kam thënë edhe herë tjetër, ne burrat dhe djemtë duhet të bëjmë një ekzaminim të thellë të ndërgjegjes sonë dhe do të konstatojmë se jemi borxhlinj ndaj nënave, grave, motrave dhe vajzave tonë. Ky ekzaminim i ndërgjegjes është absolutisht i domosdoshëm, i nevojshëm, pse është interes i madh i atdheut që e kërkon, është interes i shoqërisë socialiste, i vetë familjes sonë. Asgjë nuk do të ndërtohet mirë, asgjë nuk do të ecë drejt, në qoftë se gruaja shqiptare nuk qëndron në ballë të përpjekjeve, të punës, të progresit.

Një nga veprat më të mëdha që ka bërë Partia, që duhet njojur pa hezitim, është revolucioni në gjirin e gruas shqiptare. Ajo para Çlirimt nuk peshohej, ajo nuk ishte gjëkundi, veçse e mbyllur në shtëpi. Gruaja ishte në errësirë, në vuajtje, në mjerim, në sklavëri. I gjithë vendi, i gjithë populli ishte në këtë gjendje, megjithëse burrin e gjeje jashtë kudo, në punë, aq sa punë kishte, në shkollë, aq sa shkolla kishte, në pushtet, ashtu siç ishte pushteti.

Filloi Lufta Nacionallirimitare e udhëhequr nga Partia, u fitua kjo luftë dhe populli e mori pushtetin në dorë. Atëherë çdo gjë ndryshoi, ndryshoi edhe gjendja e gruas në vendin tonë. Ç'është bërë në këtë drejtim? Një punë kolosale në një periudhë të shkurtër. Gruaja është kudo, ajo dallohet në punë, në mendime krijuese e me frysë revolucionare, në shkollë, në drejtim; ajo dallohet për vendosmëri, për patriotizëm e zgjuarsi. Le të mendojnë të gjithë çfarë force, çfarë

kapaciteti, çfarë zgjuarsie dhe zotësie ekzistonin të sjetur në gjirin e gruas së vendit tonë. Këto shpërthyen si vulkan dhe forca e cilësia e këtyre shpërthimeve nuk mund të barazohen me gjendjen në të kaluarën.

Eksperiencia na tregon se përparimin dhe progresin e shoqërisë duhet t'i matim me përparimin dhe me progresin e gruas. Partia dhe klasa punëtore, mendoj unë, duhet ta matin ecjen përpara drejt ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste me thellimin dhe me ecjen përpara të revolucionit të gruas brenda revolucionit tonë proletar. Në qoftë se gruaja mbetet prapa, revolucioni mbetet në vend. Çështja e gruas, problemet e saj duhen parë kurdoherë me syrin e proletarit revolucionar dhe jo me syrin meskin, të konservatorit e të liberalit degjenerues.

Çështja e gruas është një nga çështjet më të mëdha shoqërore, është çështja e ekzistencës së lumtur socialiste të atdheut. Kush përdor e trajton si skillave gruan, qoftë edhe në mendime e në koncepte, ai është skillav përvolen e tij. Këto mendime e koncepte, këto vepime ndaj gruas, si gjysma e popullatës së vendit tonë të lirë, sovran dhe socialist, s'janë dhe s'do të jenë tonat, të Partisë, të klasës punëtore dhe të pushtetit të tyre, por janë të borgjezisë kapitalisto-rezisioniste, të partive dhe të shteteve të tyre.

Por në punën tonë të përditshme nuk jemi pa të meta në këto drejtime. Prandaj, të gjithë së bashku, burra e gra, t'i vëmë krahët punës për t'i zhdukur të metat e gabimet, pikëpamjet dhe konceptet e vjetra që na mundojnë, që na pengojnë në ecjen tonë përpara. Në ballë, si kurdoherë e në çdo gjë, duhet të qëndrojnë Partia dhe

klasa punëtore. Organizata e gruas duhet të vazhdojë të zhvillojë me forca të shumëfishuara aktivitetin e saj në këtë vepër të madhe të Partisë dhe të revolucionit. Ajo, që nga formimi i saj deri tani, ka zhvilluar një veprimtari të gjerë dhe shumë frytdhënëse me gratë, ajo ka fituar autoritet dhe besim te gratë e vendit tonë, ajo ka ndjekur këmba-këmbës, ka zbatuar me konsekuençë dhe me besnikëri e në mënyrë krijuese direktivat e Partisë. Bashkimi i Grave të Shqipërisë ka meritat e tij të veçanta në këtë punë të madhe që është bërë, prandaj Partia në këtë vit jubilar të 30-vjetorit të BGSH dhe në prag të Kongresit të 7-të, e përgëzon atë, përgëzon të gjitha drejtueset dhe aktivistet e saj.

Me luftë dhe me punë arrihen objektivat dhe sukseset, korrigohen edhe të metat. Kështu ngjet edhe me organizatën e Bashkimit të Grave të Shqipërisë. Kjo do të vejë në Kongresin e saj të 7-të me shumë suksese, por do të vëré në dukje edhe mungesat e të metat e punës. Të dyja do të shërbejnë për punën e madhe të mëtejshme që na pret.

Besoj se shoqet do ta kenë parasysh se në raportin për në Kongres, më parë se të flitet për detyrat e Bashkimit të Grave të Shqipërisë, problemi duhet të pozohet me një hyrje politiko-ideologjike, ku të dalë mirë se gruaja është një pjesë nga më të rëndësishmet të popullit, të tregohet roli i saj i madh në shoqëri, jo i veçuar, por i lidhur ngushtë dhe në unitet me të gjitha shtresat e tjera të popullit. Çështja e luftës së përbashkët dhe në unitet për ndërtimin e socializmit, pavarësisht nga disa çështje specifike të punës me gruan, nuk

duhet harruar asnjëherë, pse vetëm kështu shmanget çdo shtrembürim.

Kuptohet se kjo duhet të inkuadrohet në luftën revolucionare që bën gjithë populli i bashkuar, nën udhëheqjen dhe fryshtatshme e Partisë. Asnjëherë të mos paraqitet lufta e gruas jashtë luftës së përbashkët, qoftë edhe për specifikat e saj. pse që të gjitha specifikat e punës me gra ose me burra janë të lidhura me njëratjetren, ndikojnë për të mirë o për të keq te njëratjetra, kanë të njëjtat burime, janë të lidhura në jetë, ndjekin të njëtin objektiv.

Në lidhje me raportin për në Kongres, në detyrat kryesore të grave sipas rëndësisë duhet të shënohet që më parë ato të militojnë, të ngrenë nivelin ideopolitik etj. dhe të zhvillojnë luftën kundër mbeturinave e koncepteve të huaja.

Unë mendoj që, përpëra se të futeni në punët konkrete, duhet të theksoni në raport anët kryesore orientuese politike të vendimeve të rëndësishme të Partisë dhe, si organizatë levë e Partisë, i zhvilloni këto direktiva dhe punën politike organizative krahas asaj të Partisë. Po ashtu të dalë se edhe për gratë, si për gjithë popullin, lufta revolucionare ka qenë faktor me rëndësi për edukimin dhe mobilizimin e tyre në zbatimin e detyrateve që ka shtruar Partia. Të vibet më mirë në dukje bashkëpunimi i domosdoshëm i organizatës së gruas me bashkimet profesionale, me organizatën e rinisë dhe me atë të Frontit.

Që të flasin gratë, që të dëgjohet fjala e tyre, që të marrin ato vendet e përshtatshme në punë, me kapacitetin dhe me zotësinë e tyre. kjo nuk është një detyrë

vetëm e Bashkimit të Grave, ky është një ligj i Partisë dhe Partia punon e duhet të punojë gjithnjë e më shumë në të këtë drejtim.

*Botuar për herë të parë
në librin: Enver Hoxha,
«Për gruan (Përmbledhje
reprash)», f. 547*

*Etohet sipas librit:
Enver Hoxha, «Për gruan
(Përmbledhje reprash)»,
f. 547*

ATJE KU KA KONSERVATORIZËM PËR FUTJEN E MEKANIZIMEVE, NUK KA BUJQËSI MODERNE

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

28 mars 1973

Në fund të diskutimeve që u zhvilluan, shoku Petro² i shtroi drejt çështjet kryesore që kanë të bëjnë me zhvillimin e mëtejshëm të mekanizimit të bujqësisë. Ai bëri edhe vërejtje e propozime konkrete për komitetet e Parlisë të rrelheve, si dhe për Ministrinë e Bujqësisë, prandaj mendoj se nuk kemi ç'të shtojmë më tepër.

Pa qenë nevoja të futemi në të gjitha problemet e tjera të shumta që ka bujqësia, është e domosdoshme të theksojmë se çështja e mekanizimit të proceseve të ndryshme të punimeve në këtë sektor ka një rëndësi të madhe. Kur flasim për mekanizmin e bujqësisë, në

1. Në këtë mbledhje, u diskutua rreth zbatimit të orientimeve të Kongresit të 6-të të PPSH për rritjen e shkallës së mekanizmit në bujqësi, me forcat e veta.

2. Petro Dode, në atë kohë sekretar i Komitetit Qendror të PPSH.

një shkallë më të gjerë, mendoj t'i kushtojmë vëmendje, në radhë të parë, mekanizmit të vogël.

Për mekanizime të mëdha moderne e të shumëllojshme ne duhet të jemi më të kufizuar për dy arsyë: së pari, sepse kemi të bëjmë me materiale importi dhe, së dyti, mekanizimet e mëdha shpeshherë mbeten të vdekura për mungesë të veglave të ndërrimit, të cilat industria jonë nuk është akoma në gjendje t'i prodhojë të gjitha. Aktualisht ne përballojmë një pjesë relativisht të vogël të veglave të ndërrimit të makinerive bujqësore. Çfarë do të ndodhët sikur të kishim makineri të tipave të ndryshëm, siç janë korrëset e barit ose të grurit, të cilat jemi të detyruar t'i përdorim vetëm në një drejtim, për arsyet e mungesës së veglave të ndërrimit? Do të ndodhë që shumë prej tyre nuk do të viheshin në shfrytëzim dhe do të detyroheshim të kërkonim vazhdimisht vegla ndërrimi nga importi.

Pra, para nesh del detyra që mundësitet e kufizuara për mekanizim të madh t'i kompensojmë me mekanizime të vogla. Të tënë, me kalem në dorë, të bëjmë llogari e të themi: «Në këtë proces pune që sot veprojmë me krahë, a nuk është më rentabël të përdorim mekanizma?». Dhe, t'i biem kalem e të mos qëndrojmë gjatë në konstatime e në llogarira. Pasi të nxjerrim në pah leverdinë, të veprohet menjëherë konkretisht për të prodhuar mekanizma të vegjël të rinj. Në qostë se këtë çështje ia lëmë spontaneitetit, atëherë e humbëm prodhimin, sepse ai nuk e duron spontaneitetin. Bashkë me të kemi humbur, gjithashtu, kohën si dhe forcat materialë e monetare. Kështu ta gjykojmë çështjen e mekanizmit, të cilin ta marrim në dorë seriozisht dhe, si kudo,

edhe në këtë fushë të veprojmë si revolucionarë. Fjalët që thuhen të mos i marrë era, por të punohet që ato të kthehen sa më parë në vepra.

Çfarë të bëjmë atëherë?

Në radhë të parë të kontrollohen të gjitha depot, kudo që janë, me qëllim që të bëhet inventarizimi i të gjitha mekanizmave të vegjël që ekzistojnë. Kjo është absolutisht e domosdoshme të bëhet. Gjithashtu është absolutisht e domosdoshme t'u jepet urdhër SMT-ve dhe gjithë ndërmarrjeve e oficinave, sipas të cilit, të gjitha materialet e mekanizmat që disponojnë, të vihen në eficiencë, të janë në gatishmëri. Kështu është e domosdoshme të veprohet edhe në çdo kooperativë bujqësore dhe kjo të mos mbetet në fjalë, po të vihet sa më parë në jetë.

Pse them të mos mbetemi te fjalët? Sepse në kooperativë ka një ose më shumë kovaçë; mund të ketë një ose tre shoferë etj., të cilët janë në gjendje të riparojnë këtë ose atë mekanizëm. Të mos na ndodhë, shokë, që për një detal të vogël të humbur ose të prishur nga pakujdesia, të na mbetet në mes të arës, pa u shfrytëzuar, një makinë e thjeshtë «derisa të vijë UMB-ja ose SMT-ja për ta rregulluar». Raste të tillë nuk duhet të lejohen në asnje mënyrë. Prandaj, të merren masa të rrepta dhe nëasnje rast të mos lejohet të humbasin veglat që janë pjesë përbërëse të mekanizmave.

Kur sjellim nga importi makina bujqësore ose kur ato i prodhojmë vetë në uzinat tonë, tabela ose marka e secilës makinë që dorëzohet te përdoruesi, shoqërohet edhe me veglat që nevojiten përfunksionimin e tyre, të cilat gjenden të sistemuara në një kuti, bile zakonisht,

edhe të mbyllura me çelës. Këto vegla janë të domos-doshme për një riparim të thjeshtë e të shpejtë të makinës në vend. Po ç'ndodh me këto? Duke mos ia dorë-zuar sipas rregullave me përgjegjësi përdoruesit këto mjete pune, nganjëherë ngjet që kutitë me vegla që kanë makinat me vete, lihen andej-këtej pa kujdes dhe humbasin nëpër përrenj e hendeqe. Kjo bën që, kur prishet makina, për një detal fare të vogël, ajo mbetet pa punë. Kjo gjendje duhet të marrë fund njëherë e mirë dhe të vihen para përgjegjësisë të pakujdeshmit.

Mekanizimi i bujqësisë kërkon organizim të shëndoshë, urdhra të prerë e kontroll të vazhdueshëm, ndryshe nuk mund të kemi as makina, as mekanizim, as disiplinë, as prodhim, as kursim, as mbrojtje të ekonomisë shtetërore. Prandaj, Ministria e Bujqësisë duhet të japë nga ana e saj udhëzimet e nevojshme, ndërsa Këshilli i Ministrave t'u japë urdhra të rreptë komiteve ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve e të kërkojë kontrollin e zbatimit të përpiktë të udhëzimeve të ministrisë, në mënyrë që asnjë mekanizëm të mos mbetet pa shfrytëzuar.

Të lihen mënjanë teorizimet që bëhen se «fshatari ynë është konservator, prandaj ai nuk e përkrah punën me makinë!» Jo, nuk është kooperativisti konservator. Konservatorë janë disa nga kuadrot tanë, të cilët duan të justifikojnë dobësitë e punës së tyre organizuese dhe drejtuese në fushën e mekanizimeve të bujqësisë, duke ia hedhur fajin fshatarësisë. Këta kuadro, aq sa janë, duhet ta kuptojnë mirë si një dhe një që bëjnë dy, se kush s'punon për futjen e mekanizimeve në bujqësi, ai pengon zhvillimin dhe përparimin e mëtejshëm të saj.

Do t'i lënië ne të tillë drejtues konservatorë të na vënë barrikada në këtë çështje apo t'i heqim nga vendet me përgjegjësi që mbajnë? Kështu vihet çështja, ose ky problem nuk ekziston dhe koton na e ngrenë disa kuadro. Partia ta ketë të qartë se atje ku ka konservatorizëm përfutjen e mekanizmave në punë, atje ka qëndrimin në vend, atje s'mund të ketë bujqësi moderne, rendimentetë larta dhe kursim të fuqisë së krahut. Prandaj konservatorizmi duhet thyer doemos. Si do të arrihet kjo? Në radhë të parë, nëpërmjet punës politike dhe organizative. Por, kur është e nevojshme, të merren edhe masa, deri në shkarkimin nga detyra të ndonjërit, që ngurron të futë, përf shembull, qoftë edhe kultivatorin në prashitje. Dhe në vend të këtij personi të emërohet një tjetër më i përshtatshëm, i prirur përf të vënë në shfrytëzim të gjithë mekanizmat që disponohen e që do të sjellin gjëra të mira përf popullin.

Fakt është se mekanizimi i bujqësisë është zgjeruar dhe përparimet në këtë fushë janë të mëdha. Megjithatë, mekanizmat që prodhojmë janë tabako, dua të them janë akoma në një numër të vogël. Natyrisht ne duhet t'i matim me kujdes forcat dhe mundësitë që kemi, pse dëshirat mund të janë të mëdha dhe plane mund të bëhen shumë. Kjo do të thotë të matim mijërat e hektarëve të tokës, të matim milionat e ditëve të punës që na duhen përf lëvrimin e tyre e përf t'u bërë të gjitha shërbimet bimëve bujqësore dhe të zbresim prej tyre atë kohë që fitojmë duke vënë në përdorim mekanizma. Në këtë çështje, pra, në zbatimin e planit të sigurimit të makinerive, të mos ecim në tym. Prodhimin e tyre ta bëjmë me mend në kokë e jo të nisemi nga dëshirat

apo si ia do qejfi njërit o tjetrit, por si është më mirë për interesin e republikës.

Pastaj, duhet menduar mirë se çfarë mekanizmash duhet të prodhohen. Të vendoset që prodhimi i tyre të bëhet në seri, për t'i nxjerrë në numër të madh edhe pse kështu do të ulet kostoja. Në këtë mënyrë, mekanizimi në bujqësi do të futet në një shkallë gjithnjë e më të gjerë. Të mos lejojmë që një mekanizëm i vogël të na kushtojë shumë, për shkak të mosprodhimit të tij në seri. Po, për të prodhuar në seri, çështja duhet menduar e studiuar me kujdes që më parë. Kur është nevoja të aktivizohen edhe disa ndërmarrje, që të prodrojnë makineri për bujqësinë, nga të cilat as sot nuk kemi pak, po nesër do të kemi akoma më shumë. Në qoftë se nuk do të nisemi nga kritere të tilla, ne do të rrahim ujë në havan; lëndë të parë do të harxhojmë shumë; do të prodrojmë sipas dëshirave subjektive, por jo sipas nevojave që ka bujqësia në këtë ose në atë periuadhë.

Ne kemi arritur të përbushim nevojat e bujqësisë për mekanizmin e proceseve të punës në disa zëra të domosdoshëm. Cilët janë këta zëra të domosdoshëm? Bimët kryesore të arave, shumë procese të të cilave i kemi mekanizuar. Por, ne duhet të krijojmë kushte akoma më të përshtatshme që bimët e arave të zhvillohen sa më mirë. Që të realizohet kjo, është i domosdoshëm një mekanizmi në shkallë më të madhe, i cili do të na japë më shumë prodhim dhe do të na ekonomizojë forcën e krahut. Përse na duhet ky ekonomizim i forcës së krahut, mos vallë pör të dalë shëtitje në kohën e punës, nën hijen e arrave apo të plepave? Shëtitja ka

natyrisht kohën e vet, por ekonomizimi i forcave të punës na duhet për të kryer punime të tjera në ato procese që nuk është e mundur të futim mekanizma. Prandaj, çështja se çfarë mekanizmash është e nevojshme të prodhojmë, duhet bërë objekt i një studimi dhe i një vendimi të posaçëm. Ministria e Bujqësisë, në përgjithësi, për të nxjerrë një vendim, duhet të llogaritë nevojat që paraqiten, të cilat planifikohen duke përfshirë materialjet, llojet dhe sasinë e mekanizmit në uzina, forcat punëtore që do t'i bëjnë këto dhe pastaj të shihet se cilës duhet t'i jepet prioritet, cilat do të sigurohen këtë vit, cilat do të lihen në pesëvjeçarin tjetër etj., me një fjalë këmbët të nderen sa kemi jorganin.

Po t'u hidhet një sy të ardhurave të kooperativave bujqësore, del se blegtoria, në krahasim me degët e tjera, pavarësisht se plani i saj është realizuar ose jo, jep më pak të ardhura. Të ardhurat nga blegtoria në kooperativat bujqësore zënë një vend shumë të vogël. Neve duhet të na tërheqë vëmendjen seriozisht kjo çështje. Populli ynë ka qenë kurdohërë blegtori. Që fshatarit tonë t'i futësh dashurinë për delen, për dhinë apo për lopën, nuk ka nevojë për propagandë të madhe, pse ai është marrë në shekuj, brez pas brezi me blegtorianë, prandaj e do shumë atë. Mirëpo, ashtu si kemi vepruar ne, duke mos e vlerësuar sa duhet, kjo ka bërë që fshatari ynë, pak nga pak, të flohet nga kjo degë e rëndësishme e me tradita e ekonomisë sonë. Pra, është e domosdoshme që la kthejmë më mirë ftyrën nga blegtoria, ta ngremë atë më lart, ta zhvillojmë më shumë.

Kjo situatë duhet të ndryshohet që në projektiplan. Për të arritur këtë, ndryshimi duhet të duket qysh në

këta dy-tre vjetët e planit aktual. Politika që ndiqet për shtimin e lopës është e drejtë, bile shumë e drejtë, por edhe politikën e shtimit të bagëtisë së imët, gjithashtu, Partia e ka të drejtë, gjë që duket, po të vësh re dokumentet e saj. Vetëm se në zbatimin e tyre ka raste që është gabuar. Partia ka thënë që dhitë dhe delet, atje ku këto kanë mundësi të mëdha për t'u zhvilluar, nuk duhet të pakësohen, përkundrazi të zhvillohen. Dhe një nga këto rrethe është edhe ai i Gramshit, i cili, siç doli këtu, e ka nënvlerësuar shtimin e blegtorisë së imët. Pse të ndodhë kjo? Pse ky nënvlerësim ndaj kësaj tradite kaq të madhe? E kuptioni ju rrezikshmirinë e madhe që ka për gjithë vendin nënvlerësimi i blegtorisë? E kuptioni ju që ne, një vend i vogël, harxhojmë miliona lekë në vit për të sjellë ullinj, djathë, mish e dhjamë ose vaj nga jashtë? Po nesër, sikur të mos i kemi këto, çfarë do të bëjmë? Na lejohet të marrim nga një hektar tokë dy kuintalë tagji, siç u tha këtu? Kësaj i thonë të mos e kuptioni situatën fare, shokë.

Zhvillimi dhe përparimi i blegtorisë kërkon edhe mekanizmin e mëtejshëm të saj. Nuk flas për proceset e mekanizuara që kemi sot, siç është mijelja mekanike e lopëve, ose për ndonjë mekanizim të vogël që është realizuar. Edhe këto na duhen, por fjalën e kam sidomos për atë mekanizim që ndihmon për sigurimin e bazës ushqimore të blegtorisë. Dihet se tash nuk janë të pakat tokat për foragjere, mirëpo për to më duket se nuk ka asnjë kujdes. Më kanë thënë se përveç jonxhës, në bimët e tjera të këtij lloji, nuk ndihet fare dorë njeriu, gati mungon kujdesi për kultivimin dhe sigurimin e bazës ushqimore, që tokat dhe lëndinat e lëna për pro-

dhimin në sasi të bollshme të foragjereve të bëhen me të vërtetë pjellore për këto bimë që do të na ushqejnë bagëtinë. Pse ndodh që për bazën ushqimore të blegtorisë s'ka aq shumë kujdes? Sepse shumica dërrmuese e forcave të punës janë të zëna në prashitje e në procese të tjera që kërkojnë bimët e tjera bujqësore, ndërsa për blegtoria të ka nënvlerësim. Po të vazhdojmë kështu, si mund të zhvillohet atëherë blegtoria?

Të marrim një degë tjetër të bujqësisë: pemëtarinë. Ne e dimë se ky sektor, pavarësisht se duhen edhe mekanizime, kërkon shumë fuqi punëtore. Po ja që këto mekanizime, sot për sot, nuk i kemi, ashtu siç i kërkon pemëtaria. Atëherë si do të bëjmë? Na lejohet të ecim kaq ngadalë në zhvillimin e kësaj dege të rëndësishme për popullin edhe për kalamanët tanë? Shembullin e mirë në zhvillimin e pemëtarisë nuk e jepin as kooperativat e tipit të lartë. Pse të ndodhë kjo në kooperativat e këtij tipi? Si mund të pranohet që disa prej tyre të marrin nga pemëtaria më pak të ardhura se kooperativat e zakonshme? Kjo ndodh për arsyet e mosinteresimit që tregohet për këtë çështje në këto kooperativa. A është e drejtë, shokë, që sipas një statistike që më kanë dhënë, në një periudhë relativisht shumë të shkurtër, të na prishen deri në tre milionë rrënë pemë frutore e ullinj, dhe ne, vendi i ullinjve, të sjellim për të ngrënë ullinj nga jashtë? Jo, kjo nuk është e drejtë. Po pse ndodh që akoma të mos kemi sa duhet pemë? Sepse për gjithë ata fidanë që mbillen me mobilizimin e masave, ka, gjithashtu, nënvlerësim; nuk tregohet po ai kujdes si për bimët e tjera, që të rriten e të zhvillohen për të dhënë kokrra e fruta. Shumë rrënë zihen, por

më vonë, ngaqë nuk u bëhet asnjë shërbim, ato thahen. Shumë të tjera nuk janë zhvilluar, sepse nuk kujdeset njeri për to. Mund të zhvillohet kështu pemëtaria? Në këtë mënyrë nuk mund të ecet, shokë.

Zhvillimi i pemëtarisë kërkon njerëz, shumë njerëz. Ku do t'i gjejmë këta, nga do t'i sigurojmë? Ja, pra, si lind nevoja që, në vend të shumë njerëzve, të përdorim më gjerë mekanizmat edhe në këtë sektor dhe që ky të ecë kurdoherë përpara e të ketë progres, kjo punë duhet bërë në mënyrë sistematike. Prandaj, del detyra të dimë ç'mekanizma kemi dhe si përdoren ato. Pastaj, të shohim ç'duhet të bëjmë më tej, ndryshe nuk mund të shkohet përpara. Në çdo gjë duhet rregull, disiplinë, llogari. Këto janë të nevojshme sidomos në bujqësi, e cila për vetë natyrën e saj ka vështirësi, por jo të pakapörcyeshme.

Çështjen e mekanizmit të bujqësisë e shqyrtuanë në Sekretariat, sepse ishte shumë e nevojshme. Por, mendoj se këtë problem të rëndësishëm nuk mund ta ezaurojmë vetëm në një mbledhje. Megjithatë, mendimet që dhanë shokët në këtë mbledhje të Sekretariatit, të theullohen e të zbërthehen më tej nga udhëheqja e Ministritës së Bujqësisë, nga udhëheqja e Partisë dhe e pushtetit në rrethe e në bazë, nga gjithë specialistët, të cilët duhet të aktivizohen më mirë e më shumë se deri tash përkëtë problem.

Unë jam optimist se këto çështje do të gjejnë një zgjidhje më të drejtë dhe jam dakord me të gjitha konkluzionet që ka nxjerrë Partia dhe Komiteti Qendror i saj, se njerëzit tanë në bazë, qoftë në rrugë partie, qoftë në rrugë shtetërore, tash interesohen shumë më tepër se përpara për problemet e bujqësisë. Dhe rezul-

tate kemi në këtë sektor, këtë të mos e mohojmë. Nga viti në vit ka rritje të prodhimeve bujqësore, pavarësisht se rezultatet duhet të ishin akoma më të mëdha. Por, veç anëve pozitive, veç rritjes progresive të prodhimit, në bujqësi kemi edhe anë negative që planin nuk e kemi realizuar plotësisht.

Të gjithë e dimë nevojën e madhe e të ngutshme që kemi për realizimin e planeve të bujqësisë. Për këtë është e domosdoshme që udhëheqja e Partisë dhe e pushtetit në qendër e në bazë t'i shikojë më me kujdes problemet e bujqësisë, të ketë një interesim më të madh për to. Është fakt se shokët drejtues përpigen dhe e kuptojnë rëndësinë që ka realizimi i planeve në bujqësi, por përpjekjet e tyre nuk arrijnë akoma t'i kapin si duhet gjithë përbërësit e këtij sektori të madh dhe t'i kenë si një pasqyrë të vërtetë, tek e cila të shohin çdo gjë: të vënët në balancë problemet, të caktojnë radhën dhe vendin e secilit, të përcaktojnë masat që duhen marrë, të mos lejojnë krijimin e boshllëqeve, të ndjekin problemet në front pa lënë pas dore asnjërin prej tyre, ndryshe, në bujqësi, «e merr ferra uratën». Kjo do të thotë që syri i Partisë e i pushtetit të shikojë mirë, thellë, larg, të jetë kudo. Njerëzit të qëndrojnë në lartësinë e detyrave, të ketë një drejtim unitar e të balancuar të problemeve. Çdo problem ka shumë veçori. Në rast se udhëheqja nuk di të balancojë drejt forcat e mendimit e të vepriimit, atëherë ajo futet në qorrësokak, nga i cili nuk del dot. Bile, ngjet shpesh që kapet një problem, po shpejt, pa u zgjidhur gjer në fund, ai lihet mënjanë, se fillohet një tjeter dhe në këtë mënyrë disbalancohet tërë situata.

Në qoftë se udhëheqja do të bëjë përpjekje më të mëdha që ta përmirësojë metodën e saj të punës, ajo do të jetë në gjendje të mobilizojë si duhet të gjitha forcat, masat e popullit, specialistë e jo specialistë, dhe, nëpërmjet formave të shumta organizative, do t'i vërë në vëprim me përgjegjësi të plotë. Në këtë mënyrë secilit t'i diktohen problemet kryesore, sepse pastaj për gjërat e vogla duhet t'u punojë mendja të gjithëve.

Unë jam i bindur se punonjësit e bujqësisë, që nga fshatari më i lëshëtë, nuk janë kufizuar vetëm në gjërat e vogla; ata dinë e zgjidhin edhe gjëra shumë të mëdha. Atëherë, përsë disa shokë drejtues nanurisin fshatarin, duke i folur atij edhe për gjëra që ai i di? Kuadrot tanë, në tërë piramidën e tyre, duhet të kuptojnë mirë detyrat dhe funksionet që kanë për të mobili-zuar masat në probleme të përgjithshme e të vecanta, të kohës e të perspektivës, duke ruajtur raporte të drejta në kompleksin e të gjitha çështjeve, duke kapur në kohë qdo hallkë të zinxhirit të tyre. Kjo s'do të thotë se nuk do të ketë faktorë të brendshëm ose të jashtëm që, natyrisht, do të ndikojnë për mirë ose edhe për keq. Një gjë e tillë nuk mund të përjashtohet, por çështja është që të jemi organizatorë të mirë e të zotë të punës. Në këtë drejtim mendoj se kjo mbledhje mund të ndihmojë për ta përmirësuar më tej punën edhe në fushën e mekanizmit të bujqësisë.

*Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbali i mbledhjes së Sekretariatit të KQ të PPSH,
që gjendet në AQP*

T'U KRIJOJMË KUSHITE TË RINJVE E TË REJAVE PËR T'U NJOHUR ME NJËRI-TJETRIN

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

28 mars 1973

*Duke marrë shkas nga diskutimet që po zhvillohe-
shin në këtë mbledhje për lidhjet martesore në fshat,
shoku Enver Hoxha tha:*

Në qoftë se në një fshat ka më shumë vajza sesa djem dhe djemtë fejohen, vajzat e pafejuara, për shkak të mentalitetit që ekziston, e kanë të vështirë takimin me djemtë e fshatit tjeter që mund të jetë 2 ose 3 orë larg. Atëherë, si do të fejohen këto? Si mendon Partia në rreth që t'i ndihmojë këto vajza për të lidhur martesën? Është lehtë të thuhet se jemi kundër martesave me mblesëri, po çfarë të bëjë vajza kur e sheh se po i ikën mosha dhe mbetet pa martuar? Të niset ajo nga Kuçi dhe të shkojë në Vranisht, ose nga Golloborda në Maqellarë apo në Zerqan se mos i dalë ndonjë rast për

1. Në këtë mbledhje u diskutua edhe lidhur me zbatimin e orientimeve të Kongresit të 6-të të PPSH për luftën kundër zakoneve prapanike e besimeve fetare.

t'u fejuar? Si mendon pra, Partia të zgjidhet ky problem? Sa për djalin, puna është më ndryshe, se ai shkon lehtë në një fshat tjetër dhe asnjeri nuk e pyet ku vete. Ai mund t'u thotë njerëzve se po vete të takoj një mik dhe, në të njëjtën kohë shikon edhe se me cilën mund të fejohet, ndërsa vajzat nuk veprojnë dot kështu. Prandaj, çfarë keni menduar të bëni ju, shokë të rretheve? Siç thashë, është lehtë të thuhet që fejesat të mos bëhen me mblesëri, po si do të punojmë që martesat të kenë në bazë dashurinë? Ky është një problem shoqëror që duhet zgjidhur.

SHOQJA TEFTA CAMI¹: Me bashkimin e disa koooperativave në një të vetme, të zmadhuar, janë krijuar kushte më të përshtatshme për një njohje më të mirë midis djemve dhe vajzave. Këta mund të njihen me njëri-tjetrin në punë, në brigadë, në aktivitetet shoqërore e kulturore, në aksionet e të tjera.

SHOKU ENVER HOXHA: Ne duam të dimë se si bëhet kjo punë në praktikë, si vepron në këto raste mblesi, që mund të jetë edhe pjesëtar i familjes së vajzës ose të djalit që interesohen për martesë. U tha këtu se mblesi pyet: «I kujt është ky djalë dhe si është?», «Është i mirë apo jo?», dhe, para se t'i futet mblesërisë, mendon nëse bën për vajzën e tij apo të një tjetri.

Çfarë duhet të bëjmë dhe çfarë kushtesh duhet të krijojmë ne, që përpjekjet e babait, të nënës ose të mblesit për këtë çështje t'i bëjnë vetë vajzat dhe djemtë për t'u fejuar? Unë kam dëgjuar që në Skrapar, kur bëhet

1. Në atë kohë, sekretare e Komitetit të Partisë të Replotit të Dibrës.

ndonjë festë, ka raste që djem të rinj, takohen atje me vajza dhe, kur ndonjë djali i pëlqen ndonjëra, shkon e bisedon me familjen e saj. Pra, ne duhet t'uua krijojmë disa kushte dhe lehtësi të rinjve që të njihen me njërit-tjetrin.

SHOKU RAMIZ ALIA: Për fejesat me mblesëri ne kemi luftuar dhe do të luftojmë karakterin e tyre komercial, shfrytëzues, kur mblesi e bën fejesën për para dhe jo kur ndërhyjn një njeri i mirë për të martuar djalin e njërit me vajzën e një tjetri. Kjo është e mirë, interesime të kësaj natyre kudo bëhen.

SHOKU ENVER HOXHA: Natyrisht, kjo është një punë e mirë, kur janë edhe të rinjtë dakord. Një mbles i tillë në këtë rast, üshlë një ndërmjetës, një rekomandues, që vepron pa interes dhe vete u thotë prindërve ose pjesëtarëve të familjes së djalit: «Shikoni, kjo vetë është vajzë e mirë, prandaj, pasi të shikoni edhe familjen si është, vendosni!». Të rinjtë, pas këtij rekomandimi, takohen dinc bisedojnë. Qëllimi është që fejesat dhe martesat të mos bëhen «derr në thes», por të kenë në bazën e tyre njohjen, dëshirën, vullnetin, dashurinë e djalit e të vajzës.

Pastaj, duke folur për luftën kundër zakoneve fetare, shoku Enver Hoxha tha:

Është e vërtetë që ju¹ kuadrot drejtues në rrethin e Krujës mendonit se feja u zhduk?

SHOKU MUHARREM XHAFA: Ne nuk mendonim se feja u zhduk, po disa shprehje të tilla janë dëgjuar

1. I drejtohet shokut Muharrem Xhafa, në atë kohë sekretar i Komitetit të Partisë të Rrethit të Krujës.

aty-këtu edhe në rrëthim tonë. Këto mendime kanë bërë që të kemi një ulje të propagandës kundër fesë dhe zakoneve prapanike.

SHOKU ENVER HOXHA: Nga je ti, Muharrem?

SHOKU MUHARREM XHAFA: Jam nga Burizana, fshat në rrëthim e Krujës.

SHOKU ENVER HOXHA: Pse e quajnë Burizanë fshatin tuaj?

SHOKU MUHARREM XHAFA: Unë kam mbaruar për gjuhë, prandaj jam përpjekur për të gjetur origjinën e këtij emri. Zona midis Fushë-Krujës dhe Burizanës, deri në kufi me Thumanën, është kryesisht zonë burimesh. Mendoj se kjo fjalë duhet të ketë evoluar deri në formën që përdoret sot nga populli, Burizanë.

SHOKU ENVER HOXHA: Domethënë nuk vjen nga turqishtja.

SHOKU MUHARREM XHAFA: Fshati ka ekzistuar edhe para pushtimit të vendit tonë nga otomanët.

SHOKU ENVER HOXHA: Më kanë thënë se vëllai i Shotës¹ është i sëmurë. Si është tani? Interesoheni ju ndopak?

SHOKU MUHARREM XHAFA: Po jemi interesuar. I kemi vajtur edhe në shtëpi, edhe në spital.

SHOKU ENVER HOXHA: Kur ta shikoni, i bëni të fala nga unë.

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbali i mbledhjes së Sekretariatit të KQ të PPSH, që gjendet në AQP

1. Shote Galica, Heroinë e Popullit.

TE LUFTOJME NE TE DY KRAHET, SI KUNDER KONSERVATORIZMIT, ASIITU DHE KUNDER LIBERALIZMIT

Nga biseda me Fadil Paçramin

30 mars 1973

SHOKU ENVER HOXHA: Si je?

FADIL PAÇRAMI: Mirë, shoku Enver.

Unë erdha të bisedoja me ju, lidhur me diskutimin që bëtë në mbledhjen e organizatës-bazë të aparatit të Komitetit Qendror të Partisë¹.

SHOKU ENVER HOXHA: Duhet të kiske ardhur më parë të diskutonim për këto çështje dhe jo tanë, pasi fola unë. Me sa duket, ti nuk ka ardhur më përpara, se nuk e ka ndier nevojën e konsultimit. Arsyen përsë nuk e ka ndier këtë nevojë të takon ty ta thuash singarisht. Kurse, pas kritikës që të bëra në mbledhjen e komunistëve të aparatit të Komitetit Qendror të Partisë, ti nxitove të kërkoje takim menjëherë me mua, megjithatë unë nuk

1. Në këtë mbledhje, që u bë më 15 mars 1973, shoku Enver Hoxha kritikoi Fadil Paçramin për pikëpamje liberale. Shih në këtë vëllim, f. 293.

të prita shpejt, me qëllim që të kishe kohë të mjaftuese shme për t'u thelluar në kritikën time dhe në gabimet e tua, për të cilat duhet t'u hapje zemrën Partisë dhe shokëve që të njohin. Unë i njoh gabimet e tua dhe shpresoj se tani ti do të kesh reflektuar më shumë rrëth tyre.

FADIL PAÇRAMI: Megjithëse ndoshta me vonesë, mendoj se edhe tani mund të flasim. Unë kam nevojë edhe për këshilla.

Kritika që më bëtë ju ishte e hapët, e fortë dhe e rëndë për mua. Pas fjalës suaj ndiej njëfarë presioni, se çfarë do të bëj unë tani? Unë pranoj hapur se kam rënë në gabimin e theksimit të rrezikut të konservatorizmit... Jam nisur gjithnjë nga pozitat antiobskurantiste dhe antiklerikaliste.

SHOKU ENVER HOXHA: Unë nuk kam parë në shtyp ndonjë artikull tëndin ku të trajtohej ndonjë problem me rëndësi që ngrinte Partia kundër fesë dhe traditave fetare.

FADIL PAÇRAMI: Për këto probleme kam bërë fjalë në raporte.

SHOKU ENVER HOXHA: Unë nuk kam pasur mundësi t'i lexoj të tëra raportet e tua. Meqë pretendove se në pikëpamjet kundër konservatorizmit të paska udhëhequr antiobskurantizmi dhe antiklerikalizmi po të pyes; Ke shkruar ndonjë artikull kundër fesë dhe paragjykimeve fetare që komunistët dhe populli i Tiranës ta merrnin në dorë si direktivë të trajtuar në bazë të dokumenteve të Partisë?

FADIL PAÇRAMI: Jo, artikuj nuk kam shkruar, por që nga fillimi unë kam mbajtur një qëndrim antiobskurantist dhe antiklerikal.

SHOKU ENVER HOXHA: Unë e kuptoj se jo vetëm ti, po të tërë anëtarët e Partisë janë angazhuar me luftën kundër klerikalizmit dhe obskurantizmit, por duke luftuar kundër këtyre dy rrnymave të ideologjisë reaksionare, ata nuk kanë rënë as në konservatorizëm, as në liberalizëm, përkundrazi në praktikë kanë mbajtur kurdoherë qëndrim të drejtë. Kur një njeri rrëshqet ose devijon në një drejtim, sepse i kushton tërë vëmendjen një drejtimi tjeter, atëherë në këtë drejtim të fundit, në rastin tënd konkret në luftën kundër obskurantizmit dhe klerikalizmit që përmende ti, ai duhet të dallohet në mënyrë të veçantë. Mirëpo unë nuk kam parë tek ti një qëndrim të veçantë kundër fesë. Asnjë anëtar partie dhe asnjeri tjeter në vendin tonë nuk ka mbetur pa folur kundër fesë dhe institucioneve fetare. Pastaj në personin tënd, aktualisht ne nuk e shikojmë shkarjen në gabime si pasojë të pikëpamjeve të tua antiklerikale. Të jesh ateist dhe të mbash qëndrim liberal, kjo nuk shkon, shpjegimi yt paraqet një kontradiktë të madhe.

FADIL PAÇRAMI: Pikëpamje të tilla antiklerikale i kam pasur që kur isha në Ministrinë e Arsimit e të Kulturës, bile edhe atje tekstet i vendosa mbi këtë bazë.

SHOKU ENVER HOXHA: Më fal që të pres fjalën, por këtu duhet të flasësh si duhet. Nuk i vendose ti tekstet shkollore, ato nuk janë veprat e tua, por të shumë autorëve, që kanë derdhur djersë mbi to.

Ti nuk e ke marrë mundimin ndonjëherë që të vish tek unë për t'u konsultuar për luftën kundër klerikalizmit. Pastaj, veprinëtarinë tënde, siç kam dëgjuar, e ke përdorur si mjet për t'u hedhur kundër disa shkrimitarëve si, bie fjala, Lazar Siliqit, i cili nuk është klerikal.

Më kanë raportuar që ti ke thënë: — «Unë do ta luftoj deri në fund Llazarin, se ai është klerikal». Këto njoftime që më kanë ardhur janë të sakta. Më duket si zor që ti të kesh arritur me të vërtetë në konkluzionin se lufta kundër klerikalizmit dhe konservatorizmit të paska shtyrë të biesh në liberalizëm!

Ti e di fare mirë se ke bërë një luftë në stil të gjerë kundër një morie kuadrosh për motive personale. Kjo ka dalë e vërtetuar në të gjitha organizatat-bazë të Partisë.

Në kuadrin e luftës kundër klerikalizmit i paske bërë ti këto veprime, që janë në kundërshtim me detyrën tënde si sekretar i komitetit të Partisë? Këto veprime kanë rëndësi për gjithë Partinë, por dhe për ty personalisht se je komunist.

FADIL PAÇRAMI: Unë them se vazhdimisht kam qëndruar në pozitat e luftës kundër obskurantizmit.

SHOKU ENVER HOXHA: Atëherë çfarë kërkon ti nga unë?

FADIL PAÇRAMI: Unë erdha t'jua shpjegoj këto gjëra, se ndiej nevojën për të shprehur ato që kam, si dhe për të marrë ndonjë këshillë nga ana juaj.

SHOKU ENVER HOXHA: Dakord. Këshilla ime e parë është që gabimet e tua të ndreqen absolutisht nga ana jote. Partia kërkon nga ti që të thellohesh shumë në gabimet që ke bërë. Kjo mënyrë arsyetimi, me këtë përbajtje të bisedës që bëre këtu, sipas mendimit tim, nuk të ndihmon për t'u thelluar në shkaqet e gabimeve të tua. Forma dhe sidomos përbajtja e këtyre fjalëve që dëgjuam, të pengojnë seriozisht për të shikuar fundin e vërtetë të gabimeve.

Unë personalisht, si dhe të tërë shokët, mendoj që këto çështje duhet të shtrohen medoemos në Plenumin e Komitetit Qendror të Partisë. Unë do të dëshiroja që analiza e këtyre të metave, gabimeve e shtrembërimeve t'i shërbejë, para së gjithash, spastrimit të ndërgjegjes. Kjo punë e domosdoshme do të bëhet me sukses jo duke gjetur «arsye» për të fshehur të metat dhe gabimet, ose për t'i zvogëluar ato, po përkundrazi, duke zbuluar burimet dhe shkaqet e vërteta të shfaqjeve të tyre. Unë kujtoj se nuk është mirë që pikëpamjet e tua të dëmshme të kalohen lehtë, ashtu si i paraqet ti këtu. Duke vënë në dukje punën që ke bërë, në një kohë kur kritikohesh për gabime në punën e Partisë, duket qartë prirja për mbrojtje me argumente pa vend dhe për zvogëlim të gabimeve. Qëllon që një njeri të ketë një të kluar të mirë, por në një moment të caktuar me veprimet që bën, gabon vetë, çakërdis edhe shokët. Nuk përjashtohet që në punë e sipër shokët edhe mund të gabojnë, por në qoftë se dëshirojnë të ndreqen, ata duhet të theillohen në gabimet që t'i ndihmojë Partia, t'u japë dorën, kurse mënyra me të cilën e paraqit çështjen ti, nuk të jep mundësi të theillohesh në gabinet që ke kryer.

Sic thanë të tërë shokët në plenumin e Komitetit të Partisë të Rrethit të Tiranës dhe në organizatat-bazë të Partisë, është e pamohueshme që ti ke bërë një politikë personale, sidomos në lidhje me kuadrot e kulturës.

Po të arsyetosh në mënyrë të përgjithshme dhe pa i analizuar problemet konkretisht, nuk mund të gjesh forca për ta nxjerrë veten nga fajet e rënda. Këto mendime që ke, nuk të lejojnë të shikosh rrezikshmërinë e qëndrimit që mban dhe të devijimit nga rruga e Partisë.

Ti duhet t'i kuptosh mirë këto çështje, se nuk je kuadër i ri. Pse nuk i ke zbatuar rregullat, vendimet, disiplinën dhe politikën e Partisë pér kuadrin? Ti i njeh të gjitha këto rregulla të vendosura prej kohësh, por i ke shkelur pér të përkrahur elementë jo të shëndoshë. Muñd të mbrohet një njeri që gabon pér herë të parë, që ka një biografi të mirë, që është gjer në fund besnik i atdheut dhe i Partisë, por jo të përkrahet cilido edhe kur ai nuk e meriton përkrahjen. Nuk është aspak në fryshtë e Partisë sonë qëndrimi yt, që merr nëpër këmbë atë, i cili nuk vepron sipas dëshirës sate. Në qoftë se ti i shikon thellë dhe me sy kritik këto qëndrime, atëherë duhet t'i dënosh. Në rast se ti nuk mban qëndrim ndaj këtyre gabimeve, atëherë do të shtrëngohemi ne të marrim masa pér të përmirësuar punën. Le të flasim hapur, ti, Fadil, ke vënë në institucione të ndryshme kulturore të kryeqytetit një sërë kuadrosh, të cilët mbajnë qëndrime përbuzëse dhe mospërsillëse ndaj rregullave e disiplinës së Partisë, ndaj forumeve dhe autoritetit të saj. Unë flas mbi bazën e të dhënave të nxjerra nga ato që ke thënë vetë, ti i ke marrë në mbrojtje këta njerëz. Nuk je ti që u ke thënë shokëve të Ministrisë së Arsimit dhe të Kulturës: «Çfarë doni ju që shkoni pér kontroll në kino-studio osc në Teatrin e Operës dhe të Baletit? Përse përziheni ju në këto çështje?». Ti the se këto nuk janë vijë në punën tënde, por pikë-pika bëhet vija. Pikërisht këto qëndrime që mban ti, paraqesin rrezikshmëri. Në qoftë se ti i rrumbullakos kështu çështjet, në qoftë se nuk i shpjegon drejt e sinqerisht ato, por flet me ton akademik edhe para meje, që Partia më ka ngarkuar me detyrën e Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror të saj,

sigurisht e ke të vështirë të korrigjohesh. Ti e heq veten teoricien dhe mendon se mund të flasësh teorikisht, po mos i rrumbullakos gjérat.

Më kanë thënë, gjithashtu, se ti në një mbledhje paske hedhur idera «të mëdha», në të cilat bie në sy një lëmsh i madh ideologjik. Mua nuk më ke thënë asgjë që të kisha mundësi të gjykoja nëse pikëpamjet dhë mendimet e tua ishin të drejta apo të shtrembra.

Nga sa po shoh, ti paske ardhur sot tek unë për të më mbushur mendjen se gjoja liberalizmi yt qenka i rastit. Këtë gjykim tëndin nuk mund ta pranojmë. As liberalizmi, as konservatorizmi nuk lindin bashkë me njëriun, por si njëri dhe tjetri formohen dalngadalë, në fillim si koncepte, si mënyra të menduari, pastaj shfaqen në veprimtarinë praktike.

Gjer tani akoma nuk më ke thënë pikëpamjen tënde për të gjitha gabimet që ke bërë. Unë nuk kërkoj t'i thuash tash, por mendoj që ti duhet të bësh autokritikë me shkrim, ku të tregosh se cilat janë konceptet e tua liberale dhe cilët faktorë kanë ndikuar në formimin e tyre.

Kur thua se në veprat e tua nuk paska as gabime liberale, as konservatore, unë nuk e marr vesh se ku qëndrojnë atëherë këto gabime në këtë fushë. Ndryshe nga sa thua ti, unë kam mendimin se gabimet që ke bërë nuk janë vetëm incidente të shkëputura në praktikën e punës sate, përkundrazi ato kanë një vazhdimësi.

Ty të ka thirrur me dhjetëra herë shoku Ramiz Alia, që mendon jashtëzakonisht drejt për këto çështje. Edhe shoku Hysni të ka udhëzuar shumë mirë, kurse ti, duke i lënë mënjanë udhëzimet e shokëve të tjera, përmend

vetëm kritikën që të kam bërë unë. Me sa duket, të gjitha kritikat që të kanë bërë ty shokët e tjerë, si shoku Ramiz, shoku Hysni e shoku Manush, të kanë hyrë nga njëri vesh e të kanë dalë nga tjetri. Ti mund ta mohosh, por ka shumë të tjerë që provojnë se ti ke thënë: «U mbushëm me burokratë» dhe, kur të është thënë se do të vijnë aty shokë nga Komiteti Qendror, ti përsëri ke thënë: — «Edhe ata janë burokratë!».

Këto çështje duhej të të shtroheshin në mbledhje të organizatës-bazë të Partisë, por meqë nuk t'u shtruan atje, do të diskutohen në mbledhjen e Plenomit të Komitetit Qendror të Partisë.

Ti mund ta mohosh që ke thënë: ..Përse të shkoj në Komitetin Qendror? Po të jetë nevoja, le të më thérresë vetë shoku Hysni Kapo, se edhe unë kam personalitetin tim!». Por mos harro se personaliteti yt, nuk është në një nivel me personalitetin e shokut Hysni ose të shokut Ramiz. Kur komunistët shkojnë në aparatin e Komitetit Qendror të Partisë, qoftë kur i thérresin, apo me iniciativën e tyre, ata paraqiten si shokë, pa menduar se ai person që do t'i presë është më shumë apo më pak personalitet. Këtë çështje nuk e shtroj të shkëputur nga shfaqjet e tjera që janë dukur e duken tek ti.

Por le të kthehem përsëri te çështja kryesore, te pikëpamjet e tua liberale, që nuk kufizohen vetëm në mbrojtjen e elementeve liberalë të institucioneve të ndryshme, por pjesë-pjesë, që përbëjnë një të tërë, kalojnë edhe në sfera të tjera. Ti ke arritur të thuash para gjithë kolektivit: «Unë nuk kam përgjegjësi për festivalin!». Ç'është ky qëndrim i çuditshëm dhe i palejueshëm që mban ti?

FADIL PAÇRAMI: Unë kam thënë që nuk kam përgjegjësi të drejtpërdrejtë.

SHOKU ENVER HOXA: Jo, ke deklaruar pikërisht se nuk ke përgjegjësi për organizimin e dobët të festivalit të köngës në radiotelevizion, duke arsyetuar se radiotelevizioni varet nga sektori i propagandës të Komitetit Qendror të Partisë. Me këto shprehje ti ke atakuar Komitetin Qendror të Partisë, prandaj Partia nuk mund të të lejojë të veprosh në këtë mënyrë.

Partia do të arrijë në ato konkluzione që na shpien faktet, na shpie e vërteta. Në qoftë se ti nuk e pranon të vërtetën, duke u nisur nga parimi që të mohosh gjithçka, ky nuk mund të jetë një qëndrim komunist. Në qoftë se flet me gjuhën e fakteve dhe të provave, ky është qëndrim i ndershëm prej komunisti.

Ti po bisedon këtu sikur ne jemi «tabula rasa» përsaq i përket njoftes së pikëpamjeve dhe të veprimtarisë tënde liberale dhe oportuniste. Udhëheqja nuk mund të jetë dakord me ty kur e paraqet çështjen sikur vetëm ti paske të drejtë. Kurse të tjerët nuk tregokan të vërtetën.

Ti ke ndërhyrë për gjithçka, duke mënjanuar të tjerët, të cilëve u takonte të merreshin me disa probleme. Ti ke arritur gjer atje sa të syesh aktorët e Teatrit Popullor, duke thënë se ata duhen larguar që andej se «interpretojnë si në teatrin e Bogdanit!». Aktorët e teatrit janë ankuar për këtë syerje që u ke bërë.

FADIL PAÇRAMI: Unë këtë e kam pranuar se kam gabuar.

SHOKU ENVER HOXA: Të pranosh në përgjithësi se ke gabuar, kjo është njëra anë e çështjes, por

të zbulosh shkaqet e gabimeve që ke bërë, kjo ka shumë rëndësi për ty si komunist. Të thellohesh përsë ke għuar nē marrēdhōniet e tua jo me një e dy, por me shumë persona. Përsë kanë ndodhur këto gabime nē marrēdhōniet e tua me tē gjithë? A mund tē mos mendojë Partia se këto qëndrime shpreħin jo një rast, por një vijë tē ndertuar nga ti nē punën me njerëzit?

Shoku Jordan Pani¹ tē tha nē mbledhjen e plenumit se, kur ai kishte thirrur Koço Vasilin² për t'i bërë disa vërejtje lidhur me punën e tij nē Teatrin e Operës dhe tē Baletit, ti, me qëllim që ta mbroje kishe shkuar te shoku Jordan si shoqérues i Koços! Tē gjitha këto, që po tē përmend unë, dalin nga procesverbalet e mbledhjeve.

Nuk shtrohet çeshtja për tē ngarkuar ty sajet që ka bërë Koço Vasili, se ai i mban vetë përgjegjësitë e tij, por ne po tē vëmë nē dukje ato fakte që vërtetojnë se ti ke qenë liberal. Ne nuk po dëgjojmë nga ti se nē ç'drejtime e kupton liberalizmin tēnd dhe si e gjykon ideologjikisht këtë çeshtje. Unë jam i detyruar tē tē përmend disa shfaqje nē veprimet e tua konkrete që tē tē ndihmoj tē kuptosh se ku je treguar liberal.

FADIL PAÇRAMI: Jam treguar liberal nē konceptet për krijimtarinë artistike dhe nē poezi ku vihen re hermetizëm dhe paqartësi ideore. Ka ndodhur që krijuosit tanë kanë hedhur mendime tē errëta dhe tē pa-përcaktuara, kurse unë nuk kam reaguar, duke menċluar se ata ishin tē rinj dhe kishin kohë tē piqeshin

1. Në atë kohë sekretar i parë i komitetit tē Partisë tē ragonit nr. 1 tē Tiranës.

2. Në atë kohë drejtor i Teatrit tē Operës dhe Baletit, që u pörfashtua nga Partia e u dënuva.

nga ana ideoartistike. Për këto të meta u kam thënë edhe shokëve, por as ata nuk kanë reaguar plotësisht.

SHOKU ENVER HOXHA: Mos i hidh ujë verës! Mos kërko të mbytësh të tjerët, se, edhe sikur të duash ti, nuk të lë Partia. Ka njerëz që, për të larë veten, mundohen të mbytin të tjerët, por edhe nga kjo anë Partia jonë i ka sytë hapur. Prandaj ti, fol më parë për vcten tënde.

FADIL PAÇRAMI: Unë, në veprat që kam krijuar, nuk prirem nga koncepte liberale.

SHOKU ENVER HOXHA: Të këshilloj të jesh modest. Shpeshherë, gjatë bisedës na i theksove ato pesë dramat që ke bërë, duke përsëritur shprehjen: «Veprat e mia», por nuk na the asnje fjalë nëse kjo veprimitaria jote ka krijuar klane dhe vështirësi në Teatrin Popullor. Pse nuk flet për këto grupe që janë krijuar, apo edhe për këto janë gojët e liga që flasin kundër teje? Nuk të kanë pëlqyer edhe veprat e shkrimtarëve të tjerë?

FADIL PAÇRAMI: Edhe krijuesit e tjerë kanë pasur rreth vetes njerëzit e tyre simpatizues.

SHOKU ENVER HOXHA: Pse, duke theksuar rëndësinë dhe seriozitetin e unitetit, ke deklaruar në mbledhje që nuk është e drejtë të thuhet se janë krijuar klane, kur tanë vetë po thua që edhe shkrimtarët e tjerë kanë pasur rreth vtes simpatizuesit e tyre. Këto grupime s'janë gjë tjetër, veçse klanc, sepse si mund të shpjegohet që dramat e tua vihen në skenë më përparrë se ato të shkrimtarëve të tjerë?

Unë po bëj përpjekje që ti t'i kapërcesh këto qëndrime, prandaj të thashë që në fillim se baza e veprimeve të tua shikohet në qëndrimin konkret. Ti nuk i

ke analizuar me fryshtësi shëndoshë gabimet që ke bërë, sepse i ke vlerësuar si jo të shëndosha kritikat që të janë adresuar. Në një mbledhje shumë serioze ku mori pjesë shoku Ramiz, ai të dha mundësinë për të bërë autokritikë, kurse ti ke folur atje në mënyrë lakinike për unitetin dhe nuk i ke shpjeguar gabimet e kryera gjatë vëprimeve të tua konkrete.

SHOKU HYSNI KAPO: Shoku Ramiz Alia foli në mbledhjen e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të Artistëve, në muajin korrik¹, duke bërë atë punë që duhet ta kishe bërë ti. Po ti, që udhëhiqje punën kulturore dhe artistike në Tiranë çfarë bëre?

FADIL PAÇRAMI: Unë kam menduar ta ndihmoj deri në fund Lidhjen e Shkrimtarëve dhe të Artistëve, megjithëse kjo nuk është puna ime.

SHOKU ENVER HOXHA: Përse nuk është puna jote?

FADIL PAÇRAMI: Sepse nuk e drejtoj unë punën e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të Artistëve.

SHOKU ENVER HOXHA: Kush të ka penguar ta drejtosh?

SHOKU HYSNI KAPO: Ti Fadil, si sekretar i Komitetit të Partisë të Rrethit të Tiranës, mendoj se duhet të ndikoje që organizata-bazë e Partisë të luante një rol më të madh në Lidhjen e Shkrimtarëve dhe të Artistëve.

SHOKU ENVER HOXHA: Kjo është një nga çështjet kryesore. Organizata e Partisë atje ka një rol të

1. Më 15 korrik 1972 u mblohdh plenumi i Komitetit Drejtues të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të Artistëve të Shqipërisë. Në këtë plenum mori pjesë edhe shoku Ramiz Alia.

madh. Ju keni përgjegjësi për punën e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të Artistëve, të radiotelevizionit etj., sepse organizatat-bazë të Partisë, që drejtohen nga Komiteti i Partisë, e kanë për detyrë të udhëheqin tërë aktivitetin e këtyre institucioneve.

Mirëpo Todi Lubonja e ka eliminuar fare punën e organizatës-bazë të Partisë në radiotelevizion, kështu ka bërë edhe Koço Vasili në Teatrin e Operës dhe të Baletit. Si thoni ju nuk duhet t'i shikojë Komiteti i Partisë këto shfaqje të rrezikshme? Vetë komunistët e këtyre organizatave janë ngritur e kanë thënë: Asnjëri nuk na ka pyetur ne për mbarëvajtjen e punës!

Po Todi Lubonja përsë e solli Mihallaq Luarasin nga Korça në Tiranë dhe e vuri në punë në radiotelevizion pa ditur fare organizata-bazë e Partisë?

E di që ju keni përgjegjësi për shokun Klimi Misa¹, i cili u trajtua shumë keq dhe, për këtë shkak, kaloi një krizë të rëndë në zemër? Me çfarë të drejte u rrëzua vendimi i arsyeshën i organizatës-bazë për shokun Klimi?

SHOKU HYSNI KAPO: Çështja e shokut Klimi u shtrua në muajin prill të vitit të kaluar dhe u vendos që të transferohet në ndërmarrjen e botimit të librit politik². Ky veprim ishte jashtë rregullave të Partisë. Kur u shtrua çështja në organizatën-bazë, komunistët bënë autokritikë për gabimin e bërë. Edhe sekretari i organizatës, i cili veproi siç i kishte thënë Todi Lubonja, bëri autokritikë dhe organizata vendosi të mos e aprovoonte vendimin e transferimit të tij.

1. Në atë kohë direktor i televizionit.

2. Sot shëpia bëluese «3 Nëntori».

Fadili, siç e ka zakon, nuk u slet komunistëve si shokë, por me arrogancë, gjë për të cilën është kritikuar. Ai u bën pyetje të tillë komunistëve të vjetër: Kush je ti?! — Unë jam komunist, — i është përgjigjur njëri, dhe e ka pyetur Fadilin: — Po ti kush je? Të tillë qëndrime mban Fadili dhe, kur i vihen në dukje, nuk pranon asgjë.

SHOKU ENVER HOXHA: Duke mos pranuar gabimet, tregon se je mendjemadh. Arroganca është mendjemadhësi. Mendjemadhësia është një ves i rrezikshëm me pasoja të rënda, sidomos për punën e komunistëve dhe të kuadrove.

SHOKU HYSNI KAPO: Unë, shoku Enver, mendoja se Fadili do të fliste ndryshe para jush. Kur erdhi tek unë, foli 15 minuta, kishte po këtë defter dhe po këto faqe që lexon këtu, lexonte edhe atje. Këto fjalë që tha këtu, m'i tha edhe mua në takimin që pata me të, prandaj e këshillova, duke i thënë: „Përpiku ta kuptosh drejt fjalën e shokut Enver. Në plenum të thellohesh e të bësh autokritikë», por Fadili edhe në plenumin e Komitetit të Partisë të Rrethit të Tiranës, tha të njëjtat gjëra. Atje i bënë 15 a 20 pyetje dhe mund të them se, plenumi nuk u kënaq nga përgjigjet e tij. Nga diskutimet që u bënë, Fadili dëgjoi shumë gjëra për liberalizmin e tij, për politikën e gabuar me kuadrin, për zbatimin jo në frymën e duhur të normave të Partisë, për arrogancën e tij etj. Ky më në fund, tha: „Do t'i kem parasysh këto kritika që m'u bënë dhe do të thellohem në to». Pastaj u ngrita e sola edhe unë.

SHOKU ENVER HOXHA: I pranove këto kritika në plenum?

FADIL PAÇRAMI: Unë thashë se këto kritika do të më ndihmojnë, se midis tyre ka gjëra që do t'i pranoj, po ka edhe të tjera që nuk do t'i pranoj. Këtu te ju erdha për të biseduar lidhur me kritikën që më bëtë në mbledhjen e komunistëve të aparatit të Komitetit Qendror të Partisë.

SHOKU ENVER HOXHA: Ti mund të kesh ardhur për kritikën që të bëra unë, por duhet ta dish se ajo kritikë është e mbështetur në fakte të nxjerra nga veprimitaria jote, ndryshe unë nuk kishte arsyё përsë të të kritikoja. Kritika ime në adresën tënde mund të jetë e fortë, po ajo është e bazuar në shumë gabime e të meta që të kanë dalë në organizatat-bazë të Partisë, që të janë drejtuar nga shumë shokë. Më pas mund të dalin edhe gabime e të meta të tjera, por nga të gjithë ata që do të diskutojnë, do të ketë prej tyre që nuk do të bëjnë fjalë vetëm për ty, pse do të flasin edhe për veten e tyre. Për këto arsyë ne vendosëm të mos e kufizojmë diskutimin vetëm në fushën e letërsisë dhe të arteve, por ta shtrijmë atë në të gjitha fushat e aktivitetit të Partisë.

Këto probleme dhe shfaqje janë shumë serioze, prandaj në qoftë se nuk shikohen me kujdesin më të madh, atëherë gabimi do të bëhet më i rëndë. Nga qëndrimi që mban secili në këtë situatë shikohet nëse është apo nuk është me Partinë. Liberalizmi ka depërtuar në disa drejtime dhe është bërë jashtëzakonisht i rrëzikshëm, prandaj shfaqjet e kësaj natyre duhet t'i zhdukim. Nga shfaqjet e liberalizmit, ç'është e vërteta u rëndua një çikë Partia, por zemra e saj është e gjerë dhe puna që bën ajo ka synime të gjithanshme. Në qoftë se

në këtë luftë do të mbahen pozita të tilla si: «Thashë kështu e jo ashtu», atëherë vendi ynë dhe socializmi do të jenë në situata të vështira. Ndaj bartësve në të theksuar të këtyre shfaqjeve Partia do të marrë edhe masa si, bie sjala, Todi Lubonja mund të dërgohet me ndonjë punë në një rreth tjeter, por çështja është që këto të meta të zhduken në masë nga ndërgjegjja e atyre njerëzve që i kanë. Me qëndrime të padrejta, që mohojnë gjendjen e vërtetë të gjërave, nuk ndreqen dobësitë.

Unë dëshiroj që ty të të ndreqim në rrugë partie dhe kisha besim se do të thelloheshe më mirë në analizën e punës tënde, por ti akoma nuk e ka bërë këtë, megjithëkëtë, përsëri kam shpresë tek ti duke të gjykuar si një komunist të vjetër. Gabimet që ke bërë duhet t'i shikosh, t'i analizosh mirë dhe t'i shpjegosh me pjekuri, nje rrënje e jo në mënyrë të përgjithshme e të sipërfaqshme, duke u shkuar gjërave anash dhe duke fshehur këmbët. Po të analizohen përciptas gabimet e tua, nuk do të mbetesh i kënaqur as ti, as Partia. Ti, nga tërë ato që të thuhen, pranon vetëm dy-tri raste, po nuk thellohesh në mënyrë serioze, përsë i bëre qostë edhe ato që vetë i pranon. Ky qëndrim meriton të shikohet me kujdes.

Për ty, Fadil, ka pasur ankime, të cilat shokut Manush [Myftiu]¹ ia ka thënë shoku Hysni, prandaj, kur të tha Manushi, ti duhet të vije e të pyesje: Çfarë ankesash ka ndaj meje? Këtë duhej ta kishe bërë, ashtu siç kërkove për të ardhur tek unë. Menjëherë sa të tha

1. Në atë kohë ishte edhe sekretar i parë i Komitetit të Partisë të Tiranës.

shoku Manush, të vije e të bisedoje këtu, sepse kjo bisetë do të qe një ndihmë e mirë për ty. Ty të pengon gjendja shpirtërore për t'i parë të vërtetat siç janë. Ti ke gjykuar pak a shumë kështu: Me kritikën që më bëhet, nuk jam dakord, unë jam i pastër, prandaj s'ka arsyesh të vete të pyes se çfarë vërejtjesh kanë shokët për punën time. Po të kenë gjë me mua, atëherë le të më thérresin ata.

Që të takohet komunisti me ne, kjo është shumë e mirë, bile kur ai e gjykon me vend, kërkon vetë të piqet me shokët e udhëheqjes së Partisë, lëre pastaj, kur i thonë se të kërkon Enveri apo ndonjë shok tjetër, që ai vjen menjëherë. Ti, edhe sikur të ishe me të vërtetë i bindur se nuk kishe bërë gabime, prapëseprapë nuk duhet të udhëhiqeshe nga ai koncept i gabuar, sipas të cilit «në qoftë se të tjerët kanë qarje për mua, po të duan le të më thérresin». Ky qëndrim nuk është i drejtë. Gabimet që ke bërë nuk janë një, dy apo katër, por më shumë, prandaj i analizo me kujdes në ndërgjegjen tënde.

Kritika që të bëra unë në mbledhjen e komunistëve të aparatit të Komitetit Qendror nuk mund të thuash se ishte e papritur, mbasi më parë ke pasur sinjalizime dhe këshillime, por i ke nënvlerësuar, sepse në të gjitha bisedat që ke bërë me shokun Ramiz e me shokun Hysni, sipas mendimit tim, ke mbajtur qëndrim prej mendjëmadhi. Ke pasur ti shfaqje të mendjemadhësisë në marrëdhëniet e punës me shokun Manush?

FADIL PAÇRAMI: Unë mendoj se jo.

SHOKU ENVER HOXHA: Kurse unë mendoj se po.

Shoku Manush është korrekt dhe i afrueshëm me

njerëzit, por mirësjelljen e tij ti e ke kuptuar sikur të gjitha kompetencat e Komitetit të Partisë të Tiranës, ai t'i kishte kaluar ty për zbatim. Ti ke abuzuar në korrektesën e tij, duke krijuar mendimin e gabuar sikur vetëm ti ishe kompetent për ato punë, prandaj edhe ke kujtuar se ato që bëje ti ishin të drejta e të padiskutueshme!

Mos harro se shumë punë i ke bërë pa Manushin. Kur ai të jepet pesë porosi, ti plotësoje vetëm njëren prej tyre. Kur të thoshte Manushi çfarë bën kështu ky apo ai, ti nuk mbaje qëndrimin e duhur ndaj tyre, por ishc i predispozuar t'i përkrahje dhe t'i mbroje ata. Këta elementë, duke i pasur krahët të ngrohtë nga ana jote, i përsëritnin dhe i shtonin vazhdimisht gabimet.

Shoku Ramiz të ka udhëzuar kurdoherë drejt për shumë probleme, edhe për unitetin, por ti kishe hedhur farën e disunitetit e të përgarjes në rrethet letrare. Mendime të ndryshme mund të ketë, se pa mendime dhe kritika nuk mund të ecet. Shoku Ramiz të ka porositur që të luftohen mendimet e gabuara, të lihen mënjanë subjektivizmat e të tjera.

Partia në rreth dhe organizatat-bazë të saj duhet të merren vazhdimisht me zbatimin e porosive dhe de-tyrave që u takojnë.

SHOKU HYSNI KAPO: Ti u kritikove në plenumin e Komitetit të Partisë të Rrethit se nuk e ke ndjejkur rolin e organizatave-bazë të Partisë dhe nuk je vënë në krye të kësaj çështjeje. Unë nuk e di se me çfarë përshtypjesh dole ti nga plenumi, por mendoj se punimet e tij janë zhvilluar me të vërtetë në frymë partie, aty ka pasur kritika të rrepta, por ato kanë qenë të drejta dhe shoqërore, pa synime të këqija ambicioze. Nuk

është e drejtë të thuash: «Nuk kam çfarë të bëj unë për Lidhjen e Shkrimtarëve dhe të Artistëve, pasi nuk jam drejtues i saj», sepse ti e di që, si kudo, edhe atje drejton organizata-bazë e Partisë.

SHOKU ENVER HOXHA: Pse ndodhën këto gabime në organizatën-bazë të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të Artistëve pikërisht në të njëjtën kohë që vërtetohen edhe lëshimet e tua edhe të Ibrahim Uruçit¹? Kemi të drejtë ta bëjmë këtë pyetje? Duhet të njohim përsë u bënë këto gabime, ndryshe, siç thashë, nuk kemi si t'i korrigjojmë.

Skema që ke përgatitur ti për analizën e gabimeve është shumë e thatë. Ti nuk pranon gabimet e rëndë dhe nuk përcakton shkaqet e tyre. Mua, personalisht, nuk më jepet asgjë me këtë skemë që paraqet ti, prandaj, kur të diskutohen këto probleme në Plenumin e Komitetit Qendror të Partisë, të këshilloj t'u bësh një analizë të thellë e të drejtë. Ti ke punuar vetë në aparatin e Komitetit Qendror të Partisë dhe duhet t'i kuptosh mirë këto që po të këshillojmë. Me qëndrimin tënd autokritik shpresojmë që në Plenum ti do të ndihmosh veten dhe do të bindësh shokët se i ke kuptuar gabimet, ndryshe ata do të të bëjnë pyetje. Po përsë të detyrohen ata të të pyesin kur do të jetë më mirë që ti t'i thuash të tëra vetë.

Me kaq takimin e mbyllim.

Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim, që gjenden në AQP

1. Në atë kohë kryeredaktor i gazetës «Drita».

TE HARTOJMË NJË PLAN REAL, TE NGJESHUR SIÇ E KERKOJNË SITUATAT

*Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

11 prill 1973

Kisha menduar disa vërejtje, por, duke dëgjuar diskutimet që u bënë këtu, shoh se ato përputhen me mendimet e shokëve.

Eshtë e vërtetë që në Kongres kemi shtruar çështjen e prognozës (dhe duhet të punojmë për të), por në paraprojektin që më eshtë dërguar shoh se po i vihet më shumë rëndësi prognozës sesa planit të gjashtë pesëvjeçar. Mendimi im eshtë se duhet t'i vëmë më shumë rëndësi planit pesëvjeçar të ardhshëm dhe pastaj prognozës, për arsy se plani pesëvjeçar do të jetë mbështetja e prognozës, një pjesë e saj dhe, gjatë gjithë këtij procesi pune, do të na hapen perspektiva për studimet

1. Në këtë mbledhje u morën në shqyrtim orientimet themelore për hartimin e prognozës së zhvillimit të ekonomisë e të kulturës së RPSH deri në vitin 1990 si dhe të projektplanit perspektiv të pesëvjeçarit të gjashtë 1976-1980.

që nevojiten; kështu që do të kemi të dhëna të tjera për të plotësuar prognozën, për të cilën duhet të fillojmë nga puna.

Duke studiuar orientimet që na u dërguan, edhe unë kam mendimin se ka ardhur koha të fillohen studimet dhe punimet, në qendër dhe në bazë për projekt-planin e pesëvjeçarit të gjashtë. Kjo duhet të jetë detyra kryesore për direktivat e viteve 1976 deri 1980, të cilat përfaqësojnë orientimet themelore në përputhje me detyrën që na ka vënë Kongresi i 6-të i Partisë. Sipas kësaj detyre orientuese kërkohet që, krahas planifikimit për pesëvjeçarin të kalohet edhe në hartimin e planeve prognozë me asat të gjatë. Këtë orientim të Kongresit nuk duhet ta lëmë pas dore, por të bëjmë përpjekje ta zbatojmë.

Po si do ta zbatojmë ne detyrën? Si do ta fillojmë studimin? Me çfarë metodash? Çështje të tillë duhet t'i diskutojmë e të vendosim para se të fillojmë punën. Në këto drejtime të kemi parasysh situatën dhe eksperiencën, të mos harrojmë asnjërrën prej tyre, sepse ato janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën. Të mos tertiqemi nga metodat që kemi përdorur gjer tani, të cilat përgjithësisht janë vërtet të drejta, por situatat e krijuara dhe eksperiencia e grumbulluar na detyrojnë t'i rishikojmë vazhdimisht. Metodat e punës që kemi përdorur, dëshirat dhe mundësitë që ekzistojnë realisht, t'i kemi parasysh që t'i harmonizojmë, t'i kanalizojmë dhe t'i lidhim si duhet me orientimet dhe koniunkturat aktuale dhe të ardhshme. Këto kërkesa shtrojnë nevojën që të mendojmë jo vetëm ekonomikisht, por, në radhë të parë, politikisht, duke parë me kujdes nëse këto plane,

këto metoda dhe këto dëshira tonat janë të realizueshme.

Në një pjesë të planeve tona, sidomos për zhvillimin e industrisë, për nxjerrjen dhe përpunimin e mineraleve, ne llogaritim edhe ndihmën e Kinës, por le t'i bëjmë pyetjen vetes: Do ta kemi këtë burim sipas dëshirave dhe nevojave tona, apo nuk do ta kemi? Mund ta kemi, por edhe mund të mos e kemi, qoftë kjo për arsy politike, qoftë edhe për arsyek ekonomike, siç janë vështirësitë që mund të ketë vetë Kina e të tjera, e të tjera. Shohim se Kina po bën përpjekje për zhvillimin e saj dhe paraqet vështirësi në realizimin e kredive tona për këtë pesëvjeçar. Së këtejmi del përfundimi se në përcaktimin e detyrave duhet të nisemi jo vetëm nga dëshirat, por edhe nga mundësitë reale që ka vendi ynë. Realizimet tona kërkojnë një kredi të madhe nga Kina. Duke menduar se kredia e Kinës edhe mund të mos na vijë, atëherë duhet të jemi më të rezervuar në planifikim, se kjo është një situatë objektive, që nuk na lejohet ta nënverhësojmë.

Duhet të kemi kujdes që të ruhemti nga planifikimi që parashikon kuota të paarritshme. Në praktikë është vërtetuar se dëshirat dhe orekset e njerëzve janë hapur shumë në këtë drejtim, duke bërë kërkesa të fryra e të jashtëzakonshme. Këto kërkesa të papërmbajtura janë jo vetëm për sa i përket pesëvjeçarit në tërësi, por edhe për sa u përket asateve vjetore të tij, prandaj, pa e prishur metodologjinë, të përsitojmë nga eksperiencia që të mos i caktojmë kuotat pa kritere. Eksperiencia na ka treguar se në caktimin e kuotave për investime, për ndërtime e disa drejtime të tjera, që kërkojnë shpenzime joprodhuese, kërkesat janë mjaft të tepruara, kurse

në caktimin e kuotave për prodhimin duket prirja e uljes së tyre. Në rastet e kërkesave të fryra ne i kemi shkurtuar ato dhe kemi bërë mirë, por kemi bërë keq që kemi lejuar të krijojen disa deziluzione dhe pikëpamje të shtrembra te kuadrot tanë të ekonomisë, të Partisë dhe të sektorëve që merren me politikën dhe ideologjinë, sepse «iniciativat» e tyre nuk janë harmonizuar dhe përputhur kurdoherë me situatën reale të vendit. Iniciativa duhet të ketë, por ato të janë brenda kushteve konkrete të vendit, sipas rrethanave politike, duke i shtrirë këmbët aq sa e ka jorganin Shqipëria. Ka akoma njerëz, bile dhe kuadro drejtues që nuk janë mësuar të rrojnë plotësisht me situatat, jo se Partia nuk ua ka thënë atyre këtë gjë dita me ditë, se ç'është e vërteta për këtë është folur shumë, por sepse nuk është tërhequr vëmendja në masën e duhur në zbatimin e porosive për parashikimin e situatave të vështira.

Megjithëse në Byronë Politike ne marrim vendime të prera, që nuk do të lejohen shtesat e rrogave të në-punësve të administrative, gjersa të bëhet studimi që kemi caktuar, shokët ministra, si pa gjë të keq, paraqesin propozime në Ministrinë e Financave, me qëllim që disa nga ndërmarrjet, të cilat janë në vartësi të tyre, të ngrihen në kategori. Kjo do të thotë të ngrihet rroga e punonjësve të administratës. Përse i marrin ata këto vendime, shokë? I zbatojmë vendimet e Byrosë Politike a nuk i zbatojmë? Nga njëra anë marrim vendime për të mos i ngritur rrogat e punonjësve të administrative dhe, nga ana tjetër, propozohet ngritja e ndërmarrjeve në kategori! Për çfarë arsyaje u dashka të ngrihen këto ndërmarrje në kategori, apo që t'u shtohet rroga dhe

drejtuesve të saj? Ne këtu, që jemi udhëheqës, i dimë mirë vështirësitë ekonomike që ndeshen në prodhimin dhc furnizimin e artikujve bujqësorë e blegtoralë, siç janë zarzavatet, mishi, gjalpi, qumështi, orizi etj. Atëherë për sa kohë që e njohim gjendjen, të mos flasim vetëm teorikisht për ngushtimin e dallimeve thelbësore në mes fshatit dhe qytetit, por këtë çështje ta shikojmë drejt dhe praktikisht edhe në fushën e shpërndarjes së të ardhurave. Po të gjyket drejt politikisht, do të arrihet në përfundimin që shtesa e rrogave të punonjësve të administratës krijon një situatë të vështirë, prandaj këto që thuhen këtu, t'i zbatojmë.

Në qoftë se gjer tanë në metodat tonë të planifikimit kemi qenë dorëlëshuar, mendoj se ka ardhur koha ta shikojni punën një çikë më shtrënguar, jo për të prerë iniciativat e drejta, të arsyeshme, të dobishme dhc revolucionare, por për t'u prerë rrugën atyre «iniciativave» që në të vërtetë nuk i shërbejnë aspak zhvillimit të ekonomisë dhe të kulturës sonë socialiste. Të pritet «iniciativa» e atyre njerëzve që vetëm nga studimi në libra, pa e parë me sy realitetin, merren me teorizime pa vend dhc hartojnë plane «të mëdha». Disa persona, që sa kanë dalë nga veza, kur këndojnë një libër të autorëve perëndimorë, ku flitet për ekzistencën e disa gjërate, nxitojnë të paraqesin relacione, duke shprehur mendimin se kjo osc ajo gjë u bëka edhe t'ne, pa menduar se për t'u bërë edhe këtu ajo që propozohet, duhen shumë fonde për import.

Më kanë raportuar shokët, se është krijuar një situatë e tillë ku disa letrarë te ne kthejnë kokën «për t'u frymëzuar» nga shkrimtarë dhe poetë dekadentë,

kurse disa nga njerëzit e shkencës kanë kthyer syltë nga importi, duke thënë: Na jepni sonda të blejmë këtë ose atë send jashtë dhe, duke gjetur rrugën më të shkurtër, i kanë ulur përpjekjet për të krijuar me forcë e veta shumë gjëra në vend, siç bëhej më parë. Në këto kushte, është dobësuar iniciativa krijuar me ushqyer prirja, gjoja iniciativa, për «zhvillimin» dhe «modernizimin» e makinerive tona të prodhimit, e të tjera, e të tjera.

Nuk është e udhës që zgjidhja e vështirësive të gjendet vetëm me akordimin e devizës nga shteti. Kam marrë vesh që ministritë po hartojnë lista të mëdha për të dërguar sa më shumë njerëz jashtë shtetit që të specializohen për të mësuar gjer edhe se si bëhen akulloret apo si krasiten ullinjtë «në mënyrë artistike!». Por ullishtet tona kanë nevojë për shumë punë të tjera, të futesh brenda në to është për të vënë duart në kokë, se nuk u bëhet as shërbimi minimal i domosdoshëm. Në vend që të preokupohemi kaq shumë për estetikën e tyre dhe të shpenzojmë për këtë qëllim, më parë le t'i mbrojmë ullishtet, t'u bëjmë shërbimet e t'i shtojmë ato. Por vëmë re që disa shokë kanë shumë oreks për të dalë jashtë shtetit, me vend e pa vend, gjë që nuk është e drejtë. Vërtet shpenzimet për specializime jashtë shtetit, sipas marrëveshjeve ndërkombëtare i bëjnë të tjerët, por këto të drejta që kemi ne duhet t'i shfrytëzojmë në mënyrë sa më të dobishme për interesat e vendit dhe jo të disa personave.

Të më falni se u largova pak nga tema, por, me shembujt që përmenda, desha të theksoj sa të vëmendshëm duhet të jemi ndaj kërkesave që bëhen për shpen-

zime të tillë që e rëndojnë ekonominë, pa qenë nevoja dhe sa shumë kujdes duhet të kemi për t'i edukuar njërzit të jetojnë me situatat politike konkrete.

Në duhet të hartojmë një plan pesëvjeçar real, të ngjeshur ku të parashikohen sakrificat e mundshme që do të kërkojnë situatat dhe të frenohen prirjet e gabaara dhe dëshirat e tepruara. Plani ynë i ardhshëm pesëvjeçar duhet të nxitë marrjen përsipër dhe plotësimin me përpikëri e në kohë të detyrave të prodhimit, të inkurajojë krijimtarinë prodhuese për shtimin e mallrave për konsum të brendshëm dhe për eksport. Prandaj në këtë drejtim duhen dhënë orientime të drejta, të qarta, reale, konkrete, domosdoshmërinë e të cilave na e dikton eksperiencia jonë. Orientimet themelore për hartimin e projektplanit perspektiv të pesëvjeçarit të 6-të ose të prognozës për zhvillimin e ekonomisë dhe të kulturës, duhet t'i hartojmë ashtu siç thanë shokët. Kjo detyrë të përmibushet sa më mirë.

Eshtë e nevojshme të kuptohet se projektplani dhe prognoza nuk janë punë të lehta. Ato, sipas mendimit tim, kërkojnë një mobilizim shumë të madh dhe një organizim të fortë pune për studimin e çështjeve në mënyrë të përqendruar, për nxjerrjen e konkluzioneve të përpikta dhe reale, brenda mundësive shumë të përaförta, aktuale dhe të perspektivës, të bazuara në të dhëna shkencore e jo në hamendje ose sipas dëshirave pa bazë. Them të nxjerrim konkluzione të sakta për perspektivën, shokë, se edhe në këtë drejtim Byroja Politike dhe Qeveria duhet t'i studiojnë më thellë projektplanin pesëvjeçar dhe prognozën, për arsyen se situatait në botë janë të turbullta dhe se rrëthimi e bllo-

kada kundër vendit tonë, që mbron me besnikëri marksizëm-leninizmin, po bëhen edhe më të egër. Armiqtë do ta shtojnë luftën kundër nesh. Do të na godasin ushtarakisht apo jo, ky është një problem tjetër. Por, në kushtet e ndërtimit të socializmit në rrëthim, është e domosdoshme që në orientimet tona themelore për zhvillimin ekonomik të mbajmë parasysh jo vetëm të sotmen, por edhe perspektivën, sepse ka disa probleme kyç për të cilat duhet të mendojmë jo për një, dy ose katër pesëvjeçarë të ardhshëm, por për një periudhë shumë më të gjatë, për të ardhmen e Shqipërisë dhe për brezat që do të vijnë pas nesh.

Tani që po marrim më shumë naftë (dhe mund t'i quajmë të könaqshme rezultatet e arritura në këtë drejtim), nuk do të thotë që ta harxhojmë atë të tërë, sepse duhet të gjykojmë që në qoftë se nuk krijojmë rezerva, jo për 15 vjet, por edhe për brezat e ardhshëm, Shqipëria një ditë do të gjendet në vështirësi. Së këtejmi del detyra që naftën ta përdorim me ekonomi dhe për këtë duhet të ecim me llogari në të gjitha drejtimet. Naftën asnjeri nuk na e siguron, prandaj të bëjmë kujdes që depot e saj t'i kemi kurdoherë të mbushura dhe muslluqet t'i hapim me nikoqirillëk, sipas nevojave. Ne duhet të llogarilim sasinë e naftës që nevojitet për zhvillimin e ekonomisë, për ngritjen e nivelit të jetesës së masave punonjëse e të tjera, por duhet të kemi parasysh kurdoherë rezervat dhe të mos fluturojmë në ëndërrime, duke menduar se kushedi ç'ngjet më vonë. Ngjaflë një gjë e mirë pör ne, por ama duhet të marrim masa që t'i dalim së keqes përpëra.

Në qoftë se bëjmë prognozën për 15 vjet për naf-

tën, duhet të dimë afërsisht 95 për qind të rezervave të saj deri në vitin 2000. Prognoza duhet të ketë një bazë shkencore. Që të kemi të dhënat për kromin, për bakrin, për energjinë elektrike, për qymyret etj., është e domosdoshme të dinë gjërat kryesore për to, sepse në bazë të tyre do të ndërtojmë hekurudhat, fabrikat përpunuese, minierat nxjerrëse e gjithë objektet e tjera, që kërkojnë investime të mëdha. Këto e të tjera probleme ne duhet t'i mendojmë dhe jo të ngremë makineri, uzina e fabrika që për një kohë të mos kenë me se të punojnë, përkundrazi niveli i arritur të krijojë mundësi që ato të zhvillohen më tej, që nipërit e stërnipërit tanë të rrojnë dhe duhet të rrojnë të lirë e gjithnjë në zhvillim progresiv. Prandaj plani prognozë duhet t'i ketë parasysh këto çështje.

Çështja më kryesore për kapercimin e vështirësive që mund të na krijojen është bujqësia. Edhe sikur zhvillimi i industrisë të na pengohet nga mosdhënia e ndihmës nga Kina, po patëm një bujqësi të përparuar dhe po mundëm që me këtë mekanizim dhe me këto uzina mekanike që kemi dhe po forcojmë, të mbajmë në këmbë industrinë prodhuces aktuale dhe gjithë mekanizimin e bujqësisë, ne kapércejmë vështirësi të mëdha, sepse zgjidhim çështjen e ushqimit të popullit.

Sigurimi i ushqimit është një çështje me rëndësi të madhe në momentet më të vështira. Unë nuk jam shumë me atë që të kënaqemi vetëm me formula të tilla si: «vend bujqësor-industrial» ose «vend industrial-bujqësor». Të gjitha këto shprehje janë të drejta, janë marksiste, sepse pasqyrojnë shndërrimet dhe zhvillimin e ekonomisë së vendit, por përdorimi i tyre të

mos na pengojë në përpjekjet tona që bujqësinë ta bëjmë me të vërtetë moderne, që të mund të shtojë me ritme të larta prodhimet, sepse kështu do të jemi më të favorizuar për momentet e vështira, pasi në kushtet tona bujqësia është jetike.

Ne jetojmë të rrethuar. Në rast rreziku të zhvillimit të një luftë, nuk mund të luftohet e të jetohet pa pasur të siguruar bukën dhe ushqimet. Në situata të tilla njerëzit tanë duhet të kenë armë dhe bukë, se pa ngrënë për ditë të tëra nuk rrighet e nuk luftohet dot. Prandaj duhet të krijohen qysh tanë rezervat. Nga të tjerët nuk presim gjë. Shqiptarët e kanë provuar se si u kanë bërë presion të huajt, para se t'u dërgojnë një kokërr misër. Ata ta japidin këtë «ndihmë» kur je bërë për të vdekur. Ky problem duhet të na preokupojë jashtëzakonisht shumë dhë ta mbajmë parasysh në hartimin e projekteve perspektive, me qëllim që të bëjmë plane në rrugën marksiste-leniniste dhe kurdoherë duke u bazuar në balancimin e interesave jetikë me momentet që krijohen, duke parë me shumë kujdes e vëmendje situatat objektive dhe interesat tanë në bazë të këtyre situatave, pa na i lidhur këmbët formulat dhe përqindjet. Prandaj të mobilizohen të gjitha forcat që të kuptohen dhe të zbatohen drejt disa kritere të organizimit të punës dhe në planifikim të mos i lihet asgjë spontaneitetit. E vërteta është se në hartimin e planeve te ne ka edhe gjëra që i lihen spontaneitetit.

Si të gjithë shokët edhe unë mendoj se për përaktimin e orientimeve themelore, që do të shërbejnë për hartimin e projektplanit perspektiv të pesëvjeçarit të gjashtë dhe të prognozës së zhvillimit të ekonomisë

e të kulturës, duhet të krijohen komisione të përbëra nga disa njerëz shumë kompetentë, që ua pret mendja e jo të grumbullohen në to persona të papërgatitur e sidokudo. Pastaj mendimet e tyre të bazuara t'i çojmë në masë, t'ia shpjegojmë masës, e cila ka të drejtë të ndërhyjë, të korrigjojë, të këshillojë. Vërejtjet e vlefshme të masave t'i marrim parasysh. Njerëzit kompetentë, për të cilët flasim, të jenë të aftë të shfrytëzojnë në maksimum dhe në mënyrë rentabël kapacitetet e gjithë njerëzve të tjerë, të dinë të studiojnë dhe të vërtetojnë shkencërisht të dhënët që marrin. Të mos harrojnë kompetençat, që do të merren me këtë punë, se shumë njerëz kanë mbi supet detyra të tjera shumë më të rënda, prej të cilave nuk mund të heqin dorë. Për këtë arsyе ndarja e forcave në këto komisione duhet organizuar në atë mënyrë që cdhe kjo punë me shumë rëndësi të bëhet mirë, por edhe realizimi i planit të mos dëmtohet kurrrë, në asnje drejtim, për asnjë tregues dhe në asnje vend.

Pra, për suksesin në këtë punë, ka rëndësi vendimtare organizimi. Prandaj, kur i bëjmë thirrje Partisë, organeve të pushtetit dhe të ekonomisë që të fillojnë menjëherë dhe siç duhet nga puna, kjo të konsiderohet si një direktivë vetëm orientuese, kurse mënyra si do të fillojnë ata nga puna kërkon, më duket, një sqarim serioz dhe marrjen e shumë masave organizative. E përsëris se më parë duhet të jepen orientime të thella sqaruese, pa shkuar me mendimin e gabuar se «nuk është hera e parë që bëjmë planifikime». Të tëra këto çështje që theksojmë janë thënë shumë herë, megjithëkëtë ka prej tyre që bëhen shumë mirë, ka që bëhen

edhe me të meta e gabime, prandaj është me vend të rikthehem i dhe të këshillohem i kurdoherë për këtë çështje themelore. Çdo vit ne mbjellim në ara, po prapë-serapë çdo vit na është dashur të jatim udhëzime për të njëjtën punë, edhe kur ajo ka qenë shumë e thjeshtë. Ca më tepër duhet ta bëjmë këtë para hartimit të një projektplanit 5 ose 15-vjeçar; prandaj është imperative të jatim direktiva serioze e të qarta.

Mendoj që, lidhur me direktivën që do të lëshojmë, të bëjmë të qarta se imediate është detyra e hartimit të projektplanit të gjashtë pesëvjeçar dhe, krahas tij, prognoza e zhvillimit të ekonomisë dhe të kulturës së Republikës Popullore të Shqipërisë deri në vitin 1990. Për sa i përket prognozës, shokët më ndihmuani me diskutimet e tyre, prandaj edhe unë kam reflektuar, por tanë vë pyetjen: Është e nevojshme ta deklarojmë prognozën? Unë mendoj se atë mund ta bëjnë përfundim të brendshëm dikasteret dhe komisionet përkatëse, që do të punojnë me të, pa qenë nevoja që ajo t'u bëhet e njojur të tëra masave.

Sigurisht projektplanit i gjashtë pesëvjeçar do të mbështetet në realizimet që kemi arritur dhe në mundësitë që kemi për perspektivën, por mundësitë e perspektivës duhet t'i studiojmë më parë për pesëvjeçarin dhe pastaj për më tutje.

Tani po lexoj disa vërejtje plotësuese që kisha rreth materialit të paraqitur, për të parë së bashku nëse qëndrojnë apo nuk qëndrojnë:

Në faqen 4, atje ku thuhet: «Shikurtimi i kohës së punës në përgjithësi të plotësohet me rritjen e rendi-

mentit të punës-, do të ishte mirë të shtohej fraza: «dhe me mekanizimin e punës».

Në fajen 6, atje ku flitet për kooperativat bujqësore të tipit të lartë dhe pikërisht në vendin ku shkruhet: «Mbi bazën e rritjes së vazhdueshme të prodhimit bujqësor dhe të kooperativave bujqësore», mendoj të shtohet: «të ndihmës dhe të kontributit shtetëror». Kjo shësë mund të bëhet për arsyen se edhe shteti kontribuon me investime për forcimin e bazës materialo-teknike dhe për organizimin e punës në kooperativat e tipit të lartë.

Ne duhet të diskutojmë mos është vallë e parakohshme të flasim që tani për kalimin e kooperativave bujqësore të tipit të lartë në ndërmarrje bujqësore shtetërore? Unë mendoj se kemi kohë për një gjë të tillë, prandaj tani të ndihmojmë të zhvillohet drejt procesi që sapo ka filluar.

Në orientimet me karakter të përgjithshëm mendoj se mungojnë dy, që janë kryesorë: i pari, zhvillimi i mëtejshëm i arsimit dhe i kulturës dhe, i dyti, çështja e mbrojtjes së vendit. Prandaj mendoj të vihen dy paragrafë të veçantë për këto dy probleme kyç.

Për kapitullin e dytë, ku bëhet fjalë për zhvillimin dhe thellimin e mëtejshëm të procesit të industrializimit socialist të vendit, nuk kam ndonjë vërejtje me rëndësi, vetëm do të thosha nëse mund të shtojmë diçka për perspektivën e zhvillimit të mëtejshëm të industrisë së barnave mjekësore.

Për sa i përket kapitullit ku sliet për bujqësinë, në përgjithësi, jam dakord, por do të thosha se mund të vihet një paragraf i veçantë për forcimin e koope-

rativave bujqësore, të kooperativave bujqësore të tipit të lartë dhe për forcimin e bujqësisë përgjithësisht, duke futur orientime të reja, siç janë ato të specializimit të prodhimeve bujqësore, të rajonizimit, të renditjes e të qarkullimit.

Në paragrafin ku trajtohet pemëtaria, jam i mendimit të flitet veçanërisht për rëndësinë e ullirit dhe punën serioze që duhet bërë me të.

Në kapitullin e ndërtimëve të vihet më mirë në dukje çështja e strehimit.

Në pjesën ku përmendet ngritja e nivelit material dhe kulturor të masave të gjera punonjëse të fshatit, jam dakord me orientimet, por duhet të ruhem i nga optimizmi i tepruar dhe nga idealizimet, se kjo do të varet shumë nga realizimet në prodhim, që është baza. Gjithashtu, ato do të vijnë me luftë dhe me përpjekje, ato do të maten shtrënguar duke marrë parasysh ku-shtet e rrëthimit kapitalist, nevojat e mëdha që do të na imponojë kjo gjendje dhe restrikzionet¹ që do të jemi të detyruar të bëjmë për të forcuar mbrojtjen, për krijimin e rezervave, për shtimin e investimeve me forcat tona e të tjera, e të tjera. Asgjë nuk duhet të paraqitet shesh me lule në këto orientime, por ta mësojmë popullin që me të vërtetë të dijë të jetojë i rrëthuar, të jetë i kënaqur me këto që janë arritur dhe të kuptojë se, edhe në qoftë se prodhohet shumë, mallrat janë të ruajtura vetëm për të, atje, në rezervat shtetërore, për eventualitetin e një kohe të keqë. Tani situata është e mirë, në treg gjen mish dhe ushqime

1. Nga frëngjishtja — kufizimet.

të tjera. Natyrisht tregu ynë s'ka sende sa të notosh në to, por rezervat nuk duhet t'i prekim, nuk duhet të ndodhë që, për shkak të mosrealizimeve, ato çka nxirren, të mos kthehen më atje ku merren.

Për sa i përket zhvillimit të revolucionit tekniko-shkencor drejt janë përektuar rëndësia dhe roli i Akademisë së Shkencave, por nuk janë vetëm akademia me institutet e saj vartëse që do ta zhvillojnë këtë revolucion. Këtë ta kuptojmë mirë, se ka dhe do të ketë edhe institute të tjera, që, megjithëse nuk janë të varura organikisht prej akademisë, do të marrin pjesë gjallërisht në zhvillimin e revolucionit tekniko-shkencor në shërbim të realizimit të planeve tona ekonomiko-shoqërore.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mb'edhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH,
që gjendet në AQP*

**MIQËSIA RUHET, ZHVILLOHET E KALITET EDHE
DUKE SHKËMBYER GRUPE ARTISTIKE
E SPORTIVE**

*Nga biseda në takimin me trupën e cirkut
të Shangait dhe me ekipet kombëtare të basketbollit
të Kinës*

14 prill 1973

Kemi ardhur sot këtu të takohemi¹ e të bisedojmë së bashku. Ardhja e trupës së cirkut të Shangait dhe e basketbollistëve kinczë në vendin tonë i shërben kalltjes së mëtejshme të miqësisë që lidh popullin kinez e popullin shqiptar, i cili, siç e keni parë vëtë gjatë qëndrimit tuaj në Shqipëri, ushqen dashuri dhc respekt të madh për popullin tuaj.

Unë nuk munda të asistoj në shfaqjen që dhatë apo në ndonjë ndeshje që u zhvillua midis basketbollistëve kinezë dhe atyre shqiptarë. Megjithatë, ju pashë në televizor dhe ju përgëzoj për talentin artistik, për shkathtësinë dhe për guximin që treguat në interpretim dhe në lojë. Duhet të jesh i shëndetshëm nga koka, i

1. Ky takim u bë në Pallatin e Brigadave në Tiranë.

shëndetshëm nga zemra, i shëndetshëm nga trupi për të kuptuar qartë rrezikshmërinë e ideologjisë borgjezo-rezisioniste, për të përballuar e për të kapërcyer me sukses vështirësitë e jetës, për t'u mbrojtur nga çdo sulm i armikut dhe për të dalë fitimtar. Kjo do të thotë që në momente të vështira, ose më mirë të themi, në çdo moment, duhet të jemi të fortë, të përgatitur ideologjikisht, politikisht, ushtarakisht e fizikisht.

Pasi përgjegjësi i trupës së cirkut të Shangait falënderoi për pritjen e ngrohtë dhe përshtypjet që u kishte bërë çka kishin parë në Shqipëri, fjalën e mori përsëri shoku Enver Hoxha:

Midis jush ka shumë artiste dhe sportiste. Kjo tre-gon se gratë janë po aq të zonja, të zgjuara e të shkathëta sa edhe burrat. Gratë përbëjnë gjysmën e populatës, prandaj marksizëm-leninizmi na mëson se revolucioni nuk mund të ecë përpara, socializmi nuk mund të ndërtohet me sukses, në qoftë se ato nuk vlerësohen dhe nuk ndihmohen për të zënë vendin që u takon në shoqëri. Kötë mësim të marksizëm-leninizmit duhet ta kuptojnë mirë si burrat, ashtu edhe gratë. Është e domosdoshme që burrat të kuptojnë rolin tepër të rëndësishëm të grave për përparimin e shoqërisë, prandaj të mos i pengojnë ato të ecin përpara, kurse këto të mos kujtojnë se të drejtat që gjëzojnë, i kanë dhuratë nga burrat. Të dyja palët, burra dhe gra, i fitojnë të drejtat e tyre në sajë të përpjekjeve dhe të luftës së përbashkët që bëjnë për ndërtimin e shoqërisë socialiste, nën drejtimin e partisë marksiste-leniniste.

Cirku juaj ka tradita, kurse cirku ynë është i ri, prandaj shokëvc të trupës së eirkut tonë u del detyrë

të mësojnë akoma më shumë. Për sa u përket basketbollistëve kinezë, mund të them se ata luajnë mirë, janë të gjatë dhe të zgjedhur. Në lojën e basketballit duhen njerëz me trup të gjatë.

Ardhja juaj këtu shërben për të shkëmbyer eksperiencë, por, sikurse thashë, i shërben edhe kalitjes së miqësisë midis popujve tanë, sepse popujt nuk mund të rrojnë të veçuar nga njëri-tjetri, ata dëshirojnë të rrojnë në miqësi, t'i ndajnë së toku gjëzimet dhe hidhërimet dhe të ndërtojnë një jetë kurdoherë e më të lumtur. Për t'ia arritur këtij qëllimi të madh, natyrisht popujt përpiqen, luftojnë, por ai nuk mund të arrihet dhe kjo miqësi nuk mund të ekzistojë, në rast se në krye të tyre nuk qëndrojnë partitë marksiste-leniniste. Atje ku, nën udhëheqjen e Partisë marksiste-leniniste, ka fituar revolucioni, populli është bërë zot i plotfuqishëm i satit të vet dhe është i bashkuar fort. Kjo është arsyaja që atje ku në fuqi është partia marksiste-leniniste, ku është vendosur diktatura e proletariatit janë krijuar të gjitha kushtet që uniteti i brendshëm dhe miqësia e solidariteti me popujt e tjerë të forcohen vazhdimisht e të lulëzojnë sa më tepër. Miqësia ruhet, zhvillohet e kalitet në shumë mënyra e forma, një ndër të cilat është edhe shkëmbimi i grupeve artistike, sportive, teatrale, muzikore, të cirkut, të futbollit, të basketballit etj.

Në vendet ku revolucioni akoma nuk ka fituar dhe punonjësit vazhdojnë të vuajnë nga shtypja e rëndë kapitaliste e imperialiste, por edhe në vendet revizioniste ku revolucioni u tradhtua, uniteti dhe miqësia midis popujve nuk mund të arrihen, sado që dëshira

e tyre për këtë është e madhe, pse sunduesit mbjellin dhe punojnë për të përjetësuar përçarjen. Armiqtë e pengojnë me çdo kusht bashkimin e popujve, pse i tremben bashkëveprimit të tyre, që synon arritjen e fitores së vërtetë. Pavarësisht nga pengesat, revolucionarët duhet të punojnë shumë për fitoren e revolucionit.

Atje ku nuk zbatohet filozofia marksiste-leniniste, ku marksizëm-leninizmi është tradhtuar, nuk mund të kultivohen e të forcohen ndjenjat e miqësisë së shëndoshë e të vërtetë midis popujve, që këto të shërbejnë si mbështetje për të shndërruar botën drejt përparimit shoqëror.

Le të marrim rastin e Bashkimit Sovjetik.

Në kohën e Leninit e të Stalinit, ai kishte shumë miq në botë, por, kur revizionistët morën fuqinë në dorë dhe rivendosën kapitalizmin, duke e shndërruar shtetin sovjetik në fuqi socialimperialiste, ata i braktisën miqtë e vërtetë të popullit sovjetik. Bashkimi Sovjetik nuk është më mik as i popujve të Bullgarisë, të Polonisë, të Çekoslovakisë, të Gjermanisë Lindore e të Hungarisë, sepse si atje edhe në këto vende sundojnë revizionistë; bile ai nuk është në miqësi as me partitë revizioniste të vendeve që përmenda. Edhe me këto parti, revizionistët sovjetikë kanë hyrë në grindje. Në Bashkimin Sovjetik, te klika e tij sunduese, mbretëron ideja e shovinizmit të shtetit të madh.

Turneu juaj në vende të tjera evropiane do të trajtojë se populli kinez është popull me kulturë të lashtë. Njerëzit atje do t'ju shikojnë me simpati. Ata jetojnë në kapitalizëm që u ka mbyllur çdo perspektivë punonjësve, kurse rendi socialist është i vetmi rend me të

vërtetë përparimtar, këtij i takon e ardhmja, pavarësisht se kapitalistët mburren shumë me zhvillimin e shkencës e të teknikës së tyre dhe propagandojnë se sistemi kapitalist nuk është më ai i pari. Sipas tyre, ai paska ndryshuar dhe nuk qenka më shfrytëzues.

Kur të ktheheni në atdhe, u transmetoni shokëve e shoqeve tuaja, dashurinë e madhe të popullit shqiptar për popullin tuaj. U jepni të falat tona gjithë sportistëve të Kinës, të cilëve u urojmë shëndet dhe përparime të mëtejshme në të gjitha aktivitetet e tyre sportive.

Botohet për herë të parë sipas shënimave të mbajtura në këtë takim, që gjenden në AQP

MARKSIZËM-LENINIZMI ËSHTË E VETMJA BUSULL E PAGABUESHME PËR T'U ORIENTUAR NË VLERËSIMIN E SITUATAVE

*Nga biseda me ministrin e Republikës Demokratike
të Vietnamit Nguyen Ksuan Thui¹*

18 prill 1973

Pasi u përshëndetën, e mori fjalën shoku Enver Hoxha:

Gëzohemi që qeveria dhc partia juaj ju dërguan në vendin tonë, të takohemi e të bisedojmë për probleme, të cilat na interesojnë aktualisht dhe do të na interesojnë edhe në të ardhmen. Çështja e popullit vietnamец është çështje edhe e popullit shqiptar, sepse të dy popujt tanë luftojnë përkrah njëri-tjetrit kundër armiqve të përbashkët. Kjo është arsyecja që ne e konsiderojmë me rëndësi ardhjen tuaj në Shqipëri.

Takimi me ju do të na shërbejë veçanërisht, nove, shqiptarëve, për të përfituar sa më shumë nga eksperiencia e pasur e luftës së madhe dhe nga përpjekjet

1. Në atë kohë ministër pa portofol në qeverinë e Republikës Demokratike të Vietnamit. Erdhi në Shqipëri për vizitë zyrtare për të vënë në korenë Qeverinë tonë për rezultatet e bisedimeve të Parisit.

heroike të popullit tuaj, që, në përlleshje me armiq shumë të mëdhenj dhe shumë të armatosur, ka luftuar me dekada dhe me guxim të pashoq për lirinë në Jug dhe për ndërtimin në Veri. Historia e luftës suaj tregoi se pjekuria, heroizmi dhe vendosmëria e popullit heroik të Vietnamit, të Veriut e të Jugut, nuk u mposhtën dot as nga imperialistët amerikanë, as nga ideologjia reaksionare ku këta mbështeten, as nga forca e armëve të tyre.

Jo vetëm ju, por as ne nuk mund të harrojmë se çfarë ju kanë bërë amerikanët, sepse gjaku që ka derdhur populli juaj është njësoj sikur e ka derdhur populli ynë. Sukseset tuaja në luftën kundër imperializmit amerikan janë njëkohësisht edhe tonat, sepse interesat, qëllimet dhe armiqjtë i kemi të përbashkët. Ajo qëka ju ndodhi juve sot, mund të na ndodhë neve nesër.

Pasi falënderoi për pritjen e foli për përshtypjet që i kishin bërë sukseset në ndërtimin e socializmit në Shqipëri, si dhe për detyrat që qëndronin para popullit vietnamez, ministri vietnamez pyeti:

Si e vlerësoni ju, shoku Enver, situatën e sotme ndërkombëtare?

SHOKU ENVER HOXHA: Situatën e tanishme ndërkombëtare ne shqiptarët nuk e vlerësojmë ashtu si e vlerësojnë disa shokë të tjerë. Ndryshimi i vlerësimeve mund të rrjedhë edhe nga fakti se disa mund të kenë fakte e argumente të veçanta që të tjerë nuk i kanë. Ne mendojmë se, marksizëm-leninizmi është e vetmja busull e pagabueshme për t'u orientuar në vlerësimin drejt të situatave në bazë të fakteve që disponohen.

Faktet tregojnë se imperializmi amerikan është revizionizmi sovjetik janë armiq të betuar të popujve, të lirisë dhe të socializmit. Kjo duket si në ideologjinë që i udhëheq, ashtu dhe në qëndrimet që mbajnë në arenën ndërkontinentare. Intrigat dhe demagogjia e tyre në kurri zotërojnë popujve janë intensifikuar fuqishëm. Në qoftë se popujt, marksistë-leninistët, revolucionarët dhe njerëzit përparimtarë nuk mbajnë qëndrim të vendosur kritik ndaj imperialistëve e revizionistëve, nuk e kanë parasysh veprimtarinë e tyre të irrezikshme dhe nuk ndërtojnë një strategji dhe taktkë të tillë që ta dobësojnë këtë veprimitari, ne mendojmë se situata ndërkontinentare do të vazhdojë të vështirësohet gjithnjë e më shumë.

Taktikat dhe strategjia e komunistëve duhet të ndërtohen në përputhje me interesat kombëtarë të çdo vendi, pa harruar dhe interesat revolucionarë të popujve të tjerë. Në qoftë se në këtë balancë të peshimit të gjykit nuk mbahet parasysh raporti i drejtë midis interesave kombëtarë dhe ndërkontinentare, situata nuk mund të vlerësohet drejt. Ne mendojmë se imperialistëve amerikanë dhe revizionistëve sovjetikë, që janë shumë dinakë, nuk duhet t'u krijojmë në asnjë mënyrë situata të favorshme për veprimtarinë e tyre minuese.

Imperializmi kurdoherë ka qenë dhe është i pabesë. Të tërë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i kemi pruvear në kurri dhëlpëritë e tij, sepse luftërat, në të cilat ka pasur gisht imperializmi amerikan, i kemi kaluar të gjithë. Edhe në qoftë se në Luftën e Parë e të Dytë Botërore imperialistët amerikanë mbajtën anën e koalicionit kundër nazistëve gjermanë, kjo nuk do të

thotë se ata ishin përkrah popujve. Kush i studion thellë prejardhjen e nazizmit, interesat që përsaqësonte ai, do të kuptojë se ishin borgjezia franceze dhe ajo angleze ato që i mbështetën dhe u erdhën në ndihmë nazistëve gjermanë, do të kuptojë fare lehtë se imperializmi amerikan dhe gjithë imperializmi botëror janë armiq të betuar të popujve, të cilët i kanë akoma në kurriplagët e shkaktuara prej tyre.

Që nga koha kur revizionistët sovjetikë morën pushtetin në duart e tyre, në gjirin e kapitalizmit botëror u fut edhe Bashkimi Sovjetik. Kjo është pikëpamja jonë e palëkundshme, prandaj kemi luftuar dhe do të luftojmë deri në fund kundër revizionizmit sovjetik. Ne jemi të bindur se në luftën kundër tij, nuk jemi të vetëm, në këtë luftë me ne janë të gjithë popujt e botës. Disa, ashtu si ne shqiptarët, e pohojnë haptazi që janë në luftë me të; disa të tjerë, ndoshta për arsyen taktike, nuk e bëjnë akoma këtë.

Popujt e botës nuk janë më miq të Bashkimit Sovjetik, sepse shikojnë dhe po binden çdo ditë e më shumë se ai nuk është më një shtet socialist dhe, me fuqinë ushtarake dhe ekonomike që disponon, bën presione e shantazhe në dëm të interesave të tyre dhe në favor të bashkëpunimit të ngushtë më imperializmin botëror. Në këto kushte, komunistët dhe revolucionarët e botës po luftojnë. Vështirësitë e krijuara, sipas mendimit tonë, janë të mëdha dhe, për t'i kapërcyer, körkohet jo çfarëdo solidariteti, por solidaritet dhe unitet marksist-leninist.

Ne shqiptarët jemi një popull i vogël që kemi vendosur të rrojmë të lirë e kurri të mos e ulim kurrizin

e të jetojmë në gjunjë. Ne e ndicjmë nevojën e unitetit dhe të ndihmës së singertë, por kjo nuk na i errëson sytë, sa të mos jemi në gjendje të dallojmë cilët janë miq të singertë, që ecin në rrugën marksiste-leniniste dhc cilët jo. Ne nuk na gënjejnë, as na entuziazmojnë llafet e Niksonit e të Brezhnevit, që trumbetojnë se me vajtje-ardhjet e tyre nëpër vendot e njëri-tjetrit, po përpinqen «të sigurojnë paqen», sepse e dimë që këtojanë lëvizje për komplotë të ardhshme shumë të rrezikshme për të ndarë midis tyre sferat e ndikimit në botë.

Republika Popullore e Shqipërisë nuk është vetëm. Ajo ka aleate besnikë partitë marksiste-leniniste, ka popujt që luftojnë për liri dhe të gjithë revolucionarët kudo në botë. Armiqtë tanë me mendjemadhësi nuk i llogaritin këto forca, që në të vërtetë janë kolosale. Lufta e popullit heroik të Vietnamit i tronditi nga themellet Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe satelitët e tyre, saqë i futi në krizë të thollë. Një nga arsyet kryesore që Niksoni dhe imperializmi amerikan u detyruan të nënshkruajnë marrëveshjen me ju ishte lufta e popullit tuaj dhe solidariteti ndërkombëtar përkrah Vietnamit heroik. Këtë solidaritet ata e nënveftësojnë, sepse nuk duan të nxjerrin mësimë nga historia, por ky qëndrim nesër do t'u hajë atyre kokën.

Ne, marksistët, kurrë nuk i humbasim shpresat, sepse jemi të bindur që e ardhmja e botës është komunizmi. Sot situata ndërkombëtare nuk është c qetë. Nuk ka dyshim se ajo në të ardhmen do të zhvillohet më tej në favorin tonë dhc në disfavor të imperialistëve. Ju, gjatë gjithë luftës së ashpër që keni bërë me imperialistët amerikanë, nuk i keni humbur kurrë shpresat-

Çfarë lloj armatimesh nuk kanë përdorur amerikanët kundër Vietnamit? Të gjitha i kanë vënë në veprim, përvëç bombës atomike. Megjithëkëtë, ju nuk u deku-rujuat, as u dobësuat, përkundrazi, u forcuat akoma më tepër. Armiqtë tanë nuk i vlerësojnë dot forcën e madhe të doktrinës ngadhënjimtare të marksisëm-leni-nizmit dhe suqinë e pakufishme të solidaritetit të popujve, prandaj dhe i nënvlefëtësojnë, por nga ky qëndrim janë vetëm ata që do ta pësojnë.

Imperializmi amerikan vërtet e nënshkroi marrë-veslijen e paqes, gjë që përbën një fitore për ju, por atje kanë mbetur mijëra ushtarakë amerikanë të mas-kuar si civilë, ka mbetur administrata kukull e Sajgonit, që është në shërbim të tij, kurse flota amerikane noton në ujërat e Vietnamit. Në Kamboxhia lufta vazhdon. Në Laos, me gjithë marrëveshjen për disa çështje, rifilluan bombardimet.

Marrëveshja e Gjenevës nuk lejoi që në Vietnamin e Jugut të kishte një territor të çliruar me një qeveri nacionalçlirimtare, kurse lufta e armatosur kundër imperializmit amerikan e krijoj këtë bazë, që është një avan-tazh i madh. Por, siç e dini, çështja kryesore është që pushteti i vendosur në zonat e çliruara të shtrihet në gjithë Vietnamin e Jugut, kështu do të vihet në vend dhe porosia e Ho Shi Minit për bashkimin e vendit. Natyrisht bashkimi i Vietnamit do të arrihet me lufi të dhe përpjekje, duke mënjanuar mundësinë e ndërhyrjes së imperializmit amerikan, të cilat duhet t'i priten krahët, me qëllim që vietnamezët ta zgjidhin vetë çështjen e tyre. Van Thieu nuk mund t'i rezistojë suqisë së popullit që po shtyp dhe padronët e tij e dinë mirë sa i vlen atij lëkura.

Imperializmit amerikan nuk duhet t'i bëhen lajka e lëshime nga asnjëri. Në qoftë se amerikanëve u krijohen situata të favorshme, atë janë gati të ndërhyjnë përsëri, të rikthehen në Vietnamin e martirizuar, me qëllim që të shpëtojnë nga kriza ku janë zhytur. Por, po ndërhyri përsëri në Vietnam, duke menduar se i ka neutralizuar popujt që lustojnë për liri dhe miqtë e tyre, imperializmi amerikan do të bëhet më arrogant. Amerikanët mund të krijojnë situata shumë të vështira në Kambozhia e në Laos me anë të vazhdimit të një luste të egër, duke shfrytëzuar edhe kukullën Thieu e forcat e tij, si dhe Tajlandën, që e kanë bazën e tyre. Kjo situatë do të krijonte edhe një herë afër Vietnamit të Veriut dhe të Jugut një «jastëk» luste të egër.

Këtë situatë e nxitin edhe qëndrimet e Bashkimit Sovjetik. Brezhnjevi ka marrë qindra milionë dollarë kredi nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës për të shfrytëzuar gazin dhe naftën e Siberisë. Ai është lidhur ekonomikisht me imperializmin amerikan dhe për hir të interesave tregtarë, të shkëmbimeve të përbashkëta etj. Është gati të sakrifikojë gjakun dhe interesat e popujve të Kambozhias dhe të Laosit. Kur shohim revisionistët sovjetikë të lidhen kaq ngushtë me imperialistët amerikanë për të shfrytëzuar Siberinë e të krijojnë aleancë me Bonin për ta vënë Evropën nën zgjedhë, kur shohim që ata kanë çuar një milion ushtarë në kufi me Kinën, dhe sakrifikojnë interesat e popullit gjerman ehe të popujve të tjerë, atëherë mund të themi se, situata ndërkombëtare është mjaft e ndërlikuar. Një situatë e tillë i nevojitet shumë edhe imperializmit amerikan.

Ne, shqiptarët, nuk mund ehe nuk do të pushojmë

luftën kundër kötyre veprimeve imperialiste dhe fjalën tonë do ta themi me zë të lartë, sepse duam të mbrojmë popujt e Vietnamit, të Kamboxhias e të Laosit, sepse, duke vepruar në këtë mënyrë, në të njëjtën kohë ne mbrojmë edhe popullin tonë. Populli dhe Partia jonë ju duan sinqerisht, prandaj çdo mendim që kemi pasur jua kemi thënë haptazi dhe jemi të bindur se na keni kuptuar drejt. Këtë e kemi bërë dhe do ta bëjmë vazhdimisht, se jemi internacionalistë.

Ne na gëzojnë fitoret që ka arritur Vietnamit, por mendojmë se imperialistëve amerikanë nuk mund t'u zihet besë. Për këtë arsyen nuk jemi të një mendimi me disa që thonë se «imperialistët amerikanë nuk mund të hyjnë më në Vietnam!». Mund të krijohen koniunktura të tilla që ata të ndërhyjnë prapë. Në një kohë që të tjerët, në vend që t'i kundërvihen imperializmit amerikan, i bien daulles pa u shqetësuar për politikën e tij «paqësore», Niksoni vazhdon të shpifë kundër vendit tuaj «për të justifikuar» para opinionit publik amerikan dhe botëror mundësinë e risillimit të bombardimeve barbare mbi Vietnam. Nga momenti i kërcënimeve të Niksonit e deri në fillimin e veprimeve nga ana e tij, natyrisht do të kalojë njëfarë kohe, por imperializmi amerikan i kapurcen shpejt këto etapa, në qoftë se nuk i krijohet një rreth i hekurt nga popujt dhe vendet e botës.

Duke iu përgjigjur pyetjes së ministrit vietnamez për vlerësimin që ai i bënte situatës në Lindjen e Mesme dhe për marrëdhëniet midis Shqipërisë e Greqisë, shoku Enver Hoxha tha:

Imperialistët amerikanë dhe revisionistët modernë

sovjetikë përpinqen të bëjnë ligjin edhe në Lindjen e Mesme. Konflikti në këtë zonë të botës, sipas mendimit tonë, nuk do të ketë zgjidhje të afërt. Ai është pjellë e imperializmit amerikan dhe e revizionizmit modern sovjetik. Imperialistët amerikanë nuk kanë vetëm interesa të mëdhenj ekonomikë atje, interesa që lidhen me shfrytëzimin e vajgurit të saj, por edhe interesa të mëdhenj strategjikë. Të njëjtët interesa kanë edhe revisionistët sovjetikë. Ata përpinqen të zënë pozita strategjike në Afrikë dhe në vendet arabe, kanë synime për naftën. sepse me futjen në dorë edhe të saj ata do të pengonin shfrytëzimin e naftës arabe prej imperializmit amerikan dhe, për pasojë, ky i fundit do të dobësohej.

Edhe problemi i Mesdheut ka rëndësi të madhe strategjike për të dyja palët, për imperializmin amerikan dhe për socialimperializmin sovjetik. Në Mesdhe të dyja këto fuqi imperialiste parashikojnë një ndeshje interesash të mëdhenj. prandaj secila prej tyre përpinqet të zërë pozita për vete, duke shmangur ndeshjen me armë. Sovjetikët në këtë drejtim, tani për tanit, duke përfituar nga dobësitë dhe lëshimet e udhëheqësve të disa shteteve arabe, kanë krijuar disa avantazhe në rapport me amerikanët.

Popujt e vendeve arabe janë trima, por borgjezia e tyre nuk është e lidhur me popullin, ajo shikon vetëm interesat e vet që janë të pashkëputur nga interesat e borgjezisë ndërkombëtare, të trusteve të imperialistëve amerikanë, të Francës, të Italisë, të Gjermanisë Perëndimore etj. Kjo është e vërtetë, sepse ndryshe nuk ka si shpjegohet që brenda shtatë ditëve e gjithë ushtria e tyre u likuidua nga aviacioni izraelit. Në këtë kushte

është e zorshme të mendohet se ata po përgatiten seriozisht për një luftë kundër Izraelit, i cili është i fuqishëm, jo vetëm pse i kanë dhënë amerikanët aeroplanë reaktivë «Fantom», por sepse ka edhe një rrjet të përsosur informacioni, që mbështetet nga spiunazhi imperialist botëror.

Pra, interesat e imperialistëve amerikanë, francezë, të revizionistëve sovjetikë dhe të imperialistëve të tjera janë që problemi i Lindjes së Mesme të mos gjejë kurrë zgjidhje, që gjendja atje të qëndrojë gjithmonë siç është, pra të ruhet statukoja. Prandaj nevë nuk na e merr mendja që në këto kushte të bëhet gjë në favor të popujve arabë.

Gjithë simpatia dhe përkrahja jonë është për popujt arabë, të cilët ne i mbështetim me sa mundini kundër Izraelit, që është vegël e imperializmit amerikan. Qeveritarët izraelitë janë banditë, fashistë të tërbuar si Hitleri.

Ne kemi simpati për popullin palestinez, i cili sot vuan e është pa atdhe. Ai është shpërndarë në vende të ndryshme, si në Liban, në Jordani, në Egjipt, në Siri. Libani është një çerdhe e kapitalit imperialist amerikan, është një vend tipik kozmopolit. Shefi i ushtrisë libaneze, edhe pse mori vesh vrasjen e disa udhëheqësve palestinezë nga Izraeli, me cinizëm vazhdonte të pinte shampanjë. Të tilla qëndrime mbahen ndaj vëllezërve palestinezë. Si në Liban, edhe në Jordani, palestinezët janë si të vendosur me qira, prandaj bëjnë vetëm disa inkursione kundër sionistëve. Mbreti Hysein është tradhtar, ai është kundër palestinezëve, është në lufi me

ta. Edhe në Egjipt e në Siri palestinezët janë në të njëjtën gjendje.

Cila do të jetë perspektiva e tyre? Që të realizohet dëshira e palestinezëve, është shumë e zorshme, por besimi në luftën që bëjnë ka rëndësi të madhe për realizimin e çështjes së tyre të drejtë. As pretendimi i nationalistëve arabë që «izraelitët të dëbohen nga Izraeli» nuk është i drejtë.

Për arsyet që përmenda, ne mendojmë se popujt duhet të luftojnë njëkohësisht si kundër imperializmit, ashtu edhe kundër revizionizmit modern, se që të dy janë të rrezikshëm.

Ju pyetni se si janë marrëdhëniet tona me Greqinë? Ne kemi marrëdhënie diplomatike dhe kemi filluar të bëjmë edhe tregti me të. Kemi dërguar në Universitetin e Athinës delegacione mjekësh dhe pedagogësh, edhe ata kanë dërguar ndonjë delegacion në konferencat tona shkencore, si në atë për ilirët etj.

Edhe me fqinjët e tjerë ne mbajmë marrëdhënie diplomatike, shkëmbejmë delegacione dhe kemi marrëdhënie tregtare me ta. Por ne nuk mund të pajtohem me Titon, as të harrojmë ç'na kanë bërë fashistët italianni, që na kanë sulmuar dy herë, prandaj vigjilencën nuk e humbasim. Papa i Romës është hedhur tanë në sulm të hapët kundër Shqipërisë socialiste. Vatikani ka pasur në Shqipëri një rrjet të tërë pristërinjsh, që, sipas dokumentesh të pakundërshtueshme e të shumta që kemi, një pjesë prej tyre kanë qenë agjentë të fshehtë të fashizmit italian, të nazizmit gjerman dhe të të tjerrëve. Këta «fetarë» në shërbim të okupatorëve janë përpjekur t'i bëjnë varrin Shqipërisë. Armiqë mendoj-

në se Shqipëria është e izoluar, por ajo nuk është e izoluar, siç mendojnë ata, ajo kudo në botë ka miq të shumtë.

Zemra jonë gjithmonë ka rrahur pranë jush, sepse populli juaj lufton me heroizëm kundër imperializmit amerikan. Të tërë popujt kanë luftuar, por lufta e popullit tuaj kundër imperializmit amerikan dhe satelitëve të tij, ka qenë e gjatë dhe shumë e ashpër. Nga eksperiencia e kësaj lufte në kemi mësuar dhe besojmë se, pas imbarimit të saj, do të kemi mundësi të përfitojmë akoma më shumë. Këtë ne e konsiderojmë të domosdoshme, sepse përgatitja e gjithanshme për mbrojtje kërkon patjetër edhe shfrytëzimin e eksperiencës së mirë të shokëve dhe të miqve tanë.

Ju keni përpara detyra të mëdha në Veri, por akoma më të rënda i keni detyrat në Jug, prandaj si më parë, ashtu edhe tani fryma e solidaritetit është e domosdoshme dhe ne kurdoherë do të jemi pranë jush, pranë popullit heroik vietnamez.

Ne do të përpinqemi vazhdimisht për forcimin e miqësisë midis dy vendeve e popujve tanë dhe dëshirojmë e urojmë që ju të korrni suksese në të gjitha drejtimet.

Botohet për herë të parë sipas shënimave të mbajtura në këtë takim, që gjenden në AQP

SA MË SHUMË KALON KOHA, AQ MË TEPËR NA PËLQEN VENDLINDJA

Nga biseda në familjen e shokut Kadri Baboçi¹

18 prill 1973

SHOKU ENVER HOXHA: Si jeni me shëndet, shoku Kadri? Të uroj jetë të gjatë e të rrosh akoma edhe shumë vjet! Urime shoqja Irfan².

Tani jam duke lexuar një libër mjaft interesant në gjuhën frëngje me titull: «Në 50 vjeç fillonjeta». Sipas këtij libri na mbetet akoma shumë për të jetuar. Po si je? Ti dukesh mjaft i ri dhe ashtu është, je më i i ri nga unë.

SHOKU KADRI BABOÇI: Edhe ju jeni shumë mirë me shëndet, shoku Enver.

SHOKU ENVER HOXHA: Mirë jam. Kam një çikë leshrat të bardha, po s'ka gjë që më janë zbardhur.

1. Shoku Enver Hoxha bëri një vizitë në këtë familje me rastin e 60-vjetorit të lindjes së shokut Kadri Baboçi, në atë kohë zëvendësministër në Ministrinë e Arsimit e të Kulturës. Në këtë vizitë shoku Enver shoqërohej nga shoqja Nexhmije Hoxha.

2. Bashkëshortja e shokut Kadri Baboçi.

Ke vajtur në Gjirokastër, Kadri? Për mua qahen gjirokastritët. Këto ditë mora një letër nga gratë e Dumanavatit dhe të Manalatit, të cilat më stojnë të vete në Gjirokastër me rastin e festivalit folklorik dhe më thonë: «Ke katër vjet që nuk ke ardhur».

Festivalin e Parë Folklorik në Gjirokastër e pashë në film. Ai doli shumë bukur. Kjo do të thotë se edhe ambienti ka luajtur rol në suksesin e këtij aksioni.

Neve të moshuarve na pëlqen shumë Gjirokastra, por e duam edhe sepse e kemi vendlindjen tonë. Sa më shumë kalon koha, aq më shumë na pëlqen vendlindja. Ti Kadri, shkon më shpesh atje, se je më i ri dhe besoj e ke vënë re vetë se, kur shkel gurët e kalldrëmeve, sikur çmalleshi me të kaluarën. Të gjitha ato që kemi jetuar dhe janë atje akoma edhe sot, përvëjnë kujtime të ëmbla për ne. Jemi rritur me to, prandaj i kujtojmë me mall të madh.

Kjo tablo e bukur e Gjirokastrës që keni këtu në mur, pikturë është?

SHOKU KADRI BABOÇI: Jo, shoku Enver, është fotografi, e fotografit gjirokastrit Mehmet Kallfa.

SHOKU ENVER HOXHA: Kur bic përvjetori i festës së Liceut të Gjirokastrës?

SHOKU KADRI BABOÇI: Në muajin nëntor.

SHOKU ENVER HOXHA: Ç'fëmijë ke ti Kadri?

SHOKU KADRI BABOÇI: Kam dy djem. Ky këtu, Arbeni, është sekretar i organizatës së rinisë në shkollën e mesme, kurse tjetri, Agimi është në universitet, vazhdon studimet për arkitekturë.

SHOKU ENVER HOXHA: Kur ne ishim të rinj kushtet për të vazhduar shkollën ishin shumë të vësh-

tira. Në Gjirokastër diskutohej kurdoherë me frikë për ekzistencën e shkollës. Njëherë regjimi hapte një shkollë si lice, pastaj e mbyllte dhe hapte një tjetër, siç ndodhi më vonë me normalen, por edhe këtë nuk e la të nxirrte maturantë. se prapë e prishi. Regjimi obskurantist i Zogut nuk lejoi asnjëherë një shkollë të mesme të plotë në Gjirokastër. Po, megjithatë nga këto shkolla dolën shumë njerëz të mirë e të mësuar. Ti, Kadri ke punuar pedagog në Shkollën e Mesme të Gjirokastrës. Atje ishte pedagog edhe Siriu [Shaplllo] kurse Zihniu [Sako] duhet të ketë ardhur më vonë se ti. Domethënë, kur u bë demonstrata e parë, ju ishit atje.

SHOKU KADRI BABOÇI: Në atë shkollë janë bërë shumë demonstrata, po ajo e viti 1942 u frymëzua nga idetë e Partisë dhe i shërbeu punës propagandistike të saj në popull. Në gjimnaz u bë një punë e madhe revolucionare.

SHOKU ENVER HOXHA: Ku shkuat kur u bë demonstrata?

SHOKU KADRI BABOÇI: Në fillim shkuam në Pllakë, pastaj kaluam në pazar për t'u treguar autoriteteve fashiste forcën tonë. Mbaj mend se nxënësit dhe mësuesit kaluan rrugës me aq rregull e gjallëri sikur të ishin ushtarë. Duke ecur këndonin këngë patriotike, si «Për mëmëdhenë» etj. Manifestimi bëri përshtypje të madhe dhe populli tha fjalë shumë të mira. Pastaj shkuam para gjimnazit e hodhëm parulla në favor të Luftës Nacionalçlirimtare dhe, kur pamë që forcat e reaksionit do të shpërthnin nga pazari, zumë rrugën të shkolla «Drita» e u bëmë barrikadë. Vetëm me for-

cën e armëve të karabinierisë mundën të na shpërndajnë.

SHOKU ENVER HOXHA: E ke parë Elmaz Çanin¹?

SHOKU KADRI BABOÇI: Po, shoku Enver. Paraç ca kohësh jam takuar me të. Gjatëm një ditë një fotografi ku kemi dalë përpara monumentit të Çerçizit, po nuk i identifikojmë dot të gjithë ata që kanë dalë me këtë rast.

SHOKU ENVER HOXHA: Ja, ky këtu është Çomja, shoferi, kurse ky më tjetri është ai që fshinte shkollën, tjetri Aqif Selfoja, megjithëse për këtë nuk jam i sigurt prandaj, më mirë pyet vetë Aqifin. Pastaj, ja edhe Qemal Karagjozi. Ja edhe ai që sot është korriçor në Aparatin e Komitetit Qendror². Të tjerët nuk i njoh.

Po Feriku [Shtino] ku është? Eminin [Shtino] ka mjaft kohë që nuk e kam parë.

SHOKU KADRI BABOÇI: Feriku tani është pensionist. Edhe Emini është mësues pensionist.

SHOKU ENVER HOXHA: Më erdhi një herë në shtëpi Emini, biseduam gjatë bashkë për shumë ngjarje nga e kaluara.

Në Gjirokastër po bëjnë disa ndërtime dhe mirë bëjnë sepse ka nevojë, për shembull në mes të Duvanavatit e të Manalatit mendoj se duhet bërë ndonjë ndërtim se atje shtëpitë janë shumë të përhapura.

Rrimë nganjëherë me Sanon³ dhe kujtojmë kohën kur kemi jetuar në Gjirokastër. Para se të shkonim në

1. Ish-profesor i shokut Enver Hoxha.

2. Stefan Deçka.

3. Sanije Hoxha, motra e shokut Enver Hoxha.

Hazmurat, ne rrnim në Cfakë. Nëna shkonte shpesh te Fatimeja e Çoçolit, djalin e së cilës, e kisha shok, prandaj herë-herë shkoja edhe unë me të. Nganjëherë shkoja edhe në oborrin e shtëpisë suaj. Andej unë kalloja pastaj për në shtëpinë e Haxhos¹. Mbaj mend që vjehrra e motrës më dha njëherë një kokërr vezë. Mirëpo, kur shkoja rrugës, ma mori një djalë nga të Kokalarëve. Si tani më kujtohet që u përleshëm me njëri-tjetrin dhe veza u thye.

Shtëpitë tuaja janë më këtej, pasi kalon furrën e Manalatit domethënë, pasi kalon nga Asqerajt, pastaj ngjitesh te Baboçët. Atje është, siç i thonë në Gjirokastër, «fundi i dynjasë». Në kohën e luftës kjo lagje quhej e ishte bërë si Stalingradi.

A po shkruhet ndonjë gjë për mësuesit e vjetër, si për Xhafo Poshin, Arshi Çabeun, Iliaz Hoxhën, Sadik Çelon e të tjerë? Ata janë mësuesit e parë, që na mësuan edhe ne, që kanë punuar edhe në shkollën «Drita».

SHOQJA NEXHMIJE HOXHA: Është mirë dhe është e domosdoshme të shkruhet, se edhe ata kanë qenë luftëtarë dhe kanë dhënë kontributin e tyre në lëvizjen për përparimin e kombit.

SHOKU ENVER HOXHA: Ashtu është. Ishin ata që përgatitën Liceun e Gjirokastrës dhe na përgatitën edhe ne. Kështu ka ndodhur edhe me pedagogët e Liceut të Korçës. Prandaj unë mendoj se duhet punuar që të shkruhet edhe për ta.

(*Pastaj në dhomë hyjnë djali i madh dhe motra e-*

1. Haxhire Hoxha (Çipi), motra e shokut Enver Hoxha.

shokut Kadri Baboçi dhe që të dy takohen me shokun Enver e me shoqen Nexhmije.)

SHOKU ENVER HOXHA: Si je ti, ëjalë, me shëndet dhe me mësimë? Po vajza ime si shkon me mësimë, si sillct në shkollë? A keni ndonjë kritikë në adresë të saj?

AGIM BABOÇI¹: Ajo është shumë mirë si në mësimë edhe në sjellje.

SHOKU KADRI BABOÇI: Më riorganizimin e shkollës u bë një pëlekje e mirë e lëndëve. kështu që janë bërë disa përmirësimë në këtë drejtim.

SHOKU ENVER HOXHA: Si nga nxënësit, edhe nga pedagogët në procesin e mësimit po bëhen përpjekje të kënaqshme. Sipas të dhënave që kemi, janë tejkaluar të gjitha planet, kudo, në çdo sektor, ka pasur një mobilizim të madh dhe jo vetëm në shkolla, po edhe në industri, në ndërtime etj. Edhe mungesat në punë nga fshatarësia punonjëse tanë janë të pakta, ato janë mungesa që bëhen vetëm për arsyen e shëndetësore ose kur njerëzit kanë ndonjë hall. Tani çështja është që të mbahet kjo gjendje, por për këtë kërkohet një punë edukative sistematike.

Rinia janë është e shëndoshë, e pastër dhe karakterizohet nga qëndrime revolucionare. Ne prindërit nuk na lë meraku, prandaj tregojmë kujdes për fëmijët. Shqetësohem kur ju ktheheni vonë në shtëpi, pasi ngryset, prandaj të mos ju vijë keq kur ju pyesim: «Ku ishit, more djem?.. Këtë e bëjmë jo se nuk kemi besim

1. Në atë kohë student në vilin e dytë të Inxhinierisë së Ndërtimit, dega e arkitekturës.

dhe se ju nuk keni personalitetin tuaj, këtë ju e keni dhe as nuk duam t'ju pengojmë në aktivitetet tuaja, në asnjë mënyrë nuk duam t'ju pengojmë, po edhe kujdes duhet. Lufta kundër shfaqjeve të huaja është në interes të të gjithë popullit, se, po të liheshin të trasheshin ato, do të përbën rrezik të madh për vendin.

Çështja është që edhe organizata e rinisë të vihet në rrugë të drejtë, mbledhjet e saj duhet të bëhen të gjalla dhe në to të rrilën probleme që e interesojnë rininë. Kështu, kur i riu të dalë nga mbledhja e organizatës, mësimet që do të marrë atje, ta ndihmojnë të jetë aktiv. Mirëpo, mbledhjet e rinisë bëhen një herë në muaj, kurse në jetë njeriu punon vazhdimisht qdo ditë, zhvillon veprimtarinë e tij të pandërprerë, diskuton me shokun dhe me shoqen, prandaj diskutimet që bëni me njëri-tjetrin, duhet të jenë kurdoherë në rrugë partie. Në shoqëri ju mund të diskutoni për çdo gjë: për një tablo pikture, për një film, për një këngë, për një libër, mund të diskutoni e të bëni kritikën e një romani etj.. vetëm duhet të keni parasysh që këto të jenë në baza të drejta kurdoherë në rrugën që na mëson Partia. Kështu, mësoni vetë dhe edukoni shoqishtoqin, jo vetëm në organizatën-bazë të rinisë, por kudo që jeni. Për shembull, ju mund të ndodheni 4-5 shokë në një shëtitje, fjala vjen, dhe e bie rasti të diskutoni për një libër, për një roman që keni lexuar, për të cilin njëri mund të thotë se nuk është aq i mirë, se ka këtë apo atë dobësi. një tjetër mund të thotë se i pëlqen, një i tretë se nuk i pëlqen etj. Këto diskutime mund t'i bëjnë si të rinjtë studentë, edhe ata punëtorë. Kështu mund të diskutoni edhe për probleme të tjera.

ra. Të tëra këto pastaj i diskutoni edhe në mbledhje.

SHOKU AGIM BABOÇI: Gjatë diskutimeve që bëjnë të rintjtë në grupe të vogla janë më të lirshëm, bilo në shoqëri të ngushtë shpesh ata diskutojnë për probleme shumë të rëndësishme.

SHOKU ENVER HOXHA: Po në mbledhje të organizatës nuk diskutojnë?

SHOKU ARBEN BABOÇI¹: Në mbledhje nuk diskutojnë aq lirisht si në grupe të vogla; jo se të rintjtë janë indiferentë, por ndoshta ngurrojnë për të ngritur probleme të ndryshme dhe për të thënë mendime përpara një mase të madhe njerëzish.

SHOKU ENVER HOXHA: Këtu üshtë çështja që sekretari i organizatës së rinisë të shkollës, kur bisedon me 4-5 veta për probleme të rëndësishme që diskutojnë të rintjtë, duhet t'u vërë rëndësi të madhe mendimeve të tyre dhe problemet që ngrenë ata, t'i shtrojë në organizatë që mbledhjet e saj të mos janë burokratike dhe formale. Nëpër mbledhjet e rinisë, pra të mendohet me kujdes për zgjedhjen e tematikës e të punohet që të shtrohen ato probleme që i interesojnë rinisë. Ky interesim del nga debatet e gjalla që bëjnë të rintjtë, kurrihen mendime, njëri thotë kështu, tjetri ashtu. Ti që je në një grup shokësh dhe që ke diskutuar për një problem apo një tjetër, ke lidhje me sekretarët e organizatoreve, të cilëve mund t'u thuash si mendojnë për këtë ose për atë çështje, çfarë mendimi kanë etj. Kështu mund të vejë edhe një tjetër t'i thotë sekretarit që për

1. Në ajo kohë nxënës në shkollën e mesme „Ismail Qemali“ dhe sekretar i komitetit të rinisë së shkollës.

këtë problem unë mendoj kështu, sigurisht është fjala për probleme të ndryshme. Atëherë sekretari i organizatës mendon dhe arrin në konkluzionin se ato janë çështje që preokupojnë organizatën e tij, qofshin të mira ose të këqija, prandaj propozon që kjo ose ajo çështje të vihet në rendin e ditës të mbledhjes së organizatës. Kjo do të jetë një praktikë e mirë dhe do të bëjë që mbledhjet të zhvillohen gjallërisht e në mënyrë luftarake. Shokët që kanë diskutuar për këto probleme në grupe të vogla, kur të dëgjojnë që në mbledhjen e organizatës shtrohen të njëjtat probleme, do të thonë: «More po ku i gjeli ky të shtrojë në mbledhje ato gjëra, për të cilat kemi diskutuar edhe ne?» Kështu që ato që janë diskutuar në rrethet e vogla gjallërisht, nuk ka arsyë përse të mos i diskutojnë gjallërisht edhe në mbledhjet e zakonshme të gjëra, sepse këto nuk janë çështje të vogla, por probleme nga më të ndryshmet të shkencës, të kulturës, të artit etj.

Vetë të rinjtë duhet t'i propozojnë e t'i sugjerojnë sekretarit të organizatës se ç'probleme mund të diskutohen në organizatën-bazë të rinisë dhe kush mund të ngarkohet për të bërë diskutimin kryesor, ai që është më i përgatitur për një problem të caktuar dhe jo të përgatitet gjithmonë sekretari i organizatës. Mund të mblidhen të rinjtë edhe më shpesh për të diskutuar, në rast se këto takime të të rinjve bëhen interesante. Kështu, kur të vijë mësuesi, jo vetëm të asistojë atje, por të shkëmbejë me ju mendime për ato që ju interesojnë.

Prandaj, varet shumë nga rendi i ditës që mbledhjet të bëhen të gjalla, interesante, luftarake. Organizata të ketë parasysh që të mos përgatitë mbledhje formale,

sa për të kaluar radhën, por të zgjedhë tematikë që i intereson rinasë dhe jo vetëm me karakter pedagogjik, por edhe në drejtime të tjera, për shembull historik, shkencor etj., pavarësisht që disa nga ato i bëjnë mësim në shkollë. Mund të gjenden dhe probleme të veçanta që të lidhen me disa çështje të caktuara që mbledhjet të bëhen interesante dhe tërheqëse për rininë.

Që mbledhja të marrë rëndësi, më parë duhet të mendohet me kujdes, t'i kushtohet më shumë kohë përgatitjes së saj. Edhe ti, si sekretar i organizatës-bazë të rinasë në shkollë, duhet t'i kushtosh ca kohë kësaj pune, duke menduar qysh më parë qfarë do të shtrosh në mbledhje, i kristalizon këto mendime e pastaj i hedh në letër. Kështu del tema e mbledhjes, të cilën ua sugjeron shokëve dhe shoqeve. Duke vepruar kështu tema bëhet e studiuar dhe mbledhja e organizatës do të jetë me interes.

Më falni tani të ngrihem. Urime edhe një herë, Kadri, shëndet, jetë të gjatë e lumturi në familje! Mbetsh me shëndet shoqja Irfane! Djema, suksese në mësime, për t'i shërbyer sa më mirë popullit e atdheut dhe të nderoni prindërit tuaj.

*Botohet për herë të parë sipas
shënimave të mbajtura në këtë
takim, që gjenden në AQP*

TE PERSOSET ORGANIZIMI I PUNES NE UZINAT E MEDHA MEKANIKE

*Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

24 prill 1973

Para se të fillojnë diskutimet kam disa pyetje: A është e nevojshme gjithçka që prodhohet nga industria mëkanike? E bëj këtë pyetje sepse di që prodhohen disa artikuj, të cilët lihen mënjanë. Pse ndodh kjo, dëshiroj të më jepet një përgjigje e saktë, si për veglat e ndërrimit, ashtu edhe për makineritë që prodhohen, nëse përdoren të gjitha apo jo? Punohet për numër apo punohet për cilësi? Kemi nevojë ne për çelik? Sigurisht që kemi. Kemi furra çeliku e fonderi? Kemi. Atëherë pse nuk merren masa që këto fonderi të derdhin çelik në mënyrë të plotë dhe të organizuar?

Pas përgjigjeve të këtyre pyetjeve, si dhe të pyetjeve të tjera që u bënë në Byro, shoku Enver Hoxha, vazhdoi:

1. Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit «Mbi plotësimin e detyrave të caktuara nga Kongresi i 6-të i PPSH për prodhimin e pjesëve të këmbimit dhe makinerive», paraqitur nga Ministria e Industrisë dhe e Minierave.

Për pyetjet që bëra nuk mora përgjigjen e duhur ose mora një përgjigje të rrumbullakosur. Nuk e kuptoj, për këto çështje, ç'bëni ju, shokë të Qeverisë ndaj Koço Theodhosit? Pse nuk ia paraqitni këtë problem Byrosë Politike dhe t'i propozoni që ai nuk bën për ministër, për arsyen se ka shumë dobësi në punë. Merren masa, sjellim vegla, sjellim presa dhe të gjitha mjetet që na duhen, bëjmë edhe konferanca, seminare etj., etj. dhe kalojnë tre vjet të tërë që këto detyra nuk vihen në jetë. Kush e ka fajin për këtë? Në rast se e ka Ministria e Industrisë dhe e Minierave, atëherë të ngulemi në këtë çështje dhe punës atje t'i japim rrugë.

Edhe unë jam i mendimit se në fushën e prodhimit të veglave të këmbimit, në krahasim me të kaluarën, ka shumë përparime, është bërë një hop i konsiderueshëm përpara, gjë që e ka lehtesuar ekonominë tonë nga një barrë e rëndë. Natyrisht, ky përparim i detyrohet organizimit të mirë të punës nga dikasteret që kanë në varësi ndërmarrje mekanike.

Por, kur flasim për përparimet në një sektor të caktuar pune, nuk do të thotë të mos analizojmë të metat dhe dobësitë që ekzistojnë. E parë në këtë prizëm, duhet pranuar se edhe në sektorin e industrisë mekanike ka të meta të mëdha e serioze. Çështja është që këto të meta nuk mjafton t'i shikojmë dhe t'i numërojmë, ajo që ka rëndësi të madhe është marrja e masave efektive për zhdukjen graduale të tyre. Po si zhduken të metat në punë? Ato zhduken duke ndjekur e kontrolluar vazhdimisht zbatimin e vendimeve që merren. Diskutimet që bëhen edhe këtu, në Byronë Politike, nuk do të kenë vlerë, në qoftë se nuk organizohen puna dhe kontrolli

i zbatimit të tyre. Sa bëhet një gjë e tillë nga Ministria e Industrisë dhe e Minierave? Kjo është një çështje që duhet parë me sy kritik, me qëllim që puna të forcohet më tepër në të ardhmen. Forcimi i kontrollit në këto çështje është i domosdoshëm. Të metat ne duhet t'i vëmë në dukje ashtu siç janë dhe, në të njëjtën kohë, të gjejmë rrugët për të përmirësuar gjendjen.

Siq theksuan shokët që diskutuan, industria mekanike ka rëndësi të jashtëzakonshme për vendin tonë. Ajo përbën faktorin vendimtar që mban në këmbë, shpejton ose ngadalëson, zhvillimin e indistrisë sonë në përgjithësi. Këtë gjë duhet ta kuptojmë në gjithë gjerësinë dhe thellësinë e saj. Flasim shumë për kushtet tona, që ne nuk kemi mundësi të mëdha të importojmë, të zëvendësojmë një fabrikë me një tjetër, të bëjmë modernizimin e tyre me pjesë të tëra të reja etj. Në këto kushte na vihet detyrë që, këtë industri mekanike ta mbajmë si duhet në dorë dhe ta zhvillojmë, sepse me anë të saj do të vëmë në lëvizje gjithë industrinë.

Në kuadrin e zhvillimit të indistrisë në përgjithësi e të asaj mekanike në rastin konkret, me rëndësi të veçantë janë dy çështje: organizimi i teknologjisë dhe edukimi i kuadrove. Pa hyrë në detaje, dëshiroj të them se, po të vemi uzinë më uzinë e të shohim cili është procesi teknologjik, sa kuadro kemi kualifikuar dhe çfarë kualifikimi kanë, do të dalë se kemi të bëjmë me dy probleme. Po të japim një mendim të përgjithshëm, mund të arrijmë në konkluzionin se në këtë periudhë (të mos themi 30-vjeçare, sepse nuk është kaq stazhi i indistrisë sonë mekanike, po ta marrim këtë që pas vitit 1965 e këtej), për sa i përket zgjerimit të saj kemi bërë

një përparimi të madh, ndërsa në fushën e teknologjisë dhe të përgatitjes së kuadrit, me gjithë përparimet, këto nuk janë në shkallën që kërkohet. Edhe në të ardhmen, sidomos gjatë këtij pesëvjeçari është planëzuar që industria mekanike të zgjerohet më tej dhe kjo do të bëhet, por, krahas kësaj, u duhet kushtuar më tepër kujdes ngritjes në një nivel më të lartë të teknologjisë së saj dhc përgatitjes së kuadrit të nevojshëm.

Ne kemi uzinën «Traktori» më të përparuarën në këto drejtime, por «në një lule nuk vjen behari». Kemi dhe uzinën «Enver» e uzina të tjera, por as me to nuk i plotësojmë dot nevojat që na paraqiten. As me organizimin që kemi aktualisht, industria jonë mekanike nuk mund të kryejë rolin e madh që i përket si në kohën e tanishme, aq më pak në të ardhmen, kurse nevojat tona do të janë akoma më të mëdha. Për këto arsy, çështjet që kanë të bëjnë me zhvillimin e industrisë mekanike duhen marrë me seriozitet shumë të madh. Të kapemi nga uzina «Traktori» që e kemi më të përparuar dhe të ndërtojmë frontalisht në të gjitha uzinat tona mekanike një teknologji të përparuar.

Uzina «Enver», e cila është më e vjetra në vendin tonë, paraqitet prapa në drejtim të teknologjisë. Pse të jetë më prapa kjo uzinë? Unë mendoj se nuk ka asnjë arsy. Përkundrazi, traditat dhe mundësitë e saj janë të mëdha për të ecur edhe ajo përpala. Kjo kërkon që organizata-bazë e Partisë, drejtoria, kuadrot dhe inxhinierët mekanikë atje t'i vihen seriozisht punës dhe me plan. Specialistët e kësaj uzine duhet të përdoren mirë në profillet që kanë dhe të marrin eksperiencë në uzinën «Traktori» në drejtim të teknologjisë. Këtë gjë

është e domosdoshme ta bëjnë edhe uzinat e tjera mekanike, të cilat të dërgojnë në uzinën «Traktori» ekipe të veçanta për të studiuar eksperiencën e saj në zbatimin e një teknologjie të lartë. Kjo është e para.

Çështja tjetër është ajo e sigurimit të kuadrit, sidomos të kuadrit me arsim të mesëm. Po nuk e morëm seriozisht e me kohë nü dorë shpejt këtë çështje do të kemi vështirësi të ndjeshme në shfrytëzimin e makinërisë. Mirë e tha shoku Pilo Peristeri që puna me turne nuk duhet të na pengojë në sigurimin e kuadrit. Punëtori që përdor makinën, duhet të jetë i aftë ta njohë atë në hollësi. Po u arrit kjo, makina punon si sahat në të tri turnet. Por në qoftë se punëtori nuk është i aftë, atëherë makina nuk mund të japë sipas kapacitetit që ka. Po çfarë ndodh në këtë drejtim? Ka disa shfaqje liberale, që duken në lëshimet dhe në mungesën e kërkuesës së llogarisë për përgatitjen e kuadrit të nevojshtëm, pa të cilin nuk mund të vihet në lëvizje makinaria e industrisë mekanike. Shfaqje liberale është edhe ajo që shumë specialistë të mirë të kategorive të larta ose teknikë të mesëm, nga më të kualifikuarit, janë lejuar të shpërndahen andej-këtej nëpër torno të ndërmarrjeve të vogla, nü vend që këta të caktohen të punojnë në uzina mekanike të mëdha e kryesore dhe të drejtojnë në to prodhimin. Uzinat e mëdha mekanike janë baza dhe shpirti i gjithë industrisë sonë.

Detyra që të ngremë punëtorë në kategori ka vërtet rëndësi, por edhe në këtë problem vërehet se ka liberalizëm. Unë nuk jam në asnje mënyrë për të të ngritur në kategori punëtorë që nuk e meritojnë. Ai që kërkon të ngrihet në kategori, më parë duhet të djersijë, të

mësojë teorikisht e praktikisht, të japë provim në torno apo në makinën prerëse, të nxjerrë prej tyre prodhim të cilësisë së parë, sipas standardit, me kosto sa më të ulët dhe në kohën e caktuar. Kështu duhet t'i zhvillojmë provimet dhe jo siç ndodh shpesh që mësuesi ose inxhinieri tregohen liberalë, bëjnë vetëm ndonjë pyctje sa për të kaluar radhën dhe ngrenë me lehtësi njerëz në kategori, për të marrë një rrogë më të madhe, pa e merituar atë. Në këto raste, disa nga ata që janë ngri-tur në kategori vazhdojnë të punojnë përsëri sipas më-nyrës së vjetër, sepse, në fakt, kanë po atë shkallë kua-lifikimi, ndryshimi është se tani ata paguhën më shumë. Socializmi kërkon që njerëzit të paguhën me të vërtetë sipas punës që bëjnë, për aq sa i jepin shoqërisë. Ky duhet të jetë kudo parimi nga i cili duhet të nisemi kur ngremë punëtorë në kategori. E përsëris, provimi të jepet në torno, në presa, në mekanizma. Të mos shpej-tohem i t'u themi punëtorëve: «Hajde, futuni në pro-vim». Jo! Më parë t'i thuhet atij që kërkon të japë provim: Qëndro dhe puno këtu në këtë torno ose makinë prerëse, na jep prodhime me cilësi të mirë, pastaj eja të futesh në provim.

Çështja tjetër që dua të theksoj është ajo që Ministria e Industrisë dhe e Minierave dhe ministritë e tjera të mendojnë kurdoherë për përsosjen e organizimit të uzinave mekanike. Organizimi i punës duhet të jetë në zhvillim dhe jo të qëndrojë në vend ose të jetë standard për të gjitha uzinat. Të mos kemi frikë nga organizimet dhe riorganizimet, po edhe organizime çdo ditë nuk mund të bëjmë. Në qoftë se, për shembull, Ministria e Bujqësisë nuk bën mirë planet se çfarë i ne-

vojitet për sektorët që mbulon, ka rrezik që shumë materiale të produara në uzinat e saj, ku ajo është «vetë zot e vetë shkop», të mbeten stoqe. A ka fuqi ekonomike shteti ynë të lejojë, të mbahen nëpër depo vegla që kushtojnë me miliona lekë dhe të shfrytëzohen këto pas një kohe shumë të gjatë? Kemi caktuar ne këtu në Byro Politike dhe në Qeveri të prodhojmë me shumicë disa lloje veglash ndërrimi e t'i mbajmë nëpër depo? Jo, nuk kemi caktuar. Atëherë pse mbahen? Po ndodhi kjo me Ministrinë e Bujqësisë, atëherë merret me mend çfarë mund të ngjasë me Ministrinë e Industrisë dhe të Minierave që ka shumë uzina, pra, humbasim shumë fuqi punëtore, shumë rezerva makinerish dhe lëndë të parë. Prandaj çështja e organizimit, më duket mua, duhet përsosur vazhdimesht. Të marrim si shembull Uzinën e Mekanikës Bujqësore që ka tanë një organizim të caktuar. Mund të qëndrojë edhe kështu siç është sot, duke punuar me këtë organizim që ka, por edhe mund të studiohet se si të forcohet akoma më mirë organizimi i saj, duhet të lidhet me Ministrinë e Industrisë dhe të Minierave apo me atë të Bujqësisë etj.

Këto që themi janë të domosdoshme të zbatohen, sepse në disa ministri nuk ndodh si me atë të Industrisë dhe të Minierave, ndaj së cilës jemi të rreptë dhe kërkojmë llogari. Më duket se për ministritë e tjera jemi pak dorëlëshuar, Qeveria nuk e ndjek realizimin e planit të tyre sipas assortimenteve. Prandaj i rekomandoj Qeverisë që këto çështje t'i shikojë jo vetëm për Ministrinë e Industrisë dhe të Minierave, por edhe për ministritë e tjera, pa përjashtim. Çështja shtrohet kështu: ose nedo ta futim industrinë mekanike në kërkesa të drejta

rigoroze dhe ajo të bëhet me të vërtetë një mbështetje e fuqishme e tërë industrisë sonë, ose do të ecim në një rrugë qorre, e cila do të na krijojë shumë vështirësi. Prandaj është e domosdoshme të ndjekim udhën e parë.

Pse duhet ta bëjmë këtë? Këtë duhet ta bëjmë edhe pér arsyen se ne tani po flasim pér prodhimin e pjesëve të këmbimit, gjë që ka rëndësi të madhe, po çështja është se flasim vetëm pér nevojat që kanë automjetet dhe traktorët. Po përse nuk flasim edhe pér nevojat që kanë pér pjesë këmbimi edhe fabrikat e makineritë e tjera? Sepse këto i kemi akoma të reja. Mirëpo me kohë neve edhe pér këto makineri të reja do të na duhen pjesë këmbimi, të cilat nuk do të jenë më disa vidha e bulona, por akse të mëdha e pjesë të tjera të rënda nga më të ndryshmet që pér importimin e tyre do të duhen shumë fonde. Atëherë do të vihem i në pozita të tilla: T'i porositim e t'i blejmë jashtë apo të specializojmë industrinë tonë mekanike që t'i prodhojë? Cilën rrugë të pranojmë? Patjetër këtë të fundit: Të specializojmë industrinë tonë.

Në të ardhmen mund të na thonë: Tani, uzina «Dri-ni» mund të prodhojë fare mirë kollodokë etj., prandaj pse të mos bëhet kjo një uzinë speciale? Bile jo vetëm kjo uzinë, po edhe uzina të tjera kanë mundësi të prodhojnë pjesë të mëdha këmbimi, aq të nevojshme pér fabrikat, uzinat e makineritë tona, pa të cilat ato vjen koha dhe nuk mund të ecin, sepse do të amortizohen. Prandaj detyra që shtrohet është jo vetëm të prodhojmë pjesë këmbimi pér traktorë dhe automjete, por edhe pér fabrikat, pér uzinat, pér centralet e hidrocentralet, pér detajet e ndryshme të makinerive të tyre. Sa më shumë

makineri që po sjellim, aq më e vështirë do të na bëhet kjo çështje; sa më shumë ngarkohet industria jonë mekanike, aq më i domosdoshëm bëhet organizimi i saj në një mënyrë rigorozë në të gjitha drejtimet. Ndryshe, do të mbetemi prapa sepse nuk kemi mundësi dhe forca ekonomike që të përballojmë të gjitha nevojat, që ka mbarë industria e vendit tonë, nëpërmjet importit. Ne nuk mund të përballojmë një importim me kaq mijë zëra. Fryma e importimit të çdo gjëje duhet të luftohet. Kjo është absolutisht e domosdoshme. Në qoftë se lejojmë që dikasteret dhe ndërmarrjet të presin gjithçka nga importi, kërkesat e tyre nuk do të mbarojnë asnjëherë, përkundrazi do të shtohen. Të kuptohet mirë se ato që mund t'i prodhojmë me forcat dhe me mundësitetona, nuk duhet t'i sjellim në asnjë mënyrë nga jashtë. Është krejt absurde dhe e palejueshme të importojmë diçka që, po të vrasim mendjen, mund ta prodhojmë vetë.

Një koncept më të drejtë për importimet duhet të ketë edhe Ministria e Tregtisë, sepse ka edhe ajo shumë të meta në këtë drejtim. Ka ndodhur t'u jetë bërë telegram firmave të huaja për të na dërguar me ngut të madh jashtë planit një sasi malli të caktuar, në një kohë kur me disa përpjekje kjo sasi është sigruar dhe atëherë, si pa gjë të keq, niset që këtë një telegram tjetër që anulon të parin! Në këtë rast kemi të drejtë të bëjmë pyetjen: «Ç'ndodh kështu?». Gabime të tilla Ministria e Tregtisë nuk duhet t'ia lejojë vetes, prandaj të shkundet dhe ta bëjë më mirë punën. Ndërsa për gabimet që kanë dikasteret e tjera lidhur me porositë që bëjnë për import pa u menduar mirë, të përgjigjen vetë.

Të metat në këtë drejtim t'i luftojmë në mënyrë të organizuar dhe pa hezitim, pa druajtje.

*Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbali i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH,
që gjendet në AQP*

KUALIFIKIMI SIIKENCOR ARRIIET ME PUNE TË MADHE E ME SAKRIFICA

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

25 prill 1973

Universiteti i Tiranës është një institucion shtetëror me rëndësi të madhe për vendin tonë. Ai ka nxjerrë dhe po nxjerr kuadro të mësuar, që nuk kanë qëndruar pas, po kudo ku janë caktuar. kanë dhënë prova të mira duke treguar se janë në gjendje të mbajnë mbi supe detyra të rëndësishme. Kuadrot që dalin nga universiteti ynë i kanë kryer detyrat e ngarkuara përgjithësisht me vullnet, me kurajë, me frymë revolucionare dhe me pjekuri shkencore. Kjo tregon se mësimi dhe edukata që janë dhënë në universitet janë mbështetur në frymën e Partisë, direktivat e së cilës për programet dhe punën mësimore etj., janë zbatuar në përgjithësi mirë nga studentët dhe nga pedagogët.

1. Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit: «Mbi krite-ret themelore të sigurimit e të kualifikimit të kuadrit në shkolat e larta e institucionet shkencore».

Por, mendoj se, ashtu si në sektorët e tjera të arsimit dhe të kulturës, edhe në Universitetin e Tiranës, pa nënveftesaun punën e mirë që është bërë për sigurimin dhe kualifikimin e kuadrit, duhet pranuar se ka pasur edhe gabime e të meta, si edhe shfaqje të liberalizmit e të intelektualizmit. Jam dakord me vërejtjet e drejta që bëri shoku Hysni [Kapo]. Megjithëse këto gabime e të meta janë kritikuar, meqenëse nuk janë bërë përmirësimet që kërkohen, si duket, duhen kritikuar prapë që të ndreqen.

Tani çështja është të bëhen përpjekje për t'i eliminuar ato. Përgjegjësi për këto dobësi, të meta e gabime ka edhe Ministria e Arsimit dhe e Kulturës, që nuk ka qëndruar si duhet në krye të detyrës dhe ka bërë lëshime; ajo nuk ka ushtruar kontrollin e duhur mbi këtë institucion; ndihma e saj për të ka munguar. Edhe unë jam dakord të merren masa, siç u tha këtu, por më parë këto të studiohen mirë, të jenë të matura. Massat që do të merren duhet të shërbejnë për të përmirësuar me të vërtetë punën e universitetit, për të realizuар atë qëllim të madh që i ka vënë Partia këtij institucioni për mësimin, përgatitjen, formimin, kalitjen dhe edukimin e shëndoshë marksist të gjithë të rinjve e të rejave që e ndjekin. Në qoftë se del nevoja të largohen andej disa pedagogë të paaftë etj., natyrisht, këto veprime duhen bërë në mënyrë të shkallëzuar e jo përnjëherësh, sepse pa një organizim të fortë e të menduar mirë, edukimi i të rinjve dhe i të rejave si kuadro, në vend që të bëhet mirë, mund të dëmtohet.

Në parim është e drejtë edhe për të siguruar pedagogë të jashtëm për universitetin, veg duhet menduar

mirë se kjo nuk është e lehtë dhe nuk mund të zgjidhet pa u bërë më parë përgatitjet e nevojshme. Cilët do të jenë këta pedagogë të jashtëm që mund të vijnë të jaspin mësim në universitet dhe nga mund të merren? Nuk duhet harruar se ne kemi hasur vazhdimisht vështirësi për sigurimin e kuadrove të shkollave të larta. Deri edhe ne jemi marrë me këtë çështje, e, megjithatë, nuk janë siguruar kuadro sa kanë qenë nevojat. Po a jemi ne në gjendje, tani për tani, shokë, të gjejmë pedagogë të kualifikuar për të gjitha lëndët që jepen në fakultetet e ndryshme të universitetit dhe për nevojat e institucioneve shkencore? Prandaj, mendoj që nga Ministria e Arsimit dhe e Kulturës dhe nga shokët e Komisionit Qendror të Arsimit pranë Komitetit Qendror të Partisë të shikohet nëse duhet dhe kur duhet t'ia filloni punës përlëvizjen e pedagogëve; të përcaktohet se cilët duhet të largohen, me ç'ritëm do të ecim në këtë çështje, cilët duhet të jenë pedagogë të jashtëm që do të merren, cilat duhet të jenë kërkuesat ndaj tyre, sa njerëz duhen marrë në universitet pa shkëputje nga puna etj.

I them këto që lëvizja e pedagogëve të universitetit duhet bërë me kujdes, ata që mendohet të largohen, duhet të mendohet edhe me cilët do të zëvendësohen. Si mendoni ju t'i zëvendësoni kuadrot që do të largoni? Ata që do të merrni si mendoni t'i siguroni, duke i hequr fare nga puna që kryejnë aktualisht në drejtimin e ekonomisë, në drejtësi, në bujqësi, në Shkollën e Partisë, në industrinë mekanike etj., apo pa i shkëputur nga puna? Ndonjë nga këta punonjës mund të lëvizet nga puna që bën dhe të emërohet pedagog, por në një masë të gjerë kjo nuk është aq e lehtë të realizohet. Me llafe

mund të themi që ta marrim një kuadër, ta zëmë, nga Gjirokastra dhe ta bëjmë pedagog në universitet, por duhet të mendojmë si do të sistemohet ai këtu me shtëpi etj. Prandaj të bëjmë plane të studiuara mirë përkötë çështje. Këto punë nuk bëhen menjëherë, me një të rënë të shkopit. Nuk mund të veprojmë duke shkëputur nga puna e t'i emërojmë pedagogë shumë kuadro, këtë mund ta bëjmë vetëm për një numër fare të vogël dhe atëherë kur ka arsyesh shumë të forta. Nga ana tjetër, edhe pedagogët e jashtëm duhet të zgjidhen nga njerëzit më të aftë dhe atyre t'u caktohet njëfarë sistemi në punë, që edhe të japid mësim, edhe të kryejnë njëkohësisht një detyrë tjetër, nga e cila nuk mund t'i largojmë, por t'u heqim disa orë nga koha normale e punës.

Për të përgatitur planin për lëvizjen e pedagogëve, nuk duhet të kalojnë vite të tëra. Problemi të studiohet shpejt dhe të zbatohet qysh vitin e ardhshëm akademik. Megjithatë kjo duhet bërë e menduar mirë, pasi pedagogët janë njerëz me vlerë dhe nuk mund të gjykohet me lehtësi për largimin e tyre nga universiteti ose nga shkollat e tjera të larta. Në qoftë se disa prej tyre janë treguar liberalë ndaj vetes dhe të tjerëve, kjo nuk do të thotë se janë të paaftë për punë të tjera. Prandaj të merren masa që të ndihmohen. Duhet të punojmë që shfaqjet liberale të vërtetuara në punë, ata t'i kuptojnë dhe t'i ndreqin. Pikërisht këtij qëllimi do t'i shërbejë qarkullimi i tyre. Ata mund të venë, fjala vjen, nga pedagogë të shkollës së lartë, në mësues të arsimit të mesëm të përgjithshëm, profesional etj. Disa prej tyre, sipas profilit, mund të punojnë edhe në qendra pune e prodhimi, si për shembull, inxhinierët, ekonomistët e të

tjerë. Po të merret një masë e shpejtuar dhe t'i largojmë disa nga pedagogët që janë treguar liberalë ose ata që nuk kanë qenë sa duhet të ngarkuar, pa bërë mirë llogaritë, sipas mendimit tim, do të gabojmë dhe në këtë mënyrë do të dëmtojmë shkollat e larta.

Nuk mund të nënveftësohet as puna e pedagogëve që kanë bërë tekstet miësimore sepse të bësh një tekst nuk është punë aq e lehtë e që mund të kryhet brenda një kohe të shkurtër. Kur ne ngarkohemi të përgatitim një raport apo një referat, na duhen shumë ditë me radhë, nganjëherë deri edhe një muaj punë intensive, kurse pedagogëve u duhen disa muaj e ndoshta më tepër, vetëm për të grumbulluar materialet, për t'u konsultuar me fakte e të dhëna, dhe pastaj për të bërë seleksionimin, studimin, analizën e parashtrimin e tyre. Kjo është një kohë e domosdoshme pune këmbëngulëse e me përgjegjësi që u nevojitet pedagogëve të ngarkuar me këtë detyrë shumë të rëndësishme. Përveç punës për përgatitjen e teksteve, pedagogëve u është ngarkuar të paraqiten edhe në auditorë për të dhënë mësime që, gjithashtu, po të mendohet mirë, nuk është një punë e lehtë.

Vihet pyetja: Si e kanë kryer këtë detyrë pedagogët? Disa prej tyre nuk janë përgatitur mirë për dhëni e leksioneve, për shkak se një pjesë nuk kanë pasur aftësitë e duhura; disa se e quanin veten «të pazëvendësueshëm», «të palëvizshëm», duke gjykuar me mendmadhësi: «Si ne, nuk ka të tjerë!». Ndërsa disa pedagogë, që kanë pasur një ngarkesë të madhe, kanë menduar se, për të përballuar dhëni e mësimeve për studentët, ka qenë e mjaftueshme dituria që kishin. Në

mes pedagogëve ka edhe nga ata që edhe përgatitjes së teksteve u kanë shkuar mënjanë, edhe mësimet nuk i kanë dhënë në nivel, edhe ndaj kërkesave për studen-tët janë treguar liberalë. Mjaft gjëra të kësaj natyre kanë pasur disa nga këta në «bagazhin» e tyre. E bëra këtë dallim në radhët e pedagogëve që të mos futen të tërë në një «thes», se kështu do të ishte gabim. Nuk duhet ta shikojmë çdo gjë globalisht. Sikurse dënojmë praktikën e globalizmit në fushën e ekonomisë, edhe në fushën e arsimit duhet të ruhemë prej tij. Sigurisht, njerëzit t'i kritikojmë për të përmirësuar të metat, t'i mësojmë e t'i edukojmë me durim dhe të spastrojmë gradualisht terrenin që në universitet të mos na lëkun-det cilësia e mësimdhënies.

Sipas mendimit tim, më parë, duhet të caktohen njerëzit që nuk janë të aftë të jepin mësim në universitet, për shkak të kapacitetit të tyre të pamjaftueshëm, duke parashikuar edhe asfatet e zëvendësimit të tyre. Në të njëjtën kohë të mendohet se ku mund të dërgohen me punë ata që do të largohen. Me këta duhet bërë një punë politike bindëse për t'u sqaruar arsyet që imponojnë largimin e tyre nga shkollat e larta, si dhe për nevojat që kanë sektorët e tjerë të ekonomisë e të kulturës për punën e tyre. Edhe njerëzve që largohen nga universiteti për të meta të tjera, t'u thuhet të kenë të qartë se cilat kanë qenë gabimet e tyre, ku janë shfaqur ato etj.; të mendohet se kush do t'i zëvendësojë këta si pedagogë efektivë apo si pedagogë të jashtëm, me disa orë mësim në javë, pa shkëputje nga detyra që kanë etj.

E përsëris se në këtë proces punc duhet pasur kujdes që dhënia e leksioneve, përgatitja e studentëve etj.,

jo vetëm të mos dëmtohet, po për kundrazi të ecë normalisht dhe të kryhet gjithnjë e me nivel sa më të lartë shkencor. Për t'u arritur me sukses ky objektiv, kjo punë duhet menduar e duhet bërë mirë dhe me pjekuri. Kuadrot që do të largohen, të kuptojnë se zëvendësimi i tyre është i arsyeshëm dhe i domosdoshëm për interesat e përgjithshëm të ndërtimit socialist të vendit dhe për vetë interesat e tyre.

Për sistemin e kualifikimit të kuadrove në shkollat e larta, të institucioneve kërkimore-shkencore dhe të kuadrove me arsim të lartë që punojnë në prodhim, si dhe për dhënien e titujve shkencorë, unë kam folur me rektorin e universitetit¹. Mendimi im është se ne duhet të heqim dorë nga dhënia e titujve shkencorë për nam dhe për rrogë. Profesor Aleks Buda, që ka dituri të madhe, nuk ka menduar ndonjëherë për të marrë titull shkencor. Ai gjithë jetën ka mësuar sistematikisht, sepse e ka pasur pasion diturinë. Edhe sot, sado i shkuar në moshë, shoku Aleks vazhdon të mësojë. E quan profesor apo *professorissimo*², aq i bën atij; për të ka rëndësi futja përditë e më thellë në thesarët e panjohur të shkencës. Kështu i duam ne njerëzit tanë, prandaj t'i edukojmë të mos përpiken të marrin tituj sa për zë dhe për rrogë ose për të qëndruar në një vend, sa për t'u dukur dhe për të mos lëvizur andej. Njerëz të tillë nuk vlejnë për shkencën.

Ne duhet të shohim me kujdes se mbi ç'parime e ç'koncepte janë dhënë titujt shkencorë deri më sot te ne

1. Shih në këtë vëllim, f. 155.

2. Italisht — profesor i madh.

dhe t'i ndreqim të metat që vërehen. Ka shokë që u janië dhënë tituj shkencorë «Docent» ose «Profesor» në bazë të meritave që kanë treguar në fushën e zhvillimit të shkencës dhe të teknikës, si dhe në përgatitjen e kuadrove. Por, ka edhe ndonjë, që, ndonëse mban titullin «Profesor», në fakt, nuk e meriton atë, po të gjy-kohet nga puna dhe veprat e tij. Megjithatë ai hiqet i barabartë me ata që e meritojnë me të vërtetë këtë titull të lartë. Do të vazhdojmë ne t'ua japim titujt shkencorë këtyre «shkencëtarëve»? Mendimi im është që në asnjë mënyrë nuk mund të vazhdojmë të ecim në këtë rrugë.

Titulli shkencor duhet t'i jepet atij që me të vërtetë ka pasion për shkencën dhe këtë e tregon jo me përpjekjet që bën për të marrë një titull, por me veprimtarinë e dalluar, të vazhdueshme, të etshme e shumë të zellshme shkencore që zhvillon gjatë gjithë jetës së tij. Një njeri i tillë, kur zhvillon leksionet, e bën mësimin shumë interesant dhe tërheqës, sa auditori ku flet mbushet jo vetëm me studentët e kursit, por edhe me dëgjues të tjera, pse e dinë që në çdo leksion ai jep vazhdimisht të dhiёna të reja, për arsy se studion sistematikisht, megjithëse e ka kokën plot. Një kuadër i tillë i pasionuar nuk ndjek një metodë dhe formë shabllone në dhënien e mësimit, por çdo mësim të ri e zhvillon në forma nga më të ndryshmet, që dëgjuesve t'u tërheqë vëmendjen, t'u nxitë kuriozitetin shkencor dhe t'i kënaqë. Para këtij njerëzit janë gati të qëndrojnë edhe pesë orë për t'ia dëgjuar leksionin. Për një njeri si ky mund të thuhet se është plotësisht i përgatitur për ta merituar titullin shkencor dhe, sipas mendimit tim, ky

duhet të ishte edhe një nga kriteret për dhënien e këtij titulli. Po kemi ne njerëz të tillë? Unë mendoj se kemi shumë kuadro të ditur që kanë etje për t'u thelluar në fshehtësitë e shkencës dhe që janë të thjeshtë e të ndershëm.

Tani e tutje është e domosdoshme të përcaktohen kritere dhe rregulla, në mënyrë të tillë që titujt shkencorë të mos merren me lehtësi. Me «lehtësi» e merr titullin ai që ka punuar vazhdimisht tërë jetën, është përgatitur me kohë dhe plotësisht, ai që ka niësuar shumë kohë përpala jo për tituj shkencorë, po për t'u shërbbyer atdheut dhe Partisë.

Për kategorinë e personave që përpilen apostafat për të marrë një titull shkencor, «vrima e miut të bëhet 500 grosh», domethënë të bëjnë përgatitje me të vërtetë serioze dhe jashtëzakonisht të madhe në shërbim të shkencës dhe të shoqërisë, ndryshtë të mos u jepet titulli që synojnë të marrin. Përgatitja e madhe, për t'u futur në botën e shkencës dhe të teknikës dhe për t'u shquar në këto fusha, mund të bëhet vetëm me sakrifica të mëdha materiale, në kohë, në gjumë, në djersë etj., nga ai që dëshiron të kualifikohet. Kur njëri është dozent dhe synon të bëhet profesor, pasi kryen çdo ditë detyrën e dhënies së mësimit duhet të rrrijë pa gjumë gjer në orët e vona të natës, të pushojë e të flejë pak orë dhe të punojë e të studiojë 17-18 orë ditën.

Unë nuk jam dakord me ata që mendojnë se, për t'u kualifikuar, kuadrot me arsim të lartë duhet të shkëputen nga puna dhe t'i mbajë shteti në kurse. Po për të kryer një kurs kualifikimi për tre vjet rresht dhe më pas, një kurs tjetër për katër vjet, shteti do të mbajë

kuadrin shtatë vjet me radhë, përveç katër ose pesë vjetëve të ndjekjes së universitetit, që do të bëheshin kështu, gjithsej, 11-12 vjet. Po të veprohej në këtë mënyrë do të thotë që kuadri gjersa të kalojë moshën 30 vjeç, të mbahet nga prindërit dhe nga shteti. Jo, nuk është aspak e drejtë të veprohet kështu. Nuk më duket me vend praktika që ndiqet në disa raste për specializimin e kuadrove që vijnë nga rrëthet në Tiranë dhe rrinë thua jse kot, sikurse përmendi shoku Hysni për mjekët e ardhur në kryeqytet për specializim, ku bëjnë një punë fare të paktë. Në disa raste, specializimi i mjekëve nëpërmjet kurseve të kualifikimit është i nevojshëm, por mendoj të mos përgjithësohet për të tërë kjo formë pune. Në qoftë se një mjek dëshiron të bëhet, ta zëmë, kirurg për zemrën, ai duhet të vejë të punojë 8 orë në klinikën e sëmundjeve të këtij organi; të kontrollojë me kujdes të sëmurët dhe vetëm pasi të aftësohet në praktikë, mund të lejohet të bëjë kualifikim dhe të kryejë operacione. Në qoftë se dëshiron të bëhet klinicist, le të rrijë pas punës shumë orë të tjera me radhë natën me të sëmurët e shtruar në pavjonet e klinikës, për të vërejtur rastet më interesante që paraqiten, të studiojë vçprat e profesorëve të shquar të huaj për sëmundjet e zemrës; të mësojë si mendon njëri apo tjetri profesor për rastin që i ka dalë përpara; të formojë edhe vctë mendimin e tij, pastaj të kërkojë të kalojë në një kurs kualifikimi. Por, mua nuk më duket aspak e arsyeshme që kursanti pasi të dëgjojë dy orë leksion në një kurs kualifikimi, tri orë të tjera të qëndrojë në kafe, nga dy orë t'i kalojë duke biseduar me shokët, një orë duke shëtitur në park dhe vetëm dy orë të lexojë ndonjë li-

bër, ndërsa pagën ta marrë të plotë dhe të vetëkënaqet duke kujtar se di mjaft. Ca më keq është kur një njeri i tillë paraqitet në provim dhe e hedh «lumin» kollaj, sepse në komision ka «shokët» e tij! E përsëris dhe një herë, se ata që përgatiten të bëhen docentë apo profesorë, duhet të sakrifikojnë, të dërsijnë shumë që të bëhen me të vërtetë të aftë për ta merituar titullin që pretendojnë. Për të marrë tituj shkencorë është e domosdoshme të bëhet një punë shumë e madhe.

Po t'i pranojmë këto kritere në parim, atëherë del problemi i organizimit të punës. Në qoftë se nuk e organizojmë mirë këtë punë, nuk mund të realizohen lehtë detyrat që shtrohen. Unë ia kam thënë edhe rektorit të universitetit se ata që dëshirojnë të jenë profesorë duhet të studiojnë shumë e të jenë të kualifikuar, prandaj kanë punë të madhe për të bërë. Disa nga këta mund të jenë të moshuar, prandaj do të ishte mirë të lehtësos heshin ca nga puna sepse, përveç që do të japid leksione etj., do t'u duhet edhe të studiojnë.

Kam edhe një vërejtje tjeter. Nuk më duket e arsyeshme dhe as e drejtë dhënia e titujve shkencorë sipas një sistemi unik kualifikimi për punonjësit e shkollave të larta dhe për ata të prodhimit. Punonjësit mësimorë-shkencorë të shkollave të larta dhe kuadrot me arsim të lartë specialistë të prodhimit, nuk mund të marrin të njëjtë tituj shkencorë, se janë në profile pune të ndryshme. Në qoftë se kemi caktuar, për shembull, një kuadër specialist për t'u marrë me punë kërkimore-shkencore në një degë të kimisë, ky, për të marrë titullin shkencor duhet të kualifikohet në një mënyrë të ndryshme nga punonjësit mësimorë-shkencorë të shkollave

të larta. Për këtë çështje unë kam biseduar edhe me shokun Ramiz Alia.

Masat për kualifikimin e specialistëve të prodhimit janë tjetër çështje. Kjo punë të mos futet në ingranazhin e dhënies së titujve që edhe punonjësit e prodhimit që nuk merren me punë pedagogjike, të marrin titullin «Docent», «Profesor» etj., njëloj si punonjësit e institucioneve mësimore-shkencore. Ndoshta gabohem, por kështu e mendoj unë këtë çështje.

Çështjen e dhënies së titujve, mendoj ta pranojmë në parim. Por, para se të vihet në jetë, duhet të mendohet mbi të gjitha aspektet e organizimit të saj, domethënë të studiohet në cilat degë do të fillohet, kur, për cilët kuadro, me çfarë kriteresh do ta bëjmë kualifikimin pasuniversitar, duke përfshirë edhe punonjësit e prodhimit etj.

*Etohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbal i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH,
që gjendet në AQP*

ÇËSHTJET QË NGRENË KOMUNISTËT TË STUDIOHEN NË MËNYRË SHKENCORE NGA KOMITETET E PARTISË

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

27 prill 1973

Në Parti kemi shokë të vjetër, kemi shokë me stazh mesatar, kemi dhe shokë të rinj; në Parti kemi, gjithash tu, punëtorë të industrisë, të tregtisë, të komunales, të cilët quhen që të gjithë punëtorë; kemi edhe fshatarë kooperativistë.

Si u kanë qëndruar problemeve që shtroi Partia kohët e fundit këto kategori komunistësh? Çfarë konkluzionesh janë nxjerrë nga punimet e matrialeve të fundit në Parti²? Është përcaktuar metoda se si do të

1. Në këtë mbledhje u diskutua për përbërjen, shtrirjen dhe shpërndarjen e forcave të Partisë.

2. Në këtë kohë në Parti po punoheshin fjalimet e shokut Enver Hoxha në Presidiumin e Kuvendit Popullor, të 9 janarit 1973, dhe në mbledhjen e përgjithshme të komunistëve të aparatit të KQ të PPSH, të 15 marsit 1973, kushtuar luftës kundër shfaqjeve të huaja dhe qëndrimeve liberale ndaj tyre. (Shih në këtë vëllim, f. 1 dhe 293.)

nxirren këto konkluzione, ku do të synohet, çfarë plan pune do të ketë komiteti i Partisë?

Unë mendoj se duhen parë jo vetëm problemet, po edhe vetë qëndrimi i komunistëve ndaj këtyre problemeve. Të analizohet mirë dhe realisht gjendja e këtyre grupeve të komunistëve. Për shembull, gjendja e punëtorëve komunistë të kësaj apo të asaj kategorie, e fshatarëve, e intelektualëve, gjendja e komunistëve të moshuar dhe e të rinjve etj. Komunistët kurdoherë duhet të janë në pararojë, se janë nga njerëzit më të mirë, po ne flasim për disa shfaqje të huaja që manifestohen në disa anëtarë të Partisë. Ka që janë përtacë, disa të tjerë që duhen nxitur për të punuar më mirë etj. Pra, nuk e kemi fjalën për gjithë komunistët.

Komiteti i Partisë i rrethit duhet të ketë një plan pune për të ndjekur tërë ato probleme që kanë dalë në mbledhjet e organizatave-bazë të Partisë, gjatë punimit të materialeve të fundit në Parti. Çështjet që kanë dalë gjatë diskutimeve nga komunistët në mbledhjet e organizatave-bazë të Partisë ai duhet t'i nxjerrë, t'i studiojë në mënyrë shkencore dhe mbi këlo baza të nxjerrë konkluzione e detyra dhe të marrë vendime. Mund të ndodhë që një shok i vjetër nuk diskuton gjithnjë në mbledhjet e organizatës-bazë të Partisë. Por ai mund të jetë një shtyllë e organizatës së Partisë. Nuk është e thënë që ai të diskutojë sa herë që bëhet mbledhja e organizatës. Ai diskuton rrallë, po ama kur diskuton, i trajton mirë problemet dhe jep shembullin i pari për zgjidhjen e tyre në praktikë. Prandaj nuk mund të gjykojen njerëzit nga sasia e diskutimeve, po nga karakteristikat e diskutimeve dhe nga veprimet e tyre praktike.

Në qëndrimet ideologjike dhe politike shokët e vjetër komunistë, ndonjëherë, akuzohen nga të rinjtë për sektarizëm apo për konservatorizëm. Po në klasën punëtore si gjykohen në përgjithësi qëndrimet e shokëve të vjetër, janë revolucionare, të drejta apo konservatore? Punëtorët e vjetër nuk janë shumë të ngritur nga ana teorike, kurse të rinjtë janë me arsim. Mos është dukur tek të parët ndonjëfarë xhelozie ndaj specialistëve të rinj që po dalin tani? Mos u është dukur sikur këta sheshin mend? Në një mënyrë ose në një tjetër, koncepte të tillë janë frenuese. Por, a ka ekzistuar një fenomen i tillë te shokët e vjetër? Këta, sigurisht, nuk janë shokë të këqij, janë të mirë, janë nga shokët më të mirë dhe besnikë të Partisë dhe, kur e kuptojnë dobësinë e tyre, dinë t'i zgjidhin mirë problemet.

Gabimet dhe kritikat duhet të bëhen objekt i veçantë diskutimi edhe në komitetin e Partisë. Keni nxjerrë ju¹ konkluzione, për shembull, pse ka një rënie në pranimin e shoqeve në Parti, sidomos në fshat? Mua më duket se shkak për këtë është konservatorizmi. Ja, për shembull, në rrëthin e Korçës, në Pojan, ku ka gra komunistë, nuk është problem konservatorizmi, kurse në Gorë ka konservatorizëm. Prandaj të nxirrni konkluzione për këtë problem dhe të organizoni punën që pranimi i shoqeve në Parti të bëhet me ritmet e duhura.

Ose një problem tjetër: Ç'karakteristika shihni ju te komunistët pensionistë, se tani këta nuk punojnë si më parë. Duke qenë në pension, natyrisht, komunisti i vje-

1. U drejtohet sekretarëve të komiteve të Partisë të rretheve, që merrnin pjesë në këtë mbledhje.

tër është angazhuar në punë shoqërore, por ai ka mendime. Këto mendime që shfaqin këta, janë në rrugë të drejtë? Ka te këta një objektivitet marksist? Për shembull, pesë pensionistë kanë punuar në një ndërmarrje mekanike; janë komunistë të vjetër e të respektuar. Megjithëse janë në pension, ata interesohen për uzinën ku kanë punuar dhe herë pas here venë shikojnë atje çfarë po bëhet. Ata duhet të hyjnë e të shikojnë në uzinë, të marrin kontakt me shokë punëtorë dhe me udhëheqës të uzinës, të bëjnë edhe pyetje, kur kanë. E kam çështjen që këta shokë, megjithëse janë pensionistë, duhet të ndiejnë shqetësim për fabrikën apo për uzinën ku kanë punuar dhe si komunistë të vërtetë, t'u transmetojnë të rinjve përvojën, t'u thonë drejtuesve të ndërmarrjes, drejtorit, kryeinxhinierit dhe inxhinierëve mendimet që kanë për organizimin sa më të mirë të punës në prodhim. Fjala vjen, mund t'u thonë që këtu apo atje puna nuk është organizuar mirë, që normat janë shumë të ulëta e duhet t'i ngrenë; që gjatë punës nuk punohet si duhet, po bëhet muhabet etj. Partia jo vetëm duhet t'i lejojë ta bëjnë ata këtë punë, po kjo të konsiderohet si një ndihmë e madhe, se janë shokë të vjetër dhe për ta Partia duhet të ketë konsideratë. Këta shokë kanë dalë nga këto uzina dhc duhet të ndihmojnë gjithnjë për zbatimin e vijës së Partisë, duke dhënë këshilla. Në qoftë se pensionistët komunistë nuk shfaqin asnjë mendim për punën e ndërmarrjes, atëherë si qëndrojnë këta ndaj problemeve, janë konsekuentë apo vijnë sa për t'u bërë qejfin shokëve të ndërmarrjes, duke thënë pastaj «vajtëm, po nuk thamë gjë».

Pikërisht, për këtë e kam fjalën unë. Duhen nxjerrë

konkluzione për grupet e ndryshme të komunistëve, të shohim ç'mendime e ç'koncepte kanë për çështjet e ndryshme ideologjike që po diskutohen tanë në Parti, cilat janë anët e mira, po dhe cilat janë dobësitë e tyre, në mënyrë që të veprohet nga organizatat e organet e Partisë për të përballuar me sukses problemet që lindin.

*Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbali i mbledhjes së Sekre-
tariatit të KQ të PPSH,
që gjendet në AQP*

VËSHTIRESITË KAPËRCEHEN ME PLANIFIKIM E ORGANIZIM TË MIRE

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH^t*

27 prill 1973

Dëshiroj të theksoj vetëm atë që tha në fund të diskutimit të tij shoku Petro Dode, çështjen e eksperimentimit shkencor, të cilin sivjet duhet ta zbatojmë më me këmbëngulje se çdo vit tjetër, për arsyet e pengesave që na ka sjellë moti i keq. Këto pengesa nuk duhet t'i nën-vlerësojmë, por njëkohësisht të mos mbivlerësojmë as forcën tonë organizative, punën për gatishmërinë e mekanikës, për grumbullimin e plehrave, masat përgatitore që duhet të marrim për kullimin e tokave ose për ujitten. Është e domosdoshme që problemin ta shikojmë me seriozitetin e duhur; në rast të kundërt, do të gjendemi përpëra vështirësive të mëdha ekonomike. Kapërcimi i vështirësive që na u krijuan nga kushtet atmosfe-

-
1. Në këtë mbledhje u diskutua për zbatimin e detyrate të Plenomit të 2-të të KQ të PPSH për eksperimentimin shkencor dhe për përhapjen e eksperiencës së përparuar në bujqësi.

rike kërkon një organizim shumë të fortë, një objektivitet të madh dhe masa serioze nga Partia dhe të gjithë punonjësit, me qëllim që të përballohet situata e krijuar. Bimët që janë mbjellë me kohë në ara, si, për shembull, gruri, i cili paraqitet mirë, mund të na rrezikohet nga zhvillimi i barërave të këqija. Prandaj tëharrja apo luf-timi i tyre me herbicide përbën një detyrë nga më të rëndësishmet. Kësaj pune duhet t'i dalim përpara, duke organizuar mirë luftën për të shpëtuar grurin, ndryshe ai do të na ikë nga duart.

Eshtë e vërtetë se shokët e rrethit të Korgës, megji-thëse me një muaj vonesë, e mbollën panxharin. Kjo bimë, në kushtet e këtij viti, ka përpara akoma rreziqe të mëdha. Në rast se nuk mobilizohet Partia, të gjithë punonjësit e ndërmarrjeve bujqësore dhe të kooperati-vave për të menduar e për të vepruar me një ndjenjë të lartë përgjegjësie për atë se çfarë duhet bërë akoma më shumë me panxharin, atëherë nga kjo bimë e mbjellë me një muaj vonesë, nuk do të marrim rendimentin e parashikuar; do të humbasim kështu, si në përqindjen e përbajtjes së sheqerit në panxhar, ashtu edhe të prodhimit të sasisë së pritur të sheqerit, gjë që është me pasoja të rënda për ekonominë popullore. Duhet të dimë se në tregjet e jashtme çmimi i sheqerit ka hipur në qiell. Ai është ngritur afro tri herë. Prandaj ndonjë shok të mos mbajë shpresa tek importimi i sheqerit; përkundrazi, të luftohet për ta sigruar atë në vend. Kjo do të thotë të mos kënaqemi vetëm me mbjelljen e panxharit, pse nesër kundër tij mund të dalin dëmtues e sëmundje që e shfarosin në rast se nuk do të marrim masa t'i luftojmë; pasnesër mund të kërkohet prashitja, kur ne

të jemi të zënë me shumë punë të tjera e me të tjera shërbime që ju i dini më mirë se unë.

Në qoftë se nuk i planifikojmë mirë këto detyra dhe në qoftë se nuk i organizojmë mirë punët për realizimin e tyre me përgjegjësi të plotë e me afate të caktuara rreptësisht për çdo kooperativë e brigadë, në qoftë se nuk do të zbatojmë si duhet detyrat agroteknike, që janë jetike për zhvillimin e bimëve, nuk do të mundim të sigurojmë sasinë e nevojshme të perimeve në qytete dhe në fshatra. Për këtë problem duhet të mendojmë të gjithë seriozisht. Bimët e mbjella, që janë prishur nga moti i keq, duhet t'i zëvendësojmë sa më parë dhe t'u bëjmë shërbimet e nevojshme që të zhvillohen e të piqen sa më shpejt.

Është fakt se këtë vit me mbjelljet e të gjitha bimëve pranverore, në krahasim me vitin e kaluar, jemi shumë vonë. S'ka nevojë të themi përqindjet, pse gjendja flet vetë. Shkaku nuk është te mungesa e gatishmërisë. Të gjithë thonë se «kemi qenë dhe jemi në gatishmëri, po s'na mbajti koha». Edhe tani thuhet se «të gjithë traktorët janë në gatishmëri». Megjithatë nuk është keq të kontrollohet kjo detyrë, që të sigurohemë mirë nëse gjithë traktorët janë me të vërtetë në gatishmëri të plotë dhe, apo të hapë koha, të futen menjëherë në ara, me qëllim që mbjelljet të përfundojnë mirë dhe shpejt. Askush nuk duhet të thotë «kemi kohë», sepse kohë nuk ka. Këtu është punë cikli dhe kur ky cikël kalon, bima nuk zhvillohet mirë dhe s'mund të merret prej saj rendimenti i pritshëm. Prandaj kërkohet punë intensive dhe të tregohet kujdes gjatë çdo procesi. Kështu, edhe pse farën mund ta hedhim në tokë e ta mbje-

Ililm me kujdes, megjithatë puna nuk mbaron me kaq, ajo vazhdon, se pastaj vjen mbirja, pas së cilës kërkohen të bëhen të gjitha shërbimet e tjera në front dhe në të tëra bimët, pa neglizhuar asnje prej tyre, derisa të realizohet prodhimi. Kjo është një punë kolosale për Partinë, për kooperativistët, për punonjësit e SMT-ve etj.

Detyra të tillë janë shtruar vazhdimisht dhe të gjithë shokët, punonjësit dhe drejtuesit, kanë në këtë drejtim një eksperiencë të pasur. Megjithatë, duhet pranuar se nuk është përdorur kurdoherë e gjithë mekanika e madhe dhe e vogël bujqësore; për të ka shpeshherë mungesë interesimi. Nuk përdoren mirë sidomos makinritë e vogla, të produara nga uzinat tona; ato pri shen duke qëndruar pa u shfrytëzuar në depot e kooperativave bujqësore. Prandaj, është mirë të organizohet menjëherë kontrolli i të gjitha depove dhe të vihet në shfrytëzim sa më parë çdo mekanizëm. Duhet të marrë fund njëherë e mirë ai mentalitet që ekziston te disa, se «nuk mund të hyjë në prashitje kultivatori», «nuk mund të hyjë në arë ky apo ai mekanizëm». Të kemi parasysh, shokë, se nuk mund të përballohet prashitja e të gjitha bimëve vetëm me shatë, prandaj është prodhuar kultivatori, ndryshe na mbeten shumë hektarë pa prashitur. Dhe, pa u kryer ky proces i rëndësishëm pune, s'mund të merren rendimente të larta nga asnje bimë.

Mundësitë janë që planet t'i realizojmë, pavarësisht se koha ka qenë dhe vazhdon të jetë e disfavorshme. Duhet t'i kthejmë në realitet këto mundësi, që të merren prodhime të bollshme për plotësimin e nevojave të popullsisë, si në fshat, ashtu edhe në qytet. Nga jashtë nuk kemi mundësi të sjellim çdo gjë. Të mobilizojmë njerë-

zit, që me punë t'u dalim përpëra situatave që mund të na krijohen nga koha e keqë se, nuk dimë akoma si do të jetë më vonë dhe mund të vijë një thatësirë e madhe ose mund të bien shira njëri pas tjetrit që, po të mos kemi në gatishmëri rrjetin kullues, do të na dëmtojnë. Në rast se nuk i kuptojmë seriozisht këto çështje, gjendja do të rëndohet edhe më shumë. Në qoftë se Tepelena ka nën ujë një të tretën e tokës së punueshme, në këtë rreth duhet të bëhen të gjitha përpjekjet që në këtë si-përfaqe të merren doemos rendimente të larta në misër e në të gjitha bimët e tjera. Për këtë Partia dhe punonjësit në rreth duhet të vihen që tanë në lëvizje. Prandaj, të krijohen ekipe për të ndihmuar në konkretizimin e detyrave, në organizimin e punës, në rritjen e mobilitimit të masave dhe jo të thuhet: «S'kemi forca pune, s'kemi shata, s'kemi lopata», ose «Na zuri puna nga të katër anët», «S'kemi traktorë», «S'kemi kultivatorë për të bërë prashitje» etj., kur, në fakt, këta janë, po nuk përdoren. Kjo do të thotë të jetosh në një konfuzion të madh, të kesh mungesë organizimi, rregulli e disipline, prandaj të punohet me mend në kokë që këto të vendosën kudo.

Situatën që është krijuar nga Partia, veçanërisht në fshat, ku ka shpërthyer një mobilizim i gjërë për punët e stinës, ta mbajmë ngritur vazhdimisht. Nuk lejohet që më vonë të vijë ndonjë e të thotë se kaq ose aq forca nuk na dalin në punë. Njerëzit do të dalin në punë me siguri, në qoftë se ne dimë ta shtrojmë çështjen, në qoftë se mbajmë të ndezur situatën optimiste që është krijuar, në qoftë se organizojmë punën kudo mirë. Shkurt, të kemi të qartë se para Partisë në qendër e në

rrethe shtrohen detyra shumë të mëdha, që nuk janë të lehta për t'u kryer, si nga ana shkencore e teknike, ashtu dhe nga ana praktike, organizative e ideopolitike. Ndaj, është e domosdoshme të merren të gjitha masat për t'i plotësuar ato, me qëllim që të mos krijojmë deficite në realizimin e planit.

*Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbali i mbledhjes së Sekretariatit të KQ-të PPSH,
që gjendet në AQD*

SHKËMBIMI I MENDIMEVE MIDIS MASAVE DHE UDHEHEQËSVE ËSHTË KURDOHERË I DOBISHËM

*Nga biseda me një grup punëtorësh
të rrëtheve Tiranë, Durrës dhe Elbasan¹*

28 prill 1973

Si jeni me shëndet shokë? Si janë shokët punëtorë që punojnë së bashku me ju nëpër uzina, fabrika, stacione makinash dhe traktorësh dhe në qendra të tjera prodhimi?

Jam tepër i gjuar që erdhët sot këtu, në aparatin e Komitetit Qendror të Partisë, të piqemi dhe të shkëmbjmë ndonjë mendim së toku. Bisedat me njerëzit kanë rëndësi të madhe për ne, pse shkëmbimi i mendimeve midis masave dhe udheheqësve është kurdoherë i dobishëm për Partinë dhe për popullin. Unë mendoj se takime të tilla duhet të bëhen vazhdimit, jo vetëm me

1. Në këtë takim, që u organizua në selinë e Komitetit Qendror të PPSH, morën pjesë edhe anëtari i Byrosë Politike dhe sekretar i KQ të PPSH, shoku Hysni Kapo, anëtari i Byrosë Politike të KQ të PPSH dhe President i Këshillit Qendror të BPSH, shoku Rita Marko, anëtari i KQ të PPSH, shoku Pirro Kondi, si dhe shokë të tjerë.

grupe të mëdha punëtorësh të disa rretheve, por edhe me 5-6 punëtorë apo kooperativistë të një ndërmarrjeje ose kooperative bujqësore, që kërkojnë takim me shokët e udhëheqjes së Partisë e të shtetit. Kjo do të jetë një kënaqësi e madhe, sidomos për ne, sepse ju, shokë punëtorë, me punën tuaj plot vetëmohim na frysëzon e na mësoni. Ju keni mjaft probleme për të cilat nuk ju zë as gjumi, prandaj kur e çmoni të nevojshme se duhet të takoheni me mua, i thoni sekretarit të organizatës-bazë të Partisë në ndërmarrjet ku punoni se, për këto çështje, dëshironi të piqeni me shokun Enver, osc me ndonjë shok tjetër të udhëheqjes së Partisë apo të shtetit. S'ka kënaqësi më të madhe për mua dhe për shokët e tjerë kur këmbejmë mendime me njerëzit e klasës. Në këto bashkëbisedime nuk do të bëjmë filozofi, pse as unë, as ju nuk jemi filozofë, por do të bisedojmë lirisht, thjesht, në mënyrë krejt popullore, me qëllim që të nxjerrim përfundime të rëndësishme që i vlejnë punës së Partisë, teorisë dhe praktikës revolucionare të saj. Kështu na mëson Partia ta kuptojmë rëndësinë e madhe të takimeve midis udhëheqësve dhe masave.

E vërteta është se ne duhet të vijni vazhdimit te ju, por me gjithë dëshirën e madhe që kemi, nuk mund të shkojni tek të gjithë. Pastaj, mos harroni se edhe mosha sikur na ka ikur një çikë dhe, pak a shumë na pengon për lëvizje më të shpeshta. Po pavarësisht nga këto, të përpinqemi që edhe ju, edhe ne, të shkojmë e të vijmë më shpesh te njëri-tjetri, sepse kemi nevojë për shoku-shokun. Bashkëpunimi i ngushtë midis nesh është i domosdoshëm dhe jetik. Këshillat dhe sugjerimet e klasës janë vendimtare për Partinë tonë, për të tash-

men dhe për të ardhmen e socializmit. Asnjë ngurrim nuk duhet të keni për të ardhur këtu, në Komitetin Qendror të Partisë dhe për të parashtruar mendimet tuaja. Neve, Partia na i ka ngarkuar këto detyra jo për të qenë fodullë, po për të mbrojtur interesat e klasës, për të punuar me vetëdije të pastër, ashtu sikurse punoni ju dhe të gjithë njerëzit e tjerë të thjeshtë në atdheun tonë socialist.

Partia kërkon nga secili prej nesh që detyrat të kryhen mirë, pa na u rritur mendja nga sukseset që arrihen dhe pa synuar ruajtjen e karriges. Që punët të kryhen mirë, është e domosdoshme të punojmë në bazë të vijës dhe të mësimeve të Partisë, duke diskutuar me zeniér të hapët të mirat dhe të metat e punës, duke shkëmbyer mendimet që të gjendet rruga më e drejtë për të mirën e përgjithshme të atdheut tonë dhe të popullit. Dëshiroj ta mbani mirë në mendje këshillën timë për të ardhur këtu sa herë që e çmoni të nevojshme.

Më bëhet zemra mal që ju shoh të tërëve si lastarë të rinj! U përpoqa të dalloj midis jush ndonjë nga shokët e brezit tonë, si me thënë, ndonjë shok punëtor pak të shkuar në moshë, por nuk po shoh asnjë. Kjo ka ndodhur jo për arsy se gjithë të kaluarit në moshë kanë dalë në pension, por se ata, ashtu sikurse i ka mësuar Partia, kanë respekt të madh për të rinjtë dhe dëshirojnë që të vini ju në takime të tilla. Brezi i ri rrjedh nga brezi i vjetër, është gjak i gjakut të tij dhe i takon të marrë stafetën e ta çojë më përpëra në rrugën e drejtë të Partisë. Të rinjtë tanë e meritojnë nderin dhe besimin që u ka dhënë Partia. Sigurisht edhe punëtorët e rinj kanë respekt të madh për punëtorët më të moshuar, me

të cilët punojnë së bashku, sepse ata kanë një eksperiencë shumë të madhe, sepse ata nuk mungojnë t'u rrinë afër, t'i këshillojnë, t'i edukojnë dhe t'i nxitin për të ecur përpara. Që të ecet në një front të përbashkët ka rëndësi të madhe çështja e bashkimit si një trup i vetëm midis brezit më të ri dhe atij më të vjetër. Kur flas për brezin e të moshuarve, kam parasysh edhe veten time, megjithëse e ndiej veten akoma të ri, vetëm se kam një të keqe që pi shumë cigarc.

Këto shoqet, besoj, do të na lejojnë të pimë nga një cigare. Urdhëroni, shokë, ndizeni dhe mos kini turp të merrni edhe biskotat që na kanë sjellë këtu. Ju, shoqe, meqenëse nuk pini cigare, merrni biskota. Këtu jeni si në shtëpinë tuaj.

Jam në dijeni të punës së mirë që bëni dhe për këtë gjëzohem pa masë, po do të kënaqesha në goftë se ndonjëri prej jush që punon në kombinat, në uzinë apo në SMT do të më fliste shkurtimisht për punën në përgjithësi.

Në këtë takim ka shokë dhe shoqe të ardhura nga Tirana, nga Durrësi dhe nga Elbasani. Sido që punëtorët e Tiranës janë më të vjetër në industri, edhe ata të Durrësit nuk mbeten pas. Megjithëkëtë do të na vinte mirë sikur të na flasë pak Mehmeti [Bekteshi], i cili punon në Kombinatin Metalurgjik të Elbasanit, një nga veprat tona më të mëdha industriale që presim me padurim të përfundojë.

SHOKU MEHMET BEKTESHI: Ne, shoku Enver, do ta bëjmë realitet fjalën e dhënë përpara Partisë dhe përpara Jush.

SHOKU ENVER HOXHA: Sivjet ju ndërtuesit e

këtij kombinati do të keni front të gjerë pune, pasi projektet do t'i keni të gjitha.

SHOKU MEHMET BEKTESHI: Po, i kemi të gjitha, shoku Enver. Bazamentet e furrnaltës së parë janë kompletar, brenda muajit qershor do të marrë fund edhe ndërtimi i basenit. Uzinën mekanike e përfunduam së ndërtuar.

SHOKU ENVER HOXHA: Kjo uzinë do të jetë dy herë më e madhe nga uzina «Traktori». Ju, shokët, që punoni në uzinën «Traktori» mund të mburreni tani sa nuk ka filluar punën uzina mekanike e Kombinatit Metalurgjik të Elbasanit, se pastaj ajo do t'jua kalojë, do ta zërë vendin e parë në republikë.

SHOKU MEHMET BEKTESHI: Tani vetëm montimet e kësaj uzine na mbeten për të bërë. Kuadri po përgatitet në proceset teknike. Kombinati Metalurgjik ka një forcë të madhe punëtore, të ardhur nga të gjitha rrethet e Shqipërisë, prandaj do të mobilizohemi për të realizuar detyrat.

SHOKU ENVER HOXHA: Po, ju duhet të mobilizoheni e të bëni çdo përpjekje për të plotësuar boshllëqet e shkaktuara nga vonesa që patëm në ndërtimet duke luftuar që kombinatin ta ndërtojmë në afat.

Jo vetëm ndërtimi i kombinatit, por edhe montimi dhe përvlefësimi i proceseve të punës në metalurgjinë e zezë janë probleme shumë të ndërlikuara. Të mbajmë parasysh faktin se ne nuk kishim ide dhe as më të voglën eksperiencë për vepra të tilla kaq të mëdha e të vështira. Ju, shokët që punoni në uzinën «Traktori» dhe të tjerët që kanë reparte shkrirjeje me furra çeliku, natyrisht, i kuptioni më mirë këto vështirësi dhe e merr-

ni me mend se ç'do të thotë shkrirje e mineralit në një shkallë kaq të gjerë, në sasi kaq të mëdha siç do të arrihet në Kombinatin Metalurgjik në Elbasan, ku do të prodhohen afër 48-49 marka çeliqesh. Vetëm procesi i punës për ndarjen e mineraleve është mjaft i ndërlikuar, pa zënë në gojë pastaj punët e tjera dhe vështirësitë që ato paraqesin.

Para kësaj gjendjeje është e domosdoshme që komunistët dhe tërë punonjësit të punojnë me disiplinë të fortë, të ndjekin me shumë zell e vëmendje mësimin e proceseve të ndërlikuara teknike, sepse puna në Kombinatin Metalurgjik nuk mund të ecë duke u kaluar detyrave në sipërfaqe. Punëtorët tanë të përpilen të bëhen specialistë në profesionin e tyre dhe ta zotërojnë atë. Në qoftë se gjetkë kanë arritur që specialistët e mesëm, të cilët janë baza e punës në industri, të bëhen mjeshtër të mbaruar në një periudhë dhjetë ose pesëmbëdhjetëvjeçare, specialisti i mesëm te ne, për shembull, mekaniku i mesëm, duhet të perfektionohet përgjashtë vjet. Prandaj ju, specialistët e shquar në punë, që punoni në Kombinatin Metalurgjik dhe në objekte të tjera, që vërtet nuk jeni inxhinierë, por që jeni perfektionuar në punë si inxhinierë, cilësitet tuaja të rralla dhe zotësinë që keni fituar duhet t'i zhvilloni edhe te punëtorët e tjerë. Kjo është e domosdoshme të bëhet, sepse siç thotë populli: «Me një lule nuk vjen behari». Ju uroj suksese në këtë drejtim.

SHOKU HAMDI GJINI¹: Jam shumë i gëzuar që

1. Në atë kohë montator në Ndërmarrjen e Ndërtimit të Linjave të Tensionit të Lartë.

m'u dha rasti të takohem e të bisedoj personalisht me Ju, shoku Enver. Kjo është kënaqësia më e madhe në jetën time. Unë dhe shokë të tjerë kemi punuar në shumë objekte të qyteteve e të rretheve të republikës, por kudo ku kemi qenë kemi ndier kujdesin e madh të Partisë, e kemi ndier veten kurdoherë në gji të saj, kemi menduar se ajo është me ne aty në pyll, në mal e kudo.

Neve, punëtorëve që punojmë në tensionin e lartë, na dolën detyra shumë të mëdha nga Plenumi i 4-t¹ i Komitetit Qendror të Partisë për elektrifikimin e të gjithë vendit. Detyra jonë ishte që ta zbatonim me përpikëri dhe në kohën e duhur vendimin historik të Partisë dhe porosinë Tuaj shoku Enver, për të çuar dritën elektrike në çdo fshat të Shqipërisë. Prandaj mobilizimi i kolektivit tonë qe i gjithanshëm. Sigurisht, gjatë punës kemi pasur edhe të meta, të cilat tani, pas fjalës Suaj të 15 marsit, po bëjmë përpjekje më të mëdha për ti zhdukur.

Kur më lajmëruan se do të vija në takim me Ju, shoku Enver, kolektivi e brigada ku punoj më porositën t'ju premtoj, se vendimet e Partisë dhe porositë Tuaja në fjalën e 15 marsit do t'i bëjmë realitet, nuk do të lejojmë të shkelet disiplina proletare dhe do të zbatojmë detyrat e mëdha që na beson Partia.

1. Ky Plenum u mbajt në datën 11-12 dhjetor të vitit 1967 dhe vendosi përfundimin e elektrifikimit të të gjitha fshatrave të vendit deri më 8 Nëntor 1971.² Me punën heroike të popullit, të udhëhequr nga Partia elektrifikimi përfundoi më 25 tetor 1970, 13 muaj para afatit dhe 15 vjet përpëra nga sa parashikonte plani perspektiv.

SHOKU ENVER HOXHA: Në emër të Partisë i falënderojnë shokët që punojnë në ndërmarrjen për ndërtimin e linjave të tensionit të lartë dhe ju urojmë atyre suksese të mëtejshme në punë.

SHOKU IRAKLI SFILE¹: Jam murator, punën e kam filluar që në moshën 15 vjeç.

SHOKU ENVER HOXHA: Po, profesioni i muratorit është i nderuar dhe shumë i vlefshëm.

SHOKU IRAKLI SFILE: Në punën që bën ndërmarrja jonë për ngritjen e ndërtesave ka edhe të meta, sidomos në drejtim të cilësisë. Prandaj është detyra jo-në që këto ndërtesa t'i bëjmë me një cilësi sa më të mirë, por, që t'ia arrijmë këtij qëllimi, në radhë të parë, duhet të kemi ndërgjegje të lartë. Tani ne kemi marrë një sërë masash në drejtim të dorëzimit të objekteve me cilësi dhe në afatet e caktuara. Kështu kemi vepruar sidomos në ndërtesat e uzinës «Traktori», të Kombinatit Poligrafik, të pasurimit të qymyrit në Valias e në një sërë objektesh të tjera, si ai i Kombinatit të Pulave, ku kemi bërë një gjashtë magazina, të cilat i kemi dorëzuar dhe kombinati ka filluar punën, duke marrë 8 mijë e ca kokrra vezë në ditë.

SHOKU ENVER HOXHA: Ky kombinat do të arrijë të japë disa milionë kokrra vezë në vit.

SHOKU IRAKLI SFILE: Ne kemi pasur probleme për sa u përket të rinjve muratorë, për të ngjallur tek ata më shumë dashurinë për profesionin dhc, pavarësisht

1. Në atë kohë punëtor në ndërmarrjen «21 Dhjetori», në Tiranë.

se sot disa të rinj nuk po e plotësojnë normën, ne jemi të bindur se ata do ta realizojnë në të ardhmen.

SHOKU DANIEL PRIFTI¹: Unë punoj në Oficinën e Drejtorisë së Shfrytëzimit të Hekurudhave në Durrës.

SHOKU ENVER HOXHA: E keni mekanizuar ngarkim-shkarkimin?

SHOKU DANIEL PRIFTI: Mund të them se kemi mekanizuar 78 për qind të të gjitha proceseve të punës. Kemi bërë me forcat tona disa vinça, që më përpara importoheshin.

SHOKU AVDULLA KRUTANI²: Mësimet e Partisë dhe Tuajat, shoku Enver, i kemi pasur e i kemi vazhdimisht në mendje e në zemër dhe gjithnjë po punojmë për ngritjen e cilësisë dhe të disiplinës së punës, të kurssimit të lëndës së drurit dhe të zëvendësimit të prodhit me dru arre me drurë të tjerë. Dihet se arra rritet me vështirësi dhe na siguron valutë.

SHOKU ENVER HOXHA: Harxhimi pa kursim i lëndës së parë të drurit është një problem që ka ekzistuar edhe më parë.

SHOKU NESIP IBRAHIMI³: Avdullai është nga ata punëtorë, shoku Enver, që e vazhdon punën me ritmin që filloi 26 vjet më parë. Ai është iniciator për normat dhe për shumë çështje të tjera.

1. Në atë kohë punëtor, novator në Oficinën e Drejtorisë së Shfrytëzimit të Hekurudhave në Durrës.

2. Në atë kohë punëtor në fabrikën e mobilieve të kombinatit «Misto Mame», Tiranë.

3. Në atë kohë kryetar i bashkimeve profesionale të rrëthit të Tiranës.

SHOQJA YLVIE SAKO¹: Edhe ne në kolektivin tonë po punojmë për të vënë në jetë mësimet e Partisë dhe Tuajat, shoku Enver, për t'i bërë ballë rrëthimit imperialisto-revisionist, për të forcuar vigjilencën dhe përtë realizuar detyrat. Si çdo fjalim Juaji edhe fjala e 15 marsit e këtij viti na ka bërë ta shohim punën tonë me një sy të thelië kritik, sidomos përmirësimin e cilësisë.

SHOKU PETRIT SINA²: Jam shumë i gjëzuar që m'u dha rasti të takohem me Ju, shoku Enver. Jam krenar për këtë nder dhe besim që më dhanë Partia dhe klasa punëtore e uzinës ku punoj. Pas fjalimeve Tuaja të fundit, klasa punëtore në uzinë është mobilizuar si asnjëherë tjetër dhe ka arritur rezultate shumë të mira. Ne, shoku Enver, kemi pasur skarcitet të madh, sidomos në repartin e gizës. Për këtë problem zhvilluam mbledhjen e hapur të organizatës së Partisë ku mori pjesë edhe shoku Pilo Peristeri³, i cili është gjithnjë atje, bashkë me punëtorët, në çdo repart dhe në çdo kohë.

SHOKU ENVER HOXHA: Atyre që vazhdojnë shkollën, a u paguhen edhe orët që largohen nga puna, në bazë të vendimit të Qeverisë?

SHOKU PETRIT SINA: Po, shoku Enver, u paguhet dyorëshi i shkollës.

Për sa i përket zgjerimit të uzinës ne kemi ecur

1. Në atë kohë punëtore në fabrikën e mobilierisë të Kombinatit të Drurit në Elbasan.

2. Në atë kohë shkrirës në uzinën «Traktori».

3. Në atë kohë kandidat i Byrosë Politike të KQ të PPSH/dhe drejtor i uzinës «Traktori».

ngadalë për të meta në organizimin e punës nga shokët e ndërtimit.

SHOKU ENVER HOXHA: Po, i njoh këto të meta, por besoj se me masat që janë marrë do t'i plotësoni boshllëqet e krijuara.

Keni filluar nga montimet?

SHOKU PETRIT SINA: Kemi filluar në repartin e mekanikës, kurse në fonderi akoma jo.

SHOKU VELI XHINDOLLI: Jam punëtor në Uzinen Mekanike Bujqësore në Durrës, punoj në repartin e sonderisë si shkrirës i çelikut. Fjala Juaj e 15 marsit, shoku Enver, na bëri të nxjerrim konkluzione dhe të dalim me propozime konkrete për përmirësimin e punës në ndërmarrjen tonë. Brenda një periudhe prej pesë vjetësh ne kemi prodhuar mbi 14 lloje makinerish të reja dhe edhe në të ardhmen do të bëjmë gjithçka për të plotësuar nevojat e bujqësisë. Vetëm kërkojmë nga ndërmarrjet, të cilave u janë caktuar këto makina, që mundësishët të vijnë t'i marrin menjëherë, sepse ndryshe na zihet vendi i punës.

SHOKU ENVER HOXHA: Nuk kanë ardhur akoma planet për shpërndarjen e tyre?

SHOKU VELI XHINDOLLI: Jo, shoku Enver, nuk i kanë caktuar dhe nga kjo neglizhencë ne pengohemi, se ato janë shumë voluminoze dhe nuk kemi ku t'i mbajmë.

SHOKU ENVER HOXHA: Po, tharësja e misrit është tamam si një fabrikë e vogël, që duhet të ketë pranë silazhin dhe aggregatin, për arsyen se kur thahet misri, ai duhet të vazhdojë të qëndrojë i thatë, të mos futet në vende të papërshtatshme ku mund të njomet përsëri. Kjo është e kuplueshme.

SHOQJA ERIKETA JORGJI: Punoj në mapon e metrazhit në Rrugën e Durrësit këtu në Tiranë. Edhe unë, shoku Enver, si shokët që folën më parë, ndiej kënaqësi të veçantë që takohem sot me Ju. Fjala Juaj e 15 marsit e ka vënë edhe kolektivin tonë para kërkesave të reja që ta shohim punën tonë me sy kritik, sidomos në forcimin e disiplinës, në sjelljen më të kulturuar me blerësit, në tërheqjen e mendimit dhe të dëshirave të konsumatorëve.

SHOKU FERDINAND NENSHATI: Punoj në kombinatin e materialeve të ndërtimit «Josif Pashko», jam brigadier në brigadën e remontit.

Klasa punëtore e këtij kombinati ka arritur rezultate në shumë drejtime. Bëmë remontin dhe konstruktionin e të gjitha fabrikave. Suksese kemi pasur edhe në prodhimin e disa materialeve deficitarë në disa sektorë, si bie fjala, në repartin e tharjes.

SHOKU FEJZI SHEHU¹: Ne punonjësit e Stacionit të Makinave dhe të Traktorëve kemi një barrë dhe përgjegjësi të madhe për sigurimin e bukës së popullit. Pas fjalimeve Tuaja, komunistët dhe tërë punonjësit janë zotuar të plotësojnë detyrat e ngarkuara.

SHOKU AGIM TOROZI²: Edhe kolektivi ynë, shoku Enver, ka jetuar gjithmonë me frymën e vendimeve të Partisë dhe të mësimeve Tuaja. Ndër të tjera po i jepim rëndësi kontrollit punëtor brenda në ndërmarrje dhe jashtë saj. Kontrolli punëtor jashtë ndërmarrjes është në një nivel më të mirë, sesa ai që bëhet brenda

1. Në atë kohë traktorist në SMT. Tiranë.

2. Në atë kohë saldator në Oficinën e Automjeteve të Ndërtimit.

ndërmarrjes. Mendojmë se duhet forcuar më tepër kontrolli paralel. Kontrolli jashtë ndërmarrjes në shumë raste ka zbuluar të meta në tregti, në arsim apo në kulturë. Unë kam pasur rastin të marr pjesë në disa kontolle të tillë në sektorët e artit dhe të kulturës. Në këta sektorë ka disa koncepte jo të drejta për kritikën dhe autokritikën; atje nuk i kuptojnë si ne që punojmë në prodhim. Punonjësit e arsimit dhe të kulturës ngurojnë të kritikojnë njëri-tjetrin.

SHOKU ENVER HOXHA: Më lejoni, shoqë dhe shokë punëtorë, të them edhe unë disa fjalë në këtë takim të ngrohtë e shumë të dëshiruar nga ju dhe nga unë. Ju, gjatë bisedës, ngritet një sërë problemesh shumë interesante. Diskutimet tuaja, tregojnë pjekurinë politike dhe ideologjike të klasës sonë punëtore, astësinë e njerëzve të punës e të prodhimit në bazë për të drejtuar me kompetencë e për të zgjidhur çështje me rëndësi vendimtare për ekonominë dhe për politikën e Partisë sonë në luftë për ndërtimin e socializmit. Ju i kuptoni problemet drejt, thelloheni në mësimet e Partisë dhe i përvetësoni ato me gjithë shpirt. Kjo është siguri e madhe për ecjen tonë përpara dhe provon se vija e Partisë sonë ka qenë dhe është e drejtë në të gjitha fushat.

Situata e brendshme e vendit tonë është shumë e shëndoshë, revolucionare. Vija e Partisë, mobilizimi i klasës punëtore dhe i masave, me Partinë në krye, për vënien në jetë të kësaj vije, kanë bërë që të ndryshohet faqja e atdheut dhe ai të jetë në duart e sigurta të popullit. Klasa punëtore e vendit tonë ka bërë shndërrime të mëdha në industri, në arsim e kulturë dhe, tok me

kooperativistët, ka bërë që të ecë përpara edhe bujqësia jonë.

Socializmi te ne ndërtohet me sukses, sepse në emër të tij punojnë njerëz me ndërgjegje të lartë, të kalitur nga Partia. Nga e kaluara trashëguam mbeturina të vjetra mikroborgjeze, por megjithëkëtë, Partia vëren me kënaqësi të madhe se, brenda këtyre tri dekadave, me punë dhe me luftë të pandërprerë ka kalitur veten e saj dhe popullin në rrugën revolucionare mark-siste-leniniste. Partia diti të krijojë një klasë punëtore të fortë, e cila lufton jo vetëm për kalitjen e ndërgjegjes së vet socialistë, por ndikon edhe për kalitjen e ndërgjegjes socialistë të fshatarësisë dhe të inteligjencies, ku mbeturinat mikroborgjeze kanë rrënë më të thella. Një meritë e madhe e Partisë sonë është pikërisht krijimi i njeriut të ri me ndërgjegje të lartë socialistë. Prandaj, këtë fitore të madhe e të gjitha veprat e tjera që janë realizuar në vendin tonë, ne ua detyrojmë Partisë dhe klasës punëtore, e cila mishëron tiparet më të mira që i ka skalitur Partia e saj.

Përparimet tona janë të mëdha, por në asnjë mënyrë nuk mund të mendojmë se kemi arritur çdo gjë. Përkundrazi, përpiqemi të ecim kurdoherë përpara. Prandaj lufta e Partisë vazhdon në të gjitha drejtimet për ndërtimin e mëtejshëm të socializmit në fushën e ekonomisë, të arsimit, të kulturës dhe për formimin e ndërgjegjes revolucionare të njeriut të ri. Kur flasim për këtë lufë, ne kuptojmë se ndeshemë edhe me vështirësitë e me pengesat që na dalin përpara.

Dihet se sistemi socialist nuk shtrihet në tërë rrullin tokësor. Në botë ekzistojnë forca armike të egra

që janë kundër socializmit, komunizmit, marksizëm-leninizmit, siç janë: imperializmi, socialimperializmi, socialdemokracia dhe shumë rrryma të tjera të djathta, që luftojnë për jetë o për vdekje. Në këto rrethana, kur përballë nesh qëndrojnë armiq të rrezikshëm, duhet të jemi vigjilentë, të mos e dobësojmë për asnjë çast luftën kundër tyre.

Ne luftojmë me këmbëngulje kundër këtyre armiqve për të kapërcyer vështirësitë e mungesat që na shkaktohen nga rrethimi i tyre. Por, këto vështirësi nuk ka-përcehen lehtë. Situatat që kalojmë mund të përballohen vetëm në rast se do të vazhdojmë të qëndrojmë si kurdoherë në pozita të forta revolucionare, pra në rast se ideologjia sunduese e klassës punëtore pushton çdo ditë e më tepër mendjet dhe zemrat e punonjësve tanë, në rast se pushteti i klasës punëtore, diktatura e saj forcohen dhe çelikosen gjithnjë e më shumë për të mbrojtur veprën tonë të madhe përparimtarë, ndërtimtare në fushën materiale dhe shpirtërore. Para së gjithash, sukseset e arritura dhe qartësia e perspektivës vënë në lëvizje masat tona punonjëse, të cilat edukohen dhe drejtohen nga Partia për ndërtimin e socializmit dhe të komunizmit në vendin tonë. Ky është qëllimi i madh i Partisë, këtu përqendrohen përpjekjet e saj në luftën që zhvillohet kundër armiqve të jashtëm dhe të brendshëm të klasës.

Uniteti i pathyeshëm që ekziston në mes Partisë, klasës dhe popullit ka një rëndësi të madhe historike. Masat tona punonjëse e kanë kuptuar shumë drejt se zbatimi i fjalës dhe i porosive të Partisë është zbatim konkret i vijës së saj. Uniteti dhe mirëkuptimi midis

Partisë, klasës dhe masës janë rezultat i ndërgjegjes së lartë politike të popullit tonë, i vijës kurdoherë të drejtë të Partisë. Partia ka punuar shumë me masat punonjëse për ngritjen e ndërgjegjes së tyre politike, prandaj të gjithë ata elementë që orvaten të godasin ose të dobësojnë vijën e Partisë, thyejnë kokën dhe nuk mund të kenë kurrë sukses. Ata mund të pëshpëritin vesh më vesh ndonjë fjalë kundër Partisë dhe popullit, mund të bëjnë ndonjë ligësi, por para unitetit dhe mirëkuptimit tonë, janë të pafluqishëm, kurse Partia dhe populli janë të pathyeshëm.

Pse atëherë, kur armiqtë dërrmohen para forcës sonë, Partia duhet t'u bëjë herë pas here thirrje klasës punëtore dhe masave të popullit të kenë kujdes, të qëndrojnë fort dhe të përqendrohen për goditje të reja në këtë apo në atë drejtim? Sepse sukseset që arrijmë në luftë për lulëzimin e atdheut dhe në fitore mbi armiqtë, nuk vijnë vetvetiu, nuk shkojnë si të thuash, si mbi rrrotat që ecin vetë, por janë rezultat i veprimtarisë së ndërgjegjshme të udhëhequr nga Partia. Edhe rrrotat e automjetit, që të qarkullojnë lirisht e pa pengesë, duhen grasatuar. Në rast se atyre nuk u bëhet shërbimi i duhur, atëherë do të zënë ndryshk. Edhe me disa njërez kështu ndodh, që nga vetë natyra e tyre, ka momente kur u dobësohet shpirti revolucionar. Këta mund të mos bëhen kundërshtarë të Partisë, por bien në njëfarë qëtësie dhe nuk e kanë më hovin e mëparshëm revolucionar. Mirëpo interesi i socializmit, interesi i Partisë dhe i çështjes së atdheut nuk e durojnë ngadalësimin e hovit revolucionar ose ndryshkjen e njerëzve tanë.

Në rrugën e një zhvillimi të madh përpëra të Shqi-

përisë krijohen kushte shumë të favorshme që populli të ngrejë kurdoherë më lart mirëqenien e tij. Është fakt se mirëqenia e punonjësve tanë është arritur me sakrifika të mëdha, me luftë. Tërë populli ynë ka derdhur gjak dhe ka vuajtur në masë në kohën e Luftës Nacionallçirimitare. Pas përfundimit me sukses të kësaj luftë heroike erdhi një luftë tjetër: ajo e ndërtimit të Shqipërisë socialiste. Gjithë populli luftoi po me atë heroizëm si gjatë Luftës Nacionallçirimitare. Dhe bazat e socializmit u ndërtuan. Na kujtohen ato kohë, sa të vështira ishin! Por situatat u kaluan. Tani është krijuar një gjenjje shumë e mirë, shumë e favorshme, megjithëkëtë ne luftojmë për ta përmirësuar akoma më tepër. Sa më shumë përmirësohet jeta në vendin tonë, aq më i nevojshtëm bëhet vrulli revolucionar i njerëzve, i cili nuk duhet të bjerë për asnjë çast, përkundrazi, të ngrihet vazhdimi.

Brezi ynë i ri duhet të punojë, të mësojë dhe të dijë si kanë punuar e si kanë luftuar paraardhësit e tij, të njojë kështu faktin se gjithë këto të mira që gjëzon sot janë arritur me gjak e me djersë, prandaj duhen mbrojtur me vendosmëri në rrugën e Partisë, në rrugën e klasës, në rrugën revolucionare.

Sot te ne në çdo tre-katër veta njëri mëson në shkollë. Nga radhët e njerëzve të popullit Partia ka përgatitur mjekë, inxhinierë, agronomë etj., etj., të cilët në kohën e regjimeve të mëparshme antipopullore, këta bij të popullit, nuk do të ishin veçse skllevër, ashtu siç kanë qenë brez pas brezi të parët e tyre. Partia i mësoi kuadrot e rinj të saj të shkojnë më tej, të bëhen ndërtues të aftë të socializmit, ta fuqizojnë rendin tonë sho-

qëror në rrugën e Partisë, të bëhen trashëgimtarë të denjë dhe të zhvillojnë më tej virtytet e larta të baballarëve dhe të nënave të tyre, të klasës dhe të popullit që i lindi, i rriti dhe i edukoi.

Por sot ka edhe familje që marrin mbi dy rruga dhe ka disa prindër të cilëve nuk u bëhet vonë kur djali i tyre nuk shkon në punë dhe nuk i türheqin vërejtjen për këtë. Të tërë i duam fort fëmijët, por kur gabojnë, nuk mund t'i përködhelim. Ne duhet t'i edukojmë të rinjtë sipas normave dhe interesave të klasës. Qëndrimi i disa prindërve që plotësojnë tekat e fëmijëve, që u japid para sa herë që duan dhe nuk çajnë kokën fare për sjelljet e tyre, nuk është aspak i drejtë, përkundrazi është shumë i dëmshëm për vetë fëmijët, sepse një miengjes ky fëmijë i përködhelur do të marrë rrugën e vagabondazhit. Ka edhe njerëz, të cilët e marrin disiplinën proletare si diçka që mund të shikesh fare lehtë. Këta nuk i kuptojnë kërkeshat e disiplinës sonë ashtu siç mëson Partia. Partia na mëson se të thyesh disiplinën, do të thotë të lësh llogoren dhe atëherë imperialistët amerikanë, socialimperialistët sovjetikë, dhe gjithë reaksiioni që mezi e presin këtë çast, janë gati të sulmojnë, prandaj disa vese që duken te ndonjë i ri, nuk duhen nënvleftësuar. Janë vërtetuar tek të rinjtë edhe raste vjedhjesh, prandaj shoqëria me të drejtë shqetësohet, ajo nuk mund të qëndrojë e mënjanuar ndaj këtyre gjesteve të rrezikshme.

Partia, si udhëheqëse e klasës, merr sinjalizimet e klasës dhe jep orientime për zgjidhjen e problemeve të ndryshme që lindin herë pas here, sepse klasa nuk i pranon shfaqjet e huaja që prëkkin interesat e saj, por

lufton me konsekuençë kundër tyre. Ju zhvilluat kritikë dhe autokritikë të drejtë për disa qëndrime indiferente ndaj të metave që ekzistojnë në ndërmarrjet ku punoni. Shfaqje të tilla ka dhe kundër tyre duhet të luftojmë pa pushim. Natyrisht, të metat që përmendët është ju, nuk janë karakteristikë e klasës punëtore, sepse janë pikërisht punëtorët ata që i thonë Partisë së tyre: «Këtu duhet vënë rregull, ndryshe nuk mund të ecet më tej.. Prandaj, edhe në direktivat që jep Komiteti Qendror i Partisë mishërohen kërkesat e klasës punëtore. Këtu qëndron forca e direktivës së Partisë, e cila, për problemet që ngrënë dhe për vendimet që merr, ka besim të patundur se klasa dhe masat punonjëse do t'i zbatojnë, si kurdoherë, me temp revolucionar dhe me ndërgjegje të lartë socialiste. Direktiva e Partisë nuk është aspak sikurse thonë disa «një fushatë e përkohshme, që do të zgjatë një ose dy muaj dhe pastaj do të shuhet». Jo, mësimet e Partisë janë të vazhdueshme, ato bëhen edukatë për të gjithë njerëzit, sepse, siç e tha drejt dikush këtu, janë mishi dhe gjaku i tyre. Nëpërmjet Partisë klasa i ka marrë të gjitha masat dhe ka studiuar të tëra mënyrat e zbatimit të orientimeve para se ato të jepen nga Partia.

Kur kritikojmë shfaqjet e ideologjisë së huaj, që janë rezultat i presionit imperialisto-revisionist dhe i mbeturinave të së kaluarës në ndërgjegjen e njerëzve, nuk bëhet fjalë vetëm për masat punonjëse, por për të gjithë, duke përfshirë edhe udhëheqësit, të cilët, në fakt, nuk u shpëtojnë kritikave. Asnjë nga ne nuk mbetet pa u kritikuar dhe pa bërë autokritikë. Klasa punëtore, nën udhëheqjen e Partisë, ka vendosur ligjet e saj dhe kër-

kon zbatimin e tyre. Partia ka kërkuar vazhdimisht zbatimin e ndërgjegjshëm të këtyre ligjeve në të gjitha aspektet e jetës: në punë, në shkollë e kudo, për të ndërtuar socializmin dhe për ta mbrojtur atë nga çdo rrezik. Mirëpo ka raste kur rregullat dhe disiplina e klasës nuk zbatohen si duhet, jo për arsyse se nuk do klasa, por sepse disa punëtorë e drejtues ndërmarrjesh, si drejtorë, inxhinierë, bile edhe sekretarë të organizative-bazë të Partisë tregohen liberalë ose të njëanshëm. Këta mbështeten vetëm në punën edukative, e cila natyrisht, ka rëndësi të dorës së parë, por, kur edukimi është bërë gjerësisht, bile në ndonjë rast edhe është tepruar, nuk lejohet të mos zbatohen masa disiplinore, që edhe ato, gjithashtu, kanë karakter edukativ.

S'ka demokraci më të lartë se demokracia e klasës punëtore, por klasa nuk lejon që nën maskën e kësaj demokracie të kryhen veprime që, në thelb, janë anti-demokratike. Kështu ka ndodhur që, kur ndonjëri ka vjedhur, në vend që ndaj tij të zbatohen menjëherë ligjet e shtetit të diktaturës së proletariatit, disa kanë gjykuar si liberalë borgjezë, duke arsyetur kështu: «Lëre të shkretin, se ka fëmijë!». Po si mund të lihet vjedhësi pa u ndëshkuar? Si mund të gjykohet në këtë mënyrë? Pse ai vetë nuk mendoi për fëmijët e tij para se të vidhte, por u dashka të mendojnë kështu shokët? Këtij njeriu klasa i ka dhënë punë, e ka nderuar, e ka shpërblyer sipas sasisë dhe cilësisë së punës që ka kryer, e ka dërguar me pushime për t'u çlodhur, i ka dhënë apartament me një qira fare të ulët, e ka siguruar në rast paaftësie të përkohshme në punë, i siguron pension pëleqërie, ndihmën mjekësore falas etj., etj. dhe, me-

gjithëse e edukon çdo ditë, ai shkon e vjedh pasurinë socialiste. Shteti, që ta shpëtojë këtë njeri nga veprimtaria e mëtejshme keqbërëse dhe me qëllim që ta edukojë, duhet të marrë masa ndaj tij siç parashikon ligji, ndryshe ai dhe njeröz të tjerë të lëkundshëm të shoqërisë, do të edukohen keq. Një qëndrim të tillë liberal ndaj zbatimit të ligjit nuk e lejon klasa, as demokracia e saj.

Ne nuk mund të lejojmë elementë armiq. Ilasazanë e vagabondë që, në emër të «demokracisë», të diskreditojnë një punëtor që është i vendosur për Partinë, që tërë jetën ka punuar me nder, por që një herë, vetëm rastësisht dhe padashur, gabon. Elementi armik në këto raste, duke e hequr veten si «dashamirës» të socializmit, është gati të shfrytëzojë momentin për hesap të vet. Me qëllim që ta dërrmojë shpirtërisht njeriun e Partisë, ai do të përpinqet t'i fryjë e t'i shtojë të metat e njeriut tonë, do t'i stërhollojë ato, do të flasë së prapthi. Në qoftë se shokët nuk ngrihen t'i japin «grushtin» e t'i mbyllin gojën këtij ilasazani dhe intriganti, duke ia numëruar të tëra ligositë dhe qëllimet e ndyra të tij e pastaj të kritikojnë shokun që ka gabuar, kjo s'është demokraci proletare. Njeriun e Partisë që gabon do ta kritikojmë, që ta ndreqim, po edhe do ta inkurajojmë e do t'i japim dorën, që të mos bjerë më në gabime, ndërsa armiq të e klasës nuk do t'i lejojmë të përsitojnë nga demokracia e vërtetë proletare për të goditur Partinë dhe kolonën e saj vertebrorre, klasën punëtore.

Në momentet e ngritjes revolucionare partia duhet të jetë e fuqishme, të ketë pozita shumë të forta që të mund të marrë përsipër e të udhëheqë veprime të guximshme revolucionare, siç bën Partia jonë. Një parti

tjetër, që nuk i ka vetitë dhe kalitjen e Partisë sonë, nuk mund të ndërmarrë dhe nuk mund të kryejë me sukses veprime kaq revolucionare. Partia jonë është në pozita jashtëzakonisht të fortë, sepse midis saj dhe popullit ka një unitet të çeliktë. Ju, shokë punëtorë, e shikoni vetë se kur Partia dha orientime për forcimin e luftës kundër shfaqjeve të huaja, i tërë populli u ngrit në këmbë si një trup i vetëm dhe planet u tejkaluan, deficitet u plotësuan, mungesat pa arsyenë përfundën e pakësuan ose u zhdukën, kooperativistët shkuan të gjithë përfundit përuar në fushë etj. Ky mobilizim në punë nuk erdhi si rezultat i frikës nga marrja e masave disiplinore, po nga respekti dhe dashuria e popullit për Partinë, nga kuptimi i thellë i problemit, se shfaqjet e vërtetuarë ishin të huaja e të papajtueshme me karakterin e njerëzve tanë që ka rritur dhe edukuar Partia.

Në situatat e ngritjes revolucionare duken edhe njerëzit e këqij e të lëkundshëm, që s'kanë forca të qëndrojnë. Pikërisht, në këto momente, elementët armiq rrinë në përgjim dhe ngrenë veshët, prandaj klasa punëtore dhe partia e saj duhet të hapin sytë që t'i diktojnë e t'i kapin më lehtë. Këta njerëz, duke kujtuar se erdhi koha të cilën e presin me padurim, hiqen sikur janë më të kulluarit e më të flaktit dhe një mëngjes fillojnë të flasin lart e poshtë, por klasa i njeh mirë cilët janë ata, sepse pikërisht prej tyre ka që thyejnë vazhdimit disiplinën, që nuk vijnë në punë dhe që bëjnë shumë të këqija të tjera si në punë edhe në jetë. Këtyre personave ne nuk do t'u fërkojmë krahët, por as kokën nuk do t'u presim; ata do të gjykojnë sipas gabimit, në bazë të ligjeve dhe normave tona.

Ka rëndësi, shokë e shoqe, që këtë hov të madh revolucionar që ka ekzistuar dhe ekziston ndër ne, ta çojmë kurdoherë më lart. Ne ecim përpara në të gjitha drejtimet, por sot, lufta jonë zhvillohet sidomos në fushën e ideologjisë. Në këtë proces zhvillohen hope pa shpërthim, graduale, në formën e zhdukjes së elementeve të cilësisë së vjetër dhe të grumbullimit të elementeve të cilësisë së re. Këto hope shpien vazhdimisht drejt përbrysjes së plotë të ideologjisë borgjeze e mikroborgjeze, patriarkale e feudale, duke pasur si qëllim që kudo të zëré vend plotësisht ideologjia socialiste. Prandaj, Partia dhe klasa duhet të ngulin këmbë që të gjenden format, mënyrat dhe mjetet e nevojshme për ta hedhur hapin gjithmonë përpara. Të metat dhe gabimet t'i shohim konkretisht në punë e në jetë dhe jo në arsyetime filozofike jashtë realitetit objektiv, sepse në punë e sipër duken njerëzit e mirë dhe ata që bëjnë hile. Në procesin e punës t'i çmojmë të mirët dhe të korrigojmë ata që janë të sëmurë. Vlerësimet jashtë punës nuk janë të drejta dhe mund të na çojnë në gabime.

Eshtë e domosdoshme që secili ta kuptojë mirë se varet nga puna e tij dhe e të gjithëve që atdheu ynë të përparojë e të bëhet i pathyeshëm, që jeta jonë të bëhet më e lumtur, që ditët e errëta të së kaluarës të mos kthehen kurrë më. Ne i njohim vështirësitë që kemi pasur në të kaluarën, populli e di ç'ka hequr gjersa arriti fitoret që gëzon sot, prandaj, siç u tha këtu, duhet t'u tregojmë çdo ditë fëmijëve tanë se ku ishim, nga jemi nisur, me cilët armiq jemi ndeshur, sa gjak kemi derdhur për të arritur të sotmen e lumtur. Ky edukim

u bën shumë mirë të rinxje që të mos gënjen nga muzika e huaj, nga xhazet, nga leshrat e gjata, nga minifundet, si dhe nga propaganda armiqësore kundër vendit tonë.

Kohët e fundit propaganda borgjeze dhe revizioniste ka marrë në mbrojtje një ish-prift katolik, dënuar me vdekje nga gjykata e rrëthit të Krujës, sepse kishte vjedhur pasurinë socialiste, kishte sabotuar në mënyrë shumë të poshtër ekonominë e një kooperative bujqësore dhe, duke qenë agjent i amerikanëve, kishte tradhtuar atdheun. Ai prift ishte përpjekur të hidhte në erë shtëpinë e kulturës të kooperativës bujqësore. Në kohën e prashitjes së misrit organizonte prerjen e bimëve të shëndosha që kooperativistët të imbeteshin pa bukë. Fajet e tij u provuan publikisht nga dhjetëra dëshmitarë, por dy vjet pas dënimit të tij u kujtua Vatikani që, në kundërshtim me provat e pranuara nga gjykata, t'i dilte në mbrojtje këtij banditi, duke shpifur sikur gjoja ky «shenjtor» na qenkësh ekzekutuar nga komunistët shqiptarë, sepse paska pagëzuar një fëmijë! Ky armik i fëlliqur ka qenë dënuar pas Çlirimt edhe një herë tjetër me vdekje si tradhtar i atdheut, por jeta iu fal, duke shpresuar se do të pendohej përfajet e rënda që kishte kryer në dëm të shtetit dhe të popullit. Pasi bëri 20 vjet burg, u lirua, por përsëri ai rifilloi veprimtarinë e tij armiqësore, duke u bërë agjent i kapitalit italian. Propagandën armiqësore të Vatikanit kundër Shqipërisë e përhapën me zell të tepruar gazeta kapitaliste dhe revizioniste. I tillë është armiku.

Ne i lamë ata sa u lodhën së shpifuri, pastaj u dha-

më përgjigjen e merituar¹, sa e detyruam Vatikanin të mbyllte gojën. Për një njeri të tillë të ndyrë, siç ishte hajduti dhe tradhtari Shtjesën Kurti, shikoni se si u mobilizua tërë shtypi reaksionar botëror. Me mijëra gazeta shkruan për të goditur Republikën Popullore të Shqipërisë dhe emrin e mirë të saj në botë. Kjo propagandë u bë jo se imperialistëve dhe revisionistëve u dhimosej një prift i fëlliqur, por për të diskredituar e njollosur nderin e Shqipërisë socialiste. Natyrisht, në këtë propagandë adventureske, armiqëtë tanë nuk patën sukses, por unë jua tregova këtë «histori», për të ilustruar sa i poshtër dhe i egër është armiku. Të gjithë duhet ta kemi parasysh rrezikshmérinë e veprimtarisë armiqësore, prandaj të punojmë dhe të vigjilojmë gjithmonë me ndërgjegje dhe me besnikërinë më të madhe në detyrat që na janë besuar, duke filluar nga ajo punë që duket më e vogël, gjer te puna më e madhe. Gjithsejili, në vendin ku e kanë caktuar Partia dhe shteti, t'i kryejë si duhet detyrat.

Kryerja e plotë dhe me ndërgjegje të pastër e detyrës është kërkesa kryesore. Secili, kur shkon në punë duhet të mendojë se punon për Shqipërinë, për lirinë e saj, për ndërtimin e socializmit, për mirëqenien e popullit të tij, të familjes së tij dhe të brezave që do të vijnë, prandaj i bie detyrë të realizojë normat, të cilat të vendosen absolutisht në të gjitha ato procese pune që këshillon Partia. Normat teknike dhe normat progresive të vendosen sipas kritereve të përektuara. Se-

1. Shih artikujt e botuar në gazeten «Zëri i popullit» më 5 prill 1973, nr. 31 (7637), dhe më 14 prill 1973, nr. 89 (7695).

cili, sipas ligjit, të punojë tetë orë, duke e shfrytëzuar intensivisht orarët e punës dhe duke pushuar vetëm për aq kohë sa caktojnë rregullat e vendosura.

Çdo njeri te ne të mendojë se rendi ynë socialist i ka siguruar pagën, të drejtën e përsfitimeve nga sigurimet shoqërore shtetërore, banesë të mirë, mensë në qendrën e punës, të drejtën e studimit për djalin apo për vajzën, furnizimin me ushqim, veshimbathje e sende të tjera të nevojshme në treg etj.. prandaj, atje ku punon, t'i respektojë me rreptësi rregullat dhe normat e punës që kanë caktuar Partia dhe klasa. Nuk i lejohet askujt t'i thyejë normat e moralit proletar e të grabitë lekun e popullit, siç ndodh me disa shitës që nuk u kthejnë klientëve restin. Në rendin tonë shtetëror dhe shoqëror janë të gjitha mundësitë dhc rrugët që njeriu ta ruajë ndërgjegjen të pastër. Të gjitha detyrat që cakton Partia janë të lidhura me njëra-tjetrën. Në qoftë se të tërë nuk e kryejmë detyrën si duhet, atëherë, diku situata do të çalojë. Në qoftë se dikush kërkon dhe përpinqet të përsitojë diçka jashtë normave të vendosura nga shoqëria dhe jashtë mundësive që ka shteti ynë, atëherë tek të tjerët lindin pakënaqësi.

Një shoqe shitëse tha këtu se gratë kërkojnë disa mallra, të cilat nuk gjenden në treg, por a mendohet ndopak se të gjitha assortimentet që kërkohet s'ka mundësi t'i sjellim nga importi? Partia dhe shteti janë interesuar, në radhë të parë, për ushqimin e popullit. Megjithëkëtë ka njerëz që thonë se vezët që prodhohen në fabrikë nuk janë me shije si ato të pulave! Mirëpo kush e thotë këtë, cilët njerëz? A e kuptojnë këta se popullsia te ne është shtuar dhe nevojat e saj për vezë

nuk mund të plotësohen me ato pesë pula që mbajnë plakat në shtëpi, por me fabrika të tillë që prodhojnë me miliona kokrra vçzë? Po kështu edhe për mishin, edhe pse ka në treg dhe me çmim të lirë, dëgjojmë të kërkohet vetëm mish qengji e nuk preferohet mishi i derrit. Por, shokë, duhet t'i shikojmë çështjet drejt dhe realisht. Ka disa shokë me funksione drejtuese në gjirin e klasës që pa menduar thonë: «Ne jemi klasë punëtore, duam të na sillet mish qengji, duam frutat më të mira» etj. A mbahen parasysh situatat kur bëhen kërkesa të tillë? A mbahet parasysh se te ne një kilogram mish shitet shumë lirë, me 16 lekë kilogrami, nü një kohë që në botën kapitaliste e revizioniste çmimi i mishit është shumë i lartë? Prandaj ka gjëra që duhet t'i kuptojmë më thellë e më drejt.

Partia është vazhdimesht e preokupuar për furnizimin e popullit me mish, vezë, qumësht e me perime. Ja, për shembull, fasulet vjet nuk u bënë, zarzavatet, gjithashtu, prandaj tokat u mbollën prapë, e megjithatë koha nuk ishte e përshtatshme dhe përsëri pengoi zhvillimin e tyre. Po ne prapë do t'i rimbjellim ato dhe me punë e vetëm me punë do të bëjmë që të rriten prodhimet e të plotësohen nevojat. Mirë bëjmë që kritikojmë fshatarët pse nuk u bëjnë ullinjve shërbimet e duhura, po edhe punëtorët duhet t'i kritikojmë që nuk prodhojnë këpucë për kalamaniët. Shumë herë është bërë kjo kërkesë nga blerësit, kurse fabrikat e këpucëve vazhdojnë të prodhojnë vetëm këpucë për të mëdhenj dhe këtë e bëjnë për të realizuar globalin.

Përpjekjet që bëhen te ne janë të mëdha, por njerëzit duhet të rrojnë më shumë me zhvillimin e gjithan-

shëm të vendit, meraku duhet të jetë i të gjithëve. Shiu që ra na ka penguar për mbjelljet në kohë, ka bërë që të jemi vonë në mbjelljet. Për këtë arsyе komunistët dhe kooperativistët në fshat, për të fituar kohën e humbur do të mobilizohen me të gjitha forcat e tyre, për të përballuar situatën e krijuar, duke u bërë më shumë shërbime bimëve, me qëllim që prodhimet të realizohen. Kjo kërkon përpjekje të mëdha nga të gjithë jo vetëm nga fshatarësia, por edhe nga klasa punëtore, sepse bujqësia është e lidhur me industrinë, sidomos me atë mekanike, kimike, është e lidhur me traktorët etj., prandaj thotë Partia që bujqësia është çështje e të gjithëve.

Në kushtet kur ne kemi ngritur një industri të madhe e të fuqishme, industria mekanike është bërë një nga sektorët kyç dhe nga më të rëndësishmit. Asaj tani për tani i kemi vënë detyrë t'u shërbejë vetëm traktorëve dhe automjeteve, por do të vijë koha, dhe kjo nuk është e largët, që industria mekanike t'u shërbejë me pjesë këmbimi edhe sektorëve të tjera të industrisë, si kombinatit të tekstileve «Stalin», Kombinatit të Tekstileve në Berat, hidrocentraleve dhe të gjitha objekteve të tjera të vendit tonë. Pjesët e këmbimit nuk do të jenë vetëm bulona, fasho-llastika e detale të tjera të vogla, por do të jenë edhe pistona, motorë, pajisje të tjera, që ne duhet t'i përvetësojmë dhe t'i prodhojmë në vend. Që të sjellim nga jashtë vegla ndërrimi në një sasi kaq të madhe, sa po na kërkon industria jonë vazhdimisht në rritje jo vetëm na duhet të bëjmë shpenzime të mëdha në valutë, por duhet të kemi parasysh edhe pengesat që mund të na krijojnë të huajt, prandaj të

synojmë që mjaft vegla ndërrimi t'i prodhojmë me forcët tona.

Gjatë këtij pesëvjeçari industria jonë mekanike do të zhvillohet shumë. Kombinati i madh Metalurgjik do të na sigurojë çeliqet. Në këto kushte, ne duhet të spezializojmë industrinë mekanike, duke u nisur nga parimi: Çdo detal që do të nxirret e do të përpunohet nga punëtorët tanë, të jetë po aq i mirë e pse jo edhe më i përsosur se ato që vijnë nga jashtë. Kjo kërkon doemos kualifikimin dhe perfektionimin e punëtorëve tanë, dhe këto jo për t'u ngritur në kategori sa për të marrë një rrogë më të madhe, por për t'u shërbyer sa më mirë atdheut, ekonomisë e industrisë së vendit dhe popullit. Në qoftë se kuptohet në këtë mënyrë nevoja e kualifikimit dhe e perfektionimit, punëtorët tanë do të fitojnë aftësi të tillë që të jenë plotësisht në gjendje të prodhojnë detale të cilësisë së lartë. Kështu do të përmirësohen njëkohësisht kategorija, edhe paga e tyre. Por, në qoftë se kualifikimi do të bëhet ashtu siç ka ndodhur në mjaft raste, që punëtori i ri futet në provim, i jepen disa pyetje, të cilave u përgjigjet dhe, pas kësaj, edhe pse nuk është në gjendje të bëjë punë të kualifikuar, ai ngrihet menjëherë në kategorinë e pestë, të gjashë ose të shtatë, ky nuk është ai kualifikim që kërkon Partia.

Punëtorët, jo vetëm në industrinë mekanike, po kudo që punojnë, duhet ta konsiderojnë përvetësimin e profesionit si një detyrë të rëndësishme që u kanë ngarkuar Partia dhe populli, detyrë, e cila kërkon ta kryesh me ndërgjegje të plotë dhe ta ushtrosh me disiplinë proletare. Asnjjeriu nuk do t'i hahet haku për

ta ngritur në kategori, kur ai e meriton, dhe për ta shpërblirët në bazë të punës së tij. Po që se traktoristi, për shembull, e mban mirë traktorin dhe punon me të sipas kërkesave agroteknike, atëherë ai do të jetë i lavdëruar dhe i nderuar, kurse paga e tij do të shkojë duke u ngritur.

Prodhimi në vend i veglave të ndërrimit është një problem shumë kompleks dhe shumë i rëndësishëm për ne. Edhe kur të kemi Kombinatin Metalurgjik, prapë-serapë nevojat tona për to do të jenë shumë të mëdha. Kushinetat, për të cilat soli një shok këtu, bëhen me çelik special dhe kushtojnë shumë. Mirëpo ato na nevojiten ndaj i sjellim nga jashtë, por, nga ana tjetër, duhet bërë kujdes që ato të ripërtërihen vazhdimesht e t'u zgjatet jeta, derisa të mos ketë më mundësi për shfrytëzimin e tyre. Se ç'ndodh? Është vënë re që kushinetat, pasi përdoren për një kohë, hidhen tej edhe kur mund të rigjenerohen. Kështu nuk duhet të veprohet më në të ardhmen jo vetëm për kushinetat, por për çdo detal. Vetëm kur riparimi i mëtejshëm i një detali bëhet i pamundur, atëherë ai të zëvendësohet me detalet të ri. Nuk dua të zgjatem për ekonomizimin e lëndës së parë, sepse ju i dini fare mirë nevojat e vendit dhe duhet të bëni shumë kujdes në këtë drejtim.

Partia mendon se klasa jonë punëtore ka bërë dhe bën përpjekje shumë të mëdha për ndërtimin me sukses të socializmit në Shqipëri. Ajo është në pararojë të masave punonjëse, zë një vend shumë të respektueshëm, prandaj duhet të jetë si kurdoherë shembull për të gjitha masat e popullit. Është e domosdoshme që punëtorët të jenë akoma më të rreptë në kërkimin e llogarisë,

si ndaj drejtuesve të ndërmarrjeve, të cilët nuk janë të pagabueshmë, ashtu dhe ndaj shokëve të tyre; të mos druhën dhe të mos ngurrojnë për të kritikuar haptazi. Në këtë drejtim duhet të gjykojmë kështu: Do të nisesh nga interesat e shokut që gabon, apo nga interesat e atdheut? Kurdoherë që vjen puna të vihet në balance atdheu dhe shoku, në qoftë se interesat e tyre nuk përputhen, balanca do të anojë nga interesat i madh i atdheut. Nuk mund të lihet pa u kritikuar shoku, kur dëmtohet çështja e atdheut. Le t'i prishet qejfi shokut, por puna e atdheut të ndreqjet. Shokët duhet t'i duam me gjithë zemër, t'u dëshirojmë kurdoherë të mirën, por kjo nuk do të thotë aspak të mos i qortojmë kur gabojnë. Ai shok që nuk e kuption kritikën sot, do ta kuptionë nesër. E kam sjalën këtu për kritikën e drejtë, parimore dhe të pastër dhe jo për atë «kritikë» që bëhet me qëllim të keq, për hakimarrje, për syerje etj. Kur kritika bëhet me qëllim të keq, shokët le të ngrihen t'i vënë drunë kritizerit, duke i treguar vendin e merituar.

Partia dhe klasa duhet të jenë të rrepta në zbatimin pa lëshim të ligjeve të diktaturës së proletariatit dhe të rregullave të vendosura. Kjo rreptësi e nevojshtme nuk do të thotë në asnje mënyrë që për cilindo që gabon të merren masa ekstreme, pa peshuar më parë fajin, rrëthanat, dëmin, qëllimet etj. Partia nuk dëshiron të futet në burg asnjeri, por ai që e mbush kupën dhe nuk pranon të korrigohet, që vazhdon të shkelë ligjet, duke kryer krim, medoemos duhet të vejë në burg që të korrigohet. Për dënimin e atij që kryen kime, s'duhet të ketë asnjë hezitim.

Shteti kërkon që çdo qytetar të zbatojë detyrat që i ngarkohen nga Kushtetuta dhe nga ligjet e tjera. Kështu, sipas Kushtetutës, prona socialiste është e shenjtë dhe e paprekshme. Në qoftë se dikush vë dorë për të vjedhur pasurinë socialiste, ai doemos do të përgjigjet dhe, sipas ligjit, do të dënoshet me burg dhe do t'i paguajë arkës së shtetit kundërvleftën e pasurisë së vjedhur. Sipas ligjit çdo shtetas shqiptar që ka mbushur moshën 16 vjeç dhe që banon në territorin e Republikës Popullore të Shqipërisë, me kërkesën e tij pajiset me letërnjoftim. Por ai që vjedh, falsifikon ose vë në dorë letërnjoftimin e një tjetri, që ta përdorë për qëllime të këqija, patjetër që do të dënoshet sipas dispozitave të Kodit Penal. Çdo shtetas gjëzon të gjitha të drejtat që i janë siguruar me ligj, por ai, në të njëjtën kohë, është i detyruar të zbatojë edhe detyrat që rrjedhin nga ligji.

Për zbatimin me rreptësi të ligjeve duhet të ushtrojë mbikëqyrje kontrolli punëtor i bashkërenduar ky edhe me kontrollin shtetëror. Këto kontrollle janë një shtytje e madhe përparrë për çështjen e socializmit, për edukimin e masave të popullit, për t'i mësuar njerëzit të jetojnë dhe të punojnë sipas normave të moralitetit të proletarëve dhe rregullave të bashkëjetësës socialiste. Ju, punëtorët, kurrë nuk duhet të mendoni se nuk jeni në gjendje të bëni kontroll mbi këdo dhe për gjithçka. Jeta ka provuar se kontrolllet punëtore janë të nevojshme dhe të domosdoshme. Gjatë bisedave tuaja këtu provohet edhe një herë se punëtorët mund dhe duhet të ushtrojnë vazhdimisht kontrollin e klasës. Shumë nga ju janë në gjendje të kontrollojnë, të jatin gjykime dhe këshilla, për shembull, në teatër dhe kudo. Shoku

Agim Torozi përmendi këtu «sëmundje» që ekzistonin në sektorin e artit sepse ai ka vajtur dhe i ka parë vetë me syrin e imprehtë të klasës.

Çdonjëri nga ju mund të bëjë të tilla kontolle. Po të jenë të organizuara si duhet, kontrollet punëtore bëhen jashtëzakonisht të vlefshme për edukimin e njerezve, për mbarëvajtjen e punëve dhe për shkundjen e atyre që lëvizin ngadalë dhe notojnë në situata të turbullta. Tok me kontrollin punëtor mund të shkojë dhë kontrolli shtetëror. Këto kontolle u presin barin nën këmbë të gjithëve atyre që kërkojnë të dëmtojnë socializmin dhe interesat e lartë të popullit. Kontrollin punëtor ta ushtroni jo vetëm në ndërmarrjet e tjera, por sidomos në ndërmarrjet dhe repartet ku punoni vetë. Thërrisni të vijnë te ju për kontroll edhe punëtorët nga uzinat dhe fabrikat e tjera, që të shikoni mië mirë dhe më parë se si shkojnë punët në «shtëpitë tuaja». Ja, për shembull, ju shokë punëtorë dhë komunistë, që punoni në Portin e Durrësit dhe në hekurudhë, duhet ta organizoni punën e transportimit në mënyrë të përsosur, sepse tani ju kanë ardhur dhe po ju vijnë me dhjetëra vaporë me materiale të industrisë, të ndërmarrjeve të reja dhe me mallra të tjera. Vaporët që vijnë duhet të shkarkohen pa vonesë, mallrat të ruhen me kujdes dhe të nisen pa humbje në destinacion, si në Kombinatin Metalurgjik dhe në vende të tjera. Në këtë drejtim të ketë disiplinë të fortë dhe të mos lejohen dëmtime, sepse ka edhe ndonjë njeri të pandërgjegjshëm që synon t'i hapë, të marrë kartelat, të heqë veglat etj.

Mjaft nga problemet që ngritët në diskutimet tuaja janë marrë në shqyrtim edhe në Byronë Politike apo

në Qeveri. Shoku i kombinatit «Misto Mame» ngriti problemin e lëndës së drurit. Ky është një problem i madh. Kur morëm vesh pardje, në mbledhjen e Byrosë Politike që sharrat elektrike në Pukë nuk shfrytëzohen, vumë duart në kokë dhe thamë: Si është e mundur që organizata-bazë e Partisë dhe punëtorët atje nuk i kanë vënë në funksionim këto pajisje të sjella me devizë nga jashtë, për të prodhuar sa më shpejt dhe me përmasa më të përmirësuara lëndën e drurit?! Po kështu, shoku i Uzinës Mekanike Bujqësore të Durrësit tha se kjo uzinë ka bërë makina bujqësore të lehta në përdorim. Kjo është e vërtetë, por ka raste që disa prej tyre, kooperativat bujqësore i kanë hedhur andej-këtej nëpër haure, nuk i shfrytëzojnë. A mund të lejohet një qëndrim i tillë, kur hekurin me të cilin janë prodhuar ato makina e kemi siguruar duke shpenzuar valutë, pa folur për krahët e punës? Megjithëse makinat bujqësore janë, përsëri puna në bujqësi vazhdohet me shatë dhe, kur vjen sezoni i prashitjes, dëgjohet e njëjta «këngë»: «Na kanë mbuluar punët». Në qoftë se nuk përdoren kultivatorët, si do t'i dilet mbanë prashitjes së dhjetëra e qindra milionë bimëve të mbjella në dhjetëra mijë hektarë tokë? Mekanizmat bujqësorë janë, por nuk shfrytëzohen si duhet, prandaj në këtë mes kërkohet një shkundje e madhe.

Kjo është arsyaja që Partia studion e analizon gjendjen e punëve dhe del me direktiva, të cilat shërbejnë për t'i mobilizuar njerëzit tanë, të cilët, vërtet janë shumë të mirë, por mjaft prej tyre kanë disa koncepte prapanike, që patjetër duhet t'i luftojmë e t'u presim rrugën dhe këtë ta bëjmë jo me fushata, por vazhdi-

misht. Pra puna e Partisë, e organizatave-bazë dhe e çdo komunisti duhet t'i bëjë njerëzit të hapin sytë, t'u tërheqë vëmendjen për fenomenet negative, siç është në rastin konkret mospërdorimi i makinave e për probleme të tjera.

Është një kënaqësi e veçantë kur dëgjon se çështjet e ngritura nga Partia kohët e fundit u kuptuan si duhet nga masa e punëtorëve dhe nga punonjësit e tjerë. Këto probleme u diskutuan gjërësisht dhe me pjekuri të madhe. Ato do të diskutohen prapë, natyrisht, në forma të ndryshme, për probleme të caktuara dhc prej tyre do të nxirren përfundimet e nevojshme.

Rruja e ndjekur për të forcuar akoma më tepër situatën është shumë pozitive. Perspektivat janë të mira. Vështirësitet e përkohshme që shkaktoi moti i keq në bujqësi, po kapërcehen. Edhe industria, sektori ku punon klasa punëtore, po ecën shumë mirë. Detyrat u tejkaluan në të gjitha ndërmarrjet, gjë që tregon se klasa punëtore është në pararojë.

Në shkolla, gjithashtu, në radhët e nxënësve dhe të studentëve, ka një lëvizje shumë të madhe për të ecur më përpara. Kjo tregon se rininë e kemi xhevahire; ajo përnjëherë e dëgjoi fjalën e Partisë për luftën kundër shfaqjeve të huaja. Shkolla jonë ecën në një rrugë të drejtë zhvillimi. Mësuesit dhc pedagogët, duke përfshirë edhe ata që ishin prekur nga disa mendime librale, po reflektojnë dhe janë duke u mobilizuar, duke u vënë në pozita pune, për të mësuar e studiuar thellë, që shkolla jonë të përgatitë njerëz revolucionarë dhe të zotë për të punuar në frontet e ndryshme të ndërtimit të socializmit. Interesimi i mësuesve dhe i pedagogëve

për nxënësit dhe studentët, po irritet jo vetëm në shkollë, por edhe jashtë saj. Në këto drejtime po shohim një kthesë shumë pozitive.

Pra, situata në vendin tonë është shumë e mirë, revolucionare, shumë e favorshme dhe optimiste. Këtë do ta forcojë më shumë edhe fakti që këtë vit do të jemi më mirë nga gjendja ekonomike dhe furnizimi i popullit, në krahasim me vitin e kaluar, do të përmirësohet. Puna është që të realizojmë plotësisht planin e këtij viti dhe në të njëjtën kohë të plotësojmë ato pak deficite që u krijuan vjet, me qëllim që populli të ketë më shumë, të jetojë më mirë nga sa është parashikuar. Ky sukses varct nga ne. Jemi të bindur se Partia, klasa punëtore dhe masat e tjera punonjëse do t'i kryejnë me sukses detyrat që i kanë vënë vetes.

Sot u mblodhëm dhe biseduam kokë më kokë për problemet e detyrat që kemi, por, siç e thashë në fillim, kështu të mblidhemi herë pas here, qoftë duke ardhur në grupe më të vogla me nga katër-pesë shokë, që të këmbejmë mendime për një osc dy probleme për t'i zgjidhur ato më mirë. Pra, të dashur shokë punëtorë, kërkoj nga ju të mos më harroni.

Ju uroj suksese në punë, juve dhe tërë shokëve tuaj!

Gëzuar festën e 1 Majit, ta kaloni të lumtur! Partia të na rrojë e ta kemi të fortë, të çeliktë, gjithnjë në rrugën marksiste-leniniste, siç është tanë! Të na rrojë klasa jonë punëtore!

Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim, që gjenden në AQP

KRITIKA KUNDËR SHFAQJEVE TË HUAJA NUK E ERRËSON TË TERËN QË ËSHTË POZITIVE

Nga biseda me sekretarët e KQ të PPSH¹

30 prill 1973

Fjalimi që mbajta në mbledhjen e përgjithshme të komunistëve të aparatit të Komitetit Qendror u punua në udhëheqjen e Partisë, të pushtetit dhe në organizatat e masave dhe tash ai do të studiohet dhe do të punohet në gjithë Partinë dhe në popull. Sipas të dhënave, kjo ka ngjallur interesim të madh dhe po zhvillohen debate të zjarrta konstruktive dhe revolucionare për të zbuluar dhe për të luftuar të metat, gabimet dhe shtrembërimet që janë vërtetuar në jetë dhe në punë, në kolektiva e në individë. Kjo është një punë e madhe pozitive dhe frytdhënëse që ndërmerr Partia në spastrimin e ndërgjegjes së njerëzve nga veset e këqija, nga konceptet mikroborgjeze dhe jep e do të japë rezultate të mëdha në realizimin me sukses të planeve tona, qofshin ato ekonomike, ose socialkulturore. Këto plane janë vepra të Partisë, të pushtetit dhe

1. Në këtë takim merrte pjesë edhe shoku Rita Marko, në atë kohë President i Bashkimeve Profesionale të Shqipërisë.

të popullit dhe, sa më shumë të ndërgjegjshëm të jenë njerëzit, aq më shpejt e aq më mirë do të arrihen rezultatet e dëshiruara.

Aktualisht, në udhëheqje, janë duke na ardhur dhe do të vazhdojnë të na vijnë shumë raporte dhe informacione nga baza, në të cilat vihet në dukje ç'kanë nxjerrë në shesh këto diskutime dhe ballafaqime të rëndësishme. Ne po i studiojmë ato me kujdesin më të madh. Kemi parasysh se në këto materiale pasqyrohen vetëm anët negative, këto zënë vendin e parë në to, pse kundër këtyre shfaqjeve kërkohet që Partia dhe masat të reagojnë me forcë revolucionare, kërkohet të ngrihet peshë opinioni për korrigjin e tyre. Prandaj kjo pamje e pjesshme e gjërave, as neve, as bazës, nuk duhet të na errësojë të térën, të na mbulojë anën madhështore pozitive, heroizmin, drejtësinë e vijës së Partisë dhe realizimet; nuk duhet të na mbulojë pesimizmi. Këto që kanë ngjarë nuk mund të errësojnë të mirat, por fakt është se këto kanë ngjarë. Sigurisht ato s'duhet të ngjisnin ose duhet të ngjisnin shumë më pak, pse pretendime idealiste nuk mund të kemi. Ne duhet të jemi ekzigjentë, të papajtueshëm, t'i luftojmë pa mëshirë dhc nga rrënjet barërat e këqija që duan të pengojnë shoqërinë tonë socialiste, të jemi kurdoherë luftëtarë revolucionarë të papërkultur kundër këtyre shfaqjeve, pse këto pengojnë, ngadalësojnë, kalbin dhe sabotojnë punën e shëndoshë dhe njeriun e shëndoshë.

Njëkohësisht me raportet dhe me informacionet ne marrim edhe një numër të madh letrash e telegramesh nga klasa punëtore, nga fshatarët kooperativistë, nga mësues, pedagogë e nxënës, nga njerëz të artit dhe të

kulturës, ku shprehet njëzëri aprovimi i zjarrtë dhe revolucionar me Partinë dhe me vijën e saj të drejtë. Ata në mënyrë të hapët denoncojnë, zbulojnë dhe dënojnë gabimet dhe të metat e tyre në punë, mendimet dhe konceptet e tyre të gabuara për çështje të ndryshme dhe marrin zotime solemne e publike se do t'i korrigojnë, se do t'i shërojnë, se do të shëndoshin vete, familjon, punën, atdheun. Kjo është një forcë e madhe e rendit tonë socialist dhe tregon gjendjen e shëndoshë moralo-politike të Partisë dhe të popullit tonë. Në asnje vend të botës nuk mund të ngjasë kjo që ngjet te ne. Kjo është garancia e së tashmes dhe e së ardhmes. Ky është realiteti, shokë, dhe, duke u mbështetur në këtë realitet kaq pozitiv, ne duhet të organizojmë akoma më fuqimisht forcat e pashtershme të Partisë, të klasës dhe të masave të gjera punonjëse, për t'i hedhur në betejat të reja. Ne jemi duke vazhduar luftën e revolucionarizmit me forca më të mëdha, me energji më të mëdha, të frymëzuara me një entuziazëm akoma më të madh.

Si kurdoherë edhe tash, lufta kundër të metave e gabimeve duhet organizuar me forma të reja të përtërrira, që na i diktojnë rrëthanat, që na i mëson jetë, eksperienca e saj. Nuk duhet t'i lëmë asgjë spontaneitetit, entuziazmi nuk duhet lënë të fishket dhe forca të mpihet. Duhet ta rrahim hekurin sa është i nxchtë, se vetëm kështu kalitet. Prandaj, si ne në udhëheqje edhe komitetet e Partisë në rrëthe, ministritë, komitetet ekzekutive dhe organizatat e masave duhet të këshillohen dhe të instruktohen që të përgatiten për betejat që do të zhvillojmë.

Gjatë gjithë kësaj periudhe që do të vazhdojë di-

skutimi masiv dhe menjëherë pasi të mbarojë, të gjithë duhet të nxjerrim konkluzionet e nevojshme. Ç'doli nga ky diskutim? Cilat ishin anët e mira të gjendjes dhe dobësitetë? Të përcaktojmë mirë se në ç'sfera, të çfarë natyre dhe me çfarë intensiteti janë dukur këto shfaqje të këqija në punë dhe të njerëzit dhe ku e kanë buri-min. Janë shkaktuar nga paqartësi politike, nga paqartësi ideologjike apo nga lëshime dhe mungesa organizative? Sa prej tyre janë objektive dhe sa subjektive? Sa janë shkelur ligjet, urdhëresat e rregulloret, në ç'drejtime dhe pse? Sa nga këto të meta apo shfaqje janë sporadike, të rastit, të rritjes dhe sa të tjera janë bërë vijë e të rrezikshme dhe qysh?

Të gjitha këto dhe të tjera duhet të dalin nga një analizë e imët dhe shkencore e debateve që u zhvilluan. Kjo duhet të bëhet me seriozitetin më të madh, të bëhet klasifikimi i tyre, sepse në bazë të kësaj analize dhe të këtij klasifikimi do të ndërlohet edhe plani i luftës, përdorimi i «armëve të ndryshme», i taktikave të ndryshme të vjetra, që janë të sprovuara dhe që kanë dhënë rezultate, si dhe taktika lufte të reja që diktojnë rrethanat. E djeshmja jeton te ne, por ne ecim përpura, duke u mbështetur tek e mira e së djeshmes, për të spastruar atë që nuk është e mirë dhe për të forcuar të sotmen më të mirë, më të shëndoshë, për t'i hapur rrugën të resë së nesërme, akoma më të mirë e në të shëndetshme.

Kjo analizë që është bërë dhe konkluzionet, që do të nxjerrë udhëheqja, do të çohen përsëri në masat e gjera të popullit që të zbatohen me shpirt kritik dhe krijues. Prandaj këto anë negative që janë dukur në

punë dhe te njerëzit, t'i njohim me kurajë dhe t'i kërkojmë edhe në punën tonë dhe jo t'i rrumbullakosim ose të flasim me fraza pompoze e pa bukë. Përkundrazi të shohim me sy kritik punën tonë se direktiva e drejtë s'është zbatuar kurdoherë si duhet, është lënë në mes të rrugës, nuk është kontrolluar mirë, se ligjet e urdhëresat po ashtu, format e edukimit e të instruktazhit s'kanë qenë të efektshme, kanë qenë formale, se ka shokë që janë marri shumë herë me cikërrima dhe kanë harruar problemet e mëdha, se puna e tyre organizative, politike dhe ideologjike ka qenë e dobët, se nuk kanë ditur të drejtojnë, të përdorin si duhet kuadrot, zotësitë e tyre etj., etj.

Të gjitha këto nuk janë gjëra të reja që udhëheqja, Partia dhe pushteti i konstatojnë dhe i ngrenë për herë të parë. Dhe nuk do të jetë e drejtë po ashtu të thuhet se nga kjo ngritje dhe shtruarje e këtyre problemeve nuk ka dalë gjë, nuk është bërë gjë. Jo, këto kanë dhënë rezultate të mëdha. Po të mendohet ndryshe dhe kush mendon ndryshe, ai duhet të quhet me plot gojën nihilist. Por çështja qëndron në faktin se këto direktiva duhej dhe mund të jepnin rezultate më të mëdha në shmangjen, zhdukjen dhe mospërsëritjen e këtyre të metave.

Tash na vihet çështja që të korrigohemi dhe ne jemi në dijeni se nga na vijnë këto të meta, ku u formuan të çarat, për të cilat nuk morëm masa që t'i mbyllim. Tani ne jemi më mirë në gjendje të gjykojmë dhe të realizojmë pse jemi më të armatosur me eksperiencë. Tani e kemi më kollaj të përcaktojmë se duhet forcuar kjo ose ajo masë; se duhet hedhur kjo ose ajo frysë

pune e vjetruar dhe duhet përdorur kjo tjetra; se duhen plotësuar tekstet e leksionet politiko-ideologjike me material të freskët e të ri që na jep jeta; se disa njerëz duhen spastruar nga Partia e nga organet e pushtetit, sepse kanë dëmtuar me pikëpamjet, me plogështinë dhe me indiferentizmin e tyre, duke na krimbur dhe ndotur atmosferën; se duhen luftuar liberalizmi dhe konservatorizmi kudo ku shfaqen; se duhen spastruar redaksitë e gazetave dhe të revistave nga njerëzit me pikëpamje liberale etj., etj.

Kjo çështje, shokë, duhet të kuptohet kështu: Ky është një problem aq i madh, sa dhe i gjerë, i madh si populli dhe i gjerë si atdheu ku rron e lufton populli ynë. Këto probleme janë materiale dhe të ndërgjegjes, janë objektive dhe subjektive. Që t'u dalim mbanë e me sukses këtyre problemeve duhet t'i bëjmë ato çështje të të gjithë Partisë, të të gjithë popullit. Popull e Parti në unitet duhet të hidhen në luftë kundër armiqve të tyre, të dukshëm dhe të padukshëm. Partia është shtabi madhor, üshtë zemra, mishi, kocka e fortë e popullit. Ajo përgatit planet tok me popullin, ky njihet me to dhe së bashku shkojnë në luftë dhe në fitore.

Asnjë udhëheqës, i çdo kategorie ose grupei udhëheqësish, të mos mendojnë se këto probleme, që janë të lidhura me gjithë jetën e popullit, do të zgjidhen duke bërë ndonjëfarë skeme shkel e shko në zyrë dhe kjo të zbatohet nga disa njerëz, qofshin këta edhe disa mijëra veta.

Jo, këto janë punë të të gjithë Partisë, të të gjithë popullit dhe këtu do të tregohen zotësia dhe forca e Partisë sonë që veten e saj dhe popullin e vet, në më-

nyrë të ndërgjegjshme e në mënyrë të organizuar, t'i hedhë në luftë. Dhe unë kam bindjen e plotë se Partia këtë do ta bëjë si kurdoherë dhe më mirë se kurdoherë.

*Botohet për herë të parë si-
pas origjinalit që gjendet në
Arkirin Qendror të Partisë*

T R E G U E S I T

TREGUESI I LËNDËS

A

Akademia e Shkencave e RPSh — 16-20, 131-136, 399.

Alcanca dhe rivaliteti sovjet-to-amerikan — 143-144, 145, 149, 411, 413-414.

Armiqtë — veprimitaria armiqësore dhe luftha kundër tyre — 237-239, 296-297, 298, 301-304, 305-310, 312-315, 473-474, 480, 481, 483-484.

Arsimi në RPSh

- sistemi i ri arsimor — tre komponentët: mësimi, puna prodhuese dhe edukimi fizik e ushtarak; boshti ideologjik — 64-65, 100-102, 156, 222-225, 233-234, 255-258, 262-263;
- thellimi i demokracisë dhe forcimi i disiplinës. Luftha kundër shfaqjeve të huaja në shkollë — 164-166, 169, 325, 494-495;
- mësimdhënia në shkollë. Tekstet, leksionet — 156, 258-260, 325, 441-443;
- arsimi i lartë. Kriteret për zgjedhjen e degëve nga nxënësit për shkollat

- e larta — 87, 103, 155-170, 255-263, 437-443;
- arsimi pa shkëputje nga puna. Shkollat bujqësore — 86-89, 92, 325-326;
- pedagogët, mësuesit dhe kualifikimi i tyre. Nxënësitet dhe studentët — 44, 64, 150-160, 166-167, 223-225, 233-234, 256-259, 261-262, 263, 325, 438-443, 494-495.

B

Bashkimi Sovjetik, revizionizmi sovjetik

- degjenerimi i partisë, i shtetit, i kulturës dhe i mënyrës së jetesës — 298, 304-307, 408;
- strategja dhe taktikat, sabotues i lëvizjes m-l dhe i luftërave çlirimtare të popujve — 141, 142, 143, 144, 148-149, 152, 286-287, 290-291, 305-306, 403, 407, 408, 412-413.

Bibliotekat — 228-229.

Bindja, puna me njerëzit: harmonizimi i bindjes me masa

- administrative* — 203, 209-210, 253, 324, 326-329, 479, 493-494.
- Blegtoria* — politika dhe kujdesi i Partisë për zhvillimin e saj; baza ushqimore — 98, 356-358.
- Botimet, shtypi* — 10-11, 20, 68, 226, 227, 228, 234.
- Bujqësia*
- politika e Partisë për zhvillimin dhe intensifikimin e bujqësisë. Organizimi shkencor, përqendrimi, specializimi, qarkullimi, rajonizimi — 187-192, 334-338, 339, 359-360, 393-394, 397-398, 454-459, 486-487;
 - toka, trajtimi shkencor dhe sistemimi i saj. Ujita, veprat ujítëse. Mekanizmi — 87-91, 95-96, 332-333, 350-356, 358-359, 393, 457, 493;
 - drithërat; problemi i bukës dhe i sigurimit të saj në vend. Pemëtaria, ulliri. Panxhari i sheqerit — 97-98, 337, 358-359, 398, 455;
 - kooperativistët, punëtorët dhe kuadrot e bujqësisë — 87-89, 91, 105-106, 234-236.
- D**
- Demokracia socialiste; lufta kundër shtrembërimeve dhe shkeljeve të saj* — 61, 202, 479, 480.
- Diktatura e proletariutit* në Shqipëri — 14-15, 323-324, 327-329.
- Disiplina proletare* — disciplina e punës dhe ajo e planit; lufta kundër shkeljeve të tyre — 62, 173-174, 235, 250, 251, 270, 315-317, 323-324, 477, 478-479.
- Drejtimi dhe organizimi shkencor i ekonomisë* — 187-192, 395-396, 432-433, 454-455, 456.

E

- Edukimi komunist* — 224, 473, 482-483;
- edukimi ideopolitik — 249, 294-295, 322-323, 326-328;
 - edukimi moral, estetik e kulturor dhe lufta kundër shfaqjeve të huaja — 199-204, 236, 239-240, 251-252, 485.
- Ekonomia populllore* — rritura e forcimi; zhvillimi harmonik, përpjesëtimor dhe i bashkërenduar i degëve të saj — 175-176, 320-321.
- Engels, Frederik* — 68, 133, 240.
- Enver Hoxha* — të dhëna autobiografike — 163, 229-230, 286, 417-422, 463.

F

Familja — roli i saj në edukimin e brezit të ri — 271-272, 319-320, 422, 477;
— dashuria, fëjesa, martesa — 362-364.

Feja dhe lufta kundër saj.
Kleri — 301, 364, 367-368, 415.
Fuqia punëtore — politika e Partisë dhe masat e pushtetit për problemet e fuqisë punëtore — 267-269, 274-275.
Furnizimi materialo-teknik; kontratat, kontraktimet — 94, 174-181.

G

Greqia — Lufta Nacionalçlirimtare e popullit grek — 153, 281-282, 415.

Gruaja dhe BGSh — politika e Partisë për emancipimin e gruas. Roli i saj në ndërtimin socialist dhe në mbrojtjen e vendit — 202, 300, 340-349, 401.

GJ

Gjykata popullore, prokuroria — 179-180, 212-214, 328.

I

Imperializmi; kritikë pikëpamjeve borgjezo-revizoniste mbi ndryshimin e natyrës së

imperializmit të sotëm — 144-145, 303, 306-307, 403-404, 407-408.

Industria — shpërndarja përpjesëtimore e degëve të saj — 266-267, 397;
— industria mekanike; prodhimi në vend i pjesëve të këmbimit dhe i makinave — 354-355, 427-431, 432-435, 487-488, 493.

Interesi i përgjithshëm dhe interesi vetjak — 209, 320-321, 490.

Investimet; politika e Partisë në fushën e investimeve — 269, 273, 274.

K

Kapitalizmi — 240, 303, 316-317, 334-335, 403-404.
Këshillat popullorë, komitetet ekzekutive; detyrat dhe kujdesi i tyre për ekonominë, kulturën dhe artin — 1, 14-15, 322, 353.

Këshilli i Mbrojtjes; Tezat e Këshillit të Mbrojtjes — 32-33, 65-68.

Këshilli i Ministrave (Qeveria) — 19-20, 24, 98, 104, 183, 184, 223, 233, 234, 251, 254, 328, 353, 391, 433, 493.

Kina; qëndrimi ndaj RP të Shqipërisë — 150, 273, 387, 393, 400-402, 403-404.

Klasa punëtore — roli pararojë; pjesëmarrja e saj në ndërtimin socialist të vendit — 489-490;
 — struktura, rritja numerike, cilësitë moralo-politike, edukimi i saj — 264-267, 462-463, 472-473;
 — kualifikimi, kategorizimi, atestimi i punëtorëve — 98-99, 185-187, 431-432, 465, 488-489.

Kolektivizimi socialist i bujqësisë, kooperativat bujqësore
 — politika e Partisë për shndërrimin e pronës së grupit në pronë të gjithë popullit. Kooperativat bujqësore të tipit të lartë — 104-115, 334, 358, 397;
 — forcimi ekonomik e organizativ; organizimi i sektorëve dhe i brigadave — 187-192, 234-236, 330-333;
 — fondet e kooperativave bujqësore; shpërblimi i punës — 109-110, 112, 113, 114-115, 338.

Komunikacionet, transportet; zhvillimi i tyre — 180-181, 492.

Komunisti — roli pararojë: cilësitë moralo-politike; edukimi dhe kalitja revolucionare e tij — 64, 118, 123-124, 126, 200-201, 450-453.

Konservatorizmi dhe lufta kundër shfaqjeve të tij — 12-13, 199-200, 202-203, 296-297, 301-303, 343-344, 353-354, 451.

Kontrolli i Partisë, i klasës punëtore dhe i shtetit — 56-61, 213-214, 428-429, 491-492.

Koreja e Veriut (RDP e Kore-së); përpjekjet për ribashkimin e vendit — 285-289, 290-292.

Krimet, shfaqjet e kriminalitetit në RPSh: shkaqet, parandalimi dhe dënim i tyre — 198-199, 310-311, 479-480, 491.

Kritika dhë autokritika — 165-166, 251-252, 478, 490.

Kuadrot

— politika dhe kujdesi i Partisë për kuadrin; përgatitja, vendosja, shpërndarja dhe qarkullimi — 155-156, 160-164, 166-167, 361, 437-443, 476-477, 501;

— kualifikimi dhe specializimi; kualifikimi pasuniversitar — 156-160, 390-391, 443-448:

— lufta kundër të metave dhe qëndrimeve të huaja në punën me kuadrin — 166, 370, 371, 374-375, 378.

Kultura, arti dhë letërsia në RPSh

— politika dhe kujdesi i

- Partisë; roli dhe funksionet shoqërore edukative të tyre — 1-2, 3, 5-6, 7-8, 9-10, 11-12, 14-15, 221-222, 225-227;
- kultura dhe arti populor e kombëtar; përbajtja, forma dhe novatorizmi — 3-6, 9-10, 11-12;
 - lufta kundër ndikimeve të ideologjisë borgjezo-revizioniste (liberale e konservatore) në letërsi e në art — 2-3, 4, 5, 6-8, 10-11, 12-13, 14-15, 217-219, 239-240, 241-245, 247-249, 318-319, 371-372, 373-377;
 - shkrimtarët dhe artistët; titujt për punën krijuuese — 6-7, 18, 234.

Kultura dhe arti botëror; qëndrimi ndaj tyre — 5-6, 7-8, 13-14, 162-163.

Kushtetuta e RPSh — 104, 110, 112-113, 114, 210, 491.

L

Lenin, Vladimir Ilit — 46, 68, 120, 133, 138, 207, 213, 240, 303, 403.

Letrat, kërkesat dhe ankesat e popullit — 8-9, 247, 497-498.

Lëvizjet dhe luftërat çlirimtare e revolucionare të popujve — 139-140, 402-403, 407, 408, 409, 415.

Liberalizmi dhe lufta kundër shfaqjeve të tij — 13, 62, 199-200, 210-211, 248, 271-272, 296-297, 301-303, 318-319, 327-328, 372-373, 375, 380-381, 431-432, 438, 440-441, 479.

Ligjet. Ligjshmëria në RPSh

- ligjshmëria socialiste dhe ndërgjegjja juridike socialiste — 206-215;
- njojja, propagandimi, zbatimi dhe mbrojtja e tyre; lufta kundër shkelësve të ligeve — 179-180, 206-215, 317, 323-325, 328-329, 478-479, 490-491.

Ligjet objektive të shoqërisë dhe të natyrës; domosdoshmëria e njojjes së tyre — 333, 334.

Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare e popullit shqiptar — studimet dhe botimet për luftën. Përvoja, mësimet dhe rëndësia e saj — 117, 118, 119, 227, 276-284, 476.

Lufta e klasave në shoqërinë tonë dhe në Parti

- kuptimi marksist-leninist i luftës së klasave dhe zhvillimi i saj: lufta e klasave në fushën ideologjike — 241, 294-295, 309, 314-316, 482;
- lufta kundër veprimitarisë armiqësore antiparti të F. Paçramit, T. Lubonjës

- etj. — 243-244, 252-253, 297, 366-384;
- qëndrimi ndaj të metave e gabimeve dhe ndaj elementeve që gabojnë dhe bëjnë faje — 242-245, 311-312, 369-371, 330-331, 382, 480, 496-502.

M

- Marksizëm-leninizmi* — armë dhe busull për udhëheqje e reprim; studimi i tij — 68, 255-258, 262-263, 342, 403, 406.
Marks, Karl — 68, 133, 240, 303.

Mbrojtja e atdheut

- përgatitja dhe gatishmëria e plotë ushtarake e ushtrisë, e gjithë popullit dhe e vendit për mbrojtje — 37-40, 43-44, 45-56, 116-130, 293-297;
- gjithë populli ushtar; lufta kundër konceptit të ushtrisë kazermë — 45-56, 118-121, 127-123;
- Forcat vullnetare të vetëmbrojtjes popullore; Forcat rezerviste — 47-48, 50-53, 55-56, 76-77, 120.
Metoda dhe stili në punë — 27-28, 70-74, 84-85, 194-195, 206-207, 253-260, 361.
Ministritë — 390-391;
 - Ministria e Mbrojtjes

- Popullore — 49;
- Komisioni i Planit të Shtetit — 22, 265;
- Ministria e Industrisë dhe e Minierave — 428, 429, 432-433;
- Ministria e Bujqësisë — 87, 89-90, 95, 96, 113, 192, 332, 350, 353, 356, 359, 432-433;
- Ministria e Tregtisë — 435-436;
- Ministria e Arsimit dhe e Kulturës — 261, 262, 263, 325, 371, 438, 439.
Mirëqenia në shoqërinë tonë socialiste; rritja e vazhdueshme e saj — 185-186, 187, 320-321, 393-399, 476-477.
Muzika; lufta kundër shfajçeve liberale e dekadente në muzikë — 4-8, 9-10, 11-12, 226, 241-242, 243, 244, 247, 374.

N

- Nafta* — zhvillimi i industrisë së naftës dhe përdorimi me kursim i karburantit — 392-393.
Ndërgjegjja socialiste; edukimi dhe forcimi i saj — 253, 270, 310-311, 316.
Ndërtimi i socializmit në Shqipëri — politika e Partisë për ndërtimin socialist të rendit — 3-4, 132-133, 240-241,

316-317, 403-404, 473, 475-476.

O

Organizata-bazë e Partisë

- mbledhja e organizatës-bazë; gjallërimi dhe revolucionarizimi i saj — 83-85, 450-451;
- detyrat dhe kujdesi i saj në përgatitjen ushtarakë të punonjësve për mbrojtje — 124-125, 130;
- organizata-bazë e Partisë në shkollë — 24, 167, 170.

P

Paga; politika e Partisë në fushën e pagave — 182-187, 338, 388-389, 432.

Partia e Punës e Shqipërisë
— ndërtimi dhe jetë e brendshme e saj

- Statuti i Partisë — 79, 82-83;
- roli udhëheqës. Vendimet, direktivat, dokumentet; lufta kundër atyre që i shtrembërojnë dhe i shkelin ato — 22, 40, 97, 132-133, 190, 200, 242, 246-247, 326, 336, 343-344, 348, 395-399, 472, 478, 490, 501-502;
- karakteristikat revolucionare marksiste-leniniste

- të saj — 297-301, 480-481;
- lidhjet me masat, demokracia e brendshme dhe disiplina; zgjedhjet në Parti — 79-85, 460-462;
- përvërja shoqërore, mosha dhe stazhi. Pranimet në Parti — 449-453.

Partia e Punës e Shqipërisë

- organet udhëheqëse qendrore të saj
 - Kongresi VI i PPSH (1-7 nëntor 1971) — 187, 338, 341, 385;
 - Komiteti Qendror dhe plenumet e tij. Byroja Politike, Sekretariati dhe sekretarët e KQ — 21-25, 26-29, 94-95, 98, 133, 180, 183, 184, 186, 193-197, 205, 219, 252-253, 261, 341, 359, 388, 466, 478, 492, 493;
 - Plenumi i 3-të i KQ të PPSH (5-6 shkurt 1973) — 171-205;
 - aparati i KQ të PPSH — 27-28, 56-57, 253, 263, 332, 373;
 - studimet dhe materialet për organet udhëheqëse të Partisë — 21-25, 93-95, 264-265, 274-275, 332-333, 335, 338, 385-387, 499-500;
 - Letra e KQ të Partisë për bujqësinë (janar 1971) — 190, 335-336.

Partia e Punës e Shqipërisë — organizatat dhe komitetet e Partisë në rrethe dhe në ushtri

- konferenca e Partisë e rrethit; përfaqësia e saj. Komiteti i Partisë i rrethit; plenumi dhe anëtarët e tij — 80-85, 253, 450;
- lidhjet dhe bashkëpunimi i komiteve të Partisë të rretheve me ushtrinë. Roli udhëheqës dhe detyrat e tyre në përgatitjen ushtarake të punonjësve — 54-56, 59-60, 76-77, 125-127;
- organizatat dhe komitetet e Partisë në ushtri — 37, 63, 65, 67, 72-73, 125, 127-128;
- organizata dhe Komiteti i Partisë i Rrethit të Tiranës — 167, 191, 253, 370, 377-378, 383.

Partia marksiste-leniniste; roli udhëheqës i saj në revolucion dhe në ndërtimin socialist — 402, 403, 409, 480-481.

Përvoja e përparuar; përgjithësimi i saj — 96, 430-431.

Planet, planifikimi i ekonomisë popullore

- metodologja e planifikimit. Komisionet dhe specialistët e planifikimit — 274, 385-399;

- plani i gjashtë pesëvjeçar (1976-1980). Planet perspektive dhe programe — 21-23, 285-399;
- puna për plotësimin e planeve; realizimi i planeve ritmikisht, në sasi, cilësi, assortiment dhe në tregues financiarë — 94, 172-182, 270-271, 320-321;
- planet, planifikimi në bujqësi dhe në kooperativat bujqësore; puna për realizimin e tyre — 90, 97-98, 192-193, 338-339, 360, 457-459.

Politika e jashtme e RPSh

- parimet themelore marksiste-leniniste të politikës së jashtme. Përkrahja internacionale për lëvizjet dhe luftërat clirimtare dhe revolucionare të popujve — 137-138, 281-283, 289, 408-409, 411-412, 414;
- solidariteti dhe përkrahja internacionale për Vietnamin dhe Korenë — 137-138, 147-148, 151-154, 285-286, 290-291, 293, 405-406, 411-412, 416;
- lësta për demaskimin e imperializmit dhe revisionizmit — 142-143, 148-149, 150-151, 290-291, 408.

Politika në plan të parë. Vështrimi i problemeve me syrin politik — 31-32, 37.

Populli shqiptar — vitytet moral-politike, traditat patriotike revolucionare — 124, 280-282, 294-295, 299-300.

Popullsia — të dhëna demografike — 267-269.

Prona socialiste — forcimi dhe luftha kundër vjedhjeve dhe shpërdorimeve të saj — 213, 231, 324-325, 491.

Psikologjia mikroborgjeze dhe luftha kundër saj — 312-316.

Puna — organizimi dhe drejtimi shkencor. Qëndrimi socialist ndaj saj — 320-321, 323, 484-485;

- rendimenti; normal dhe normimi i punës — 94-95, 182-184.

R

Radiotelevizioni Shqiptar — 7-8, 9, 242, 243, 253, 318-319.

Revolucionarizimi i jetës së vendit — 197-205, 241, 293-302, 327-329, 475-476, 480-482, 494-495, 496-502.

Rezervat shtetërore — 251, 270, 394, 398-399.

Rinia dhe BRPSH

- politika dhe kujdesi i Partisë për rininë. Edukimi ideopolitik, moral e kulturor i saj dhe luftha

kundër shfaqjeve të huaja — 8-9, 24, 168-170, 198-200, 201-202, 204, 216-231, 232-233, 236-237, 247, 249, 253-254, 265-266, 300, 319-320, 422-423, 432-483;

- rinia punëtore; rinia koooperativiste — 234-236, 265-266;

- rinia shkolllore dhe studenteske. Organizata e rinisë në shkollë — 44, 64, 167, 217-218, 223-225, 231, 423-426;

- organizata e rinisë në ushtri — 57, 63-64.

RR

Rrethimi, blokada e presioni imperialisto-revisionist dhe luftha për përballimin dhe çarjen e tij — 2-3, 237-238, 249-250, 269-270, 273-274, 293-329, 391-392, 394, 473-474.

S

Stalin, Josif Visarionoviç — 68, 133, 153, 180-181, 183, 240, 287, 304, 305, 403.

SH

Shfaqjet e huaja dhe luftha kundër tyre — 9, 23, 163-170, 196-205, 217-219, 241-242, 249-250, 251, 270-273, 309-

-323, 342-343, 348, 438, 477-
-478, 496-497.

Shkenca në RPSH

- studimet në fushën filozofike, ekonomike, historike etj. — 262, 376-384, 386-397, 441;
- shkencat bujqësore; studimet në bujqësi — 191-192, 330-334, 335-336, 337-339;
- shkencetarët, punonjësit shkencorë; titujt dhe gradat shkencore — 16-18, 19, 133-135, 157-158, 159, 443-448.

Shkolla e Lirë Ushtarake — 46-48, 120.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës — politika e luftës dhe e agresionit; kriza dhe disfatat — 141-142, 144-145, 146-147, 149-151, 407, 409-411, 412-413.

T

Teoria dhe praktika; uniteti dialektik i tyre — 257, 332.

Të drejtat dhe detyrat e shtetasve — 323-324, 328, 485, 491.

Tregtia e brendshme — shpërndarja e produkteve; furnizimi i popullsisë — 177, 178, 272-273, 320, 485-486.

Tregtia e jashtme dhe organet e saj; importi dhe pakësimi i tij — 178, 389-390, 435-436.

U

Uniteti i popullit, uniteti Parti-popull — 118-119, 474-475, 481, 501-502.

Universiteti i Tiranës (Universiteti i Tiranës «Enver Hoxha») — 42-43, 155-170, 255-263, 437-443.

Ushtria Popullore

- roli udhëheqës i Partisë. Vendimet dhe direktivat e Partisë për ushtrinë — 30-31, 40-41, 65-68;
- roli dhe detyrat e saj për mbrojtjen e atdheut. Stërvitjet, forcimi i disciplinës dhe revolucionarizmi i ushtrisë — 45-46, 61-63, 69-75, 121, 128-129, 295-296;
- puna ideopolitike dhe përgatitja ushtarake, programet — 30-45, 47-48, 54-56, 61-63, 66-78, 121-122, 128-129;
- kuadrot politikë e ushtarakë (komisarët, komandanët), ushtarët. Përgatitja, kualifikimi i tyre. Marrëdhëniet kuadër-ushtarë — 31-37, 38-42, 43-45, 48-49, 50, 57-63, 69, 70-74, 75-77, 125-127;
- Drejtoria Politike — 32, 40-41, 49, 55-56, 59, 65-66, 67-68, 77;

- komandat, shtabet. Bashkëpunimi dhe bashkërendimi ndërmjet armëve, shërbimeve, reparateve e njësive ushtarake — 37, 72-74, 125, 128-129;
- armatimi dhe teknika luftarake; zotërimi dhe mirëmbajtja e tyre. Qitja, rritja cilësore e qitjes — 36-38, 73-76, 121-122, 130;
- domosdoshmëria e njohjes dhe e vlerësimit të armikut (e armëve, e strategjisë dhe e taktilës së tij) — 37-39, 121-122;
- kontrolli punëtor (ushtar) në ushtri — 56-61;
- lidhjet dhe bashkëpunimi me terrenin; detyrat e ushtarakëve në përgati-

- tjen e popullatës për mbrojtje — 49-56, 59-60, 65, 76-77, 125-127;
- lufta kundër shablonizmit dhe rutinës në ushtri — 44-45, 70-72.

V

Vietnam — lufta e popullit vietnamez për liri e bashkim kombëtar kundër agresorëve amerikanë — 137-142, 145-147, 152-153, 290, 405-406, 409-411, 412.

ZH

Zhvillimi dialektik — lufta e të kundërtave si burim zhvillimi — hopi në shoqërinë tonë socialiste — 333-334, 482.

TREGUESI I EMRAVE

A

- Alia, Ramiz — 26, 30, 262, 364,
372, 373, 377, 382, 383, 448.
Aristofani — 229.
Ajzenhauer, Duajt — 140.

B

- Baboçi, Agim — 422.
Baboçi, Arben — 424.
Baboçi, Irfanc — 417, 426.
Baboçi, Kadri — 417-420.
Balluku, Beqir — 32-33, 46.
Bekteshi, Mehmet — 463-464.
Bilali, Kamber — 229.
Bonaparti, Napoleon — 162-
-163.
Brezhnjev, Leonid — 140, 144,
148, 409, 411.
Buda, Aleks — 19, 135, 136,
443.

C

- Cami, Tefta — 363.

Ç

- Çarçani, Adil — 171.
Çabej, Arshi — 421.

- Çabej, Eqrem — 135.
Çako, Hito — 32-33, 34, 46, 56.
Çani, Elmaz — 420.
Çelo, Sadik — 421.
Çoçoli, Fatime — 421.

D

- Deçka, Stefan — 420.
Deliana, Thoma — 244.
Dode, Petro — 195-196, 350,
454.
Dume, Petrit — 32-33, 46.
Dyma, Aleksandër — 229.

G

- Gierek, Eduard — 143.

GJ

- Gjini, Hamdi — 465-466.

H

- Hoxha, Nekhmiye — 284, 417.
Hoxha (Çipi), Haxhire — 421.
Hoxha, Iljaz — 421.
Hoxha, Sanije — 420.
Homeri — 229.

Hrushov, Nikita — 140, 145,
148.

Hysein, Abdullah — 414-415.

I

Ibrahimî, Nesip — 468.

J

Jorgji, Eriketa — 471.

K

Kapo, Hysni — 18-19, 26, 27,
28, 80, 131, 193, 372-373, 377,
378-379, 381, 383-384, 438,
446, 460.

Kapo, Vito — 340.

Kadar, Janosh — 148.

Kao Ki — 141.

Karagjozi, Qemal — 420.

Kim Ir Sen — 285.

Kofina, Samuel — 229.

Kondi, Pirro — 460.

Kongo, Ilia — 241.

Krutani, Avdulla — 468.

Kuneshka, Sotir — 158.

Kurti, Shtjefën — 483-484.

L

Lon Nol — 290.

Luarasi, Mihallaq — 378.

Lubonja, Todi — 9, 243, 378,
381.

M

Marko, Rita — 460, 496.

Myftiu, Manush — 373, 381,
382-383.

Matiez, Alber — 277.

Mero, Agim — 216, 243.

Misa, Klimi — 378.

Mishle, Zhyl — 277.

Molier, Zhan-Baptist Pokëlen
— 224.

N

Nenshati, Ferdinand — 471.

Ngo Din Diem — 139, 145.

Nguyen Ksuan Thui — 405.

Nguyen Tin Bin — 142.

Nguyen Van Thieu — 139, 141,
145, 147, 149, 152, 290.

Nikson, Riçard — 140, 143, 145,
146, 147, 148, 149, 150, 409,
412.

P

Paçrami, Fadil — 252-253, 297,
311, 366-384.

Pak Çen Hi — 285, 288, 290.

Pani, Jordan — 375.

Peristeri, Pilo — 431.

Pikaso, Pablo — 217.

Pinkerton, Alen — 229.

Poshi, Xhafo — 421.

Prifti, Daniel — 460.

R

Rexha, Lumturi — 243.

S

Sadat, Anvar — 144.

Sako, Ylvic — 469.

Sako, Zihni — 419.

Sartr, Zhan Pol — 11.

Savonarola, Xhirokamo — 202.

Selso, Aqif — 420.

Sfile, Irakli — 467-468.

Siliqi, Lazar — 368, 369.

Sina, Petrit — 469-470.

Spahiu, Xhevahir — 10, 11.

SH

Shapillo, Siri — 419.

Shehu, Fejzi — 471.

Shehu, Mehmet — 9, 97, 330.

Shekspir, Ulliam — 224.

Shtino, Emin — 420.

Shtino, Ferik — 420.

T

Toska, Haki — 26, 27, 28, 193.

Ten, Ipolit — 277.

Tito, Josip Broz — 144, 415.

Torozi, Agim — 471-472, 492.

TH

Theodhosi, Koço — 428.

U

Uruçi, Ibrahim — 384.

V

Vasili, Koço — 375, 378.

XH

Khafa, Muharrem — 364-365.

Khindolli, Veli — 470.

Khonson, Lindon — 140.

Y

Ylli, Kahreman — 1, 14.

Z

Zogu, Ahmet — 419.

ZH

Zhores, Zhan — 277.

TREGUESI GJEOGRAFIK DHE I EMERTIMEVE TË TJERA

A

- Afrikë — 291, 413.
Akademia Ushtarake — 41-43.
Amerika Latine — 291.
Azi — 291.

B

- Britania e Madhe — 147.
Burizanë (Krujë) — 365.

C

- Çamëri — 283.

D

- Dien Bien Fu (Vietnam) — 139, 146.
«Drita» (gazeta) — 10.
Durrës — 463.

E

- Egjipt — 413-414.
Elbasan — 206, 209, 211, 212, 463.
Evropë — 240, 298.

F

- Festivali i 11-të i Këngës në Radiotelevizion — 242-243, 244,

247, 252-253, 374.

Festivali i Parë Folklorik Kombëtar — Gjirokastër — 418.
Francë — 147, 277-278, 413.
Fronti Kombëtar i Çlirimtë Vietnamese — Jugut, Qeveria Revolucionare e Përkohshme e Republikës së Vietnamese — Jugut — 142, 147-148, 290.

G

Gdansk [Dancig] (Poloni) — 148.
Gorë (Korçë) — 451.
Gramsh — 357.

GJ

«Gjenerali i ushtrisë së vdekur» (romani~, I. Kadare) — 227.
Gjermania Perëndimore (RF e Gjermanisë) — 413.
Gjirokastër — 229, 321, 418-421.

H

Hanoi — 146.
Hajfong (Vietnam) — 146.

«Historia e Artit Ushtarak Popullor të Luftës Nacionalçlirimtare» (teksti ~) — 278.
«Historia e Luftës Nacionalçlirimtare e popullit shqiptar» (teksti ~) — 276-284.
«Historia e Partisë së Punës të Shqipërisë» (teksti ~) — 232.
«Historia e Shqipërisë» (teksti ~) — 281, 282.
Historikët e brigadave partizane — 279-280, 284.
Historikët e qarqeve e të rretheve — 279-280, 284.
Hungari — 148.

I

Instituti i Lartë Bujqësor — Tiranë — 87.
Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste pranë KQ të PPSH — 262, 264, 275, 276, 284.
Itali — 5-6, 413, 415.
Izrael — 413-414.

J

Jordani — 414.
Jugosllavi — 283, 415.

K

Kaninë (Vlorë) — 178.
Këshilli i Përgjithshëm Nacionalçlirimtar — 282.

Kinostudio «Shqipëria e Re» — 371.
Kodi Civil — 104.
Kombinati i Drurit — Laç — 178.
Kombinati i drurit «Misto Mamme» — Tiranë — 493.
Kombinati i Pulave — Tiranë — 467.
Kombinati i Tekstileve — Berat — 487.
Kombinati i tekstileve «J. V. Stalin» — Tiranë — 487.
Kombinati Metalurgjik (Kombinati metalurgjik «Çeliku i Partisë») — Elbasan — 463-464, 465, 488, 489, 492.
«Komisari Memo» (romani ~, D. Agoll) — 227.
Komisioni Qendror për Arsimin pranë KQ të PPSH — 439.
Konferanca (marrëveshja) e Gjenevës (26 prill — 21 korrik 1954) — 139, 147.
Konferanca (marrëveshja) vietnamezo-amerikane — Paris (tetor 1972) — 143, 146, 148.
Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe — (20-25 nëntor 1972) — 20.
Kongresi i 6-të i BRPSH (23-26 tetor 1972) — 219.
Kongresi i 7-të i BGSh (11-14 qershor 1973) — 341, 347, 348.
Kooperativa Bujqësore e Tipit

të Lartë (Ndërmarrja bujqësore «Enver Hoxha») — Plasë — Korçë — 96, 137, 338.
 Korçë — 455.
 Koreja e Jugut — 287-288.
 Kosovë — 282-283.
 «Kronikë në gur» (romani ~, I. Kadare) — 227.
 Kryesia e Bashkimit të Grave të Shqipërisë — 340-341.

L

Laknas (Tiranë) — 104.
 Lezhë — 178.
 Liban — 414.
 Liceu — Gjirokastër — 421.
 Liceu Kombëtar i Korçës — 162, 421.
 Lidhja e Shkrimtarëve dhe e Artistëve — 377-378, 384.
 Lindja e Mesme — 291, 412-414.
 Lufta e Parë Botërore — (1914-1918) — 407.
 Lufta e Dytë Botërore (1939-1945) — 305, 407.
 Lufta e Vlorës e vitit 1920 kundër imperializmit italian — 281.
 «Lumi i vdekur» (romani ~, J. Xoxa) — 227.
 Lushnjë — 8, 91, 178.

M

Maqedoni — 283.

N

Ndërmarrja e Ndërtimit të Linjave të Tensionit të Lartë — Tiranë — 467.
 «Nëntori» (revista ~) — 10.
 Ndërmarrja e Sharrave — Pukë — 493.

NJ

«Njollat e murime» (drama ~) — 244.

P

Palestina, palestinezët — 414-415.
 Partia Komuniste e Greqisë — 153.
 Partia e Punës e Koresë — 287, 291.
 Partia Komuniste (revisioniste) e Bashkimit Sovjetik dhe Kongresi i 20-të i saj — 304, 305.
 Pojan (Korçë) — 451.
 Poloni — 148.
 Porti i Durrësit (Porti detar i Durrësit «Enver Hoxha») — 181, 492.
 Porti i Vlorës — 22.

R

Reforma Agrare — 108, 132.
 Revolucioni i Madh Socialist i Totorit — 280, 305.
 Romë — 202.

S

- Seul — 290.
 Siri — 414.
Skrapar — 363-364.
 Statuti i Kooperativave Bujqësore — 104, 107, 109.

SH

- Shkolla e bashkuar e oficerëve «Enver Hoxha» — 41-43.
 Shkolla e lartë e Partisë «V.I. Lenin» — 42, 262, 439.
 Shkolla Normale — Gjirokastër — 419.
 Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacionalçlirimtare — 282, 283.

T

- Teatri i Operës dhe i Baletit — 225, 371, 375, 378.
 Teatri Popullor — 374, 376.
 Tepelenë — 4, 458.
 Tiranë — 253, 367, 463.

U

- Uzina «Enver» — Tiranë — 430.

Uzina e Sodës Kaustike — Vlorë — 178.

Uzina Mekanike Bujqësore — Durrës — 160-161, 470, 493.
 Uzina mekanike «Drini» — Shkodër — 434.

Uzina mekanike e Kombinatit Metalurgjik (Kombinati metalurgjik «Çeliku i Partisë») — Elbasan — 464.
 Uzina «Traktori» (Kombinati i autotraktorëve «Enver Hoxha») — Tiranë — 59-60, 430, 431, 464.

V

Vatikani — 415, 483, 484.
 Vendet arabe — 413-414.
 Vlorë — 241, 242.

Z

«Zëri i popullit» (gazeta ~) — 344.
 «Zëri i rinisë» (gazeta ~) — 242-243.

L E N D A

PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 50-TË V—IX

1973

| | |
|---|-------|
| ZHVILLIMI I LETËRSISË DHE I ARTEVE TË BE- HET NË LUFTË KUNDËR ÇDO NDIKIMI TË HUAJ IDEOLOGJIK — Diskutim në mbledhjen e Presidiu- mit të Kuvendit Popullor të RPSH (9 janar 1973) | 1—15 |
| DISA PROBLEME TË AKADEMISË SË SHKENCAVE QË KËRKOJNË STUDIM E DISKUTIM — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (10 ja- nar 1973) | 16—20 |
| VLERA E MATERIALEVE QË NA PARAQITEN VA- RET NGA BRENDIA E TYRE — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (10 janar 1973) | 21—25 |
| TË TREGOJMË KUJDES PËR SHËNDETIN E SHO- KËVE TË UDHËHEQJES — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (10 janar 1973) | 26—29 |
| PUNA IDEOPOLITIKE E KULTURORE NË USHTRI T'I SHËRBEJË MBROJTJES SË ATDHEUT — Fjala në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (19 ja- nar 1973) | 30—78 |

| | |
|---|---------|
| DEMOKRACINË TA ZHVILLOJMË KURDOHERË NË INTERES TË FORCIMIT TË PARTISË — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (19 janar 1973) | 79—85 |
| BUJQËSIA ÇOHET PËRPARA ME NJERËZ TË KU- ALIFIKUAR — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (19 janar 1973) | 86—92 |
| ZBATIMI I DIREKTIVËS KËRKON KONTROLL TË FORTË NGA ORGANET E PARTISË DHE TË SHTETIT — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (22 janar 1973) | 93—99 |
| NË PUNËN PRODHUESE NXËNËSIT E STUDENTËT KALITEN, POR EDHE MËSOJNË NJË PROFESION — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (22 janar 1973) | 100—103 |
| KALIMI I KOOPERATIVAVE NË NDËRMARRJE BUJQËSORE TË BËHET I MATUR DHE NË MËNYRË TË STUDIUAR — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (22 janar 1973) | 104—115 |
| TË GJITHA FORCAT E POPULLIT USHTAR TË JENË KURDOHERË NË GATISHMËRI TË PLOTË — Diskutim në mbledhjen e organizatës-bazë të Partisë ku bën pjesë (23 janar 1973) | 116—130 |
| AKADEMIA E SHKENCAVE DO T'I JAPË NJË HOV TË MADH ZHVILLIMIT TË SHKENCËS SONË — Nga biseda me anëtarët e Akademisë së Shkencave të RPSH (25 janar 1973) | 131—136 |
| VETËM ME LUFTË POPUJT MUND TË FITOJNË LIRINË — Nga biseda me ambasadorin e RD të Vietnamit dhe me ambasadorin e Republikës së Vietnamit të Jugut (26 janar 1973) | 137—154 |

| | |
|--|---------|
| UNIVERSITETI — SHKOLLË E MADHE PËR PËRGATITJEN E KUADROVE DHE EDUKIMIN REVOLUCIONAR TË RINISË — Nga biseda me rektorin e Universitetit të Tiranës (27 janar 1973) | 155—170 |
| PLOTËSIMI I DETYRAVE TË PLANIT MBETET SI KURDOHERË FRONTI KRYESOR I PUNËS SË PARTISE DHE I MASAVE TË GJERA PUNONJËSE TË QYTETIT DHE TË FSHATIT — Nga fjala e mbylljes në Plenumin e 3-të të KQ të PPSH (6 shkurt 1973) | 171—185 |
| LIGJET TONA SHPREHIN POLITIKËN E PARTISE DHE VULLNETIN E POPULLIT — Diskutim në mbledhjen e Presidiumit të Kuvendit Popullor të RPSH (15 shkurt 1973) | 206—215 |
| ÇDO GJË NË VENDIN TONË BEHET PËR RININË — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (23 shkurt 1973) | 216—254 |
| MBI DISA PROBLEME TË LËNDËVE SHOQËRORE NË UNIVERSITET DHE NË SHKOLLAT E LARTA — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (23 shkurt 1973) | 255—263 |
| RRITJA E KLASES PUNËTORE — TREGUES I RËNDËSISHËM EKONOMIK, SHOQËROR E IDEOPOLITIK — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (26 shkurt 1973) | 264—275 |
| TA PËRSHKRUAJMË REALISHT LUFTËN TONË QË NGA FILLIMI E GJER NË FUND — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (26 shkurt 1973) | 276—284 |
| QËLLIMIN STRATEGJIK TA REALIZOJMË PA SHKELUR PARIMET — Nga biseda me ambasadorin e RDP të Koresë (13 mars 1973) | 285—292 |

| | |
|--|---------|
| SI DUILLET KUPTUAR DHE SI DUHET LUFTUAR RRETHIMI IMPERIALISTO-REVIZIONIST I VENDIT TONË DHE EFEKTI I PRESIONIT TË TIJ MBI NE — Fjala në mbledhjen e përgjithshme të komunistëve të aparatit të KQ të Partisë për dhënien llogari e zgjedhje (15 mars 1973) | 293—329 |
| EKONOMITË MODERNE KËRKOJNË FORMA E METODA TË REJA PUNE — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (26 mars 1973) | 330—339 |
| PËRPARIMIN E SHOQËRISË TA MATIM ME PËRPARIMIN E GRUAS — Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (26 mars 1973) | 340—349 |
| ATJE KU KA KONSERVATORIZËM PËR FUTJEN E MEKANIZIMEVE, NUK KA BUJQËSI MODERNE — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (28 mars 1973) | 350—361 |
| TU KRIJOJMË KUSHTE TË RINJVE E TË REJAVE PËR TU NJOHUR ME NJËRI-TJETRIN — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (28 mars 1973) | 362—365 |
| TË LUFTOJMË NË TË DY KRAHËT. SI KUNDER KONSERVATORIZMIT, ASHTU EDHE KUNDER LIBERALIZMIT — Nga biseda me Fadil Paçramin (30 mars 1973) | 366—384 |
| TË HARTOJMË NJË PLAN REAL, TË NGJESHUR SIÇ E KËRKOJNË SITUATAT — Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (11 prill 1973) | 385—399 |
| MIQËSIA RUHET, ZHVILLOHET E KALITET EDHE DUKE SHKËMBYER GRUPE ARTISTIKE E SPORATIVE — Nga biseda në takimin me trupën e cirkut të Shangait dhe me ekipet kombëtare të basketballit të Kinës (14 prill 1973) | 400—404 |

| | |
|--|---------|
| MARKSIZËM-LENINIZMI ËSHTË E VETMJA BUSHUELL E PAGABUESHME PËR T'U ORIENTUAR NË VLERËSIMIN E SITUATAVE — Nga biseda me ministrin e Republikës Demokratike të Vietnamit, Nguyen Ksuan Thui (18 prill 1973) | 405—416 |
| SA MË SHUMË KALON KOHA, AQ MË TEPEËR NA PËLQEN VENDLINDJA — Nga biseda në familjen e shokut Kadri Baboçi (18 prill 1973) | 417—426 |
| TË PËRSOSET ORGANIZIMI I PUNËS NË UZINAT E MËDHA MEKANIKE — Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (24 prill 1973) | 427—436 |
| KUALIFIKIMI SHKENCOR ARRIHET ME PUNË TË MADHE E ME SAKRIFICA — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (25 prilli 1973) | 437—448 |
| ÇËSHTJET QË NGRENË KOMUNISTËT, TË STUDIOHEN NË MËNYRË SHKENCORE NGA KOMITETET E PARTISË — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (27 prill 1973) | 449—453 |
| VËSHTIRËSITË KAPËRCEHEN ME PLANIFIKIM E ORGANIZIM TË MIRE — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (27 prill 1973) | 454—459 |
| SHKËMBIMI I MENDIMEVE MIDIS MASAVE DHE UDHEHEQËSVE ËSHTË KURDOHERË I DOBISHËM — Nga biseda me një grup punëtorësh të rrëtheve Tiranë, Durrës dhe Elbasan (28 prill 1973) | 460—495 |
| KRITIKA KUNDËR SHFAQJEVE TË HUAJA NUK E ERRËSON TË TËREN QË ËSHTË POZITIVE — Nga biseda me sekretarët e KQ të PPSH (30 prill 1973) | 496—502 |
| Treguesi i lëndës | 505 |
| Treguesi i emrave | 517 |
| Treguesi gjografik dhe i emërtimeve të tjera | 521 |